Problem i fazave të kryerjes së veprës penale është i lidhur ngushtë dhe me institutin e heqjes dorë nga kryerja e veprës penale pasi jo në të gjitha fazat personi mund të heqë dorë vullnetarisht. Ai në mënyrë vullnetare e përfundimtare heq dorë nga përgatitja, tentativa e metë, ndërsa ajo e plotë nuk mund të heqë dorë. Për këtë problem ka pikëpamje të kundërta në literaturë juridike, sepse disa autorë pranojnë heqjen dorë nga tentativë e plotë, por sipas pikëpamjes sonë kjo nuk gjen mbështetje as teorike dhe as në praktikën tonë gjyqësore.

Që një person të ngarkohet me përgjegjësi penale duhet të ketë prekur ose të ketë krijuar një rrezik imediat për një marrëdhënie shoqërore të caktuar. Duke u nisur nga ky parim, megjithëse i jepet rëndësi anës subjektive, nuk merren në përgjegjësi penale personat në mendjen e të cilëve kanë lindur e janë shfaqur mendime për kryerjen e një vepre penale.

Kjo sepse ato jo vetëm që nuk prekin ndonjë raport shoqëror por as e rrezikojnë atë. Përgatitja për kryerjen e krimeve paraqet në vetvete një shkallë rrezikshmërie shoqërore që e bën të panevojshme marrjen e masave penale.

Edhe në tentativën, megjithëse nuk kemi pasojë kriminale, përderisa ekziston mundësia për të ardhur ajo, ligji konsideron atë të dënueshme vetëm për krime. Në përgatitje në tentativë mungon rezultati shoqërisht i rrezikshëm dhe ky rezultat mund të mos vijë për shkaqe të varura ose të pavarura nga vullneti i personave, ose se veprimtaria paraprake kriminale ka qënë e pamjaftueshme ose se ai nuk ka parashikuar të gjitha rrethanat që do ti dilnin përpara, gjatë çuarjes deri në fund të veprimtarisë paraprake kriminale.

Për përcaktimin e fazave të veprimtarisë paraprake kriminale.

Për përcaktimin e fazave të veprimtarisë paraprake kriminale duhet ndalur vetëm në ato moment të kryerjes së krimit me dashje , të cilat shfaqen me veprime të jashtme konkrete dhe janë te pandara nga kombinimi i momentit objektiv dhe subjektiv.

Fazat e veprimtarisë paraprake kriminale autorë të ndryshëm i përcaktojnë në mënyrë jo të njëjlojtë. Shumica e autorëve mendojnë se ka tri faza të veprimtarisë paraprake kriminale siç janë shfaqja e mendimit, përgatitja dhe tentativë për kryerjen e një veprë penale. Disa autorë pranojnë vetëm dy faza të veprimtarisë paraprake kriminale që në mënyrë esenciale kanë në mes të tyre dallime të rëndësishme. Keto faza përshtaten me etapan kryesore të çdo veprimtarie të ndërgjegjshme që nuk kanë rezultat të menduar dhe të zhvillimit të veprës penale në lindjen e mendimit. Me lindje mendimi kuptohet prania në mendjen e personit në një moment të caktuar të mendimit për të kryer një veprë shoqërisht të rrezikshme, kur ky mendim nuk ka gjetur asnjë shprehje në botën e jashtëme dhe nuk ka influencuar në sjelljen e personave të tjerë .

Veprimi ose mosveprimi që formon veprën penale është veprimtari e ndërgjegjshme e drejtuar në një objekt të caktuar, ndërsa lindja e mendimit, si rregull i përgjithshëm nuk drejtohet në po atë objekt për të cilin do të kryhet vepra penale.

Marrëdhënia shoqërore, e cila vihet në rrezik është karakteristikë e veçantë e të gjitha fazave të veprimtarisë paraprake kriminale për kryerjen e një veprë penale të caktuar.

## ***2-Kuptimi i tentativës, cilat vepra mund të ngelen në tentativë?***

Për të përcaktuar faktin nëse kjo veprat ngelen apo jo në tentativë, do të duhet të japim në mënyrë shumë të përmbledhur kuptimin që ligji penal i jep tentativës. Sipas Kodit Penal, vepra penale konsiderohet e mbetur në tentativë, në rastet kur subjekti i veprës penale ka kryer veprime të drejtëpërdrejta për realizimin e veprës penale, por ajo është ndërprerë për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tij.<sup>1</sup>

Nga përcaktimi që ligji i bën kuptimin të tentativës, rezulton se në mënyrë që të jemi para një veprë penale të ngelur në fazën e tentativës, duhet që të plotësohen njëkohësisht këto dy kushte:

**Së pari:** Duhet që subjekti i veprës penale të ketë kryer veprime të drejtëpërdrejta për realizimin e veprës penale dhe

**Së dyti:** Duhet që kryerja e veprës penale të jetë ndërprerë dhe të mos ketë përfunduar për shkaqe që nuk varen nga vullneti i këtij personi.

Problemi që ka hasur më shumë në praktikë në lidhje me kuptimin e tentativës është kushti i dytë që ka të bëjë me ndërprerjen dhe mospërfundimin e veprës penale për shkaqe që nuk varen nga subjekti i veprës penale. Në këtë rast shtrohen pyetjet: Ç'farë

<sup>1</sup>(Kodit Penal,22 përcakton:“Vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtëpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet dhe nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij”).



duhet të kuptojmë me ndërprerje dhe mospërfundim të veprës penale? Ndërpreja ose mospërfundimi i veprës penale, i referohet vetëm mosardhjes së pasojës kriminale, apo ndërpreja dhe përfundimi i veprës penale ndodh edhe në rastet kur vepra penale nuk ka pasojë? Ose thënë me qartë, tentativa është një institut i të drejtës penale që zbatohet vetëm tek veprat penale që kërkojnë detyrimisht ardhjen e pasojës kriminale apo zbatohet në të gjitha llojet e veprave penale?

Për të dhënë përgjigje në lidhje me këto pyetje do të duhet t'i referohemi teorisë së të drejtës penale dhe për këtë do të duhet të referohemi në autorë të ndryshëm. Nga ana e teorisë së të drejtës penale, veprat penale nga pikëpamja e faktit nëse kërkojnë ose jo ardhjen e pasojës, në mënyrë që të konsiderohen të kryera në mënyrë të plotë, ndahen në vepra *penale materiale* dhe *vepra penale formale*. Vepra penale materiale konsiderohen ato vepra penale të cilat për t'u konsideruar të kryera plotësisht kërkojnë detyrimisht ardhjen e pasojës kriminale. Si vepra të tilla mund të përmedim veprën penale të "*Vrasjes*" të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, veprën penale të "*Plagosjes së rëndë me dashje*", të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal etj.

Vepra penale formale konsiderohen ato vepra penale të cilat për t'u konsideruar të kryera plotësisht nuk kërkojnë ardhjen e ndonjë pasojë tjetër, përveçse kryerjes së veprimit ose veprimeve konkrete të parashikuara në mënyrë të shprehur nga dispozita. Si të tilla mund të përmendim veprën penale të "*Kalimit të paligjshëm të kufirit*", të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal, veprën penale të "*Nihma për kalimin e paligjshëm të kufijave*" të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, ose veprën penale të fyerjes, të shpifjes etj.

Diskutime dhe debate në teorinë e të drejtës penale ka patur nëse tentativa zbatohet vetëm për veprat penale materiale apo ajo gjen zbatim edhe për veprat penale formale. Në lidhje me kategorinë e veprave penale materiale të cilat, siç u tha më lart, kërkojnë ardhjen e pasojës kriminale, në mënyrë që të konsiderohen të kryera plotësisht, çështja është më e thjeshtë dhe përgjigjia është se këto lloj veprash penale ngelen në fazën e tentativës. Për këtë çështje të gjithë, teoria e të drejtës penale dhe praktika gjyqësore janë të një mendimi dhe në unison me njëri-tjetrin; këto vepra ngelen në tentativë dhe në këto raste konsiderohet se vepra ka ngelur në tentativë, megjithëse, subjekti ka kryer veprime të drejtëpërdrejta për ardhjen e saj, pasoja e veprës penale nuk ka ardhur për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tij. Për shembull, personi E.C ka hasmëri me personin H.D dhe vendos që ta vrasë atë. Për këtë qëllim gjen një armë pistoletë dhe e pret personin H.D që të dalë nga restoranti ku është duke drekuar dhe në momentin që personi H.D del nga restoranti, personi E.C qëllon katër herë në drejtim të tij, por vetëm një nga plumbat qëllon mbi personin H.D, i cili e kap në këmbë, duke i shkaktuar paafësi për punë mbi nëntë ditë. Në këtë rast personi E.C do të përgjigjet për kryerje të veprës penale të "*Vrasjes me paramendim*", të parashikuar nga neni 78/2 i Kodit Penal, të ngelur në tentativë. Vepra penale e "*Vrasjes me paramendim*", të parashikuar nga neni 78/2 i Kodit Penal, ka ngelur në tentativë në rastin konkret, sepse personi E.C ka ndër marrë veprime të drejtëpërdrejta për kryerjen e saj, por pasoja e veprës penale nuk ka ardhur për shkaqe që nuk varen nga vullneti i këtij personi dhe që janë konkretisht mos goditja në shenjë e tij ndaj personit H.D.

Fakti që veprat penale materiale ngelen në tentativë rezultojnë në mënyrë të nënkuptuar edhe nga interpretimi që i bëhet paragrafit të dytë të nenit 23 të Kodit Penal, i cili parashikon përgjegjësinë për tentativën. Ky paragraf përcakton se gjykata në varësi të shkallës së afërsisë së ardhjes së pasojës, si dhe shkaqeve për të cilat krimi mbeti në tentativë, zbut dënimin dhe mund ta ulë atë nën minimumin e parashikuar në ligjose të caktojë një lloj dënimi më të butë se ai i parashikuar në ligj. Kjo dispozitë ligjore e lidh në mënyrë indirekte tentativën e veprës penale me faktin e mosardhjes së pasojës kriminale dhe prej saj mund

të nxjerrim përfundimin se vepra konsiderohet se ka ngelur në tentativë në rastet kur ajo nuk ka sjellë pasojën kriminale, dhe mosardhja e pasojës ka ndodhur për shkaqe që nuk varen nga vullneti i subjektit të veprës penale. Por, nga ana tjetër duhet të kemi parasysh se ky përfundim është i vertetë vetëm për veprat penale materiale, dhe ky përfundim nuk mund të zbatohet për veprat penale formale të cilat nuk kërkojnë ardhjen e pasojës. Përderisa tek këto vepra në mënyrë që të konsiderohen plotësisht të kryera nuk kërkohet ardhja e ndonjë pasojë tjetër përveç kryerjes së veprimit të kundërligjshëm të parashikuar në dispozitën penale, shtrohet çështja a mund të ngelin këto vepra në tentativë apo jo?

Pikërisht kësaj çështjeje do t'i kthehemi tani. Nga teoria e të drejtës penale dhe nga praktika gjyqësore janë mbajtur qëndrime të ndryshme në veprat penale formale mund të ngelin apo jo në tentativë. Në lidhje me këtë çështje autorët ndahen në dy grupe; grupi i parë i autorëve janë të mendimit se veprat penale formale nuk mund të ngelin në tentativë sepse sipas tyre veprimi kriminal në këto vepra nuk mund të ndërpritet dhe vepra penale përfundon në mënyrë të plotë, pasi në këtë rast nuk kërkohen as veprime të tjera e as pasoja për t'u quajtur vepra e plotë. Si shembuj të veprave formale këto autorë përmendin fyerjen, shpifjen, kanosjen etj, (Muçi, 2007, 193). Nga mënyra sesi e interpretojnë këto autorë tentativën në kryerjen e veprës penale, kam mendimin se ato e lidhin tentativën me mosardhjen e pasojës kriminale dhe sipas tyre vepra penale konsiderohet e ngelur në tentativë në qoftë se subjekti ka kryer veprime të drejtpërdrejta për ardhjen e saj, por pasoja nuk ka ardhur për shkaqë që nuk varen nga vullneti i subjektit. Sipas këtyre autorëve, tek veprat penale formale, duke qenë se nuk kërkohet ardhja e ndonjë pasojë në mënyrë që vepra të konsiderohet si e kryer, këto vepra nuk mund të ngelin në tentativë, sepse përderisa sa nuk ka pasojë të veprës penale nuk mund të ketë as tentativë.

Grupi i dytë i autorëve janë të mendimit se veprat penale formale mund të ngelin në tentativë, pavarësisht faktit se tek këto vepra nuk kërkohet ardhja e ndonjë pasojë kriminale përveç kryerjes së veprimit të kundërligjshëm të parashikuar në dispozitën penale. Sipas këtyre autorëve vepra penale formale ngelet në tentativë, sepse edhe në këto vepra personi i kryerjen të gjitha veprimet që drejtohen drejtëpërsëdrejti në realizimin e saj, por vepra ndërpritet nuk përfundon për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij (Elezi&Kaçupi&Haxhia,2001,165). Siç mund të konstatohet këta autorë nuk e lidhin tentativën si fazë e kryerjes së veprës penale, me ardhjen e pasojës ose me mundësinë e ardhjes së saj, por e lidhin me kryerjen nga ana e personit të veprimeve të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale dhe me ndërprerjen e këtyre veprimeve për shkaqe që nuk varen nga vullneti i subjektit të veprës penale.

Nga këto dy grupe autorësh mendimi më i saktë më duket ai i grupit të dytë sipas të cilëve veprat penale formale mund të mbeten në tentativë, ashtu si edhe veprat penale materiale dhe ndërprerja e ardhjes së pasojës kriminale apo mundësisë së ardhjes së saj, nuk është kusht i domosdoshëm, në mënyrë që vepra penale të ngelet në tentativë. Fakti që edhe veprat penale formale mund të ngelin në tentativë rezulton edhe nga vetë kuptimi që Kodi Penal i jep tentativës, sipas të cilit vepra penale konsiderohet e ngelur në tentativë, kur megjithëse personi ka ndërmarë veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e saj, vepra është ndërprerë dhe nuk ka përfunduar për shkaqe që nuk varen nga vullneti i personit.

Siç shihet ligji penal e lidh tentativën vetëm me dy kushte:

**Së pari:** Me ndërmarrjen nga ana e subjektit të veprimeve të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe

**Së dyti:** Me ndërprerjen e veprës penale dhe me mospërfundimin e saj për shkaqe që nuk varen nga vullneti i këtij subjekti.

Në asnjë fjalë apo shkronjë të tij, ligji penal nuk e lidh tentativën me ndërprerjen e ardhjes së pasojës apo me ndërprerjen e mundësisë së ardhjes së saj, por përkundrazi e lidh me ndërprerjen e kryerjes së veprës penale dhe me mospërfundimin e saj. Në këto kushte do të konkludojmë pa frikë se tentativa gjen zbatim edhe në veprat penale formale, krahas atyre materiale.<sup>2</sup>

Por në këtë rast do të duhet të bëjmë një vërejtje të rëndësishme që është; ndërsa tentativa gjen zbatim në të gjitha veprat penale materiale që kryhen me dashje direkte, ajo nuk gjen zbatim në të gjitha veprat penale formale që kryhen po me dashje direkte. Kam mendimin se tentativa gjen zbatim në shumicën e veprave penale formale dhe nuk gjen zbatim vetëm në ato vepra penale formale të cilat kryhen me veprime që për nga natyra e tyre nuk mund të ndërpriten nga shkaqe që nuk varen nga vullneti i subjektit të veprës penale. Në këtë rast është natyra e veprimit të kundërligjshëm i cili përcakton nëse vepra penale ngelet ose jo në tentativë. Në qoftë se veprimi i kundërligjshëm i cili përbën veprën penale formale është i një natyre të tillë që nuk mund të ndërpritet nga shkaqe që nuk varen nga vullneti i subjektit të veprës penale, atëherë vepra penale formale nuk mund të mbetet në tentativë. Si vepra penale formale tek të cilat veprimi i kundërligjshëm që përbën veprën penale nuk mund të ndërpritet për shkaqe që nuk varen nga vullneti i personit dhe për pasojë nuk mund të mbeten në tentativë, mund të përmendim mbajtjen pa leje të armëve dhe municionit luftrar, etj. Tek këto vepra penale natyra e veprimit të kundërligjshëm që përbën veprën penale është e tillë që nuk mund të ndërpritet nga faktorë që nuk varen nga vullneti i subjektit dhe, për pasojë vepra nuk mund të mbetet në tentativë.

Nga ana tjetër tek shumica e veprave penale formale, natyra e veprimit të kundërligjshëm që përbën veprën penale, është e tillë që mund të ndërpritet dhe vepra të mos kryehet për shkaqe që nuk varen nga vullneti i personit. Për shembull, tek vepra penale e kalimit të paligjshëm të kufirit, sigurisht që kjo është një vepër penale formale, por veprimi i kundërligjshëm është i tillë që mund të ndërpritet nga shkaqe që nuk varen nga vullneti i personit, për shembull, personi kapet në kufi nga rojet kufitare duke kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin. Në këtë rast edhe pse jemi para një vepre penale formale, ajo ka mbetur në tentativë, nuk është kryer për shkaqe që nuk varen nga subjekti, por duke qenë se është kundërvajtja penale, subjekti nuk mban përgjegjësi penale, sepse sipas Kodit tonë Penal, tentativa për kryerjen e një kundërvajtje penale nuk dënohet penalisht. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për veprën penale të “*Nidihmës për kalimin e paligjshëm të kufijve*”, e cila është një vepër penale formale, megjithatë, mund të mbetet në tentativë, për shembull, kur subjekti kapet në mjetin e tij të transportit, pasi ka futur klandestinët brenda në mjet dhe është në çastin duke ndezur mjetin për t’i transportuar ato, ose kur kapet në hollin e hotelit të tij dhe është në çastin që po bën sistemin e klandestinëve për t’i strehuar ato me qëllim kalimin e paligjshëm të kufijve, etj. Si vepra të tjera formale që mund të ngelin në tentativë mund të përmendim fallsifikimin e dokumentave, fallsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë, rrëmbimin e personit, shtërngimin me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë etj, duke sqaruar se të tilla janë shumica e veprave

<sup>2</sup>(Paraprakisht do të duhet të pohojmë se tentativa gjen zbatim vetëm në veprat penale që kryhen **me dashje direkte**, pavarësisht nëse ato janë vepra penale materiale ose formale. Një gjë e tillë rezulton nga përmbajtja që ligji penal i jep tentativës ku përcakton se vepra mbetet në tentativë, kur megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtëpërdrejta për kryerjen e veprës penale, ajo ndërpritet dhe nuk përfundon për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tij. Ndërmarrja e **veprimeve të drejtëpërdrejta** nga ana e personit mund të bëhet vetëm kur ai vepron me dashje direkte dhe nuk mund të ndodhë kur ai vepron me dashje indirekte ose nga pakujdesia në formën e vetëbesimit të tepruar ose neglizhencës).

penale formale të parashikuara në Kodin Penal.

### **3-Tentativa tek vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”**

Fakti nese vepra penale ngelet apo jo ne tentative eshte nje nga problemet më të debatuarat të hasura në praktikën gjyqësore, për të mos thënë më i debatuari, në lidhje me veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/a të Kodit Penal, a mundet të ngelet ose jo në tentativë dhe cilat janë konfliktet e praktikës gjyqësore në lidhje me këtë çështje. Për të përcaktuar nëse vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”, mundet të ngelet ose jo në tentativë ose jo do të duhet të përcaktojmë fillimisht nëse ajo është një vepër penale materiale apo formale. Nga teoria e të drejtës penale si dhe nga praktika gjyqësore prej shumicës së autorëve është pranuar se vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”, është një vepër penale formale. Kjo vepër konsiderohet formale për faktin se në mënyrë që të konsiderohet e kryer plotësisht mjafton të vërtetohet ekzistenca e një prej veprimeve të kundërligjshme të parashikuar në nenin 283/a të Kodit Penal, në mënyrë që ajo të konsiderohet plotësisht e kryer. Pra, mjafton që të vërtetohet ose importimi, ose eksportimi ose tranzitimi ose tregtimi në kundërshtim me ligjin i lëndëve narkotike në mënyrë që vepra të konsiderohet e kryer. Fakti që vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”, është një vepër penale formale është pranuar pa mëdyshje edhe nga praktika gjyqësore e viteve të fundit, ku vlejné të theksohen disa vendime të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nga interpretimi i të cilëve rezulton se kjo është një vepër penale formale (Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nr. 608,2007, nr.494,2008, nr.734,2007, nr.179,2008, nr.590,2008, nr.547,2008).

Çështja më e rëndësishme që shtrohet për diskutim në këtë rast është nëse kjo vepër penale duke qenë një vepër penale formale, a mundet që të ngelet apo jo në tentativë? Pra, a është kjo vepër penale e atillë që veprimi i kundërligjshëm që përbën veprën penale të mund të ndërpritet për shkaqe që nuk varen nga vullneti i personit dhe për pasojë vepra penale të mos kryhet, apo është një vepër e tillë kur veprimi i kundërligjshëm nuk mund të ndërpritet për shkak të natyrës së tij dhe për pasojë vepra kryhet plotësisht në çdo rast. Në lidhje me këtë çështje praktika gjyqësore ka patur debate të shumta, ku gjyqtarët dhe profesionistët e tjerë të drejtësisë janë ndarë në dy grupe.

Njëri grup pranon që vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”, nuk ngelet në tentativë, ndërsa grupi tjetër pranon kjo vepër penale mund të ngelet në tentativë. Duhet të pranojmë se shumica e autorëve janë të mendimit se vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal janë të mendimit se kjo vepër nuk mund të mbetet në tentativë. Kështu Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në disa vendime të tij ka argumentuar se kjo vepër penale nuk mund të mbetet në tentativë. Nga këto vendime të këtij Kolegji vlejné të përmendim vendimet nr. 494, datë 05.11.2008, nr. 734, datë 21.11.2007, nr. 179, datë 09.04.2008, nr. 590, datë 12.12.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në një prej këtyre vendimeve ky Kolegj ndër të tjera arsyeton: “...Kështu sikurse ka vënë në dukje edhe në çështje të tjera me të njëtin objekt gjykimi (Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, 608,2007). Kolegji Penal çmon me vend që të vëjë përsëri në dukje faktin që dispozita e nenit 283/a të K.Penal (trafikimi i narkotikëve) ndodhet në kreun e VIII-të të tij, i cili titullohet “Krimet kundër autoritetit të shtetit” dhe më konkretisht në seksionin e III-të të këtij kreu, i cili titullohet “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” objektin e përgjithshëm të të cilave e përbëjnë mardhëniet shoqërore që marrin në mbrojtje rendin juridik të vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe sigurinë publike të saj. Kurse objektin e posaçëm të figurës së

*krimit të trafikimit të narkotikëve e përbëjnë mardhëniet shoqërore që marrin në mbrojtje rendin juridik të vendosur në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht, në sferën e importimit, eksportimit, tranzitimit dhe tregtimit të substancave narkotike ose psikotrope, mardhënie këto, të cilat çënohen (dhe jo vihen në rrezik për t'u çenuar, sikurse ndodh kur vepra penale mbetet në tentativë) kur kjo veprimtari në një nga format e saj, (ose importim ose e eksportim ose tranzitim ose tregtim) zhvillohen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi (përfshirë edhe aktet ndërkombëtare në këtë fushë, të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe të botuara në Fletoren Zyrtare, të cilat sipas Kushtetutës, pas kësaj procedure, bëhen pjesë e sistemit të brenshëm juridik. Kolegji çmon që, **pikërisht cënimi i këtyre mardhënieve përbën edhe pasojën në figurën e krimit të trafikimit të narkotikëve parashikuar nga neni 283/a të K.Penal, edhe nëpërmjet formës së tranzitimit, me kushtin sipas të cilit, tranzitimi i këtyre lëndëve të ndaluara, transferimi nga njëri vend në tjetrin, qoftë edhe brenda përbrenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të bëhet ose për t'i nxjerrë ato jashtë këtij territori ose gjatë transferimit të tyre nga një vend në tjetrin, pas hyrjes (kuptohet në mënyrë të kundërligjshme) nga jashtë, në territorin Shqiptar ...**“.*

*Prandaj bazuar në sa më sipër, Kolegji Penal arriti në përfundimin që vendimi i Gjykatës së Apelit, në këtë pjesë të tij, duhet të ndryshohet, duke e cilësuar krimin e tranzitimit të narkotikëve të kryer (të konsumuar plotësisht), sikundër me të drejtë e kishte cilësuar Gjykata e shkallës së parë. ...”*

Vlen të theksohet fakti se edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka mbajtur vazhdimisht të njëtin qëndrim në lidhje me faktin nëse vepra penale e “*Trafikimit të narkotikëve*”, mbetet apo jo në tentativë. Kështu vlen të përmendim vendimin nr. 546, datë 26.11.2008 të këtij Kolegji i cili ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 15, datë 16.03.2007 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, e cila nga ana e saj kishte lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin ishte deklaruar fajtor i pandehuri R.K për veprën penale të “*Trafikimit të narkotikëve*”, të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, mbetur në fazën e tentativës.

Me këtë rast nuk kam të njëtin mendim me arsyetimin e bërë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 494, datë 05.11.2008, i cili ndër të tjera shprehet se”... **pikërisht cënimi i këtyre marrëdhënieve përbën edhe pasojën në figurën e krimit të trafikimit të narkotikëve parashikuar nga neni 283/a të K.Penal, edhe nëpërmjet formës së tranzitimit, me kushtin sipas të cilit, tranzitimi i këtyre lëndëve të ndaluara, transferimi nga njëri vend në tjetrin, qoftë edhe brenda përbrenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të bëhet ose për t'i nxjerrë ato jashtë këtij territori ose gjatë transferimit të tyre nga një vend në tjetrin, pas hyrjes (kuptohet në mënyrë të kundërligjshme) nga jashtë, në territorin Shqiptar...**” (Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë, 2008, 494). Qëndrimi im i ndryshëm nga mendimi i mësipërm i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, bazohet në faktin se nga teoria e të drejtës penale dhe nga praktika gjyqësore është pranuar përgjithësisht së cënimi i mardhënieve shoqërore që mbrohen nga norma juridike përbën kurdoherë objektin e figurës së veprës penale dhe jo pasojën e saj, pavarësisht nga fakti nëse vepra penale është materiale apo formale.

Pikërisht ky mosunifikim i qëndrimeve nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ka bërë që edhe gjykatat më të ulta të hasin tepër vështirësi në lidhje me përcaktimin e drejtë të faktit nëse vepra penale e mësipërme ngelet apo jo në tentativë dhe Kolegjet e Bashkuara me Vendimin Nr.3 të datës 24.01.2011, unifikuan e praktikën gjyqësore, lidhur

me kryerjen e veprës penale apo mbetjen së saj në tentativë, duke pasur parasysh katër mënyrat e kryerjes së veprimit kriminal të trafikimit të narkotikëve, të parashikuara nga neni 283/a i Kodit Penal ekzaktësisht:

**a) Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për importimin e saj, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e importimit e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal (Kolegjet e Bashkuara, 3, 2011, 13)**

**b) Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete e të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për eksportimin e saj, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal në territorin shqiptar, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e eksportimit e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal (Kolegjet e Bashkuara, 3, 2011, 13).**

**c) Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete e të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për tregtimin ndërkombëtar të saj, sipas rastit, nuk ka hyrë apo nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal brenda a jashtë vendit, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e tregtimit ndërkombëtar e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal (Kolegjet e Bashkuara, 3, 2011, 14).**

**ç) Kur lënda narkotike, e cila ka hyrë më parë në territorin shqiptar, megjithë veprimet a mosveprimet e mëtejshme, konkrete e të drejtpërdrejta, të autorëve të veprës për tranzitimin e saj jashtë këtij territori, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e tranzitimit e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së këtij veprimi kriminal brenda territorit shqiptar. (Kolegjet e Bashkuara, 3, 2011, 14)**

Personalisht edhe unë jam i mendimit se vepra penale e “*Trafikimit të narkotikëve*”, të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, mbetet në tentativë, ashtu si shumica e veprave penale formale. Ky qëndrim i imi bazohet në kuptimin që ligji i jep tentativës të cilën e lidh me kryerjen e veprimeve të drejtpërdrejta të subjektit në kryerjen e veprës penale dhe me ndërprerjen dhe mos përfundimin e saj për shkaqe që nuk varen prej tij. Siç u theksua më lart, ligji nuk e lidh tentativën e veprës penale me ndërprerjen e ardhjes së pasojës, siç mund të mendojnë disa autorë, por me ndërprerjen e veprimeve dhe të kryerjes së veprës penale nga shkaqe të pavarura.

Vepra penale e “*Trafikimit të narkotikëve*”, mund të mbetet në tentativë sepse, pavarësisht se ajo është një vepër formale, nga natyra që kanë veprimet e kundërligjshme që përbëjnë kryerjen e veprës penale, ato mund të ndërpriten për shkaqe që nuk varen nga vullneti i subjektit dhe vepra të mos përfundojë. Veprimet e kundërligjshme që përbëjnë kryerjen e kësaj vepre penale janë siç dihen katër, ose importimi, ose eksportimi, ose tranzitimi ose tregtimi në mënyrë të kundërligjshme të lëndëve narkotike. Në këtë rast secili prej këtyre veprimeve mund të ndërpritet dhe vepra të mos përfundojë për shkaqe që nuk varen nga

vullneti i subjektit të veprës penale. Për shembull, veprimi i importimit ndërpritet jashtë vullnetit të subjektit kur subjekti siguron një sasi lëndë narkotike jashtë shtetit dhe vendos që ta dërgojë në Shqipëri. Në momentin që subjekti kryen veprime për të sjellë këtë lëndë në Shqipëri, në qoftë se ai kapet nga policia pa e futur lëndën narkotike në Shqipëri ose nuk e fut këtë lëndë për çdo shkak që nuk varet nga vullneti i tij, vepra e tij është ndërprerë, nuk ka përfunduar jashtë vullnetit të tij dhe për pasojë do të cilësohet si e mbetur në tentativë. Ose veprimi i eksportimit ndërpritet jashtë vullnetit të subjektit kur subjekti siguron një sasi lëndë narkotike në Shqipëri dhe vendos që ta dërgojë jashtë shtetit për shembull në Greqi. Në momentin që subjekti kryen veprime për të dërguar këtë lëndë në Greqi, në qoftë se ai kapet nga policia pa e futur lëndën narkotike në Greqi ose nuk e fut këtë lëndë për çdo shkak që nuk varet nga vullneti i tij, vepra e tij është ndërprerë, nuk ka përfunduar jashtë vullnetit të tij dhe për pasojë do të cilësohet si e mbetur në tentativë. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për veprimin e tranzitimit të lëndëve narkotike, i cili mund të mbetet në tentativë, kur subjekti siguron një lëndë narkotike dhe vendos ta tranzitojë atë në një shtet të tretë, në qoftë se subjekti kapet pasi e ka siguruar lëndën narkotike duke kryer veprime që lidhen me tranzitimin e saj, vepra do të cilësohet si e ngelur në tentativë. Po ashtu ndodh edhe me tregtimin e lëndës narkotike, i cili është veprimi i fundit sipas të cilit mund të kryehet lënda narkotike, në qoftë se subjekti pasi e ka importuar ose eksportuar ose tranzituar lëndën narkotike, vendos që ta tregtojë atë, dhe kapet në momentin që po kryen veprimin e tregtimit ose kryen veprime të drejtëpërdrejta për tregtimin, por ai nuk realizohet për shkak që nuk varen nga vullneti i tij, vepra do të konsiderohet si e ngelur në tentativë.

### Konkluzione

Përfundimisht nisur nga sa u tha më lart, mund të konkludojmë se vepra penale e “*Trafikimit të narkotikëve*”, e parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, mund të ngelet në tentativë. Rastet kur kjo vepër mund të ngelet në tentativë, nuk mund të përkufizohen, por duhet të verifikohen rast pas rasti në praktikë, në varësi të kushteve dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale dhe për përcaktimin e faktit nëse kjo vepër ka ngelur apo jo në tentativë, do të duhet t’i referohemi në çdo rast kushteve ligjore të parashikuara nga neni 22 i Kodit Penal, i cili jep kuptimin e tentativës dhe përcakton kushtet se kur një vepër do të konsiderohet se ka ngelur në tentativë.

### Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.  
Konventa Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore”.  
Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.  
Elezi I & Kaçupi S & Haxhia M. (2007). *Komentari i Kodit Penal të R.Sh.* Tiranë.  
Muçi, Sh. (2007). *E drejta penale Pjesa e Përgjithshme*. Tiranë.  
Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë Vendimi nr.608, (2007).Tirane.  
Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë Vendimi nr.494.(2008).Tirane.  
Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë Vendimi nr.734, (2007).Tirane.  
Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë Vendimi nr.179. (2008).Tirane.  
Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë Vendimi nr.590. (2008).Tirane.  
Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë Vendimi nr.547.(2008).Tirane.  
Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.Vendimi nr.3. (2011). Tirane.

## FDI inward policy in Kosovo: A critical analysis

MBA Flamur Bunjaku  
Prishtina University "Hasan Prishtina"

### Abstract

The importance and positive effects of FDI inwards are multilateral. There is a wide consensus among scholars that FDI inwards positive effects for the host country outweigh cost of such an engagement. However, there are some scholars who approach to the FDI inwards with skepticism. In addition, some relevant international organizations such as OECD (2002) suggest that FDI positive effects depend on the business environment, institutional – legal aspects, structure of the economy, and so forth. The idea of this paper is not to under evaluate the importance of FDI inwards. On the contrary it approaches to the FDI inwards policies with a dose of criticism in order to maximize their positive effects. We consider that current FDI inwards policy in Kosovo doesn't take into account the specifics of the economy, business environment, adequate entry modes and cross – sector FDI distribution. What is most important it doesn't take into account the idea of directing FDI inwards to the strategic sectors of Kosovo economy, especially to production activities directed to export? The paper suggests a revision of current FDI inward policy of Kosovo, since it is not in compliance with long term needs of the economy. The paper also provides data regarding the levels of FDI inwards in Kosovo by sectors.

**Key words:** *FDI, Kosovo, etc.*

### Introduction

The fall of the communist rule in all states of central and southeast Europe on the last decade of 20th century was followed by the establishment of democracy and the pluralist political system. The central planned economy was replaced with a liberal one, based on free market, opening the route to free business initiatives, of both domestic and foreign origin. Most of the southeast European countries travelled together in this journey, except Kosovo, which because of not resolved political problems, resulting with war in 1998, had to wait for the democratic changes until the end of the year 1999. After the war in Kosovo in 1999, following the resolution 1244 of United Nations Security Council, UNMIK (United Nations Mission in Kosovo) was established. UNMIK remained to be the main authority in Kosovo up to the year 2008 when Kosovo parliament declared the independence. The role of international community, respectively the United Nations role was crucial in the aspect of building up provisional institutions and establishing a legal framework. The establishment and enforcement of such a framework was crucial instrument in generation of an overall normal business climate. Since then many foreign companies started to invest in Kosovo bringing a radical change to the business picture, as well as changing the old archaic mentality in doing business.

The subject of FDI in Kosovo has been dominated by the arguments and counterarguments regarding the quantitative aspects of FDI inwards. However, there has been an extreme lack of debate regarding the FDI qualitative aspects, such as their structure, entry modes, government incentives, legal issues regulating the FDI activities, and so forth. Therefore, this paper approaches to the FDI inwards policy in a critical manner aiming to identify the main drawbacks of FDI policy in Kosovo.



Following the introduction, the latest literature review regarding the FDI policies is provided. The literature review focuses mostly in cross/sector FDI policy issues, and the FDI entry modes. Third part of the paper provides a critical analysis of the FDI policy in Kosovo, which is followed by conclusions and recommendations.

### **Literature review**

Modern academic literature provides many academic publications related to FDI, which remain to be an important subject for many scholars. In most of those publications the importance and the positive outcomes to both, foreign investors and the host country are highlighted. There are few scholars, especially those representing Keynesian economic doctrine and few other who approach to some specifics of FDI with skepticism (e.g. Mencinger, 2003; Roolah and Vissak, 2005; Zilinski, 2010; Petrescu, and Joia, 2013). Their general conclusions are that FDI inwards have a positive impact to the economic growth, however, enhancing the role of a FDI inwards cross-sector adequate strategy, and entry mode selection, in order to obtain a comprehensive benefits to all sectors of the economy. The studies regarding FDI inwards effects on economic growth differ. Although most of the studies suggest that FDI inwards promote economic growth, there are also some studies that indicate no significant economic development progress associated to FDI inwards. Some authors such as Edison et al (2002) claim that these conflicting results come as a result of different methodology used for those studies such as, sample model, sample periods, and other comparative techniques used for such a purpose, whereas some others, such as (Bhagvati, 1978; Mencinger, 2003; Roolah and Visak, 2005; Petrescu and Joia, 2013) suggest that moderate or negative results associated to FDI inwards come as a result of an inadequate FDI policy. Bhagvati (1978) claims that FDI inwards would increase economic growth in the export promoting countries, whereas the FDI inwards growth effects in the countries with import substitution policies would be moderate or without any growth effect (cited in Mencinger, 2003). Therefore, suggesting for a FDI inwards policy directed to sectors manufacturing exchangeable goods. Moreover, as suggested by Roolah and Vissak (2005) concentration of FDI inwards only in few sectors of the economy can misbalance the economic growth and generate structural economic problems.

There are also many academic works related to FDI inwards entry modes. In this aspect Wang and Wong (2009) analyzing the effects of different FDI entry modes in economic growth, using data from 84 countries in a time period from 1987 to 2001, found that Greenfield FDI inwards have a significant positive effect on economic growth, whereas Brownfield FDI inwards such as M&A do not generate such effects. In addition, in regard of Brownfield FDI such as M&A, the same authors claim that, in order to generate positive effects the host country has to reach minimum level of human capital development (p. 328), insisting on educational improvements of labor force. Furthermore, Muller (2007) analyzing FDI entry modes, respectively Greenfield investments versus Acquisitions, found that in markets that are highly competitive, Greenfield are the adequate entry modes, whereas if the market is not highly competitive but rather intermediate, Acquisitions are more adequate entry modes. In this line other authors, such as Shaver (1998) claims that Greenfield investments are less volatile to the changes of external environment compare to Acquisitions which are more volatile. In addition, the same author claims that stronger companies prefer Greenfield investments rather than Acquisitions. Most likely, this is because of the fact that strong companies do not want to share their high tech and knowhow with other companies. Other authors, such as (Mayeda, 2007; Petrescu, and Joia, 2013) emphasize the need of

adopting specific rules and regulations in order to direct FDI inwards to the strategic sectors. Petrescu and Joia (2013) claim that FDI laws besides the liberalization regulations aimed to promote FDI inwards, should contain also restrictive measures in some particular sectors and industries. In addition, the same authors, based on a research published in the World Investment Report 2012, provide evidence of restrictive FDI inwards policies undertaken by numerous countries in some strategic sectors of the economy. Furthermore, based on the data of 44 countries, the above mentioned authors found that among 66 economic regulations adopted worldwide, 15 of them aimed restriction of FDI flows to particular sectors of the economy. Moreover, the same authors claim that countries with over enthusiastic approach regarding liberalization of FDI flow which have ignored the specifics of business environment suffered losses, especially during financial crisis.

### **Critical analysis on FDI policy in Kosovo**

FDI inwards remain to be considered as the main drivers of economic growth, especially for developing countries. However, the idea that FDI inwards will automatically result to economic development is not accurate. In addition the quantitative increase of FDI inwards shouldn't be seen with over enthusiasm, because it represents only a statistical data not analyzed inside the matter. Organization for Economic Co – operation and Development - OECD (2002) suggest that FDI positive effects for a certain economy depend on business environment, institutional – legal aspects, educational level, structure of the economy, and so forth. The latter doesn't mean that our approach towards FDI inwards is negative. On the contrary, the critical approach aims to improve the FDI inwards policies in order to gain more economic benefits from them.

Overenthusiastic approach over FDI inwards comes as a result of lack of in-depth qualitative analysis. In this regard, the most important point is the analysis of FDI cross-sector distribution and their entry modes. Especially, Greenfield FDI participation in sectors producing exchangeable goods is of great importance. According to Central Bank of Kosovo, FDI inwards participation in Kosovo by sectors is dominated by real estate, financial services, and construction sector. Only in the first quarter of the year 2014 the participation of FDI inwards in real estate was 47%, financial services 17%, followed by construction sector 13.3 % (see figure1). The production sector participated only with 7.6% of FDI inwards. The concentration of FDI inwards only in few sectors of the economy may create structural economic problems. Moreover, the participation of Greenfield investments in production sector is extremely low since most of the FDI entry modes in Kosovo were Brownfield influenced either by the privatization process or by the increase of cross border M&A. Analyzing further the structure of FDI inwards in Kosovo it is obvious that current structure not only that does not contribute to the economic development, but on the contrary, it is generating contra productive effects. The aggressive investments in real estate, banks, and construction, are generating a circle of debt amongst Kosovo population, reducing the consumption power in the market. The incentives in financial and banking market regarding the housing loans, followed by incentives in real estate and construction sector have increased the demand in housing industry market. There is e perception that these three sectors have established a kind of oligopoly, which may be identified as three lateral reversible oligopoly, since the profits in one of these sectors reversibly generate profits to the other two in the future. These developments contributed in concentration of the financial assets mainly in these three sectors of Kosovo's economy. Our findings are also backed by academic findings such as

Unkovic and Kordic (2010) who claim that an increased investment on real estate sector results in housing loan expansion, which results in a shift of financial resources from sectors producing exchangeable goods to the ones that generate un-exchangeable goods. Attractive offers by banks, expansion of real estate and construction sector incentives in regard of loan opportunities for housing market in Kosovo was so intense, hence, was followed by the phenomenon of population migration from rural to urban areas, which resulted in decrease of agricultural production, worsening the agricultural and production activities. Moreover, the Kosovo FDI law in any point of it doesn't mention the need of a long term FDI inward strategy. The law covers only the aspect of foreign investor's rights in Kosovo and their protection in general, not leaving a legal space neither for establishing government incentives in the strategic sectors of the economy, nor to pursue a Greenfield FDI inwards promotion policy..

Therefore, we raise a question! Is the current FDI inwards policy in Kosovo the right policy to be pursued? Is there a need for reconsidering the current FDI inwards policy in Kosovo? We believe, there is an urgent need to reconsider the FDI inwards policy in Kosovo. The current FDI promotion strategy in Kosovo is not the adequate one, because it is not based in any development strategy or innovation. Moreover, the law on FDI doesn't leave a room for any selective FDI strategy, which would make possible to establish adequate incentives in the strategic sectors of Kosovo's economy, or promote Greenfield investments. Greenfield FDI inwards directed to the production of exchangeable goods are considered by the waste majority of scholars as the best instruments in revitalizing the economy of the FDI host country. Attempts of Kosovo government to increase the levels of FDI inwards without a strategy over the FDI entry modes and their sector of investment may not necessarily generate positive effects. The current FDI inward policy in Kosovo generates only short term positive effects. Moreover, in a mid and in a long term perspective generates structural disadvantages, especially in respect of production sector. The issue of reconsidering the FDI inwards policy in Kosovo becomes more urgent having in consideration the current foreign trade deficit, which according to Kosovo Agency of Statistics in the year 2013 was over 88% in figures around 2,155 billion Eur. In this line, the first important step would be reviewing and adjusting current FDI regulations. For example the FDI law in Kosovo unlike the FDI laws of the countries in the region, doesn't leave a room for a pragmatic and more efficient FDI inwards distribution to the sectors with higher interests. We don't claim that Kosovo government should pursue a biased FDI inwards policy; however, there is a necessity to adopt it to the needs of the economy. We do not claim that Kosovo should deviate from its free trade liberal policy. However, we urge for an efficient management of FDI inwards in terms of directing them to the strategic sectors of the economy, which would utilize better the foreign investments. Moreover, according to UNCTAD (2000) from the year 2000 around 90 countries have adopted competition regulations, under which non Greenfield FDI were reduced constantly. A pure example of this FDI inward policy is Canada where the government has adopted a regulation according to which is required to notify Canadian government for all Mergers and Aquistions (Wang and Wong, 2010). Furthermore, the FDI law of the countries in the region such as Montenegro foresees an adequate strategy regarding the FDI inwards, leaving a legal space to the government to review its FDI inwards policy every five years. In terms of Kosovo economy, directing FDI inwards flow to the production sector, especially to production sector of exchangeable goods is a necessity. The latter would improve the negative trade balance of Kosovo, increase the market share in the region, and also reduce unemployment.

## Conclusions and recommendations

In order to maximize FDI positive effects countries need to adopt adequate economic policies. Idea that FDI inwards quantitative increase will lead to economic prosperity is overenthusiastic. The positive effects of FDI inwards depend on country specifics, especially on the sector of investment, and FDI entry modes. It is empirically proven and also supported by many academics that FDI inwards in production sector, especially in production of exchangeable goods would result in more benefits to a certain economy. In regard of FDI entry modes, the Greenfield investments are considered as the adequate ones, especially, if the host countries are under process of economic revitalization. Although, the globalization effects and liberalization trends accompanied by institutional foreign trade liberalization acts diverge over the rights of sovereign states to adopt independent FDI policies, we consider that sovereign countries, especially developing countries should adopt that sort of FDI inwards policy that would generate substantial long term transformation of the economy, rather than short term nominal results. Someone may say this is a restrictive policy directed in opposition to the liberalization trends. However, the idea is to adopt more efficient FDI inward policies, directing them to the sectors that will make the economy of a country more prosperous. This will result in better absorption of other FDI inwards which in a particular moment weren't considered as attractive. Kosovo as a country with weak economic indicators, suffering multiple economic problems should be careful in establishing its FDI inwards policy. In this line promotion of Greenfield FDI inwards and their distribution to the production economic activities is of great interest. The quantitative FDI inwards policy should be replaced with a comprehensive qualitative approach, which would maximize the positive effects of FDI inwards. The latter would improve the foreign trade balance, increase Kosovo's market share in the region and promote sustainable employment.

## References

- Bhagwati, J. (1978) Anatomy and Consequences of Exchange Control Regimes, Special Conference Series on Foreign Trade Regimes and Economic Development, Vol. XI, Cambridge.
- Central bank of Kosovo: Time series: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124> [Accessed on 20th of December 2014]
- Edison, H. J., M. Klein, L. Ricci and T. Slok (2002). Capital Account Liberalization and Economic Performance: Survey and Synthesis, IMF Working Paper, 120/2002.
- Kosovo agency of statistics: <http://ask.rks-gov.net/eng/> [Accessed on 2nd Of December 2014]
- Mencinger, J. (2003) Does foreign direct investments always enhance economic growth. *Kyklos*, 56(4), p. 491-508.
- Muller, T. (2007) Analyzing modes of foreign entry: Greenfield investments versus acquisition. *Review of international economics*, 15(1), p. 93-111.
- Petrescu, H. C. E. and Joia, R. M. (2013) National policy measures: Right approach to foreign direct investments. *Theoretical & applied economics*, 20(2), p. 103-112.
- Roolhat and Vissak (2005) The negative impact of foreign direct investment on Estonian economy. *Problems of economic transition*, 48(2), p. 43-66.
- Shaver, J. M. (1998) Accounting for endogeneity when assessing strategy performance: Does entry mode choice affect... *Management science*, 44(4), p. 571-585.
- Unkovic, M. and Kordic, N (2010) Potential for attracting FDI in Serbia. *Singidunum scientific review*, 8(1), p. 163-177.
- Wang, M. and Wong, M. C. S. (2009) What drives economic growth: The case of cross border M&A and Greenfield FDI activities. *Kyklos*, 62(2), p. 316-330.

## Ndikimi i krizës globale financiare në reformën e kontabilitetit, posaçërisht në vlerësimin e aseteve të fondeve pensionale

Dr. Sherif Gashi

### Abstrakt

Kriza globale financiare e viteve 2007-2008 e cila vazhdon edhe sot, por me një intensitet më të vogël, la pasoja të rënda në sistemet ekonomike si në vendet e zhvilluara, po ashtu edhe në vendet në zhvillim, e cila së pari përfshiu tregun e pasurive të paluajtshme në ShBA dhe u shtri me shpejtësi të madhe në pjesën tjetër të botes, duke përfshirë tërë sektorët e zhvillimit të një shteti, që tregoi se reformat në sistemin financiar janë të domosdoshme. Sektori që kërkonte reforma të domosdoshme për t'iu adaptuar situatës (krizës globale financiare) ishte ai i kontabilitetit, në mënyrë që për të gjithë shfrytëzuesit e informacionit kontabël t'u ofrohen me kohë informacione të nevojshme dhe të besueshme. Çrregullimet financiare, të cilat filluan me krizën në tregun e kredive hipotekare, me cilësi të ulët në ShBA në mesin e vitit 2007, kanë shkaktuar një goditje të rëndë në administrimin e pensioneve private. Kontabiliteti, një nga shtyllat kryesore të shoqërisë mund të rrisë apo të zvogëlojë besimin e aksionarëve, investitorëve institucionalë, si dhe kreatorëve të politikës ekonomike të një shteti. Kriza goditi sistemin financiar, institucionet financiare e posaçërisht fondet pensionale ngase potenciali financiar i këtyre fondeve, në nivel të sistemit financiar botëror, ka një koeficient të lartë pjesëmarrje. Kriza globale detyroi shtetet më të fuqishme që të marrin hapa radikalë për përballimin e krizës, eliminimin e pasojave dhe ringjalljen e ekonomive të tyre. Reformat që ndërmorën në sistemin financiar nuk ishin të mjaftueshme, pa një reformë në sistemin e kontabilitetit, në mënyrë që të gjithë të interesuarve t'u ofrojnë informacione të besueshme dhe me kohë. Në punim do të trajtohet ndikimi i krizës globale financiare në kontabilitet si tërësi, si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

**Fjalët kyçe:** *Kriza financiare, vlerësimi i aseteve, fondet pensionale, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.*

### Hyrje

Në shekullin XXI, botën e karakterizon zhvillimi i hovshëm i sistemit financiar, i sistemit ekonomik, globalizimi si njëra ndër sfidat kryesore të kohës së sotme dhe asaj të ardhshme. Zhvillimi ekonomik bëri bum në vendet me rend shoqëror kapitalist, sidomos në shtetet më të zhvilluara, ku shteti luajti rol indiferent ndaj zhvillimit aktual duke u mbështetur në teorinë postkensiane të përfaqësuar nga Fred dhe Gipson, se tregu është katalizator i cili rregullon të gjitha problemet ekonomike në mënyrë të pavarur, duke mos pasur nevojë intervenimi nga shteti. Prandaj sa më pak të ketë barriera shtetërore ndaj tregut, sa më pak intervenime, ai do bëhet autorregullator i ekonomisë së një vendi. Por zhvillimet në dhjetë vjetshin e fundit, dhanë sinjal se tregu si i vetëm nuk është në gjendje që të zhvillohet dhe të gjejë rrugën më optimale drejt një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik. Sistemi financiar sot është 50 herë më i lartë se sa ekonomia reale botërore, pra problemi kryesor është çekuilibri ekonomik-financiar. Kriza globale financiare më së shumti preku fondet e lira të cilat ishin të investuara në tregjet e kapitalit, për shkak të lëkundjes së madhe të çmimeve të letrave me vlerë dhe derivateve të tyre. Harmonizimi i standardeve të raportimeve financiare në globalizimin e një sistemi financiar ka një rëndësi të veçantë ngase mundëson: mbrojtjen e investitorëve, mbrojtjen e institucioneve financiare dhe

pjesëmarrësve të tjerë në tregjet financiare nga informacioni kontabël jo i besueshëm, i pamjaftueshëm, i pasaktë dhe jo i plotë. Kur flasim për krizën financiare nuk mund të lëmë pa analizuar ndryshimet më të rëndësishme të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, sidomos SNK 39 - Instrumentet Financiare, njohja dhe matja, si dhe SNK 1. Raportimet financiare.

## Kapitulli I

### Shkaqet e krizës globale financiare

Globalizimi përpiqet ta sjellë botën më afër, të largojë barrierat ekonomike dhe fiskale, që mallrat, produktet dhe shërbimet të shkëmbehen lirshëm, të mundësojë lëvizjen e lirë të njerëzve, të kapitalit, të informacionit, dijes dhe kulturës. Globalizimi financiar është një dimension i procesit kompleks të globalizimit. Ky proces në dekadat e fundit ka ndryshuar tërë pamjen e ekonomisë ndërkombëtare.

Globalizimi financiar është një rrezik por edhe një mundësi. Viteve të fundit globalizimi financiar është bërë objekt i një debati për shkak të efekteve destabilizuese në sistemin financiar dhe në ekonominë reale. Efektet destabilizuese të këtyre flukseve financiare transmetohen në shkallë globale.

Me globalizimin e ekonomisë botërore dhe ndërthurjen e madhe të ekonomive kombëtare të vendeve të veçanta, treguesit e ndryshëm ekonomiko-financiar dhe rezultatet e njësive ekonomike në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, janë bërë shumë të luhatshme. Rreziqet si rrjedhojë e këtyre luhatjeve janë shumë të mëdha dhe më të përhapurat në hapësirë dhe kohë. Kriza financiare është fenomen i njohur, ajo nuk vjen papritur sikurse katastrofat, por gjithherë i befason ekonomistët, pjesëmarrësit në tregun financiar, i befason edhe vetë politikanët, pa marrë parasysh sa kanë mundur të kenë ndikim. Ekspertët, ekonomistët, analistët e sistemit financiar u shokua nga kjo tronditje financiare. Filluan të japin mendime për shkaqet, pasojat, mënyrën se si të tejkalohet. Në librin “Shkaqet e krizës financiare” të autorit George Cooper, botuar nga “Masmedia”, 2009 Zagreb, autori kritikon teorinë e tregut të lirë. Ekonomisti amerikan, Hyman P. Minsky, gjatë analizës së krizës globale, idenë e tij mbi krizën dhe masat për të dalë nga kriza i mbështet në parimet e Johan Maynard Keynesa. Në 90 vjetorin e Fakultetit Ekonomik të Zagrebit u bë promovimi i libri *John M. Keynes i hervatska ekonomiska misao* e autorëve Zvonimir Baletiq dhe Gjuro Mediq, të cilët theksuan se terapi për të dalë nga kriza është teoria e Keynes.

#### 1.1. Shkaqet e krizës globale financiare

Shkaqet që çuan te kriza globale financiare mund t'i ndaj në tri grupe të mëdha:

- Debalnci makroekonomik, zhvillimi i hovshëm i kreditimit, kreditë hipotekare, menaxhimi jo i mirë i kolateralit gjatë dhënies së kredive. Duhet theksuar se nga e tërë sasia e kredive të këqija në ShBA mbi 50% vinin nga Evropa. Politika ekspansioniste monetare çoi te rënia e çmimit të gjitha aktiveve të paluajtshme, aktiveve financiare, rritja e normës së interesit etj.
- Zhvillimi jo i mjaftueshëm i tregut financiar, problemet makroekonomike dhe mosharmonizimi i tregut financiar me atë të prodhimit shkaktoi recesionin i cili mori karakter ndërkombëtar. Sipas të dhënave thuhet se kapitali financiar në fillimin e vitit 2007 ka qenë 50 herë më i madhe se kapitali industrial, që llogaritet një nder shkaqet kryesore të krizës globale financiare.

Shkaqet e tjera janë p.sh. rreziku politik, ndryshimi i strukturës ekonomike, Kina me rritje

ekonomike mesatarisht 9% bëri që të bëhet fuqi botërore prodhimi, thithi mjetet likuide në tregjet e ndryshme të botes e posaçërisht në ShBA. Tregu monetar në ShBA vuante nga mjetet likuide. “ Tregu pra, lulëzonte ma para të marra borxh( përfshirë dhe dollarët e vendeve arabe të siguruar nga ngritja e çmimeve të naftës), kurse vlera e aktiveve të blera me kredi të pagarantura po rriteshin në përmasa të papara. Në këtë mënyrë, deri në tetor të vitit 2007, vlera totale e aksioneve në ShBA u rrit në 30.7 trilion dollarë”(A.Pano,2009). ShBA mjetet likuide i siguronin nga tregjet ku kishte mjete, kështu përmes emetimit të aksioneve siguronte mjete likuide nga Kina.

## 1.2. Pasojat e krizës financiare globale

Pasojat e krizës globale financiare janë shumë të mëdha, nuk mund të krahasohen me asnjë krizë tjetër, madje as me krizën e viteve 1929-30 nga se vlerësohet se “humbjet e shkaktuara ekonomisë dhe sistemit financiar tejkalojnë humbjet e dy luftërave botërore së bashku (Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore)”. Pasojat e krizës financiare globale duhet të shikohen nga aspekti ekonomik dhe ai gjeografik.

*Aspekti ekonomik.* - Personalitete nga më të spikaturat të botës ekonomike e financiare botërore, si Alain Grispén, Dominique Strauss Kahn, Ben Bernanke, Jan Claude Trichet në fillim të krizës, në vitin 2007, krizën e trajtuan si “ një turbulencë të tregjeve financiare amerikane”. Por shumë shpejt kriza goditi tregun monetar e sidomos dollarin amerikan i cili filloi të çlërësohet me shpejtësi në raport me euron, duke vënë në gjendje alarmante ekonominë amerikane. Jemi në një realitet se bota është në krizë globale nga se njëkohësisht është : krizë financiare, monetare, ekonomike, ushqimore, energjetike dhe krizë ekologjike.

*Krizë financiare.* - Nga se u shkri vlera e aktiveve financiare toksike (fiktive), aq sa nuk falimentoj sistemi financiar, u devaluuan të gjitha aktivet e bankave, fondeve pensionale, fondeve siguruese, humbën pasurinë kompanitë prodhuese, humbën pasurinë miliardë etj. U krijua mungesë e likuiditetit bankar. U krijua kaos në tregun e kapitaleve. U shkaktua mosbesim në përgjithësi në sistemin financiar.

*Krizë monetare.* - Vlera e monedhave u devaluua shumë, ra sidomos vlera e dollarit, u shkaktua mungesë e mjeteve likuide, u zvogëluan rezervat monetare në vendet e zhvilluara, dhe u rritën rezervat monetare të vendeve në zhvillim. U shkaktua inflacion i lartë sidomos në ato vende ku për këmbim mallrash përdornin kurs fikse të monedhës.

*Krizë ekonomike.* - Nga masat e marra për përbalimin e krizës financiare, në shumë shtete, u bë recesion në ekonomi, humbën shumë vende të punës, u mbyllën shumë fabrika prodhimi, u zvogëlua konsumi i mallrave, shumë kompani sigurimesh pësuan në investimet financiare, disa banka falimentuan, shumë fonde investive u tretën etj. Kriza po rrit impaktin psikologjik, papunësia dhe varfëria në rritje sjellin pasigurinë e së ardhshmes, konsumi bie, ekonomia futet në një cikël negativ ku intervenimi i shtetit do të jetë i domosdoshëm. Kriza në fillim ishte financiare, pastaj ekonomike, por nëse nuk ndërmerren masa adekuate, kriza mund të shndërrohet edhe në krizë sociale. Shumë njerëz, në mjaft vende, po përballen me krizën sociale, e cila është po aq serioze sa edhe kriza financiare. Kriza shkurtoi 30 milionë vende pune në tërë globin, ndërsa sot mendohet se afër 200 milion njerëz janë të papunë, si rrjedhojë e reflektimit të krizës globale financiare. Sfidat, rreziqet dhe krizat bëhen globale, qeverisjet e vendeve në zhvillim dhe atyre në tranzicion kanë më pak politika, instrumente, fonde konkrete për të pamundësuar rënien ekonomike.

*Krizë ushqimore.* - Produktet ushqimore siç janë orizi, gruri, misri, sheqeri, vaji arritën çmime rekorde të papërballueshme për shumicën e popullit.

*Krizë energjetike.* - Çmimet e naftës u ngritën shumë, burimet alternative janë në zhvillim e sipër. Vendet prodhuese kryesore të naftës gjenden përherë në luftë ose në trazira sociale. *Aspekti gjeografik* – Kriza filloi në SHBA dhe me të shpejtë përfshiu shtetet e Evropës Veriore apo shtetet e zhvilluara të Evropës, përfshiu shtetet në zhvillim dhe nuk la pa prekur edhe vendet e varfra. Për shtetet në zhvillim për t'u inkorporuar tërësisht në ekonominë globale, ekziston, sipas shumë shkencëtarëve, një periudhë kohore afatgjate, përafërsisht 40 vjeçare. Kriza preku globalizimin si fenomen i ekonomisë botërore, jo si model i keq, por si moszhvillim dhe mosadaptim në kohë. Shtrohet pyetja se kriza globale financiare a pati ndikim njësoj në të gjitha shtetet? Përgjigjja do të ishte jo. Kriza la pasoja shumë më të thella në shtetet e zhvilluara ( ekonominë amerikane) se sa në shtetet në zhvillim, apo në shtete të varfra. Sipas Profesor Jing Men kriza financiare e ka rritur shumë rëndësinë e Kinës në ekonominë botërore. “Motori i saj ekonomik ka mbajtur në punë ekonominë e vendeve siç është ekonomia e SHBA-së dhe Evropës përmes eksporteve dhe importeve, si dhe rezervës valutore të madhe të Kinës”.

## **Kapitulli II** **Kriza globale financiare dhe fondet pensionale**

### **2.1. Asetet e fondeve pensionale**

Menaxhimi i mirë i aktives dhe pasives i mundëson kompanisë, nga fondet e lira që krijohen, të bëjnë investime në ekonomi, pikërisht në atë pjesë të ekonomisë ku ka nevojë për mjete likuide. Menaxhimi i aktives dhe pasives është një proces strategjik dhe i vazhdueshëm i formulimit, zbatimit, monitorimit të pasurisë së kompanisë me të cilën kompania mëton arritjen e objektivave të veta financiare.

Asetet totale në fund të vitit 2011 arritën në 27.509 bilion dollarë, një tregues shumë i fuqishëm i sistemit financiar. Fondet pensionale kanë rëndësi të madhe për shoqërinë, për rritje ekonomike të shtetit si dhe rritjen e mirëqenies së popullsisë, veçanërisht për atë pjesë të popullatës që kanë arritur moshën e daljes në pension. Nga tabela shihet se fondet e pensioneve merrnin pjesë nga 81% në GDP sa ishte në vitin 2006, 76% në vitin 2011, që është një element qenësor për rritjen ekonomike të një vendi. Kriza globale financiare ndikoi shumë në uljen e aseteve krahasuar me vitin 2007 kur filloi kriza. Duhet theksuar se asetet e fondeve pensionale kanë karakter afatgjatë, dhe brenda një periudhe afatshkurtër mund të rikuperohen, andaj rëndësi e veçantë duhet kushtuar mënyrës së raportimit financiar në pasqyrat financiare të parapara sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK nr. 1).

Asetet totale e fondeve të pensioneve për periudhën 2006-2011

Vitet	Asetet totale të shprehura në bilionë dollarë (\$)	Asetet totale në raport me GDP
2006	23.237	81%
2007	24.932	82%
2008	20.418	61%
2009	23.790	70%
2010	26.496	72%
2011	27.509	76%

Burimi: Global Pensions Assets study 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011



## 2.2. Zhvlerësimi i vlerës së asetëve të fondeve pensionale për shkak të krizës globale financiare

Gjatë krizës globale financiare fondet pensionale u përgjysmuan, krahasuar me periudhën e vitit paraprak, dhe zvogëlimi brenda viti 2007-2008 arriti mesatarisht afër 50%. Mirëpo pas vitit 2008 vlera e asetëve të fondit të pensioneve filloi të rritet por në një nivel jo të kënaqshëm. Humbjet e investimeve në të gjitha planet e pensioneve private të OECD (duke përfshirë llogaritë individuale të pensioneve dhe kontratat e sigurimit të pensionit) janë vlerësuar në 5 trilionë dollarë amerikanë, nga të cilat 3.3 trilionë vetëm në ShBA (Botimi nr. 5 I OECD, dhjetor 2008). Fondet irlandeze duket të kenë qenë më të ekspozuarat ndaj humbjes së vlerës së fondeve pensionale me një mesatare prej 60% të asetëve të ndjekura nga ato të ShBA-ve, Britanisë së Madhe dhe Australisë. Në ShBA “Calpers” fondi më i madh shtetëror pensional nga 250 miliardë dollarë asete që kishte në fillim të vitit 2007, ato në tremujorin e tretë të viti 2008 ranë në 192 miliardë dollarë. Sipas Zyrës së Kongresit për Buxhet fondet e pensioneve në ShBA që nga viti 2007 llogariten të kenë humbur vlerën prej 3.000 miliardë dollarë.

Zhvlerësimi i asetëve të fondeve pensionale gjatë krizës globale financiare

Vendet	Zhvlerësimi i asetëve të fondeve pensionale gjatë periudhës 31.12.2006- 31.12.2007	Zhvlerësimi i asetëve të fondeve pensionale gjatë periudhës 31.12.2007-30.12.2008
Australia	-33.90%	-34.70%
Brazili	n.n.	-27.40%
Kanada	-29.4%	-10.20%
Franca	-9.90%	-9.90%
Gjermania	-3.20%	-3.20%
Hong Kongu	-24.60%	-8.00%
Irlanda	-31.60%	-29.80%
Japonia	-1.50%	9.40%
Holanda	-18.10%	-19.57%
Afrika Veriore	n.n.	-28.00%
Zvicra	-4.60%	-5.60%
Britania Madhe <sup>e</sup>	-35.00%	- 46.75%
Amerika	-18.90%	-23.30%
Totali	-19.20%	-21.30%

Burimi: Global Pensions Assets study 2006, 2007

Emetimi dhe tregtimi i aksioneve përfaqëson një nga proceset më të rëndësishme të sigurimit të fondeve për shoqëritë aksionare dhe një nga format më të rëndësishme të investimit të mjeteve të lira të individëve dhe të institucioneve financiare. Fondet pensionale janë institucione financiare që kanë mjete të tepërta, që në çdo moment kërkojnë angazhimin e tyre, qëllim themelor sigurim të fitimit sa më të lartë. Menaxhimi i këtyre mjeteve kërkon një kujdes të veçantë nga se shumë lehtë mund të humbin apo të

zhvlerësohen sikurse ndodhi me rastin e krizës globale financiare. Bursa e letrave me vlerë përfaqësojnë tregje të organizuara në një formë të caktuar, ku kryhen veprimet e tregtimit të letrave me vlerë që ndodhen në qarkullim (të aksioneve dhe obligacioneve), në kushtet e një ballafaqimi të shitësve dhe të blerësve të tyre dhe të formimit të çmimeve përkatëse në përputhje me veprimin e ligjit të ofertës dhe kërkesës së tregut. Zgjedhja e portofolit investues luan rol të rëndësishëm siç shihet nga tabela në vijim.

### 2.3. Portofoli investues i fondeve pensionale

Investimet në aksione të tregtueshme sjellin një dobi më të madhe për kompaninë por bartin një rrezik më të lartë të kthyeshmërisë. Fondet pensionale nuk kanë pasur aftësi që të identifikojnë shenjat e para të krizës globale financiare, nga se mbi 56% e mjeteve të lira i kanë angazhuar vetëm në aksione, nga kjo rrjedh se humbjet më të larta nga kriza patën pikërisht në këta instrumenta financiarë, po ashtu humbje më të mëdha të asetëve financiare pësuan shtetet të cilat kishin investuar më shumë në aksione. Reagimi i shpejtë i poseduesve të fondeve orientoi mjetet e lira në bona dhe në depozita, apo i ruanin në llogari rrjedhëse. Në këtë rast kthyeshmëria është më e ulët, por siguria e mjeteve është më e lartë.

Portofoli investues i fondeve pensionale për periudhën 2007-2008

Viti 2007 Viti 2008

Vendet	Aksione	Bonde	Të tjera	Aksione	Bonde	T ë tjera	Rap. i aksioneve 2007/2008
Australia	58%	16%	25%	45%	29%	27%	- 22.41%
Kanada	52%	33%	15%	42%	43%	16%	- 19.23%
Franca	30%	52%	18%	18%	64%	18%	- 40.00%
Gjermania	28%	65%	6%	16%	77%	7%	- 42.85%
H o n g Kongu	64%	23%	13%	45%	38%	18%	- 29.69%
Irlanda	62%	20%	18%	54%	27%	19%	- 12.90%
Japonia	46%	47%	7%	28%	63%	9%	- 39.13%
Holanda	41%	43%	16%	26%	58%	16%	- 36.59%
Zvicra	33%	38%	29%	21%	44%	25%	- 36.36%
B. e Madhe	64%	24%	11%	49%	37%	14%	- 23.44%
ShBA	59%	23%	17%	45%	35%	20%	- 23.73%
Totali	56%	28%	16%	41%	41%	18%	-26.78%

Burimi: Global Pensions Assets study 2007, 2008 Towerswatson.com, përpunuar nga autori

### 2.4. Pasojat e krizës globale financiare në fondet pensionale të vendeve në zhvillim

Kriza goditi shume fondet e pensioneve nga se potenciali financiar i këtyre fondeve në nivel te sistemit financiar botëror ka një koeficient të lartë të pjesëmarrjes. Fondet e sistemit të pensioneve "PAYG" (pay as you go), që janë të lidhura me fitimet do të preken në mënyrë më pak dramatike dhe të menjëhershme. Për shkak të rënies ekonomike bie edhe fuqia kursimeve, nga njëra anë, kurse nga ana tjetër kemi rritjen e mundshme të kërkesave për pension. Rënia ekonomike globale do t'i zvogëlojë të ardhurat nga kontributet në shumicën e vendeve si pasojë e rënies së punësimit apo rënies së nivelit të fitimeve mbi të cilat vilen këto kontribute. Nga ana tjetër çdo vit e më shumë vihet re tendenca e rritjes

së shpenzimeve për pensione për shkak të rritjes të numrit të pensionistëve. “Vendet si Azerbajxhani, Brazili, Egjipti, Maroku, Rusia, Serbia, Tunizia etj. kanë një trysni fiskale më të madhe, prandaj kriza globale financiare këto vende goditi më shumë”(BB 2010) . Sistemit e pensioneve në principin e llogarive individuale në fonde pensionesh, kanë pësuar më së shumti nga kriza globale financiare. Vendet me pensione të mbuluara me fonde të detyrueshme të cilat pësuan më së shumti nga kriza janë Kili, Salvadori, Meksika, Peruja, Kosova, Hungaria, Polonia etj. Trusti i Kursimeve Pensionale i Kosovës gjatë krizës globale financiare pësoi një rënie të aseteve në vlerë prej 136.000.000 euro, nga vlera e aksionit 1.25 euro në fillim të vitit 2007 për njësi ra në 0.79 euro në fund të vitit 2008 (TKPK, 2012) Por duhet theksuar se humbjen e ndienë vetëm ata pensionistë të cilët gjatë krizës globale financiare arritën moshën e pensionimit, të cilët jo që fituan nga mjetet e kursyera por humben ato deri në 30%.

### **Kapitulli III**

#### **Reagimi i Institucioneve rregullative të kontabilitetit në krizën globale financiare**

##### **3.1. Kontabiliteti i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare**

Kontabiliteti merret me pasqyrimin e plotë, të përgjithshëm, të pandërprerë, të dokumentuar në mënyrë të prerë të veprimeve ekonomike që shkaktojnë ndryshime sasiore dhe cilësore në strukturën organike, në strukturën pronësore dhe në procesin e rritjes së vlerës-kapital. Qëllimi kryesor i kontabilitetit financiar është që të japë informacion në lidhje me gjendjen financiare, me performancën dhe ndryshimet në gjendjen financiare të njësisë. Kontabiliteti financiar jep informacion në lidhje me gjendjen e rezervave pasurore të njësisë, burimeve të financimit të tyre, apo kërkesave për to. Kontabiliteti për mes pasqyrave të rezultatit tregon dinamikën e realizimit të rezultatit ekonomik të njësisë. Informacioni kontabël u shërben një numri të madh përdoruesish në vendimmarrjen e tyre ekonomike. Informacioni kontabël i shërben njësisë ekonomike në marrjen e vendimeve ekonomike të vlefshme për drejtimin e saj me sukses. Zhvillimi i kontabilitetit si shkencë ka kaluar nëpër tri faza duke iu përshtatur zhvillimit ekonomik në nivel botëror ( Drazic, Gulin, Mamic, Tadijancevic, Tusek, Vasisek, Zager,6) . Kontabiliteti i dyfishtë lindi si domosdoshmëri historike për të pasqyruar dinamikën e ndryshimit të gjendjes së kapitalit tregtar nga marrëdhëniet midis subjekteve të këmbimit, që vazhdoi me shekuj. Zhvillimi industrial në Angli bëri që kontabiliteti i dyfishtë të zgjerojë zërat e shumtë duke pasqyruar raportet dhe strukturën e prodhimit. Me zhvillimin industrial kemi të bëjmë me integrimin e kontabilitetit tregtar me atë industrial. Globalizimi, zhvillimi i hovshëm i sistemit financiar në shekullin e fundit bëri që edhe kontabiliteti të mbërrij nivel të lartë zhvillimi duke u kushtëzuar nga integrimi i kapitalit financiar, tregtar dhe industrial. Tregu i kapitaleve ose tregu i tregjeve dhe BURSA, lindën me zhvillimin e madh të kapitalit financiar. Në bilancin kontabël zhvillimi i sistemit të tillë ndryshoi shumë strukturën e aktives dhe pasives. Përveç aktiveve afatshkurtra dhe aktiveve afatgjata ju shtuan edhe aktivet afatshkurta dhe afatgjata financiare. Ky ndryshimi i strukturës së aktives solli edhe ndryshimin e strukturës së pasives, si tituj pronësie, ku në shoqëritë aksionare struktura pronësore e kapitalit u bë tepër komplekse. Përveç këtyre, si në aktiv ashtu edhe në pasiv u shtuan instrumentet financiare, që nuk ekzistonin më parë dhe që u bënë dominuese në zhvillimin e tregjeve financiare.

##### **3.2. Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe rëndësia e tyre**

Dinamika e tillë e rritjes së tregut financiar, tregtar dhe industrial, ndërkombëtarizimi i

plotë i bursës, kanë bërë që të bëhen përpjekje më të mëdha për njësimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimeve Financiare Vjetore (SNRF). Vlen të theksohet se kontabiliteti klasik i cili u përdor deri në vitin 2000 nuk ka qenë një ndër shkaqet e krizës globale financiare e pastaj edhe krizës ekonomike. Dëshira e madhe për pasuri të pakufizuar, apo maksimalizimi i fitimit ka qenë një ndër shkaqet kryesore të krizës. Rritja shumë e shpejtë e tregut financiar, futja e produkteve të reja financiare, shtyri institucionet e ndryshme financiare botërore që të mendojnë për të korrigjuar Standardet e deritashme Ndërkombëtare të Kontabilitetit, sidomos Standardin 39. Bashkësia Evropiane gjatë vitit 1999 bëri ndryshimet dhe plotësimin e Standardi 39, ku nga koncepti tradicional i vlerësimit të aktiveve (vlera furnizuese), kalohet në vlerësimin e aktiveve në bazë të çmimit në treg (vlerës reale). Investitorët amerikanë në fillim të shekullit XX, iu drejtuan Komisionit Amerikan të Letrave me Vlerë, ku kërkuan ndryshimin e metodës për vlerësimin e aktiveve financiare afatgjata. KALV (Komisioni Amerikan i Letrave me Vlerë) përmes Komitetit Amerikan për Standardet e Kontabilitetit Financiar (KASKF) ndryshoi Standardet Amerikane të Kontabilitetit (GAAP). Pra BE dhe ShBA harmonizojnë ndryshimet dhe plotësimet e Standardit nr. 39, ku vlerësimi i aktiveve financiare afatgjata gjatë raportimeve financiare sipas Standardit nr. 1 do të bëhet në bazë të vlerës reale në datën e raportimit financiarë.

### **Ndryshimi i SNK 39 - Instrumentet financiare, njohja dhe matja, luan rol të rëndësishëm në tejkalimin e krizës**

#### **4.1. SNK 39 instrumentet financiare, njohja dhe matja**

Objektivi i këtij standardi është të vendosë parimet për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, pasiveve financiare dhe të disa kontratave për shitjen ose blerjen e zërave jofinanciarë. Në raportimet financiare vend të rëndësishëm zënë vlefshmëria e pasurisë. Nëse pasuria e kompanisë, apo institucioneve të ndryshme në pasqyrat e raportimit financiar vlerësohet sipas çmimit furnizues, rasti me bankat, dhënia e kreditit apo letrave me vlerë të cilat blihen dhe vlerësohen me vlerë nominale, investitorët potencialë nuk kanë mundësi të ballafaqohen me rreziqe që kanë të bëjnë me këtë lloj pasurie. Në fund të vitit 2007 Komisioni Amerikan i Letrave me Vlerë kërkoi që në raportimet financiare në fund të periudhave raportuese të jenë të obliguara edhe raportet e vlefshmërisë së pasurisë (çmimi i pasurisë në kohën e hartimit të raportit financiar). Vlerësimi në bazë të vlerës së tregut në kontabilitet daton shumë vonë. Gjatë krizës globale financiare në institucionet kreditore amerikane, vlerësimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare në bazë të çmimit të kostos, tregonte një pasqyrë joreale të pasurisë të këtyre institucioneve, kurse investitorët kishin dyshime në vlerësimin e pasurisë së tyre, si dhe pamjaftueshmëri në mbulimit e obligimeve (mungesa e likuiditetit). Regjistrimi i aktiveve financiare në fillim është bërë, sipas çmimit të cilit e kishin instrumentet financiare në momentin e blerjes, që ka qenë shumë më i lartë se sa çmimi i tregut. Problem kryesor me shumicën e aksionarëve ka qenë pikërisht vlerësimi i aktives.

#### **4.2. Vlera reale në treg (faire value) bazë për vlerësimin e pasurisë në periudhën raportuese**

Për këtë arsye nga organizatat profesionale të kontabilitetit janë bërë shumë kërkime dhe janë hulumtuar shumë metoda për të zgjedhur alternativën më të mirë për vlerësimin e instrumenteve financiare në periudhën e raportimit financiar. Nga të gjitha alternativat vlerësimi i instrumenteve financiare në bazë të vlerës së tregut, eliminon shumicën e

mangësive të vlerësimit në bazë të çmimit të kostos. Vlerësimi i aktiveve në bazë të vlerës së tregut kuptohet, çmimi i aktiveve në një moment caktuar dhe në rrethana të caktuara që siguron një vlerë reale të pasurisë dhe obligimeve. Në vendet e zhvilluara menaxhmenti ka të drejtë të zgjedhë politikatat e raportimeve financiare të kompanive, zgjedhjen e politikave kontabile, apo pranimin e vlerësimeve profesionale, që ndikojnë në përmbajtjen e bilancit. Sipas standardit 39, vlerësimin e instrumenteve financiare në bazë të vlerës se tregut (faire value) duhet të shfrytëzojnë:

- çmimet e kuotura, për ato instrumente për të cilat ekziston treg matës si dhe
- vlerësimet teknike, për ato instrumente ku nuk ekziston treg matës (që nuk ka vlerë tregu) (Dhimarko,2009 ,71).

#### **4.2. Humbja e vlerës së pasurisë nga pasojat e krizës globale financiare**

Kriza globale financiare, e karakterizuar nga mungesa e likuiditetit, kërkesa e likuiditetit nga tregjet financiare, çmimet e tregut, të cilat deri atëherë kishin qenë të dhëna më të rëndësishme në përcaktimin e vlerës së drejtë, bëhet i padëshirueshëm. Mungesa e likuiditetit në shumicën e tregjeve ka bërë që çmimet në treg të sjellin disa instrumente financiare në vlerën zero (duke pasur për bazë vlerësimin e tyre në bazë të vlerës reale në treg). Një numër i madh i kompanive, përmes *Citigroup apo Merrill Lynch*, kanë obliguar shlyerjen e një pjese të instrumenteve financiare në aktive, kështu shënohet një rënie rekorde e aksioneve të tyre. Megjithatë, për menaxhmentin një vlerësim i tillë është krejtësisht i papranueshëm për shkak të kushteve në të cilat ka ndodhur, shkaqet që kanë shkaktuar panik, apo kushtet e krizës.

### **Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) - Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe raportet financiare në kohën e krizës**

#### **5.1. Amendamentet e reja në SNK 39**

Pasojat e krizës globale financiare detyruan institucionet ndërkombëtare që të bëjnë ndërrim në Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 39, me qëllim që raportimet financiare të jenë sa më reale. Këshilli për Standardet Ndërkombëtare solli disa propozime për ndryshimin e SNK nr. 39 për pranimin dhe vlerësimin e instrumenteve financiare të cilat paraqiten në tetor 2008. Me këto ndryshime iu mundësua bankave të mëdha botërore, institucioneve të tjera financiare, si dhe shumë kompanive të tjera, të zvogëlojnë sa është e mundur pasojat e krizës globale financiare, të cilat reflektohen në raportimet financiare, përmes rezultateve të veprimtarisë në bilanc. Qëllimi i ndryshimeve ka qenë harmonizimi i SNK – SNRF me parimet e kontabilitetit amerikan (ShBA GAAP) (Dhamo, 2005,37). Për shkak të kësaj situatë shumica e institucioneve financiare në ShBA nga politika e vlerësimit në bazë të çmimeve të tregut, kanë kaluar në vlerësimin në bazë të inputeve në nivelin e tretë, ose vlera në përdorim ( Prof. Wiliam Beaver). Situata e tillë detyroi institucionet ndërkombëtare për raportimet financiare, të rishikojnë konceptin e vlerës reale të deritashme mbi vlerësimin e aktiveve, e cila krijoi mundësinë për sjelljen e amendamenteve të reja në Standardet e Raportimeve Financiare, amendamente të cilat mundësojnë vlerësimin e instrumenteve financiarë që mbulojnë kategorinë e kredive që nuk mund të aplikojnë vlerën e drejtë në datën e përpilimit të bilancit. Me këtë rast, në bilancin e suksesit, ndryshimet në vlerën reale nuk do të regjistrohen më, kështu që deri sa vlera e instrumenteve financiare bie, rënie e cila karakterizohet si e përkohshme, institucionet financiare në librat e regjistrimeve nuk do të regjistrojnë humbjet për shkak

të rënies së vlerës. Kjo vlen vetëm për instrumentet financiare që janë shitur apo blerë që nga korriku 2008. Amendamentet e vlerësimit të aktiveve në bazë të vlerës reale nuk janë ndryshuar, mirëpo përmes disa korrigjimeve dhe riklasifikimit të instrumenteve financiare, mundësohet që institucionet financiare të cilat më së shumti u prekën nga kriza ta përmirësojnë profitabilitetin e tyre. Qëllimi i rregullave të kontabilitetit është përdorimi i disa metodave, të cilat do t'i përgjigjeshin situatës aktuale. Nga sa u tha më sipër mund të vijmë në përfundim: kriza globale financiare kontabilitetit i pamundëson sigurimin kualitativ të informacionit kontabël mbi vlerën e aktiveve dhe pasiveve të një institucioni financiar.

## 5.2. Qëllimi e amendamenteve të reja të SNK 39

Ndryshimet e amendamenteve në SNK nr. 39 qëllimin kryesor e ka pasur në zvogëlimin e pasojave që ka pasur kriza globale financiare në bilancin e suksesit. Qëllimet kryesore kanë qenë:

- *Te natyrës psikologjike.* Kriza globale financiare ka bërë që shumë miliardë të bëjnë vetëvrasje, vlerësimi i aktiveve jo në momentin e hartimit të bilancit, por në momentin kur shiten, mundësoi që sado pak të zvogëlojnë psikologjinë të aksionaret dhe të investuesit të mjeteve, për ruajtjen e pasurisë.
- *Aktivet dhe pasivet në fondet e pensioneve janë afatgjata.* Rikuperimi i këtyre mjeteve nuk ka rëndësi, nga se fondet pensionale kanë sasi të mjaftueshme të mjeteve likuide për mbulimin e obligimeve. Trusti i Kursimeve Pensionale në Kosovë brenda dy viteve arriti çmimin për njësi nga 0.79 euro në vitin 2009, në 1.05 në vitin 2011 (Trusti 2011).

*Ruajtja e besueshmërisë të konsumatorët ekzistues dhe joshja e konsumatorëve potencial.* Fondet e pensioneve kohëve të fundit pësojnë shumë nga humbja e besimit ( rreziku nga humbja e besimit). Kohëve të fundit menaxherët gjithnjë e më shumë po i kushtojnë vëmendje menaxhimit të rrezikut të besimit. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e krizës së tashme globale financiare. Është e padiskutueshme që besimi është një përbërës i domosdoshëm në fondin e pensioneve. Fondet e pensioneve në fakt operojnë në “ biznesin e besimit”. Reputacioni është një paketë gjithëpërfshirëse e perceptimeve, opinionëve dhe pritshmërisë së qëndrueshme të aksionarve. Reputacioni konsiderohet si një fenomen publik, kolektiv. Besimi është një kundërvështrim subjektiv dhe individual i besueshmërisë së një organizate. Përformanca është një tjetër përcaktues i rëndësishëm i besimit. Besimi nuk do të jetë i qëndrueshëm nëse përformanca e korporatës dështon për të përbushur pritshmërinë e aksionarëve. Përgjegjshmëria luan një rol të rëndësishëm sa herë që grupet e interesit ndërveprojnë direkt në një organizatë. Paraqitja është element që jep kontributin më të vogël në besim. “Është e një rëndësie të veçantë për industrinë e fondeve të pensioneve për vetë faktin që ajo shet shërbime të paprekshme dhe abstrakte”, (The Geneva Paper, 2009).

## Konkluzione

Kriza financiare është fenomen i njohur, ai nuk vjen papritur sikurse katastrofat, por gjithherë i befason ekonomistët, pjesëmarrësit në tregun financiar, i befason edhe vetë politikanët, pa marrë parasysh sa kanë mundur të kenë ndikim. Sipas tërësaj që po ndodh, thuhet nuk ka fuqi, as forcë e cila do të mund ta parandalojë krizën financiare. Mbylli shumë fabrika, shumë institucione falimentuan, miliardë humben pasuritë e tyre, punonjësit humben vendet e punës, fondet të tera u tretën, mungesë e theksuar e likuiditetit, kriza u reflektua në ekonomi si një uragan që shkatërroi tërë çka ishte krijuar

për një kohë të gjatë.

Menaxhimi i mirë i fondeve pensionale zvogëlon rrezikun e aftësisë paguese, ruan stabilitetin e fondeve dhe njëkohësisht ruan besimin e kontribuueseve të fondit. Duke marrë në konsideratë shpejtësinë dhe kompleksitetin në rritje të tregjeve financiare, menaxhuesit e fondeve të pensioneve duhet të jenë të përgatitur për zhvillimet që mund të shkaktojnë sfida e ndryshme (kriza globale financiare 2008). Është mirë të evitohen ndryshimet e papritura të politikave, në përgjigje të rrethanave të menjëhershme, nga se sistemet e pensioneve janë strukturuar të funksionojnë në periudha të gjata kohore.

Për menaxhimin e krizës e cila shkatërroi sistemin financiar dhe ekonomik po thuajse në tërë botën, duhet hulumtuar rrugë, metoda, modele që mundësojnë daljen nga kriza dhe zbutjen e pasojave të saj. Shoqatat e ndryshme të Kontabilistëve, dhe financiarëve aprovuan amendamente me të cilat ndryshuan SNK 39. ku me ndryshimet e tyre u bë i mundur zvogëlimi i pasojave të krizës, ndryshime shumë të rëndësishme.

Ndryshimet e amendamenteve të tilla dhe shumë të rëndësishme në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit SNK 39. në vijim pritet të japin rezultate e dëshiruara. Ndryshimet e tilla veç kanë filluar të dhenë rezultatet e para në fondet e pensioneve, nga se arritën ta ruajnë besimin, si te aksionarëve ashtu edhe te kontribuueseve, ruajtën asetet dhe filluan rritjen e tyre.

Fondet e pensioneve janë një nder kontribuuesit themelor për rritjen ekonomike të vendit, e krahas saj edhe zhvillimit ekonomik të vendit. Gjithherë janë kontribuues i financimit të ekonomisë, qoftë sektorit financiar apo ekonomik, në ata sektor ku krijohet mungesë likuiditeti, duke u huazuar fondet e lira, në forma të ndryshme.

## Literatura

1. Binaj, A. & Kalem, F. (2008). "Kontabiliteti" botimi i tretë, Tiranë.
2. Maesao, R., Philipps, A. & Raulet, Ch. (2009). Kontabiliteti Financiar, DUNOD, Paris.
3. Angjeli, A. "Kriza e borxheve dhe falimentimi i shtetit" "albatlanta .com"
4. Drazic, I., Gulin, D., Mamic, I., Tadijancevic, S., Tusek, B., Vasicek, V., Zager, K. & Zager, L. (2010). "Kontabiliteti" Ekonomski Fakultet Zagreb.
5. Dharmo, S. (2005). "Kontabiliteti i Avancuar", Tiranë.
6. Dhimarko, Th. (2009). "Komentari Mbi Standardet e Kontabilitetit", Tiranë.
7. Ostojic, S. (2007). "Osigurim dhe Upravljanje Rizicima", Status, Beograd.
8. Lukic, R. (2011). "Bankarstvo Racunovodstvo" Ekonomski Fakultet, Beograd.
9. Civici, A. (2009). "Kriza Globale Financiare", Tiranë.
10. Pano, A. (2009). "Kriza e Tanishme Financiare – Kreditore dhe ndikimi i saj në ekonominë tonë", Tiranë.
11. Baletiq, Z. & Mediq, Gj. (2009). "John M. Keynes i hervatska ekonomska misao", Zagreb.
12. Boshnjak, M. (2011). "Globalna financiska i ekonomska kriza", pjesa e parë, Beograd.
13. Grupa autoresh. (2008). Prakticna primena MSFI u Republici Srbii, "Racunovodstvo", Beograd, Savez Racunovoda i revizora Srbije.
14. Majstorevic, A., Milojevic, I. (2009). "Racunovodstvo", Novi Sad, privreda Akademija.
15. The Geneva Paper on Risk and Insurance Issues and practice, vëllimi 33, nr.1 janar 2009.
16. Cooper, G. (2009). "Uzroci finansijske krize", Masmedia, Zagreb.
17. BB Botimi nr 5 I OECD, dhjetor 2008 [www.worldbank.org/](http://www.worldbank.org/).
18. Juriçiq, Lj. (2008). "Anatomija krize." Kapitalizmu glava u torbi", botuar në Magazina MADE-in.
19. Bradic, A. & Martinovic. (2009). "Panzijski Planovi", Beogradska Banka Akademija, Beograd.

20. Towers Watson and secondary sources Assets/ GDP ratio for the World is calculated in USD and assets were estimated as of 31 Dec 2006, januar 2007. [www.towerswatson.com](http://www.towerswatson.com)
21. Towers Watson and secondary sources Assets/ GDP ratio for the World is calculated in USD and assets were estimated as of 31 Dec 2007, januar 2008. [www.towerswatson.com](http://www.towerswatson.com)
22. Towers Watson and secondary sources Assets/ GDP ratio for the World is calculated in USD and assets were estimated as of 31 Dec 2008, januar 2009. [www.towerswatson.com](http://www.towerswatson.com)
23. Towers Watson and secondary sources Assets/ GDP ratio for the World is calculated in USD and assets were estimated as of 31 Dec 2009, januar 2010. [www.towerswatson.com](http://www.towerswatson.com)
24. Towers Watson and secondary sources Assets/ GDP ratio for the World is calculated in USD and assets were estimated as of 31 Dec 2010, januar 2011. [www.towerswatson.com](http://www.towerswatson.com)
25. Towers Watson and secondary sources Assets/ GDP ratio for the World is calculated in USD and assets were estimated as of 31 Dec 2011, januar 2012. [www.towerswatson.com](http://www.towerswatson.com)
26. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUSTI) raporti, 2010. [www.trusti.org](http://www.trusti.org)
27. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUSTI) raporti, 2012. [www.trusti.org](http://www.trusti.org)
28. BQK(2011) Raporti vjetor 2011, qershor 2012. [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)
29. BQK(2010) Raporti vjetor 2010, qershor 2011. [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



## Të dhënat kristalografike të mineraleve të Trepçës

M.Sc.Sabrije Musa-Syla  
UP.ISA BOLETINI-Mitrovicë

### Abstrakt

Qëllimi i këti punimi ishin të dhënat e mineraleve që gjenden në muzeun e Trepçës. Në muzeun e Trepçës gjenden rreth 1800 minerale. Hulumentimet e para për mineralizimet polimetalore të Pb-Zn, u bë nga gjeologët anglez, mirpo në vitin 1930 fillon prodhimi provues i mineralizimeve sulfure të Pb-Zn në këtë vendburim.

Në muzeun e Trepçës minerali më i rëndësishëm është vivianiti. Miniera Trepça në Stantërg i përket qytetit të Mitrovicës. Për herë të parë në literaturë emri Trepça përmendet më 1303, në dokumentet që ruhen në arkivin e Dubrovnikut, si dhe në arkivat Osmane në veçanti për rajonin e Artanës.

Hulumentimet e para gjeologjike filluan në vitin 1924, atëhere kur gjeologët anglez filluan kërkimet gjeologjike për mineralizimet polimetalore sulfure të Pb-Zn, në suaza të fushës xeherorë të Trepçës në Stantërg.

Termi Kristal (greqisht, kristalsos-akull ,kristal i malit) është një trup i ngurtë homogjen ,i formuar ne kushte natyrore ose artificiale, i kufizuar nga jashtë me faqe te sheshta dhe me forma te ndryshme gjeometrike.

Pra kristalet janë ato përbërje kimike, qe zotërojnë një rregullsi trepermasore periodike te njësie ndërtuese-pra një strukturë kristaline. Forma e kristaleve shprehet me ane te dy nocioneve :me ane te pamjes dhe me ane te habitusit te tyre.

Pamja e kristaleve përfaqëson trajtën e përgjithshme te tyre qe kushtëzohet nga karakteri i rritjes se kristaleve.

**Fjalë kyçe:** Trepçë, Muze, Mitrovicë, Mineral, Kristal.

### Hyrje

Miniera Trepça në Stantërg i përket qytetit të Mitrovicës. Mitrovica është pa dyshim ndër qytetet më të rëndësishme jo vetëm në Kosovë por edhe në gjithë Gadishullin Ballkanik e më gjerë, për nga pasuritë minerale. Shtrihet në fushën aluviale të lumenjve: Ibër, Sitnicë dhe Lushtë, si dhe në shpatet e kodrave që e rrethojnë. Mitrovica gjendet në lartësinë mbidetare 508 – 510 m dhe ka pozitë të mirë gjeografike. Përcaktimi i llojeve të mineraleve që ndërtojnë xeherorin e vendburimit, marrëdhëniet para gjenetike, si dhe radhitja në vijueshmërinë e formimit të tyre paraqesin vlerën më të rëndësishme në përcaktimin e gjenezës së vendburimit.

Republika e Kosovës ,me sipërfaqe rreth 10887 km<sup>2</sup>, përmban të gjitha karakteristikat për një zhvillim normal ekonomik për vendin.

Vendi ynë përveç tokës bujqësore rreth 54% apo 5890 km<sup>2</sup>, 42%apo 4600 km<sup>2</sup> janë tokë pyjore dhe rreth 3.64% apo 397 km<sup>2</sup> përkasin tokës pjellore. Vendi ynë është i begat edhe me pasuri natyrore, e veçanërisht është i njohur për mineralizimet e Pb-Zn-Ag.

Për herë të parë në literaturë emri Trepça përmendet më 1303, në dokumentet që ruhen në arkivin e Dubrovnikut, si dhe në arkivat osmane në veçanti për rajonin e Artanës.

Hulumentimet e para gjeologjike filluan në vitin 1924, atëhere kur gjeologët anglez filluan kërkimet gjeologjike për mineralizimet polimetalore sulfure të Pb-Zn ,në suaza të fushës xeherorë të Trepçës në Stantërg. Më vonë, saktësisht në vitin 1926,në Londër formohet

një shoqëri aksionare e njohur me emrin Trepça Mines Limited, e cila merr me koncesion shfrytëzimin e këtij vendburimi për 50 vjet.

Në vitin 1930 fillon prodhimi provues i mineralizimeve sulfure të Pb dhe Zn në këtë vendburim .Gjatë Luftës së Dytë Botërore gjermanët e mbajnë minierën e Trepçës në Stantërg në gjendje pune, por me një nivel të zvogëluar të prodhimit .

Ndërsa nga viti 1945 e këndej deri më 1990, miniera ka punuar pa ndërprerë me një kapacitet mesatar të prodhimit rreth 600.000 ton në vit.

Gjatë kësaj periudhe në shfrytëzim ishin këto miniera: Trepça në Stantërg, Cërncac, Bellobord, Koporiq dhe Zhuta Perlla –Albanik (ish Leposaviq), Kishnica, Hajvalia, Badovci dhe përroi i ngjyrosur-Artanë.

Ndërkaq pas luftës (2000-2004), miniera nuk ka prodhuar, por ka qenë në permanizim, hulumtim dhe përgatitje të punishteve.

Kështu në vitin 2005 miniera ka filluar me prodhimin e xehes së plumbit, mirëpo suksesti më i madh i kombinatit Trepça në Stantërg u arrit në vitin 1983.

### **Miniera e Trepçës – Historiku**

Miniera Trepça në Stantërg i përket qytetit të Mitrovicës. Mitrovica është pa dyshim ndër qytetet më të rëndësishme jo vetëm në Kosovë por edhe në gjithë Gadishullin Ballkanik e më gjerë, për nga pasuritë minerale. Shtrihet në fushën aluviale të lumenjve: Ibër, Sitnicë dhe Lushtë ,si dhe në shpatet e kodrave që e rrethojnë. Mitrovica gjendet në lartësinë mbidetare 508 – 510 m dhe ka pozitë të mirë gjeografike.



Qyteti kufizohet me shpatijet e Kreshbardhës (Kopaoniku, Rogozna, Mokra dhe Çyçavica). Territori i kësaj komune kufizohet në pjesën veriore me atë të Zveqanit, me Besianën në pjesën lindore, me Vushtrrinë në pjesën juglindore, me Skenderajn në pjesën

jugperëndimore. Ne drejtim të Sitnicës lidhet me rrafshin e Kosovës .

Rajoni i Mitrovicës me rrethin ka pozitë të rëndësishme gjeografike dhe strategjike, sepse në këtë trevë ndërpriten rrugë të rëndësishme që të shpijnë në brendinë e Gadishullit Ballkanik, në bregdetin Adriatik, në Detin Ege dhe në Detin e Zi.

Karakteristikë mbizotërues morfologjike të territorit të komunës së Mitrovicës, janë zonat malore –kodrinore. Lidhjet e komunikacionit janë të kënaqshme, pasi përveç rrugëve automobilistike që e përshkojnë, këtu kalon edhe hekurudha Beograd –Mitrovicë-Shkup. Vendburimi i Stantërgut ndodhet 9 km larg kësaj hekurudhe. Si rrugë kryesore e Rajonit ku shtrihet miniera e Trepçës, shërben rruga automobilistike Mitrovicë-Prishtinë-Shkup. Përveç kësaj ka edhe rrugë të tjera, të cilat gjate stinës së dimrit bëhen të pakalueshme (Shala, 2010).

Me rrugën Mitrovicë-Stantërg-Bajgorë –Podujevë, treva ka perspektivë edhe në zhvillimin e turizmit malor.

Vendi ynë është i begatë me pasuri natyrore, veçanërisht është i njohur për mineralizimet e Pb – Zn – Ag, për të cilat dihet që nga kohërat e lashta.

Pasuritë e Kosovës shfrytëzoheshin nga paraardhësit tanë ilirët, më pas nga bizantinët, turqit dhe së fundi nga okupatori serb. Që në kohërat e lashta është ditur për vendburimet polimetalore të sulfureve të Pb, Zn, Ag, Au, në Kosovë. Këtë e kanë vërtetuar zbulimet e shumë punimeve të vjetra minerale: galeri, puse, vegla të punës, që janë përdorur në kohëra të ndryshme gjatë shfrytëzimit të mineralizimeve të këtij lloji, si dhe mbetjet nga shkrirja e tyre. Disa nga vendburimet sulfure (Trepça në Stantërg, Bellobërdë, Cërnac, Përroi i ngjyrosur – Artanë), edhe sot pas luftës së fundit në Kosovë (1998/99), gjenden në shfrytëzim. Ndërkaq vendburimet si: Hajvalia, Badovci dhe Kishnica janë të zhytura në ujë dhe kanë mbetur pa kurrfarë mbikëqyrje edhe pse para luftës (periudha 1988/99), ishin prodhues të rëndësishëm të xehes së Pb, Zn dhe Ag etj.

Qe ne kohërat e lashta është ditur për vendburimet polimetalore te sulfureve të – Zn – Ag, në Kosovë.

Disa nga vendburimet sulfure (Trepça në Stantërg, Bellobërdë, Cërnac) edhe sot pas luftës së fundit në Kosovë (1998-99), gjenden në shfrytëzim.

Ndër kaq vendburimet si: Hajvalia, Badovci dhe Kishnica janë të zhytura në ujë dhe kanë mbetur pa kurrfarë mbikëqyrje.

Për herë të parë në literaturë emri Trepçë përmendet më 1303 në dokumentet që ruhen në arkivin e Dubrovnikut. Për zhvillimin e xehetarisë në territorin ku gjendet minierat e Trepçës dihet qysh në kohërat ilire e romake e që vazhdon deri në Mesjetë.

Hulumtimet e para gjeologjike filluan në vitin 1924, atëherë kur gjeologet anglezë filluan kërkimet gjeologjike për mineralizimet polimetalore sulfure te plumbit dhe zinkut, në suaza të fushës xeherorë te Trepçës në Stantërg më vonë në vitin 1926 në Londër formohet një shoqëri e njohur me emrin Trepça Mines Limited, e cila merr në koncesion shfrytëzimin e këtij vendburimi për 50 vjet. Në vitin 1930 fillon prodhimi provues i mineralizimeve sulfure te plumbit dhe zinkut në këtë vendburim. Gjate luftës Gjermanët e mbajnë minierën e Trepçës në Stantërg në gjendje pune por me një nivel të zvogëluar të prodhimit.

Ndërsa nga viti 1945 e kënde, deri më 1990, miniera ka punuar pa ndërprerë me një kapacitet të prodhimit rreth 600.000 ton në vit (Feraund, 2005)

Bazuara në statistikën e prodhimit, miniera e Trepçës në Stantërg, nga viti 1930 e deri në vitin 2000 ka pasur këtë ecuri të mirë të prodhimit (Shala, Hyseni, Durmishaj, 2010).

Ndërkaq, pas luftës, gjatë periudhës 2000-2004, miniera nuk ka prodhuar, por ka qen në

permanizim, hulumentim dhe përgatitje të punishteve për prodhim.

Kështu, në vitin 2005, miniera ka filluar me prodhimin e xehes së plumbit e zinkut me kapacitet minimal por në rritje shumë më të madhe.

Suksesi më i madh i kombinatit të Trepçës u arrit në vitin 1983, atëherë kur Trepça eksportoi mallra me vlerë prej 103 milion dollarë, duke u radhitur në vetin e 5 të eksportuesve në ish Jugosllavi. Për 58 vjet të punës prodhuese, kombinati i Trepçës ka prodhuar 33 milion ton xehesor me përmbajtje mesatare 9% (Pb dhe Zn), apo rreth 3 milion ton metal (Pb dhe Zn).

Përveç kësaj në metalurgjinë e Trepçës dhe fabrikën e pasurimit, në kohëzgjatje të ndryshme, janë prodhuar këto sasi të metaleve të çmueshme: argjend (Ag), ar (Au), bismut (Bi), kadmium (Cd).

Vendburimi polimetaloresh i Pb, Zn, Ag dhe Au në Stantërg, është ndër vendburimet polimetalore më të njohura në Evropë, për nga madhësia dhe më atraktivi nga shumë llojshmëria e mineraleve dhe bukuritë kristalore që ka ky vendburim. Bazuar nga bukuritë mahnitëse të kristaleve ka ekzistuar ideja e themelimit të muzeut të kristaleve në Stantërg. Kështu, në vitin 1964 u themelua Muzeu i Kristaleve të Trepçës në Stantërg. Në atë kohë kishin filluar grumbullimet e para të mineraleve dhe më pas, vendosja e tyre në muze. Fillimisht numri i nxjerrë të kristaleve ishte i vogël, mirëpo me kalimin e kohës ky numër erdhi duke u rritur deri në ditët e sotme. Numri i kristaleve të nxjerrura nga vendburimi Trepça është i madh dhe vështirë të dihet numri i saktë i tyre. Mirëpo, në fondin e muzeut të kristaleve Trepça, aktualisht gjenden të ekspozuara 1560 eksponate.

### **Të dhënat teorike mbi disa veqori të mineraleve dhe përdorimi i tyre Elementet e lindura (native)**

According to (OECD, 2005) now role of the teacher is changing. Requirements in schools and teachers are becoming more complex. Society now expects schools to deal effectively with different languages and different background students. To be more sensitive to culture and gender issues, to promote tolerance and social cohesion, to effectively responding to students with deficiencies and students with learning problems and their behavior, the use of new technology, and to be in step with the rapid developments in the fields of knowledge as well as ways to evaluate students.

Teachers should be able to prepare students for a society and an economy in which they are expected to be self guided students, enabled and motivated to continue with lifelong learning, "in their preparation for professional development and their working life (OECD, 2005, pp. 100- 110)

### **CLT as part of Kosovo Curriculum**

The essence of CLT is the engagement of learners in communication in order to allow them to develop their communicative competence. The elaboration of what we know as CLT can be traced to concurrent 20th-century developments in linguistic theory and language learning curriculum design both in Europe and in North America. (Savignon, 2006).. Kosovo curriculum strongly emphasizes the CLT, where the student is independent to communicate and to optimize the topic or situation to talk about, and puts a specific emphasis on learning the language with the sole purpose of using it in situations outside school, such as airports, restaurants, shops, streets. (Ministry of Education, 2011)

Competences provided by the Curriculum Framework are derived from the overall goals of undergraduate education and define key learning outcomes, which should be reached by students in a progressive and sustained during undergraduate education system. (Ministry of Education, 2011)

One of the key Competences that students must own during the undergraduate education is Competence of communication and expression with student as effective communicator. (Ministry of Education, 2011)

Competence of communication and expression according to (Ministry of Education, 2011) are:

- Communication through mother tongue
- Communication through foreign languages
- Cultural expression through symbols, signs and other artistic expressions
- Communication through Information Technology
- The commitment and contribution for productive dialogue
- Respect the rules of communication
- Giving and accepting constructive feedback
- The expression of tolerance in communication
- Initiate constructive actions

The competences of communication and expression (“Effective communicator”), means that children and young people should be developed as personalities, learn and participate actively in society, it is important to understand messages to who are directed and adequately expressed through languages, symbols, signs, codes and artistic forms. To communicate effectively, students are encouraged to utilize independent, critical and creative tools and possibilities of communication and expression.

The competences of communication and expression, thinking competencies and learning competencies are instrumental nature: they are the basis for other competencies, which are more related to the circumstances and with certain content, such as necessary competences to private lives, public and professional.

### **Learning a language using CLT**

Most authors stated that learning a foreign language in the past considered as mechanical. They also put emphasis on precision and accuracy of a language. This means that students had to compile grammatically correct sentences without even a single grammatical mistake in morphology and syntactic. My opinion is that this method makes student highly dependent from the teacher, not giving much opportunity to students to communicate in a relaxed way, among teachers and students, as well as students themselves. Students would learn things by heart, known at present but not being able to produce at the moment they need.

The constructive theory with the method of communication has a different point of view compared to some other methods where the student becomes the centre of the class and where the teacher is only a facilitator.

(Richards, 2006) describes learning through Communication method as follows:

- Interactivity between language learners and speakers.
- Creating a cooperative meaning.
- Establish a meaningful interactivity through a language.
- Learning through a student participation feedback when they learn or use a language.
- Being carefully about the language they hear (the input) and attempt to incorporate new forms with anyone who develops communicative competences.
- Attempt of using the language and experiment with various forms the language.

The broad aim of CLT is to apply theoretical perspective of communicative approach making communicative competence a purpose of teaching and accepting interconnection of a language and communication (Diane, 2000).

(Richards, 2006), speaking about his experience in a class where is used CLT, he speaks according to his class observations. Based on these observations he comes out with the following principles:

Whenever possible “authentic language” should be used – a language that is used in a real context.

Being able to convey the goals of speaker and writer, is part of being competent in communication.

English as (target language) is a tool for communication in the classroom, and not just the object of study.

A function may have different linguistic forms. Since the focus of the course is the real use of language, then it is presented along with a wide range of varieties of linguistic forms. We should emphasis the process of communication but not on language forms.

Games are important, as they have clear features, shared with real communicative events. Also, the speaker takes immediate/instant feedback by the listener, no matter if he / she have made a successful communication.

As activity as a goal has the fluency of a language, the teacher does not correct the student but takes notes for the students mistakes and later discusses with the class.

### **Research methodology**

The research question in this article is how much is CLT implemented in public schools in Republic of Kosovo?

We used the observation method to see the implementation of CLT, the compulsory method that teachers should be using according to Kosovo curriculum.

An experiment was conducted by applying the CLT syllabus to see the changes in student performance while teaching with CLT and with other methods.

A sample of 150 students was part of the experiment for our experimental and control groups in urban school “Luarasi in Prishtina and “Hivzi Sylejmani”.

At the end of the academic year, students’ knowledge was tested, with PET test (Preliminary English Test) not only to measure the students’ performance after applying CLT, but to compare the experimental group’s performance who were taught using CLT and control group’s performance, who were taught using other methods.

At the same time SPSS was used to see the correlation between the four language skills and their interactions version 17.0.

### **Results**

From the class observation in some English classes of above mentioned schools of the Republic of Kosovo, we came to conclusion that the CLT, as a recommended method by the Kosovo curriculum, is not implemented in almost any school in place where the research was done. Furthermore, some of the teachers did not have a clue of what the methods and techniques were. Three of four observed teachers were not even qualified as English teachers. They finished some English courses in private schools of foreign languages but not university where they could gain proper methodical and pedagogical knowledge of how to teach.


The method that was widely used by teachers was that ESA. This method usually belong to a multi- Syllabus- Syllabus which incorporates in itself a most wide range of syllabi as the grammar syllabus, the lexical syllabus, the functional syllabus, the situational syllabus, the topic-based syllabus and the task-based syllabus. Reasons why ESA method has been used is because the Ministry of Education, Science and Technology (MEST) makes it compulsory for schools to use “Headway” course books which are designed with multi-



syllabus - syllabus, which is a paradox in itself, as it seems that MEST itself does not take into consideration Kosovo curriculum.

What we observed in the class was: the teachers started their class explaining the grammar as a first thing, which was against the features of CLT. Communication in the class was in a very low level, the exercises in the class were related mostly to grammar and reading, and the attention in class was in low level too.

FIGURE I. Results in Performance after applying the PET testing



If we refer to “Fig.1”, we can see that after application of the CLT syllabus, the experimental group has 47.26% of performance compared to control group which has only 30.62% of performance. This tells us that application of CLT was highly successful.

TABLE I. Results of control and experimental groups with different skills

Category		N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
Reading	PET Gr. Control	51	8.5294	3.15068	.44118
	PET Gr. Experimental	53	12.6819	3.67142	.50431
Writing	PET Gr. Control	51	2.9804	3.42631	.47978
	PET Gr. Experimental	53	4.2075	3.73321	.51280
Listening	PET Gr. Control	51	8.2549	3.45163	.48332
	PET Gr. Experimental	53	11.7170	4.04008	.55495
Speaking	PET Gr. Control	51	10.8578	4.50340	.63060
	PET Gr. Experimental	53	18.6557	4.56556	.62713
Total	PET Gr. Control	51	30.6225	9.29893	1.30211
	PET Gr. Experimental	53	47.2621	12.41994	1.70601

As seen from the Tab. 1 descriptive statistics parameters included:

- Arithmetic mean (central tendency calculation results)
- Standard Deviation (distribution of results from their average value) and
- Standard error mean.

The number of participants in testing for control group was 51 and for experimental

group were 53 students. Speaking about Reading skill as seen from the table the arithmetic mean shows that for control group was 8.52 and for experimental group it was 12.62. For Writing skill arithmetic mean for control group was 2.98 and 4.20 for experimental group. Listening - control group 8.25 and experimental group 11.71. Speaking - 10.85 for control group and 18.65 for experimental group.

Standard deviation did not differ significantly between the two groups as seen from the tab. 1. From 3.15 and 3.67 for Reading, 3.42 and 3.73 for Speaking to 3.45 and 4.04 for Listening and finally 4.50 and 4.56 for Speaking skill.

### Discussion and Conclusion

We came to a conclusion that there was a significant difference while comparing the performance of the two groups, control and experimental group, after conducting the experiment, where we implemented the CLT syllabus. The experimental group succeeded with 45.41% and control failed with only 28.51% in their performance. So, we can say that experimental group passed from A1 to A2 level after implementing the CLT syllabus.

Another statistical fact is that three skills which improved after applying the CLT Syllabus in experimental group were Speaking with the value of 18.65, Reading - 12.68 and Listening - 11.71, which was not the same success with Writing skill with a result of only 4.20.

Finally, we can conclude that CLT is a method that is highly successful in Listening, Reading and especially in Speaking as it is traditionally known but not in Writing as was seen from the statistical figure.

### References

- Vrasidas, C. & McIsaac, M., (2001). Integrating Technology in Teaching and Teacher Education: Implications for Policy and Curriculum Reform. *Education Media International* , 130-131.
- Diane, L. (2000). *“Techniques and Principles in language Teaching”*. Published by: Oxford University press 2000.
- Dörnyei, Z. (2009). The 2010s Communicative language teaching in the 21st century The ‘principled communicative approach’. *34th National Convention of TESOL* , 33- 42.
- Matrosov, V. L. (2011). *The New Schoolteacher for the New Russian School. Russian Education And Society*.
- Ministry of Education, S. a. (2011, August 29). <http://www.masht-gov.net>. Retrieved February 09, 2015, from <http://www.masht-gov.net/advCms/#id=1348>: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Korniza%20e%20Kurrikules11.pdf>
- Musai, B. (1999). *“Psikologji Edukimi ( Zhvillimi, të nxënit, mësimdhënia)”*. Tiranë.
- OECD. (2005). *“Teaching Matters ( attracting, developing and Retaining effective teachers)”*.
- Richards, J. C. (2006). *Communicative Language Teaching Today*. 32 Avenue of the Americas, New York,: © Cambridge University Press 2006.
- Savignon, S. J. (2006). Beyond communicative language teaching:What’s ahead? *Journal Of Pragmatics* , 207-220.

## **Konventa Evropiane e te Drejtave te Njeriut si faktor njesues nderkombetar i se drejtes private ndermjet shteteve. Gjykimet ne Gjykatën Evropiane te te Drejtave te Njeriut**

**Phd. Entela Abduli**

*Universiteti Europian i Tiranes  
Departamenti i se Drejtes Private*

### **Abstrakti**

Qellimi kryesor i se drejtes se krahasuar eshte pakesimi dhe eliminimi i dallimeve midis sistemeve kombetare per adoptimin e parimeve te perbashketa te se drejtes. Qellimi me i madh i kombeve sot eshte qe te zhduken kufijte dhe te hartohet nje e drejte uniforme, si nje traktat shumepalesh qe i detyron nenshkruesit e tij te zbatojne nje te drejte uniforme. Ky njesim i se drejtes e ben biznesin ligjor ndermjet shteteve me te lehte, duke shmangur rreziket e zbatimit te se drejtes se huaj ne rast mosmarreshjeje ndermjet praktikave tregetare te dy vendeve te ndryshme. Keshtu e drejta e krahasuar ben nje parashikim me te madh ligjor dhe sjell nje siguri me te madhe ndermjet shteteve, si dhe nje ndihmese per gjykatat ne rast zgjidhjeje mosmarreshjesh.

Qellimi i ketij punimi eshte pikerisht trajtimi i rolit qe luan Konventa Evropiane e te Drejtave te Njeriut si percaktimi i nje te drejte minimum per kufizimin e te drejtave te njeriut nga te gjitha shtetet anetare.

Ne baze te studimit te literatures dhe praktikës gjyqesore te Gjykares Evropiane te te Drejtave te Njeriut lind pyetja, a luan kjo Konvente rolin e njesuesit te se drejtes ndermjet shteteve anetare persa i perket te drejtave te njeriut, thjesht ne aspektin e afirmimit te ketyre te drejtave apo ben nje mbrojtje reale te tyre duke i detyruar shtetet perkatese shkelese te Konventes tu nenshtrohen sanksioneve perkatese te Gjykares Evropiane te te Drejtave te Njeriut.

**Fjala Kyce:** *Afirmim i se drejtes, garantim i minimumit te cenimit te lirive, parime te perbashketa, njesim i se drejtes.*

### **Konventa kufiri minimum i afirmimit dhe garantimit te drejtave dhe lirive te njeriut**

Per vete kohen ne te cilen u krijua si marreshje nderkombetare, ishte nje pergjigje direkte e luftes se dyte boterore dhe e holokaustit te kesaj lufte. Kishte ardhur momenti, qe te drejtat e njeriut jo vetem te afirmoheshin ne dokumenta te ndryshme, por ato te gjenin nje garanci ne zbatimin e tyre. Kjo fryme dhe ideologji gjeti nje mbrojtje nga filozofia e fitimtareve te luftes se dyte boterore te cilet menduan dhe per mjetet qe do te viheshin ne mbrojtje te ketyre te drejtave, qe ato te mos ngeleshin thjesht ne nje leter te firmosur me shume buje nga vendet anetare. Katalogu i mirefillte i te drejtave te njeriut u krijua nepermjet Deklarates Nderkombetare te te Drejtave te Njeriut 1948, nga ku mori shembull Konventa. Si garantor te kesaj konvente do te behej Komisioni Evropian i te Drejtave te Njeriut, dhe Gjykata Evropiane e te Drejtave te Njeriut. Te dy keto institucione i dhane jete Konventes.

Per kushtet historike, ekonomike dhe politike kur u krijua Konventa shqetesim kryesor ishte, qe te arrihej sa me shpejt marreshja midis shteteve anetare me qellim qe te nenshkruhej prej tyre. Per kete qellim u vendos kompromisi, qe keto te drejta te ishin sa me pak te kundershueshme dhe te mos vendosnin nje peshe te madhe ndaj shteteve anetare per ruajtjen e tyre, per kete arsye u perfshine te drejta sociale politike ekonomike,

qe konsideroheshin jetesore per mosperseritjen e veprimeve cnjerezore te ndodhura gjate luftes se dyte boterore. Te drejtat e tjera do te perfshiheshin ne Konvente nepermjet protokolleve te ndryshme.

Vecantia kryesore e dispozitave te konventes qendron ne faktin se, per here te pare u kapercye ideologjia, se mbrojtja e te drejtave te njeriut ishte shqetesim i brendshem i qeverive te ndryshme, te cilat merrnin karakter nderkombetar ne rast se cenonin interesat e nje shteti tjetër. Per here te pare u vendos kufiri i cenimit te se drejtave individuale nga vendet anetare. Shtetasi mund te kerkoje mbrojtje nga shkeljet, qe mund te behen nga vete shteti ne territorin e te cilit ndodhet. Konventa nuk lejon qe kufijte shtetor te sherbejne si kufij per mohimin e lirive, me arsyetimin se jane ceshtje te brendshme kombetare. Midis normave te percaktuara ne Konventen Evropiane te te Drejtave te Njeriut, nuk ekziston nje hierarki, cka do te thote qe nese kemi perplasje te drejtash, nuk mund te themi se, njera e drejte ka prioritet karshi tjetres.

Sidoqofte normat e Konventes mund te grupohen ne norma te pakontestueshme dhe te pakufizuara si e drejta e jetes, ndalimi i tortures dhe trajtimit cnjerezor, dhe te drejta te kontestueshme te limituara si e drejta e pronesise, e drejta e tubimit, e drejta e fese, liria e mendimit etj. Ne pergjithesi personi i cili pretendon se, i eshte shkelur nje e drejte duhet te provoj shkeljen e pretenduar, ndersa kur kemi nderhyrje nga shteti ne te drejtat e limituara eshte ai qe, duhet te provoj se, nje nderhyrje e tille eshte e justifikuar ne baze te legjislacionit te brendshem per interesin e pergjithshem publik.

Konventa eshte ratifikuar nga vendi yne me date 31 Korrik 1996, dhe qe nga ky moment ajo eshte nderthurur dhe eshte bere pjese integrale e legjislacionit te brendshem, madje ne te njejtin rang me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise. Per kete arsye dhe juridiksioni i Gjykates Evropiane te te Drejtave te Njeriut shtrihet dhe mbi territorin e shtetit Shqiptar.

### **Rregullimi qe ben Konventa per te Drejten Private**

Mbrojtja e prones eshte e parashikuar ne neni 1 protokolli numer 1 i Konventes.

*“Cdo person fizik apo juridik ka te drejte per respektimin e pasurise se tij. Askujt nuk mund ti hiqet prona e tij vecse per dobi publike dhe ne kushtet e parashikuara nga ligji, si dhe nga parimet e pergjithshme te se drejtes nderkombetare, Dispozitat e meparshme nuk cenojne, te drejten shtetorore qe te vene ne fuqi ligjet, qe ato i quajne te domosdoshme per te rregulluar perdorimin e te mirave ne pershtatje me interesin e pergjithshem, ose per te siguruar pagesen e taksave, te kontributeve te tjera ose te gjobave”.* Duke u nisur nga ky nen shikojme se mbrojtja e pronesise, si nje e drejte e lidhur ngushtesisht me njeriun gjen garanci dhe ne Konvente. Gjithashtu kjo e drejte eshte bere dhe pjese e se drejtes se brendshme Shqiptare, duke gjetur nje rregullim te vecante dhe duke u bere pjese e Kushtetutes Shqiptare, por ndryshe nga te drejtat themelote si e drejta per jete, ndalimi i tortures te cilat gjejne nje mbrojtje absolute ne konvente dhe jane te pakufizuara, e drejta e pronesise nuk eshte nje e drejte absolute e pakufizuar.

Sipas Marek Antoni Nowicki *“Rreth Konventes Evropiane te te Drejtave te njeriut”*, mbrojtja e pronesise ka hasur ne shume diskutime nese duhej futur ose jo ne katalogun e te drejtave te garantuara ne Konvente. Mosmarreshje te medha kishte shkaktuar problemi i demshperblimit ne rastin e cenimit ose heqjes se pronesise, nepermjet nacionalizimit, per keto arsye kjo e drejte nuk u perfshi ne te drejtat themelore te Konventes, por ne protokollin shtojce te saj qe u pranua ne 20 Mars te vitit 1952, para hyrjes ne fuqi te konventes.

Vete protokolli numer 1 tregon karakterin jo absolut dhe te pakufizuar te kesaj te drejte

, pjesa e pare garanton respektimin dhe mbrojtjen e se drejtes se pronesise. Fjalja e dyte tregon se mbrojtja dhe paprekshmeria nuk eshte absolute por brenda kushteve te percaktuara ligjore mund te behet kufizimi i kesaj te drejte ose marrja e pronesise. Pjesa e trete buron nga pjesa e dyte dhe ju le kopetence shteteve perkatese nepermjet rregullimeve ligjore, por jo ne menyre arbitrare rregullimin e shpronесimit per nje interes publik te pergjithshem.

Sipas te drejtes Shqiptare shpronесimi mund te behet me nje vendim te Keshillit te Ministrave, per nje interes publik si, ndertimi i shkollave, spitaleve, parqeve, rrjetit rrugor hekurudhor, inxhinjerit, elektrik, mbrojtjes kombetare, rendit publik etj. Ky shpronесim vjen gjithmone pas nje shperblimi te plote dhe paraprak qe percaktohet po me ligj. Pronesia e sendit te shpronесuar i kalon shtetit dhe pronarit i jepet vlера e plote e sendit e percaktuar ne leke sipas vleres se tregut ne ditën e ekzekutimit te vendimit te shpronесimit . Kompesimi mund te behet dhe ne natyre ne rastin e ndertimit te banesave me fonde shterore. Eshte pronari ne cdo rast ai qe zgjedh midis kompesimit ne natyre dhe atij ne te holla, pasi nuk mund te behet pa pelqimin e tij.

Gjithashtu legjislacioni shqiptar njej dhe rekuizimin si menyre ligjore e kufizimit te se drejtes se pronesise, si marrje ne perdorim te perkohshem e prones se pronarit pa vullnetin e tij per shkak te forces madhore per mbrojtje kombetare. Vendimi dhe ne kete rast merret nga Keshilli i Ministrave dhe me perfundimin e afatit sendi i kthehet pronarit sebashku me shperblimin e demit, qe mund te jete shkaktuar si rezultat i rekuizimit.

Kjo tregon dhe njehere se e drejta e pronesise, si e drejte e garantuar ne kushtetute nuk eshte ne te njejtin rang absolut dhe te pakufizuar si e drejta e jetes, por kjo nuk do te thote se, i lihet dore e lire dhe arbitraritet shteteve perkatese ne kufizimin e kesaj te drejte pasi konventa ka vendosur nepermjet nenit 1 te protokollit kufijte minimum te mbrojtjes dhe garantimit te kesaj te drejte. Shtetet anetare nuk mund ti shkelin keto kufij te vendosur nga Konventa. Vete karakteri i interesit te pergjithshem publik kerkon nje kufizim ligjor te se drejtes se pronesise, por gjithmone duke detyruar gjithë te tjeret qe ta respektojne kete te drejte. Rregullimi qe i behet pjeses se dyte dhe te trete te nenit 1 te protokollit 1 te konventes dhe procedura qe percakton secili shtet per kufizimin e se drejtes se pronesise per nje interes te pergjithshem publik eshte ne funksion te pjeses se pare te nenit 1, mbrojtjes dhe respektimit te se drejtes se pronesise, duke mos lene shteg per arbitraritet nga legjislacioni i vendeve perkatese, te cilat e kane bere kete konvent pjesë te se drejtes se tyre te brendshme. Nocioni interes publik u le autoriteteve nje hapesire ne vleresimin e nevojës per shpronесim, apo formave te ndryshme te kufizimit te pronesise, duke nderhyre ketu motivet e ndryshme politike, ekonomike dhe shoqerore ne nje shtet te caktuar demokratik. Pra vendimet ne lidhje me shpronесimet ndikohen shume nga situata e brendshme e nje vendi e cila ndryshon nga ajo e nje vendi tjetër, prandaj dhe rregullimi nuk eshte i njejte ne vende te ndryshme. Kete hapesire e ka lejuar dhe vete Konventa. Parimi i pergjithshem i percaktuar ne te drejten nderkombetare eshte parimi i demshperblimit, megjithate ka raste te rralla kur privimi i shtetasve nga e drejta e pronesise te perligjet pa demshperblim. Neni 1 i protokollit nuk e garanton hapur te drejten e demshperblimit ne cdo rast, por paraqet interesin publik si kusht i mjaftueshem per kufizimin e se drejtes se pronesise. Ky paragraf u jep mundesi shteteve qe te miratojne dispozita ligjore, qe i konsiderojne te domosdoshme per interesin e pergjithshem, megjithate jane normat e se drejtes nderkombetare te percaktuara ne pjesen e dyte te nenit 1 te protokollit te cilat kontrollojne ose kufizojne arbitraritetin e autoriteteve te brendshme te nje shteti. Shtetet vertete, qe gezojne nje autonomi dhe liri ne zgjedhien e mjeteve te nevojshme per interesin e pergjithshem publik, por ne cdo rast ato duhet ta justifikojne ne menyre te

arsyeshme kete nderhyrje. Nese pronesia kalon nga nje person tek nje tjetër ne menyre te perkohshme nuk kemi te bejme me shpronosim por vetem me nje kufizim qe kerkon nje rregullim te vecante.

Ne ceshtjen Lozidou kunder Turqise, sipas permledhjes se vendimeve te gjykates se te drejtave te njeriut, ankuesja pretendon se, eshte pronare e trojeve te lena ne pjesen Veriore te Qipros, pas luftes se vitit 1974. Dhe ne te vertete perderisa nuk ka dale nga ana e qeverise Turke ndonje vendim shpronosimi shtetasja ka te drejte. Ajo ka humbur kontrollin dhe mundesine e shfrytezimit te pronave te saj. Gjykata konstatoi se, ajo pavaresisht se, nuk ishte privuar nga prona, as nuk ishte rregulluar menyra e perfitimit prej saj, dhe kjo situatë perligj ne menyre absolute shpronosimin pa kundershperblim, pasi qeveria turke duhet te marre masa per zgjidhjen e kesaj situatë.

### **Gjykimet ne Gjykatën Evropiane te Drejtësisë**

Gjykata Evropiane e te Drejtave te Njeriut eshte nje mekanizem juridik nderkombetar, i krijuar si mjet per garantimin e zbatimit te Konventes Evropiane te te Drejtave te Njeriut, pasi ne ndryshim nga organizmat e tjera nderkombetare, per shkeljen e te drejtave te njeriut, dhe kur jane ezauruar te gjitha rruget e ankimit brenda vendit shtetasit i drejtohen Gjykates Evropiane te Drejtësisë. Pra Konventa nuk ngelet nje ideal per tu arritur nga te gjitha kombet per te miren e perbashket por ajo shkon me tutje duke siguruar dhe garantuar zbatueshmerine e detyrueshme te saj nepermjet dy instrumentave te saj, Komisionit Evropian te se Drejtave te Njeriut ne te cilin paraqiten ankesat dhe denoncimet e shteteve anetare, dhe te cdo personi tjetër ne rastin e shkeljes se Konventes Evropiane te te Drejtave te Njeriut. Ky komision ben shqyrtimin dhe selektimin paraprak te ceshtjeve perpara se ato ti kalojne Gjykates.

Ne baze te protokollit 11 te Konventes eshte mundesuar shkurtime i procedurave te mbrojtjes te te drejtave te njeriut, duke lene si mekanizem te vetem Gjykatën Evropiane te te Drejtave te Njeriut, si nje organ i perhershëm ne te cilin cdo shtet anetar perfaqesohet nga nje gjyqtar. Gjykata Evropiane e te Drejtave te Njeriut e zgjidh ceshtjen, te cilen ia ka drejtuar Komisioni dhe pasi konstaton shkeljen e Konventes percakton sanksionet perkatese per shkelesit.

Ne baze te nenit 35 te Konventes si kushte per pranimin e ankimit jane:

1. Shterimi i mjeteve te brendshme ligjore, pasi Gjykata mund ta shqyrtoj ceshtjen, pasi te jene ezauruar mjetet e rekursit te percaktuara ne baze te se drejtes se brendshme te vendit kunder te cilit eshte paraqitur ankesa. Para se te paraqitet ankesa i duhet dhene mundesi shtetit, qe te rregulloj vete shkeljen e supozuar ne dem te individit. Barra e proves ne kete rast u takon autoriteteve, qe te vertetojne se nuk jane konsumuar mjetet e rekursit te brendshem.

2. Afati i gjashte muajve. Gjykata mund ta shqyrtoj ceshtjen nese kane kaluar gjashte muaj nga data e marrjes se vendimit te vendit perkates forme te prere. Ky kusht lidhet me domosdoshmerine e shterimit te mjeteve te brendshme ligjore, si dhe per ti dhene mundesi ankuesit per kohen e mjaftueshme per pergatitjen e padise. Gjithashtu ankesa nuk mund te jete anonime pasi kjo perben kusht per papranueshmerine e saj. Ankesa permban gjithë te dhenat dhe identifikimin e autorit. Vendimi i Gjykates eshte i formes se prere dhe i detyrueshem per palet. Konventa i kushton me shume rendesi mbrojtjes te te drejtave dhe lirive themelore, sesa thjesht afirmimit te tyre.

Kjo konvente luan nje rol te rendesishem, dhe eshte shume aktuale pasi eshte pasuruar dhe plotesuar nepermjet protokolleve te ndryshme, qe jane miratuar ne kohe te ndryshme. Ne

Gjykate kryesisht nuk goditen normat apstrakte por si rregull goditen menytrat e zbatimit te ligjeve dhe te akteve te tjera te caktuara ne vend. Goditen veprimet e shtetit, vendimet e gjykatave per ceshtje te caktuara, si dhe nese keto veprime vijne ne kundershtim me normat e Konventes. Megjithate ne raste te rralla mund te jene goditur dhe akte te ndryshme si vendimi qe godiste ligjin kunder homoseksualeve, dhe vendimi kunder ligjit per pergjimin e telefonave. Gjithashtu Gjykata mund te kerkoj dhe pezullimin e ekzekutimit te nje vendimi kunder te cilit eshte bere kerkese ne Gjykate, ne ato raste kur rrezikohet seriozisht jeta e personit qe ankohet, si rasti i vendimeve per debim dhe ekstradim. Si dukuri te vendit tone mund te permendim mosekzekutimin e vendimeve te formes se prere me pale shtetin per shkaqe te pajustificuara, per vendime qe kane te bejne me kthim shumash, te cilat rrjedhin nga mardheniet e punes. Keto raste Gjykata i ka vleresuar si shkelje te parimeve themelore per nje process te rregullt ligjor, neni 6 i Konventes.

Gjykata Evropiane e te Drejtave te Njeriut nuk eshte ne rolin e Gjykates se Larte ne sistemin gjyqesor te vendeve anetare te Konventes, dhe nuk luan rolin e interpretuesit te se drejtes se brendshme te vendeve anetare. Megjithate Gjykata luan rolin e interpretuesit te Konventes, kur ne lidhje me te ka vendime te gjykatave te brendshme te cilat mund te jene te ndryshme, ne arsyetime dhe perfundime. Nga pikpamja e te drejtave te njeriut Gjykata luan rolin e Gjykates me te Larte, megjithate roli i saj eshte konstatues, ajo nuk mund te shfuqizoj nje norme te brendshme thjesht se e konstaton ne kundershtim me Konventen. I takon ne vijim shtetit pergjegjes, qe te marre masat e duhura, per shmangien e kesaj mosperputhjeje. Megjithate realisht eshte thuaje e pamundur per shtetet anetare, qe e kane ratifikuar dhe e kane bere pjese te se drejtes se brendshme kete konvente, qe te kete papajtuesmeri midis legjislacionit te brendshem dhe atij te Konventes, pasi ajo eshte standarti minimal nen te cilin shtetet pale nuk mund te zbresin. Shtetet anetare mund te respektojne ne menyre me te plote te drejtat dhe lirite themelote te njeriut ne baze te akteve te ndryshme normative te nxjerra per kete qellim. Per respektimin e Konventes mjafton qe dispozitat e brendshme te mos cojne ne nje gjendje me te pafavorshme, se ajo qe percakton Konventa

Praktika gjyqesore e Gjykates Europiane te te Drejtave te Njeriut ka shqyrtuar nje numer te madh ceshtjesh qe kane te bejne me shkeljen e te drejtave dhe lirive themelore te njeriut, ne shtete te ndryshme, te pasqyruara ne permbledhesen "Per nje rend publik Evropian", vellimi 1 i Vendimeve te zgjedhura te Gjykates Evropiane".

Lauko Kunder Sllovakise Vendimi 02.09.1998:

Ne Qershor te vitit 1992 Ivan Lauko ne perputhje me ndryshimet e reja ne legjislacion kerkoi qe ti shitej apartamenti i tij, qe ndodhej ne nje bllok apartamentesh ne Sllovaki. Me pas fqinjete e tij e shqetesoi me sjellje zhurmuese dhe demtim te dritareve dhe te kutise postare. Pas ankeses qe beri ne polici mori pergjigje se, faktet per te cilat ai ankohej nuk qendronin, dhe hetimi per kallezimin e tij u mbyll, gjithashtu zyra lokale konstatoi se, kerkuesi kishte kryer nje kundravajtje penale, pasi pa asnje shkak kishte, akuzuar familjen B per shkaktimin e shqetesimeve, duke e gjobitur me 300 korona Sllovake. Pasi ezauroi rruget e ankimit te vendimit te zyres lokale, ne zyren rajonale me 16 Gusht te 1994 ky shtetas paraqiti ankim ne Gjykatën Kushtetuese me arsyetimin se ndaj tij ishte shkelur neni 6 i konventes, sepse nuk ishte zhvilluar proces gjyqesor i drejte dhe i hapur, dhe organet administrative qe shqyrtuan rastin e tij nuk kishin qene te paanshme, por Gjykata Kushtetuese e rrezoi kerkesen e tij, si dhe nuk pranoi kerkesen per rishikim te vendimit te meparshem. Kerkesa e paraqitur ne komision u pranua pjeserisht, dhe komisioni pasi nuk

e realizoi dot zgjidhjen me pajtim konkludoi se, ishte shkelur neni 6 i konventes, paragrafi 1, dhe ceshtja iu kalua Gjykates Evropiane te te Drejtave te Njeriut. Gjykata arsyeton se, e drejta e secilit per nje gjykim te rregullt dhe te paanshem nga nje gjykate e paanshme eshte nje element kryesor i demokracise. Ne rastin konkret organet qe kane shqyrtuar ceshtjen kontrolloheshin nga qeveria dhe nuk kane qene te pavarura. Gjykata ve ne dukje se zyrtar lokal dhe rajonale jane te ngarkuara me kryerjen e detyrave shteterore administrative nen kontrollin e organeve te qeverisjes qendrore. Emerimi i ketyre punonjesve kontrollohet nga Ekzekutivi, duke mos pasur garanci kunder presioneve te jashtme. Meqenese vendimet e zyrtare lokale dhe atyre rajonale nuk mund te rishikoheshin nga orgnet gjyqesore nepermjet nje gjykimi te drejte dhe te paanshem detyrimisht eshte shkelur neni 6 i Konventes. Per keto arsye Gjykata vendosi se, eshte shkelur neni 6 i konventes dhe se, shteti duhet ti paguaj brenda tre muajve 5000 korona Sllovaqe persa i perket demit jomaterial, dhe 1000 korona Sllovaqe persa i perket kostove dhe shpenzimeve.

### Konkluzione

Shekulli i 20 mund te perkufizohet si shekulli, qe ka qene deshmitar i dhunimeve me te medha te te drejtave te njeriut, gjithashtu eshte dhe shekulli ku te drejtat e njeriut u njohen dhe u afirmuan si vlera te perbashketa te njerezimit, te lidhura ngushtesisht me ekzistencen e njerezimit dhe shoqerive demokratike. Fokusi kryesor i mbrojtjes dhe garantimit te te drejtave ka qene shteti, pasi shteti ka qene dhe dhunuesi me i madh i te drejtave dhe lirive themelore te njeriut, ai eshte sovran i forces se justifikuar.

Konventa Evropiane e te Drejtave te Njeriut mbetet pika e referimit ne sistemin e mbrojtjes se te drejtave te njeriut ne Evrope, dhe jo vetem ne sferen e te drejtave por dhe ne ate te kontrollit gjyqesor nderkombetar te zbatimit te tyre. Aderimi i Bashkimit Evropian ne KEDNJ eshte menyra me efikase per ruajtjen e harmonise te sistemit europian te mbrojtjes te se Drejtave te Njeriut.

### BIBLIOGRAFIA

#### Literatura

1. Anastasi, A. (2000) "E drejta kushtetuese". cikel leksionesh. Tirane.
2. Zajmi, I. (2003) "E Drejta Europiane". Cikel leksionesh. Tirane.
3. Nowicki, Marek Antoni. (2003) "Rreth Konventes Evropiane". Tirane.
4. "Per nje rend publik Evropian". (2001). Vellimi 1 i vendimeve te zgjedhura te Gjykates evropiane te te drejtave te njeriut. Tirane.
5. Dollani.N. "E Drejta e Krahasuar e Kontratave". punim leksionesh.
6. Fromont,M. (2009) "Sistemet e Huaja me te Medha te se Drejtes". Tirane: Papirus.
7. Galgano, F. (1999) "E Drejta Private" botimi i pare. Tirane: Luarasi.
8. Zwergert & H.Kotz "Njohuri per te Drejten e Krahasuar", parimet themelore.

#### 2. Burime Paresore

9. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise e vitit 1998.
10. Konventa Europiane e te Drejtave te Njeriut.
11. Kodi i Republikes se Shqiperise me praktike gjyqesore i vitit 1994. Tirane: Luarasi, (2003).



## Assessing impact of life changes in early 1990 Albania

Arbjola Halimi

“Aleksander Xhuvani” University

### Abstract

Many changes that occurred in early 1990, in contrast with other countries, had few attentions from psychology research in Albania. Many of them focus on transition without asking from the very beginning of it. The article is an attempt to identify some issues related to that from the psychological perspective. It is assumed that rapidly<sup>1</sup> life and social changes tend to create some psychological effects like stress, insecurity and because of the typical case (from communism to democracy) some other psychological changes in all age groups. Principal data are collected from narratives from individuals in different ages in order to compare data before and after the fall<sup>2</sup> and the fall itself on the psychological well being. Content analyses it is used for data interpretation and discussion. Some of the evidence has shown that the psychological effect of social changes where strongly related with the degree and the nature of life changing experiences, living place, education, and the age of the persons. Although they describe more negative experiences and the corresponding effects on emotional state, all group ages reflect satisfaction with their lives after the changes from analyses they do now for their lives. Suggestions can be made about people psycho education to enable them knowing the real effect of a life and social change on their wellbeing.

**Key words:** *Change, Impact, Psychological Well-Being, Communism, Democracy.*

### Hyrje

Teoritë e tranzicionit<sup>3</sup> sugjerojnë se tranzicioni është shkaku kryesor i distresit që kërcënon jetën personale dhe mirëqenien psikologjike të individit. Sipas kësaj teorie, gjatë jetës së individit ai i mbijeton shumë ndryshimeve jetësore në nivelin personal dhe social të cilat mund t'i shkaktojnë gëzim por edhe nivel të lartë distresi prej impaktit që kanë mbi jetën e tij dhe proceseve të tij të brendshme. Kjo nënkupton që tranzicioni personal dhe ai social<sup>4</sup> ecin bashkarisht dhe ndikojnë njësoj në mirëqenien psikologjike e emocionale të individit. Sigurisht që fazat e ndryshme të tranzicionit jetësor ndryshojnë në nivelin e ndikimit të distresit në varësi të burimit të tyre (ekonomik, kujdesi shëndetësor, siguria emocionale, etj) dhe strategjitë bashkëpunuese (perceptimi i rrezikut etj). Ky tranzicion kalon në një rreth vicioz nga ngjarjet pozitive dhe negative, por dihet mirë<sup>5</sup> që nëse ngjarjet janë negative dhe nëse kombinohen me faktorë social negativë të tilla si niveli i ulët ekonomik, edukativ, social dhe shëndetësor, sigurisht që kërcënohet dukshëm mirëqenia e individit.

<sup>1</sup>Changes happening during the period where rapid and multiplied

<sup>2</sup>Fall of communism

<sup>3</sup>Shiko referencat në fund

<sup>4</sup>Në referim të paradigmes ekologjike të Urie Bronfenbrenner

<sup>5</sup>Shumë studime mbështesin këtë me gjetje dhe teori (kontrolli mjedisor sipas Carol D. Ryff si tregues i mirqënies, teoritë e sistemeve zhvillimore, stresit mjedisor, etj)

## 40 vjeç. Mashkull. Martuar. 18 vjeç në 1990.

### *Narrativa*

Vitet 89-90 kanë qenë vite të vështira. Në moshën 18 vjeçare u nisa për të kryer shërbimin ushtarak në veri të vendit. Muajt nëntor-dhjetor që fillova ushtrinë në këtë pjesë të vendit ishte shumë e rëndë për një adoleshent myzeqar sepse nuk isha mësuar me klimë shumë të ftohtë dhe detyrat e përgjegjësitë e mëdha për ruajtjen e kufirit. Pas hapjes së ambasadave dhe në kufi filluan të ndihen trazirat e para. Na vinin qytetarë të ndryshëm për të kaluar kufirin. Unë si komandant truproje pasi kisha marrë vesh nga televizionet jugosllave për lëvizjet e para në Shqipëri dhashë shembullin e parë që t'i nxirrja këta qytetarë jashtë kufirit. Midis tyre kishte edhe familjarë me gjithë fëmijë. Unë si person nuk e mora dot guximin të kaloja kufirin sepse nuk më linte ndërgjegjja nga detyra që kisha. Pasi mbarova aktin ushtarak u ktheva në Lushnje. Edhe këtu kishin filluar lëvizjet demokratike. Shpërndaheshin gazeta e tesera të partisë demokratike, po dëgjoni nga mediat e atëhershme rënien e bustit të diktatorit Enver Hoxha dhe marrjen fund të atij sistemi.

Edhe ne si të rinj filluam të emigronim për në Greqi. Nuk i harrojmë kurrë ato vite 91-92, (kuptohet për në Greqi). Bashkoheshim, bëheshim një grup goxha i madh që ishin pothuajse nga të gjitha krahinat e vendit, njerëz shumë të vuajtur, të veshur keq, me triko pambuku, me thasë të vendosur në kurriz i cili, ushqimi, llogaritej për shtatë ditë rresht. Pas shumë shkeljesh të kufirit, ilegale në të shumtat e rasteve kapeshim nga ushtarët grekë të cilët na trajtonin barbarisht. Pasi punova për ca kohë në Greqi mbloodha disa të ardhura dhe erdha të investoja në firmat që ishin ngritur asaj kohe në Shqipëri (fondacione). Ishin "Populli" dhe "Xha Ferri" të cilat pas njëfarë kohe ato falimentuan dhe na ngelën lekët brenda. Për mua që një disfatë e madhe se kishim krijuar dhe familje, kishim një djalë të mrekullueshëm. Pas firmave përjetuam një gjendje më të keqe nga të parat në 1997 për arsye se u hapën depot e armëve dhe armët bien në duart e popullit dhe plasi një trazirë e madhe, dhe njerëzit s'po emigronin më po ruanin familjet. Patrullonim nëpër rrugët e lagjes me kallash në dorë pasi çdo organ i shtetit doli jashtë funksionit. Pas pak filluan të stabilizoheshin gjërat. Populli filloi të vetëpunësohesh. Ashtu edhe ne hapëm një biznes të vogël i cili ne na ndihmoi pas kaq vitesh të ndërtonim një shtëpi, të blenim edhe një makinë. Në vitin 2008 e deri tani ne po hasim vështirësi të mëdha nga kriza botërore, rënia e biznesit, taksat e makinës, tatimet e biznesit, rritja e ushqimeve, rritja e naftës, etj. Shpresoj që në të ardhmen të bëhet më mirë për mua dhe familjen time.

Zhvillimet pas '90. Patjetër që jeta ime ka patur uljet dhe ngritjet e saj por duke u krahasuar me vitet e mëparshme u bë më mirë. Po njoh persona të tjerë. Shumica e të afërmve kanë emigruar jashtë vendit që në vitet e para të demokracisë të cilët janë të kënaqur me të ardhurat e tyre. Disa prej tyre kanë ardhur për të investuar.

Nga pikëpamja profesionale periudha më e vështirë 2009-2013 rënie në biznes, rënie ekonomike,

shoqërore 1997: -nuk mund t'i besohej asnjërit për shkak të luftës civile, personale 2000 sepse njëri nga prindërit e mi u largua nga jeta dhe kjo shkaktoi mjaft trazira të pakëndshme në familje.

### **Analizë e rastit**

Përshkrimi fillon me momentin ku gjendet subjekti në kohën e trazirave, roli dhe pergjegjësitë e tij në këtë kohë, zhvillimet e së cilës ai i citon 'trazira', 'vite të vëshira'. Ai e quan një shembull 'dhashë shembullin e parë' rolin e tij në dhënien e ndihmës ndaj qytetarëve për të kaluar kufirin, ç'ka mund të nënkuptojë perceptimin pozitiv të tij ndaj këtyre ndryshimeve. Në vazhdim përmenden fraza: Unë si person nuk e mora dot guximin të kaloja kufirin, ndërgjegja nga detyra, mbarova aktin ushtarak, edhe ne si të rinj filluam të emigronim për në Greqi. Nuk i harrojmë kurrë ato vite '91-'92. Bashkoheshim, bëheshim një grup goxha i madh që ishin pothuajse nga të gjitha krahinat e vendit, njerëz shumë të vuajtur, të veshur keq, me triko pambuku, me thasë të vendosur në kurriz, ushqimi, llogaritej për shtatë ditë rresht. Pas shumë shkëlqesh të kufirit, ilegale në të shumtat e rasteve kapeshim nga ushtarët grekë të cilët na trajtonin barbarisht. Edhe pse dukej si një shkëputje, ndërprerje nga gjithçka, gjen vend këtu një analizë e përmendur edhe nga H. Beqja<sup>6</sup> se veçoritë individuale dhe psikologjike ndryshojnë ngadalë dhe jo domosdoshmërisht ecin paralel me ndryshimet sociale, qofshin këto edhe të mëdha. Konkretisht, shprehjet 'nuk e mora dot guximin të kaloja kufirin', 'ndërgjegja nga detyra', 'mbarova aktin ushtarak', duken si një e dhënë e vazhdimësisë së veçorive individuale të induktuara më parë, të lidhura, në rastin konkret me ndjesinë e pergjegjësisë ndaj detyrës.

Përjetimet në lidhje me kushtet e emigrimit, veçori tipike e kohës, edhe pse të rënda dhe dhunuese, përmenden shkurtimisht në narrativë, duke bërë një përshkrim më të zgjeruar për jetën shumë vite më pas. Është e vështirë të përcaktosh nëse ky përshkrim i shkurtër i impaktit të atyre viteve në jetën e tij është pasojë memorizuese apo lidhet me vështirësitë më të mëdha pas këtyre viteve (përmenden termi 'disfatë e madhe' në lidhje me humbjen e parave dhe një e keqe më e madhe se kjo në lidhje me ngjarjet e vitit 1997 si një kërcënim shumë më serioz i sigurisë në jetë sesa humbja e kapitalit financiar të vënë me mundim). Disa ngjarje përgjithësohen, çka le të nënkuptosh se mund të kenë qenë të përhapura 'populli filloi të vetëpunësohej', 'ashtu edhe ne hapëm një biznes të vogël', 'na ndihmoi shumë' të cilat janë tërësisht të kundërta me qasjet jetësore të para viteve '90, ku iniciativa e lirë atrofizohej. Zhvillimet e pas '90 konsiderohen përgjithësisht positive dhe nëse kemi parasysh se këto zhvillime mund të trajtohen edhe si ecuri jetësore, del se perceptimi i tij mbi ecurinë e jetës është kryesisht pozitiv. Megjithatë, disa përvoja të pakëndshme gjatë kësaj ecurie gjenden të lidhura ngushtë me cilësinë e marrëdhënieve ndërpersonale të kërcënuara, që i gjejmë në shprehjen 'njëri nga prindërit e mi u largua nga jeta dhe kjo shkaktoi mjaft trazira të pakëndshme në familje'.

### **38 vjeç. Femër. VI. Lushnje. Vb. Lushnje. Martuar. Vetëpunësuar. Fëmijë 2. 16 vjeç në 1990.**

#### *Narrativa*

Për periudhën 1990-1995. Viti 1990 më gjeti në shkollë të mesme. Ishin vite shumë të bukura me një shoqëri shumë të singertë. Vite që nuk i harroj kurrë. Gjithçka ndryshe jo si sot. Në 1993 u fejova. Çast i lumtur i jetës sime pasi gjeta njeriun e duhur. Në 1994 u

<sup>6</sup>H. Beqja "Tranzicioni demokratik në Shqipëri dhe psikologjia e shqiptarëve të sotëm"

martova dhe 1995 linda djalin e parë. Kjo periudhë ishte shumë e mirë dhe e paharruar për mua.

1996-2000. Gjatë kësaj periudhe isha pak e stresuar pasi ishin trazirat e 1997. Burri im ishte polic. Isha shumë e frikësuar pasi armët ishin nëpër duar. Në familje gjithshçka ishte shumë mirë. Bënim një jetë normale. Merreshim me punët e shtëpisë, shkonim tek fqinjët për të pirë ndonjë kafe dhe ato vinin tek ne. Nuk e ndjenim atë vetminë në familje. Ishim shumë të qetë nga një anë. Nga ana tjetër ndjeheshim keq kur dëgjonim kronikat e zeza me lajme. 2001-2006. Linda fëmijën tim të dytë dhe ky ishte një çast gëzimi. Nuk kisha asnjë vështirësi në rritjen e fëmijëve të mi pasi nga ana ekonomike nuk kemi qenë keq.

Bënim një jetë normale si në veshje, ushqim dhe argëtim. Një çast shumë i bukur i familjes sime edhe martesë e kumatës. Në 2004 surprizë e madhe për mua: takova pas dhjetë vjetësh shoqen që erdhi nga Amerika. Komunikonim me telefona por ishte gjithçka ndryshe ballë për ballë. Kujtonim me respekt mësuesit. Kjo periudhë ishte një periudhë e bukur, pa strese. 2007-2012. Në 2007 përjetuam një çast hidhërimi. U nda nga jeta gjyshja jonë. Ishte një nënë shumë e mirë. Kujdesej për fëmijët e mi me gjithë shpirt. I donte por edhe ata i rrinin pranë. Gjatë këtyre viteve filluam të organizonim festa me shoqet tona. Dilnim në çdo qytet çdo vit. Ana shoqërore u lidh më shumë. Shkojmë te njëra tjetra pasditeve kur kemi kohë të lirë. Jam lidhur edhe me shoqërinë e viteve '90 pasi mirëqënia është rritur shumë. Komunikojmë me internet. Ana ekonomike është normale. Fëmijët studiojnë. Me mësim janë shumë mirë. Kanë krijuar shoqërinë e tyre gjë që mua më pëlqen shumë. Festojmë ditëlindjet e fëmijëve. Pra sa vjen dhe çdo gjë rregullohet. Kjo periudhë ka qenë e mirë dhe e qetë. Zhvillimet pas '90 kanë qenë të mira.

### *Analiza e rastit*

Edhe në këtë rast gjejmë të përmendur shprehjen 'nuk i harroj kurrë ato vite' çka le të nënkuptosh se impresioni ndaj tyre është i madh, por e vështirë të kuptohet edhe në këtë rast nëse rëndësia me të cilën vishen ato lidhen me moshën (rinisë së hershme) apo ngjarjet e theksuara politike-sociale të ndodhura që ndikuan këtë brez. Shprehje si: -Nuk e ndjenim atë vetminë në familje. -Ishim shumë të qetë nga një anë. Nga ana tjetër ndjeheshim keq kur dëgjonim kronikat e zeza me lajme' nxjerr në pah dikotominë apo ambivalencën në përjetime dhe përvoja jetësore. Zhvillimet pas '90 cilësohen 'të mira' edhe në këtë rast me ngjarje jetësore të zakonshme të përjetuara relativisht mirë dhe ku del në pah kënaqësia në rritjen e fëmijëve dhe sukseset e tyre. Veçori e rastit është fokusimi në zhvillimet teknologjike dhe zhvillime të tjera pozitive. Po të marrim parasysh se subjekti e fillon përshkrimin duke theksuar marrëdhëniet shoqërore dhe ndërpersonale, të cilat, në mënyrë krahasuese diferencohen si më pozitive në ato vite sesa në ecurinë më mbrapa.

### **55 vjeç. Mashkull. Skrapar, Berat. Martuar. Drejtues teknik firmë private. 33 vjeç në 1990. Fëmijë 2**

#### *Narrativa*

Kam lindur në Skrapar në vitin 1957. Mbasi kreu shkollën 8 vjeçare ika për studime në shkollën e mesme ushtarake "Skenderbej". Më shumë në fillim isha i mërzitur sepse pak isha

mësuar të largohesha nga familja por me kalimin e kohës u mësova dhe krijova shoqërinë time të cilën e ruajmë edhe sot që jam në moshën 53 vjeçare. Në këtë kohë kishim një kujdes të veçantë nga ana e shtetit si për kërkesat e shkollës, mësimit, ushqimit. Gjatë kësaj kohe në u kalitëm me vështirësitë e jetës duke u edukuar me disiplinë dhe korrektësi. Mbase mbarova shkollën e mesme vazhdova akademinë ushtarake dhe u mësua e edukua të cilat ato virtyte i ruajmë edhe sot e kësaj dite. Në vitin 1981 u sistemova oficer. Krijova familjen, ku nusen e mora me arsim të lartë. Nuk kisha asnjë stress në punë dhe shtëpi. Lindur dhe edukuar 2 djem të cilët i arsimova me arsim të lartë në degën informatikë dhe financë në Universitetin e Tiranës dhe të Elbasanit. Ndryshimet demokratike në viti 1991 që i përkrahëm por gjendja jonë ekonomike ishte e vështirë nga viti 1990 deri 1997 mbase bashkëshortja ime ishte pa punë dhe unë në vitin 1996 u largova nga puna.

Në vitin 1997 u shqetësua shumë nga ngjarjet që ndodhën atë vit të mbrapshtë. Në vitin 1997 bashkëshortja ime u arsimua në Universitetin e Elbasanit. Gjatë periudhës 2000-2005 u stabilizua gjendja ekonomike. Bashkëshortja vazhdon të punojë në arsim dhe unë pranë një firme policie private. Nga viti 2007 vazhdojnë të jenë në punë (arsim) dy djemtë e mi të cilët janë të punësuar. Gjendja shpirtërore e jona është jo e mirë për arsye se jeta ka problemet e saj.

Viti më vështirë 1996 kur u lirova nga puna dhe ku ishte pa punë edhe bashkëshortja. Nga pikëpamja personale 1996 e në vazhdim.

### ***Analiza e rastit***

Ndryshimet jetësore të subjektit përshkruhen qartë. Ai jep një përshkrim të largimit nga shtëpia për arsye të arsimimit. Në lidhje me arsimimin dhe kujdesin ai ia atribuon kujdesit të shtetit të asaj kohe. Ndërsa në lidhje me vitet 1991-1997 ai i cilëson si 'gjendja ekonomike e vështirë' si pasojë të daljes nga puna e bashkëshortes. Edhe kjo një tjetër situatë stresuese e tranzicionit.

Subjekti e fillon përshkrimin duke cituar arritjet dhe cilësinë e marrëdhënieve shoqërore pozitive sipas tij. Ai thekson virtyte të fituara gjatë shkollimit, të cilat për të janë të rëndësishme dhe të qëndrueshme të tilla si disiplina, korrektësia. Përmendja e këtyre virtyteve mund të lidhet me profesionin e subjektit, por në mënyrë metakomunikuese mund të kuptohet edhe si një mesazh krahasues midis kësaj periudhe shoqërore, cilësive individuale që fitonte njeriu në raport me shoqërinë dhe perceptimit të tij mbi njeriun e sotëm. Përmendet shprehja 'Nuk kisha asnjë stres në punë dhe në shtëpi'. Këtu mund të analizojmë se këto mund të kenë filluar më pas në jetën e tij dhe se tranzicionet e deriatëhershme në jetë kanë qenë kryesisht të suksesshme (pa stres) dhe më pas ato të mëvonshme me stres. Ky mund të ketë qenë edhe impakti kryesor i ndryshimeve në cilësinë e tij të jetës. Nuk duhet lenë pa përmendur se tek subjekti në fjalë ndryshimet rrënjësore shoqërore të ndodhura e gjejnë atë në një periudhë të stabilizuar jetësore duke i kërcënuar atij disa nga këto qëndrueshmëri, veçanërisht në periudhën e viteve 1990-1997.

-Gjendja shpirtërore e jona është jo e mirë për arsye se jeta ka problemet e saj.

### **Konkluzione dhe Diskutime**

Ajo që vihet re më qartë në këto tre përshkrime, edhe pse duhet theksuar se nuk janë të mjaftueshme për të bërë përgjithësime, është fakti se impakti i ndryshimeve të

ndodhura pas vitit 1990 mund të ketë pasur konotacion negativ tek grupmosha kryesisht të stabilizuara në periudhën përkatëse në lidhje me disa prej tranzicioneve jetësore si: puna, familja, marrëdhëniet shoqërore, arritjet, etj. Ndërkohë në grupmosha më të reja ky impakt është i ndryshëm. Vështirësitë në zgjidhjen e tranzicioneve jetësore tek kjo grupmoshë janë aktuale dhe të zgjidhura relativisht mirë. Pavarësisht problemeve në zgjidhjen e tranzicioneve jetësore nuk është e qartë nëse pas ndryshimeve politike-sociale të ndodhura gjendja shpirtërore, të ndjerit, të menduarit e të përjetuarit e njeriut është përmirësuar apo përkeqësuar në grupmosha të ngjashme dhe të ndryshme.

### Referencat

1. Bronfenbrenner U. (1979) *The Ecology of Human Development, experiment by nature and design*. Harvard University Press, fq 3-349.
2. Beqja H. (2000) "Tranzicioni demokratik në Shqipëri dhe psikologjia e shqiptarëve të sotëm", Tirane.
3. Dai, Williams (1999). *British Psychological Society Occupational Psychology Conference*, January.
4. Manning P., K., Cullum-Swan, B., (1994). Narrative, content and semiotic analysis. In Denylin, N., K., Lincoln, Z., S. *Handbook of qualitative research*. Sage publication, London, fq 463.
5. *Evolutionary developmental psychopathology*, fq 18, 820.
6. www.business.com John Fisher personal transition curve and personal change, Tenth International Personal Construct Congress, Berlin, 1999, revised 2012 Leicester University, England.

## Moderniteti në “Dy drama “ të autorit Ragip Sylaj. Drama “ Dëbim nga Parajsa”.

Msc. Kujtim Bytyci

### Abstrakt

Autori Ragip Sylaj vjen para lexuesit në një mënyrë të re paraqitjeje. i ndryshëm si në gjininë poetike, po ashtu dhe në gjininë e dramës që përpiket të eksperimentojë. Autori nuk është i panjohur për lexuesin shqiptarë , autori është përfaqësuar në antologji në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. E megjithatë, popullariteti i një shkrimtari ka magjinë e surprizës, që në momentin që shfaqet e bën për vete lexuesin me “ surprizat” e këndshme që i servir . Poezia është gjinia më e lëvruar e këtij autori, por nuk ngelet pas dhe në prozë, ese, kritikë letrare, dhe dramë.

Kalimi nga njëra gjini në tjetrën, sigurisht që ka pjesën e vet të vështirësisë, duke sjellë një “përshtatje” të krijuesit. Përveç përshtatjes, është dhe gjetja e vetvetes. Gjetja e vetvetes është dhe orientimi drejtë asaj lloj drame , që përshtatet më së shumti me prirjet dhe shijet estetike të krijuesit. Sylaj në eksperimentimin e tij drejtë dramës ka një orientim mëse të qartë, drejtë dramës moderne, por që pika e referimit është lexuesi ( spektatori). Moderniteti i Ragip Sylaj në dramë , nuk qëndron vetëm në faktin e kreativitetit të prezantimit të dramave në modelin e antidramave, të heronjve si antiheronj, por edhe në organizimin e tekstit të dramave. “ Dy dramat” e tij kanë komoditetin që të lexohen edhe si një material letrar, por edhe si tekste të mirëfillta dramatike, por që në këtë të fundit, komoditeti shndërohet në një dhimbje koke për çdo regjizor që do të kërkojë të vejë në skenë këto drama. “ Kokëdhimbja “ vjen për faktin që regjizori duhet që këtë material letrar bruto ta shndrojë në një shfaqje tetrale që kërkon mjeshtëri regjizoriale dhe aktoriale.

Moderniteti në dramat e shkrimtarit Ragip Sylaj zbulohet tek “plateja” e absurdit në të cilën lëvizin heronj-antiheronj, dhe drama-antidramë. Lënda mbi të cilën ngrihet drama, është lënda biblike. Megjithëse kjo është lënda bazë, autori ka mundur që ti shpëtojë “kurthit “ për ta trajtuar lëndën bazë në kufijtë e religjionit. Ai ka mundur që fabulën biblike ta vejë në shërbim të lëndës dramatike, ku religjioni shndërrohet në absurd, dhe ekzistencializëm.

Historia e letërsisë botërore njeh mjaftë raste të orientimit të shkrimtarëve ndaj subjekteve biblike, duke krijuar vepra letrare të cilat në sajë të fuqisë së penës së tyre I kanë qëndruar kohës. Historishkrimi letrar zë fill që në periudhën e Rilindjes Europiane, me autorë të tillë si Ligieri, Bokaçio, listë e cila vazhdon dhe në periudhat e mëvonshme letrare, me Dostojevskin, Bodler, Kamy, Prust etj. Secili në gjykimin dhe këndvështrimin e tyre ka trajtuar artistikisht subjektet biblike, duke na sjellë vepra letrare me modele krijuese, simbole botën e përtejme (feri, parajsa, purgatori). F. Kafka në veprën e tij “Proçesi” na sjell gjykimin për Mëkatën e Madh, të trajtuar artistikisht. Bibla është quajtur ndryshe dhe “Libri I librave”.

Studiuesi amerikan Notrop Fraji për ndikimin që ka pasur dhe vazhdon të ketë Bibla në letërsinë perëndimore shprehet se: “Në kulturën tonë( perëndimore) , libri i shenjtë është Bibla, e cila mbase është libri i shenjtë i ndërtuar më sistematikisht në botë. Asnjë libër nuk ka ndikim të vet në letërsi, pa pasur vetë cilësi letrare, kurse Bibla është vepër e letërsisë,

*përderisa ajo studiohet nga kritika letrare*”. Trajtimi i subjekteve biblike në letërsinë shqiptare zë fill me përpjekjet e kishtarëve shqiptarë për të rizgjuar gjuhën e bukur shqipe. Me shkrimin e parë shqip, “Formula e Pagëzimit” të Pal Engjëllit, është orientimi i parë i letërsisë shqiptare drejtë subjekteve biblike. Kjo traditë orientimi vazhdon më tej, dhe me krijues të tjerë kishtarë ose jokishtarë, por që tek bibla kanë gjetur spuntun dhe subjekte të cilat fare mirë i shkojnë përshtat momenteve të ndryshme të shoqërisë shqiptare. F.Noli me veprën e tij “ Izraelitë e Filistinë: , kryekëput ka subject biblik. Konstatimi I orientimit të letërsisë shqiptare, e më konkretisht I letërsisë së Shqipërisë së Veriut, drejtë letërsisë peerëndimore, duke marrë prej saj anët më të mira, por dhe trajtimi I temave fetare në fillimet e letërsisë shqiptare, Namik Resulli në veprën e tij “ Shkrimtarë shqiptarë” përpiket të japë arsyet e këtij orientimi , dhe trajtimit të temave me motive biblike. “ Tri janë “ karakteristikat” kryesore të prodhimit letrar të veriut, që e dallojnë nga prodhiet letrare shqipëtare të tjera përpara Lidhjes së Prizrenit.

a) Lënda është gadi krejt fetare, pse u shkrua me qëllim kryesor që të mbajë gjallë e të forcojë në katolikët e veriut fenë katolike, e cila nën pushtimin osman kish nisur të shkatërroheje të çdukej;

b) Është I madh, ndoshta I tepërt, influksi latin e Italian mbassi auktorët e këtij prodhimi ishin lidhur ngusht me kishën e perëndimit, duke qenë nën urdhërat e saj, dhe kishin kryer studjimet e veta përtej Adriatiku, në Itali.

c) Gjithë për arsyet e sipërme, alfabeti I përdorur prej tyre po thua ai I tipit latin-italjan. Pa dyshim ky prodhim verior është më I rëndësishmi I prodhimeve të pjesë së parë të letratyrës shqipe, si nga pikëpamja e sasisë dhe gjërësisë si dhe nga pikëpamja e lëndës dhe e mbrëndisë. Këta shkrimtarë të vjetër të veriut nuk janë vetëm të parët që filluan një farë lëvizje kulturore në vendin t`anë, nuk janë vetëm të parët që I dhanë shqipes një alfabet-alfabetin latin- po janë edhe të parët që mendojnë e punojnë për atdhenë e gjuhën e tyre, për Shqipen e Shqiperinë. Madje nga kjo pikëpamje kombtare ky prodhim munt të lidhej drejtë për drejtë me atë që erdhi pas Lidhjes së Prizrendit, po t` ishte e madhe vlera estetike e qëllimi I përbashkësisë shqipëtare”.

(Resuli, 2007, 13 )

Ky orientim u ndërpre në periudhën e pasluftës (1945), por që sot shikojmë përsëri tendencën e këtij orientimi. Një nga faktet e këtij orientimi është dhe vepra e Ragip Sylaj “Dy drama”.

Në shënimin hyrës të autorit, i referohet shkrimtarit Amoz Oz, i cili shprehet se “ Unë mendoj se familja është institucioni më misterioz në botë, më paradoksal në botë, më i çuditshmi në botë, më ekzotiku në botë, dhe më interesanti në botë.” Sylaj ka mundur që lëndën biblike ta socializojë, ku si pikë referimi i botës është njeriu. “Edhe pse mbretëria e qiellit është brenda nesh,/ Andaj thuaj vetëm memento memento memento/ për djallin e dashurisë sate të engjëlltë.” Hapja e dramës, “prologu” me një strukturë poetike, nuk prish rendin dhe strukturën e dramës, por mendoj se arrin të orientojë lexuesin (spektatorin) drejtë lëndës mbi të cilën është organizuar e gjithë drama. Përcaktimi që autori i bën dramave të tij, tragjikomedi shkon njësh me subjektin lëndor, e cila “shtron shinat” drejtë absurdit dhe ekzistencializmit të jetës njerëzore, duke u përballur me paradoksin e dy botëve, botës së Parajsës, zanafillës së gjenezës njerëzore, por njëkohësisht dhe Realiteti i prekshëm, pavarësisht që personazhet mbartin simbolikën e gjenezës së njerëzimit. Adami dhe Eva vijnë vetëm me “lëkurën” biblike, nënvetëdija e tyre është njerëzore. Është njerëzore në përpjekjen për të gjetur përgjigjen e ekzistencialimit njerëzor.

Për ta klasifikuar një dramë moderne ka kriteret e saj. Duke filluar nga struktura, dialogu,



personazhet, linjat që trajton, mënyra e konceptimit të subjektit që trajton, didaskalitë, njësia e kohës, e vendit etj. Duke u nisur tek dy elementët e fundit, njësia e kohës dhe e vendit do të ndalesha për pjesën e parë të dramës. Pjesa e parë është konceptuar e ndarë në katër pjesë, të cilat korespondojnë me stinët e vitit. Njësoj si sinfonia e Vivaldit. Por ndryshe nga "Katër stinët" e Vivaldit, Sylaj është munduar të sjellë para lexuesit atë që është brenda nënvetëdijes njerëzore, katër momente të cilat vendosën vulën e Mëkatit të Madh, para Zotit. Skaneri i dramaturgut duket që mundohet të shikojë më tej, jo Mëkatin e Madh njerëzor para Zotit, por momentet që kalon njeriu në jetën e tij. Janë fazat e jetës njerëzore, por që simbolikisht autori ka arritur të gjejë dhe gjejësimin simbolike të secilës etapë, Pranvera e dashurisë, Vera e etjes, Vjeshta e urisë, Dimri i vetmisë. Në secilën pjesë, ajo që bije në sy është dialogu mes dy personazheve, Adamit dhe Evës. Dhe personazhet mbartin në vetvete simbolikën e tyre.

*Eva- Bëj diçka përderisa nuk bën asgjë.*

*Adami- Pse, asgjë të duket ekzistenca ime, asgjë të duket puna ime e përditshme:*

*Eva- Shih, mendo diçka edhe për mua derisa lodhesh e humb kohë për të tjerat.*

*Adami- Ku ka femra të tjera ne Eden, oj e marrë?*

*( Sylaj, 2012, 13-140).*

Dialogu që është në zanafillën e dramës "Dëbimi nga Parajsa", të krijon idenë e tërheqjes por edhe të xhelozisë së pritshme, të dy njerëzve që janë zanafilla e njerëzimit, por që mbi vete do të mbartin dhe të gjithë pasojat që do e ndjekin njerëzimin deri në ditët e sotme. Çeshtja e zanafillës së njerëzimit, nga Adami dhe Eva, është trajtur si në planin e religjionit, po ashtu dhe të planit shkencor dhe letrar. Gjithësecili në fokusin e vet ka dhënë opsionet veta, në varësi të këndvështrimit që kanë pasur.

Pjetër Budi në veprën e tij "Doktrina e Kërshtenë", duke iu referuar mëkatit të bërë nga Adami dhe Eva, jep dhe arsyen e dëbimit të dy krijesave të para të njerëzimit.

O i pafati nieri

Gjithë ndë të keq harruom;

I dhani ndë madhështi,

Me mkat pështjellë e ngatërruom.

*(Resuli, 2007, 29).*

Rimarrja e kësaj çeshtje nga autori, është parë në planin social-filozofik, Autori ka vepruar përmes retrospektivës, por që në fakt lënda që trajtohet është mëse aktuale. Shoqëria njerëzore është përbalhur dhe vazhdon të përballet me shumë probleme, gjë të cilën e konstantojmë dhe përmes dialogut të Evës dhe Adamit.

*Eva- E si mendon se do ta popullosh këtë tokë të shkretë? Kam droje se edhe ata që do të vijnë pas nesh do të jenë të anktshëm si ti, frikacakë, egoist-njësoj si ti.*

*Adami- Lakmitarë, nepsqarë e të pangopshëm njësoj si ti.*

*( Sylaj, 2012,20)*

Ky dialog, në pjesën "Pranvera e dashurisë" duket se krijon kontrastin, tragji-komedinë e vërtetë të njerëzimit, bash në stinë më të bukur, që autori i referohet dhe si stinë e dashurisë, kur priten dhe frytet më të mira të kësaj stine, fillon paradoksi i vërtetë, a thua se Parajsa paska qenë vetëm një mashtrim, një realitet-jorealitet, ose më mirë të themi një ferr-parajsë, ku zu fillë njerëzimi, me gjithë pasardhësit e vet, të egër, frikacakë, lakmitarë, të pangopshëm, egoistë. Njësia e kohës edhe pse shtrihet në katër stinë të vitit, në të vërtetë i kalon këto kufij. Katër stinët janë vetëm simbolikisht, Kufijtë e shtrirjes së zhvillimit të ngjarjes janë në të gjithë historinë e jetës njerëzore, në planin e përgjithshëm, kurse në një plan më të ngushtë, këto kufij zgjasin sa një jetë njeriu, me lindjen (Pranvera e Dashurisë) deri në vdekje (Dimri i Vetmisë). Konceptimi i njësisë së kohës, është në

kufijtë e një realiteti eszistencialist, që zë fillë që në fillesën e jetës njerëzore.

Njësia e vendit. Ngjarjet zhvillohen në parajsë, që më vonë zhvendosen në realitetin njerëzor. Por duket që asgjë nuk ndryshon, as në pjesën e parë (të dy pjesët e dramës janë në unitet me njëra –tjetrën) ashtu dhe në pjesën e dytë, të titulluara “Dëbimi nga Parajsa” dhe “Jetëvdekja”. Në pjesën e parë ngjarjet zhvillohen në parajsë, por që asgjë nuk të kujton këtë vend të mrekullueshëm, me plot grindje, xheloz, dashuri-padashuri. Dialogu mes dy personazheve te jep idenë që zhvillohet pasi janë dëbuar nga parajsa.

*Adami- Pse, a nuk e sheh sa ngushtë e kemi këtu, në Eden”*

*Eva- Jo, Adam, ti po flet si i dehur. Edeni i takon vetëm të kaluarës. Zemërimi i Hyjit na përzuri nga amshimi dhe na përllasi në truallin e pikëllimit tonë.*

*( Sylaj,2012, fq 23)*

Duke iur referuar përsëri veprës së Budit, në “Doktrina e Kërshenë, kemi paraqitjen e plotë të dëbimit të Evës dhe Adamit nga Parajsa, dhe përndjekjanga pas e mallkimit të zotit për mëkatin që kishin bërë.

Ndeper vepërat e ti,

`Ndë dhen e mallëkoi,

E me sa kundrështi

Gjellenë i a permetoi.

(Resuli, 2007, 35).

Dallimi në mes të prozës narrative dhe dramës në tekst është mungesa e një ndërmjetësi ose narratorit. Por ky rregull është thyer nga autori. Në pjesën e dytë kemi praninë e narratorit, ose ndryshe të Rrëfimtari. Prandinë e rrëfimtari e kemi vetëm në pjesën e dytë të dramës. Por cili është funksioni i rrëfimtari në pjesën e dytë të dramës? Dy pjesët e dramës duket sikur janë të veçuara nga njëra –tjetra, por në të vërtetë janë një njësi unike, pavarësiht karaktereve të ndryshëm dhe ambienteve ku zhvillohen ngjarjet. Pjesa e dytë fillon me fjalët e rrëfimtari : “Na ishte një herë Jeta dhe Vdekja...”. Ky moment i fillimit të rrëfimit të nga rrëfimtari është një formulë klishe e fillimit të rrëfimeve popullore. Model i cili është marrë dhe nga autori, . Kjo formulë e përdorur nga Rrëfimtari, parapregatit lexuesin për rrjedhën e ngjarjeve. Të njëjtin model të përdorimit të klisheve hyrëse i ndeshim dhe tek Kuteli, por dallimi mes dy autorëve qëndron në faktin që kanë lëvruar dy gjini të ndryshme, dhe në funksione të ndryshme. Roli i Rrëfimtari në dramën e Sylaj është në të njëjtën pozitë me Korifeun e dramës së Antikititit, në dallim me Rrëfimtarin e Kutelit, i cili nga fillimi deri në fund, mbart peshën e rrëfimit të ngjarjes. Pra, duket qartë , që roli i Rrëfimtari në të dy autorët kushtëzohet dhe nga gjinitë letrare në të cilin funksionalizohen. Ragip Sylaj njihet dhe si lëvruar i prozës, por gjithashtu në opusin e krijimtarisë së tij letrare na bën të ditur që njeh mirë dhe krijimtarinë gojore të popullit, çka i ka dhënë mundësi që të bëjë ndërfutjen e shprehjeve popullore, pa humbur vlerën e tyre, një ndërfutje tepër organike, në funksion të nxitjes situatave komike . Por një tjetër funksion i Rrëfimtari ka të bëjë dhe me “huazimin” e modelit të Korifeut nga drama e antikitetit grek. Kur shprehemi “ huazim” nuk kemi parasysh imitim, por një zgjedhje konceptuale e autorit, i cili nuk ka qëndruar “ skllav” i modelit të dramës së antikitetit. Për mua mendoj që Rrëfimtari në dramën e Ragip Sylaj luan dhe funksione të tjera si të Njeritit të Urtë dhe të Mençur dhe rapsodit shqiptar. Mësimi kjo duket qartë në momentin kur Rrëfimtari në pjesën e tretë të titulluar “Disa gjëra, njeriu duhet t`i harrojë në jetë” i referohet baladës së murimit, e konkretisht legjendës së Konstandinit. Në këtë legjendë kemi magjinë dhe forcën e fjalës së dhënë. Si e tillë, dhe fjala e rrëfimtari në këtë pjesë është në funksion të zhvillimit të ngjarjeve, të zhvillimit të tensionit dramatik. Duke qëndruar përsëri në funksionin që kryen Rrëfimtari në dramën e Sylaj, vërejmë që pjesët

e zgjedhura , në të cilët rrëfimtari është nistori i çdo pjese, është në përputhje me vetë zhvillimin e ngjarjeve të çdo pjese, dhe zbulon aspektin filozofik të kësaj drame.

- **Pjesa e parë** ( I Përçmuari të përçmon)---Kemi mendimin filozofik ekzistencialist të luftës mes jetës dhe vdekjes.

- **Pjesa e dytë** ( Dhembja si shpërblim)— Konflikti i përjetshëm mes të mirës dhe të keqes, mes dashurisë dhe urretjes.

- **Pjesa e tretë** ( Disa gjëra njeriu duhet ti harrojë në jetë )--- Rëfimi i legjendës së Konstandinit, me synimin për të zbuluar një nga vlerat e karakterit njeërezor, fjala e dhënë.

- **Pjesa e katërt** ( Po më dridhen gjunjët)---Njeriu në luftë me vetveten. Tek njeriu janë e mira dhe e keqja. Njeriu akoma nuk ka fituar betejën me vetveten e tij. Kabili dhe Habili janë brenda njeriut.

**Pjesa e pestë**---(Rrugët tona ndahen këtu). Përsëri beteja e njeriut me vetveten Engjëlli në luftë me Djallin. Dashuria sublime për të mirën e përsosur në luftë me të keqen.

**Pjesa e gjashtë**----( As në vetveten s`kam ku të kthehem). Lakmia është si akulli, që here pas here shfaqet në shpirtin e njeriut.

E gjithë struktura e dramës është ndërtuar në dhjetë pjesë. Një numër ndoshta i zgjedhur rastësisht nga autori, por që vetvetiu të shkon mendja tek harmonia e përsosur, dhe tek Dante Aligheri, i cili në veprën e tij përdor shumfishin e numrit dhjetë, numrin njëqind. Por në rastin e Sylaj, organizimi i dramës sipas këtij rregulli hyjnor duket që ka gjetur vendin e duhur. Jo vetëm për faktin që pjesa e parë e dramës fillon me dy personazhe , Adamin dhe Evën, si zanafilla e njerëzimit, të krijuara sipas shëmbëlltyrës së Krijuesit, por edhe për faktin që bazën e kësaj drame e përbën pikërisht problem i familjes, krijesa më hyjnore.

Drama e autorit Ragip Sylaj “ Dëbimi nga Parajsa” klasifikohet si sociale dhe filozofike. Por ajo çafërre e dallon këtë dramë ndryshe nga dramat e tjera, është trajtimi i një teme jashtë klisheve të dramës tradicionale sociale. Personazhet e saj janë antiheronj, dhe drama-antidramë, për këndvështrimin dhe konceptimin e saj. Jeta sociale, edhe pse e parë në këndvështrimin e problemeve të një familjeje shpirtare ( tek pjesa e dytë e saj) , dy pjesët e saj janë në unitet me njëra tjetrën duke krijuar një tablo ku nocioni kohë është thyer, është i çdo kohshëm, problem i familjes trajtohet në zanafillën e saj, por jashtë skemave me karakter biblik, duke socializuar temën që trajton, si një temë që nuk mund të merret vetëm për familjen shqiptare, por e parë në tërësi problematika e familjes në historinë e shoqërisë njerëzore, një nocion që nocioni hapësirë nuk ka një pikë reference, por e gërshetuar me temën e kurbetit, ( mendoj se kjo është linja kryesore që nxit konfliktin dramatik) shërben dhe si linjë aktuale me të cilën janë përballur dhe përballen shqiptarët.

## Literatura

Sylaj, Rakip. “Dy drama” Shb “ Rozafa”, Prishtinë 2012.

Resuli, Namik. “Shkrimtarë shqiptarë”. ( Pjesa e parë). Tiranë, Botim II Pakti, 2007.

## Qeverisja në Kosovën e Pavarur

**Adem Shala, Phd (c),**  
*UET-e, Fakulteti Juridik: e Drejta publike*

### Abstrakti

Kosova, është shtet i ri, më traditë fillestare në procesin e pavarur qeverisës dhe institucional. Shoqëri e vonuar në reformat e tranzicionit dhe në procesin e integritimit. Por, më një shoqëri që ka sakrifikuar shumë për liri, pavarësi e demokraci dhe që ka përcaktim e nevoj për zhvillim të të gjitha sferave. Cilësia institucionale dhe qeverisëse, paraqet njërin ndër faktorin esencial zhvillimor dhe integruer. Pas pavarësisë 2008, u krijuan parakushtet për qeverisje e organizim institucional, më përcaktime kushtetuese e ligjore sipas standardeve demokratike dhe të së drejtës ndërkombëtare. Ka arritë suksese konkrete qeverisëse, institucionale e juridike, por kërkohet implementim më efikas, më cilësor e më efektiv i rendit juridik e politik, duke mos lejuar tjetërsimin e qëllimeve dhe përcaktimeve kushtetuese në procesin qeverisës.

Është proces tejet i vështirë, për shkak të mungesës së kushteve bazë për demokraci: nivelit të ultë të zhvillimit ekonomik; mungesa e traditës demokratike; pengesat e jashtme; kultura politike e biznesore; përqendrim i pushtetit mbi burimet dhe sektoret egzistencial; ambient biznesor të papërshtatshëm; mungesë të opozitës së mirëfilltë; etj. Për të arritë rezultate zhvillimore, po kërkohet cilësi e re qeverisëse, në fokus të thellimit e krijimit të parakushteve për procese bashkëpunuese rajonale, integrimin në BE dhe integrimin në organizatat e proceset rajonale e globale. Këto arrihen, përmes angazhimit të qartë e të vendosur të faktorit vendor dhe ati ndërkombëtar njëkohësisht, për të konsoliduar cilësinë institucionale e qeverisëse. Këto janë procese esenciale të domosdoshme, për konsolidimin cilësor demokratik të institucioneve, zhvillimin ekonomik dhe integrimin e Republikës së Kosovës.

**Fjalë Kyçe:** *Qeverisja, Institucionet, Aktet, Proceset, Zhvillimi, Integrimi, Qeverisja lokale.*

### Hyrje

Procesi qeverisës dhe zhvillimi institucional e juridik në Kosovë gjatë periudhes 1999-2013, është i lidhur, i ndikuar dhe i kushtëzuar më një mori faktorëve e rrethanave vendore, rajonale e globale. Të gjitha këto rrethana së bashku, kanë përcaktuar përmbajtje, dukuri e tendenca të përgjithshme e specifike të procesit qeverisës, institucional, kushtetues, ligjor e kulturor, me efekte e pasoja konkrete në sferat tjera. Andaj, objekt studimi dhe qellimi kryesor i këti punimi është analiza, shtjellimi, identifikimi i cilësisë dhe shkaqet, pasojat, efektet e procesit qeverisës e institucional. Hulumtimi i procesit të konsolidimit, sukseseve dhe dukurive negative e pengesave, si dhe mënyrat e tejkalimit tyre. Të hulumtohet e pasqyrohet veprimtaria e përgjithshme e institucioneve kryesore politike: legjislativë, ekzekutive, gjyqësore e administrative dhe raporti në mes tyre të ndërlidhura me subjektet e jetës politike parlamentare e qeverisëse, dhe aspekti kushtetues e implementues. Pluralizmin politik e shumpartiak, zgjedhjet, legjitimitetin, sovranitetin popullor, qytetar e territorial, shoqërinë civile, mediat, etj, në kohën dhe hapsirën e lartëcekur. Pra, për të përcaktuar shkaqet e pasojat sipas faktorëve, intensitetin e influencave, korelacionet në mes variablëve, etj.

Lëndë studimi do jenë ngjarjet, proceset, vendimmarrjet, aktet, veprimet, rekomandimet, mosveprimet, raportet, etj, kosovare dhe të Bashkësisë Ndërkombëtare. Theksimi i Aktve

dhe Proceseve globale që kishin dhe kanë rolë të veçantë në zhvillimet intitucionale dhe proceset politike e qeverisë në Kosovë dhe rreth saj. Analiza e Forcave shoqërore dhe politike, kontradiktat dhe konstelacionet e subjekteve politike në pushtet dhe qeverisje. Interpretimi dhe pasqyrimi i tyre në kontekst të cilësisë së qeverisjes dhe institucionalizimit; në fokus të rolit të tyre në zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e sferave tjera. Në veçanti proceset integruese e afirmuese të Republikës së Kosovës, në funksion të përmirësimit të qeverisjes dhe rritjes ekonomike, si dhe shndërrimit të kësaj rritje në zhvillimin e sferave tjera si obligim, rolë dhe qellim primar i institucioneve dhe i qeverisjes efektive kosovare. Disa nga pyetjet që punimi do të sjell përgjigje janë: Cilat janë cilësitë qeverisëse e institucionale? Cilat janë shkaqet, pasojat, sfidat, aktet dhe efektet kryesore të qeverisjes e institucioneve gjatë kësaj periudhe? Cilat ishin veçantitë dhe karakteristikat e përgjithshme, gjatë bashkëqeverisjes më Bashkësinë ndërkombëtare? Më cilat sfida ballafaqohen institucionet dhe qeverisja kosovare pas pavarësisë dhe në të ardhmen? Si të arrihet qeverisja e mirëfilltë demokratike në këto sfera: kultura dhe stabiliteti politik; sundimi i ligjit; autonomia dhe kontrolli reciprok i pushtetëve; debati; procesi zgjedhor dhe konkurrenca; respektimi i kushtetutshmërisë e ligjshmërisë; efikasiteti dhe reformimi i administratës; rritja ekonomike dhe zhvillimi; mirëqenja, etj? Cilat janë dukuritë negative në qeverisje e institucione, dhe si të tejkalohen? Si të ndërtohen dhe ruhet karakteri i hapur i institucionëve? Si të integrohen pakicat, veçmas ajo serbe? Si të arrihet integrimi? Cilat ndryshime do të përmirësonin qeverisjen? etj.

### **Administrimi ndërkombëtar 1999-2008**

Sistemi socialist i qeverisjes në Kosovë, përpos karakteristikave të përgjithshme sistemore e ideologjike socialiste dhe realitetin ballkanik e global të pasluftës së dytë botërore, kishte edhe veçantitë tjera deformuese si rezultat i mohimit të vetëvendosjes së popullsisë shqiptare në teritoret etnike në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë(RSFJ). Përpjekjet e popullatës shqiptare për afirmim kombëtar, zhvillim, liri e barazi ishin të vazhdueshme, të cilat ndërlihdeshin me proceset e dukurit institucionale e qeverisëse. Gjatë viteve të 70-ta, filluan procese pozitive që patën si rezultat zbutjen e deformimëve dhe tejkalimin e një praktike të tillë, të cilat afirmuan pozitën statusore të Kosovës në Federatë dhe liberalizimin relativ të procesit qeverisës. Edhe vetëqeverisja socialiste ishte më liberale; dallohej nga qeverisja e vendeve tjera socialiste.

Presionet ndaj Kosovës u rishfaqen pas vitit 1981. Më demonstratat e këti viti dhe në vazhdimësi, rinia dhe populli i Kosovës kishte të theksuar kërkesën për statusin e Republikës në Federalizmin e RSFJ-së. Serbia më 1989-99 ia hoqi autonominë dhe e okupoj Kosovën, duke e dhunuar më forma të aparthejdit dhe gjenocidit. Në këtë periudhë filloi edhe procesi i shpërbërjes së Federatës dhe ndryshimet e sistemit qeverisës në vendet socialiste dhe ndryshimet globale. Nga ana e qytetarëve dhe e subjekteve politike kosovare u shfaqen proceset rezistuese politike, kushtetuese, institucionale e qeverisëse. Ndërsa, gjatë vitit 1998-1999 edhe rezistenca ushtarake. Të gjitha këto rezistenca karakterizoheshin më rezistencë këmbëngulse për vetëvendosje dhe për qeverisje e institucione legjitime e të pavarura. Rezistenca politike dhe ushtarake ishin faktorë esencjal që shkaktuan përkrahjen dhe ndërhyrjen e Bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Faktori vendor kosovar, ishte njëri ndër faktorët esencjal zberthyes në ndryshimin e gjendjes, kuptohet krahas proceseve e veprimeve të faktorëve të jashtëm. Ndërthurja përkrahëse e faktorit vendor nga faktori i jashtëm në rrethanat ndërkombëtare nuk ishte fare e lehtë. Veprimtaria këmbëngulëse dhe sakrificat kosovare gjatë viteve 80-ta dhe 90-ta, veçmas 1998-99, e thelluan përkrahjen

e çështjes së Kosovës dhe ndërhyrjen e drejtëpërdrejtë të Bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Më ndërhyrjen ndërkombëtare, u krijuan rrethana dhe forma të reja qeverisëse e institucionale më ndikime të theksuara nga faktori i jashtëm. Ndërhyrja ndërkombëtare në rajon dhe në çështjen e Kosovës ishte e vazhdueshme gjatë viteve të 90-ta, më një mori vendimeve, rezolutave, sygjerimeve, veprimëve dhe presioneve. Por, ndërhyrja më e drejtëpërdrejtë në Kosovë ndodhi në vitin 1999, përmes akteve dhe veprimeve ndërkombëtare më të drejtëpërdrejta, kryesisht më: Organizimin e Konferencës së Rambujesë (1999); Ndërhyrjen ushtarake të NATO-s (mars, 1999) dhe Rezoluten 1244 e KS të OKB-së (1999), të cilat krijuan rrethana të reja përcaktuese qeverisëse e institucionale në Kosovë. Gjatë Administrimit ndërkombëtar 1999-2008, qeverisja dhe institucionalizimi në Kosovë bazohej kryesisht në Rezoluten 1244 të OKB-së. Kjo Rezolutë, karakterizohej nga qendrimet kompromisëse të kontradiktave ndërkombëtare ndaj statusit të Kosovës, të cilat reflektoheshin edhe në qeverisjen dhe institucionalizimin kosovar. Kjo Rezolutë në pikën 11 përcaktonte përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare në përkrahjen për krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje përmbytësore në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare, duke marrë tërësisht parasysh aneksin 2 dhe marrëveshjet e Rambujesë (S/1999/648); të cilat përshkruajnë procesin qeverisës në këtë fazë kalimtare. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Kosovën (PSSP), në bashkëbisedime me subjektet politike të Kosovës dhe më vendet më ndikim, menjëherë pas lufte arriti të krijojë: Këshillin e Përkohshëm Administrativ (KPA). Më vonë Këshillin Tranzitor të Kosovës (KTK), departamentet administrative dhe administratoret e UNMIK-ut në nivelin lokal-Komuna. Autoritet vendimmarrës absolut në qeverisjen kosovare, me „veton” e vet në sferën legjislativë e ekzekutive, ishte Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP), deri në të drejtën e shpërndarjes së institucioneve të zgjedhura kosovare. I gjithë mekanizmi dhe organet e Administratës ndërkombëtare në Kosovë (UNMIK), nuk jepnin përgjegjësi ndaj organeve të zgjedhura kosovare dhe as para gjyqësorit në Kosovë. Pra, që nga fillimi kishte kompetenca tejet të reduktuara të faktorit vendor në qeverisje, të cilat u sanksionuan edhe më Kornizën e përkoshme kushtetuese (2001).

Rregullimi juridik kushtetues-Korniza e Përkohshme Kushtetuese 2001 ishte e imponuar. Kuvendi i Kosovës nuk e kishte funksionin e vertetë ligjvënës e kontrollues, gjyqësori nuk ishte i pavarur, e edhe ekzekutivi më institucionet tjera gjithashtu. Faktorit vendor në qeverisje nuk i lejohej mundësia e krijimit të vullnetit politik dhe as vendimmarrje të rëndësishme. Procesi i qeverisjes 1999-2008, ishte i subordinuar nga faktori ndërkombëtar. Si i tillë sillte gjendje kaotike, anarki, papërgjegjshmëri dhe ishte i papërcaktuar në shumë aspekte. Në realitet kjo përkthehej në pengim të qeverisjes dhe institucionalizimit të mirëfilltë kosovar, për shkak të mohimit të vetëvendosjes/pavarësisë. Rezoluta e OKB-së, sa i përket Statusit ndaj Kosovës ishte e papërcaktuar, kundërtëdhënëse dhe qellim kishte pengimin e pavarësisë së Kosovës deri në ndonjë zgjidhje të ardhshme politike. Periudhë kjo, që zgjati tetë vite mbajtje peng të vullnetit politik të shqiptarëve në Kosovë, mungesën e reformave dhe më mungesën e krijimit të përvojës/traditës qeverisëse demokratike të pavarur si faktor tejet i rëndësishëm.

Faktorin kosovar në procesin qeverisës dhe në vendimmarrje, Bashkësia ndërkombëtare e reduktoi në nivel konsulltimi, propozimi, këshillimi e njoftimi. Pra, pa pushtet real në asnjë sferë. Ndër shkaqet tjera, që drejtëpersdrejti ndikuan në cilësitë e qeverisjes gjatë bashkëqeverisjes më Bashkësinë ndërkombëtare është edhe kaosi ligjor. Kishte rregullore të paqarta dhe kishte përpjekje për imponim edhe të legjislationit jugosllav. Periudhë kjo, që zgjati mbi tetë vite mbajtje peng të shumë proceseve e reformave të tranzicionit dhe të

vullnetit politik të shqiptarëve në Kosovë. Këto rrethana dhe procese, sadoqë ishin pozitive në raport më të kaluarën kosovare, ndikuan drejtëpersedrejt në cilësinë e reformave, funksioneve dhe efekteve institucionale e qeverisë në Kosovë. Pra, kjo qeverisje e kësaj periudhë karakterizohej:

- Qeverisja ndërkombëtare 1999-2008, ishte joefektive dhe penguese e proceseve, për shkak të papërcaktimit të statusit të pavarur të Kosovës.
- Institucionet kosovare gjatë bashkëqeverisjes më faktorin e jashtëm 1999-2008, ishin të penguar, të varura dhe u mungonin kompetencat. Si të tilla ishin edhe joefektive e joefikase, të papërgjegjshme e jodemokratike në kompetencat e tyre dhe ndaj procesit politik.
- Pengesat dhe vonesat në reforma e integrim, kanë ndikuar negativisht në shumë sfera e procese, pasojat e të cilave janë afatëgjata.
- Pakica serbe, veçmas në veri tolerohej nga Bashkësia ndërkombëtare të luante rol destruktiv në procesin e institucionalizimit dhe në qeverisjen kosovare të administruar. Pasojat e kësaj tolerance shihen edhe sot e kësaj dite.

Të gjitha këto ndikuan drejtëpersedrejt në organizimin e funksionimin institucional dhe në cilësinë e efektet qeverisë gjatë kësaj periudhe.

Dështimet e Bashkësisë ndërkombëtare në sferën e krijimit të një shoqërie moderne dhe demokratike në sferën qeverisë e institucionale, e raportojnë një numer i madh i organizatave dhe organeve ndërkombëtare në Kosovë. Psh. kemi një Raport të Ombudspersonit në Kosovë M. A. Novicki (2004) i cili punoi 5 vite në këtë funksion. Në pjesën e këtij Raporti, cekën të drejtat e njeriut dhe sfidat që ballafaqohej shoqëria dhe qytetaret më qeverisjen e institucionet në Kosovë. Ai vëren praktikën dhe rezultatin e kundërt të administrimit ndërkombëtar, të cekura në nenin 11 të Rezolutës 1244 të OKB-së (1999), që parasheh: „organizimin dhe mbikqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për një vetëqeverisje demokratike dhe autonome derisa të arrihet një zgjidhje politike.” Ndër vërejtjet kryesore, Novicki M.A (2004), cek se:

*“vetë UNMIK-u nuk është strukturuar në pajtim me parimet demokratike. Siç tashmë është kritikuar edhe në Raportin e Dytë vjetor, kur UNMIK-u u vendos si zëvendësim i shtetit në vitin 1999, ai plotësisht injoroi njërin nga parimet themelore të demokracisë, respektivisht ndarjen e pushtetit. Pothuajse mënjëherë pas emërimit të tij, PSSP nxjerri një rregullorë të UNMIK-ut, e cila i mveshë atij pushtet total ekzekutiv dhe legjislativ dhe i lejoi pushtet administrativ mbi gjyqësinë. Kjo mosperfillje e parimeve demokratike të qeverisjes, vazhdon të ketë ndikim negativ në funksionimin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë; në ligjshmërinë demokratike të këtij misioni. Deri më tani, as UNMIK-u e as Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse-IPVQ, nuk kanë qenë në gjendje të përballen më paligjshmërinë e përgjithshme që momentalishtë egziston në Kosovë.”*

Zhvëshja e faktorit vendor nga kompetencat dhe rrjedhimishtë, nga përgjegjësia e llogaridhënia juridike e politike, ishte karakteristik dominante. Përpos kësaj, lidhshipi kosovar duhej të kishte përgjegjësi morale e politike edhe për gjendjen e krijuar, për proceset kosovare, për pozicionin tejet servil të tij ndaj faktorit të jashtëm dhe ndaj status quo. Uzurpimi i udhëheqjeve partiake dhe futja në institucione e grupeve të interesit dhe të presionit për përfitime grupore përmes keqpërdorimeve, i deformonte proceset akoma më shumë. U shfaqën korrupsioni, krimi i organuar, nepotizmi, etj brenda institucioneve, si dhe papërgjegjësia e mungesa serioze e vullnetit për luftimin e tyre. Dominoi moskuptimi i proceseve, joefikasiti e joefektiviteti, mangësit e procesit zgjedhor, dobësitë e votuesvetetarëve në këtë proces, thyerja e vlerave, përqendrimi i pushtetit dhe jozhvillimi

ekonomik. Shoqëria civile është e brishtë dhe mediat e politizuara/partizuara. Të gjitha këto si rezultat kishin lulëzimin e korrupsionit në institucione publike, në gjyqësor, krimin të organizuar, papërgjegjësi, jollogaridhënie, joefikasitet dhe dobësim i vlerave pozitive, si dhe humbje e besimit për demokraci tek qytetarët.

Kotë votonin qytetarët, ngase mungonin programet partiake e konkurenca e mirëfilltë në mes tyre, si dhe mungesa e pushtetit real të kosovarëve. Në raport më gjendjen juridike dhe në raport më dukurit e lartëpërmendura, nuk ishin opozitë asnjëra nga subjektet politike. Nuk ishin as kundër status quos statusore e qeverisë. Udhëheqjet partiake ishin të korruptuara, krijonin opinion mashtrues kinse është zgjidhur çështja e Pavarsisë/Vetëvendosjes, mburrëshin dhe shtyheshin në mes veti për meritat e kaluara, pa bërë asgjë për problemet egzistuese dhe sfidat e së ardhmes. Në procesin zgjedhor konfrontoheshin më shpife e etiketa, sharje e kërcnime, vetëm e vetëm për ardhje në pushtet, pa konkurrencë të mirëfilltë. Nuk garonin për qeverisje të mirëfilltë, por qëllim primar kishin privilegjet dhe keqpërdorimet në emer të institucioneve e interesave publike. Këto rrethana dhe mbajtja peng e vullnetit politik për pavarësi dhe mosndryshimi i politikës serbe ndaj Kosovës, ndikuan në shpërthimin e paknaqësisë dhe revanshit spontan e të pakontrolluar të qytetarëve, në mars 2004. Këto ngjarje treguan se situata është e padurueshme. Më 2006 filloi të konsolidohet një levizja opozitare jashtë institucioneve–Vetvendosja. Në këtë vitë u nda edhe Mali i zi nga Serbia.

Grupi i Kontaktit (2005), në konsensusin e tij të fundit, deklaroi parimet udhëzuese për zgjidhjen e statusit, disa nga to përcaktuan edhe qëllimet qeverisë:

*”Çdo zgjidhje e cila është e njëanshme apo rezultat i dhunës nuk do të pranohet. Nuk do të ketë ndryshim të territorit të tashëm të Kosovës, ndarje të Kosovës apo bashkim të Kosovës me cilindo shtet apo pjesë të ndonjë shteti. Integriteti territorial dhe stabiliteti i brendshëm i fqinjëve rajonalë do të respektohet plotësisht. Grupi i Kontaktit gjithashtu insiston që zgjidhja e ardhshme duhet të sigurojë mekanizma për pjesëmarrje në qeveri të të gjitha bashkësive në Kosovë, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Gjithashtu theksohet se struktura efikase e vetëqeverisjes lokale nëpërmjet procesit të decentralizimit duhet të lehtësojë bashkëjetesën e bashkësive të ndryshme”*

Në të njëjtën kohë, Sekretari Gjeneral i OKB caktoi ish-Presidentin finlandez, Martti Ahtisari, që të udhëheqë bisedimet dhe procesin e arritjes së një marrëveshje rreth statusit. Ahtisari u përball me një detyrë të vështirë për shkak të pozitave të ndryshme mbi statusin final të çështjes së Kosovës; pozitave të cilat reflektonin qëndrimet kundërshtarë të Beogradit dhe Prishtinës dhe dallimeve të vendeve më ndikim ndërkombëtar. Procesi i bashkëbisedimeve në krye më Marti Ahtisarin, shfaqen Propozimin Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës-shkurtimisht: Plani i Ahtisarit (2007).

### **Qeverisja në Kosovën e Pavarur**

Konsolidimi institucional e juridik i qeverisjes në Kosovën e pavarur është i bazuar në Planin Gjithëpërfshirës të Ahtisarit dhe Mbikëqyrjes ndërkombëtare për implementimin e tij. Në (Nenin 1.3.) të këtij Plani (2007) parashihet që: „Kushtetuta e Kosovës do të përshkruajë dhe garantojë mekanizmat ligjorë dhe institucionalë, të cilët janë të domosdoshëm për t’u siguruar se Kosova qeveriset sipas standardeve më të larta demokratike, dhe e cila do të promovojë bashkëjetesën paqësore dhe prosperitetin e të gjithë banorëve të saj” Ky planë parasheh rregullimin e sistemit politik e juridik në vija të përgjithshme, e disa sfera përcaktohen edhe në detale. Në (Nenin 1.1.) të Dispozitës së përgjithshme të Planit të



Ahtisarit (2007) përcaktonë se:

*"Kosova do të jetë shoqëri shumetnike, që do të qeveriset në mënyrë demokratike dhe me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Ushtrimi i pushtetit publik në Kosovë, do të bazohet në barazinë e të gjithë qytetarëve dhe respektimin e nivelit më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre".*

Plani i Ahtisarit, e përcakton Kosovën si shoqëri më demokraci multietnike, joreligjioze, me gjuhën shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare, me një ekonomi të tregut e të hapur e më konkurrencë të lirë. Ofron elemente kryesore për të drejtat minoritare dhe pronësore, për një formë të fortë të qeverisjes lokale të decentralizuar në nivelin komunal. Psh. në Nenin (3.2) kërkon "mbrojtjen e identitetit nacional apo etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të të gjitha Bashkësive dhe anëtarëve të saj." Në nivelin kombëtar, Plani i Ahtisarit siguron pjesëmarrje të pakicave të rezervuara dhe të mbrojtura në qeverinë qendrore. Psh. Aneksi I siguron kuota për pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në qeverinë nacionale. (Neni 3.3) kërkon një minimum prej njëzetë ulëseve (nga 120) të rezervuara për minoritetë, (dhjetë për serbët e Kosovës) në Kuvendin e Kosovës. (Neni 3.7-9.) siguron pjesëmarrjen dhe votimin e pakicave në Kuvend për çështjet të cilat ndikojnë në bashkësitë e tyre. Neni 5. kërkon një numër minimal të Serbëve dhe përfaqësuesve tjerë të bashkësisë minoritare në qeveri. Aneksi I gjithashtu i jep përfaqësuesve jo-shumicë një rol të theksuar në zgjedhjen e anëtarëve të Gjyqit Kushtetues (Neni 6) dhe rol të veçantë në procesin e ndryshimit të Kushtetutës (Neni 10).

Pra, Plani i Ahtisarit siguron një kornizë për një demokraci funksionale multietnike, edhpsë pakicat në Kosovë përbëjnë rreth 8% të popullsisë. Qëllimi ishte që pakices serbe t'i siguroi status të veçantë për ta integruar dhe deinstrumentalizuar nga politika destruktive e Serbisë ndaj Kosovës, ngase Serbia destruktivitetin e bënte përmes pakicës serbe në Kosovë. Por kjo ka anet negative, ngase nga koncepti i multietnicitetit që afirmohej më të madhe, u kalua në Komuna më shumicë serbe e jo multietnike. Kjo ndarje në baza etnike nuk ishte parimore dhe nuk shpreh strukturën reale të popullsisë kosovare dhe më tepër e enklavizon shoqërinë kosovare, se sa që kontribon në multietnicitetin e mirëfilltë. Në rastin e Kosovës nuk kishte konflikte ndër-etnike, por ishte instrumentalizimi i pakicës serbe nga politikat dominuese të Serbisë dhe nga tolerimi ndërkombëtar për ta penguar vetëvendosjen, institucionalizimin dhe qeverisjen; e jo për interesat dhe të drejtat e pakicës serbe. Për ta amortizuar këtë instrumentalizim dhe pengesat e Serbisë, zgjidhjet që i përfshinë Plani i Ahtisarit, u bënë të pranueshme për palën kosovare institucionale edhpsë, dihet se Kosova nuk është shoqëri e theksuar multietnike. Por, zgjidhja reale e këti problemi bëhet duke i penguar politikat ndërhyrëse të Serbisë dhe aleatëve të saj kundër pavarësisë së Kosovës.

Më krijimin e rrethanave ndërkombëtare, Kuvendi i Kosovës shpalli Pavarësinë e Kosovës si shtet sovran. Kuvendi shpalli Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës (17 shkurt 2008) Pasoj njohja ndërkombëtare e një numri të konsiderueshëm të vendeve më ndikim global. Kushtetuta e Kosovës (2008) përcaktoi karakterin, funksionet dhe organizimin e institucioneve. Të gjitha përcaktimet dhe autorizimet e pushtetit qeverisës e institucional, u konsoliduan sipas kërkesave të Planit të Ahtisarit, duke i theksuar garantet e të gjitha grupeve etnike dhe të drejtat e qytetarit, veçmas minoritetit serb në Kosovë. Kushtetuta e përcaktoi sistemin politik e juridik: Republikë parlamentare e ngajshme më sistemin qeverisës më vendet e demokracisë përendimore dhe të vendeve të tranzicionit. Shtet unik, më qeverisje lokale komunale të decentralizuar.

Kushtetuta e Kosovës paraqet zgjidhjet bazë për procesin qeverisës dhe institucional, sipas standardëve demokratike. Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës, në (Kapitullin I në nenin 16.2.) të Dispozitave themelore, thekson se: „Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.” Në (nenin 2.1, të K-I), përkufizon se: „Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet në pajtim me Kushtetutën nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute” Duke shpreh epërsinë e këtij akti dhe kushtetutshmërinë në procesin qeverisës, në (nenin 16.1, K-I), përkufizohet se: „Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë”. Në Dispozitat themelore (neni 4.1, K-1) përcaktohet forma e qeverisjes dhe ndarja e pushtetit: „Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar më Kushtetutë.” Në pajtim me zgjidhjet kushtetuese, ligjet, procedurat dhe aktet tjera nenligjore, u konstituan të gjitha institucionet, sipas kompetencave e përgjegjësi. Edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë së OKB-së (22 korrik 2010) me qendër në Hagë, publikoi opinionin këshilldhënës pozitiv, lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Ndër sukseset e mëdha, është edhe fundi i mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, (shtator/2012), e cila shënoi edhe implementimin e plotësimin e kriterëve që kërkoheshin nga Pakoja e Marti Ahtisarit. Pra, më këtë u rrumbullaksuan parakushtet nga aspekti juridik e organizativ funksional i konstituimit të institucioneve dhe qeverisjes vendore të Republikës së Kosovës. Më përjashtim të mos shtrirjes së pushtetit në veri.

### **Cilësia qeverisëse dhe institucionale**

Pas shpalljes së Pavarësisë, cilësia qeverisëse dhe institucionale paraqet thelbin e zhvillimit, përkatësisht, moszhvillimit të të gjitha sferave. Pavarësia e mirëfilltë nuk mund të përmbajtësohet pa cilësi në qeverisje e institucione demokratike, funksionale e efektive në bazë të rendit juridik përkatës. Cilësia e qeverisjes dhe funksionimit institucional varet nga një mori faktoresh e rrethanash. Varet nga: cilësia e normimit kushtetues e ligjor (rendi politik dhe juridik) i cili momentalisht konsiderohet i përshtatshëm dhe sipas standarteve demokratike, por implementimi i tij nuk është i lehtë, ngase mungon: struktura e vetëdijes politike të qytetare; cilësia e subjekteve politike dhe e lidhshpirt; tradita politike e qeverisese; niveli i zhvillimit ekonomik; mungesa e shtresëzimit të shoqërisë; proceset e vonuara integruese; pozita gjeografike dhe e infrastrukturës; pozita në raport me tregjet rajonale e globale; qendrimet pozitive të vendeve fqinjë, ndikimet e qarta ndërkombëtare në rajon, niveli i shoqërisë civile dhe mediave, mungesa e forcave të reja opozitare, politika ekonomike e mirëfilltë, etj.

Në veçanti, niveli i zhvillimit ekonomik është i ndërlidhur drejtëpërsdrejti, ngase pa zhvillim të sferës ekonomike private nuk ka qeverisje demokratike dhe nuk ka shpërqendrim të pushtetit, e as shoqëri civile të avancuar. Por, edhe pa qeverisje efektive, sundim të rendit, sigurisë, politikave të përshtatshme ekonomike, administratë cilësore e shërbime publike cilësore, të cilat duhet t'i siguroi qeverisja, nuk ka zhvillim ekonomik e as shoqëri civile përkatëse. Pra, egziston një ndëridhje reflektuese e kushtëzuese reciproke për tejkallimin e situatës. Pa përpjekje të shumanshme e gjithëpërfshirëse të sferave, faktorëve e aktoreve të shumtë njëkohësisht, duke filluar nga qytetaret e lidhshpirt, e deri të përkrahja e jashtme e mirëfilltë, nuk ka qeverisje cilësore, e as zhvillim dhe as integrim. Pas shpalljes së pavarësisë (2008) e deri më 2014, për nga forma juridike (Kushtetuta e

Republikës së Kosovës 2008) dhe rezultatet efektive të shprehura nga opinionet e qytetarëve, nga vlerësimet e shumta të vetë institucioneve politike të pasqyruara përmes mediave ditore, nga shoqëria civile (KDI,2013) dhe institucione ndërkombëtare të cekura edhe në listën e referencave(European Commission 2011, 2012, 2013; Sekretari i përgjithshëm i OKB-së,(nandor-2012); Freedom House, dhjetor 2012; FMN, janar 2013; BB, dhjetor 2012, Organizata Europiane e Gjyqësisë,(25/qershor/2013; etj) si dhe nga vëzhgimet, analizat e vlerësimet e mia, konstatojmë se qeverisja dhe institucionet kosovare gjatë kësaj periudhe moren këto karakteristika:

- Ka filluar qeverisja përmes institucioneve të pavarura, legjitime dhe funksionale sipas përcaktimeve juridike. Ka rezultate të dukshme e konkrete, por nuk ishte cilësia e duhur e lidërshiptit dhe e zyrtarëve në institucionet përfaqësuese, ekzekutive, në gjyqësor, në administratë, në shërbimet publike dhe as në institucionet tjera të pavarura. Vërejtje të theksuara ka në organet e ndjekjes dhe tëk gjyqësori, të cilat nuk ishin efektive kundër dukurive negative dhe nuk kishin përkrahje serioze nga institucionet kryesore politike.
- Nuk ka politika të qarta ekonomiko-zhvillimore. Ka ngecje në krijimin e kushteve për mjedis të përshtatshëm biznesor. Mungojnë reformat dhe politikat e qarta ekonomike e makroekonomike. Politikat ekonomike të gjertanishme, nuk janë konkrete e specifike, nuk janë projekte e strategji afatëmesme dhe afatgjata, për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.
- Autoriteti dhe legjitimiteti qeverisës e institucional po përceptohet negativ tek qytetaret, si rezultat i dukurive negative të grupeve në udhëheqjet partiake dhe në institucione.
- Konkurrenca ndërpartiake është jo parimore: e përcjellur më akuzat, shpifje e ofendime dhe jo sa duhet bashkërenduese e konsensuale në vendimmarrjet pozitive.
- Mungojnë forcat opozitare të mirëfillta. Si rezultat i kësaj ka pjesëmarrje të ultë në votime dhe mungesë të pjesëmarrjes cilësore e sasiore të qytetarëve në procesin politik.
- Mosndëshkim nga gjyqësori i bartësve të dukurive negative në qeverisje dhe përzierja e politikës në gjyqësor.
- Mosndëshkim i subjektëve dhe liderve të tyre më votë nga qytetarët, si rezultat i votuesve emocional dhe më struktur të vetëdijes politike të ngarkuar nga e kaluara dhe jo sa duhet kognitive, si dhe nga përqendrimi i lartë i pushtetit mbi burimet egzistenciale publike dhe mediave jo të pavarura sa duhet.
- Shkelje të rënda të parimeve demokratike në procesin zgjedhor, të cilat po ndikojnë në uljen e nivelit të legjitimitetit, autoritetit dhe efektivitetit qeverisës dhe institucional.
- Me sistemin zgjedhor proporcional u influencua paksa bashkërenditja, kooperimi dhe toleranca ndërpartiake dhe ulja e tensioneve në mes tyre në procesin qeverisës dhe në funksionet institucionale. Si rezultat i proporcionalitetit zgjedhor/elektoral, nuk kemi dy taborre dhe dy tirani të shumicave, por disa parti të mesme të detyruara për aleanca e bashkëpunim për të kriju pozitë, si dhe për efekte opozitare.
- Kishte dhe ende ka ndërhyrje të theksuara ndërmjetësuese nga faktori i jashtëm, në zgjidhjen e krizave instiucionale dhe në proceset vendimmarrëse.
- Toleranca ndëretnike është në rritje.
- Përpjekjet në eliminimin e kundërshtarve partiak përmes metodave jodemokratike, antikushetuese e jologjore, gjithnjë po relativizohen dhe zbehen. Tiranizmi si metodë e veprimtarisë politike po pakësohet.
- Guximi qytetar dhe aktiviteti racional politik ka fillue të rritet. Shoqëria civile përmes

OJQ-ve gjithënjë po konsolidohet. Edhe mediat kanë ngrit nivelin e pavarësisë, analizës dhe kritikës së bazuar. Por, këto të fundit ende anojnë nga ngjyrimet partiake.

- Shtresëzimi dhe struktura plurale e shoqërisë kosovare po mungon, si rezultat i jozhvillimit ekonomik në sferen prodhuese e shërbyese private.
- Mbrojtja nga sulmet e jashtme po bëhet nga forcat ushtarake ndërkombëtare dhe nga politikat përcjellëse të Bashkësisë ndërkombëtare. Ruajtja dhe mbikqyerja e kufirit dhe siguria e brëndshme po bëhet nga Policia e Kosovës. Kosovës, ende po i mungon forca ushtarake më rolet dhe funksionet e saja.
- Sundimi i ligjit nuk është në nivelin e duhur, por të gjithë po vetëdijsohen për gjendjen dhe pasojat. Ka përpjekje konkrete dhe kërkesa, presione e përkrahje nga jashtë që të përmirësohet kjo sferë esenciale për qeverisje demokratike, pa të cilën nuk ka efekte dhe funksione demokratike qeverisëse në asnjë sferë.
- Vetëmbrojtja e brëndshme po bëhet nga institucionet e sigurisë, të mbikqyrura e të kontrolluara nga forcat civile institucionale dhe nga sistemi juridik.
- Mbështetja kulturore dhe konsolidimi i vlerave demokratike në qeverisje, në ekonomi, në respektim të të drejtave të njeriut dhe pakicave, barazisë gjinore, etj., janë në rritje.
- Interpretimi dhe mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në qeverisje, po bëhet nga gjykata kushtetuese, në të cilën ka edhe përfqësues ndërkombëtar. etj.

### **Dukuritë negative dhe Luftimi i tyre**

Gjendja qeverisëse pas shpalljes së pavarësisë është e ndikuar nga e kaluara e tejzgjatur e qeverisjes joefektive, si rezultat i pengimit të vetevendosjes/pavarësisë; moszhvillimit ekonomik; papunësia; varfëria; mungesa e investimeve; uzurpimi i udhëheqjeve partiake dhe depërtimi i grupeve të korruptuara në institucione, mosluftimi i dukurive negative në institucione për një kohë të gjatë; përqendrimi i pushtetit; pasojat posttraumatike; etj. Këto rrethana e shkaqe, patën pasoja në cilësinë e funksioneve institucionale, në nivelin e realizimit të roleve e kompetencave të vetë parlamentit si institucion bazë i demokracisë parlamentare, dhe rrjedhimisht, edhe në institucionet tjera. Moszbatimi i ligjit, mungesa e autonomisë së pushteteve dhe pamundësia e kontrollit reciprok, veçmas, e parlamentit ndaj ekzekutivit dhe gjyqësorit, mungesa e funksionimit të mirëfilltë të procesit zgjedhor, karakteristikat e subjekteve politike dhe lidershipit të tyre, etj., kanë sjell pasoja në rritjen e korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe në mosluftimin e tij.

Dukuritë negative në institucione po e dëmtojnë buxhetin e shtetit, ekonominë dhe shoqërinë: duke i penguar e deformuar investimet publike dhe duke krijuar pasiguri për investitorët potencial të brëndshëm e të jashtëm. Po ndikojnë drejtëpersedrejt në moszhvillimin ekonomik, pasigurinë dhe në cilësinë e shërbimeve publike e administrative. Andaj, janë të doemosdoshme masat dhe reformat e caktuara qeverisëse, për tejkalim të gjendjes në sferen ekonomike. Drejtoresha e Bankës Botërore për Europën Juglindore, Jane Armitage, në një intervistë (2012), duke kërkuar reforma në këto sfera kosovare thekson se: "duhet të bëhen shumë gjera, të luftohet korrupsioni, të përmirësohet gjyqësori, të gjitha këto janë pjesë e mjedisit biznesor. Pra, kur bëhen indikatorët e biznesit dhe afarizmit, investitorët i shikojnë të gjithë këta indikatorë." Kjo gjendje po vazhdon ngase, Gjyqësori është ende joefikas, jo i pavarur sa duhet dhe i ndërlidhur më dukuritë negative qeverisëse, si dhe nën presion të grupeve të interesit dhe grupeve të presionit në institucionet e larta. Funksionimi i sistemit gjyqësor është qenësor për sundim të ligjit, por ende është i varur e

joefektiv. Në aspektin juridik e kushtetues duket i pavarur, por aspekti faktik është krejtë tjetër. Kosova në opinionet e qytetarëve dhe organizatave monitoruese, çoftë vendore çoftë ndërkombëtare, cilësohet si një shtet me nivel të lartë të korrupsionit në: ndërmarrjet publike, në proces të prokurimit dhe në shpenzimet qeveritare. Punësimet në administratë dhe në sferat tjera publike bëhen përmes nepotizimit dhe përkatësisë partiake pa përfillur cilësitë profesionale dhe etike. Ka një administratë publike të politizuar/partizuar dhe ende të pareformuar sa duhet. Ka shkallë të lartë të ekonomisë informale dhe mungesë të kapaciteteve e vullnetit për ta luftuar atë.

Mungon konkurrenca reale e partive si rezultat i dukurive negative të futura në vetë udhëheqjet partiake dhe përmes tyre në institucione. Garat në mes tyre nuk bëhen për alternativa qeverisëse e programore, por për përvetësime, privilegje dhe keqëpërdorime grupore në emër të qeverisjes dhe institucioneve. Mu për këtë, debatet në mes tyre janë të ashpra, fyese, etiketuese e destruktive. Këto janë karakteristika edhe para pavarësisë, por këto vazhduan më një intensitet më të ultë edhe pas pavarësisë. Në të gjitha raportet monitoruese të organizatave ndërkombëtare dhe nga OJQ-të vendore dhe mediat hulumtuese, theksojnë se elitat e larta politike janë të korruptuara përmes procesit të privatizimit të manipuluar, keqëpërdorimit të tendërve dhe prokurimit, shpënzimeve buxhetore të qeverisë, nga fondet paraprake të donatorëve, partneritetit të korruptuar publiko-privat, etj. Këto grupe përpos presioneve dhe korrupsionit, informalitetit, krimin të organizuar dhe kontrabandes, po pengojnë demokratizimin dhe funksionimin kushtetues e ligjor të institucioneve. Këto grupime të depërtuara në institucione e subjekte politike dhe të ndëlidhura më to, i financojnë fushatat parazgjedhore për udhëheqjen partiake që favorizon dukurit negative. Manipulojnë dhe e deformatojnë procesin zgjedhor dhe manipulimin e opinionit përmes mediave të varura, shantazheve, demagogjisë, etj. Këto grupime i sjellin lojalet e tyre në institucionet kryesore dhe në agjencitë e pavarura. Këto dukuri dhe bartësit e tyre po e pengojnë qeverisjen demokratike dhe rrjedhimisht, po e pengojnë zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e sferave tjera.

Korrupcioni në Kosovë është pjesë e sistemit. Pra, vetë bartësit e pushtetit dhe institucionëve janë të përfshirë në dukuri të tilla. Në Barometrin Global të Korrupsionit (korrik, 2013) partitë politike janë identifikuar si fushë më e prekur nga korrupsioni në Kosovë, dhe përpjekja e qeverisë për luftimin e tij është tejet e paefektshme. Kosova vazhdon të krahasohet me shumicën e vendeve afrikane për nivelin e korrupsionit në sektorin publik, përderisa bashkë me Shqipërinë janë "kampionet" evropiane për korrupsion. Kosovën në vitin 2012 e renditi në vendin e 105-të në listën e shteteve më të korruptuara. Luftimi i dukurive negative të lartëpërmendura mund të arrihet nga bashkërendimi i veprimtarisë së: qytetarëve, subjekteve politike opozitare dhe lidhësive të ri, më përkrahjen e qartë të faktorit pozitiv ndërkombëtar. Pra, bashkimi dhe bashkërendimi i këtyre faktorëve, mund të japin rezultate duke konsoliduar integritetin e institucioneve dhe të procesit qeverisës. Duke filluar nga transparenca, nga ndryshimi i strukturës së vetëdijes dhe vlerave të votuesve, konsolidimi dhe respektimi i parimeve demokratike të procesit zgjedhor dhe i legjitimitetit të institucioneve. Pra, kthimin e efikasitetit e integritetit të institucioneve. Fuqizim të shoqërisë civile, mediave të pavarura, kritike e analitike. Përkrahja ndërkombëtare efikase përmes presioneve, por edhe përmes shpejtimit të procesit të integritetit e zhvillimit, është ma se e domosdoshme. Zhvillimi i qendrueshem ekonomik paraqet domosdoshmeri për demokraci, por ai nuk mund të arrihet pa qeverisje e institucione të përgjegjshme më efekte paraprake të sigurimit të rendit dhe ligjit.

Konsolidimi i Gjyqësorit më kuadro të guximshme dhe të pavarura nga politika e korruptuar është një hap para, por kërkohet mbështetje e të gjitha institucioneve dhe e

qytetarëve. Shefi i zyrës ndërlidhëse të Komisionit European në Kosovë, (Khaldun, 2012) në përfundim të mandatit, në një intervistë vlerësoi se: „Lufta kundër korrupsionit, reformimi i sistemit zgjedhor, reforma e administratës publike, zhvillimi ekonomik i vendit, janë disa nga kushtet që duhet t'i përmbushin institucionet, nëse deshirojnë që ta shpien vendin drejt integritit në BE”. Duke shtuar se: „përveç institucioneve që kanë obligim të luftojnë korrupsionin, duhet kujtuar se korrupsioni është problem edhe i shoqërisë dhe i mentalitetit.” Andaj, kërkohet ndryshime e angazhime të shumanshme në krijimin e vlerave, njohurive dhe qëndrimëve të votuesve; konsolidimi i subjektëve opozitare më lider dhe kuadro më integritet; presion dhe mbështetje nga shoqëria civile; përkrahje nga jashtë përmes politikave mbështetëse edhe përmes shpejtimit të integritimeve. Përkrahja ndërkombëtare është efikase dhe e domosdoshme, ngase përmes identifikimit të shkaqeve e faktorëve, informiomit, presioneve dhe përmes shpejtimit të procesit të integritit, mobilizon qytetarët dhe opozitën e mirëfilltë që të veproi kundër dukurive negative. Mundëson lindjen e forcave të reja opozitare dhe përkrahjen e tyre. Këto masa dhe procese, do jenë efikase në ndryshimin pozitiv të gjëndjes dhe fillimin e proceseve të reja reformuese.

Pra, Konsolidimi i Gjyqësorit më kuadro të guximshme dhe të pavarura nga politika, përkatësisht, të mbështetura nga politika e mirëfilltë, veçmas nga parlamenti dhe nga institucionet e ndjekjes, si dhe kërkim llogaria e rezultateve në luftimin e korrupsionit brenda gjyqësorit dhe në vetë institucionet e larta, krijon efikasitet, përgjegjësi e rezultate pozitive. Lufta kundër korrupsionit; reformimi dhe sigurimi i parimeve demokratike të procesit zgjedhor/ruajta dhe siguria e votës; reformat në administratën publike; reformat institucionale; plotësimi i legjislacionit; konsolidimi i zbatimit të ligjit; transparencë e fondeve publike; informimi i shpejtë dhe alternativ, i plotë dhe i drejtë i publikut; politika të qarta e vizionare ekonomike; bashkëpunim cilësor më Bashkësinë ndërkombëtare, etj, duhet të jenë disa nga prioritetet qeverisëse, për ta ndryshuar pozitivisht gjëndjen dhe qeverisjen aktuale.

### **Proceset integruese**

Proceset integruese në BE dhe ato globale po kërkojnë thellim të reformave dhe proceseve bashkëpunuese rajonale. Këto arrihen përmes angazhimit dhe veprimit të faktorit vendor dhe ati ndërkombëtar njëkohësisht. Këto janë procese esenciale të konsolidimit demokratik të institucioneve dhe qeverisjes, në funksion të zhvillimit ekonomik të ndërlidhur drejtëpersdrejti më cilësinë qeverisëse e institucionale. Në prizmin dhe frymën e bashkëpunimit rajonal duhet thelluar bashkëpunimin ndërfqinjësor dhe bashkëpunimin mbarëshqiptar në të gjitha sferat e sektoret, veçmas në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. Shoqëria dhe qeverisja e Kosovës dhe e Shqipërisë duhet të krijojnë parakushte infrastrukture fizike, juridike e politike, për procese bashkëpunuese intenzive, në pajtim më proceset e kërkuara të bashkëpunimit rajonal si domosdoshmëri paraprake për integritim europian. Ky bashkëpunim ndikon fuqishëm në zhvillim reciprok. Bashkëpunimi intenziv gjithëshqiptar në kuadër të procesit integrues rajonal, europian dhe global është i mundshëm, tejet i dobishëm dhe i domosdoshëm, dhe nuk do jetë në dëm të askujt, përkundrazi. Këto procese janë kyçe për zhvillimin ekonomik, sigurinë dhe cilësinë e jetës në Kosovë.

Nuk ka zhvillim të as një sfere, e integritim më vendet dhe organizatat rajonale e ndërkombëtare, pa kapacitete e cilësi qeverisëse e institucione të mirëfillta demokratike kosovare. Në rastin e Kosovës kjo është më se e domosdoshme në të gjitha proceset që

kaloi dhe që po kalon Kosova. Andaj, roli dhe ndikimi i cilësisë qeverisëse është esencial për procese zhvillimore të ndërlydhura më proceset integruese kombëtare, rajonale e globale. Shoqëria dhe politika kosovare gjithëherë duhet të jetë e vetëdijshme dhe e parapërgaditur që të krijoj parakushte për procese pozitive e të pashmangshme globale, për t'i tejkaluar pengesat e politikave dominuese negative në ballkan. Këto pengesa janë shumdimensionale, dhe u shprehen edhe kundër qeverisjes e institucionalizimit kosovar. Andaj, faktori kosovar duke i fuqizuar institucionet dhe qeverisjen cilësore, i tejkalon më se miri këto pengesa dhe se bashku më faktoret pozitiv ndërkombëtar, konsolidon pozitën integruese ndërkombëtare të shtetit të Kosovës. Edhe Bashkësia Ndërkombëtare, ndër kërkesat themelore për integrim po kërkon cilësi e efikasitet në qeverisje dhe institucionalizim e kulturë sa më demokratike. Qeverisja dhe rendi demokratik në Kosovë, reflekton siguri dhe paqë ndërkombëtare në këtë rajon dhe më gjerë.

Edhe pse kishte mangësi, vonesa, kontradikta, e dukuri negative nga jashtë, Kosova ka përfituar shumë nga përkrahja që i është dhënë prej BE-së, SHBA-së e shteteve tjera dhe nga Organizatat ndërkombëtare. Ka përfituar asistencë të konsiderueshme gjithëpërfshirëse të drejtëpërdrejtë qeverisëse, institucionale e juridike, si dhe financiare. Përmbyllja e Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim, do të kontribuon për hapjen e shoqërisë kosovare. Por, askush nuk duhet të ketë iluzione se rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në BE është e lehtë. Kushtet për anëtarësim janë përcaktuar nga Këshilli Evropian. Vendet kandidatë, pra edhe Kosova, duhet të ndjekin vlerat e përbashkëta të vendosura në Traktatin e Unionit dhe ato kërkohet që të kenë arritur stabilitet të institucioneve dhe qeverisjes demokratike dhe ekzistim të një ekonomie konkurrenente të tregut, të miratojnë dhe implementojnë tërësi ligjeve e standarteve të BE-së, të ashtuquajturin "Acquis Communautaire". Ky është një proces i gjatë dhe i vështirë. Derisa BE-ja do të vazhdojë me sigurimin e çdo lloj asistence, rezultatet varen nga vetë Kosova, nga lidhshipti i saj dhe qytetarët, se sa shpejt mund të përmbushen kriteret për anëtarësim. Për Kosovën do të ishte me rëndësi vitale që të jetë në proces të integritimit dhe e integruar në BE. Kjo sfidë i takon procesit qeverisëse e institucional kosovar.

### **Çështja e veriut dhe marrëdhëniet me Serbinë**

Pjesa veriore e pintegruar, është realitet i krijuar qëllimisht dhe artificialisht, qysh nga ndërhyrja ushtarake e politike e Bashkësisë Ndërkombëtare, i "arsyetuar" më sigurinë e pakicës serbe. Kjo argumentohet më vendimmarrjet që nga ndërhyrja dhe deri më politikatat e gjertanishme. Në Konferencën Ndërkombëtare „Gërmia Hill” në Prishtinë (2012), ish- Administratori i parë i Kosovës, francezi Bernard Kushner, pranon se "gabimi më i madh ishte ndalesa tek lumi Iber. Territori i Kosovës ishte mbi malet e jo mbi lumin. Kjo ndoshta nuk ishte zgjidhje e drejtë por kjo është jeta." Por, tani ai mendon, "se ka kapësirë që të negociohet për një autonomi substanciale për këtë pjesë, siç është bërë që nga fillimi i krizës dhe ashtu siç është definuar edhe nga komuniteti ndërkombëtar përmes planit të Ahtisarit." Ai theksoi se kjo autonomi e qeverisjes lokale nuk nënkupton autonomi substanciale politike që do ta damtonte sovranitetin dhe integritetin e shtetit të Kosovës. Por, tani pas të gjitha këtyre proceseve, çështja është si të integrohet kjo pjesë. Politika e Serbisë si gjithëherë e edhe sot, po manipulon më ndarje mbi baza etnike të komunitetit serb në këtë rajon. Qëllimet e saj ishin dhe ende janë, pengimi i funksionalitetit shtetror të Kosovës. Pas shpalljes së pavarësisë, kishte pretendime edhe të ndarjes, nëse lejon Bashkësia ndërkombëtare. Por, Bashkësia ndërkombëtare përkrahu vetëvendosjen teritoriale sipas kufijve egzistues të njësive federative, e jo në baza etnike.

Tani në proces të Bisedimeve më Serbinë dhe ndërmjetësimin e Bashkësisë ndërkombëtare-Komisionit European-së në Bruksel, zgjidhjet juridike të Planit të Ahtisarit të përfshira në tërësi në Kushtetutën dhe sistemin politik e juridik funksional të Kosovës, si dhe integrimi i suksesshem i pakices serbe (pos veriut), janë argumente të patejkalueshme dhe praktika të suksesëshme për zgjidhjen e problemeve të veriut, përkatësishtë, integrimin e tij. Edhe qendrimet ndërkombëtare janë të qarta, se nuk ka ndryshim kufijsh në baza etnike. Andaj, roli destruktiv i Serbisë në institucionalizimin e qeverisjes kosovare në këtë pjesë gjithnjë po amortizohet. Plani i Ahtisarit, Kushtetuta e Kosovës dhe integrimi i pakices serbe në pjesët tjera të Republikës së Kosovës, janë fakte që tregojnë garantimin dhe zgjidhjet më të avancuara në rajon për të drejtat e Komunitetit serb në pushtetin lokal dhe qendror, më standarte më të theksuara demokratike. Këto janë argumente të mjaftueshme dhe të fuqishme për integrimin e kësaj bashkësie etnike të veriut; për funksionimin e suksesshem të një formë të fortë të qeverisjes lokale të decentralizuar në Kosovën e pavarur.

Plani i Ahtisarit siguron një kornizë për një demokraci funksionale multietnike dhe shtetin kosovar e përcakton shtet të komunitetëve edhe pse të gjitha pakicat përbëjnë rreth 8% të popullsisë. Të gjitha këto janë të inkorporuara edhe në Kushtetutën e Kosovës dhe në zbatim të plotë në praktikën qeverisëse në pushtetin qendror dhe atë lokal. Diplomati Rohan, A (2012), si zavëndes i Ahtisarit në bisedimet e Vjenës për caktimin e statusit të Kosovës, më hapjen e Bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, në kontekst të veriut thot se: „Plani i Ahtisarit përmban autonominë substanciale për serbet e veriut të Kosovës.” Andaj, çdo largim nga ky Plan, krijon komplikime në sistemin politik e juridik të Republikës së Kosovës” thekson ai. Këtë e kanë kuptuar të gjitha palët. Edhe Republika e Serbisë e detyruar nga nevojat e brendshme dhe integruese, ka filluar të ndryshoj qasjen ndaj Kosovës dhe veriut. Fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes demokratike kosovare në të gjitha nivelet, do të ndikon në integrimin cilësor të këti komuniteti dhe territori.

Thelbi i rezultatëve të bisedimeve për veriun, në frymën e normalizimit të marrëdhënieve Kosovë –Serbi, më ndërmjetësimin e Komisionit Evropian –Bruksel (19 prill 2013), shihet në Marrëveshjen e 15 pikave, e nënshkruar nga kryeministrat: Thaçi dhe Daçiç:

1: *“Bashkësi/Asociacion” të Komunave me shumicë serbe në Kosovë, e hapur edhe ndaj komunave të tjera, nëse anëtarët pajtohen.*

2: *“Bashkësia/Asociacioni” do të formohet me statut.*

3: *Strukturat do të formohen sipas të njëjtës bazë sikur edhe rajonet ekzistuese në Kosovë.*

4: *Kompetencat do të jenë sipas Kartës europiane të vetëqeverisjes lokale dhe sipas ligjeve të Kosovës.*

5: *“Bashkësia/Asociacioni” do të ushtrojë kompetenca shtesë ashtu siç i jep autoriteti qendror.*

6: *“Bashkësia/Asociacioni” do të ketë një rol përfaqësues në autoritetin qendror dhe do të ketë një ulëse në Këshillin konsultativ të komuniteteve.*

7: *Në Kosovë do të ketë vetëm një forcë policore, e cila do të quhet “Policia e Kosovës”. E gjithë policia në veri të Kosovës do të integrohet në kuadër të Policisë së Kosovës. Pagat do të jepen vetëm nga Policia e Kosovës.*

8: *Anëtarëve të strukturave të tjera serbe të sigurisë do t’u ofrohen pozita përkatëse në strukturat e Kosovës.*

Kjo marrëveshje përcakton qartë formën e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës, e përcaktuar që: „Kompetencat do jenë sipas Konventës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale” (pika 4). Asociacioni i Komunave Serbe në veri, sipas Marrëveshjes



së arritur Kosovë-Serbi: „do të ushtrojë kompetenca shtesë ashtu siç i jep autoriteti qendror.” (pika 5).

Qeverisja lokale si formë e decentralizimit paraqet njërin ndër parimet më esenciale e të domosdoshme të qeverisjes dhe institucioneve demokratike. Në Kosovë kjo është e tillë dhe më e avancuara në rajon. Vetëqeverisja lokale dhe decentralizimi në Kosovë, njësi bazë ka komunat, të cilat gëzojnë një shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe po sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në jetën qeverisese sipas kompetencave dhe të drejtave për financim vetanak dhe nga autoritetët qendrorë. Komunat po gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale dhe po sigurojnë pjesëmarrje e nevoja të të gjithë qytetarëve. Kushtetuta e Kosovës (Kap-X, Neni 123, p.4) përcakton: „Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.”

Komunat kanë të drejtë për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar në fushat e kompetencave të tyre vetjake dhe të zgjeruara. Kjo përkufizohet edhe në Kapitullin e X të nenit 124 në pikat 3-7 të Kushtetutës:

*3. Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.*

*4. Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.*

*5. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.*

*6. Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.*

*7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin.*

Qeverisja komunale paraqet avancim të qeverisjes demokratike sipas standardeve e praktikave Europiane të qeverisjes lokale. Kapitulli i X i Kushtetutës së Kosovës në nenin 23 thekson: „Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.” Kjo është kërkesë nga të gjithë qytetarët dhe komunitetët etnike të Republikës së Kosovës, për zhvillim e prosperitet për të gjithë. Kjo zgjidhje juridike po realizohet më sukses, ngase: „Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në afrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.” (Kap.-X, Neni 123, p.4.).

Për të realizuar të gjitha këto të drejta dhe qëllime për interesin lokal, janë rregulluar e funksionalizuar edhe Kompetencat komunale të parapara me Kushtetutë. Psh. në Kapitullin X Neni 3. p.1 parashih këto kompetenca komunave:

*”a. Zhvillimi lokal ekonomik; b. Planifikimi urban dhe rural; c. Përdorimi dhe zhvillimi i tokës; d. Implementimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve të kontrollit të ndërtimit; e. Mbrojtja lokale e mjedisit; f. Afrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transportin lokal dhe skemat e ngrohjes lokale;”*

Autoritetet qendrore në Kosovë delegojnë përgjegjësi tek komunat si Kompetenca të deleguara komunale vijuese: „a. Regjistrat kadastror; b. Regjistrat civilë; c. Regjistrimi i

votuesve; d. Regjistrimi dhe licencimi i bizneseve; e. Shpërndarja e pagesave të ndihmës sociale (duke përfshirë pensionet) dhe f. Mbrojtjen e pyjeve.” (Neni 5.p.2,Kap-X).

Aktivitetet komunale në fushat e kompetencave të tyre vetjake përkufizohen në sigurimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjin në fuqi. Kjo bëhet nga ana e shqyrtimit administrativ të akteve komunale siq i parasheh Neni 6. i Kapitullit X i Kushtetutës:

*Autoriteti mbikëqyrës administrativ mund të kërkojë nga komuna që të rishqyrtojë vendimet apo aktet tjera ligjore që konsiderohen se janë në mospërputhje me Kushtetutën apo ligjet e miratuara në pajtim me këtë zgjidhje...autoriteti mbikëqyrës administrativ mund të kundërshtojë vendimin apo aktin tjetër ligjor në gjykatën e qarkut kompetente për territorin e komunës. Gjykata e qarkut, si masë të përkohshme, mund të urdhërojë pezullimin e zbatimit të vendimit të kontestuar apo aktit tjetër ligjor...autoritetet qendrore mund të shqyrtojnë përshtatshmërinë e vendimit komunal të dhënë apo të aktit tjetër, krahas pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën e Kosovës dhe legjisllacionin e miratuar në pajtim me këtë zgjidhje dhe, së këndejmi, mund të pezullojnë, modifikojnë apo zëvendësojnë, sipas nevojës, ekzekutimin e vendimit komunal.*

Vetëqeverisja lokale komunale po i kryen më sukses funksionet e veta në të gjitha komunat e edhe në ato më shumicë serbe në pjeset tjera të Kosovës, pra pos veriut. Edhe Asociacioni i Komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës, nuk ka asnjë arsye që të mos funksionoi sikurse në komunat tjera. Asociacioni komunal i veriut do të themelohet në funksion të këti zbatimi kushtetues e ligjor të qeverisjes lokale dhe sipas kompetencave të nivelit qendror. Andaj, sipas marrëveshjeve dhe pas të gjitha këtyre proceseve e sukseseve në institucionalizim dhe konsolidimi juridik, tani çështja është si të integrohet sa më shpejtë dhe sukseshem kjo pjesë dhe të qeveriset e institucionalizohet sipas Kushtetutës dhe ligjeve kosovare- qeverisjes qendrore dhe qeverisjes lokale komunale mjaftë të avancuara dhe sipas Kartës europiane të vetëqeverisjes lokale, dhe më e avancuara në rajon. Kushtetuta dhe rendi juridik e politik i Kosovës është shtet unik me qeverisje lokale komunale mjaftë të avancuar e funksionale dhe më përfaqësim e vendimmarrje përbajtësore në nivelin qendror të komunitetëve pakicë. Andaj, nuk ka asnjë arsye për asnjë formë destruktive e enklavizuese, që do ta damtonte multiethnicitetin dhe përcaktimet demokratike të qeverisjes kosovare.

## Përfundim

Shoqëria kosovare dhe Republika e Kosovës ka nevoj për zhvillim e integrim. Kjo arrihet përmes qeverisjes dhe institucioneve demokratike efektive, si instrument zhvillimi përmes politikave zhvillimore liberale dhe proceseve integruese. Proceset globale në rajonin e ballkanit dhe veprimtaria kosovare, krijuan rrethana për formën dhe përbajtjen qeverisëse e institucionale në Kosovë, të ndërlydhura më procesin e vetëvendosjes. Procesi i qeverisjes dhe i institucionalizimit në Kosovë 1999-2013, u ballafaqu më pengesa serioze të jashtme dhe vendore. Pavarësia e Kosovës dhe aspekti juridik e institucional përkatës, krijuan parakushte për qeverisje e institucione vetanake me rezultate e stabilitet rajonal, por më cilësi e efekte ende jo të kënaqshme sipas nevojave dhe standarteve demokratike; sipas përcaktimeve qëllimore kushtetuese e ligjore. Gjëndja e rëndë ekonomike, papunësia, varfëria, tradita paraprake në qeverisje, dukuritë negative brenda institucioneve, përkrahja e pamjaftueshme nga jashtë,etj, u reflektohen në cilësinë qeverisëse e institucionale. Njëherit, edhe kjo mungesë e cilësisë po e rigjeneron gjendjen e rëndë dhe nuk po kontribuon në tejkalimin e saj.

Shoqëria kosovare duhet të angazhohet më shumë në krijimin e vlerave të reja, ndryshimin

e sjelljeve e subjekteve politike dhe gjetjen e lidërshiptit sa më të përshtatshëm, për të kriju efektive zhvillimore në të gjitha sferat. Për të konsolidu institucione e qeverisje më të përgjegjshme, më llogaridhënëse, më efikase, të hapura, profesionale, etj. për tejkalimin e gjendjes së rëndë momentale në qeverisje dhe në zhvillim. Sfidë mbetet përmirësimi i luftimit të korrupsionit dhe dukurive tjera negative në institucione, harmonizim të legjislacionit dhe avancim të procesit integruar në BE, në funksion të zhvillimit. Respektimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në procesin e qeverisjes është esenca e qeverisjes demokratike. Thellimi i respektimit të ndarjes (autonomisë) së pushtetëve dhe kontrollit reciprok. Fuqizimi i gjyqësorit dhe i rolit e funksioneve të parlamentit në raport më të gjitha institucionet tjera, për ngritjen e cilësisë. Konsolidimi i parimeve demokratike të procesit zgjedhor në Kosovë, është themeli i qeverisjes dhe institucioneve demokratike. Në veçanti fuqizimi i shoqërisë civile dhe mediave të pavarura. Të gjitha këto masa janë të domosdoshme dhe urgjente për ta përmirësuar cilësinë e procesit qeverisës, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shndërrimin e tij në zhvillim të të gjitha sferave tjera.

### Lista e Referencave

- Armitage, J. (Nëndor/2012), "Gjyqësori dhe korrupsioni pengojnë ekonominë", *Gazeta: Kosova sot*, fq.6
- Banka Botrore, (18 Dhjetor 2012), "Raporti ekonomik për EJT", Telegrafi.
- Bernard, K., (nëndor 2012): *Konferencë ndërkombëtare, Gërmia hili*, "Çështja e veriut", *Gaz: Koha ditore*, f.3.
- Barometri Global i Korrupsionit (korrik 2013): "Gjyqësia, sektori më i korruptuar", *Gaz: Kosova sot* 9.07.2013.
- European Commission, (2011), "Kosovo 2011 Progress Report", Brussels.
- European Commission, (2012), "Kosovo 2012 Progress Report", Brussels.
- European Commission, (2013), "Kosovo 2013 Progress Report", Brussels.
- Deklarata e Pavarësisë, (17 shkurt 2008), *Kuvendi i Kosovës, Prishtinë*.
- Konferenca Rambujesë 1999, Francë.
- Korniza kushtetuese për qeverisje të përkohshme, (maj 2001), Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Prishtinë.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008. *Kuvendi i Kosovës, Prishtinë*.
- Komisioni Evropian-Bruksel, (19 prill 2013) "Marreveshja më 15 pika për Asociacionin e komunave": <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,143112> (shiquar më 01.03.214).
- Informimi Demokratik i Kosovës (ang.KDI), (2013), Raport monitorues: *Mbi 10 vjet parlamentarizem në Kosovë*, *Gaz: Koha ditore* 04.08.13, f.2.
- Komisioni Evropian-Bruksel, (10 tetor 2012): "Studimi i fisibilitetit të marrëveshjes së stabilizim-asocimit, në mes të BE dhe Kosovës" *Gazeta Koha ditore*, f.1.
- Komisineri Stefan Fule (10 tetor 2012), "MSA për Kosovën", *Gaz. Koha ditore*, f.2.
- Khaldun, S. (Gusht/2012), "Korrupsioni-problemi i institucioneve dhe i shoqërisë", *Koha ditore*, fq.2.
- Grupi i Kontaktit, (9 nëntor 2005), Nju Jork: *Gjashtë parimet mbi zgjidhjen e problemit të Kosovës*: <http://www.bing.com/search?q=Grupi+i+kontaktit+gjasht%C3%AB+parimet+e+zgjidhjes+se+pr oblemit+t%C3%kosoves>
- Grupi Ndërkombëtar Drejtues, (10 shtator 2012), "Përfundimi i mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë" *Kosova sot*, f.1.
- Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë-Hagë (23 korrik 2010), "Opinion i GjND mbi pavarësinë", *Gaz. Koha ditore*, f.2.
- Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr.1244, (1999).
- Rohan, A. (Tetor/2012), "Plani i Ahtisarit përmbanë autonominë e serbëve", intervistë, *Koha ditore*, fq.1.

- Novicki M.A.(2004),”*Raporti i Katërt Vjetor*” i Ombudspersonit në Kosovë, Prishtinë:Iliri, f. 15.
- Fondi Monetar Ndërkombëtar,(4 janar 2013),*Rritja ekonomike 2012*, Bruksel, Telegrafi, f.1.
- Organizata Europiane e Gjyqësisë,(25/qershor/2013),”*Korrupsioni largon investoret nga Kosova*”, Gazeta: Kosova sot,1).
- Organizata e Kombeve të Bashkuara, Dokumenti S /1999/699 (2 qershor 1999).
- Plani i Ahtisarit, (mars 2007),”*Propozim Gjithëpërfshirës për Vendosjen e Statusit të Kosovës 2007*”.
- Rohan,A.(24 tetor/2012), ”*Plani i Ahtisarit përmbanë autonominë e serbëve*”, intervistë,Koha ditore, fq.1.
- Statement by the NATO Secretary General’(Mars 23,1999):(në internet:<http://www.nato.com>) shiq. nandor2013.
- Sekretari i përgjithshëm i OKB-së,(nandor-2012), *Raporti tre mujor për Kosovën*,Gaz:Kosova sot,f.1.
- Stefan Fule (10 tetor2012),” *MSA për Kosovën*”, Gaz:Koha ditore,f.2.
- Freedom House, (9 dhjetor 2012),”*Raportet mbi Kosovën*”, Gazeta: Kosova sot, f.2.

## Procesi i rregullt ligjor dhe kuptimi i tij

Phd Kandidat Agron Bajri  
UET

### Abstrakt

Procesi i rregullt ligjor dhe kuptimi i tij përcaktohen në përmbajtjen e këtij punimi në mënyrë të detajuar. Kur flitet për procesin e rregullt ligjor analizojmë të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të procedimit penal, mënyrën e sjelljes së tyre dhe raportin e këtyre subjekteve me institucionet shtetërore. Sipas nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut përcaktohet se çdokush ka të drejtën e një seance të drejtë gjyqësore.

Ky përcaktim përfshin shume aspekte të procesit të duhur të së drejtës, si e drejta për akses në gjykatë, e drejta për një seancë në praninë e të akuzuarit, e drejta për të mos kontribuar në vetë-inkriminim, barazia në mjete, e drejta për seanca gjyqësore në bazë të parimit të kontradiktoritetit dhe para së gjithash e drejta për një gjykim të arsyeshëm.

Detyra e gjyqtarit është të sigurojë që të gjitha palët në një mosmarrëveshje të kenë një “seance të drejtë gjyqësore”.

Është Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut që garanton këtë të drejtë e cila sanksionohet si e tillë në Kushtetutën, e RSh-së dhe në parashikimet proceduriale.

Shteti normon sjelljen e individëve me anë të ligjeve dhe akteve të tjera të nxjerra në zbatim të tyre. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur se cilido person ka të drejtën për të bërë çdo lloj pretendimi para organeve proceduese në lidhje me të drejtat e tij.

E drejta për një proces të rregullt ligjor përfaqëson një të drejtë kushtetuese të individëve, nëpërmjet të cilit ata kërkojnë realizimin e procedurave të drejta dhe të ndershme ligjore.

Nga njëra anë kjo e drejtë kushtetuese paraqitet si një garanci për shtetasit kundër veprimeve të padrejta të organeve të pushtetit shtetëror dhe, nga ana tjetër, ajo përbën një detyrim për këto të fundit që të mos cenojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve pa ua siguruar respektimin e procedurave të rregullta ligjore.

**Fjalët kyçe:** *Procesi i rregullt ligjor, të drejtat e njeriut, seancë e drejtë gjyqësore, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të procedimit penal.*

### Kuptimi i procesit të rregullt ligjor

Konventa Europiane e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe e Lirive Themelore në nenin 6 të saj, të titulluar “E drejta për një proces të rregullt ligjor”, ka sanksionuar të drejtën e shtetasve për t’u dëgjuar drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj - si një nga të drejtat themelore të shtetasve.

Në nenin 6 të Konventës janë përfshirë, gjithashtu, edhe parimi i prezumimit të pafajësisë për të akuzuarit, derisa fajësia e tyre të vërtetohet plotësisht me vendim gjykate, si dhe disa të drejta të rëndësishme të të akuzuarit që lidhen me procedimin penal ndaj tij.

Gjyqësori dhe, në fund të fundit, vetëm gjyqësori mund të përcaktojë përfundimisht kush del fitimtar në konfliktin e pashmangshëm ndërmjet individëve; ndërmjet qeverisë dhe

të qeverisurve, duke përfshirë edhe ata që akuzohen nga shteti se kanë shkelur ligjin; ndërmjet individëve dhe shoqërive dhe ndërmjet organizatave, si publike ashtu edhe private.

Atmosfera që rrethon gjykatat dhe ngjarjet në gjykata është formale dhe e pazakontë për shkak se gjykatat janë unike. Ato zgjidhin konflikte duke zbatuar ligjin mbi faktet e çështjeve të veçanta, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

Kur ligji zbatohet mbi faktet që sillen në gjykatë, çdo palë ka të drejtën absolute për të pasur një arbitër që është i pavarur nga palët e asaj çështjeje dhe avokatët e tyre.

Proceset gjyqësore duhet të reflektojnë qëllimet e gjykatës, siç janë drejtësia individuale në çështje gjyqësore individuale, dukshmëria e drejtësisë individuale në çështjet gjyqësore individuale, si dhe mbrojtja e individëve ndaj përdorimit arbitrar të pushtetit qeverisës.

Çështjeve gjyqësore individuale duhet t'u jepet vëmendje individuale. Ligji duhet të zbatohet drejt për çdo çështje. Pavarësisht nga statusi ekonomik, për të gjithë duhet të ekzistojë qasje e barabartë në gjykatë. Çdokush që vjen në gjykatë dhe para saj duhet të trajtohet me dinjitet, respekt, drejtësi dhe në mënyrë të barabartë. Proceset gjyqësore dhe zbatimi i ligjit mbi faktet në çështjet individuale duhet të jenë të qëndrueshme dhe të parashikueshme.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë kjo e drejtë përmendet në mënyrë specifike në dy nene të saj. Neni 42 e rendit atë krahas të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, ndërsa neni 131 shkronja "f" e përcakton si një çështje juridiksioni për Gjykatën Kushtetuese.

Në të dy dispozitat ky parim i rëndësishëm shfaqet si një garanci kushtetuese për individët ndaj çdo privimi që mund t'u bëhen të drejtave të tyre themelore nga shteti nëpërmjet organeve të tij vendimmarrëse.

Neni 42 i Kushtetutës sanksionon mbrojtjen e të gjitha të drejtave të njohura në Kushtetutë dhe me ligj, duke veçuar si të drejta kryesore lirinë, të drejtën e pronës, si dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë duket se nuk mban të njëjtin qëndrim ndaj të drejtave.

Ka të drejta që mund të kufizohen, ashtu siç ka disa të drejta të tjera, për të cilat kufizimi është i papranueshëm për çdo rast.

Nëse e vështrojmë me kujdes nenin 42 pika 1, do të na rezultojë se liria, prona apo të drejta të tjera të njohura me Kushtetutë mund të kufizohen, mjafton që procesi ligjor të jetë i rregullt. Shprehja e përdorur në këtë dispozitë se "*nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*", e nënkupton se kushti i vetëm për të mos u prekur këto të drejta është respektimi i procesit ligjor. Por në qoftë se procesi ligjor respektohet me përpikëri, që do të thotë se zbatohet kushti i domosdoshëm i pikës 1 të nenit 42, atëherë ndaj lirisë, pronës ose të drejtave të tjera, mund të lejohet ushtrimi i kufizimeve kushtetuese.

Është e parashikuar në nenin 27 të Kushtetutës se *Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.*

Në nenin 41 lejohet shpronësimi ose kufizimi në ushtrimin e të drejtës së pronës vetëm për interesa publike. Ka edhe të drejta të tjera në Kushtetutë që mund të kufizohen për arsye të përligjura, të cilat njihen si kufizime kushtetuese.

E drejta për një proces të rregullt ligjor përmendet gjithashtu edhe në nenin 131 shkronja "f" të Kushtetues si një ndër kompetencat e kufizuara të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me të

drejtën e saj për të shqyrtuar ankesat e individëve. Në dallim nga dispozitat e mëparshme kushtetuese që lejonin Gjykatën Kushtetuese të zgjidhte përfundimisht ankesat e personave të paraqitura në rrugën e kontrollit kushtetues për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme, neni 131 shkronja “f” paraqitet më i kufizuar.

Në të thuhet :“Gjykata Kushtetuese vendos për ... gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”.

Po t’i referohemi nenit 6 të KEDNJ-së, do të gjejmë një kuptim më të gjerë në formulimin e tij. Në këtë nen përfshihen, e drejta për t’u dëgjuar, e drejta e një gjykimi të drejtë, procesi i hapur publik, zhvillimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës, parimi i prezumimit të pafajësisë, e drejta e të akuzuarve për tu informuar brenda një afati sa më të shkurtër dhe në gjuhën e tij për akuzën, e drejta e tij për tu mbrojtur, e drejta të bëjë pyetje dhe të kërkojë thirrjen e dëshmitarëve, të ndihmohet falas nga një përkthyes kur nuk kupton gjuhën e përdorur etj.

Për aq sa ka thënë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë për procesin e rregullt ligjor, dalin dy momente thelbësore:

*së pari* : shtetasit duhet t’i jenë cenuar liria, prona dhe të drejtat kushtetuese e ligjore;

*së dyti* : cenimi i tyre duhet të ketë ndodhur pa u realizuar një proces i rregullt ligjor.

Të kuptuarit e kësaj dispozite vështirësohet, pasi nuk jepet ndonjë përkufizim për procesin e rregullt ligjor. Atë që nuk e jep Kushtetuta, është përpjekur ta zgjidhë praktika e Gjykatës Kushtetuese, e cila është orientuar kryesisht nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe e disa gjykatave të tjera kushtetuese evropiane. Gjykata Kushtetuese është përpjekur në praktikën e saj gjyqësore të bëjë një dallim thelbësor të rolit të saj si autoritet që garanton respektimin e Kushtetutës, nga funksioni i dhënies së drejtësisë që mbetet atribut i organeve të pushtetit gjyqësor. Prirja për ta orientuar Gjykatën Kushtetuese në një pozicion që të mos konfondohej me shkallët e tjera të gjykimit, por të nxjerrë në pah nga kontrolli i kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore vetëm problemet esenciale që prekin procesin e rregullt ligjor, ndjehet vazhdimisht në praktikën e saj.

*E drejta për një seancë të drejtë e të ndershme* përfshin të gjitha procedurat dhe garancitë dhe qëndron në thelb të konceptit për gjykim të drejtë. E drejta për një shqyrtim të drejtë në gjykimet penale specifikohet nga një numër i të drejtave konkrete, si e drejta për t’u konsideruar i pafajshëm, e drejta për t’u gjykuar pa vonesë të panevojshme, e drejta për të përgatitur mbrojtjen, e drejta për tu mbrojtur vet ose përmes avokatit, e drejta për të thirrur dëshmitarë etj.

*E drejta për seancë publike* shtë garanci thelbësore e ndershmerisë, e drejtësisë dhe e pavarësisë së procesit gjyqësor, si dhe një mënyrë e mbrojtjes së besimit publik në sistemin e drejtësisë. Përveçse në rrethana të përcaktuara ngushtë, të gjitha seancat dhe gjykimet duhet të jenë publike. E drejta për seancë publike do të thotë që jo vetëm palët në proces, por, gjithashtu, edhe publiku në përgjithësi kanë të drejtën të jenë të pranishëm. Publiku ka të drejtën të dijë si administrohet drejtësia dhe çfarë vendimesh merren nga sistemi gjyqësor. E drejta për seancë të hapur mbështetet te prania e vëzhguesve. E drejta e vëzhguesve gjyqësor për të ndjekur seancat publike si dhe për të formuar opinion mbi pajtueshmërinë e tyre me ligjin dhe me detyrimet e angazhimet ndërkombëtare, përfshihet si një e drejtë në legjisllacionin ndërkombëtar dhe në atë vendas.

## **E drejta për te mos kontribuar ne vete-inkriminim (Agaj, 2012).**

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur se e drejta për seance te drejte gjyqësore ne çështjet penale përfshin “te drejtën e gjithsecilit te akuzuar për një kundërvajtje penale. . . te mos flasë dhe të mos kontribuojë në vetë-inkriminim e tij”.

Në çështjen e *Saunders kundër Mbreterisë së Bashkuar*, Gjykata deklaroi se Gjykata kujton se megjithëse jo specifikisht është përmendur ne Nenin 6 te Konventës, e drejta për te mos folur dhe e drejta për te mos u vetë-inkriminuar janë zakonisht standarde te njohura ndërkombëtare qe qëndrojnë ne thelbin e nocionit te një procedure te drejte sipas Nenit 6. Parimi i tyre bazë, ndërmjet të tjerave qëndron ne mbrojtjen e te akuzuarit kundrejt detyrimit te padrejtë nga autoritetet për të folur, duke kontribuar në shmangien e gabimeve te drejtësisë dhe ne përmbushjen e synimeve që parashikon neni 6 i KEDNJ-së.

E drejta për te mos inkriminuar vetveten në veçanti presupozon që seancat gjyqësore në një çështje penale të jenë të tilla që të realizohet provueshmëria e akuzës kundër te pandehurit pa u mbështetur ne provat e përfuara nëpërmjet metodave te detyrimit apo dominimit.

Ajo çfarë i kushtohet rëndësi është mbrojtja e vullnetit të të akuzuarit. Në këtë kuptim e drejta është e lidhur ngushtë me prezumimin e pafajësisë ne përmbajtje te Nenit 6 (2) te Konventës. Po i njëjti arsyetim është pasqyruar dhe në parashikimet proceduriale sipas të cilave përcaktohet se kur para autoritetit procedues një person që nuk është marrë si i pandehur, bën deklarime nga të cilat dalin të dhëna për inkriminim në ngarkim të tij, autoriteti procedues ndërpret pyetjen, duke e paralajmëruar se pas këtyre deklarimeve mund të zhvillohen hetime ndaj tij dhe e fton të caktojë një mbrojtës. Deklarimet e mëparëshme nuk mundet të shfrytëzohen kundër personit që i ka bërë.

E drejta për te mos kontribuar ne vete-inkriminim ka lidhje kryesisht me respektimin e vullnetit të një të akuzuari për të mos folur.

Siç kuptohet përgjithësisht ne sistemet ligjore te Palëve Kontraktuese te Konventës dhe ne vende te tjera, kjo e drejte nuk shtrihet ne përdorim ne proceset gjyqësore te materialeve qe mund te përftohesh nga i akuzuari nëpërmjet përdorimit te kompetencave detyruese, por qe kane një ekzistence te pavarur nga vullneti i te dyshuarit si për shembull, midis te tjerash, dokumente qe janë marre ne baze te një mandati (TDNJE, 2001).

Kjo çështje kishte te bënte me një drejtor kompanie te cilit iu kërkua me ligj qe tu përgjigjej pyetjeve te bëra nga autoritetet qeveritare ne lidhje me dhënien e informacionit për veprimtaritë e biznesit te kompanisë qe iu nënshtua sanksioneve penale. Te dhënat e intervistës u pranuan më vonë si prova kundërtij në një gjyq ku ai u dënua. Gjykata e konsideroi këtë si shkelje te Nenit 6 të KEDNJ-së.

Megjithatë Gjykata ka zgjedhur një pikëpamje tjetër përse i përket rregullave qe lejojnë tërheqjen e formave te ndërhyrjeve te kundërta nga heshtja e një te akuzuari gjate marrjes ne pyetje ose gjykimit.

Gjykata u shpreh ne çështjen e *John Murray kundër Mbreterise se Bashkuar* se “e drejta për te qëndruar ne heshtje” nuk është një e drejte absolute. Megjithëse është ne kundërshtim me këtë imunitet për te bazuar një dënim vetëm ose kryesisht nga heshtja e te akuzuarit ose nga refuzimi i tij për t’iu përgjigjur pyetjeve, është e qarte se ky privilegj nuk parandalon qe te merret parasysh heshtja e te akuzuarit qe është e qarte se ka nevojë për te dhënë



shpjegime. Gjykata konstatoi ne këtë çështje se legjislacioni i zbatuar nuk shkelte Nenin 6 të KEDNJ-së.

Kërkuuesi nuk i ishte nënshtruar detyrimit të drejtëpërdrejtë, ku as nuk ishte gjobitur, as paralajmëruar me burgim. Gjykata me tej konstatoi se përdorimi i ndërhyrjeve ishte një shprehje e implikimit që nënkuptohet kur një i akuzuar dështon që të japë një shpjegim pafajësie për veprimet ose sjelljen e tij. Kishte mjaft garanci që përputheshin me gjykimin e drejte dhe barra e përgjithshme e provës i mbetej prokurorit i cili duhej të përcaktonte çështjen *prima facie* përpara se të merrej parasysh ndërhyrja (Agaj, 2012).

Gjykata megjithatë u shpreh në çështjen e *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* se juria duhej të drejtohej në mënyrën e duhur nga gjyqtari i gjyqit kur merr vendime nëse duhet apo jo të nënkuptohet si 'pohim' heshtja e të akuzuarit me qellim që të mos përbejë shkelje të Nenit 6 të KEDNJ-së.

### **Barazia në mjete dhe e drejta për t'u vënë në dijeni për faktet e argumentet e palës kundërshtare dhe anasjelltas (KE, 2004).**

Kjo nënkupton se çdokush që është palë në procesin penal duhet të këtë mundësi të barabarte që të paraqesë çështjen e vet dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit. Është e detyrueshme të përcaktohet një ekuilibër i drejte midis palëve.

E drejta përnjë seance të drejte përfshin gjithashtu edhe, nocionin se të dy palët në një proces kanë të drejte të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë për palët në një seance penale që të kenë njohuri edhe mbi komentet mbi provat e nxjerra ose hetime të arkivuara.

Në këtë kuptim një rëndësi e veçantë duhet ti jepet shfaqjes së ushtrimit të drejte të drejtësisë.

Këto parime zbatohen si për procesin penal ashtu edhe në procesin civil (KE, 2004).

Në çështjet penale ato mbivendosen me disa garanci të veçanta të Nenit 6 (3) i KEDNJ-së, por nuk kufizohen me ato aspekte të procedimeve. Për shembull, Gjykata e Strasburgut në çështjen e *Bonisch kundër Austrisë ka mbajtur qëndrimin sipas të cilit*, kur një eksperti apo dëshmitari të caktuar nga mbrojtja nuk i jepet lehtësia e njëjte si atij të caktuar nga prokurori, atëherë kemi shkelje të Nenit 6 (1) i KEDNJ-së.

Me pas në një çështje tjetër dhe konkretisht në çështjen *Jespers kundër Belgjikës është arsyetuar se* parimi i barazisë në mjete i interpretuar se bashku me Nenin 6 (3) imponon një detyrim mbi autoritetet gjyqësorë e hetuese për të nxjerre ndonjë material që është në zotërim të tyre, ose për të cilat ata mund të marrin akses, që mund të asistojnë të akuzuarin për të dhënë prova pafajësie ose për të marrë reduktimin e dënimit. Ky parim shtrihet për materiale që mund të dëmtojnë besueshmërinë e një dëshmitari në seanca gjyqësore.

Në çështjen *Foucher kundër Francës*, Gjykata u shpreh se kur të pandehurit që dëshironin të përfaqësohej me mbrojtës, iu mohua aksesi nga prokurori i çështjes dhe nuk iu lejuan kopje të dokumenteve që përmban çështja, e si rrjedhim nuk ishte në gjendje të përgatiste një mbrojtje të duhur, kjo rezultoi në shkelje të parimit të barazisë në mjete.

Në çështjen e *Roe dhe Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, e cila ka lidhje me gjyqin e

- BGBl. Nr 280/1978 Bundesgesetz vom 15 Juni 1978 über Änderungen des Ehegattenerbrechts, des Ehegüterrechts und des Ehescheidungsrechts.
- Gesetz über die Gleichberechtigung von Mann und Frau auf dem Gebiete des bürgerlichen Rechts (Gleichberechtigungsgesetz – GleichberG) Vom 18 Juni 1957, zuletzt geändert durch Art 127 Erstes G über die Bereinigung von BundesR im Zuständigkeitsbereich des BMJ vom 19 April 2006 (BGBl. I S. 866).
- Loi n°85-1372 du 23 décembre 1985 – Art 12 JORF 26 décembre 1985 en vigueur le 1er juillet 1986.
- ZGB-Schweizerisches Zivilgesetzbuch vom 10 Dezember 1907 (Stand am 5 Dezember 2008).



## Garancitë dhe të drejtat e individit në procesin penal

**Dr. Ferdinand Elezi**  
*Drejtues i Prokurorisë Apelit Durrës*

### Abstrakt

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut përbëhen nga tërësia e të drejtave civile e politike me karakter universal, të cilat mundësojnë e lejojnë çdo individ të mbrojë lirinë dhe dinjitetin e tij, bazuar në garancitë kushtetuese, ligjore e institucionale. Në çdo shoqëri shkalla e respektimit të drejtave dhe lirive themelore të individit është kriter themelor e përcaktues për shkallën e demokracisë në atë shoqëri dhe të funksionimit të shtetit të së drejtës. Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit është i lidhur ngushtë jo vetëm me kuadrin kushtetues e ligjor por me respektimin e tyre në praktikë, respektim i cili kushtëzohet nga pavarësia e sistemit gjyqësor si dhe funksionimin në tërësi të gjitha institucioneve demokratike të një shteti.

Pa dyshim që akti më i plotë e efikas në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut është Konveta Europiane e të Drejtave të Njeriut (K.E.Dr.Nj.), miratuar nga shtetet themeluese të Këshillit Europës, dhe është plotësuar me njëmbëdhjetë protokolle shtesë. Rëndësia dhe efikasiteti i K.E.Dr. Nj. bazohet në mekanizmat garantues të parashikuara në këtë konventë në lidhje me kontrollin e respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut. Individët që pretendojnë se ju janë shkelur të drejtat, pasi kanë ezauruar mekanizmat nacionalë kanë të drejtë të drejtohen Gjykatës E.Dr.Njeriut (Gjykata e Strasbugurt) e cila ka juridiksion ndërkombëtar për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit Europës. Në K.E.Dr.Nj. vendin më të rëndësishëm dhe trajtim më të gjere i kanë garancitë dhe të drejtat e individit në fushën e veprimit të së drejtës penale. Gjithashtu edhe po ti referohemi praktikës gjyqësore të Gjykatës E.D.Njeriut, rezulton se 2/3 e çështjeve që janë gjykuar nga kjo gjykatë i përkasin çështjeve që lidhen me juridiksion penal.

Në këtë punim do të trajtohen parashikimet garancitë dhe të drejtat e personave të akuzuar në procesin penal sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe legjislacionit tonë penal, bazuar në garancitë dhe të drejtat e parashikuara në K.E.Dr.Nj, konkretisht në nenet 3, 5, 7 dhe 8 të kësaj konvente.

**1. Historiku i akteve ndërkombëtare mbi të drejtat e individit.** Përkufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit rezulton të jetë i hershëm, ai formalizohet nga anglezët që në vitin 1215 me të famshmen *Carta Magna* e përbërë nga 63 nene të cilat parashikonin të drejtat e individëve dhe vasalëve të mbretit mbi; lirinë e lëvizjes, banimit, tregëtisë etj.. në Mbretërinë Britanike. Në gjysmën e dytë të shekullit 18 në këtë drejtim u miratuan mjaft akte të cilat njohën të drejtat e njeriut, kryesisht në ameriken e veriut dhe në europën perëndimore, këtu mund të përmendim Deklaratën e Virxhinias, Pensilvanisë, Merilandit, Karolinës Veriut etj.. Ndër aktet më të plota për këtë periudhe rezulton të jetë *Deklarata Franceze e të drejtave të njeriut dhe qytetarit* e gushtit 1789 si dhe tetë amendamentet e para të Kushtetutës Amerikane të quajtura *Bill of Rights* (1789-1791). Këto akte patën një rëndësi të madhe pasi ato hodhën bazat e njohjes së të drejtave dhe lirive të individit, pavarësisht se shkalla e respektimit tyre ishte në nivele mjaft të ulëta. Pas Luftës së Dytë Botërore në kuadrin e O.K.B. u hartuan akte në mbrojtje të këtyre të drejtave. "*Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*" miratuar e shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e O.K.B. me rezolutën Nr 217 datë 10.12.1948 si dhe "*Pakti mbi të Drejtat Civile dhe Politike*" miratuar nga po kjo asamble me rezolutën Nr 2200 datë 16.12.1966 ndryshe i quajtur edhe si pakti i Nju Jorkut. Akti akti më i plotë dhe i gjithë pranuar nga shtete anëtare, mbi garancitë dhe të drejtat e individit në procesin penal është Konveta

Europiane e të Drejtave të Njeriut (K.E.Dr.Nj.), e nënshkruar në Romë më 04.12.1950 miratuar nga shtetet themeluese të Këshillit Europës, si dhe nga shtetet e tjera të Europës Lindore pas viteve 90-të. Konvetës i janë shtuar edhe njëmbëdhjetë protokolle shtetsë të cilat kanë zgjeruar garancitë dhe të drejtat e individit në tërësi të tyre dhe në vecanti në procesin penal.

Në vendin tonë, garancitë dhe të drejtat e personave të akuzuar në procesin penal, u parashikuan në mënyrë të plotë vetëm me miratimin e Kodit Proçedurës Penale, ligjin Nr 7905 datë 21.03.1995, duke e rradhitur atë në sistemet proçeduriale demokratike me karakter akuzator. Veçori e proçesit tonë penal është karakteri i pastër akuzator, me barazi të plotë të palëve në fazën e gjykimit çështjes, me të drejta më të gjëra të organit ndjekjes penale gjatë hetimit paraprak, të drejta këto të cilat verifikohen, kontrollohen e miratohen nga ana e gjykatës për veprimet dhe disponimet kryesore proçeduriale. Duhet thënë se nga ana e ekspertët dhe hartuesit e projektit të Kodit Proçedurës Penale, mbi garancitë dhe të drejtat e individit në procesin penal, janë bazuar në parashikimet e K.E.Dr.Njeriut si dhe në legjislacionin proçedural penal të shtetit italian, i cili rezultonte me kodin më të ri të proçedurës penale në Europën Perëndimore.

**2. Ndalimi i përdorit të torturës.** Konventa në nenin 3 të saj ka parashikuar se “Askush nuk mund ti nënshtrohet torturës, dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”. Tortura apo çdo formë tjetër e trajtimit çnjerëzor apo poshtëruës ndaj një individi sipas Kushtetutës dhe në mënyrë specifike nga ligji penal material, konsiderohet si krim i rëndë. Në dispozita të veçanta të pjesës posaçme të k.penal (*Nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal të R.Shqipërisë*), parashikohet se kryerja dhe shkaktimi i vuajtjeve të rënda fizike apo mendore, individit, nga një funksionar publik apo çdo trajtim tjetër poshtëruës e çnjerëzor, konsiderohet si krim i rëndë për të cilën ligji penal ka parashikuar dënime të rënda dhe vetëm me burgim.

Edhe legjislacioni proçedural penal në mjaft dispozita ka parashikuar e njohur të drejta dhe garanci për individët të cilët hetohen, merren në pyetje apo ndaj të cilëve kryhen proçedura të ngjashme me intervistimin penal nga ana e autoriteve të ngarkuara nga ligji. Garantimi i të drejtës mbrojtjes që në momentet e para, e drejta për të mos bërë asnjë deklaratë, detyrimi i autoritetit për tja bërë të ditur individit këto të drejta, pavlevshmëria e çdo deklaratë apo akti që krijon dyshime mbi respektimin e këtyre garancive etj, përbëjnë në vetvete garanci në drejtim të parandalimit të çdo veprimi të kundraligjshëm ndaj individëve gjatë proçesit të intervistimit penal.

Çdo veprim që dhunon fizikisht apo mendërisht një individ, pavarësisht nga qëllimi apo pretendimi për zbulimin e aktivitetit kriminal, përbën vepër penale, paligjshmëria nuk mund të goditet me veprime të paligjshme. Shoqëritë demokratike sot kanë arritur në një stad të zhvillimit tyre sa të mos pranojnë asnjë formë të dhunimi mendor apo personalitetit të individit, qoftë edhe në shkallë minimale, pa folur këtu për shkallën më të lartë të këtij dhunimi, ushtrimin e torturës (*J.Dhrami “A duhet lejuar përdorimi i torturës” Tribuna juridike 2009*). Edhe në aspektin shkencor të vërtetësisë dhe rezultatit që arrihet nëpërmjet torturës, praktika në të kaluarë ka treguar në mjaft raste që jo vetëm nuk është zbuluar aktiviteti kriminal por ka ndodhur e kundërta. Pretendimi se qëllimi justifikon mjetin, është sa i gabuar aq edhe kriminal. Dëmi që i shkaktohet shoqërisë nga përdorimi i torturës dhe çdo veprimi të paligjshëm në këtë drejtim është më i madh se dëmi që pretendohet të parandalohet apo përfitimi që ka shoqëria nga zbulimi i një krimi si rezultat i përdorimit të torturës.

Pavarësisht krimeve të kryera nga idividët, kryerja ndaj tyre e veprimeve të tilla si mbajtja

në qeli me temperaturë shumë të ulët apo shumë të lartë, mbajtja lidhur për orë të tëra në karrike apo vende të tjera, mungesa e ujit të pijshëm, ushqimit, lagia me ujë, detyrimi për të mos fjetur apo përdorimi i teknikave të simulimit mbytyjes në ujë, elektrohokun etj.. për më tepër të kryera në mënyrë të përsëritur e të vazhdueshme, jane veprime torturuese dhe dhunojnë në mënyrë flagrante të drejtat dhe liritë themelore të individit të mbrojtura nga Kushtetuta, ligji dhe konventat ndërkombëtare. Sado e nevojshme dhe e rëndësishme të jenë të dhënat që duhet të merren nga individët, përdorimi i torturës dhe veprimeve të tjera të dhunshme është apsolutisht i palejuar, pavarësisht qëllimit dhe nevojës ekstreme që kanë autoritetet ligjzbatuese.

**3. E drejta e lirisë dhe sigurisë individit.** E drejta për liri dhe siguri e individit si një nga të drejtat më themelore është njohur e garantuar jo vetëm nga aktet ligjore kombëtare të shteteve demokratike por edhe nga një sërë aktesh ndërkombëtare. Liria e individit nënkupton lirinë fizike të tij nga ndalimi apo arrestimi i paligjshëm, ndërsa siguria është mbrojtja e tij nga veprimet arbitrare që çenojnë lirinë e këtij individit. Kushtetuta jonë ka njohur, trajtuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në pjesën e dytë të saj (*Nenet 15 – 63 të Kushtetutës R.Shqipërisë*), menjëherë mbas përkufizimit të parimeve themelore. Në këtë akt themelor janë njohur e garantuar këto të drejta në përputhje të plotë me aktet ndërkombëtare në këtë drejtim, me K.E.Dr.Njeriut, Deklarata Universale e të Dr. Njeriut, Pakti Nd. për të Drejtat Civile e Politike dhe akte të tjera ndërkombëtare të cilat tashmë janë njohur e ratifikuar nga ana jonë.

Kushtetuta (*Neni 17/1,2 të Kushtetutës R.Shqipërisë*) ka parashikuar dhe garantuar se kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose në mbrojtje të interesave të të tjerëve. Në paragrafin e dytë të këtij neni përcaktohet në mënyrë të qarte se shkalla e këtij kufizimi nuk mund të tejkalojë shkallën e kufizimeve të parashikuara nga K.E.Dr.Njeriut. Ndonëse legjislacioni penal material dhe ai procedurial penal është më i hershëm se Kushtetuta, pasi është miratuar dhe hyrë në fuqi para saj (*K.Penal miratuar me ligjin Nr7895 datë 27.01.1995, K.Pr.Penale miratuar me ligjin Nr 7905 dt.21.03.1995*), ky legjislacion rezulton të jetë në përputhje të plote me kushtetutën dhe të gjitha aktet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të individit.

Objekt i këtij punim është trajtimi i përgjithshëm i standartit që ka legjislacioni penal shqiptar në aspektin e njohjes dhe garantimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohura e te garantuara nga KEDNJ dhe zbatimi i këtij legjislacioni nga ana e organeve ligjzbatuese. Në nenin 27 të Kushtetutes tone në pikën 1 dhe 2/a,b,c të saj parashikohet shprehimisht se; 1. Askujt nuk mund ti hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. 2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhteme; a) Kur është dënuar me burgim nga një gjykatë kompetente. b) Për moszbatim të urdhërave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj. c) Kur ka dyshime të arësyeshme se ka kryer një veper penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj....

Duke bërë krahasimin me parashikimet e nenit 5 të KEDNJ jo vetëm që rezulton e njëjta përmbajtje por janë përdorur në pjesën më të madhe edhe të njëjta formulime dhe specifikime ligjore.

Në nenin 5 të konventës parashikohet e drejta për liri dhe siguri e përcaktuar në mënyrë të qartë dhe konkretisht; Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund ti hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj; a. Kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë

kompetente. **b.** Kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për moszbatim të një urdhëri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi ligjor. **c.** Kur arrestohet ose ndalohet për tu çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arësyeshem se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arësyeshme e nevojshme për parandalimin e kryerjes prej tij të veprës penale ose largimit pas kryerjes saj.

E njëjta përputhje rezulton të jetë edhe me dispozitat e K.Pr.Penale konkretisht të neneve 227 - 276 të Titulli V këtij kodi në të cilin parashikohen në mënyrë të qartë jo vetëm rregullat procedurale të veprimit të subjektit procedural penal (organit që procedon) por kushte dhe kritere të qarta ligjore në lidhje me rastet e ndalimit apo arrestimit në flagrancë, caktimin ose jo të masave të sigurimit personal, llojit tyre, afatet dhe kohëzgjatja, të drejtat dhe detyrimet e palëve, në mënyrë të qartë të drejtat e paleve të cilat cënohen nga veprimet që kufizojnë këto të drejta si dhe mjetet për realizimin e tyre.

**4. Ligjshmëria dhe procedura në rastet e heqjes lirisë individit.** Nga përmbajtja e nenit 5 të konventes rezulton qartë që heqja e lirisë mund të bëhet jo vetëm për shkak të ligjshëm por edhe procedura që duhet të ndiqet për heqjen e kësaj lirie, duke u kryer sipas rrugës dhe në mënyrën e parashikuar nga ligji. Ligjshmëria zë vendin parësorë (*Shih Vendimet e Gj E Dr Njerit në çështjen Enkel dt.01.101975, në çështjen Brand dt11.05.2004*), ajo nënkupton domosdoshmërisht egzistencën e një shkakut për të cilin ligji ka parashikuar që një individ mund ti hiqet liria. Rruga ligjore, apo procedura që duhet të ndjekin organet ligjzbatuese detyrimisht duhet të jetë ajo e parashikuar po nga ligji procedural, të jetë proces i paanshëm dhe i përshtatshëm, i kryer nga një autoritet kompetent duke mënjanuar veprimet dhe karakterin arbitrar (*Shih Vendimet e Gj E Dr Njeriut në çështjet Einterëerp dt.24.101979, në çështjen Cakici dt.08.07.1999*).

Duke ju referuar nenit 5 i konvetës në lidhje me heqjen e lirisë si rezultat i veprimit të ligjit penal mendoj që duhen trajtuar më vete heqja e lirisë si rezultat i tre formave kryesore sikurse janë, ndalimin e arrestimi në flagrancë, paraburgimi dhe burgimit pas dënimit penal. Ndalimi e arrestimi në flagrancë sipas ligjit tone procedural penal janë veprime jo të zakonshme që kryen nga ana e policisë gjyqësore dhe prokurori ndaj një individ i cili dyshohet se ka kryer një vepër penale për të cilën ligji penal material kërkon domosdoshmërisht që të parashikohet dënim me burgim jo më të ulët se 2 vjet. Natyra e ndalimit me atë të arrestimit në flagrancë si dhe rastet e aplikimit të tyre janë të ndryshme.

**Ndalimi** i individit mund të kryhet nga Prokurori edhe në rastet kur nuk janë kushtet e flagrancës por ligji ka parashikuar që domosdoshmërisht të ketë shkaqe të bazuara se ka rrezik që ky individ të largohet dhe ti shmanget organit procedues në rastet e kryerjes së një krimi (*Neni 253 i K.Pr.Penale*). Në të njëjtat kushte dhe rrethana, ndalimin mund ta kryejë edhe policia gjyqësore në raste tepër të ngutëshme.

Për **arrestimin në flagrancë**, ligji procedural penal së pari kërkon domosdoshmërisht për çdo rast egzistencën e gjendjes flagrancës, kuptimin dhe rastet konkrete i ka përkufizuar vetë ligji (*Neni 252 i K.Pr.Penale*). Në rastet e arrestimit në flagrancë nga ligji janë përkufizuar dy nocione, ai i detyrimit për të kryer arrestimin në flagrancë dhe ai i së drejtës për të kryer këtë arrestim. Rastet që ligji parashikon kur duhet detyrimisht të kryehet arrestimi në flagrancë kanë të bëjnë me autorë të krimeve të kryera me dashje, për të cilat ligji material parashikon dënimin në maksimum jo më të ulët se 5 vjet burgim (*Neni 251/1 i K.Pr.Penale*). Ndërsa rastet kur parashikohet “e drejta” për të vendosur e kryer arrestimin në flagrancë, janë të njëjtat kushte si më lart, por masa e dënimit e parashikuar nga ligji të mos jetë më e ulët në maksimum se 2 vjet burgim, si dhe në rastet e krimeve të kryer me

pakujdesi për të cilat ligji parashikon dënim jo më të ulet në maksimum se 10 vjet burgim (Neni 253/2 i K.Pr.Penale).

Në rastet e ndalimit apo arrestimit në flagrance, autoriteti kompetent që ka kryer këtë veprim duhet detyrimisht të bëjnë të ditur individit që nuk ka asnjë detyrim për të bërë deklaratat apo dhënë shpjegime, dhe nëse e bën duhet të njoftohet që ato mund të përdoren ndaj tij në gjykim, të njoftojnë menjëherë prokurorin si autoriteti më i lartë i ndjekjes penale, të njoftojnë individin me të drejtën e mbrojtjes si dhe njoftimin e mbrojtësit, me pëlqimin e tij të njoftohen familjarë etj. (Neni 255 i K.Pr.Penale). Ky parashikim ligjor si dhe ai i bërë nga neni 98 vjen në përputhje parashikimet e nenit 5 pika 2 të konventës.

Në Kushtetutën tonë dhe ligjin procedural penal (Neni 28/2 i Kushtetutës dhe neni 258/1 dhe 259/5 i K.Pr.Penale), kjo formë e heqjes së lirisë konsiderohet si masë paraprake e marrë në raste të ngutëshme, gjendje e cila nuk mund të vazhdojë më shumë se 96 orë nga momenti i heqjes lirisë individit. Organi prokurorisë si autoriteti kompetent i caktuar me ligj, është i detyruar që brenda 48 orëve duhet të paraqesë kërkesën para gjykatës në lidhje me ligjshmërinë e ndalimit apo arrestimit në flagrancë, ose në të kundërtën duhet të urdhërojë lirimimin e individit nga paraburgimi. Është gjykata i vetmi autoritet i njohur nga ligji e Kushtetuta për tu shprehur detyrimisht brenda 48 orëve, në lidhje me ligjshmërinë e kësaj heqje lirie si dhe rrugën dhe procedurën ligjore të ndjekur në rastin konkret, sikurse parashikon edhe konventa (Neni 5 pika 3 e Konventës).

**5. Paraburgimi si masë sigurimi personale me karakter shtërngues.** Paraburgimi është masa me ekstreme e heqjes së lirisë individit, por në mjaft raste ajo ngelet si zgjidhja më e mirë dhe e drejtë për interesat e gjithë shoqërisë. Paraburgimi apo heqja e lirisë në kuader të një procesi penal vendoset nga gjykata si i vetmi organ kompetent, kjo masë kushtëzohet nga faktorë mjaft të rëndësishëm të cilët detyrojnë gjykatën për caktimin e saj, ndonëse kjo masë është ekstreme, në raste të caktuara ajo rezulton të jetë më e përshtatshme, ajo në vetevete përmban cënim të rëndë të lirisë individit që është në proces hetimi apo gjykimi penal.

Për këtë shkak i gjithë legjislacioni si dhe konventat në tërësinë e tyre kanë përcaktuar në mënyrë të qartë jo vetëm rastet kur kjo masë mund të aplikohet ndaj individit por edhe organin kompetent që ka të drejtën ta vendosë atë, gjykatën, duke përcaktuar kushte dhe kriteret të qarta ligjore (Nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale) të cilat vlerësoj se duhen grupuar në kushtet dhe kriteret të përgjithshme dhe ato specifike.

Kriteret e përgjithshme lidhen me egzistencën e kushteve dhe rrethanave për të cilat ligji ka parashikuar që individit mund ti kufizohet liria në forma dhe mënyra të ndryshme deri duke e paraburgosur atë. Më konkretisht ato janë; **a)** Egzistenca e dyshimit arësyeshem të bazuar në prova se individi është autor i veprës penale. Ë thënë ndryshe duhet që ndaj individit për tu caktuar masë sigurimi (për më tepër të paraburgoset) të egzistojë dyshimi i arësyeshem i bazuar në prova se është autor i kryerjes së veprës penale (neni 228/1 të K.Pr. Penale). Koncepti i dyshimit të arësyeshem sikurse parashikon edhe Konventa (neni 5/1 pika "c" e Konventës), në ligjin tonë procedural penal është më i avancuar në drejtim të drejtave dhe lirive të individit, pasi parashikohet për çdo masë sigurimi (dhe jo vetëm për paraburgimin) si dhe kërkohet detyrimisht që ky dyshim i arësyeshem të jetë i bazuar në prova. **b)** Ndaj asnjë individi nuk mund të merren masa sigurimi kur rezultojnë shkaqe padënueshmërie apo kur vepra penale për të cilën kërkohet të caktohet masa e sigurimit, është shuar (neni 228/2 të K.Pr.Penale).

Kriteret specifike janë parashikuar nga ligji në mënyrë të hollësishme (nenet 228/3, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale), ato ndikojnë drejtpërdrejtë në llojin e masës sigurimit dhe shkallën e

privimit të lirisë individit që proçedohet dhe konkretisht; **a)** Vendimarrja e gjykatës është e përcaktuar nga ligji proçedural penal, që për mbajtjen në një institucion paraburgimi të individit, veç kushteve dhe kriterëve të përgjithshme që duhet të egzistojnë, detyrimisht duhet të jenë prezent njëkohësisht edhe dy kushte specifike, rezikshmëria e veçantë e kimit kryer dhe individit (neni 230 të K.Pr.Penale). **b)** Egzistenca e rrezikut të ikjes dhe largimit tij, ose rrezikut për marrjen e adminsitrimin e provave apo për verifikimi i vërtetësisë tyre.

**c)** Kur për shkak të rrethanave dhe personalitetit të individit ka rrezik që ai të kryejë krime më të rënda apo të njëta me ato për të cilat proçedohet. **d)** Shkalla e privimit të lirisë individit duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit kriminal, sanksionin që parashikon ligji për atë krim dhe rrethana të tjera në tërësi që konkurojnë në çdo rast.

Liria dhe siguria e individit garantohet dhe nga mjaft institute të parashikuara nga Kushtetuta dhe në menyre specifike nga legjislacioni proçedural. Këtu mund të përmendim pjesëmarrjen e detyrueshme të mbrojtësit në seancën e caktimit masës sigurimit, e drejta ankimit, përcaktimi i afateve kohore të paraburgimit sipas natyrës kimit për të cilin akuzohet individit, detyrimin e gjykatës për verifikimin çdo 2 muaj të kushteve për të cilat është caktuar paraburgimi, e drejta e kompesimit në rastet e paraburgimit të padrejtë etj...

**6. Paraburgimi pas dënimit të dhënë nga gjykata.** Kjo mënyrë e heqjes së lirisë individit mund të konsiderohet si më e ligjshme, pasi ajo është rezultat i një dënimi me burgim të dhënë nga një gjykatë kompetente, vendimi i së cilës ka marrë formë të prerë dhe detyrimisht duhet të ekzekutohet. Gjkata në përbërje të së cilës janë gjyqtarë të pavarur ofrojnë garancitë e duhura sipas edhe nenit 5/1 të Konventës. Legjislacioni proçedural ka parashikuar në institute më vehte rregullat proçeduriale të cilat rregullojnë gjithë veprimtarinë e ekzekutimit të vendimeve penale të formës prerë. Gjatë kësaj periudhe të privimit të lirisë individit, ka mjaft rëndësi jo vetëm respektimi i të drejtave në lidhje me kërkimet për rishikimin e vendimit dënimit, pezullimin e tij, kërkimet për dënime alternative, por edhe me trajtimin human, mjekësor dhe krijimin e kushteve për reabilitimin e edukimin e tij gjatë kësaj periudhe. Legjislacioni shqiptar është plotësuar me miratimin e ligjeve të veçanta që rregullojnë gjithë veprimtarinë e ekzekutimit të vendimeve penale si dhe në lidhje me trajtimin e të dënuarve në Republikën e Shqipërisë (ligji Nr 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe, Ligji Nr 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e dënuarve me burgim”).

Nga ana e Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut në mjaft raste janë konstatuar se nga ana e autoriteve janë kryer shkelje të drejtave dhe lirive themelore të individeve në kohën që ata kanë qënë duke vuajtur dënimit penal me burgim të dhënë nga gjykata (vendimet e GjEDrNj Drozd, Janousek kundër Fraces datë 26.06.1992, Bizzotto kundër Greqisë datë 15.11.1996, Bozono kundër Francës dt.18.12.1986, Droogebroesk kunder Belgjikës dt.24.06.1982 etj..). Sikurse janë konstatuar edhe nga ana e Gjykatës Kushtetuese në gjykimet në kuadër të nenit 6 të Konevntes dhe nenit 42 të Kushtetutës në lidhje me proçesin e rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut në tërësinë e tyre lidhen edhe me përcaktimet e nenit 6 të koneventës mbi proçesin e rregullt ligjor.

E drejta për një proçes të rregullt ligjor ndonëse është e vështirë për tu përkufizuar, referuar nenit 6 të Konventes, në të paraqitet në mënyrën më klasike të mundëshme, si shprehje e parimit të ligjshmerimë në proçedurë (fair trial). Do të jemi para një proçesi të rregullt ligjor nëse e gjithë proçedura e ndjekur nga ana e gjykatës në gjykimin e një çështje të caktuar është kryer sipas të gjitha rregullave proçeduriale të parashikuara nga ligji

proçedural dhe konventat në tërësinë e tyre dhe për çdo element. E. Litrrë ka përkufizuar se “do të kemi proçes të rregullt ligjor, kur gjykata është e prirur dhe i trajton palët në mënyrë të barabartë, duke njohur të drejtën e sejcilit në mënyrë të paanshme” (E. Litrrë “*Dictionnaire de la langue francaise*” – 1996.

Dispozita të veçanta që vihen në mbrojtje të lirise e sigurisë personit nga veprimet e kundraligjeshme dhe që përbëjnë vepër penale, përmban Kodi Penal i R. Shqipërisë. Ndër dispozitat më të rëndësishme në këtë drejtim përmendim rrëmbimin e personit, heqjen e paligjeshme të lirisë, kryerja e veprimeve arbitrare, mosmarrja e masave për ndërprerjen e gjendjes paligjeshme, mbajtja në burg pa vendim etj... (nenet 109, 110, 250, 251, 252, të K.Penal).

**7. Edrejta për respektimin e jetës private e familjare.** Konventa në nenin 8 të saj ka parashikuar që çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, në banesë dhe korespondencë. Në paragrafin e dytë të këtij neni janë parashikuar rastet e cënimit të këtyre të drejtave nga ndërhyrja e autoritetit publik në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit, moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve. Duke ju referuar parashikimeve të konventës, Kushtetutës si dhe legjislacionit penal rezultojnë se kemi të bëjmë me tre grupe të drejtash ajo e jetës private, banesës dhe korespondencës, ato janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën.

**E drejta e jetës private** të individit në mjaft raste çënohet nga ndërhyrjet si rezultat i veprimtarisë hetimore në aspektin penal. Të tilla mund të jenë kontrolllet, këqyerjet, përgjimet dhe filmimet në banesë si dhe në vendim e punës së individit. Çdo formë ndërhyrje, kontrolli për të zbuluar e dokumentuar korespondencën, komunikimet elektronike të çdo lloji etj, përbën ndërhyrje në jetën private të individit.

Në kuadër të drejtësisë penale është në të drejtën e gjithsecilit për ta jetuar jetën sipas dëshirës tij duke qënë i mbrojtur nga ndërhyrjet e autoriteve publike. Kjo mbrojtje sikurse ka parashikuar vetë konventa nuk është absolute, ajo mund të çënohet në rastet e parashikuara nga ligji në interes të sigurisë publike, mbrojtjes së rendit publik, shëndetit, moralit apo të drejtave dhe lirive të personave të tjerë, të cilat rrezikohen apo janë çënuar nga veprimet e këtij individ. Në jetën private nuk përfshihet vetem periudha në të cilën individ kryen aktivitetin e tij në banesë por edhe në vendin e tij të punës dhe gjatë aktivitetit të tij profesional.

Gjykata E.Dr.Njeriut ka nënvizuar faktin se përgjimet telefonike të bëra edhe gjatë aktivitetit ekonomik, tregtare përbëjnë cënim dhe ndërhyrje në jetën private të individit (vendimi datë 24.04.1990 Huvig kundër Francës, vendimi datë 23.11.1993 A kundër Francës, datë 30.03.1989 Champell, datë 16.12.1992 Niemietz kundër Gjermanisë etj...).

**E drejta e paprekshmërisë banesës** nga kryerja e kontroleve apo bastisjeve nga autoritetet publike është e garantuar nga Kushtetuta dhe ligji (neni 37 i Kushtetutës dhe neni 202/2 të K.Pr.Penale). Kryerja e kontrollit të banesës, vendeve të tjera apo dhe vetë individit mund të kryhet vetëm mbi bazën e një vendimi të dhënë nga gjykata në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara në mënyrë të posaçme nga ligji proçedural penal. Kryerja e kontrollit në këto raste mund të bëhet drejtpërdrejtë nga gjykata ose nga policia gjyqësore e urdhëruar nga gjykata. Në legjislacionin tonë proçedural përjashtim nga ky rregull janë rastet e flagrancës në të cilat objektivisht nuk mund të pritët deri në vendimarrjen e gjykatës për shkak të nevojës së ngutëshme që kanë autoritetet për të gjetur e administruar prova për proçesin penal, arrestuar autorin e kryerjes krimi i cili është në ndjekje nga policia gjyqësore apo për të ekzekutuar një urdhër arresti ndaj individit që

futet apo ndodhet në banesë (*nenet 202/3 dhe 298 të K.Pr.Penale*). Kryerja e këtij kontrolli nga ana e policisë në kushtet e flagrancës duhet detyrimisht të bëhet vetëm në rastet kur autoriteti ka arsye të bazuara se ato gjenden ose mbahen të fshehura në këtë banesë apo objekt. Ligjshmëria e këtij kontrolli verifikohet nga ana e prokurorit brenda 48 oreve nga kryerja e tij si dhe nga ana e gjykatës.

**Fshehtësia e korespondencës dhe e komunikimeve.** Kontrollat e korespondencës dhe përgjimi i komunikimeve janë mjete të kërkimit të provave në kuadër të një procesi penal të cilat sipas kushteve dhe kritereve ligjore aplikohen nga ana e organit të akuzës për marrjen dhe adminsitrimin e provave penale. Nga ligjvënësi janë parashikuar rastet në të cilat nga gjykata mund të vendosë kryerjen e kontrollit apo përgjimit, por duhet detyrimisht që ndaj individit që i cënohen të drejtat duhet domosdoshmerisht të disoponohen të dhëna dhe prova të tjera që e lidhin atë me aktivitetin kriminal. Me pak fjalë duhet të ketë të dhëna e prova rreth aktivitetit kriminal që të mund të kontrollosh korespondencën dhe të përgjosh atë individ në kërkim të provave të tjera ndaj tij (*nenet 202/1 dhe 222/1 të K.Pr. Penale*).

Nocionet e jetës private, paprekshmërisë banesës dhe fshehtësi korespondencës e komunikimeve janë objektet dhe qëllimi kryesor i nenit 8 të konventës. Këto të drejta jo vetëm që janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën por edhe në tërësi me të gjitha të drejtat dhe liritë e tjera të njohura e garantuar në kushtetutë, legjisllacionin në tërësi si dhe aktet ndërkombëtare.

Provata e marra dhe të administruara nga ana e organit të akuzës në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga legjisllacioni përkatës si dhe nga Konventa nuk mund të përdoren pasi ato rezultojnë të jenë të pavlefshme. Nga ana e gjykatës në procesin e gjykimit nuk duhet të merren dhe të administrohen këto prova e aq më tepër të vlerësohen e çmohen si të tilla në dhënien e vendimit gjyqësor.

## Literatura

- (1998). *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* Tiranë.
- (2010). *Përmbledhje e Konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga R.Sh.* Tiranë.
- (2014). *Kodi Pr. Penale të R.Shqipërisë, (i azhornuar)*. Tiranë.
- (2014). *Kodi i Penal i R.Shqipërisë (i azhornuar)*, Tiranë.
- (2014). *Përmbledhje e vendimeve të Gj.E.Dr.Njeriut, përkthim*, Tiranë.
- (2014). *Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese R.Shqipërisë*, Tiranë.
- (2014). *Përmbledhje e vendimeve të Kol. Bashk, K. Penal Gjykatës Lartë*, Tiranë.
- Dhrami J. (2009). "A duhet lejuar përdorimi i torturës" *Tribuna juridike*, Tiranë.
- Paolo Ielo, P. (2002). *Libero convincimento e verita processuale*. Romë.
- Pradel, J. Corstens, G. Vermeulen, G. (2010). *E drejta Penale Europiane*. Tiranë.
- Ruggiero, L. (2006). *L'incidente probatorio*, Romë .
- (2013) *Ligji Nr.8737 "Për organizimin e funksionimin e Prokurorisë"*, Tiranë.
- (2014) *Ligji Nr.8677 "Për Policinë Gjyqësore në R.Sh."*, Tiranë.
- (2013) *Ligji Nr 8328 "Për të dr. e trajtimin e dënuarve me burgim"*, Tiranë.
- (1992-2014) *Revista juridike shkencore, Drejtësia, Jeta Juridike, Justicia*, Tiranë.



## The role of human resources in development of tourism in Kosovo

**PhD Marta Muqaj**

*Faculty of Economy  
European University of Tirana*

### Abstract

God has distributed the benefits and natural beauty, as has disseminate the skills and inclinations of people, giving us to understand; people tailor the benefits and natural beauty in order to satisfy their tastes and desires, at the same time to make them attractive for others. This paper aims to provide the connection and impact of Human Resource Management (HRM) and interactions in tourism, reviewing appropriate literature in these areas, through analysis of reported cases. Some case studies which show us clearly the impact and necessity in demonstrating different characteristics of Human Resources in the tourism sector.

Because of the importance of Human Resource Management (HR) in the promotion of competition in the tourism industry, will highlight the most important practical issues regarding HR, regarding the realization of organizational objectives, furthermore it shows related issues regarding, which include changing technological, legislative regulations, national culture, globalization, or internal factors; including size, characteristic of industry sectors and the structure of an organization, strategy and past the MRH. It is important that employees, employee - employer relationships, job satisfaction, giving out the responsibilities, employee productivity, teamwork climate, emotional state, relations between the employees, the state of economic activity should be taken into account. So as a natural product is important, for the majority of tourists the quality and experience of staff, proper awareness level of interactions, diversity of staff in the sector level where they belong, are the basis of the development of the whole economy of the tourism sector in particular.

**Key words:** *Tourism, people, human resources, strategy, fun.*

### Introduction

Management is the process of orientation to human activities in order to accomplish certain objectives, which means the integrity of interrelated activities such as: planning, organization, Human Resource leadership and control, is the interaction of personnel in the most efficient way to achieve the objectives that the organization has in front of him. Based on the full understanding of the complex and management as a process that could define as general activities delivered through some functions in order to efficiently provide, distribute, and to exploit the potential of human and physical resources so as to achieve the purpose.

Tastes, desires and possibilities are different between people, ages and native residents, people are those who should find the specialties and answer to the tastes, preferences and possibilities, so it should always be in search of present when we add this the dynamism of life, the change and advancement in taste and ability, then we should always seek in order to be a cutting edge or a step ahead of time. If a host country, as can be: hotel, restaurant, guest house, camper, or beautiful tourist spot, with high conditions and higher infrastructure level if the mass of the population don't recognize and do not have

knowledge that such place exists, then it will not have any good, if even recognize, they visit it but those responsible for the promotion, hospitality, sociability, etc. To be able to make a combination of classic and contemporary, regardless of type and tourism facility, meaning they are not up to the task, shall be a failure. Now since we live in the age of the Internet, we can say that the possibilities for promotion and publication are facilitated to a great extent, but without stopping with that, participating in symposiums, various tourism fairs, special offers and different from the existing, unique, can attract tourists and new visitors, not leave out those existing who likes sportsmanship, confidence, attitude, hospitality, will be grateful and permanent clients. In relation to productivity in the service sector, (Gronroos and Ojasalo 2004) note that: "The productivity of an organization is related to how effectively resources inputs in a process (production process, process service) are transformed into economic results for the provider of service and value for consumers thanks".

"Within the manufacturing sector, a traditional productivity concept has evolved based on the assumption that the consumption and production of physical goods are separate processes and that consumers do not take part in the production process" (Gronroos, 2007). Therefore, HRM practices and related measurements remain in the level of productivity in production will differ from those within the service sector. To achieve the objectives being to competitive advantage, organizations must focus on the management of human resources (HR) and training and development of these resources for special sectors. Since every times and every time we need to increase efficiency and effectiveness in service.

## II.1. Purpose of the paper

The paper aims to highlight local perceptions regarding HR impacts of tourism development. Based on the background of economic structural changes, a key competitive asset to attract skilled workforce that through marketing to promote regional development and regional country, the aim of this study is to "take a step forward" by encouraging these people who first to design a creative environment, to be competitive in its kind, and second to make possible the emergence of traits we ah environmental, ecological, by combining the present with the traditional, and other aspects that are of interest.

Results show that creative environment constitutes a space containing human interaction, based on further understanding of the creative environment, will be based on social context, or more precisely the social space.

-The choice of theme also was oriented from actuality, and the continuing demand of people for tourism of all kinds.

-The influence of Human Resources in development, promotion and tourism organization, focusing on:

1. Connection between human resources and tourism,
2. What contemporary literature says about HR and tourism.
3. Selections from what previous researchers of this field have provided through publications are valuable source, references of special importance.

- The fact that Tourism influence of HR in Kosovo it is not in the level we want makes this paper much more reasonable.

## II.2 Paper objectives

-The selection of literature that has to do with the study and the role of tourism in economic development, the ranking of the causes that make possible the development of tourism and tourism definition of the term.

1. Hypothesis “Kosovar society still doesn’t understand the role of the, HR the management and development and their treatment in achieving the objectives and long-term strategy formulation Tourism Sector”
2. This hypothesis is the essence of the organization of this paper, but it is related with the following hypothesis which is:
3. Kosovo’s economy still today has no development strategy which will support the development, promotion and policy development.

## III. The importance of the study

I think the paper it is of the utmost importance, this paper will come to help managers of economic entities in general especially in tourism are of special emphasis in Human Resources. It will serve the tourism sector managers, small business, medium, but also private individuals who have the opportunity in the future to be directly or indirectly involved in Tourism businesses, since here will be included different management models, more contemporary models from those that different businesses have used in their environments which have provided results.

## IV.1. The concept of tourism development in historical and contemporary treatment

Tourism is a complex phenomenon that originated from the journey and the temporary and permanent of residents. It is developed parallel with the history and development of mankind, and appears in different types and shapes. Nature with its structures is one of the most important factors for the development of tourism, maintaining such countries that have their role in the production and satisfying holiday. The productivity of an organization is the best indicator of how sources of inputs in a production process are effectively transformed for owner’s economic outcomes by increasing the satisfaction of consumers. Therefore, HRM practices and measurements in relation to the impact on productivity levels in production will differ from those services. <https://detyraimefalas.wordpress.com/2014/03/16>

Great and useful progress were made in the context of this field during the last century, in terms of constructive development of human resources and business strategy in general, however, in the field of HR extent to which concepts are clearly defined leaves much to be desired, since it is relatively early stages of development in terms of screening and research different compared to business in general, since the range of business tourism sector needs requires knowledge of the multilateral research.

Through initiatives intervention Governments also may require to influence the decision

of the private sector in order to ensure that the room-board decisions are consistent with and supportive of tourism goals, objectives and plans of the region. The real challenge in the tourism sector has to do with some exogenous factors which have potentials to influence the performance of the sector, on which planners and decision makers in the region have little or no control, but which require appropriate conditions and often reaction time, in order to soften the impact of the possible negative impact on the sector. ( Cecil & Miller 2009, 6)

The improvement of the quality of human resources is a key factor of competitiveness in tourism, identifying the quality of human resources in the tourism sector will be defined on the basis of a comparative analysis with other countries, but in advance, emphasis will be placed on analysis the impact of the quality of human resources in tourism competitiveness.

The overall goal of state policy in the tourism industry of Armenia is to increase its contribution to the national economy and to provide an increase equal to the regional economy, while at the same time alleviating poverty.

This will be achieved by supporting policies favorable to the introduction of foreign and domestic tourists, while the growth of tourism has generated higher revenues by offering higher value, products and services, as well as creating new opportunities working in this sector. (Tourism development concept paper) <http://www.mineconomy.am/uploads/> Professor Nguyen Van Dinh, who is involved in drafting a strategy for the development of human resources for the tourism industry, said that “in recent years, Vietnamese Tourism Administration has made every effort to mobilize all sectors of the community and economy, as well as utilize international aid for human resource development for the industry”. However, the industry has not built a long term strategy for the development of human resources and personnel, so it is not yet been able to meet the requirements. During the last 10 years, the number of workers who work in the tourism industry has grown steadily from 20,000 in 1995 to 64,000 in 1995, 15,000 in 2000 and 235,000 in 2005. Despite improvements in quality and quantity, it labor force has not fulfilled the requirements of a market economy, especially in terms of professionalism and knowledge of foreign languages.

<http://english.vov.vn/Politics/> *Tourism industry faces human resource challenges* Management agreements- They affect the activity of many SMEs, businesses which remain legally independent especially when the representation of workers is concerned, with exclusive rights or similar agreements. ([www.International labour organization](http://www.international-labour-organization.org/))

#### **IV.2. The context and theoretical framework**

Tourism uses resources that fled the region in abundance and have advantages in production. Natural flora and fauna of each country and human makes attractive, allows the region to market a diversified range of products for complaints ever-increasing number of niche markets. These attributes, together with the proximity to the Caribbean have led to remain a favorite holiday desired destination sailing, even saphorya regions as competitive with market tourism destination. (Cecil & Miller, 2009, 18)

Production of natural goods and services traded, involves the use of inputs such as labor, land, capital equipment and material inputs. Through the combining of human use in the manufacturing process of labor and capital equipment “add value” to raw materials for the purpose of conversion to their profitable product or service. It is this transformation that constitutes the production process or service.

This is to increase labor productivity that allow for improvements in economic welfare, and enhancing the competitiveness of a company, industry or country. It is clear that the amount of physical capital that is available to each worker, the employment, the capital is a contributing factor. Improvements in increasing the quality and quantity of capital over time, increased work productivity, but not all jobs are identical, the better educated, better trained and more experienced workers are more productive, and this notion is captured by the concept of human capital. “The reward system was organized to attract and motivate so much to keep the employees, so the employees conform to have an impact on decision-making authority and control. The works also has been determined and not based on duties as the classical approach. The advantages of such a system put in the premise that the commitment of employees is higher showing the better performance of the work.( Beardwell, Holden and Claydon,2004,14)

Also as selection criteria were based on competence, it also represented the element of adaptability and flexibility. Using the employees which are adapted better to certain duties calls to effectively. (Arrey, 2006, 8)

The reason why economic policymakers consider tourism as the important trend of economic and social development of our country is linked with the great importance there was this element in these years of transition, which is seen as one of the most important sources of income, employment opportunities, the diversification of the economy, environmental protection and the promotion of intercultural exchanges. All states have used a variety of methods depending on the philosophy that choose to develop tourism in the required standards and in accordance with the specifications that represents each country.

Industrial social elements are two: the locals and friends. Their ratio is determined by conditions that the predecessor’s offers, cultures that reflect the services performed, understanding the mentality of tourist and profit achievement only the satisfaction retaliation has taken the latter. On the other hand, friends are undisputed subject and who are always right and this is the only concept on the basis of which tourism can flourish.

The impact of social context in the development of the domestic economy is not an unknown phenomenon, contrary a series of works are recognized and are considered simultaneously both economic and sociological. The economy, as a decryption key development and transformation of society has been the object of study of many researchers even occasionally the same act is considered as sociological, as a science closely related to it and the economic simultaneously. Not so coincidentally many sociological thinkers have also been prominent economists (Weber, Marx, Pareto, Hume etc.) ( <http://www.zemrashqiptare.net>)

### **IV.3. Costumer management**

Tourism has emerged as an important activity in socio-economic development. This is an important international industry and a major economic guidance services sector in XXI century. Orientation in the development of the HR department is in the center of the initiative for the development of sustainable tourism. It has noticed that over the years, there has been a change in the pattern of demand and supply of human resources for the travel industry, with demand in favor of educated personnel and specialized personnel. However, the development of human resources in tourism is subject to a number of obstacles, and remained severely unprepared in terms of professionalism. There is no evidence of any type that approach DHR being followed by tour operators / travel agency. Lack of skills in the industry is the result of short-term management and lack of investment in people. Workforce in tourism seems to be “uneducated, unmotivated, untrained, unskilled and unproductive”. Thus, there is a need to enhance the image of the industry personnel HRM practices through human standards, which require the cooperation of the people involved in the tourism business. In this paper an attempt is made to shed light on the problems and challenges of DHR in the tourism industry in India. ( Becherel & Cooper, 2002, 27)

### **V. Conclusions**

Tourism as an economic activity could be anywhere, it is an activity that can come to short-term revenue, is a flexible employment opportunity and rewarding career, there are many options that we face as opportunities for tourism.

It is one of the industries that has affected mostly in economic growth in different countries of the world.

1. Educational practices, training should cover virtually every aspect of the tourism management, policies and planning through to the withdrawal of visitors.
2. There should be schools in the respective directions, clear in tourism, and combining this with a specialization in HRM, and its special application in tourism.
3. Tourism sector organizations will focus on the performance of the employees and for identifying customer requirements, which will be a basis for development planning employer order.
4. To create a work culture where costumer pleasure and loyalty are key components of an individual performance in work.
ky ligj mund të zbatohet për objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, vetëm në rast se për to procedura e legalizimit nuk kërkon kalim pronësie mbi truallin. Ndërtim pa leje” është objekti, për të cilin është përfunduar konstruksioni dhe mbulesa, i destinuar për banim, veprimtari ekonomike dhe/ose funksione të tjera (si për shembull, social-kulturor, arsim, shëndetësi e të tjera të këtij lloji), për të cilin nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”. Në ndërtimet pa leje bëjnë pjesë edhe tejkalimet dhe shtesat informale të objekteve të ndërtuara me leje brenda vendbanimeve formale nga subjekte, persona fizikë dhe juridikë, privatë, për qëllime shitblerjeje/qiradhënieje (banesa, zyra, dyqane, punishte, parkim etj.) ose për vete. Përcakton detyrat e njesive vendore strukturave perkatese, dokumentacionin që duhet dorëzuar para tyre afatet perkatese, zyrat e vetedeklarimit, procedurat që duhet të ndiqen, marrja e vendimeve, kalimi I pronësisë dhe kompensimi I ish pronarëve.... Duke qene ne keto kushte konstatohet se permes ketyre ligjeve realisht nuk njihet e drejta e pronësisë së pronarëve 100% por konstatohen rastet e kompensimit që vijne si rrjedhojë e shpërndarjes në mënyrë të padrejtë të pronave të tyre apo të zaptimit të tyre nga të tjerë dhe legjitimitet epersise se të drejtës së jopronarit pronar dhe diskriminimit dhe zvarritjes se të drejtës së pronësisë së pronarit jo pronar.... Apo ish pronar....

### **Kuadri Kushtetues dhe Unifikues**

Perfshin ndryshimet që kanë ardhur përmes vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Duke qene ne keto kushte një rol të një rëndësie të vecantë ka luajtur dhe Gjykata e Lartë përmes vendimeve të saja Unifikuese si dhe Gjykata Kushtetuese, të cilat janë përpjekur për unifikim praktikë (por që njëkohësisht ka lënë vend për dykuptimesi në shumë raste dhe kanë zvarritur dhe me tej gjykimin e themelit të ceshtjeve duke vonuar kështu realizmin e të drejtave të pronësisë nga ana e subjekteve të shpronësuar). Ndryshimet që kanë sjellur ato mes të tjerave përfshijnë, shkrirjen e Zyrave Rajonale të Kthimit dhe kompensimit të Pronave në rrethe, kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm, Ankimet në rrugë administrative pastaj direkt në rrugë gjyqësore, përfshirja e ceshtjeve të tilla si gjykime civile dhe jo administrative si dhe kompetencën tokësore për shpërtimin e ceshtjeve të tilla nga ana e Gjykatës perkatese. Vendimet nr 27/2010 dhe 43/2011 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë ku evidentohet se kjo Gjykatë ka vlerësuar antikushtetues dispozitat ligjore të cilat legjitimonin AKKP në çështje të organit procedues që të vazhdonin trajtimin dhe shpërtimin e ankimeve të depozituara nga ZVASH, duke synuar marrjen e një vendimi përfundimtar me arsytimin se Autoriteti Shtetëror i cili duhet të trajtojë keto kërkesa duhet të gezojë statusin e një organi teresisht të pavarur dhe të paanshem sipas parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë. Duke qene ne keto kushte referuar vendimit nr 43/2011 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi (21 shtator 2011) AKKP, ka humbur juridiksionin dhe kompetencën në trajtimin e kesaj ceshtje dhe për këtë arsye ky organ procedues duhet të shprehet me vendimin e deklarimit të mungesës së juridiksionit.

**Në vendimin unifikues nr.24, datë 13.03.2002**, Kolegjet e Bashkuara janë shprehur se: “Në kohën e daljes së kuadrit ligjor për kthimin. e pronave ish pronarëve, ligjvënësi mund të parashikonte edhe rrugën gjyqësore të kërimit dhe kthimit të pronave të shtetëzuara apo konfiskuara padrejtësisht, por çmori më të përshtatshme rrugën administrative dhe të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimeve të organeve administrative të ngarkuara për këtë qëllim. Në rastin se do të pranohej zgjidhja e parë edhe analogjia do të ishte më dukshme



**Vendimin Unifikues nr.24, datë 13.3.2002.** Në këtë vendim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë analizuar dhe interpretuar natyrën dhe qëllimin e ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” si dhe nocioni kthim i prone të përdorur si në titullin e ligjit (*rubrica legis fit lex*), ashtu edhe në përmbajtjen e tij. Në këtë vendim Kolegjet e Bashkuara janë shprehur se: *“...Ligjvënësi me këto akte të rëndësishme normative ka njohur padrejtësinë, shkëljen e të drejtave të pronësise ish pronarëve dhe ka vendosur të rinjohë të drejtën e pronësisë së tyre duke ju kthyer pronat e shtetëzuara, të shpronësuara, të konfiskuara apo të marra pa të drejtë në forma të tjera, dhe në pamundësi, duke i kompensuar ato. Këto ligje, duke konsideruar të padrejtë atë që kish ndodhur më parë, parashikuan kthimin e të drejtave të pronarëve mbi pronën, kur objekt i saj ishin sende të paluajtshme.*

**Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr.25/2003** lidhur me subjektet që legjitimohen proceduralisht si paditës, thuhet se: *“... ndërsa në grupin e parë përfshihen subjektet që kërkojnë rivendosjen apo kompensimin e të drejtave të tyre si ish-pronarë (trashëgimtarë të ish-pronarëve), në grupin e dytë të subjekteve të legjitimuar proceduralisht përfshihen ato subjekte që kundërshtojnë, në emër të së drejtave apo interesave të tyre të ligjshme, përfitimet e paligjshme që mund të kenë realizuar subjektet e grupit të parë nëpërmjet vendimeve të komisioneve të pronave”.*

**Vendimin nr.4/2005** kanë arritur në përfundimin unifikues se: *“Pavarësisht nga momenti i regjistrimit të çështjes për gjykim (para apo pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri), në të gjithë rastet kur padia për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave është ngritur nga persona të tjerë që kanë fituar të drejta pronësie mbi pronat e trajtuara nga ky vendim, është gjykata ajo që ka juridiksionin për shqyrtimin e këtyre çështjeve”.*

**Vendimin Unifikues nr.7/2005,** Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se: *“... të gjitha çështjet, të cilat kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të Komisioneve të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish Pronarëve, që janë marrë në zbatim të Ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 dhe që janë kundërshtuar në gjykatë përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, janë në juridiksionin gjyqësor dhe jo në atë administrativn.*

**Vendimin Unifikues Nr 2/2011,** Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë ndryshuar qëndrim nga vendimi unifikues

**Vendimin Unifikues nr.2/2009** duke unifikuar praktikën me sentencën unifikuese se: *“... subjektet e shpronësuara kanë detyrimin që t’i drejtohen organit administrativ, pra A.K.K.P. së, vetëm në dy situata. Së pari, në rastin kur subjektet e shpronësuara paraqesin për herë të parë kërkesë për njohjen dhe kthimin e pronës në cilësinë e ish pronarit. Së dyti, në rastin e ankimit ndaj vendimit të dhënë në emër të tyre e mbi kërkesën e tyre nga (ish) Zyra Rajonale e A.K.K.K.P. (Vendimin Unifikues nr 4 dt 10-12-2013).*

Referuar Vendimit Unifikues nr 4 dt 10-12-2013 , i cili ka cituar se Kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo Agjencisë Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile. Në këto gjykime Kolegji Civil, në përcaktimin e kompetencës tokësore për shqyrtimin e këtyre çështjeve në varësi të natyrës së këtij gjykimi, objektit dhe shkakut ligjor të padisë, ka vendosur se duhet të zbatohen parashikimet e nenit 45 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me kompetencën tokësore: *“Paditë për të drejta reale mbi sende të paluajtshme, për pjesëtimin e sendeve të përbashkëta dhe për posedimin ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen sendet ose pjesa më e madhe e tyre...”* dhe jo parashikimet e nenit 327 të K.Pr.Civile, që thotë se: *“Padia kundër një akti administrativ shqyrtohet*

*nga seksioni përkatës i gjykatës, në zonën e së cilës ka qendrën organi administrativ, ndaj të cilit drejtohet padia”* (Përmenden disa nga vendimet: nr.429, datë 06.10.2011; nr.314, datë 14.06.2012; nr.397, datë 20.09.2012; nr.2179, datë 03.10.2013).

### **Referuar Praktikës së Strasburgut**

Në vendimin e GJEDNJ “Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në §36 dhe §77, kjo gjykatë vëren se: mosmarrëveshja lidhur me këtë të drejtë, e cila për nga natyra është një e drejtë civile, është një mosmarrëveshjeje ndërmjet shtetit dhe ankuesit, për të përcaktuar të drejtën e tij të pronësisë. Nëpërmjet vendimeve të Komisionit kompetent për çështjen në fjalë, shteti u njohu të drejtën e kompensimit ankuesve.... Gjykata vëren se në jurisprudencën e saj ajo ka shqyrtuar mosekzekutimin e një vendimi që njeh një titull pronësie, në kuadrin e fjalisë së parë të nenit 1 protokollit 1 (shiko *Burdov v. Russia*, nr.59498/00, § 40, ECHR 2002-III, *Jasiūnienė v. Lithuania*, nr.41510/98, § 45, 6 Mars 2003; *Sabin Popescu v. Romania*, nr.48102/99, § 80, 2 Mars 2004; dhe *Beshiri dhe të tjerë, i cituar më sipër § 99*). Rrethanat e çështjes konkrete janë të ngjashme me ato të çështjeve të sipërpërmendura dhe për këtë arsye ndërhyrja duhet trajtuar në kuadrin e fjalisë së parë të paragrafit të parë të nenit 1 protokollit 1, i cili përcakton parimin e gëzimit të qetë të pronës në terma të përgjithshme. Për të mos i cituar të gjitha vlerësimet e GJEDNJ në këtë vendim, përmenden konkluzionet në § 45, 50-52, 79-84 (ky vendim ka shërbyer si referencë pothuaj në çdo gjykim kundër Shqipërisë). Në këtë frymë GJEDNJ argumenton dhe në çështjet e tjera si *Nuri kundër Shqipërisë*, *Hamzaraj nr.1 kundër Shqipërisë* dhe në vendimin pilot *Puto kundër Shqipërisë*, etj. Edhe në çështjen *Maria Atanasiu dhe të tjerë kundër Rumanisë*, § 134. GJ.E.D.NJ. thekson se: “§134. ... se një ankues mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 vetëm në masën që vendimet e kundërshtuara lidhen me “pronat” e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite. Pronat” mund të jenë ose “prona ekzistuese” ose pasuri, duke përfshirë pretendimet në lidhje me të cilat ankuesi mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “pritshmëri të ligjshme” të përfuturit të gëzimit efektiv të një të drejte pronësie (...). Gjykata vëren më tej se neni 1 i protokollit nr.1 nuk mund të interpretohet sikur vendos ndonjë detyrim të përgjithshëm ndaj palëve kontraktuese për të kthyer pronën që u ishte transferuar atyre përpara se të ratifikonin Konventën (...). Nga ana tjetër, nëse një shtet kontraktues që ka ratifikuar Konventën, duke përfshirë protokollin nr.1, miraton legjislacion që parashikon kthimin e plotë ose të pjesshëm të pronës së konfiskuar sipas një regjimi të mëparshëm, ky legjislacion mund të konsiderohet se sjell një të drejtë të re pronësie të mbrojtur nga neni 1 i protokollit nr.1 për personat që përmbushin kërkesat e pranueshmërisë...” (Vendimin Unifikues nr 4 dt 10-12-2013).

Pra sic konsttohet Çështja e pronësise se subjekteve te shpronësuar, referuar ligjit per kthim dhe kompensimin e pronave ka pesuar ndryshime te njepasnjeshme qofte ne kuader ligjor apo dhe ne Praktike unifikuese te gjykates se Larte dhe Praktiken Kushtetuese duke sjellur zvarritje te gjykimit dhe cenim te se drejtes se pronësise e cila eshte konstatuar dhe nga Gjykimet ne Gjykate te Strasburgut te cilat kane arritur ne nje konkluzion unanim per demet qe i vijne pronarve subjeteve te shpronësuar si rrjedhoje e keqmenaxhimit te situates dhe zvarritjes se gjykimeve nga ana e organeve shteterore .

### **Subjekti i shpronësuar ne kendveshtrimin e hetimit administrative dhe gjyqesor**

Praktika Gjyqesore Shqiptare eshte e mbingarkuar me ceshtje te cilat kane per object

Shfuqizimin e vendimit te AKKP e cila eshte shprehur ne menyra te ndryshme lidhur me kerkesat e subjekteve te shpronesuar qe u jane drejtuar AKKP per njohje kthim dhe kompensim. Por cilat jane hallkat ne te cilat kalon procedura e njohjes ,kthim apo kompensim pronash , e cila eshte nje procedure e gjate qe nga faza administrative dhe gjer tek faza e ekzekutimit te vendimit . Ne kete seksion do te trajtoj shkurtimisht, fazen administrative, fazen gjyqesore , fazen ekzekutimit, perplasjet e legjislacionit ne keto faza dhe mbajtja e qendrimeve te ndryshme ndaj dispozitave ligjore , problematikat qe hasen ne keto lloj gjykimesh .

*Faza Administrative* : Para se te filloje procedura gjyqesore, subjekti I shpronesuar eshte drejtuar me pare AKKP , me kerkese per njohje kthim apo kompensim te prones object gjykimi se bashku me teresine e dokumentacionit qe parashikohet nga Ligji per Kthim dhe Kompensimin e Pronave dhe Aktet e tjera per zbatim te tij te parashikuara nga Ligji Nr. 9235, date 29.7.2004 “ Per kthimin dhe Kompensimin e Pronave” me ndryshimet perkates. Vendim nr 747 dt 09-11-2006 “ Per Procedurat e Mbledhjes , pepunimit dhe Administrimit te kerkesave te subjekteve te shpronesuar gjate procesit te njohjes kthimit apo kompensimit te prones(Permbledhje Legjislacioni per kthimin dhe kompensimin e prones, botim I Qendres se Publikimeve Zyrtare, Maj 2009- fq 28-29), ku percaktohet teresia e dokumentacionit ligjor dhe hartografik qe shoqeron kerkesen e subjektit te shpronësuar konkretisht : Dokumentacioni shoqërues, që vërteton pronësinë e subjektit të shpronësuar, përbëhet nga:a) **dokumentacioni ligjor**, i cili përmban, sipas rastit:i) vërtetimin e pronësisë, të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për efekt të kthimit dhe kompensimit të pronave;dokumentin kadastral (pranë zyrave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në këshillin e qarkut);vendimin gjyqësor të formës së prerë, së bashku me hartën e pasurisë, të vulosura me vulën e gjykatës;dokumentin, që vërteton heqjen ose marrjen e së drejtës së pronësisë së subjektit të shpronësuar nga shteti, sipas akteve, ligjore e nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose në çdo mënyrë tjetër të padrejtë, që nga data 29.11.1944, apo dokumentin për pasuritë e paluajtshme të shtetasve shqiptarë, të krijuara përpara datës 7 prill 1939, të cilat janë sekuestruar sipas nenit 14 të ligjit nr.37, datë 13.1.1945 “Ligja e tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës”;vendimet e mëparshme të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të marra sipas ligjeve nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” dhe nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë ose me troje të ish-pronarëve të tokave bujqësore, livadheve, kullotave, tokave pyjore dhe pyjeve”, vendimet e Komisionit/Komitetit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të marra sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të cilat janë marrë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar;dokumentin nga arkiva hipotekare (pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme);dokumentin nga Arkivi i Shtetit Shqiptar (kur dokumentet, hipotekare apo kadastrale, janë të depozituara në të, si dhe dokumentet, që vërtetojnë shpronësimin, konfiskimin apo shtetëzimin e pronës);dekretet e Presidentit, me objekt shpronësimin e ish-pronarëve;çdo dokument tjetër ligjor, i nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes;b) **dokumentacioni hartografik** për pozicionin gjeografik të pronës, i cili paraqitet në dy forma, i mëparshmi dhe aktual. Dokumentacioni hartografik i mëparshëm përmban planvendosjen e pronës, e cila mund të sigurohet nga:ministria përgjegjëse për punët publike, e cila ka në varësi arkivin qendror teknik dhe degët e saj në rrethe;departamenti i shërbimit të tokës dhe ujit (ish-Instituti i Studimit të Tokave) në QTTB, Fushë-Krujë;Arkivi i Shtetit Shqiptar;Drejtoria e Shërbimit Pyjor (arkivi i kadastrës pyjore);Bashkia/qarku

(arkivi hartografik i urbanistikës);këshilli i qarkut (zyra e administrimit dhe mbrojtjes së tokës).Dokumentacioni hartografik aktual përmban hartën aktuale, në varësi të vendit të pronës së pretenduar. Harta mund të sigurohet në një nga institucionet e mëposhtme:zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të gjitha zonat urbane dhe për zonat rurale, ku është bërë regjistrimi;Drejtoria e Shërbimit Pyjor, për pyjet dhe kullotat, dhe tokat e tjera jobujqësore;këshilli i qarkut (zyra e administrimit dhe mbrojtjes së tokës) për tokat bujqësore, të paregjistruara, dhe tokat e tjera jobujqësore;njësitë e legalizimit, pranë organeve të qeverisjes vendore apo Agjencia e Legalizimeve dhe Urbanizimit të Zonave Informale (ALUIZNI), të krijuara sipas ligjit nr.9482, datë 16.2.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.(Lidhja e Ligjit nr 9235 dt 29-07-2004” per kthimin dhe kompensimin e pronave dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij Fq-44). Vendim Nr 599, datë 17.7.2013 Per percaktimin e rregullave dhe te kritereve per shperndarjene fondit te kompensimit te Pronareve ne te holla per vitin 2013( fletore Zyrtare e Republikes se Shqiperise , Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Nr. 128 -2 gusht 2013, fq 5419), ku percaktohet Subjektet, që kanë aplikuar për kompensimin në të holla, të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: a) Kërkesën për kompensim financiar;; b) Deklaratën për pranimin e kritereve për kompensim dhe të kushteve të tjera që lidhen me to, c) Dëshminë e trashëgimisë, ç) Prokurën e posaçme. AKKP-ja shqyrton dokumentacionin e subjekteve që kërkojnë kompensim në të holla, duke kryer veprimet e mëposhtme: a) Verifikon dosjen dhe vendimin përkatës, të dhënë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. b) Kërkon nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që, brenda 10 (dhjetë) ditëve, të konfirmojnë, për: i) regjistrimin e vendimit përkatës në ZVRPP; ii) përcaktimin e gjendjes juridike aktuale të pronës dhe verifikimin nëse ajo ka ndryshuar nga momenti i daljes së vendimit me të cilin aplikohet; ....Merr vendimin për pranimin apo refuzimin e kërkesës për kompensim të subjektit të shpronësuar. ë) U dërgon subjektit të shpronësuar, Avokaturës së Shtetit dhe zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme kopje të vendimeve të marra për t’u dhënë mundësi të ushtrojnë

*Pavaresisht se c fare u citua ne baze te ligjies , problemet qe evidentohen ne fazen administrative dhe qe sjellin si pasoje rrezimin e kerkesave te subjekteve te shpronësuar ne kete faze por qe ne fazen gjyqësore rrezohen si te paargumentuara ne ligj konsistojne ne :*

- Mosparaqitjen e dokumentit te shpronësimit (ne te shumten e rasteve).
- Mosparaqitjen e teresise se dokumentacionit te plote te parashikuar nga ligji , qofte ligjor apo hartografik.
- Paraqitja e vendimit gjyqësor me object ‘ Vertetim Fakti ; si nje document I vetem per te vertetuar te drejten e pronesise
- Mos zhvillimi I nje correspondence korrekte mes AKKP dhe subjekteve te shpronësuar .
- Mos zhvillimi I nje correspondence brenda afateve kohore te parashikuara nga ligji mes AKKP dhe institucioneve te treta.
- Zgjatja e procedurave te vendimarrjes nga ana e AKKP te pajustificuara ne kohe qe tejkalojne ne maksimum afatet e parashikura nga ligji.
- Nderprerja e komunikimeve mes AKKP dhe subjekteve te shpronësuar .
- Mungesa e plan vendosjes
- Mungesa e Arsytimit te Vendimit ne te cilin eshte rrezuar
- Mosdhenia e te drejtes per kompensim pasi mungon deshmia e trashëgimnise se trashëgimtareve ligjore te subjekteve te shpronësuar

- Mosdhenia e te drejtes per kompensim pasi nuk ka fonde
- Mosdhenia e te drejtes per kompensim pasi prokurat nuk jane ne formen e kerkuar nga Ligji .
- Mosdhenia e te drejtes per kompensim pasi nuk jane hapur llogari bankare ne emer te secilit nga trashjegimtaret ligjore
- Mosdhenia e te drejtes per kompensim pasi institucionet e treta nuk kane kthyer pergjigje persa I perket prones object gjykimi lidhur gjendjen juridike te saj .

Duke qene ne keto kushte, AKKP pasi merr ne shqyrtim kerkesen e subjekteve te shpronesuar dhe dokumentacionin perkates kur konsiston ne arsyet e sipercituara ( ne te shumten e rasteve ) shprehet me rrezimin e kerkese duke refuzuar njohjen e te drejtes se pronesise . Brenda afatit ligjor te percaktuar ne Vendimin e AKKP, subjekti I shpronesuar I drejtohet Sistemit Gjyqesor per zgjidhjen e drejte te ceshtjes(cdo padi kunder AKKP eshte ngritur ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane , fakt I cili ndryshoi pas vendimit unifikues te gjykates se larte me nr 4/2013 ) dhe se sistemi gjyqesor ( ne te shumten e rasteve ) referuar shkaqeve te sipercituara mban kete qendrim :

### **Qendrimi I Gjykatave Shqiptare ne raport me shkaqet e sipercituara dhe arsyet e prishjes se vendimeve kur jane shkaqet e sipercituara**

*Mosparaqitja e dokumentacionit te shpronesimit* nuk eshte shkak qe subjektit te shpronesuar te mos u njihet e drejta e pronesise sidomos ne rastet kur eshte I njohur boterisht fakti qe Kushtetuta e Republikes se Shqiperise, viti 1976 , ka ndaluar te drejten e prones private dhe cdo pasuri kaloi ne emer te shtetit, duke qene ne keto kushte ish pronarit nuk mund ti kerkohet pajisja e nje dokumenti shpronesimi apo e nje vendimi apo e nje dekreti, I cili nuk mund te jete dhene per te gjithë shtetasit e kohes kur ndodhi shtetizimi . Duke qene ne keto kushte ky argument eshte I pabazuar dhe I paargumentuar ne ligj dhe nuk eshte shkak ligjor per mosnjohjen e te drejtes se pronesise kur subjekti I shpronesuar paraqet dokumentacion tjetër ligjor per njohjen e te drejtes se pronesise ( Qendri I mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe Gjykata Apelit te pasqyryar ne vendimarrje).

*Mosparaqitjen e teresise se dokumentacionit te plote te parashikuar nga ligji* , qofte ligjor apo hartografik, gjykata ka arritur ne konkluzionin se nuk eshte e domosdoshme te paraqitet e gjithë teresia e dokumentacionit ligjor dhe hartografik te parashikuar nga ligji , por per njohjen e pronesise eshte e mjaftushme te paraqitet dokumentacion ligjor qe cmohet I arsyeshem nga ana e Gjykats me ane te se ciles jepen te dhena pronesie, kufizime , vendodhje , planvendosje , e cila ne vetvete perben dokumentacion ligjor dhe hartografik qe jep te dhena per pronen object gjykimi me ane te se ciles krijohet bindja e plote dhe e pakontestushme lidhur me pronen dhe subjektine shpronesuar( Qendri I mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe Gjykata Apelit te pasqyryar ne vendimarrje).

*Paraqitja e vendimit gjyqesor me object ‘ Vertetim Fakti ;* si nje document I vetem per te vertetuar te drejten e pronesise , nuk perben shkak ligjor per rrezim te kerkeses se subjektit te shpronesuar I cili ka paraqitur Vendim Gjykate me object ‘ Vertetim Fakti” I cili eshte I ligjshem , nuk eshte kontestuar , ka marre forme te prere dheperben prove ligjore [asi shume ceshtje te rendesishme jane zgjidhur permes :Vertetim Fakti” ndaj ky document I paraqitur prane AKKP nuk duhet te anashkalohet dhe ti humbase vlere pasi eshte nje document I mirefillte ligjor, aq me shume ne fazen e tranzicionit qe ka kaluar vendi yne qe shume dokumente nuk figurojne si rrjedhoje e trazirave politike nder vite .

(Qendri I mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe Gjykata Apelit te pasqyryar ne vendimarrje).

*Mos zhvillimi I nje correspondence korrekte mes AKKP dhe subjekteve te shpronesuar.* Mos zhvillimi I nje correspondence brenda afateve kohore te parashikuara nga ligji mes AKKP dhe institucioneve te treta, Zgjatja e procedurave te vendimarrjes nga ana e AKKP te pajustificuara ne kohe qe tejkalojne ne maksimum afatet e parashikura nga ligji. Nderprerja e komunikimeve mes AKKP dhe subjekteve te shpronesuar , nuk perben shkak ligjor per rrezimin e kerkeses se subjekteve te shpronesuar pasi subjekti I shpronesuar nuk duhet te penalizohet si rrjedhoje e mospermbushjes se detyrimeve ligjore nga ana e insitucioneve shteterore dhe organeve te administrates publike te cilat duhet ti sherbejne qytetarit Brenda afatit ligjor , dhe jo ta zvarrisin pambarimisht ate duke cenuar te drejten e tij te pronesisë.

*Mungesa e plan vendosjes,* permes aktit te ekspertimit ne gjykate ne te shumten e rasteve percaktohet pozicionimi I saj, pra eshte pune e ekspertit , nese gjen zgjidhje ne Gjykate permes detyrave te lena nga eksperti , me te drejte lind pyetja se perse qenka e pazgjidhshme ne rruge administrative ku dhe AKKP eshte e pajisur me eksperte topografe ,vleresues etj....

*Mungesa e Arsytit te Vendimit* ne te cilin eshte rrezuar , perben shkak per prishje te vendimit te leshuar nga AKKP , conform nenit 116 te k Pr Administrative

*Mosdhenia e te drejtes per kompensim pasi mungon deshmia e trashegimnise se trashegimtareve ligjore te subjekteve te shpronesuar. Mosdhenia e te drejtes per kompensim pasi prokurat nuk jane ne formen e kerkuar nga Ligji . Mosdhenia e te drejtes per kompensim pasi institucionet e treta nuk kane kthyer pergjigje persa I perket prones object gjykimi lidhur gjendjen juridike te saj ,* nuk jane shkaqe ligjore qe merren ne considerate nga Gjykta pasi kete ceshtje jane ezauruar gjate fazes fillestare administrative kur eshte vendosur per njohjen e pronesisë , kthimin fizik te siperfaqes perkatese dhe kompensimin ne ato raste kur nuk eshte e mundur kthimi fizik . Ne momentin qe njeri nga kerkuesit kushto nga trashegimtare ben kerkesë per kompensim AKKP , nuk mund te hape nje hetim administrative themeli duke rikerkuar deshmi trashegimnie apo prokura apo konfirmim juridik pasi subjekti shpronesuar nuk po kerkon gje te re , por po kerkon ate c fare AKKP ja ka njohur , ka mbetur ne fuqi eshte bere titull ekzekutiv , kur paraqiten prane AKKP per kompensim kerkojne kompesnimin e asaj qe u eshte njohur me pare, dhe aq me shume qe nuk duhen sanksionuar subjektet e shpronesuar se mungon korrespondenca me institucionet e treta apo se ato nuk jane shprehurlidhur me konfirmimet juridike te pronesisë.

*Mosdhenia e te drejtes per kompensim pasi nuk ka fonde .Mosdhenia e te drejtes per kompensim pasi nuk jane hapur llogari bankare ne emer te secilit nga trashegimtarete ligjore,* jane shkaqe te paargumentura dhe jot e mbeshtetura ne ligj te cilat gjykata nuk I merr ne considerate dhe prish vendimin e AKKP I cili paraprakisht ka rrezuar te drejten pe kompensim te subjektit te shpronesuar.

Pra duke qene ne keto kushte Gjykatat e Rretheve Gjyqesore apo te Apelit ( Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane , Gjykata e Apelit Tirane, ceshtjet e ndjekura personalisht nga une ne cilesine e Avokatit te Shtetit , periudha 2011-2015 ) kane mbajtur nje qendrim te tille, duke unifikuar vete procedure e njohjes kthim apo kompensim te prones nisur nga fakti gjate hetimit administrative cmohen se u cenohen shume te drejta subjekteve te shpronesuar te cilat I argumentojne si ligjore por qe rrezohen ne Gjykim , duke sjellur si pasoje boshllek ligjor dhe shfuqizim de fakto te dispozitave ligjore te parashikuara nga Ligji .

## Qendrimi i Strasburgut lidhur me ceshtjen e pronesise ne Shqiperi

Neni 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore citons e Cdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohe drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e cdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar”. Neni 1 të Protokollit shtesë i Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore parashikohet se :Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.....

tek ÇËSHTJA RAMADHI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË (ANKIMI NR.38222/02) VENDIM STRASBURG -13 NËNTOR 2007, ÇËSHTJA DRIZA KUNDËR SHQIPËRISË(ANKIMI NR.33771/02)VENDIM-STRASBURG-13 NËNTOR 2007 *atribuohej moszbatimin e vendimeve të formës së prerë sa më poshtë:“...çështjet e hasura deri tani lidhen me mungesën e koordinimit ndërinstytucional në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe ndëroperueshmërinë e arkivave të këtyre institucioneve (...) Legjislacioni i pronësisë është i copëzuar dhe duhet të konsolidohet dhe thjeshtohet, me qëllim parashikimin e procedurave të thjeshta dhe transparente të kompensimit. Procesi i regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme në të gjithë vendin nuk kishte përfunduar ende. Nuk ekzistonte një hartë kombëtare e unifikuar prone. Agjencia nuk ka një bazë të unifikuar të të dhënave të vendimeve (...) Procesi i legalizimit nuk kishte përfunduar ende dhe identifikimi i pronave që do të bëheshin pjesë e Fondit të Kompensimit në Natyrë, nuk kishte përfunduar. Mosmarreshja lidhur me kete te drejte , e cila per nga natyra eshte nje e drejte civile eshte nje mosmarreshje mes shtetit dhe ankuesit , per te percaktuar te drejten e tij te pronesise . Permes vendimeve te komisioneve kopetente per ceshtjen ne fajle shteti u njohu te drejten e kompensimit ..... Gjykata veren se ne jurisprudencen e saj ajo ka shlyrtuar mosekzekutimin e nje vendimi qe nje nje titull pronesise ne kuader te fjalise se pare te nenit 1 Protokollit 1.( Standartet e gjykimit civil, Administrativ dhe Penal permes Vendimeve Unifikuese te Gjykates se Larte, 2002-2014, Klotilda Bushka (Ferhati) Alma Kodraliu Irida Kacerja, Tirane 2014).Gjetje te ngjashme sugjerojne se praktika legjislative dhe gjyqesore, duke perfshire dhe ekzekutimin e vendimeve le per te deshruar pasi sjell zvarritje te perfitimit te te drejtave te njohura Kushtetuese. Ne ceshtjen MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË (Vendim 31 korrik 2012-Strasburg konstatohet mosekzekutimi ivendimeve qe marrin forme te prere qe ne vetvete sjellin shkelje te se drejtes per nje proces te rregullt ligjor Një vonesë e gjatë në mënyrë të paarsyeshme për zbatimin e një vendimi detyrues mund të shkaktojë shkeljen e Konventës (...). Arsyeshmëria e kësaj vonese duhet të përcaktohet duke marrë parasysh veçanërisht kompleksitetin e procedurave përmbartimore, sjelljen e vetë ankuesit dhe të autoriteteve kompetente, si dhe shumën dhe natyrën e vendimit të gjykatës (...).Kompleksiteti i procedurës së brendshme përmbartimore ose të sistemit buxhetor të Shtetit nuk mund të lehtësojë Shtetin nga detyrimi i tij sipas Konventës, për t’i garantuar çdokujt të drejtën për zbatimin*

e një vendimi gjyqësor të zbatueshëm dhe detyrues, brenda një afati të arsyeshëm. Nuk i takon një autoriteti shtetëror që të citojë mungesën e fondeve ose burimeve të tjera (si për shembull strehimi) si justifikim për mosrespektimin e një detyrimi sipas një vendimi gjykate (...) I takon Shteteve Kontraktuese të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që autoritetet kompetente të mund të përmbushin detyrimin e tyre në këtë drejtim (...).”

### Konkluzione

Permes ketij punimi dua te citoj faktin se procesi i njohjes kthim dhe kompensimit te prones subjekteve te shpronuesar eshte nje proces i cili po zvarritet gjithnje e me shume dhe nuk po gjen zgjidhje, zvarritje te cilat jane te panevojshme dhe te ekzagjeruara qe nuk sherbejne ne zgjidhjen e drejte te ceshtjes por ne konfondimin e metejshem te saj, ne zvarritjen, cenimin e te drejteave te pronesise, perplasje te siperfaqeve te pronave , ligje te ndryshme qe njohin pronar te ndryshem dhe qe lenë peng pronarin e vetem duke penalizuar ne kete menyre per vite me rralle subjektet e shpronuesar dhe duke u zvarritur pambarimisht rrugeve te institucioneve zyrtare dhe hallkave te gjyqesorit te ashtequajturit subjekte te shpronuesar .Eshte e domosdoshme qe te mirret ne konsiderate dhe te unifikohet praktika administrative permes praktikës gjyqesore , arsyet e rrezimit te vendimeve te AKKP ne gjykate nese jane apo jo te drejta , cfare mund te permisohet ...unifikim persa i perket dhe menyres se kompensimit pasi dhe Ligjiparashikon forma te tjera te kompensimit te cilat nuk zbatohen dhe nuk merren ne konsiderate nga AKKP, marrja e masave shternguse nga ana e Institucioneve te tjera zyrtare qe bashkpunon AKKP per dhenie informacioni brenda afateve te arsyeshme, sanksione ne rast te moskthimit te pergjigjes nga ana e insitucioneve shtetore te fjetura qe zvarrisin dhe cenojne te drejtat e taksapaguesve dhe shtetasve shqiptare , unifikim te praktikës se AKKP dhe marrja e masave qe te mos nxirren pengesa ne proceduren e ekzekutimit te vendimeve, pasi dhe permes kesaj cenohen te drejtat e pronesise se subjekteve te shpronuesar .

### Referenca

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, "Grand Prind" 2006.  
Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Ligji Nr.5506, datë 28.12.1976.  
Kodi Civil I perditesuar me praktike gjyqesore Alb juris 2014.  
Rreth Konventës Evropiane. Komentari I shkurtër mbi konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut, Marek Antoni Nowicki, Tirane 2003.  
Permbledhje Legjislacioni për kthimin dhe kompensimin e prones, botim I Qendres se Publikimeve Zyrtare, Maj 2009.  
Pronesia mbi token. Av Delo Mecani . Albpaper .  
Ligji Nr. 9235, date 29.7.2004 " Per kthimin dhe Kompensimin e Pronave" me ndryshimet perkatese . Ligjin Nr 7501 dt 19-07-1991 ' Per token" me ndryshimet perkatese . Ligji Nr 9482 dt 16-02-2006 " Per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje.  
Vendim nr 747 dt 09-11-2006 " Per Procedurat e Mbledhjes , pepunimit dhe Administrimit te kerkesave te subjekteve te shpronuesar gjate procesit te njohjes kthimit apo kompensimit te prones . Vendim Nr 599, datë 17.7.2013 Per percaktimin e rregullave dhe te kriterëve per shperndarjane fondit te kompensimit te Pronareve ne te holla per vitin 2013( Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë , Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Nr. 128 -2 gusht 2013.



Vendimet nr 27/2010 dhe 43/2011 te Gjykates Kushtetuese te Republikes se Shqiperise.

Vendim Unifikues I Gjykates se Larte Nr 5 /2011. Vendim unifikues nr.24, datë 13.03.2002, te Kolegjeve te Bashkuara. Vendimin Unifikues nr.24, datë 13.3.2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr.25/2003 Vendimin nr.4/2005 Vendimin Unifikues nr.7/2005, Vendimin Unifikues Nr 2/2011, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë Vendimin Unifikues nr.2/2009, Vendimit Unifikues nr 4 dt 10-12-2013 , i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte .

Çeshtja Ramadhi dhe te tjere kunder Shqiperise( Ankim Nr 38222/02-Vendim Strasburg 13 Nentor 2007.

Ceshtja Driza Kunder Shqiperise ( Ankim nr 33771/02-Vendim Strasburg 13-nentor 2007.

Ceshtja Manushaqe Puto dhe te tjere kunder Shqiperise Vendim 31 korrik 2012-Strasburg.

Standartet e gjykimit civil, Administrativ dhe Penal permes Vendimeve Unifikuese te Gjykates se Larte, 2002-2014, Klotilda Bushka (Ferhati) Alma Kodraliu Irida Kacerja, Tirane 2014.

## Sovraniteti në aktualitetin shqiptar ( Filozofi Politike )

**Arben Voci**

*Fakulteti i Shkencave Sociale, UT*

### Abstrakt

Nëse shtrohet pyetja rreth elementeve të veçanta, nga të cilat përbëhet një bashkësi sho-qërore demokratike, arrihet domosdoshmërisht të thënia, sipas së cilës demokracia është sundim i popullit. Të njëjtën gjë nënkupton edhe përkthimi nga greqishtja i fjalës “demokraci”. Në çdo kushtetutë demokratike, në këtë apo në një formë tjetër gjendet thënia, sipas së cilës populli është bartësi i fundit i gjithë sovranitetit. Sipas saj, pushteti është i legjitimuar në mënyrë demokratike vetëm në rast se ai ka dalë nga vullneti i lirë dhe me miratimin e popullit. Nëse qeverisja e popullit përmes popullit, në kohën tonë është e pamundur për shkak të arsyeve të bre-ndshme dhe të jashtme, atëherë mbetet si konkretizim i sovranitetit të popullit para së gjithash zgjedhja e përfaqësuesve, të cilët më pas e udhëheqin me përgjegjësi qeverinë sipas vullnetit të popullit dhe me miratimin e tij. Me themelimin e shtetit shohim të lidhur ngushtë problemin e sovranitetit, pasi kemi de-legim të tij, nga individit në drejtim të shtetit. Këtu së pari merret mendimi politik. Para se të jetë objekt i të drejtës kushtetuese, i të drejtave në përgjithësi, ai, sovraniteti së pari shihet dhe trajto-het brënda hapsirave të filozofisë.

Natyrshëm në realitetin politik shqiptar lind pyetja sa Sovran është populli dhe si sillen bartësi i sovranitetit me sovranin?

Vendimi mbi çështjet detale i lihet përfaqësuesve të zgjedhur; zgjedhësi vetëm duhet të vendosë në mes kandidatëve të prezantuar nga partitë dhe t'i zgjedhë ata, për të cilët në kushte të rëndomta, për shkak të përkatësisë së tyre partiake mendon se do të bëjnë politikë në kuptimin e bindjeve dhe interesave të tij. Këtu do kishte përsëri një ndalesë. A i plotësojnë zgjedhjet në Shqipëri kushtet dhe standartet për të qënë vërtetë demokratike? Ai që do t'i japë kuptim vullnetit të popullit duke marrë në konsideratë aktin e daljes në zgjedhje duke i bërë ato në këtë mënyrë instrument vendimtar të konkretizimit të sovranitetit të popullit, duhet të parashtojë fillimisht disa kërkesa. Të zgjedhurit mund të lidhen me vullnetin e zgjedhësve vetëm nëse ata detyrohen të zgjidhen rregullisht në intervale periodike kohore, për të marrë pëlqimin e zgjedhësve për punën e tyre të deritanishme dhe për vazhdimin e saj në të ardhmen. Vetëm në këtë mënyrë, të zgjedhurit detyrohen të respektojnë bindjet dhe interesat e zgjedhësve të tyre. Përveç kësaj, populli zgjedhës duhet të ketë mundësinë e vërtetë të zgjedhjes. Zgjedhjet duhet t'i ofrojnë atij alternativa të ndryshme të pavarura dhe personale. Listat me kufij të përcaktuar janë simptoma të diktaturës.

E drejta e përgjithshme dhe e barabartë e votës është realizuar jo ngaqë me ndihmën e saj mundësohet zgjedhja e qeverisë “më të mirë”, por sepse ajo është provuar si metoda më e mirë dhe praktike për sigurimin e paqes sociale.

**Fjalë kyçe:** *Demokraci, Qytetar, Sovranitet, Pushtet, Zgjedhje.*

### Hyrje

Doktrina e sovranitetit të popullit hodhi poshtë pikëpamjen tradicionale, sipas së cilës, mbretit apo princit i takonte pushteti për shkak të prejardhjes nga dinastia e tij e dhuruar nga Zoti. Në themel të kësaj doktrine është përjashtimi, ndërhyrja e qytetarit. Në këtë ndarje themelo-re të sunduesve dhe të të sunduarve qëndron thelbi i antagonizmit mes demokracisë dhe monar-kisë. Demokracia nuk i njeh shtetit pushtetin

e lartë të ndarë ngafuqitë mbinatyrore, por e njeh atë si rezultat të vullnetit të të gjithë individëve pjesëmarrës në angazhimin e tyre për zgjidhjen e detyrave të përbashkëta. Në këtë kontekst, forma dhe përmbajtja e shtetit nuk i janë paracaktuar popullit si të tilla, por ato rrjedhin nga vetë ai. E tërë kompetenca e tyre mbi këto detyra, nga zgjidhja e të cilave janë të prekur të gjithë, quhet me fjalë të tjera sovraniteti i popullit.

Si edhe Hobsi, Ruso pushtetin më të lartë sovran e shikon te pushteti ligjvënës dhe pu-shteti ekzekutiv (*Midgaard, 2007:105*). Mendimet politike të Rusos ngjajnë fort me ato të Aristotelit por e reja që sjell Rusoo është se ai e vë theksin mbi rëndësinë e bashkëveprimit të të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë, në mënyrë të veçantë në nxjerrjen e ligjeve (*Midgaard, 2007: 107*). Ai thoshte se sovraniteti është i pandashëm për të njëjtën arsye se është edhe i patjetërsueshëm. Të ndash sovranitetin qysh në parimet e tij, do të thotë ta vrasësh atë. (*Guchet, 2001: 174*).

Kush është mbajtësi i sovranitetit?

Per Bodenin është monarku absolut. Duhet quajtur sovran, cdo pushtet qe është vendosur dhe ek-ziston ne fakt ne nje shtet. Shoqeria qe e dorezon pushtetin ne baze te kontrates shoqerore nuk është me mbajtëse e tij. Blekstoni, quan sovran parlamentin anglez, te cilit i atribuon pushtet te pakufizuar. Per Hobbsin dhe Spinozen ceshtja e mbajtësit te sovranitetit varet nga forma konkrete te e qeverisjes se shtetit. (monarki-mbreti etj).

Me themelimin e shtetit shohim të lidhur ngushtë problemin e sovranitetit, pasi kemi delegim të tij, nga individit në drejtim të shtetit. Këtu së pari merret mendimi politik. Para se të jetë objekt i të drejtës kushtetuese, i të drejtave në përgjithësi, ai, sovraniteti së pari shihet dhe trajto-het brënda hapsirave të filozofisë.

Për Ruso teoria e sovraniteti të popullit thotë se populli është bartës i pushtetit sovran, e jo monarku. Për të sovraniteti është dukuri e pandashme dhe jo e delegueshme deri në heqje dorë nga sovraniteti i vetë popullit për t'ja deleguar shtetit. Sovraniteti i popullit realizohet para së gji-thash nëpërmjet formave të demokracisë direkte. Ndonëse më pas nuk është konsekuent në këtë qëndrim, kur pranon kryerjen e sovranitetit nga ana e përfaqësuesve dhe trupave përfaqësuese. Në politikën moderne flitet shpesh për vullnetin e popullit, pa qenë e qartë se ç'nënkuptohej saktë- saktësisht me këtë nocion. Rusoi besonte se kishte arritur të ndërtonte vullnetin e përbashkët të popullit; sipas tij, ai duhet të jetë identik me të mirën e përgjithshme. Megjithatë, edhe ai ishte i detyruar ta paraqiste në teorinë politike vullnetin e shumicës si të barabartë me vullnetin e përba-shkët dhe të shtypte pakicën devijuese, sepse, sipas tij, ajo ka vullnet të gabuar. Nuk mund të je- mi plotësisht me Ruso-in kur bëhet fjalë për identifikimin e vullnetit të shumicës me të mirën e përbashkët. Përvoja ka treguar se edhe shumicat gabojnë. Për më tepër në kushtet e Shqipërisë çështja e shumicës është relative. A është shumica shprehje e vullnetit, zgjedhjes së qytetarëve? Për këtë arsye është i nevojshëm një sistem i tillë qeveritar, i cili nuk i shtyp, por i respekton pa- kicat dhe prefill njëkohësisht vullnetin e shumicës, sepse ai i afrohet më tepër idesë të së drejtës për vetëvendosje, duke respektuar domosdoshmërinë e bashkëjetesës. Nga praktika e deri më so-tme e zgjedhjeve parlamentare vërejmë kundërvënien të hapur ndaj “Kodit Etik”, konstatohet qar-të tendenca e “harresës etike” apo dhe e manipulimit elektoral, deformim i votes etj.

Ne shek. XIX Dë Mestrë- sovraniteti i perket shtetit ne teresi si person abstrakt juridik. Per popullin flitet ne 2 drejtime: si pjesemarrës ne pushtet dhe si objekt i pushtetit. Populli si një masë homogjene dhe kompakte ka nje karakter relativ, kur populli ndahet ne grupe antagoniste me karakter klasor ose etnik. Dallimi midis klasave dhe rendeve.

Ka autorë që konstatojnë se “sovraniteti i popullit është parullë e demokracisë “. Sovra-

niteti nuk është kategori absolute. Individit, shoqëria ka më shumë se sovraniteti, ndaj me sovra-nitet do të kuptojmë vetëm një cilësi të popullit, por që njëkohësisht është dëshmesë e zhvillimit të një populli. Populli qeveris punët shtetërore, nëse këtë pushtet e ushtron shumica e popullit. Nuk mund të pretendojmë dhe nuk mund të ketë sovranitet kur pushtetin e ushtron pakica e popullit apo më keq një klikë. Parimi i shumicës është rrjedhoja e vetme e munshme nga pikëpa-mja demokratike mbi njeriun, e cila nisat nga njeriu i pjekur në një botë të lirë dhe merr parasysh konfliktet e mendimeve dhe të interesave në mes njerëzve. Pranimi i parimit të shumicës nuk do të thotë që politikani përgjegjës duhet të bazohet vetëm në mendimin e masës. Megjithatë, pari-misht parimi i sovranitetit të popullit mund të konkretizohet vetëm nëpërmjet parimit të shumicës, si bazë e veprimit politik. Për këtë arsye, demokracia moderne nuk është vetëqeverisje e popullit. Ajo sot mund të realizohet si qeveri e përfaqësuesve të popullit, të dalë nga zgjedhjet e përgjithshme, të lira, të barabarta dhe të fshehta, të cilët mund të detyrohen prej tij, të marrin de-tyrat qeveritare dhe ta udhëheqin vendin sipas vullnetit të shumicës përkatëse të forcave politiko shoqërore të një kombi. Këtu vimë në konstatim shumë të rëndësishëm që lidhet me idenë, kup-timin, përkufizimin e qytetarisë.

Së pari qytetaria ka një kuptim juridik. Qytetari nuk është një individ konkret. Qytetari është një subjekt i të drejtës. Me këtë titull, ai zotëron të drejta civile dhe politike. Ai gëzon të drejta individuale dhe të drejta politike. Për më tepër, ai ka detyrimin për të respektuar ligjet, për të marrë pjesë në shpenzimet kolektive, në funksion të burimeve të tij dhe të mbrojtje shoqërore ku bën pjesë, në rast se kërcënohet. Qytetaria është, gjithashtu, një parim i legjitimitetit politik. Qytetari nuk është vetëm një subjekt i të drejtës individuale. Ai është bartës i një pjese të sovranitetit politik. Është bashkësia e qytetarëve, të ngritura në kolektivitet politike, ose në “komunitete qytetarësh” që, me anë të zgjedhjeve, zgjedh qeveritarët. Është bashkësia e qytetarëve që është buri-mi i pushtetit dhe që justifikon se vendimet e marra nga qeveritarët do të zbatohen. Është bashkësia e qytetarëve që kontrollon dhe sanksionon veprimin e qeveritarëve të dalë nga zgjedhjet. Të qeverisurit pranojnë se, ata duhet tu binden urdhërave të qeveritarëve, sepse ata që japin këto urdhëra, janë zgjedhur prej tyre dhe mbeten nën kontrollin e tyre. Është bashkësia e qytetarëve që zotëron sovranitetin. Ky është kuptimi i shprehjeve tepër të njohura, qytetari është “mbret”, ose qytetari është “Sovran”.

Qytetaria është edhe burim i lidhjes sociale. Në shoqërinë moderne demokratike, lidhja ndërmjet njerëzve është politike. Të jetosh në bashkësi, kur flasim për lidhjen politike mes njerëzve, do të thotë të jesh qytetar i të njejtin organizim politik, në kushtet kur ka më shumë se një të tillë. Parimi i legjitimitetit trasmetohet progresivisht në të gjitha format e jetës sociale. Shoqëria e qytetarëve, në institucionet e saj politike dhe sociale, në shkëmbimet më të përditshme, nuk ngjan me asnjë model tjetër. Çdo qytetar, duke marrë pjesë në të njejtin sovranitet ka të drejtën për të njejtin respekt, ka të drejtë që të shikojë se dinjiteti i tij pranohet. Marrëdhëniet ndërmjet njerëzve bazohen mbi një dinjitet të barabartë të të gjithë qytetarëve. Ideja e qytetarisë, në vendet demokratike, është bërë aq e brendshme sa që ajo duket si e natyrligje. Formula “një njeri, një votë”, që reflekton këtë kuptim, duket si e nënkuptuar dhe që nuk mund të diskutohet.

Çdo ditë provojmë ndjenjën, se kur ka të bëjë me politikën, nuk gjejmë aty përfaqësuesit e drejtpërdrejtë të votuar nga populli, por më shumë me një aparat burokratik. Dhe mentaliteti i efikasitetit ka përfshirë shumë fusha të jetës, ashtu si në ekonomi. Jürgen Habermas e ka provuar këtë ndjenjë. Më shumë se kaq: Një demokraci burokratike masive, brenda së cilës disa pak vetë merren vesh për kompromise jotransparente, si edhe

“ekonomizimi i jetës”, këto janë karakteri-stika të shoqërisë moderne, mendon Habermas. Për këtë arsye ai kërkon përfshirjen më të madhe të shoqërisë civile, pak a shumë ky është koncepti i futur nga Habermas i “opinionit publik liberal” si dikur, kur qytetarët takoheshin në kafene për të diskutuar e për të pasur ndikim në shoqëri.

Pushtet politik suprem, fillestar (origjinar) ne kuptimin qe nuk rrjedh nga ndonje pushtet tjetër ne sensin juridik dhe eshte i pakushtezuar nga pushtete te tjera. Prej ketij pushteti politik rrjedhin dhe legjitimohen te gjitha pushtetet e tjera.

A është e mundur që shoqëria shqiptare të ndërtojë rendi social nisur nga parimi liberal i autonomisë së individit? Na ndihmon në përgjigje Edmund Barkes. Ai dënon racionalizmin poli-tik dhe denoncon i fanatizmin ideologjik ku, sipas tij, do të shkohej në mënyrë të domosdoshme. Shpallja e të drejtave të njeriut të vlefshme në çdo kohë dhe për të gjitha vendet, nuk merr para-sysh kushtet reale të jetës së njerëzve që tashmë ndodhen në një shoqëri të formuar, trashëguese e një historie të veçantë. Nuk mund të nisesh kurrë nga një *tabula rasa*. Qytetari, dhe jo njeriu i turmës, ndodhet në një gjendje të shqetësuar. Ai ndodhet i kapur ndërmjet parimit dhe mekanizmit formal të demokracisë, nga njera anë, dhe, nga ana tjetër, realiteti i demokracisë: disa as-pekte reale të demokracisë duket se i kundërshtojnë këto parime, duke i penguar, ose duke i bërë të kota, këto mekanizma. E tillë është aktualisht shqetësimi njëherësh civil dhe intelektual, poli-tik dhe shkencor i demokracisë aktuale. Që në krye të herës përcautoam se demokracia është sun-dim i shumicës, Kjo nuk le vend për hamendje as në Shqipërinë e pas '90. Problemi qëndron se a sundon vërtetë shumica? Në çfarë rruge, mënyrash pushteti ka siguruar shumicën? Si sillet ai, pushteti, me pakicën?

Organet demokratike - janë organe shtetërore që vijnë në pushtet në mënyrë demokratike, me anë të zgjedhjeve ku i zgjedh vetë populli. Organet burokratike - janë organe shtetërore që përcaktohen nga ndonjë subjekt më i lartë shtetëror, por jo nëpërmjet zgjedhjeve demokratike, Paradoksi në demokracinë tonë qëndron pikërisht në rolin, funksionet, peshën që kanë këto orga-ne. Tashmë u bë kulture, mënyrë të kuptuari, sjelljeje dhe pune që nka rotacione pushteti kemi rotacion deri në nivelet fundore të administratës. Partia, grupi fitues, që përbën maxhorancën në një fare mënyre realizon “përrjashtimin social” të minorancës. Kjo praktikë sjell sipas rotacionit mendimin se kështu funksionon demokracia ndaj duhet dashur ose urryer, në varësi të pozicionit se ku gjendet. Vërtetë kemi sundim të shumicës, por kjo nuk është demokraci, por Ohlokraci. Sundimi i shumicës është sundim i dhunshëm. Mungon ne jeten politike shqiptare vullneti, deshira per te bere divorc me kete menyre te ushtrimit te pushtetit, si rrjedhoje, menyre e funksio-nimit te demokracise, sepse pa kete stimul nxitjeje per militantet e tyre ndjehen te pa fuqishem per te ardhur ne pushtet. “Ka raste në historinë e botës kur buxheti i shtetit dhe punësimet në administratën publike kthehen në një plaçkë lufte. Disa vende e kanë përjetuar këtë situatë dhe nuk kanë dalë kurrë shumë mirë dhe as shumë lehtë prej saj.” (spoils system). Natyrshem ketu do te benim pyetjen: **Ç’është shteti** ? Shteti është shprehje e nevojës që ndien shoqëria për ekzisten-cën e një pushteti të organizuar, të paisur me mjetet e duhura të shtrëngimit dhe të aftë për ta dre-jtuar vetë shoqë-rinë, duke i imponuar zgjidhjet që atij i duken të arësyeshme, nëpërmjet norma-ve juridike. Termi “Shtet” përdoret në dy kuptime: në kuptimin e një organizate politike në sho-qëri dhe

në kuptimin politiko-geografik. Shteti, si organizatë e sundimit politik, është një fuqi e organizuar, e cila vullnetin e saj ia imponon gjithë shoqërisë dhe disponon një aparat të tërë për zbatimin e këtij vullneti. Pushteti politik, që sigurohet nëpërmjet shtetit, nuk është qëllim në vet-vehte, por mjet për të vënë në zbatim një politike të caktuar. Fjalja e fundit dale nga literatura hu-mbet vleren reale në Shqipëri. Perkufizimi formal do të qe: shtetit, është qëllim në vetvehte, mjet për të vënë në zbatim një politike të caktuar, që në praktike e shohim të konkretizuar si politika në favor të një grupi, klani të caktuar. Ekzistenca dhe roli partive politike në këto lloj realiteti është një shtrenberim dhe handicap i shoqërisë shqiptare. Partitë politike janë forma të veçanta të organizimit social. Për Giovanni Sartori, i cili ligjëroi për një kohë të gjatë në Universitetin e Ko-lumbisë në New York dhe është një nga hulumtuesit më të njohur të partive politike, e definon një parti si: “cili do grup politik i identifikuar me një emërtim zyrtarë i cili paraqitet gjatë zgjedhjeve, dhe ka aftësi që nëpërmjet zgjedhjeve të vendos kandidatat për zyrën publike.” Partitë jo vetëm se mundohen që të marrin pjesë në formimin e opinionit politik. Ato gjithashtu aspirojnë të marrin pjesë në përfaqësimin e popullatës në parlament. Kjo nënkupton se partitë marrin pjesë në zgjedhje. Kontributi politik i një partie si dhe “peshë” e vet politike është e lidhur ngushtë me zgjedhjet. Vullneti i votuesve është i një rëndësie të konsiderueshme për partitë. Edhe një rol më pak atraktiv, ai i opozitës ofron elemente interesante për pjesëmarrje aktive. Partitë politike janë gjithmonë qendra për debate dhe diskutime rreth reformave politike dhe ndryshimeve politike. Të interesuarit për politikë në të shumtën e kohës e gjejnë një parti që reflekton perceptimet e veta, qoftë ajo në opozitë apo në pushtet. Partitë në opozitë ushtrojnë një funksion të rëndësishëm në sistemet demokratike si një “kujdestarë” i politikave qeveritare dhe se si një alternativë politike në të ardhmen. Opozita mund të konsiderohet si e tmerrshme, por është esenciale për funksionimin e demokracisë.

Një parti përpiket për të influencuar formimin e opinionit politik dhe synon të ketë një ndikim të përgjithshëm politik. Influenca aktive e opinion-bërjes synohet në periudhë më të gjatë kohore si dhe në një rajon më të gjerë dhe se nuk duhet të koncentrohet në nivel lokal apo në një çështje të vetme;

- “Një parti është një asociacion i qytetarëve që mbajnë një anëtarësim individual, dhe duhet të ketë numrin minimal të anëtarëve, kështu që serioziteti i synimeve të veta dhe prospekti i suksesit të mbetet i qartë” (***Partitë politike Funksioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike Wilhelm Hofmeister dhe Karsten Grabow.fq.12***). Deformimi i parë vjen pikërisht lidhur me citimin emesiperm të parties sin je asociacion qytetaresh. Nuk bie termi asociacion, por brendia e keti asociacioni. Brenda çdo sho-qërie ekzistojnë opinione, nevoja, pritje dhe pikëpamje të ndryshme për problemet ditore; gjitha-shtu ekzistojnë pyetje të “mëdha” mbi organizimin e shoqërisë, normat dhe procedurat. Nuk ekziston diçka e ngjashme me vullnetin e përbashkët të popullatës apo të mira të përbashkëta të para përcaktuara. Ndryshe, në çdo shoqëri ka interesa rivale të cilat shpesh ndeshen shumë fort. Në mënyrë që paqësisht të ndërmytesojmë konfliktin, formimi i pikepamjeve politike duhet të ndodhë në një proces të hapur të debatit mes opinionëve të ndryshme. Është i nevojshëm mini-mumi i bindjes së përbashkët. Ky është mendimi praktik i demokracisë. Bazohet në parimin se secili qytetar ka të drejtë të përfaqësoj opinionin dhe bindjen e vet në një garë paqësore të men-djeve. formimi i opinionit politik në një shoqëri

pluraliste arrihet nëpërmes një procesi të hapur të konkurimit mes interesave heterogjene. Për shkak të llojllojshmërisë së opinioneve dhe kon-flikteve sociale nuk ka zgjedhje të përsosur për problemet. Vendimet duhet të merren në bazë të pëlqimit dhe aprovimit të shumicës së qytetarëve. Megjithatë, nuk mund të ketë asnjë “tirani e shumicës” që fyen rregullat demokratike dhe shkel të drejtat e patjetërsueshme të njeriut. Edhe vendimet e shumicës mund të përfshijnë mangësi apo edhe padrejtësi. Prandaj, një mbrojtje e veçantë dhe e garantuar me kushtetutë e pakicave në njërën anë, si dhe pranimi i votimit ose të humbjes në zgjedhje e palës humbëse në anën tjetër, me kusht që ato të jenë (kryesisht) të lira dhe të ndershme - janë elemente konstituive të këtij koncepti të demokracisë. Partite kontribu-ojnë në legjitimitetin e sistemit politik: në themelimin e lidhjeve mes qytetarëve, grupimeve so-ciale dhe sistemit politik, partitë kontribuojnë në ancorimin e rendit politik në vetëdijen e qyte-tarëve dhe në forcat sociale. Partite politike ne shqiperi siç konstatova me lart dalin nga funksioni i tyre politik, social në kushtet e një sistemi demokratik real, funksional. Historia e 20 viteve te fundit na jep rast flagrante te vjedhjes, manipulimit te zgjedhjeve, per te shkuar me forma disi me te rafinuar si ato te blerjes, manipulimit te votes, afrimi i individeve me rekorde kriminale, afrimi i biznesmenve donator deri ne aferat kandidaturash dhe marveshesh. Partite para zgjedhjeve ha-pin “ zyrat e punes” per militantet, te cilat kur partia del fituese behen realitet per nje pjese te ty-re. Qytetaret levizin nga nje parti ne tjetren jo se ndjehen me te perfaqesuar si anetare te nje aso-cacioni te caktuar ekonomik, social etj, por se gjejne veten me prane vendit te ndarjes se bene-fiteve qe ofron pushteti. Produkti i dale nga kjo amalgam eshte qe ne fillim i kompromentuar, çka sjell si pasojë kompromentimin e demokracise.

- Një parti duhet të jetë organizatë e pavarur dhe permanente; nuk duhet të formohet vetëm për një palë zgjedhje dhe pastaj të pushoj së vepruari. Praktika tregon se vetem organizata te pavaru-ra nuk janë. Partite politike kthehen ne nje lloj Sh.P.K. ku deidenti. Pushteti, ndahet ne baze te aksioneve dhe kontributit pa bere definicion mes aksionerve. Ato, partite, ne mjaft raste nuk si-gurojne, pervec emrit, as ekzistencën permanente te tyre per sa kohe qe per hir te marrjes se pu-shtetit ndertojne, bejne aleanca para dhe pas zgjedhore qe nuk kane baza programore, por vetem ate qe ne gjuhen e perditshme do ta quanim si ndarje e presë, plaçkës së luftës.

Kete gjendje ja veshim tranzicionit politik dhe pepjekurise se partive politike. Protagonist e gjendjes kujtojne se kjo eshte semundje e demokracive te reja dhe mund te bejne re-ferate te tera me situatë qe vende demokratike te stme kane kaluar ne “ femirine “ e tyre demo-kratike.

Tranzicion demokratik quhet pika e shuarjes së një regjimi autoritar dhe fillimi i proceseve demokratike. Fillimi i tranzicionit karakterizohet me një shpërbërje të regjimit autoritar i cili fillon me shenjat e para të mobilizimit të masave dhe përfundon me vendosjen e një forme të re të qeverisjes e cila fiton legjitimitet nëpërmjet zgjedhjeve. Autori Dankward Alexander Rustow i dallon tri faza të tranzicionit:

“1. Faza e përgatitjes që arritët me polarizimin e aktorëve kryesorë politik.

2. Faza e vendimit ku institucionalizohen elementet kryesore të procedurës demokratike.

3. Faza e tranzicionit që është periudha gjate së cilës politikanët dhe elektorati janë mësuar me rregullat e reja politike”. (*Rustow Dankward, Transitions to Democracy Towards a Dynamic Model (Tranzi-cionet Demokratike Drejte një Modeli Dinamik), Columbia*

**University Press, 1970, Fq 338)**

I qendroj idese se nuk duhen parakushte sociale dhe ekonomike për të arritur demokracinë . Ajo që nevojitet është uniteti nacional si parakusht për demokracinë dhe arritja e një konsensusi të elitave politike.

Për të kuptuar termin tranzicionin demokratik është e domosdoshme ti referohemi edhe veprës së mendimtarëve të kësaj fushe Juan Linz dhe Alfred Stepan. Këta dy autorë shkojnë një hap më larg dhe kërkojnë të kuptojnë se si karakteri i regjimeve të ndryshme jodemokratike ndikojnë ose nuk ndikojnë në kompletimin e tranzicionit demokratik. Pra sipas tyre një tranzicion demokratik është i kompletuar kur kemi:

1) Një marrëveshje të mjaftueshme për të prodhuar një qeveri të zgjedhur.

2) Kur një qeveri vjen në pushtet si rezultat i votës së lirë dhe demokratike

3) Kur kjo qeveri, de facto, ka autoritet për të zhvilluar politika

4) Kur pushteti ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor të gjeneruar nga demokracia e re nuk kanë nevojë ta ndajnë pushtetin me institucione tjera de jure. (**Linz Juan & Stepan, Alfred, Democratic Transitions and Democratik Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe (Tranzicionet Demokratike dhe Konsolidimi Demokratik:Europen Jugore, Ameriken Jugore dhe Shtetet Post-Komuniste), Mimeo, 1991, Fq 6)**

Krahasuar me tranzicionin e regjimeve, konsolidimi është një koncept shumë më i mjegullt me më shumë pasiguri të konsiderueshme rreth pikave përfundimtare. Në çdo rast koncepti i konsolidimit konsiderohet si proces më i gjerë, më i thellë dhe më i gjatë sesa tranzicioni. Në procesin të konsolidimit demokratik veçoj rolin ekskluziv të elitave politike në këtë proces duke e theksuar lidhjen ndërmjet sistemit dhe shoqërisë.

“Pas çdo tranzicioni nga sundimi autoritar demokracia emergjente do të jetë një regjim, në të cilin jo të gjithë aktorët politike nuk kanë kredenciale të mjaftueshme demokratike, edhe ku rregullat demokratike të procedurës ende janë duke u përvetësuar nga shoqëria në përgjithësi. Nëse fa-za e tranzicionit nuk është ndërprerë, ajo mund të hapë rrugën për një proces të konsolidimit demokratik. Pika referuese e këtij procesi do të jetë pasiguria e periudhës së tranzicionit progresi-visht zvogëlohen pasi që procedurat e reja kuptohen më mirë, dhe pranohen më gjerësisht. Regjimi i ri bëhet i institucionalizuar, korniza e hapur dhe shprehja konkurruese politike bëhet e integruar, kështu në masë të madhe paqartësitë dhe rreziqet tejkalohe. Ky proces mund të kompletohet në periudhën kohore të një gjenerate. Kur procesi i demokratizimit avancohet nga fundi i tranzicionit tek konsolidimi i plotë ka një zgjerim të aktorëve politik të cilët adoptojnë sjelljen demokratike, një thellim i angazhimit të aktorëve të cilët negociojnë kornizat demokratike (pra të gjithë marrin një qëndrim parimor në vend të qasjes instrumentale ndaj respektimit të këtyre kornizave). Në këtë mënyrë aktorët politikë mësojnë se si të ndryshojnë perceptimet e vetvetes, të tjerëve apo tërë sistemit. E tërë kjo arrihet me një kampanjë të koordinuar ose faktikisht të organizuar për ta familjarizuar masën me pranimin e rregullave demokratike”. (**Whitehead Laurence, The Consolidation of Fragile Democracies (Konsolidimi i Demokrative të Brishta), European Consortium for Political Research (ECPR), 1988, Fq 6-8)**

Demokracinë e konsoliduar e definojnë si një dimension sjellje, qëndrimi dhe kushtetutë pra me fjalë të tjera konsolidimi arrihet vetëm kur demokracia është bërë e vetmja lojë në qytet. Në aspektin e sjelljes (Behaviourally) një regjim demokratik në një shoqëri është i konsoliduar kur asnjë aktor nacional, social, ekonomik, politik ose institucional nuk



shpenzon burime të rëndësishme për t'i përmbushur objektivat e veta jo-demokratike. Në aspektin e qëndrimit (attitudinally) një regjim demokratik është i konsoliduar kur shumica absolute e opinionit publik beson se institucionet dhe procedurat demokratike janë mënyra më e përshtatshme për të qeverisur jetën kolektive në një shoqëri si ajo e tyre dhe kur përkrahja e alternativave anti-sistem është e vogël ose pak a shumë e izoluar në raportin me forcat pro demokratike. Në aspektin kushtetues (Constitutionally) një regjim demokratik është i konsoliduar kur edhe forcat qeveritare dhe ato opozitare zgjedhjen e konflikteve e bëjnë përmjet ligjeve dhe procedurave demokratike.

### Konkluzionet

Pra duke analizuar faktin se partitë politike përbëjnë elementin thelbësor të konsolidimit demokratik në shoqëritë moderne. Të dala nga vetë shoqëria, në shumicën e demokracive partitë politike luajnë rolin e ndërmjetësit mes qytetarëve dhe organeve kushtetuese. Në shumicën e rasteve ato hyjnë madje edhe në sferën e shtetit. Anëtarët e partive politike zënë postet politike në shtet. Në përgjithësi, duke u fokusuar në partitë politike dhe sistemet partiake duhet të theksuar se ato determinojnë konsolidimin demokratik dhe cilësinë e atij sistemi. Pra partitë politike ndikojnë në tri sfera:

1. në raportet parti politike-shtet;
2. raportet ndërpartiake pra arritjen e koalicioneve ndërpartiake ku shfaqja e praktikave jo demokratike zhduket;
3. raporti parti politike-shoqëri ku partitë janë ato që në një mënyrë e vetëdijesojnë masën për rregullat demokratike.

Konsolidimi varët në masë të madhe nga partitë pasi që ato kanë një rol të rëndësishëm në shtet ku në demokracitë liberale konsiderohet se ato e okupojnë shtetin, rregullojnë aspekte të rëndësishme shtetërore si ushtria, administrata publike etj. Në këtë mënyrë konsiderohet se partitë janë një aktor i rëndësishëm i cili legjitimon sistemin politik. Roli i partive në shoqëri e cila është në udhën e demokratizimit është vital, pasi që ato rregullojnë lidhjet shtet-shoqëri, janë promovuese të kontratës sociale nën mbështetjen demokratike, integrojnë grupe të ndryshme shoqërore në sistem, rrënjisin një ndër vlerat themelore të demokracive liberale pra participimin në garat elektorale. Megjithatë lidhjet ndërpartiake kanë rëndësi të jashtëzakonshme në konsolidimin e demokracisë pasi që me koalicione të ndryshme dhe me kompetencën e ligjshme shmangen konflikte të ndryshme të cilat mund të degradojnë nivelin demokratik ose në raste të ndryshme ta ndryshojnë krejt regjimin.

Neni 2 i Kushtetutës Shqiptare, e viti 1998, afirmon që "sovrانيتeti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit" dhe se "populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejt-pëdrejt".

Bazuar mbi vlerësimin e individit dhe mbi barazinë gjyqësore, ideali demokratik modern shfaqet në fillim të shekullit të 18-të nga një konceptim i ri mbi njeriun sipas të cilit, ai, i lirë dhe i pajisur me vullnet të vetin, nuk është më i nënshtuar nga forcat hyjnore. Liria përkufizohet si një dhunti e vetvetishme e qenies njerëzore dhe realizohet plotësisht nëpërmjet njohjes së të drejtave natyrore, të patjetërsueshme dhe të shenjta.

Demokracia përfaqësuese është e bazuar në parimin, sipas të cilit vetëm një trup

përfaqësuesish të zgjedhur mund të ngjallin në mënyrë të vërtetë vullnetin kombëtar. Zhan Zhak Ruso, teorist i sovranitetit popullor në “Kontrat sociale” (1762), bëhet apostulli i demokracisë së drejtpërdrejtë ku çdonjëri nga individët që përbëjnë popullin është zotëruar i një cope pushteti, të cilën e ven-dos nën vullnetin e përbashkët. Ky vullnet shfaqet nga e drejta e votës universal, demokracia e drejtpërdrejtë dhe regulli i shumicës. Eksperiencat demokratike perëndimore nisen nga ky kon-ceptim i pamundur për ta vënë në punë në shtetet e mëdha dhe shoqëritë moderne komplekse.

**Demokracia** (gr. *demo* - popull, *kraci* - rend) është një formë qeverisje në të cilën shumica e nje-rëzve ushtrojnë sovranitetin e tyre ose drejtpërdrejtë, nëpërmjet referendumeve, ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, nëpërmjet zgjedhjes së përfaqësuesve. Duke filluar pas luftës së dytë botë-rore, interpretimet për demokracinë si rend qeverisës janë shumë, dhe ndërmjet tyre ka dallime të mëdha.

Ajo që ne sot nënkuptojmë me termin demokraci, megjithë përdorimin e shpeshtë, akoma mbetet e pakuptueshme. Edhe pse ne në fakt jemi të bindur se demokracia ka të bëjë me lirinë e individit dhe të qeverisjes së popullit, ne akoma nuk e dimë saktësisht nëse dhe si mund të realizohen sot konceptet e tilla të demokracisë. I larmishëm dhe kontradiktor është edhe ajo që në botë kuptohet si demokraci apo demokratike. Kjo ndodh sepse interpretuesit përkatës përdorin në mënyrë të parreflektuar njërën pas tjetrit definicionet e demokracisë nga periudhat dhe rregullimet e ndryshme shoqërore, në vend që të nisen nga thelbi parimor i mendimit demokratik dhe të kenë parasysh trajtimet e kushtëzuara nga periudha përkatësekohore. Çfarë do të thotë atëherë formula, sipas së cilës demokracia qenka sundimi i popullit nëpërmjet popullit? Nëse teoria niset nga i tërë pushteti, çfarë gjasash ka atëherë populli të vendosë në mënyrë kompetente për çështjet politike? Apo, për të kujtuar një definicion tjetër (liberal), a ekzis-ton sot në botë një demokraci si sundimi i mendimit publik, derisa kjo del nga procesi i diskuti-mit racional? A argumentohet në shoqërinë tonë në mënyrë të arsyeshme, apo agjitetohet dhe reagohet? Përveç kësaj, çfarë është mendimi publik, sipas të cilit duhet të orientohen politikanët? Janë vallë mendim publik rezultatet e demokracisë apo mendimet dhe komentet e publikuara nëpër gazetata e mëdha apo në radio dhe televizion të shoqatave dhe partive të mëdha apo të koncerneve televizive?

Liria e njejtë për të gjithë qytetarët është kusht i pashmangshëm i demokracisë. Për këtë arsye, edhe vlefshmëria e përkufizimit klasik të demokracisë varet nga pyetja, se sa e respektojnë dhe mundësojnë format konkrete të demokracisë, të dala nga ky definicion, lirinë e njejtë të të gjithëve. Se a do të mund të na shërbejnë dukuritë historike të demokracisë si shembuj në të ardh-men, kjo do të varet nga masa e plotësimit të këtyre kushteve themelore. Demokracia niset nga një pikëpamje përkatëse mbi njeriun. Sipas saj, njerëzit duhet të jenë të lirë, dmth. ata duhet të kenë mundësinë e zhvillimit dhetë shpalosjes së personalitetit të tyre sipas vendimeve vetjake. Prapa kësaj - pa marrë parasysh se a bëhet fjala për argumentime krishtere apo idealiste-huma-niste - qëndron mendimi, se çdo njeri jeton në dinjitet, i cili atë e bën person dhe e dallon nga ka-fshët. Në fjalorin politik kjo do të thotë se i gjithë pushteti duhet të ketë kufinj të tij në pacenu-eshmërinë e dinjitetit të çdonjërit. Parimisht, pushtetit i duhen kufinj dhe kontrolli. Përveç kësaj, ai duhet të themelohet mbi pajtueshmërinë e të nënshtruarve, sepse në të kundërtën, mundë-sia e pakufizuar e ndërhyrjes do ta cënontelirinë dhe dinjitetin e individit. Sepse çdo gjë, e po-saçërisht pushteti, duhet t'i shërbejë sigurimit dhe përmirësimit të mundësive dhe shanseve për një jetë në dinjitet të të gjithë pjesëtarëve të një shoqërie. Liria në këtë kontekst nuk duhet kuptuar si diçka abstrakte. Ajo nënkupton konkretisht lirinë e zhvillimit të jetës private,

lirine e besi-mit dhe lirinë e ndërgjegjes. Liria e zgjedhjes së profesionit, mundësia e lirë e zhvillimit të je-tës private, liria e pronësisë së pasurisë private, liria dhe pacënueshmëria e banesës, e komuni-kimit postal dhe telefonik. Liri do të thotë edhe sigurim nga arrestimi arbitrar dhe mundësimi i procesit juridik para gjyqit, si dhe kontrolli mbi informatat të cilat shteti mbledh mbi qytetarët. Këtu bën pjesë edhe e drejta e shprehjes së lirë të mendimit, liria e shtypit, liria e tubimit dhe e bashkimit, e drejta për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike e çdo pjestari të një shoqërie. Të gjitha të drejtat e lirisë, të cilat këtu nuk u numëruan deri në fund, duhet të shërbejnë si kusht i çdo themelimi shoqëror. Thelbi i këtyre të drejtave, dinjiteti i njeriut, nuk është dhuratë e shtetit për individin, por ai duhet të njihet nga shteti si i dhënë, i garantuar, i pacënuar dhe i pashman-gshëm. Sigurimi i dinjitetit të njeriut është qëllim i çdo kushtetute demokratike. Mirëpo të drejtat e lirisë së individit nuk duhet të kuptohen si diçka absolute. Kufinj të tyre gjenden në të drejtat e lirisë së të tjerëve. Karakteri i demokracisë bëhet i kuptueshëm vetëm pas definimit të tillë të njeriut. Një bashkësi shoqërore mund të quhet demokratike nëse ajo duke njohur dinjitetin e nje-riut, synon në mënyrë të njëjtë garantimin e lirive të të gjithë qytetarëve për shpalsjen e personalitetit dhe zhvillimin e ndërgjegjshëm të jetës dhe e cila siguron kushtet për arritjen e kë-saj. Demokracia pra nuk është shumica e rregulloreve formale, por ajo përbëhet nga qëllimi i saj përmbajtësor për mundësimin e masës më të madhe të mundur të lirive, vetëpërgjegjësisë dhe barazisë sociale, natyrisht gjithnjë duke u nisur nga rrethanat historike dhe shoqërore. Demokracia vë marrëveshjen para asaj që në asnjë mënyrë nuk vihet në diskutim; vetëm mbi këtë bazë të bin-djeve themelore bëhet i mundshëm parimi i vendosjes së shumicës. Demokracia pra nuk është rregull neutral procesi, por formë politike e bazuar në vlera dhe e cila synon jetësimin e këtyre vlerave. Sipas ish-kryeministrit britanik Winston Churchill “demokracia paraqet formën më të keqe të rregullimit shtetëror, me përjashtim të të gjitha formave tjera”.

## Referencat

- Wilhelm Hofmeister dhe Karsten Grabow. Konrad Adenauer Stiftung “Partitë politike Funksioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike”.
- Whitehead Laurence, The Consolidation of Fragile Democracies (Konsolidimi i Demokracive të Brishta), European Consortium for Political Research (ECPR), 1988, fq.6-8).
- Linz Juan & Stepan, Alfred, Democratic Transitions and Democratik Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe Mimeo, 1991 fq.6).
- (Rustow Dankward, Transitions to Democracy Towards a Dynamic Model (Tranzicionet Demokratike Drejte një Modeli Dinamik), Columbia University Press, 1970, Fq 338).
- Giovanni Sartori Questioni di metodo in scienza politica, Firenze, Università degli Studi, 1959.
- Aristoteli: Politika, “KOHA” Prishtinë, 2003.
- Mere, Zherard: Kryeveprat e Mendimit Politik, “Dita 2000” Tiranë, 2007.
- Zh.Zh.Ruso “Kontrata Sociale” Universiteti “Luarasi”. Tiranë 2005.
- Stumpf Enoch Samuel, FILOZOFIA-Histori&problemet, “Toena” Tiranë.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë – 1988.
- Malnes, Raino dhe Knut, Midgaard. 2007. Filozofia Politike. Prishtinë: Rozafa.
- Chevallier.J.J, Guchet.Y: Veprat e Mëdha Politike (Nga Machiavelli deri në ditët tona), “Liria” Tiranë, 2001.
- Jürgen Habermas Philosophical-Political Profiles (1983).

## Tabela

Tabela 1- 1/1 Harta e Economist Intelligence Unit për Indeks të Demokracisë në 2012,

Tabelë 1/1

Harta e Economist Intelligence Unit për Indeks të Demokracisë në 2012, ku ngjyrat më të gjelbra përfaqësojnë vende më demokratike.

Demokraci të plota:

■ 9.00-10.00

■ 8.00-8.99

Demokraci të mangëta:

■ 7.00-7.99

■ 6.00-6.99

Regjime hibride:

■ 5.00-5.99

■ 4.00-4.99

Regjime autoritare:


■ 3.00-3.99

■ 2.00-2.99

■ 0.00-1.99

Informacion i pamjaftueshëm, pa vlerësim:

■



## Kërkimi i tregut nga ana e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves

**Fatos Turkaj**

*Senator në Universitetin "Haxhi Zeka" – Pejë,*

**Zymer Tafaj**

*Forca e Sigurisë së Kosovës, Isniq-Deçan*

**Safete Hadergjonaj**

*Prof. Kolegji Biznesi - Prishtinë, Deçan*

### Abstrakt

Ky punim shtjellon temën e kërkimit (hulumtimit) të tregut nga ana e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves. Qëllimi i çdo biznesi është që të plotësoj nevojat dhe dëshirat e konsumatorve, e kjo realizohet përmes një instrumenti të rëndësishëm se veçantë që është kërkimi i tregut, dhe përmes tij arrijnë deri tek informacionet e duhura që na ndihmojnë në marrjen e vendimeve të drejta afariste.

Qëllimi i punimit është që të pasqyrohet analizimi dhe kërkimi i tregut nga ana e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujevës, si dhe përpjekjet dhe angazhimin e tyre për përdorimin e informatave që marrin nga kërkimi i tregut në vendosjen e drejt afariste dhe plotësimin maksimal të nevojave dhe dëshirave të konsumatorve.

Punimi përbëhet nga dy pjesë, në pjesën e parë paraqitet aspekti teorik i mbështetur në të dhëna dytësore dhe terciare, ku përdoret metoda deduktive, pjesa e dytë paraqet aspektin empirik dhe mbështetet në të dhëna primare të mbledhura në teren, këtu përdoret metoda induktive. Metodologjia e përdorur është kualitative ku është hartuar një pyetësor dhe janë intervistuar 30 menaxherë të bizneseve në këtë Komunë dhe nga rrezultatet e arritura vijmë deri tek përfundimet prej nga burojnë edhe rekomandimet e përgjithshme rreth kërkimit të tregut nga ana e menaxherve të këtyre bizneseve.

Ndër gjetjet kryesore të punimit janë se menaxherët e bizneseve në Komunën e Podujevës janë të vetëdijshëm për rëndësinë e kërkimit të tregut për hulumtimin e nevojave të konsumatorve dhe marrjen e masave për plotësimin e tyre, sepse përmes këtij procesi zvoglohet paqartësia gjatë vendosjes afariste. Kurse si rekomandim është që këto biznese të vazhdojnë më kërkim të tregut sepse përmes tij arrijnë deri tek zgjedhjet e mira alternative që ndikojnë në rritjen e fitimit të biznesit.

**Fjalët kyce:** *Tregu, kërkimi, menaxheret, biznesi.*

### Hyrje

Bizneset gjatë aktiviteteve të tyre synojnë që të shesin mallra dhe shërbime të shumta dhe të arrijnë fitimin maksimal duke knaqur kërkesat e konsumatorve, nga ana tjetër konsumatorët synojnë të përmbushin kërkesat e tyre sa me shumë dhe me çmim më të vogël, tregu e mundëson takimin, këmbimin dhe përmbushjen e qelimeve të këtyre palve. Duke pasqyruar që produktet që ofron biznesi duhet të përmbushin kërkesat dhe preferencat e konsumatorit atëherë ky punim shtjellon temën e kërkimit (hulumtimit) të tregut nga ana e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujevës. Qëllimi i çdo biznesi është që të plotësoj nevojat dhe dëshirat e konsumatorve, kjo realizohet përmes një instrumenti të rëndësishëm se veçantë që është kërkimi i tregut, dhe përmes tij arrijmë deri tek informacionet e duhura që na ndihmojnë në marrjen e vendimeve të drejta afariste.

Qëllimi i punimit është që të pasqyrohet analizimi dhe kërkimi i tregut nga ana e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujevës, si dhe përpjekjet dhe angazhimin e tyre për përdorimin e informatave që marrin nga kërkimi i tregut në vendosjen e drejt

afariste dhe plotësimin maksimal të nevojave dhe dëshirave të konsumatorve. Pyetje gjenerale hulumtuese është: A bëjnë bizneset e komunës së Podujevës kekime (hulumtim) të tregut.

Punimi përbëhet nga dy pjesë, në pjesën e parë paraqitet aspekti teorik i mbështetur në të dhëna dytësore dhe terciare, ku përdoret metoda deduktive, pjesa e dytë paraqet aspektin empirik dhe mbështetet në të dhëna primare të mbledhura në teren, këtu përdoret metoda induktive. Metodologjia e përdorur është kualitative, cilësore ku është hartuar një pyetësor dhe janë intervistuar 30 menaxherë të organizatave në këtë Komunë dhe nga rezultatet e arritura vijnë deri tek përfundimet prej nga burojnë edhe rekomandimet e përgjithshme rreth kërkimit të tregut nga ana e menaxherve të këtyre bizneseve. Mostra e menaxherve nga mbledhja e të dhënave është zgjedhur në menyre rastësore. Edhe metoda analitike dhe pershkruese gjejnë zbatim gjatë punës tonë kërkimore

Ndër gjetjet kryesore të punimit janë se menaxherët e bizneseve në Komunën e Podujevës janë të vetëdijshëm për rëndësin e kërkimit të tregut për hulumtimin e nevojave të konsumatorve dhe marrjen e masave për plotësimin e tyre, sepse përmes këtij procesi zvoglohet paqartësia gjatë vendosjes afariste, dhe ata sa herë që është e nevojshme bëjnë kërkime të tregut në menyre që të largojnë paqartësit dhe të përmbushin në maksimum kërkesat e blersve. Kurse si rekomandim është që këto biznese të vazhdojnë më kërkim të tregut sepse përmes tij arrijnë deri tek zgjedhjet e mira alternative që ndikojnë në rritjen e fitimit të biznesit dhe reputacionit, pra kërkimet në biznes largojnë paqartësit dhe krijojnë kushte për vendimarrje të drejtë, ky është mjeti që i garanton bizneseve sukses sepse përmes plotësimit të kërkesave të blersve ato arrijnë të jetojnë gjatë në biznes të këndë reputacion të mirë dhe fitim maksimal.

## **Tregu dhe Biznesi**

Tregu mund të definohet në menyra të ndryshme, në rend të parë ai përdoret për të përkufizuar vendin ku takohen dhe bëjnë transaksione shitblerëse blerësi dhe shitësi, ku ofrohen produkte për shitje dhe ku ndërrohet pronari i tyre, në disa raste nocioni treg paraqet raportet ndërmjet ofertës dhe kërkesës për ndonjë produkt të caktuar (Rexha, 1982, 66). Në aspektin tradicional ka kuptimin e një vendi ku në kohë të caktuar janë takuar shitesit dhe blerësit dhe ku është realizuar akti i shitblerjes pra tregu është shprehja e vullnetit, e gadishmerisë dhe e aftësisë së palve të interesuara për transaksionimin e produkteve a të sherbimeve për përmbushjen e nevojave vetjake (Jakupi, 2008, 95). Me nocionin tregë kuptojmë: bashkësinë e njerëzve (individëve ose ndërmarrjeve) të cilët kanë nevojë për ndonjë produkt të caktuar, që kanë aftësi të caktuar blerëse, gatishmëri dhe autorizim për blerjen e produktit të caktuar (Dibb, Simikin, Peride & Ferrell, 1991, 66).

Në kuptim të gjerë të fjalës tregun mund ta kuptojmë edhe si kërkesë të gjithëmbarshme të konsumatorëve potencialë për produkte të caktuara (Reshiti, 2006, 34). Pra një treg që te jete aktiv duhet të plotësojë të gjitha kushtet vijuse: artikujt e tegtuar brenda tregut janë homogjen, blersit dhe shitesit e gatshëm gjenden në çdo kohë, çmimet janë të pranushme dhe të arritshme për publikun (Skenderi, 2010, 254). Fakti që jetojmë në një botë me burime të kufizuara dhe të pamjaftueshme dhe përderisa individët nuk mund të plotësojnë nevojat me produkte të prodhuara prej tyre i detyron ata të dalin në treg si shites apo si blerës dhe çdo pjesëmarrës në treg kërkon të fitoj nga këmbimi dhe se vet tregu perfaqson një kategori komplekse ku gjithqka që përfshihet në të është në levizje (Mançellari, Hadëri,

Kule & Qiriri, 2002, 25).

Pra tregu është një organizim nëpërmjet të cilit blersit dhe shitesit takohen ose komunikojnë me qëllim tregtimin e të mirave dhe shërbimeve (Uruçi, 2004, 64). Treg është hapsira objektive ose ideale ku takohen oferta dhe kërkesa, ofruesi dhe kërkuesi për të blerë apo shitur, çmimi formohet pikerisht aty ku harmonizohet kërkesa me ofertën dhe ky proces përben elementin bazë të një ekonomie tregu, forma te ndryshme te tregut janë: monopoli, monopsoni, oligopoli, oligopsoni dhe konkurenca e plotë (Konini & Peçi, 1997, 302). Tipologjia e tregut përmban ndarjen, klasifikimin e tregut të tërsishem në tipe te veqanta që kanë disa specifika të përbashketa ose te ngjashme, tregjet janë të shumllojshme dhe varesisht nga prizmi qe shikohet ato mund te ndahen nga aspekti gjeografik, sipas komplekseve, sipas konkurences, ne baze te numrit te shitsve dhe blersve gjithashtu mund të ndahen në gjenerike dhe të produkteve, por tregjet mund te jenë të tipit publik, privat, i organizuar, jo i organizuar, legal, ilegal etj (Jakupi, 2008, 96-98).

Kurse Biznesi është njëri ndër institucionet që ka kontribuar shumë në përmirësimin e cilësisë së jetës njerëzore, renditet krahas shkencës, artit dhe edukimit (Çela, 2006, fq.15). Një firmë biznesi është një organizatë që është ndërtuar me qëllim sigurimin e fitimit për pronarët e tyre, duke prodhuar të mira apo shërbime të vlefshme në treg për konsumatorin (Uruçi, 2004, fq.184). Një biznes mund të definohet si një organizatë që ofron mallra dhe shërbime për të tjerët që duan apo kanë nevojë për ato<sup>2</sup>. Ndërmarrjet, kompanitë ose firmat janë organizata që përmes tregut punojnë për klientët, dhe presin të marrin atë që duan, me çmimin që ata do të paguajnë (Jones, Parker & Rene ten Bos, 2005, fq.10). Biznesi është një grup njerëzish të cilët punojnë së bashku për të zhvilluar, prodhuar ose shpërndarë mallra apo shërbime (Ingram, Albrigh & Baldwin, 2003, fq.5). Funkzioni kryesorë i biznesit është identifikimi dhe plotësimi i nevojave të klientëve duke ju shërbyer mirë atyre, një biznes mund të mbijetojë e lulëzojë me kalimin e kohës (Jones, Parker & Rene ten Bos, 2005, fq.10). Pra biznes është çdo lloj veprimtarie ekonomike, zakonisht private, që ka për qëllim fitimin, në një mënyrë me biznes kuptohet edhe një ndërmarrje ose organizatë tjetër ekonomike (Skenderi, 2010, fq.29).

### Kërkimi i tregut

Bizneset produktet dhe shërbimet e tyre i krijojnë për treg, mirpo ato nuk duhet te nisin këtë pune pa e ditur çka kerkohet ne tregjet e synuara, është e nevojshme që bazuar në aktivitetet për kerkimin, hulumtimin dhe studimin e tregjeve te pergaditet oferta e cila do të jetë e pranushme për konsumatorin dhe aktivitetet e kerkimit, hulumtimit dhe studimit te tregut, marrja e vendimeve per cilesin, sasin dhe llojet e produkteve, caktimin e çmimeve, menyrave të distribuimit dhe komunikimi me konsumatorët janë veprime kryesore te marketingut (Reshidi, 2008, 4). Qëllimi kryesor i kërkimeve të tregut është që të zvogëlojë paqartësinë dhe rrezikun në vendosjen afariste ne situat kur ndermarrja ka në dispozicion zgjidhjen e dy apo me shumë drejtimeve të veprimit dhe procesi i kerkimit niset nga pytjet çka duhet te bëhet, në cilen menyre, pse, kur ku dhe kush pra kerkimet ne treg kanë të bejnë me zbulimin e mundesive te tregut, kerkimet për nevojat e plitikes se produktit,

<sup>2</sup><https://www.shqiperia.com/kategori/kat/knr/1028/Biznesi>

lidhur me politiken e çmimeve, me politiken e distribuimit dhe kërkimet lidhur me aktivitetet e promocionit (Ceku & Reshidi, 2006, 68-71).

Kërkimet e tregut janë aktivitete kryesore që i ndihmojnë menaxherit të ndërmarrjes që të fitojë informacione mbi konsumatorët dhe jokonsumatorët, mbi konkurrencën dhe kanalet e distribuimit, ato shërbejnë si bazë për zbulimin e nevojave dhe kërkesave në treg për identifikimin e problemeve afariste, si dhe për kontrollin e afarizmit (Green, Tull & Albaum, 1988, 26). Në literaturën profesionale ekziston numër i madh i përkufizimeve të kërkimeve të tregut si regjistrimi, përpunimi i analizës së të dhënave, pra kërkimet e tregut paraqesin procesin e gjetjes dhe analizën sistematike dhe objektive të informacioneve që janë të rëndësishme, për identifikimin dhe zgjedhjen e problemeve nga fusha e marketingut (Ceku & Reshidi, 2006, 33). Kërkimet e tregut përmbajnë aktivitetin e organizuar e të mbështeture ne metoda shkencore, ne grumbullimin, përpunimin dhe analizen e të dhënave në sferen e konsumit, të prodhimit, në realizimin e ofertes, dhe te kërkeses në treg dhe në analizen e faktorëve tjerë që ndikojnë në krijimin e kompaktësisë të prodhuesit dhe te konsumatorit (Jakupi, 2008, 107). Gjatë kerkimit te tregut duhet të jepen përgjigje në këto pyetje: cilet janë konsumatorët për produkteve te ndermarrjes, çfarë sasi të produkteve konsumojnë, Çfarë dobie kerkojn konsumatorët nga produkti dhe pse konsumatorët i blejnë ose nuk i blejnë produktet e caktuara (Ceku & Reshidi, 2006, 33).

Kërkimet e tregut përveq analizes në të kaluarën dhe të tashmen bejnë të mundur edhe parashikimin për të ardhmen (Jakupi, 2008, 107). Pra procesi efikas i kërkimeve te tregt përfshinë vetë keto faza:Përkufizimi i problemit dhe qellimi kërkimor, përpilimi i planit kerkimor, mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe analizimi i të dhënave si dhe prezantimi dhe interpretimi i rezultateve (Ceku & Reshidi, 2006, 74). Përmes kërkimeve të tregut arrijmë deri të rezultatet, të cilat në formë të informacioneve na shërbejnë për marrjen e vendimeve afariste, prandaj kërkimet e tregut paraqesin një punë kërkimore, rezultat i të cilit është prezantimi i zgjedhjeve në disa alternativa të mundshme ,në disa situata deri të njohja e tregut arrihet përmes arsyes personale ose përmes intuitës së menaxherit të ndërmarrjes (Mustafa, 2005, 61).

### **Rezultatet e hulumtimit - Analizimi i të dhënave**


Për të pasqyruar një situatë më reale rreth kërkimeve të tregut nga ana e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves si dhe për të arritur konkluzionet e duhura dhe për të shprehur rekomandime sa më të plota, u hartua një pyetësor, i fokusuar në këtë problem. Të dhënat e mbledhura në teren janë cilësore ku janë intervistuar 30 menaxher me qëllim që të pasqyrohet qëndrimi i tyre rreth kërkimeve të tregut gjatë realizimit të aktiviteteve të tyre afarist, kampioni i menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves u zgjodhën në mënyrë rastësore.

Në këtë pjesë të punimit përdoret metoda kualitative, dhe ajo induktive me qëllim që rezultatet e përfituara nga këto intervista të përgjithësohen dhe deri diku të përshkruajnë se cila është qasja e menaxherve ndaj kërkimeve të tregut. Metoda analitike dhe e krahasimit gjejnë zbatim në punim.

Në vazhdim paraqiten rezultatet e intervistës së bërë me menaxheret në Komunën e Podujeves:




1. A bën biznesi juaj kërkime të tregut apo aktivitetet i realizoni në menyra tjera (duke u mbështetur në arsye personale dhe intuitë).



Rezultatet e figurës 1. tregojnë së 70% e menaxherve të intervistuar thonë se aktivitetet e tyre i mbështesin në kërkime të tregut sepse vetem përmes tyre mund të largohen paqartësit dhe të zgjidhen alternativat me të mira dhe se ata bëjnë kërkime sa herë që ndeshen me paqartësi, kurse 30% e menaxheve të intervistuar thonë se aktivitetet e tyre afariste i mbështesin në arsye personale dhe intuitë. Nga ku edhe mund të përfundojmë se shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves i mbështesin aktivitetet e tyre afariste në kërkime të tregut sepse përmes tyre, deklarohen ata, largohen paqartësit dhe zgjidhen alternativat e drejta dhe se ata bëjnë kërkime të tregut sa herë që ndeshen me paqartësi.


Sqarim: Tri pyetjet në vijim vlej vetem për menaxheret që janë deklaruar se bëjnë kërkime të tregut.

2. A e realizoni procesin e kërkimeve duke u mbështetur në fazat kryesore të tij?




Rezultatet e figurës 2. tregojnë së 100% e menaxherve të intervistuar nga ata që janë deklaruar se bëjnë kërkime të tregut thonë se ato i mbështesin në fazat kryesore të tij si: përkufizim të problemit dhe qëllimi kërkimorë, përpilim i planit kërkimorë, mbledhje e të dhënave, përpunim dhe analizimi i të dhënave si dhe prezantim dhe interpretim i rezultateve. Nga ku edhe mund të përfundojmë se shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves gjatë kërkimit të tregut aplikojnë fazat kryesore të tij.

3. A e përgaditni oferten për konsumatorë duke u mbështetur në kërkimet e tregut?




Rezultatet e figurës 3. tregojnë së 100% e menaxherve të intervistuar nga ata që janë deklaruar se bëjnë kërkime të tregut thonë se ata çdoherë e përgadisin oferten për konsumatorë duke u mbështetur në këto kërkime. Nga ku edhe mund të përfundojmë se shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves gjatë aktivitetëve të tyre afariste e përgadisin oferten për konsumatorë duke u bazuar në rezultatet e kërkimit të tregut.

4. A ju ndihmojn kërkimet e tregut në procesin e vendimarrjes?




Rezultatet e figurës 4. tregojnë së 100% e menaxherve të intervistuar nga ata që janë deklaruar se bëjnë kërkimet në treg thonë se ato ndihmojnë shumë procesin e vendimarrjes në biznes. Nga ku edhe mund të përfundojmë se shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujevës gjatë aktiviteteve të tyre afariste përdorin rezultatet e arritura nga procesi i kërkimeve në biznes për vendimarrje të drejt.

5. A e dini cilet janë konsumatorët tuaj, çfarë sasive konsumojnë dhe çfarë dobie kërkojnë?




Rezultatet e figurës 5. tregojnë së 70% e menaxherve të intervistuar thonë se kanë njohuri rreth konsumatorve e dine çfarë sasive konsumojnë dhe çfarë dobije kërkojnë, 10% e menaxherve nuk kanë njohuri rreth konsumatorve, kurse 20% e menaxheve të intervistuar thonë se përafersisht e din cilet janë konsumatorët çfarë sasive konsumojnë dhe çfarë dobije kërkojnë. Nga ku edhe mund të përfundojmë se shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujevës kanë njohuri rreth konsumatorve.

6. A keni informata pse konsumatorët i blejnë ose jo produktet e caktuara?



Rezultatet e figurës 6. tregojnë së 70% e menaxherve të intervistuar thonë se kanë informata pse konsumatorët i blejnë ose jo produktet e caktuara, kurse 30% e menaxheve të intervistuar thonë se nuk kanë informata të tilla. Nga ku edhe mund të përfundojmë se shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujevës e dine pse konsumatorët blejnë produkte të caktuara miëpo kanë informata edhe pse ata nuk blejnë produkte të caktuara..

7. A keni informata rreth politikave të çmimeve dhe menyrës së promovimit?



Rezultatet e figurës 7. tregojnë së 70% e menaxherve të intervistuar thonë se kanë informata rreth politikave të çmimeve dhe menyrës së promovimit, kurse 30% e menaxheve të intervistuar thonë se nuk kanë informata të tilla. Nga ku edhe mund të përfundojmë se shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujevës kanë informata rreth politikave të çmimeve dhe menyrës së promovimit.

## Konkluzionet dhe Rekomandimet

### Konkluzionet

Shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves i mbështesin aktivitetet e tyre afariste në kërkime të tregut sepse përmes tyre deklarohen ata largohen paqartësit dhe zgjidhen alternativat e drejta dhe se ata bëjnë kërkime të tregut sa herë që ndeshen me paqartësi pra ata kanë njohuri rreth rëndësisë së aplikimit të hulumtimeve të tregut gjatë punës së tyre.

Shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves gjatë kërkimit të tregut aplikojnë fazat kryesore të tij si: përkufizim të problemit dhe qellimi kërkimorë, përpilim i planit kërkimorë, mbledhje e të dhënave, përpunim dhe analizimi i të dhënave si dhe prezantim dhe interpretim i rezultateve, pra ata kanë njohuri të mira rreth këtij procesi.

Shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves gjatë aktiviteteve të tyre afariste e përgadisnin ofertën për konsumatorë duke u bazuar në rezultatet e kërkimit të tregut sepse kjo ju garanton përfitim më të madhë.

Shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves gjatë aktiviteteve të tyre afariste përdorin rezultatet e arritura nga procesi i kërkimeve në biznes për vendimarrje të drejtë sepse ato ofrojnë informata të nevojshme që udhëzojnë zgjedhjen e alternativave të drejta.

Shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves se kanë njohuri rreth konsumatorëve, e dinë cilet janë konsumatorët e tyre, çfarë sasi konsumojnë dhe çfarë do bëjnë kërkime sepse bëjnë hulumtim të tregut dhe posedojnë informata të mjaftueshme.

Shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves e dinë pse konsumatorët blejnë produkte të caktuara mirëpo kanë informata edhe pse ata nuk blejnë produkte të caktuara, dhe se këto informata burojnë nga kërkimet e tregut që ata bëjnë.

Shumica e menaxherve të bizneseve në Komunën e Podujeves kanë informata rreth politikave të çmimeve dhe menyrës së promovimit sepse bëjnë kërkime në treg dhe marrin informata për këto çështje.

### Rekomandimet

Rekomandohen menaxherët e bizneseve në Komunën e Podujeves që të vazhdojnë të zhvillojnë aktivitetet e tyre afariste duke u mbështetur në kërkime të tregut sepse përmes tyre largohen paqartësit dhe zgjidhen alternativat e drejta. Ata menaxher që nuk aplikojnë kërkimet e tregut le të fillojnë ta bëjnë këtë sepse do të kenë informata të shumta në dispozicion dhe do të marrin vendime të drejta afariste.

Rekomandohen menaxherët e bizneseve në Komunën e Podujeves që gjatë kërkimit të tregut nëse deshirojnë informata mjaftueshme të aplikojnë fazat kryesore të kërkimit si: përkufizim të problemit dhe qellimi kërkimorë, përpilim i planit kërkimorë, mbledhje e të dhënave, përpunim dhe analizimi i të dhënave si dhe prezantim dhe interpretim i rezultateve.

Rekomandohen menaxherët e bizneseve në Komunën e Podujeves që të vazhdojnë të përgadisnin ofertën për konsumatorë duke u bazuar në rezultatet e kërkimit të tregut sepse kjo ju garanton përfitim më të madhë, e ata që nuk e kanë bërë këtë deri tani duhet të fillojnë ta aplikojnë.

Rekomandohen menaxherët e bizneseve në Komunën e Podujeves që të vazhdojnë

të zhvillojn dhe aplikojn kërkimet e tregut sepse informatat e fituara nga ky proces ndihmojn në vendimarrje të drejt, ato ofrojn informata të nevojshme që udhëzojn zgjedhjen e alternativave të drejta. Gjithashtu japin njohuri rreth konsumatorve pra cilet janë konsumatorët çfarë sasi konsumojn dhe çfarë dobije kërkojn ata.

Rekomandohen menaxheret e bizneseve në Komunën e Podujevës që të vazhdojn të zhvillojn dhe aplikojn kërkimet e tregut sepse informatat e fituara nga ky proces ndihmojn dhe paisin ata me njohuri për konsumatorët blejnë ose nuk blejnë produkte të caktuara. Gjithashtu informojn rreth politikave të çmimeve dhe menyrës së promovimit.

### Referencat

1. Ceku, B., N. Reshiti, (2006): "Marketingu", Prishtinë, Prograf.
2. Çela, H., (2006): "Etika e Biznesit", Tiranë, albPAPER.
3. Dibb, S., L. Simikin, Peride & Ferrell, (1991): "Marketing", Houghton Mifflin Company.
4. Green, P. E., T. D. Tull, G. Albaum, (1988): "Research for marketing decision", Prentice Hall.
5. Ingram, R., Th. Albright, and B. Baldwin, (2003): "Kontabilitet Financiar", Mason, Ohio USA, Thomson South-Western.
6. Jakupi, A., (2008): "Marketingu", Prishtinë, Universiteti AAB.
7. Jones, C. Parker, M. and Rene ten Bos, (2005): "For Business Ethics", London and New York, Routledge Taylor & Francis Group.
8. Konini, M., I. Peçi, "Fjalor Ekonomik", Tiranë, CIVET, 1997. Fq.302.
9. Mançellari, A., S. Hadëri, Dh. Kule, S. Qiriqi, (2002): "Hyrje në ekonomi", Tiranë, Pegi.
10. Mustafa, M., (2005): "Menaxhimi i investimeve", Prishtinë, Reinvest.61.
11. Reshidi, N., (2008): "Menaxhmenti i Marketingut, ligjerata të autorizuar", Prishtinë, UP.
12. Rexha, N., (1982): "Marketingu", Prishtinë.
13. Skenderi, N. (2010): "Fjalor Ekonomiko-Social", Prishtinë, AKB.
14. Uruçi, E. (2004): "Mikroekonomia", Tiranë, Toena. Fq.64.
15. <https://www.shqipëria.com>

## Politika e Gjellbër - perspektivë e nënavancuar në Marrëdhëniet Ndërkombëtare

**Dr. Adnan Limani**  
Universiteti Europian i Tiranës

### Abstrakt

Autori në këtë studim trajton politikën e gjellbër si një perspektivë të re për të cilën ka një numër shkrimesh përbrënda sferës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare, por që në rastin më të mirë ka ende hapësirë dhe nevojë për të studjuar, nga arsyeja se kjo politikë ka ende një pozicion të nënavancuar dhe të nënvlerësuar në Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Në Marrëdhëniet Ndërkombëtare politika e gjellbër më shumë fokusohet në strukturat, proceset politike dhe në mënyren se si këto struktura dhe procese politike mbizotëruese i ndihmojnë shkatërrimit të natyrës. Objekti qëndror i analizës, si dhe qëllimi i hulumtimit të kësaj politike është mënyra se si shoqëria njerëzore shkatërron specie e ekosisteme, duke penguar kështu funksionimin e suksesshëm të biosferës nga e cila varet mbijetesa e shoqërisë njerëzore. Politika e gjellbër në karakterin e vet ka pozicionim global. Pozicionimi i gjellbër, politikat globale i adreson në një mënyrë të veçantë, por që ka edhe aspekte të përbashkëta me pozicionime të tjera. Megjithatë, kontributi i politikës së gjellbër dallon dhe është i veçantë në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, sepse ajo ofron një analizë dhe shpjegim alternativ të problemeve politike dhe të procesit të negociimit ndërkombëtar ndaj qasjeve nacionaliste tradicionale si dhe ka promovuar ligjërime të reja normative, që kanë prodhuar propozime alternative politikë-formimi në raport me ato që kanë dominuar deri tani negociatat ndërkombëtare. Duke shfletuar përmbajtjen e kësaj politike gjejmë analizat e dinamikave dhe të politikave globale, mirëpo, aty gjejmë edhe vizionet normative për ristrukturimin e politikave globale. Që të konstruktoret një pozicionim i gjellbër në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, argumentat dhe idetë duhet vjelë nga teoria politike e gjellbër, dhe nga "Ekologjia globale". Ky konstruktim i politikës së gjellbër bëhet përmes etiketimit ekocentrik ndaj rritjes, si dhe përmes decentralizimit të pushtetit, e që janë qëndrimet kryesore të kësaj politike. Teoria e politikave e gjellbër dhe "Ekologjia globale" na japin shpjegime të shumta të shkatërrimeve të natyrës nga ana e shoqërisë njerëzore, por gjithashtu me ndihmën e tyre fitojmë edhe një bazë të fuqishme normative se si t'i rezistojmë këtij shkatërrimi dhe si ta krijojmë një shoqëri më të vetëdijësuar dhe më të qëndrueshme.

**Keywords:** *Green Policy, International Relations, ecocentrism, environmentalism, common spaces.*

### Hyrje

Çështjet e ndëlidhura me mjedisin asnjeherë nuk kane qenë në qendër të disiplinës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Disiplina e Marrëdhënieve Ndërkombëtare tradicionalisht ka qenë e preokupuar me të ashtuquajturën "politikën e lartë" dhe është përqendruar kryesisht në sigurinë apo në konflikte ndërshtetërore. Mirëpo, rritja e shpejtë ekonomike, përhapja e teknologjive të reja si dhe rritja e numrit të popullsisë në botë, pas viteve të gjashtëdhjeta, sjellin edhe rritjen e konsumit të energjisë dhe të burimeve, të cilat njëkohësisht ishin edhe burime ndotjeje e prodhimi mbeturinash, që sollën edhe erozionin e shpejtë të biodiversitetit të Tokës. Me paraqitjen dhe me përshkallëzimin e problemeve të tilla mjedisore dhe sidomos të problemeve të para ndërkuftare, është paraqitur edhe nevoja për bashkëpunim mjedisor ndërkombëtar, gjë që ka sjellë lindjen e një nënfushe të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, të politikës së gjellbër, të përqendruar kryesisht në menaxhimin e burimeve të përbashkëta, që të jetë në gjendje të ofrojë interpretime

analitike për ndryshimet mjedisore globale. Megjithatë me rritjen e vazhdueshme të ndërvarsisë globale ekonomike dhe ekologjike dhe me shfaqjen e problemeve në mënyrë unike globale ekologjike, të tilla si ndryshimi i klimës, dëmtimi i shtresës së ozonit dhe shkatërrimit të biodiversitetit të Tokës, si dhe me shfaqjen e çështjeve të tjera që ishin vërtetë globale, kjo fushë studimi e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në vazhdimësi është rritur dhe ka përparuar. Në debate mbi ndryshimin e klimës globale, politika e gjelbër e ka zgjeruar këtë linjë hulumtimi kritik duke përfshirë brenda saj edhe fushat e lëna pas dore të dominimit dhe të marxhinalizimit mjedisor, si dominimin e natyrës jonjerëzore, neglizhimin e nevojave të brezave të ardhshëm dhe shpërndarjen e pabarabartë të rreziqeve ekologjike midis klasave të ndryshme sociale apo shteteve e rajoneve të ndryshme. Teoria e gjelbër ka bërë edhe përpjekje të vazhdueshme që ta tejkalojë kuadrin shtetocentrik të teorisë tradicionale të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe të ofrojë interpretime të reja analitike dhe normative për ndryshimin global mjedisor.

### **Politika e gjelbër – ambientalizmi**

Ambientalizmi duke vepruar brenda strukturave egzistuese, politike, sociale, ekonomike dhe normative të politikave botërore, si dhe duke i pranuar ato, tenton të bëjë ndryshime, gjegjësisht të bëjë përmirësime në çështjet ambientale, gjithnjë brenda strukturave egzistuese. Politika e gjelbër në anën tjetër, pikërisht këto struktura i sheh si burim të krizave ambientale (Patterson, 2009, 268-72) dhe e ka synim dhe insiston që ato struktura egzistuese politike, sociale, ekonomike dhe normative të politikës botërore, të sfidohen dhe të tejkalohen. Dallimi i rëndësishëm mes politikës së gjelbërt dhe ambientalizmit, në mënyrë të qartë pasqyron edhe dallimin në mes teorisë kritike dhe teorisë e cila synon të zgjidh ato çështje.

### **Teoria politike e gjelbër**

Drejtimi i parë që ndihmon konstruktimin e politikës së gjelbër në Marrëdhëniet Ndërkombëtare është teoria politike e gjelbër. Ajo ofron një bazë solide normative për vështrimin e gjelbër. Rreth karakteristikave definuese të politikës së gjelbër ekzistojnë disa ide, të cilat dallojnë mes veti.

Disa ide (Eckersley, 2002, 49-70) si karakteristikë e kanë ekocentrizmin. Ato refuzojnë vështrimin antropocentrik të botës, i cili i vë vlerat morale vetëm mbi njerëzit dhe pranimin nga ata të vështrimit tjetër, që vë vlera të pavarura mbi ekosistemet, por edhe mbi të gjitha qeniet e gjalla.

Disa ide të tjera, teorinë e vlerës së gjelbër e vendosin në qendër të teorisë politike të gjelbër, duke shpjeguar se burimi i vlerës në gjëra është fakti se ato kanë një histori të krijimit përmes proceseve natyrore, në vend të atyre artificiale njerëzore. Këto ide e refuzojnë antropocentrizmin e Eckersley. (Dobson, 2005, 481-561)

Politika e gjelbër këmbëgjul se rritja ekspansionale e dy shekujve të fundit qëndron në rënien e krizës së tashme ambientale. Duhet cekur gjithashtu se politikën e gjelbër nuk e karakterizon besimi në krizën ambientale, por kuptimi i natyrës së kësaj krize, gjë që ata i veçon nga të tjerët. Ky pozicionim i Dobsonit (Dobson, 2006, 447-51) duket më bindës, sepse nëse do të fukosoheshim vetëm në qëndrimin etik ndaj natyrës jo-njerëzore, duke mos i marrë parasysh argumentat për arsyet e atij shkatërrimi nga njerëzit duket se do të largoheshim shumë nga qëndrimet kryesore të politikës së gjelbër dhe politikisht ajo do të mbetet e padefinuar. Bëhen në vazhdimësi përpjekje që të identifikohet edhe pika e tretë

qëndrore e politikës së gjelbër – që është pika e decentralizimit. Nga debatet e shumta që janë zhvilluar rreth asaj se a është decentralizimi në qendër të politikës së gjelbër, si dhe a është decentralizimi i domosdoshëm për politikën e gjelbër (Paterson, 2000, 115-132), është konkluduar se decentralizimi është pika më qëndrore e politikës së gjelbër.

### **Të gjelbërit – politika globale**

Qëndrimet e politikës së gjelbër në lidhje me çështjet e rendit botëror dhe reformimin e saj, janë çështje qëndrore që do të analizohen në vazhdim të këtij studimi.

Ekocentrizmi, si njëra ndër shtyllat e politikës së gjelbërt është ende subjekt i kundërshtimeve se a është apo jo parim kyç i kësaj politike. Ekocentrizmi shpjegon se duhet decentralizuar pushtetin brenda shtetit, por së pari duhet centralizuar atë në nivelet rajonale dhe globale (Eckersley, 2002, 58-69). Sipas kësaj, në një fazë të dytë, gjithnjë sipas këndvështrimit ekocentrik, do të nevojiteshin struktura të reja politike globale. Kjo do të ishte e nevojshme dhe e domosdoshme për të mbrojtur natyrën.

### **Kriza ekologjike globale**

Duke pasur parasysh gjendjen e krijuar dhe krizen ekologjike botërore, arrijmë në përfundimin se vetëm prespektiva mbirajonale dhe veprimi multilateral i shteteve do të mund të sillnin ndryshimet drastike, tepër të nevojshme për shpëtimin e hapësirave të përbashkëta (Rowlands, 1995, 81-108). Bashkëpunimi kombëtar, rajonal dhe global si dhe kontributi ynë, sidomos në ngritjen e vetëdijësimit, do të siguronin funksionimin e biosferës si tërësi, nga e cila varet mbijetesa e shoqërisë njerëzore në Tokë.

Kriza ekologjike globale është aq e rëndë dhe përshpejtimi i saj është i tillë sa që njerëzimi nuk mund të ndalojë e të mos reformojë institucionet dhe tërë atë çfarë është e nevojshme për nxitjen e një aksioni kombëtar dhe ndërkombëtar. Përqendrimet atmosferike të gazrave serrë që shkaktohen nga aktiviteti njerëzorë janë rritur së tepërmi sidomos pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ndërsa vitet e '90-ta të shekullit të kaluar shfaqen si vitet më të ngrohta nga regjistrimet në planetin tonë. Studjuesit e politikës së gjelbër tërheqin vërejtjen se nëse vazhdohet me emetimet e pakontrolluara të gazrave, që shkaktojnë efektin serrë atëherë bota do të përballet me shfarrosje masive, me mungesë uji, energjie dhe ushqimi, si dhe në humbjen e brezave koralorë, me rritjen e nivelit të deteve, me dëmtime infrastrukturore bregdetare, me një numër të lartë vdekjesh njerëzore apo me përjetimin nga shfaqja e shpeshtë e kushteve ekstreme të motit (IPCC, 2001, 31). Ndryshimi i klimës do të përshkallëzojë, gjithashtu, pabarazitë ekzistuese në posedimin e mjeteve më të domosdoshme për jetesë, si përkujdesjen shëndetësore, ushqimin e përshtatshëm dhe ujin e pijshëm. Për komponentat e qenësishme për ekzistencën e njeriut dhe të mbijetesës në Tokë, siq është uji, Organizata Botërore e Shëndetësisë tregon se 3/5 e popullsisë në vendet e varfëra nuk furnizohen me ujë përkatës, krahas kësaj një numër edhe më i madh i popullsisë së vendeve të varfëra nuk kanë dhe nuk kanë pasur kurrë as stabilimentet minimale higjienike. E njëjta vlen edhe për tokën, ajrin dhe komponentat e tjera të mjedisit, të cilat, si rezultat i zhvillimit tekniko-shkencor, ose i përdorimit të gabuar, kanë pasur për pasojë degradimin mjedisor, me çfarë është rrezikuar seriozisht jeta dhe shëndeti i njerëzve, që janë ndër të drejtat më elementare të njeriut. (Schlosberg, 2007, 118-36).

Ekonomitë industriale përdorin disa lëndë kimike të cilat në kontakt me ajrin udhëtojnë deri në shtresat më të larta të atmosferës duke ndërvepruar kështu me ozonin dhe duke

e dëmtuar atë. Ozoni, i cili ndodhet në shtresat e larta të atmosferës dhe që shërben për filtrimin e rrezeve të dëmshme ultraviolete, që vijnë nga dielli, hyn në mesin e faktorëve kyç për mbijetesën në Tokë. Prandaj, varfërimi i ozonit është një çështje madhore në vete. Konferenca e Parë e palëve për reduktimin e emitimeve të gazrave serrë nga vendet e industrializuara u mbajt në Berlin në vitin 1995 (Hickman & Bartlett, 2001, 11-12), ku u ra dakord se duhej negociuar me urgjencë një Protokoll i cili do të ishte i detyrueshëm ligjërisht dhe që të përmbante objektiva të detyrueshëm për reduktimin e emitimeve të gazrave serrë të vendeve të industrializuara. Kjo konferencë hapi rrugët për Protokollin e Kiotos, të mbajtur në Kioto të Japonisë, në vitin 1997.

Sipas protokollit të Kiotos, vendet e industrializuara dhe ekonomitë në tranzicion të përfshira në Shtojcën I të Konventës zotoheshin për uljen e totalit të emitimeve të tyre direkte të gazrave serrë për së paku 5.2 % kundrejt niveleve të vitit 1990, për një periudhë kohore pesëvjeçare 2008-2012 edhe pse vende të ndryshme negociuan objektiva të ndryshëm. Megjithatë, objektiv i prej 8%, i negociuar nga administrata amerikane e presidentit Clinton në Kioto, u hedh poshtë në vitin 2001 nga administrata e presidentit Bush, kështu SHBA dhe Australia ishin dy vende shumë të rëndësishme që refuzuan të ratifikojnë Protokollin e Kiotos. Edhe në mungesë të këtij bashkëpunimi të shtetit më të fuqishëm të botës, Protokollin e Kiotos (Grubb, Brack and Vrolijk, 1999, 256) u bë ligjërisht i detyrueshëm në vitin 2005, pasi në fund të vitit 2004 atë e ratifikoi Rusia. Në fund të periudhës së parë të zotimit, në Doha më 2012, është miratuar një amendament për të zgjatur Protokollin deri më 2020. Në këtë amendament, Bashkimi Evropian zotohet se do të ulë emitimet për 20% gjatë periudhës deri më 2020, krahasuar me vitin bazë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vazhdimësi janë përpjekur t'i shmangen Protokollit të Kiotos. Në fund të vitit 2004 me një marrëveshje alternative për klimë, të njohur si "Partneriteti Azi-Paqësor për një Klimë dhe Zhvillim të Pastër" (The Asia-Pacific Partnership on Clean Development and Climate, APP), me pjesëmarrjen e Australisë, Kinës, Indisë, Koresë së Jugut dhe Japonisë, marrëveshje e cila vepron jashtë kuadrit të Kombeve të Bashkuara (McGee & Taplin, 2006, 173-92). Nga shembujt e përmendur rezultojnë qartë mosserioziteti dhe mospërkushtimi i duhur i institucioneve të specializuara kombëtare e ndërkombëtare ndaj kësaj çështjeje aq madhore për njerëzimin.

Megjithatë, edhe me pjesëmarrje të plotë të Shteteve të Bashkuara në Protokollin e Kiotos, objektivi agregat i negociuar në masën rreth 5% nuk do të mjaftonte për të filluar zgjidhjen e çështjes së ngrohjes globale, sepse sipas studjuesve dhe teoricientëve të politikës së gjelbër, për të mbrojtur atmosferën e Tokës, është e nevojshme që përqendrimet atmosferike të gazrave serrë të reduktohen me rreth 60-80%. Një veprim i përmasave të tilla duket i paaritshëm në raportet e sotme politike në marrëdhënit mes shteteve dhe në kohët e stërmbushura me probleme nga më të ndryshmet, duke filluar nga kriza ekonomike globale në një anë dhe sfidat në luftën kundër terrorizmit global në anën tjetër. Megjithatë, politika e gjelbër në vazhdimësi i artikulon këto shqetësime (Nixon, 2011, 106-07) duke kontribuar dhe në vazhdimësi duke synuar veprime bashkërenditëse lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të domosdoshme për të arritur objektivat e këtyre përmasave.

Duke pasur parasysh madhësinë e sfidës përpara nesh, mund të presim që negociatat për ndryshim të klimës të bëhen tipar i vazhdueshëm i disiplinës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Megjithatë, kontributi i teorisë së gjelbër në Marrëdhëniet Ndërkombëtare dallon nga teoritë e tjera (Steans, Pettiford, Lloyd, 2004, 203-28). Ajo ofron një analizë dhe shpjegim alternativ të çështjeve politike dhe të procesit të negociimit ndërkombëtar ndaj qasjeve nacionaliste tradicionale si dhe kanë promovuar ligjërime të reja normative,



që kanë prodhuar propozime alternative politike-formimi në raport me ato që kanë dominuar deri tani negociatat ndërkombëtare.

### Argumentat e qëndrimit ekocentrik

Qëndrimi ekocentrik argumenton zvogëlimin e bashkësive njerëzore dhe në veçanti kundërshtimin e prirjeve për globalizim dhe homogjenizim. Duke studiuar mbi pasojat e ekocentrizmit në politikë (Eckersley, 2002, 39-56), pikëpamjet mbi kufizimet e rritjes shtohen edhe më tej. Këto pasoja bëhen edhe më domethënëse për strukturat politike globale. Janë të dobishme disa pozicionime që burojnë nga versioni i kufizimit të rritjes për qëndrueshmëri, e që janë të pranuar nga të gjelbërit.

Pozicionimi i parë e emërtuar si *“shteti dhe kombi”*, pohon se shteti-komb është njëkohësisht shumë i madh dhe njëherit edhe shumë i vogël që seriozisht të merret me çështjen. Nga kjo arsye, për këtë synim sipas tyre, nevojiten struktura rajonale dhe globale për një bashkërendim sa më efikas të veprimeve, krahas decentralizimit brenda vetë shteteve. Një pozicionim tjetër flet për nevojën e një autoritarizmi të centralizuar, e cila përcjell logjikën e parimit të quajtur si *“tragjedia e hapësirave të përbashkëta”*, që do të thotë se burimet e përbashkëta do të shfrytëzoheshin tej mase dhe se do të ishin të nevojshme politikat globale të centralizuara, për të detyruar ndryshimet e sjelljes, në arritjen e qëndrueshmërisë. Pozicionimi i fundit, i ngjashëm me pozicionimin e dytë, thekson gjithashtu se autoritarizmi do të ishte i nevojshëm, por e kundërshton idenë e shtrirjes së tij në përmasa globale. Ky qëndrim ndan idenë se liria dhe egoizmi janë në mesin e faktorëve kyç që deri më tani e kanë shkaktuar krizën ambientale, por në të njëjtën kohë propozon që këto prirje negative duhet minimizuar, në mënyrë që të krijohen shoqëri sa më të qëndrueshme. Kjo pikëpamje e emërtuar si *“zgjidhja anarkiste”* është pranuar nga të gjelbërit, si interpretimi më i mirë i pasojave të kufizimit të rritjes. Ky pozicionim konsiderohet edhe si njëri nga parimet e mirëfillta të politikës së gjelbër. Ndërsa, me termin *“anarkist”* të gjelbërit parashohin një rrjetë bashkësish globale të vogla dhe të pavarura. Por, edhe pse të pavarura ato kanë orientim global, nuk janë të shkëputura nga bashkësitë e tjera, por në shumë aspekte janë të konceptuara brenda rrjetit të marrëdhënieve të detyrimit, të shkëmbimeve kulturore. (Barry,1996, 115-31)

### Mendo globalisht, vepro lokalisht

Nga këndvështrimi i gjelbër, shteti jo vetëm se është i panevojshëm, por është edhe plotësisht i padëshiruar. Slogani i njohur i politikës së gjelbër: *“Mendo globalisht, vepro lokalisht”*, buron nga ideja se edhe në qoftë se çështjet e shumta që e rëndojnë gjendjen ambientale dhe ekonomiko-shoqërore mbijetojnë në nivel global, ato mund të menaxhohen, të kontrollohen, por me një pëkushtim të gjithëmbarshëm edhe të menjaherë. Nje gjë e tillë mund të realizohet vetëm nëse këto struktura globale të pushtetit (Szczyszynski, 2006, 75-100), që i gjenerojnë ato, bëhen përmes veprimeve lokale. Nga ato ndërtohen pastaj bashkësi të vogla të pavarura politike dhe ekonomike. Këtë konstatim e mbështesin edhe disa autorë. Njëri ndër ta është John Dyzek, me veprën e tij *“Kthimi argumentues në Politikë Analizë dhe Planifikim”* (Dyzek, 1993, 213-32). Ky autor në përmbledhjen e tij analizon përparësitë e decentralizimit. Sipas tij bashkësitë e vogla janë më të dobishme dhe më efektive, sepse mund të reagojë më shpejtë në zgjidhjen e ndonjë çështjeje ambientale në një ambient të caktuar, sepse rruga e reagimit është më e shkurtër, e këtë e mundëson pavarësia dhe vogëlsia e tyre. Kjo mënyrë mundëson veprim shumë më të shpejtë, para se

këto çështje të thellohen dhe te ndërlikohen.

### Hapësirat e përbashkëta

Studiuesit e ekonomisë globale e theksojnë në veçanti argumentin e teorisë së gjelbër për decentralizimin e pushtetit. Këtij argumenti ata ia bashkangjesin edhe një trajtim nga pikëpamja e ekonomisë politike, përmes së cilës ata sugjerojnë se ajo nuk është thjeshtë një çështje e përmasave të organizimit politik, por edhe e riorganizimit të formës strukturore të institucioneve politike dhe në veçanti të rikonceptimit të asaj se si prodhim ekonomik, shpërndarja dhe shkëmbimi (Barry & Eckersley, 2005, 179–94), që përbëjnë mënyren e drejtëpërdrejtë përmes së cilave shoqëritë njerëzore e tjetërsojnë natyrën, integrohen në jetën politike. Argumenti i tyre kategorik është se format më të pranueshme të ekonomisë politike janë “hapësirat e përbashkëta”. Ky argumentim mbron në thelb idenë se hapësirat e përbashkëta janë vende ku aktualisht zbatohen praktikatat më të qëndrueshme. Këto hapësira janë të kërcnuara nga zhvillimi, i cili vazhdimisht përpiket t’i rrethoi dhe pushtoi, në mënyrë që t’i kthejë ato në mallëra konsumi. Vërejmë se një nga pjesët qëndrore të politikës së gjelbërt është rezistenca e saj ndaj këtij rrethimi dhe pushtimi. I një rëndësie të veçantë është edhe projekti për krijimin e këtyre hapësirave edhe atje ku ato nuk janë prezente. Në ato hapësira përdorimi nuk mungojnë rregullat për qeverisjen e tyre, ato administrohen përmes rregullave të përcaktuara nga bashkësitë e varura prej tyre. Se a do të jetë përdorimi i suksesshëm i këtyre hapësirave kjo varet nga barazia mes anëtarëve. Nëse nuk ka barazi në pushtet mes anëtarëve, disa anëtarë mund edhe t’i injorojnë rregullat e bashkësisë (Curtin, 2002, 293-304). Këto hapësira gjithashtu krijojnë edhe praktika më të qëndrueshme. Duke siguruar kështu barazi në të ardhura dhe barazi në pushtet, gjë që nënkupton se askush nuk mund të uzurpojë apo mbizotëroi sistemin. Gjithashtu edhe natyra reth këtyre hapësirave të përbashkëta me pyje dhe lumenj mbetet e padëmtuar, sepse secili pjesmarrës kujdeset nga arsyeja se nga to varet cilësia e jetesës së tij, por edhe nga frika se do të përballet me fqinj të e vet, kështu që të gjithë kujdesen për një të mirë të përbashkët.

Argumentat e teorisë së gjelbër janë në përputhje me idetë e cekura të hapësirave të përbashkëta, që kanë të bëjnë me nevojën e decentralizimit të pushtetit dhe me demokracinë në mesin e njerëzve të zakonshëm. Ideja e hapësirave të përbashkëta i plotëson argumentat e teorisë së politikës së gjelbër, duke shpjeguar njëherit se bashkësitë e vogla demokratike kanë më tepër gjasa të krijojnë praktika të qëndrueshme brenda kufijve të planetit tonë, i cili gjithsesi se nuk është i pafund (Kweon, Sullivan & Wiley, 1998, 832-58).

Duke i shtjelluar argumentat e gjelbëra për decentralizim, hasim edhe në kundërshtitë ndaj tyre. Së pari, thuhet se vizioni i të gjelbërve për një politikë të tillë, të lokalizuar, lë përshtypjen e një krijese të vogël, të padëshiruar, në të cilën do të ishte e pakëndshme të jetohej, se një “krijesë” e tillë do të ishte edhe tiranizuese. Një anë pozitive sipas tyre dhe me shumë rëndësi do të ishte fakti se ata nuk do të shqetësoheshin për ambientin, në anën tjetër të kufirit. Të gjelbërit, duke qenë të vetëdijshëm për këtë argument, japin propozimet e tyre dhe shpjegojnë se këto bashkësi të vogla nuk do të duhej të ishin egoiste, të mbyllura apo të orientuara vetëm nga vetja e tyre. Por, ato do duhej të ishin të hapura, të bashkëpunonin dhe sidomos të këmbenin përvojat mes veti. Kjo sipas të gjelbërve do të ishte ajo që kërkohet për ruajtjen e hapësirës së përbashkët. Përsa i përket shqetësimeve që janë kundër këtij argumenti, e që kanë të bëjnë me kujdesin e një bashkësie ndaj një bashkësie tjetër, hidhen poshtë si naive dhe të pabaza (Dobson, MacGregor, Torgerson

& Saward, 2009, 317-50). Aty thuhet se asnjë formë politike nuk do të ishte në gjendje të garantonte që bashkësitë do të përkujdeseshin për pasojat tek bashkësitë e tjera. Se a do të zgjidhet me sukses një çështje me aq rëndësi, nuk i takon strukturës politike, por kulturës politike.

Një kritikë tjetër që adresohet tek të gjelbërit ka të bëjë me decentralizimin. Kundërshtarët theksojnë se mbrojtja që të gjelbërit ia bëjnë decentralizimit duhet të pranojnë se ata nuk e njohin sistemin e shteteve sovrane bashkëkohore, e që një pohim i tillë cenon rëndësinë globale të pohimeve të të gjelbërve. Kundërshtarët më pastaj shtojnë se këto bashkësi të vogla e të decentralizuara do të kenë shumë pak gjasa që të merren me zgjidhjen e çështjeve globale ambientale, duke pasur parasysh se numri më i madh i tyre janë ndërkombëtare apo edhe globale dhe që për të reaguar ndaj tyre medoemos nevojitet një bashkëpunim global (Forsyth, 2002, 20-3). Ky argument është i arsyeshëm, por nëse shtojmë se shteti me të drejtat e veta sovrane, të paprekshme është ajo formë e nevojshme për mundësinë e një bashkëpunimi të tillë, atëherë me këtë kthesë në argumentim, janë edhe më pak bindës.

Argumentat e të gjelbërve, të cilët propozojnë një sistem me pushtet sa më shumë të decentralizuar, duket se arrijnë në pikën e tyre më të dobët. Mirëpo, kritikët dhe kundërshtarët (Goodin, 1994, 79-81) kanë dështuar në përpjekjet e tyre për ta provuar se të gjelbërit kanë nevojë të parashikojnë më tepër, se sa thjeshtë të shndërrohen në institucione të grumbullimit të të dhënave. Propozimet e gjelbëra, në anën tjetër, mbesin në përparësinë e tyre se decentralizimi radikal bënë menaxhimin ambiental më praktik në terren. Arrijmë kështu dilemën e pashmangshme, duke mos e pasur të qartë se me argumentat e dhënë, vështirësojmë bashkërendimin e njërive, si pasojë e decentralizimit, apo bashkërendimin brenda njërive, si pasojë e ruajtjes së formave të centralizuara të organizmit shoqëror.

Studimet e shumta, që sidomos në dekadën e fundit merren me politikat e gjelbëra në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, arsyetojnë se kjo politikë mbetet me tërë qenien e saj e përkushtuar për një model sovran. Ndërsa disa trajtime teorike të kësaj lëmie mund të inkorporohen në teorinë eko-politike (Christoff, 1996a, 151-169), në rend të parë për shkak të orientimit të tyre të ngjashëm të shtetit dhe sovranitetit. Ndonjë teori e pranon shtetin si vend të përshtatshëm për eko-politikë, por në anën tjetër ka edhe teori të cilat shpjegojnë se shteti është e kundërta absolute e politikës së vërtetë ekologjike. E përbashkëta e këtyre teorive është ajo se e sendërtojnë shtetin si një hapësirë apo lokacion të aktivitetit politik, ose për të mirë ose për të keq. Nga kjo arsye edhe lindin propozimet për një mënyrë më të saktë të të kuptuarit të formave të qeverisjes në lidhje me politikat ambientaliste, e që është, të braktisen totalisht konceptet egzistuese hapsinore dhe territoriale të politikës.

Jemi dëshmitarë se në epokën e globalizimit dalëngadalë po shfarosen format e rrjeteve ndërkombëtare të qeverisjes, sidomos për të minimizuar çështjet ekologjike, të cilat mundësojnë një formë alternative të politikës. Problemet me këtë formulim, kryesisht qëndrojnë në faktin se ai (Vogler & John, 2008, 348-416) i merr si të mirëqena proceset politike dhe ekonomike të globalizimit, të cilat dëmtojnë format tradicionale të politikës dhe në këtë mënyrë ky formulim nuk ia del të imagjinojë mundësinë e rezistencës ndaj globalizimit, jo për të ringjallur shtetin kombëtar, por për të mundësuar një decentralizim më të plotë të jetës politike.

Një urrëlidhëse e përshtatshme e bashkëpunimit dhe e bashkërendimit më të lehtë ndërkombëtarë ndoshta mund të ishte edhe shoqëria civile me rrjetet e saja globale, në mënyrë që bashkësia ndërkombëtare më me seriozitet t'i qasej bashkërendimit të çështjeve të shtruara, por me kushtin se ato sërish nuk t'i kthente prap në fushën e politikës (Terrier

& Wagner, 2006, 223-34).

Pavarësisht nga dyshimet e ngritura dhe ndaj kritikës së politikës së gjelbër, argumentat e tyre fuqizohen me disa argumenta të studuesve të “*Ekologjisë globale*”. Ata përqendrohen në atë se si këto “*Hapësirat e përbashkëta*” janë një formë e hapësirës politike dhe sociale nga më inkurajueset për praktika të qëndrueshme. Ky qëndrim i fuqizon edhe më tej argumentat për centralizim (Dryzek, Downes, Hunold, Schlosberg & Herne, 2003, 145-64).

Teoria politike e gjelbër po ashtu mbron edhe parimet e ekocentrizmit, të kufizimeve të rritjes dhe të centralizimit të pushtetit dhe refuzon sistemin ekzistues të shteteve. Më tepër e arsyejnë decentralizimin politik të bashkësive të varura nga shtetet kombe, se sa format e reja të shtetit politik global (Eckersley, 2004, 254-87). Këtu përfshihet jo vetëm decentralizimi i organizatave politike, por edhe i organizatave ekonomike e shoqërore. Kjo politikë synon braktisjen e sistemeve të praktikave tradicionale sovrane dhe formimin e hapësirave apo lokacioneve të kombinuara të pushtetit.

### **Objekti qëndror dhe qëllimi i politikës së gjelbër**

Objekti qëndror i analizës, si dhe qëllimi i hulumtimit të politikës së gjelbër është mënyra se si shoqëria njerëzore shkatërron specie e ekosisteme, duke e penguar kështu funksionimin e suksesshëm të biosferës nga e cila varet vetë mbijetesa.

Në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, të gjelbërit më shumë fokusohen në strukturat, proceset politike dhe në mënyren se si këto struktura dhe këto procese politike mbizotëruese i dalin në ndihmë këtij shkatërimi. Qëllimi i hulumtimit të tyre është normativ, që të kuptohet se si mund të reformohen strukturat globale politike për të parandaluar një shkatërrim të tillë dhe për të siguruar marrëdhënie më të qëndrueshme njerëzore me planetin dhe me pjesën tjetër të banorëve të tij. Imperativa normative është impulsi primar në politiken e gjelbër (shpjegimi i shkatërrimeve ambientale renditet më pas), kurse në aspektin metodologjik, nuk ka një metodologji që do të mund të identifikohet qartë si “*Metodologjia e gjelbër*”. (Steans, Pettiford & Diez, 2004, 203–228)

Teoria e gjelbërt, sikurse edhe shumë teori të tjera, refuzon të veçojë Marrëdhëniet Ndërkombëtare nga disiplinat e tjera. Kjo teori ndan refuzimin e dallimit të vrazhdë dhe të nxituar fakt-vlerë me feminizmin, me teorinë kritike dhe me poststrukturalizmin, gjithnjë duke bërë përpjekje konkrete për të integruar qasjet normative dhe ato shpjeguese. Ata mendojnë (MacGregor, 2006b, 101-26) se qëllimi primar i teorisë është të nxisë emancipimin. Duke e mohuar kategorikisht shtetin, mohojnë edhe ndarjen e prerë mes politikës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare këtu politika e gjelbër bashkohet me pluralistët, por njëkohësisht edhe me marksistët, teoricienët kritik dhe me feministët. Politika e gjelbër ka edhe elemente të teorizimit modern në aspektin që tentojnë të kuptojnë botën në mënyrën më serioze të mundur dhe që të mundësojnë përmirësimin e saj.

Gjatë analizimit vërehet qartë se teoria e gjelbërt ka një perceptim të veçantë. Ajo është e përqëndruar në marrëdhëniet njerëzim-natyre dhe tek pranimi i etiketimit ekocentrik në lidhje me këto marrëdhënie (Eckersley, 2010, 267-76). Vëmendja e saj përqendrohet në kufizimet e rritjes, me një qasje të veçantë ndaj aspektit shkatërrimtar, ndaj zhvillimit dhe në veçanti ndaj decentralizimit e shtetit komb. Tiparet e përmendura janë unike për politikën e gjelbër.

Prandaj, me plot bindje themi se qëllimi i teorisë së gjelbërt në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare është që të ofroi shpjegime për krizat ekologjike me të cilat përballet sot njerëzimi sidomos kohëve të fundit. Ajo i trajton këto kriza si çështje me të cilat duhet të merret njerëzimi, duke ofruar bazën normative për një trajtim të tillë.

### Konkluzion

Politika e gjelbër me përceptimin e saj të veçantë ndihmon gjelbërimin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare duke ofruar shpjegime dhe baza normative për ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës. Marrëdhëniet Ndërkombëtare me kalimin e kohës, por sidomos pas fillimeve të globalizimit të teorisë së gjelbër janë komletuar dhe janë përplotësuar nga hulumtimi i gjelbër normativ, e cila me politikën e saja të gjelbëra ka kontribuar në debate të ndryshme mbi drejtësinë ndërkombëtare, demokracinë kozmopolite dhe të ardhmen e shtetit.

Kjo politikë ka parasysh çështjet që kanë të bëjnë me krizën ekologjike, çështje këto të së mirës së përgjithshme. Sot, duke qenë dëshmitar të veprimeve të pamatura që bëhen ndaj mjedisit, më shumë se kurrë shtrohet nevoja e domosdoshme për një bashkëpunim ndërkombëtar për ruajtjen dhe përparimin e mjedisit si një *res omnium* (një e mirë e përgjithshme) për ne për brezat e ardhshëm.

Teoricienët e gjelbër normativë argumentojnë se shtetet përfaqësojnë institucionin më të lartë me kapacitetin dhe legjitimitetin e duhur për të imponuar kufizime ekologjike. Prandaj, shtetet demokratike dhe sistemi i shteteve përbëjnë hapin e nevojshëm drejt modernizimit reflektues, që pritet të prodhojë një globalizëm të vërtetë të kufizuar ekologjikisht.

Teoria e gjelbër e Marrëdhënieve Ndërkombëtare i është nënshtuar një zhvillimi domethënës gjatë dekadës së fundit, sot njihet dhe pranohet si një rrymë e re dhe domethënëse e teorisë së Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Nëse thuhet se shtetet (dhe qytetarët brenda tyre) bëhen gjithnjë e më shumë përgjegjës e të përgjegjshëm për komunitetet dhe mjedisin përtej kufijve të tyre, atëherë ata mund të cilësohen si shtete e qytetarë të një bote globale e jo vetëm shtete-kombe apo qytetarë të një kombi të caktuar. Kjo që u tha është ende larg nga ideali dhe nuk është aspak e lehtë për t'u realizuar, por politika e gjelbër e ka nxjerr tanimë këtë ideal në shesh dhe dita më ditës kanë arritur ta bëjnë gjithnjë e më të përfytyrueshëm dhe më real realizimin e tij.

### Literatura

- Barry, J. (1996). *Democracy and Green Political Thought. Sustainability, Rights and Citizenship*. London: Routledge.
- Barry, J. & Eckersley R. (2005). *The State and the Global Ecological Crisis*. London: MIT Press.
- Christoff, P. (1996a). *Democracy and Green Political Thought. Sustainability, Rights and Citizenship*. London: Routledge.
- Curtin, D. (2002). Ecological Citizenship, *Handbook of Citizenship Studies*. London: Sage.
- Dobson, A. MacGregor, S. & Torgerson, D. (2009). Trajectories of green political theory. *Contemporary Political Theory*, 8(3).
- Dobson, Andrew. (2006). Ecological citizenship: A defence. *Environmental Politics* 15(3).

- Dobson, A. (2005). *Citizenship. Political Theory and the Ecological Challenge*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Dryzek, J. (1993). *The Argumentative Turn in Policy Analysis and Planning*. London: UCL Press.
- Eckersley, R. (2010). 'Green Theory' in *International Relations Theories: Discipline and Diversity*. Oxford: Oxford University Press.
- Eckersley, R. (2004). *The Green State: Rethinking Democracy and Sovereignty*. London: MIT Press.
- Eckersley, R. (2002). *Environmental pragmatism, ecocentrism, and Deliberative Democracy*, Oxford: Rowman and Littlefield.
- Fischer, F. (2003). *Beyond Empiricism: Policy Analysis as Deliberative Practice*. Cambridge, Cambridge University Press.
- Forsyth, T. (2002). *Critical Political Ecology: The Politics of Environmental Science*. London: Routledge.
- Grubb, Brack & Vrolijk. (1999). *The Kyoto Protocol. Assessment*. London: Earthscan.
- Intergovernmental Panel on Climate Change (IPCC), *The IPCC Third Assessment Report, Climate Change*, (2001).
- Hickman J. & Bartlett S. (2001). "Global Tragedy of the Commons at COP 6 "Synthesis/Regeneration 24. Greens.org. Retrieved (2010).
- Kweon, Sullivan & Wiley, (1998). *Green Common Spaces and the Social Integration of Inner-City Older Adults. Environment and Behavior*. MA: The MIT Press.
- McGee, J. & Taplin R. (2006). A complement or competitor to the Kyoto Protocol?," *Global Change, Peace and Security*, Vol. 18, No. 3.
- MacGregor Sh. (2006b). A feminist critique of environmental citizenship. *Environmental Citizenship*. Cambridge, MA: The MIT Press.
- Nixon, R. (2011). *Slow Violence and the Environmentalism of the Poor* (Cambridge, MA.: Harvard University Press).
- Patterson, M. (2000). *Understanding Global Environmental Politics: Domination, Accumulation, Resistance* (London: Palgrave).
- Patterson, M. (2009). 'Green Politics' in *Theories of International Relations*. Burchill, Scott et al. Basingstoke: Palgrave Macmillian.
- Goodin, R. (1992). *Green Political Theory*, Oxford: Polity Press.
- Rowlands, I. (1995). *The Politics of Global Atmospheric Change*, Manchester University Press.
- Schlosberg, D. (2007). *Defining Environmental Justice: Theories, Movements, and Nature* (Oxford: Oxford University Press).
- Stans, J. Pettiford, Ll. Diez, Th. (2004). *Introduction to International Relations: perspectives and themes* . London: Pearson.
- Szerszynski, B. (2006). *Local landscapes and global belonging: Toward a situated citizenship of the environment*. Cambridge, MA: The MIT Press.
- Terrier, J. & Wagner, P. (2006). The return of civil society and the reopening of the political problématique. *The Languages of Civil Society*. Oxford: Berghahn.
- Vogler, J. (2008). 'Environmental Issues' in *The Globalization of World Politics: An Introduction to International Relations*. Oxford: Oxford University Press.

### **Vebfaqe të rëndësishme**

#### **[www.envirosecurity.org](http://www.envirosecurity.org)**

Instituti për Siguri Mjedisore. Një organizatë jo-qeveritare, jo-profitabile ndërkombëtare e themeluar në vitin 2002, në Hagë për të ngritur vëmendjen politike për sigurinë e mjedisit, si një mjet për të ndihmuar në ruajtjen e kushteve thelbësore për paqe dhe zhvillim të qëndrueshëm.

#### **[www.gci.org.uk](http://www.gci.org.uk)**

Instituti i Përbashkët Global. Një institut i pavarur me qendër në Londër, i drejtuar nga Aubrey Meyer, i përkushtuar për pakësimin dhe lirimin emetimeve globale të gazrave serrë në të ardhmen.

#### **[www.twinside.org.sg](http://www.twinside.org.sg)**

Rrjeti i Botës së Tretë. Një rrjet i pavarur jo-profitabil ndërkombëtar i organizatave dhe individëve të përfshirë në çështjet që ndërlidhen me zhvillimin e çështjeve të Botës së Tretë dhe Veri-Jug, me një lidhje të plotë të mjedisit.

#### **<http://www.wupperinst.org/globalisation>**

Instituti Wuppertal. Një institut i pavarur hulumtimi që bën kërkime mbi efektet sociale dhe ekologjike të globalizimit dhe zhvillon strategji për globalizim të qëndrueshëm.

#### **[http://en.wikipedia.org/wiki/Kyoto\\_Protocol](http://en.wikipedia.org/wiki/Kyoto_Protocol)**

Dokumentat dhe vendimet e Konferencës, Protokolli i Kiotos, Japoni, 11 dhjetor 1997.

## Përcaktuesit e Strukturës së Kapitalit

**Dr. Anila Çekrezi**

*Departamenti i Financë-Kontabilitet, Fakulteti Ekonomik,  
Universiteti "A-Xhuvani", Elbasan*

### Abstrakt

Struktura e kapitalit të firmave është një fushë e rëndësishme kërkimore e financave të korporatave dhe ajo mbetet në qendër të studimeve të akademikëve të ndryshëm. Megjithatë pjesa më e madhe e studimeve janë fokusuar mbi firmat e listuara të vendeve të zhvilluara dhe pak vëmendje u është kushtuar firmave të palistuara të vendeve në zhvillim. Prandaj, ky studim përqipet që të plotësojë hendekun duke analizuar strukturën e kapitalit të firmave të palistuara në Shqipëri. Mostra përfshin 69 ndërmarje të vogla dhe të mesme, të dhënat e të cilave janë marrë nga pasqyrat e bilanceve të dorëzuara pranë Zyrës Shtetërore të Tatimeve për periudhën 2008-2011.

Në këtë studim është testuar ndikimi i përcaktuesve specifikë të firmës: kthimi nga aktivet (ROA); kthimi nga kapitali (ROE); trupëzimi i aktiveve (TRUP); likuiditeti (LIK); madhësia (MADH); rreziku (RISK); fleksibiliteti financiar (FLEKS) dhe përfitimi tatimor nga shpenzimet joborxh (PTSHA). Ndërsa struktura e kapitalit i cili shërben si variabël i varur është matur përmes raportit të totalit të detyrimeve ndaj totalit të aktiveve (DAT). Hetimi përdor procedurën e të dhënave panel si dhe regresionin e thjeshtë shumëvariabël. Rezultatet e këtij studimi vërtetuan se jo të tërë faktorët ndikojnë njëllë mbi të gjitha firmat si dhe modeli i ndërtuar vlen më shumë për shpjegimin e firmave të mëdha se sa të grupeve të tjera të firmave.

**Fjalë kyçe:** *Shqipëri, struktura e kapitalit, faktorët specifikë të firmave, faktorët makroekonomikë.*

### Hyrje

Shumë studime janë kryer për të provuar vërtetësinë e teorive të strukturës së kapitalit, por ajo mbetet sërish një nga çështjet më të diskutuara në financat moderne të korporatave. Pyetja e Myers (1984, f. 575): "Si e zgjedhin firmat strukturën e tyre kapitale?", ende ka nevojë për një përgjigje. Për këtë arsye, studime të tjera empirike mbi këtë çështje, janë bërë dhe do të vazhdojnë të bëhen në mënyrë që të sillen fakte të mëtejshme mbi teoritë e strukturës së kapitalit. Studimi i Myers (1984) është një nga më të cituarit në literaturën e gjërë mbi strukturën e kapitalit, i cili e shpjegon financimin e korporatave duke marrë në konsideratë disa nga faktorët specifikë të firmave në vendet e zhvilluara. Ky studim shqyrton faktorët specifikë të firmave dhe faktorët makroekonomikë, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga modeli i Myers (1984).

Në vendet e zhvilluara ekziston një literaturë e gjerë mbi strukturën e kapitalit, por shumë pak studime janë bërë me të dhëna të vendeve në zhvillim. Gjithashtu, studimi empirik i përcaktimit të strukturës së kapitalit në Shqipëri, është thuajse inekzistent, pavarësisht rëndësisë së kësaj çështjeje. Nuk ka asnjë provë empirike për t'iu përgjigjur pyetjeve të tilla si:

1. Cilët janë faktorët që ndikojnë në vendimin e strukturës së kapitalit të firmave shqiptare?
2. A ka dallime në përzgjedhjen e strukturës së kapitalit midis firmave të vogla të mesme dhe të mëdha?

Ky punim vijon si më poshtë: Seksioni vijues është shqyrtimi i literaturës, Seksioni i tretë paraqet në detaje metodologjinë e studimit, Seksioni i katërt paraqet analizën e rezultateve



dhe interpretimin e të dhënave të gjetura dhe seksioni i fundit përmbledh përfundimet e bazuara në rezultate.

### Shqyrtimi i literaturës

Teoritë kryesore mbi strukturën e kapitalit janë si më poshtë:

- Teoria e Modigliani dhe Miller e vitit 1958, thekson se në kushte të caktuara, vlera e një firme nuk varet nga mënyra sesi ajo financohet. Kjo teori u zhvillua më tej në vitin 1963, e njohur dhe si MM II.

- Teoria trade-off pohon se firmat përpiqen që të maksimizojnë kthimin, duke “tregtuar” avantazhet e borxhit (përfitimi nga zbritja e interesave të borxhit para tatimit) kundër disavantazheve të tij (mundësisë së falimentimit nga rritja e nivelit të borxhit).

- Teoria e kostove të agjencisë propozon se struktura e kapitalit ndikohet nga drejtuesit e firmës, sepse ata mund të përpiqen që të sigurojnë përfitime personale, në vend që të përpiqen për të maksimizuar vlerën e aksionerëve.

- Teoria e asimetrisë së informacionit mbështetet në idenë se, meqenëse menaxherët brenda firmës zotërojnë më shumë informacion mbi të ardhmen e firmës, vendimet e tyre mbi strukturën financiare mund të shërbejnë si informacion-sinjal për tregun.

- Teoria e rendit të zgjedhjes argumenton se firmat duhet të ndjekin një hierarki financimi: fondet e brendshme janë të preferuara mbi financimin e jashtëm.

- Teoria e kohës së tregut pohon se firmat i kushtojnë vëmendje kushteve të tregut në përpjekje për të “kohëzuar” tregun. Pra firmat zgjedhin mënyrën e financimit (borxh ose kapital neto), i cili në momentin kur ka nevojë firma, është më i vlerësuar nga tregjet financiare.

- Teoria e ciklit të jetës mbështet idenë se struktura e kapitalit të firmës varet nga faza e jetës në të cilën gjendet firma.

- Teoria përcakton gjithashtu se struktura e kapitalit ndikohet edhe nga industria në të cilën bën pjesë firma.

Gjithashtu ky studim ofron një përmbledhje të literaturës mbi faktorët që ndikojnë në vendimet e strukturës së kapitalit, duke përfshirë faktorët specifikë të firmës (përfitueshmërinë, strukturën e aktiveve, likuiditetin, madhësinë e firmës, rrezikun e firmës, fleksibilitetin financiar dhe përfitimin tatimor nga shpenzimet joborxh) si dhe faktorët makroekonomikë (normën e rritjes së GDP-së, normën e inflacionit dhe normën e interesit).

Përcaktuesit e strukturës së kapitalit dhe modelet e tij janë testuar më parë nga studiues të shumtë, sidomos për kompanitë e listuara të vendeve të zhvilluara. Megjithatë nuk ka pasur shumë studime të realizuara më parë për të provuar modelet teorike dhe përcaktuesit e strukturës së kapitalit, në vendet në zhvillim dhe, veçanërisht në Shqipëri, duke përdorur si kampion ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Tabela 1. Përmbledhje e disa prej studimeve mbi strukturën e kapitalit

Autorët	Sogorb-Mira dhe Lopez-Gracia (2003)	Daskalakis dhe Psillaki (2006)	Psillaki and Daskalakis (2008)	Degryse et al. (2009)	Paydar dhe Bardai (2012)
---------	--	-----------------------------------	-----------------------------------	-----------------------	--------------------------

Vendi	Spanjë	Greqi, Francë	Greqi, Francë, Itali, Portugali	Hollandë	Malajzi
Firmat e studiuar	SME	SME	SME	SME	Firma të listuara
Periudha e studimit	1994-1998	1997-2002	1998-2002	2003-2005	2004-2010
Variabli i varur	DAGJ	DAT	DAT	DAGJ	DAT
Trupëzimi	(+) <sup>***</sup>	(-) <sup>***</sup>	(-) <sup>***</sup>	(+) <sup>***</sup>	(+) <sup>*</sup>
Përfitueshmëria	(-) <sup>***</sup>	(-) <sup>***</sup>	(-) <sup>***</sup>	(-) <sup>***</sup>	(-) <sup>**</sup>
Madhësia	(+) <sup>***</sup>	(+) <sup>***</sup>	(+) <sup>**</sup>	(+) <sup>***</sup>	(-)
Likuiditeti					(-) <sup>**</sup>
Rreziku					(-)
Rritja	(+) <sup>***</sup>	(+) <sup>***</sup>	(+)	(+) <sup>***</sup>	(+)
Përfitimi tatimor nga shpenzimet joborxh	(-) <sup>***</sup>			(+) <sup>***</sup>	
Norma e rritjes e GDP-së					(+)

Shënim: Shenja (+) tregon një lidhje pozitive midis variablave dhe shenja (-) tregon një lidhje negative midis tyre. Ndërsa ‘\*’, ‘\*\*’ dhe ‘\*\*\*’ tregojnë përkatësisht 10% nivel rëndësie, 5% nivel rëndësie dhe 1% nivel rëndësie.

Burimi: Bell dhe Vos (2009), f. 7-8 si dhe shqyrtimi i literaturës nga autori.

Tabela 1 pasqyron lidhjen e gjetur midis variablave të përzgjedhura dhe levës financiare, sipas studimeve të Sogorb-Mira dhe Lopez-Gracia (2003), Daskalakis and Psillaki (2006), Psillaki and Daskalakis (2008), Degryse et al. (2009) dhe Paydar and Bardai (2012).

### Metodologjia

Për të testuar nëse faktorët që ndikojnë në përcaktimin e strukturës së kapitalit varen nga madhësia e aktivitetit të firmave, në këtë studim është bërë një riklasifikim i firmave në tre grupe: të mëdha, të mesme dhe të vogla. Për të bërë këtë klasifikim jemi bazuar

në Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 mbi “Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (referuar Kreut 4, Nenit 41 mbi personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare, pika c (i dhe ii). Kështu në grupin e parë janë përfshirë të tëra ato firma, të cilat për të katërta vitet e studimit plotësojnë dy kushte: totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël arrin ose tejkalon shumën prej 40 milion lekësh dhe shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose tejkalon shumën prej 30 milion Lek. Në grupin e dytë janë përfshirë firmat, të cilat shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) për çdo vit të studimit e kanë më të madhe se 8 milion lekë por më të vogël se 40 milion Lek ose të cilat nuk plotësojnë kushtin e parë mbi totalin e aktiveve të cilësuar më lart. Në grupin e tretë janë përfshirë të tëra firmat, të cilat e kanë xhiron vjetore më të vogël se 8 milion Lek, të cilat nuk e plotësojnë të dy kushtet e ligjit si dhe kanë xhiro më të ulët se 8 milionë Lek në të katërta vitët e studimit.

Tabela 2. Grupimi i firmave në të mëdha, të mesme dhe të vogla

Grupi	Numri i firmave	Numri i viteve	Numri i vrojttimeve
I madh	21	4	84
I mesëm	36	4	144
I vogël	12	4	48
Totali	69	4	276

Tabela 2 paraqet rigrupimin e firmave në të mëdha (21 firma), të mesme (36 firma) dhe të vogla (12 fima). Shohim që pjesa më e madhe i përkasin grupit të dytë duke vijuar me ato të grupit të tretë dhe të parë. Matja e variablave paraqitet si më poshtë:

Variabël i varur:

DAT = Borxhi total ndaj totalit të aktiveve.

Variablat e pavarura:

ROA = Kthimi nga aktivet.

ROE = Kthimi nga kapitali.

TRUP = Aktivet fikse ndaj totalit të aktiveve.

LIK = Aktivet korente ndaj detyrimeve korente.

MADH = Logaritmi natyror i totalit të aktiveve.

RISK = Devijimi standard i EBIT-it ndaj vlerës mesatare të EBIT-it.

FLEKS = Mjetet monetare ndaj aktiveve korente.

PTSHA = Shpenzimet e amortizimit ndaj totalit të aktiveve.

Tabelat e mëposhtme paraqesin statistikat përshkruese të variablave të marra në shqyrtim:

Tabela 3. Statistikat përshkruese, duke përdorur vrojtimit 01:01-21:4, për grupin e firmave të mëdha (Grupi I)

Variabli	Mesatarja	Moda	Minimumi	Maksimumi	Devijimi standart	Koeficienti i variacionit
----------	-----------	------	----------	-----------	-------------------	---------------------------

DAT	0.6587	0.6678	0.0317	1.3588	0.2462	0.3737
ROA	0.0735	0.0591	-0.0751	0.2994	0.0701	0.9537
ROE	0.2396	0.2138	-0.2996	1.0213	0.2173	0.9068
TRUP	0.2580	0.1975	0.0000	0.8944	0.2459	0.9533
LIK	6.7046	1.5666	0.6020	73.2199	14.3569	2.1414
MADH	19.0444	18.7848	17.4551	20.9756	0.9164	0.0481
RISK	0.3570	0.3600	-0.9401	1.3744	0.4468	1.2516
FLEKS	0.1645	0.0373	0.0000004	0.9239	0.2456	1.4927
PTSHA	0.0270	0.0133	0.0000	0.3663	0.0450	1.6676

Tabela 4. Statistikat përshkruese, duke përdorur vrojtimit 01:01-36:4, për grupin e firmave të mesme (Grupi II)

Variabli	Mesatarja	Moda	Minimumi	Maksimumi	Devijimi standart	Koeficienti i variacionit
DAT	0.6086	0.6639	0.0188	1.3209	0.2955	0.4853
ROA	0.0821	0.0568	-0.2132	0.6913	0.1119	1.3628
ROE	0.2537	0.2055	-1.2637	3.3657	0.4050	1.5966
TRUP	0.2441	0.1255	0.0000	0.9256	0.2770	1.1349
LIK	13.2990	2.1851	0.0829	298.601	38.6228	2.9042
MADH	16.9909	16.9154	14.9224	19.3447	0.8279	0.0487
RISK	-0.2499	0.4088	-24.1260	1.6889	4.1005	16.4081
FLEKS	0.2302	0.0824	0.0006	0.9861	0.2725	1.1837
PTSHA	0.01561	0.0031	0.0000	0.3952	0.0376	2.4068

Tabela 5. Statistikat përshkruese, duke përdorur vrojtimit 01:01-12:4, për grupin e firmave të vogla (Grupi III)

Variabli	Mesatarja	Moda	Minimumi	Maksimumi	Dev.stand.	Koef. variac.
DAT	0.5735	0.5840	0.0014	1.4546	0.3213	0.5602
ROA	0.0144	0.0201	-0.2247	0.1949	0.0799	5.5347
ROE	0.0768	0.05890	-1.8212	2.1696	0.4614	6.0058
TRUP	0.3503	0.2188	0.0056	0.9979	0.3147	0.8984
LIK	45.7360	1.6861	0.2709	583.188	145.806	3.1880
MADH	16.5326	16.2110	14.5250	18.9370	1.2397	0.0750
RISK	-6.2616	0.3562	-70.6467	2.9899	19.7964	3.1616
FLEKS	0.2414	0.0740	0.0000	1.0000	0.3229	1.3374
PTSHA	0.0144	0.0000	0.0000	0.1806	0.0336	2.3338

Tabelat 3,4 dhe 5 paraqesin statistikat përshkruese të tre grupeve të firmave. Nga rezultatet shihet qartë se firmat e vogla përdorin më pak borxh (57.35 përqind) sesa firmat e mëdha (65.87 përqind) dhe të mesme (60.86 përqind). Rezultatet tregojnë se treguesit ROA dhe ROE janë të përafërt për firmat e mëdha dhe të mesme por shumë të ndryshme nga ato të firmave të vogla.

Hipotezat e këtij studimi paraqiten si më poshtë:

H1: Përfitueshmëria (ROA, ROE) është e lidhur negativisht me vendimin e strukturës së kapitalit.

H2: Struktura e aktiveve është e lidhur pozitivisht me vendimin e strukturës së kapitalit.

H3: Likuiditeti është e lidhur negativisht me vendimin e strukturës së kapitalit.

H4: Madhësia është e lidhur pozitivisht me vendimin e strukturës së kapitalit.

H5: Risku është i lidhur negativisht me vendimin e strukturës së kapitalit.

H6: Fleksibiliteti është e lidhur negativisht me vendimin e strukturës së kapitalit.

H7: Shpenzimet me natyrë jo borxhi janë të lidhura negativisht me vendimin e strukturës së kapitalit.

### Rezultatet e studimit

Ky studim përdor panel data (Gujarati, 2004) si dhe programin statistikor Gretl (2012). Tabelat e mëposhtme paraqesin përmbledhje të rezultateve të regresioneve:

Tabela 6. Përmbledhje e rezultateve të regresionit të raportit të borxhit afatshkurtër (DASH), afatgjatë (DAGJ) dhe totalit të borxhit (DAT) për grupin e firmave të mëdha

Variablat	Modeli 1 (Firmat e mëdha)	Modeli 2 (Firmat e mesme)	Modeli 3 (Firmat e vogla)
E pavarura	DAT	DAT	DAT
Kostantja	-0.2904	0.7019*	0.6917*
ROA	-2.409***	-1.533***	-1.376***
ROE	0.8312***	0.2048***	0.2482***
TRUP	0.0053	0.1124	0.1888*
LIK	0.0010	-0.00007	-0.00004
MADH	0.0524***	-0.0003	-0.0022
RISK	-0.086***	0.0049	0.0082***
FLEKS	-0.239***	-0.1098	-0.313***
PTSHA	-0.0363	-0.0545	-2.995***
R-katror	0.8694	0.4974	0.7064
R-katror i korrektuar	0.8554	0.4676	0.6462
F(8, 75)	62.3937	16.7016	11.7302
P-vlera (F)	4.85e-30	4.88e-17	2.59e-08

Shënim: \* $p < 0.1$  (10% nivel rëndësie), \*\*  $p < 0.05$  (5% nivel rëndësie), \*\*\*  $p < 0.001$  (1% nivel rëndësie).

Tabela 6 paraqet rezultatet e regresionit të ndikimit të variablave të pavarura mbi raportin e borxhit total të firmave të mëdha, të mesme dhe të vogla. Vlera e R-katrorit prej 0.8694 në Modelin 1, tregon se afërsisht 86.94 përqind e ndryshueshmërisë së raportit të totalit të borxhit të firmave të mëdha, shpjegohet nga faktorët specifikët të firmave. Vlera e R-katrorit prej 0.4974 në Modelin 2, tregon se afërsisht 49.74 përqind e ndryshueshmërisë së raportit të totalit të borxhit të firmave të mesme, shpjegohet nga faktorët specifikë të firmave. Vlera e R-katrorit prej 0.7064 në Modelin 3, tregon se afërsisht 70.64 përqind

e ndryshueshmërisë së raportit të totalit të borxhit të firmave të vogla, shpjegohet nga faktorët specifikët të firmave. Përfundimet duke u bazuar në rezultatet e regresionit të tre grupeve të firmave janë si më poshtë:

#### *Grupi i parë-firmat e mëdha*

- Faktorët të cilët janë statistikisht të rëndësishëm në përcaktimin e raportit të totalit të borxhit janë: ROA, ROE, TRUP, RISK, FLEKS dhe PTSHA.

#### *Grupi i dytë-firmat e mesme*

- Faktorët të cilët janë statistikisht të rëndësishëm në përcaktimin e raportit të totalit të borxhit janë: ROA dhe ROE.

#### *Grupi i tretë-firmat e vogla*

- Faktorët të cilët janë statistikisht të rëndësishëm në përcaktimin e raportit të totalit të borxhit janë: ROA, ROE, TRUP, RISK, FLEKS dhe PTSHA.

### **Konkluzione**

Struktura e kapitalit ka qenë dhe është subjekt debati i shumë studimeve, duke filluar nga artikulli i Modiglianit dhe Millerit (1958) e duke vijuar me autorë të tjerë. Leva financiare e firmave si dhe vendimi i përzgjedhjes së mënyrës së financimit e tyre është analizuar në vende të ndryshme si dhe duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme. Ky studim shqyrton kryesisht faktorët specifikë të firmës, të cilat ndikojnë në vendimin e strukturës së kapitalit të firmave të palistuara në Shqipëri. Konkluzionet e këtij punimi janë si më poshtë:

1. Koeficienti i kthimit nga aktivet (ROA) rezultoi negativ dhe statistikisht i rëndësishëm në të tëra grupet e firmave të shqyrtuara. Kjo tregon se nëse përfitueshmëria e matur përmes ROA-së rritet atëherë leva financiare do të ulët. Gjithashtu u konstatua se koeficienti i ROA-së me DAT-në është më i madh (afërsisht -2.4) tek firmat e mëdha, krahasuar me firmat e mesme (afërsisht -1.5) dhe ato të vogla (afërsisht 1.37). Pra një rritje e ROA-së ndikon më shumë në uljen e borxhit të firmave të mëdha sesa të firmave të tjera, pasi ato kanë një përfitueshmëri më të lartë dhe nuk kërkojnë të rrisin nivelin e borxhit.
2. Koeficienti i kthimit nga aktivet (ROE) rezultoi pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm në të tëra grupet e firmave të shqyrtuara. Koeficienti i ROE-së me DAT-në është përsëri më i madh (afërsisht 0.8) tek firmat e mëdha, krahasuar me firmat e mesme (afërsisht 0.2) dhe ato të vogla (afërsisht 0.24). Pra një rritje e ROE-së ndikon më shumë në rritjen e borxhit të firmave të mëdha sesa të firmave të tjera. Në fakt ROE-ja tregon përfitueshmërinë e pronarëve të firmës, duke mos mbajtur parasysh tërë palët që kanë interesa mbi firmën si psh. kreditorët. Kështu në mungesë fondesh firmat me kthim nga kapitali të lartë do të rrisin borxhin, së pari sepse firmat në Shqipëri nuk mund të emetojnë aksione dhe së dyti pasi kostoja e borxhit është relativisht më e ulët sesa kostoja e kapitalit të vet.
3. Lidhja midis trupëzimit dhe DAT-së është pozitive për të tri grupet e firmave, por e rëndësishme vetëm për firmat e vogla (10 përqind nivel rëndësie).
4. Koeficienti i likuiditetit të firmave rezultoi statistikisht i parëndësishëm për raportin e totalit të borxhit (DAT) për të tri grupet e firmave.
5. Koeficienti i madhësisë së firmave rezultoi pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm për

DAT-në tek firmat e mëdha dhe statistikisht i parëndësishëm vetëm për firmat e tjera. Kjo tregon se madhësia e firmave, e matur përmes logaritmit natyror të totalit të aktiveve, do të ndikojë në rritjen e financimit afatgjatë të firmave të mëdha. Ashtu siç është argumentuar dhe më parë firmat e mëdha kanë potencial si dhe “emrin e mirë” për të marrë financim afatgjatë pasi janë në gjendje që ta shlyejnë atë.

6. Koeficienti i rrezikut të firmës rezultoi statistikisht i rëndësishëm dhe negativ për DAT-në tek firmat e mëdha. Gjithashtu ky koeficient u gjet statistikisht i rëndësishëm dhe pozitiv tek firmat e vogla, por i parëndësishëm tek firmat e mesme.

7. Koeficienti i fleksibilitetit financiar rezultoi negativ dhe statistikisht i rëndësishëm për firmat e mëdha dhe të vogla.

8. Koeficienti i përfitimit tatimor nga shpenzimet joborxh rezultoi statistikisht i rëndësishëm për firmat e vogla. Kështu një rritje e amortizimit ndaj totalit të aktiveve do të çojë në uljen e detyrimeve afatgjata të firmave të vogla, pasi ato zotërojnë më pak aktive dhe rritja e këtij raporti i bën më të ndjeshëm në reduktimin e financimit total.

## Referenca

- Daskalakis, N., & Psillaki, M. (2006). The Determinants of Capital Structure of the SME's: Evidence from the Greek and the French Firms. W P, [Online]: [www.univ-orleans.fr/deg/GDRecomofi/Activ/psillaki\\_strasbg05.pdf](http://www.univ-orleans.fr/deg/GDRecomofi/Activ/psillaki_strasbg05.pdf).
- Degrype, H., Goeij, P., & Kappert, P. (2009). The Impact of Firm and Industry Characteristics on Small Firms' Capital Structure: Evidence from Dutch Panel Data. European Banking Center Discussion, W P (No) 2009-03. [Online]: [arno.uvt.nl/show.cgi?fid=94982](http://arno.uvt.nl/show.cgi?fid=94982).
- Gujarati, N. (2004). Basic Econometrics. McGraw Hill Companies, New York, 2004.
- Ligji Nr.10091, datë 05.03.2009 mbi “Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, Kreu 4, Neni 41 mbi personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare, pika c (i) dhe c (ii).
- Modigliani, F., & Miller, M. (1958). The Cost of Capital, Corporate Finance and the Theory of Investment. American Economic Review, 1958, Vol (48): 261-297.
- Myers, S. (1984). The Capital Structure Puzzle. Journal of Finance, 1984, Vol (39): 575-592.
- Paydar, M., & Bardai, B. (2012). Leverage Behavior of Malaysian Manufacturing Companies a Case Observation of the Industrial Sector's Companies in Bursa Malaysia. International Research Journal of Finance and Economics, 2012, Vol (90): 54-65.
- Psillaki, M., & Daskalakis, N. (2008). Are the Determinants of Capital Structure Country or Firm Specific? Evidence from SMEs. Small Business Economics, 2008, Vol ( 33(3)):319-333. [Online]:<http://ssrn.com/abstract=1341860>.
- Sogorb-Mira, F., & Lopez-Gracia, J. (2003). Pecking Order Versus Trade-off: An Empirical Approach to the Small and Medium Enterprise Capital Structure. Instituto Valenciano De Investigaciones Económicas, S.A., WP-EC 2003-09. [Online]: [www.ivie.es/downloads/docs/wpasec/wpasec-2003-09.pdf](http://www.ivie.es/downloads/docs/wpasec/wpasec-2003-09.pdf).

## The Correlation Between Students' Success and Students' Age

**Besarta Zhaku-Kondri, PhD Candidate**

*Primary school Nuri Mazari-Dollogozha, Struga, Macedonia*

### Abstract

Education is a huge process, which is created as a whole based on the harmony of the parts. It consists of different parts. Assessment is an important part of the process of teaching and learning. Grades are used as an evidence to show students work done every day at school to achieve success. But not all the students achieve the same success. It depends on different factors. This study will deal just with one of the factors that could affect the students' success. Students' age is the factor that will be discussed in this study. The aim of this study is to test if there is a correlation between students' success and their age. Moreover, to see what kind of correlation exists between the two variables, students' success and their age. To achieve this aim a study will take place in the primary school, Nuri Mazari, Dollogozhda, Struga. In the study will participate 115 students. All the participants are Albanian students who study English as a foreign language. English is one of their school subjects. Students' final grades in English language will be taken into consideration as data for this study. Students' success will be compared with their age. They are not the same grade; they are sixth, seventh, eighth and ninth grade students.

**Keywords:** *Students' Success, Students' Age, English Language, Primary School.*

### Introduction

Students' success is an important part of teaching and learning process. The main objective of school authorities is to organize everything as good as possible to ensure students' success. There are a lot of factors that could affect the students' success. Internal and external factors indicate students' success. Students' age could be one of those factors. The existence of a possible correlation between students' success and their age is the main aim of this study.

### Literature Review

Assessment is an important part of teaching and learning process. Grades that teachers give to their students are evidence about their work that students do everyday during the lessons. Moreover, they show their success at school. The control of students' knowledge has always been a part of the educational process in schools from antiquity to nowadays schools (Kraja, 2006, p. 316). Students' success is an important factor in student life. Besides the effect that it has in school work, it also affects the student life after school. Moreover, success helps students have strong self-esteem, as he says "success can lead to greater confidence in academic and social situations, instead of embarrassment" (Jensen, 2003, p. 3). According to Weeden, Winter, & Broadfoot (2002) "Pupils identified three reasons for success in school – effort, ability and opportunity to learn" p. 51. However, (Seidman, 2012) says that "If a student's background, both academic and social, and a college's characteristics, are similar, there is a likelihood of student success" p. 268. Furthermore, Simpson (2012) says that "there are many things that can increase student



success in all kinds of learning, but in trying to do everything there is no way of prioritizing activities, and finding what works most cost effectively in a situation where funding is always limited” p.106.

### The Aim of the Study

The main aim of the study is to test whether there exist a correlation between students’ success and their age. Moreover, this study aims to see if the correlation between the two variables, students’ success and students’ age is positive, so as the students’ success increases, the students’ age increases, as well, or it is a negative correlation, so as students’ success increases, the students age decrease. Furthermore, it aims to show whether the correlation between the is statistically significant or not.

### Research Questions

There are a lot of factors that could affect the students’ success; students’ age is one of them. The research questions that arise here are given bellow.

If there exists a correlation between students’ success and their age?

Rather the correlation between students’ success and their age is positive or negative?

If the correlation between students’ success and their age is statistically significant?

### Participants

In this study participated 115 primary school students. They all are Albanian students who study English as a foreign language. The study took place in the primary school, school Nuri Mazari, Dollogozhda, Struga. The participants were not the same age. In the study participated sixth grade students, seventh grade students, eight grade students and nine grade students. Since the classes are based on their age, the students were not divided into groups for this study.

### Results

The computerical program, SPSS was used to show the results of the data gathered for this study. The results of the data are given with numbers and percentages in the tables; to show the results visually, there are given charts, too.

*Students’ Success*

		<i>Frequency</i>	<i>Percent</i>	<i>Valid Percent</i>	<i>Cumulative Percent</i>
Valid	Not satisfied	19	16.5	16.5	16.5
	Satisfied	41	35.7	35.7	52.2
	Good	17	14.8	14.8	67.0
	Very good	17	14.8	14.8	81.7
	Excellent	21	18.3	18.3	100.0
	Total	115	100.0	100.0	

Table #1 descriptive statistics about the frequency of the Students’s Success

The figure above shows that in the study participated 115 students in total. 19 students or 16.5 % of them were students who have got the lowest grade. *Not satisfied* was the success of the biggest group of the participants. In this group, there were 41 students or 35.7% of the total number. The success of 17 students or 14.8% of the participants was *good*. There were also 17 other students or 14.8 % of participants whose success was *very good*. 21 students or 18.3% has got the highest grades. The chart below shows the same results visually.




Figure #1 The chart about Students' Success

Students's Age

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
10 years old	2	1.7	1.7	1.7
11 years old	12	10.4	10.4	12.2
12 years old	36	31.3	31.3	43.5
Valid 13 years old	31	27.0	27.0	70.4
14 years old	28	24.3	24.3	94.8
15 years old	6	5.2	5.2	100.0
Total	115	100.0	100.0	

Table # 2 descriptive statistics about the frequency of the Students's Age

The table above shows that in the study participated 115 students in total. 2 students or 1.7% of the participants were 10 years old. 12 students or 10.4 % of the participants were 11 years old. 36 students or 31.3 % of the participants were 12 years old. 31 students or 27.0 % of the participants were 13years old. 28 students or 24.3% of the participants were 14 years old. 6 students or 5.2 % of the participants were 15 years old. The chart below shows the same results visually.




Figure # 2 The chart about Students' Age

### Analysis

The data gathered for this study were analyzed with the computerical program SPSS. Below are given the results of the Pearson correlation and the regression with the data used for this study

#### Pearson correlation

Pearson correlation was used to show the correlation between the two variables, students' success and students' age. Whether the younger students are, the higher their success or the opposite.

The null hypothesis, Ho: there is no statistically significant correlation between students' success and students' age.

The alternative hypothesis that arise as a result of the null hypothesis is Ha: there is a statistically significant correlation between students' success and students' age. The hypothesis is a two tailed hypothesis that goes both ways.

#### Correlations

		Students' Success	Students's Age
Students' Success	Pearson Correlation	1	.076
	Sig. (2-tailed)		.422
	N	115	115
Students's Age	Pearson Correlation	.076	1
	Sig. (2-tailed)	.422	
	N	115	115

Table 3 Pearsons' correlation to show the correlation between the Students' Success and Students' Age

The table above shows how students' success and their age are correlated to each other.

The correlation coefficient gives the direction of the correlation. In this case, it is a positive correlation because the correlation coefficient is positive, it is 0.07. So as students' age increases the students' success increases, too. Moreover the correlation coefficient shows also the strength of the correlation. In this case it is a weak correlation because it is closer to zero. The graph below shows the same data visually.

The table shows also the p-value that is  $p=0.42$

If  $p > 0.05$  the null hypothesis is not rejected, in this case  $0.042 > 0.05$  so we fail to reject the null hypothesis.

Since the null hypothesis is not rejected, it is concluded that the alternative hypothesis is not accepted since there are not enough evidences to say that there is a statistically significant correlation between students' success and students' age.




Figure 3 The graph of the correlation between the two variables, Students' Success and Students Age

The graph above shows the correlation between students' success and students' age. The relationship is not strong because all those these data points are all around, they are not in the same line, which shows a strong correlation. So, virtually this is not a strong correlation, but there is a pattern that goes from down left to up right, which shows that the correlation is positive.

### Regression

Regression was used to show the relationship between the two variables, students' success and students' age. The computerical program SPSS that is used for the regression between the two variables give the four tables that are given bellow.

Ho: there is no supported relationship between students' success and students' age, so  $b=0$

Ha: there is a supported relationship between students' success and students' age, so  $b \neq 0$

#### Variables Entered/Removed<sup>a</sup>

Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
1	Students's Age <sup>b</sup>		.Enter

a. Dependent Variable: Students' Success

b. All requested variables entered.

Table # A regression table variables entered/removed

The table above shows the dependent variable is students' success and the independent variable is the students' age.

*Model Summary*

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.076 <sup>a</sup>	.006	-.003	1.37389

a. Predictors: (Constant), Students's Age

Table # The regression Model Summary

The table above shows the R that is 0.07 and the R square that is 0.006 and if it is changed in percentages for 0 % of the participants age is significant for their success. The students' success is explained by other factors so age does not really matters.

*ANOVA<sup>a</sup>*

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
	Regression	1.226	1	1.226	.650	.422 <sup>b</sup>
1	Residual	213.295	113	1.888		
	Total	214.522	114			

a. Dependent Variable: Students' Success

b. Predictors: (Constant), Students's Age

Table # Regression- ANOVA

The table above shows the p-value, p=0. 42

If  $p > 0.05$  the null hypothesis is not rejected, in this case  $p > 0.05$ ,  $0.42 > 0.05$  the null hypothesis is accepted so there is no supported relationship between students' success and students' age.

*Coefficients<sup>a</sup>*

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	T	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	1.664	1.448		1.149	.253
	Students's Age	.091	.113	.076	.806	.422

a. Dependent Variable: Students' Success

Table # regression coefficients

The table above shows the constant B=1. 66. This tells us that when the age is 0, students' success is 1.66, this does not really make any sense in the real world, but it makes sense in regression because it is the beginning of the analysis when the students age is 0. But, how the studnets'success can be predicted by studnets'age? 0.091 is the slop that shows how students' age affects students' success. For one year increase in age, the students will have 0.09 unites increase in their success.

The table shows also the p-value that is the same as the p-value that is shown in the table about ANOVA test, p=0. 42, so the null hypothesis is accepted.

## Conclusion

Students' success at school can be affected by many factors, but this study deals just with one of those factors. It studies the correlation between students' success and their age. The computerical program SPSS was used to do the statistical analysis of the data gathered for this study. Based on the Pearson correlation that is given above the null hypothesis is accepted so there is not a correlation between students' success and their age. The same results are shown through the use of regression for the same data so the null hypothesis is accepted because there is not enough evidences to show that there exist a statistically significant correlation between students' success and students' age.

## Suggestion and Recommendations

English is just one of the school subject that students study at schools the same method can be used to study the correlation between students' age and students' success by taking in consideration students final grades in other school subjects. So the same methodology can be used to do similar studies in the future. Maybe it could give different results about the correlation between students' age and their success, taking in consideration students final grades of other school subjects. Moreover, a bigger number of participants, or participants from different places could give different results from the results of this study, or maybe they can give similar results shown above.

## Bibliography

- Jensen, E. (2003). *Student Success Secrets*. New York: Barron's Educational Series, Inc.
- Kraja, M. (2006). *Pedagogjia*. Tiranë: Mileniumi i ri .
- Saidman, A. (2012). *College Student Retention: Formula for Student Success*. Maryland: Rowman & Littlefield Publishers, Inc.
13. Simpson, O. (2012). *Supporting Students for Success in Online and Distance Education*. New York, NY: Routledge.
- Weeden, P., Winter, J., & Broadfoot, P. (2002). *Assessment*. London: Routledge Falmer.

## Hasan Prishtina dhe Lidhja e Kombeve (1924-1931)

MA. Kastriot I. Veselaj  
MA. Sabit Muçaj  
Prishtinë

### Abstrakt

Punimi trajton hollësisht kontributin e Hasan Prishtinës, aktivitetet e tij në vazhden e përpjekjeve për sigurimin e të drejtave qytetare e kombëtare të shqiptarëve në Mbretërinë Jugosllave gjatë viteve 1924-1931. Për këtë periudhë ka një lloj heshtje apo ngurrimi për të vështruar shndërrimet e pandërprera të këtij personalitet në raport me rrethanat e krijuara në Kosovë dhe jo vetëm, dhe si e tillë do të mundohemi të kontribuojmë sado pak në “ndriçimin e së vërtetës historike” duke u bazuar në burimet arkivore dhe nga të dhënat të ndryshme për personalitetin e Hasan Prishtinës si dhe për Lidhjen e Kombeve. Po kështu jemi thelluar edhe për përpjekjen e tij për ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare në përgjithësi. Njëri personalitet që me të drejt nga studiuesit e historisë së diplomacisë, konsiderohet si “truri i lëvizjes kombëtare shqiptare dhe figura qendrore e ndërkombëtarizimit të kësaj çështje” padyshim që ishte Hasan Prishtina. Një gjë me rëndësi në këtë periudhë është sigurisht përpjekja ndërkombëtare e Hasan Prishtinës me dërgimin e letrave, peticioneve e memorandumeve të ndryshme, Lidhjes së Kombeve, Organizmave ndërkombëtarë dhe organeve të tjera Evropiane si dhe shkrimet e ndryshme në gazetat e kohës, të gjitha përpjekjet për njohjen e të drejtave politike e shoqërore të minoriteteve për shqiptarët të mbetur jashtë Shtetit Shqiptar nga konferencat Evropiane, etj.

**Fjalët kyçe:** *Hasan Prishtina, Lidhja e Kombeve, çështja shqiptare, ndërkombëtarizimi, Mbretëria Jugosllave.*

### Hyrje

Mbretëria Jugosllave ndoqi një politikë shkombëtarizuese dhe asimiluese dhe jo vetëm, ndaj popullit shqiptar që jetonte në territoret e aneksuara prej saj. Kjo ishte periudha më e ngjeshur për Hasan Prishtinën në përpjekjen për të realizuar të drejtat qytetare dhe kombëtare të shqiptarëve të Kosovës e më gjerë, të drejta këto që premttoheshin nga nënshkruarit e traktatit të Sen-Zhermenit, ku edhe Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene pararendëse e mbretërisë jugosllave ishte nënshkruese e saj.

Hasan Prishtina, ishte një figurë e ndritur me guxim, ide dhe veprimtari të farkuara atdhetarisht duke dhënë një kontribut të çmueshëm për çlirimin kombëtar, por edhe për ndërkombëtarizimin e çështjes kombëtare shqiptare në përgjithësi.

Që në shkurt të vitit 1924 Hasan Prishtina, në emrin e Komitetit Shqiptaro-Maqedonas për Maqedoni dhe Kosovë, i dërgoi një letër Lordit Curzon, në mes të cilave theksonte se: “një milionë shqiptarë në Jugosllavi po keqtrajtoheshin në çdo drejtim, po grabiteshin, shumë ishin të vrarë, atyre po u krijoheshin vështirësi të shumta në çdo sferë të jetës, me qëllim që të braktisnin tokën e tyre. Populli shqiptar po detyrohej nëpërmjet metodave të një terrorizmi gjakatar të largohet nga vatrata e të parëve të tij. Ai i kërkonte qeverisë britanike që të mbronte jetën dhe ekzistencën e kërcënuar të një milionë shqiptarëve në Jugosllavi nga tirania serbe” (Meta, 2012, 14). Në fund të vitit 1924 edhe Bedri Pejani, i deklaroi përfaqësuesit britanik, Selby se represioni kundër shqiptarëve ishte rritur dhe

qeveria jugosllave po e vononte përgjigjen e saj për Këshillin e Lidhjes së Kombeve, me qëllim që Këshilli të mos mund ta shqyrtonte çështjen në takimin e tij të dhjetorit. Bedri Pejani gjithashtu, nënvizonte se “rezultati i kësaj vonesë do të ishte shkatërrimtar”. Ai tha se “ai dhe bashkëpatriotët e tij kishin më se tre vjet që po përpqeshin në Konferencën e Paqes dhe pranë Lidhjes së Kombeve për njohjen e të drejtave të minoriteteve për shqiptarët, por deri në këtë kohë, përpjekjet e tyre nuk kishin pasur sukses.” Sipas tij, “populli shqiptar gjendej në dëshpërim pasi që regjimi Pashiqit po përdor metodat më brutale kundër tyre” (Pirraku, 2013, 253). Ai paralajmëroi se, “nëse Lidhja e Kombeve dhe qeveria britanike nuk merrnin masat e duhur për të mbrojtur shqiptarët, qeveria e Beogradit do të përfitonte nga shtyrja e shqyrtimit të kësaj çështje në takimin e ardhshëm të Këshillit në muajin mars, për t’i dëbuar shqiptarët nga trojet e tyre, duke e vënë kështu Lidhjen e Kombeve para faktit të kryer” (Pirraku, 2013, 254).

Më 26 shtator 1924, Hasan Prishtina, Bajram Curri dhe Bedri Pejani ia dërgojnë Lidhjes së Kombeve në Gjenevë një memorandum, ku protestojnë me fakte për dhunën serbe kundër shqiptarëve (Shala, 2014, 186). Në të theksohet se, “që në ditët e para të rivendosjes së sundimit serb në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi (15-30 tetor 1918) komitetet tona i janë drejtuar Konferencës së Paqes, asaj të Ambasadorëve, Lidhjes së Kombeve dhe opinionit publik të botës së qytetëruar për të protestuar kundër këtij regjimi dhe kundër faktorit që shteti serbo-kroato-sloven jo vetëm nuk ka dashur të respektojë të drejtat e minoriteteve, por ka arritur deri aty sa t’u mohojë shqiptarëve të drejtat për të jetuar” (Dokumente, 1987, 121). Të gjitha këto veprime ishin në kundërshtim të plotë me traktatin e Sen-Zhermenit, të 10 shtatorit 1919, midis Fuqive Aleate dhe mbretërisë Serbo-Kroate-Slovene. Këshilli i Lidhjes së Kombeve nuk mori asnjë masë në sesionin e dhjetorit por vetëm njoftoi anëtarët e tij rreth memorandumit të adresuar në Këshillin e tyre nga personat e lartpërmendur.

Veprimtari e Hasan Prishtinës dhe përpjekja e tij në të mirë të zgjidhjes së çështjes së Kosovës, por edhe të ndryshimit të regjimit politik në Shqipëri shënohet me paraqitjen e një proteste të re në Lidhjen e Kombeve nga vet dora e Hasan Prishtinës, i cili më 15 mars 1927 i drejtoi një protestë sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve sër Erik Drummond, për gjendjen në Kosovë, ku i vinte në pah se “Gjendja e dëshpëruar shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi më shtrëngon t’i drejtohem sërish Lidhjes së Kombeve me lutjen që të merren masa të tjera për të ndihmuar një popull të shtypur e të torturuar” (Dokumente, 1978, 166-167). Hasan Prishtina në këtë protestë koncize të formuluar me 3 pika nënvizonte së Lidhjes së Kombeve shumë herë i ishin bërë të ditura fakte që provonin gjendjen e dëshpëruar të shqiptarëve atje, megjithatë, asgjë nuk kishte ndryshuar, dhe se afro 1 milion shqiptarë që jetonin në Kosovë e Maqedoni, jo vetëm që u ndalua arsimit kombëtarë, por qeveria po përdorë “të gjitha mënyrat e mundshme për t’i shfarosur”, duke i vrarë e plaçkitur, duke i tatuar rëndë, duke “konfiskuar” pasurinë pa kompensim, për t’ua dhënë kolonëve serbë e malazezë, si dhe duke i detyruar të shpërngulen në masë të madhe.

Hasan Prishtina i kërkon Lidhjes së Kombeve që ajo të dërgonte një komision në Jugosllavi që “të shqyrtojë në vend gjendjen e pakicës shqiptare atje” (AQSH i RSH, Fondi. 263, dos. 163, f. 1-2. \*Protestë e Hasan Prishtinës, Vejnë, data 15 mars 1927, dërguar sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve sër Erik Drummond\*), por kjo kërkesë nuk do të plotësohej. Shkak kryesor ishte se “Lidhja e Kombeve ishte nën ndikimin e Fuqive që kishin krijuar Jugosllavinë dhe nuk i shihte me simpati kërkesat e shqiptarëve. Përfaqësuesi i qeverisë jugosllave kishte miqësi me sekretarin e Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, sër Erik Drummondin, dhe prej tij, qysh më herët, kishte marrë garanci se pas peticionit



të Hasan Prishtinës “*nuk do të merrej kurrfarë hapi*”. Mirëpo, Erik Drummond, më 15 prill 1927 e informoi Hasan Prishtinën se memorandum i tij “nuk mund të merrej në shqyrtim, nga shkaku se pohimet ishin me karakter shumë të përgjithshëm” (Meta, 2012, 15).

Këto përgjigje të Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve dërguar Hasan Prishtinës si përfaqësues i Komitetit të Kosovës, nuk i pëlqyen përfaqësuesit të qeverisë Jugosllave në LK, andaj ky përfaqësues u ankua tek drejtori i Sektorit për Minoritete, Kolban, i cili nuk i kushtoi asnjë rëndësi memorandumit të Hasan Prishtinës, dhe përgjigjen e Sekretarit të Përgjithshëm e quajti “si një formalitet më të zakonshëm, pa kurrfarë vlere” (Verli, 2012, 357). Në të vërtetë, përfaqësuesi i mbretërisë jugosllave në Lidhjen e Kombeve i vuri në dije Kolbanit se një formaliteti i tillë mund të mos ketë rëndësi për njerëzit serioze, mirëpo, për ata “*të tipit siç është Hasan Prishtina, ajo do të thotë shumë*” (Meta, 2012 17), posaçërisht kur është e nënshkruar nga vet dora e Sekretarit të Përgjithshëm së Lidhjes së Kombeve.

Në këto rrethana, Kolbani e quajti gabim nënshkrimin e Sekretarit të Përgjithshëm të LK dhe për përgjigjen që ai dha Hasan Prishtinës, në lidhje me memorandumin e datës 15 mars 1927, në të cilin theksohet se përgjigja duhej të ishte nënshkruar nga zëvendësi i Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve. Po në këto rrethana Hasan Prishtina duke parë neglizhencën e Lidhjes së Kombeve, për të marrë në shqyrtim protestën (memorandumin) e tij, vendosi që të dërgonte një peticion-memorandum të ri të detajuar e të plotësuar me fakte, si plotësim të protestës së 15 marsit, si dhe duke marrë kontakte të shumta, ndër të tjerash edhe me nënsekretarin e Lidhjes së Kombeve, Grandi, dhe me shumë burra shtetesh e delegatë të shteteve të ndryshme në Lidhjen e Kombeve (Pirraku, 2013, 276. \**Sipas dokumentacionit jugosllav të kohën, të cituar në këtë vepër, Hasan Prishtina me përkrahjen e Iljaz bej Vrionit dhe Xhemail Dinos, delegatëve të Shqipërisë, arriti të merrte pjesë në mbledhjet e Lidhjes së Kombeve*\*).

Siç dëshmohej me të dhëna arkivore nga historianët e publicistët e ndryshëm, qeveria jugosllave bëri ç’ ishte e mundur ta pengonte Hasan Prishtinën, dhe tentuan ta blinin apo edhe ta kompromentonin para qarqeve patriotike shqiptare dhe opinionit demokratik botëror. Gjithashtu qeveria jugosllave arriti ta sabotonte diskutimin e memorandumit të vitit 1927 në LK. Mirëpo, meqenëse Hasan Prishtina nuk ishte tërhequr, Këshilli i Lidhjes së Kombeve do të detyrohej të merrte në shqyrtim memorandumin e datës 15 mars 1927, i cili ishte plotësuar dhe ishte detajuar në gusht të po të njëjtit vit. Këtë tekst të këtij memorandumit të gushtit, qeveria jugosllave e kishte njohur të paktën para datës 31 gusht 1927 (Haxhiu, 1968, 218), dhe i kishte vënë vetes për detyrë t’i kundërshtonte pohimet e Hasan Prishtinës para Këshillit të Lidhjes së Kombeve.

Hasan Prishtina në krye të Komitetit të Kosovës, sikurse konstatohet nga një intervistë e dhënë për gazetën “Neues Vienes Tagblatt”, disa javë pas protestës së lartpërmendur, dhe gjithashtu edhe në fletoren italiane “Giornale d’Italia”, dhe jo vetëm në këto dyja por edhe në të tjera, duke u përpjekur që përmes medias të ndikonte edhe mbi opinionin publik për gjendjen e popullit shqiptar në Mbretërinë Jugosllave, mes të tjera ai konstatonte, se “... Mua nuk më shkon mendja që të shkoj në Jugosllavi, unë do të mbetem armik derisa ky shtet t’u jep të drejtat e minoritetit miliona shqiptarëve që rrojnë në Kosovë e Maqedoni, të drejta që nuk u janë njohur deri më sot...” (Dokumente, 1978, 167). Dhe sipas tij, “...serbët bënë një gafë të madhe, ata donin të luanin një lojë të madhe por përfundimet qenë negative. Politikanët e Beogradit nuk shohin më larg nga hunda e tyre. Kjo ngjarje i la serbët në Shqipëri pa ndonjë rëndësi dhe bëri të qeshte me ta Ballkani ...” (Dokumente, 1978, 167).

Hasan Prishtina nuk ishte i vetmi përfaqësues i Komiteti të Kosovës që propaganduan për sensibilizimin e faktorit ndërkombëtar ndaj çështjes së Kosovës. Në revistën prestigjioze të kohës “Federata Ballkanike” u botuan shumë intervista me personalitete dhe drejtues të tij, si me Bedri Pejanin, Ibrahim Gjakovën, Qamil Balën, etj, për gjendjen e popullsisë shqiptare në Kosovë dhe jo vetëm, ku evidencuan rrezikun nga Mbretëria Jugosllave në Kosovë dhe nga ajo italiane në Shqipëri dhe bënë thirrje për ndihmë “partizanëve të programit” në luftën për emancipimin e popullit shqiptar, për “çlirimin nga shtypësit e huaj dhe të brendshëm” si dhe për “të realizuar një shqiptari të bashkuar dhe të lirë”, që ishte gjithashtu qëllimi i programit të Komitetit të Kosovës (Haxhiu, 1968, 228).

Pas dy vitesh nga memorandumit i 15 marsit 1927, drejtuar Erik Drymondit, Hasan Prishtina, i tërhoqi përsëri vëmendje Lidhjes së Kombeve. Ku në peticionin e datës 05 prill 1929, ai reagoi sërish edhe këtë herë në mënyrë mjaftë të detajuar, për gjendjen e mjeruar të shqiptarëve në mbretërinë jugosllave, duke theksuar se detyrohej “*të parashtronte edhe njëherë në mënyrë më konkrete, ankesat kundër trajtimit të shqiptarëve në Mbretërinë Serbo-Kroate-Slovene*” (Meta, 2012, 19), duke menduar së në përgjigjen e protestës së mëparshme të Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, sër Erik Drymond, i kishte bërë të ditur se “*karakteri tepër i përgjithshëm i pohimeve që përmbante letra, nuk lejonte që në rastin e saj të përdorej procedura e vendosur nga këshilli për peticionet e pakicave*” (AQSH i RSH, Fondi 251, dos. 559, f. 3-8. \*Peticioni i Hasan Prishtinës, i datës 05 prill 1929, drejtuar në Gjenevë presidentit të Lidhjes së Kombeve për të protestuar për trajtimin e popullit shqiptar në Mbretërinë Jugosllave\*).

Ky memorandum, krahasuar me memorandumit e vitit 1927, ishte i shkruar me një ton më të matur, më pajtues ndaj Lidhjes së Kombeve, ishin dhënë disa detaje për zullumet dhe vrasjet, por ishte edhe më i matur dhe pa fryrje aq të rënda ndaj qeverisë jugosllave. Dhe kështu, në urdhëresën telegrafike të Kumanud-it, ministër pa portofol e përfaqësues i MPJ-së së Jugosllavisë, ku me 24 prill 1929, “për delegacionin e Serbisë në Shoqatën e Popujve”, thuhej: “*Të njoftohet sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, sër Erik Drummond, se nuk mund të pranohet peticioni i Hasan Prishtinës, ngase Hasan Prishtina, për shkak të punës tradhtarë të tij gjatë kohës së okupimit (austro-hungarez), ka qenë i detyruar të lëshojë vendin përnjëherë pas çlirimit. Hasan Prishtina prej atëherë gjatë tërë kohës ka vazhduar punën kundër shtetit tonë dhe ky peticion nuk është asgjë tjetër, por një akt i propagandës dhe i insinuatave kundër vendit tonë*” (AQSH i RSH, Fondi 251, dos. 559, f. 3-8).

Megjithatë, në shtator 1929 Komiteti i të Treve shqyrtoi peticionin e Hasan Prishtinës për persekutimin e popullsisë shqiptare nga qeveria jugosllave. Qeveria jugosllave iu përgjigj Këshillit të Lidhjes së Kombeve se ky peticion ishte i papranueshëm duke u justifikuar se Hasan Prishtina “kishte qenë një revolucionar dhe irredentist i angazhuar në aktivitete subversive kundër Jugosllavisë” (Meta, 2012, 19). Gjithashtu qeveria jugosllave i paraqiti një memorandum Këshillit të LK me datën 21 gusht 1929 në të cilin kundërshtoheshin akuzat e Hasan Prishtinës për shtypjen e minoritetit shqiptar në Jugosllavi dhe deklarohesh se në Jugosllavi “ekzistonte një numër i madh shkollash me klasa të veçanta për fëmijët shqiptarë” (Meta, 2012, 19-20).

Hasan Prishtina edhe njëherë në peticionin e datës 05 prill 1929 kërkonte që Lidhja e Kombeve të dërgonte një komision për të shqyrtuar në vend gjendjen e shqiptarëve që jetonin në Mbretërinë Jugosllave dhe të bënte demarshet e duhura për t’u siguruar dhe garantuar shqiptarëve “të drejtat që u njihen pakicave”. Në mes tjerash aty thuhet, “Pakica shqiptare në shtetin serbo-kroato-sloven është e shtypur. Prova më e dukshme është së

në këtë shtet një milion shqiptarë jetojnë pa pasur asnjë shkollë shqipe. Ky fakt dëshmon më tepër se kushdo që qeveria e shtetit serbo-kroato-sloven është në rrugën e zhdukjes së kombit shqiptar brenda territorit të vet” (AQSH i RSH, Fondi 251, dos. 559, fl. 6). Në kushte kur në Jugosllavi rinia shqiptare nuk mund të arsimohet në gjuhën amtare, asaj i mbeten vetëm dy rrugë: ose të humbasë kombësinë, ose të heqë dorë nga arsimi. Këto dy mundësi janë aq të dhimbshme dhe fatale për të ardhmen e kombit tonë sa indinjon Evropën, në kufijtë e së cilës gjendet kombi ynë” (Pirraku, 2013, 315).

Komiteti i Lidhjes së Kombeve vendosi që në bazë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të qartë të akuzave që ishin bërë në peticionin dhe duke e marrë në konsideratë përgjigjen “e detajuar dhe të kënaqshme” të qeverisë jugosllave si dhe duke pasur parasysh personalitetin dhe qëndrimin e autorit të këtij peticioni, nuk druhej të marrë asnjë vendim lidhur më këtë çështje. Ky Komision i cili ishte caktuar për këtë çështje vuri në dyshim vetëm një çështje, dhe ajo ishte: “Në përgjigjen jugosllave jepeshin statistika mbi numrin e shkollave me “klasa speciale” për fëmijët shqiptarë, por nuk ishte e qartë që këto klase speciale u ofronin plotësisht lehtësitë e përcaktuara nga traktati i minoriteteve (Sen Zhermenit)”, dhe pasi shkroi përfaqësuesi serbo-kroato-sloven, Drejtori i Seksionit për minoritete mori garanci se këto shkolla ishin në përputhje me këto standarde (Meta, 2012, 20).

Edhe pse Delegacioni i qeverisë jugosllave në Lidhjen e Kombeve nuk pranoi asnjë ankesë të Komitetit të Kosovës të shkruar nga Hasan Prishtina, Lidhja e Kombeve ngriti një komision të përbërë nga përfaqësuesit e Britanisë së Madhe, Persisë dhe të Finlandës. Mirëpo nga raporti i këtij komisioni që mban datën 29 dhjetor 1929, shihet se Lidhja e Kombeve “ishte nën kontrollin e Fuqive të Mëdha dhe ndiqte vijën e interesave të tyre politike” (Pirraku, 2013, 317). E gjitha mund të shihet edhe nga përgjigjja që i dërgonte përfaqësuesi i ministrit për Punë të Jashtme të Jugosllavisë, K. Kumanudi, përfaqësuesit të Jugosllavisë në Gjenevë, Ilia Shumenkoviçit, me datën 03 janar 1930, në lidhje me vendimin e komisionit të Lidhjes së Kombeve për shqyrtimin e memorandumit të Hasan Prishtinës. Ku në këto dokumente, ndër tjera, thuhej se interpretimet e mendimit të Komitetit të Treve për shkollat shqiptare në Jugosllavi t’i jepen përgjigje në kuadrin e vërejtjeve të mia me këtë shkresë:

- 1) “Se në viset e Mbretërisë së Jugosllavisë ku jetojnë shqiptarët në një numër të mjaftueshëm për të pasur mundësi që të merren parasysh si pakicë kombëtare, kurrë nuk ka pasur kurrfarë shkollash shqiptare. Përpos një numri të vogël të shkollave serbe, në ato vise përgjithësisht nuk ka pasur kurrfarë shkollash. Në një masë shumë të kufizuar ka ekzistuar njëfarë lloji i mësimit religjioz, të cilin e kanë dhënë vetë hoxhallarët. Ai përbëhej kryesisht nga të mësuarit përmendsh të disa lutjeve në gjuhën arabe”.
- 2) “Se Mbretëria e Jugosllavisë, duke i marrë ato vende nuk ka gjetur asnjë shkollë shqipe, dhe kurrfarë personeli arsimor”.
- 3) Se ato vise deri me inkorporimin e tyre në Mbretërinë e Jugosllavisë, ishin më të prapambetura në Evropë, pa komunikacion, pa siguri publike, pa kurrfarë institucioneve sanitare, kulturore, ekonomike dhe arsimore”.
- 4) Se te popullsia shqiptare e atjeshme nuk ka pasur kurrfarë shprehjeje për shkollim, as aspirata për të, as që ajo popullsi, madje edhe në masën më të vogël, ka parë për të nevojshme shkollimin. Ajo ishte nevojë, aq më pak ngase gjuha shqipe si gjuhë letrare, përgjithësisht askund nuk ka ekzistuar, pse nuk kishte as libra as gazeta në atë gjuhë, dhe nga kjo edhe dobia eventuale nga arsimi në këtë gjuhë do të ishte minimale ose thënë

saktësisht, kurrfarë. Aspirata për shkollë është shfaqur vetëm tek elementi serb, i cili me vuajtje të rënda ka arritur të hapë një numër të vogël të shkollave serbe, të cilat vetë i ka mbajtur” (Pirraku, 2013, 309).

Hasan Prishtina, nuk u pajtua me një përgjigje kaq poshtëruese e armiqësore pa fund kundër ekzistencës kombëtare të popullsisë shqiptare në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Dhe si, ish-kryeministër shqiptar, e si përfaqësues i shqiptarëve që jetonin në territorin e Mbretërisë së Jugosllavisë dhe në emrin e Komitetit të Kosovës, me datë 18 mars 1930 iu drejtua Komitetit për Minoritete të Lidhjes së Kombeve, se “qeveria mbretërore jugosllave ka deklaruar se ankesat tona janë të pabazuara, se shqiptarët në Jugosllavi gëzojnë liri të plotë, kanë shkolla dhe ushtrojnë të drejtat politike. Këto deklaratë nuk i përgjigjen aspak fakteve” (Revista “Shenja”, gusht 2012, Shkup, 30). Mirëpo e vërteta ishte ndryshe se në Jugosllavi nuk kishte asnjë shkollë shqiptare, se elementi shqiptar kudo në vendin e sipërmenduar është i shtypur dhe se shqiptarët janë zhveshur bile edhe nga prona e tyre dhe janë shpërndarë serbëve, malazezëve dhe rusëve. Me 18 mars 1930, njëherit ishte edhe memorandum i treti në radhë brenda 3 vjetësh i Hasan Prishtinës si kryesues i Komitetit të Kosovës, drejtuar Komitetit të Lidhjes së Kombeve për minoritete (AQSH i RSH, Fondi 251, dos. 149, f. 234. \*Memorandum i Hasan Prishtinës, i datës 18 mars 1930, drejtuar Lidhjes së Kombeve). Ku në këtë memorandum adresuar nga Vjena, Komitetit të Lidhjes së Kombeve, i cili vinte pas konkluzioneve të një komisioni, ku nga të dhënat e 29 dhjetorit 1929 dhe pas deklaratave jugosllave se ankesat e shqiptarëve ishin të pabazuara, dhe se Hasan Prishtina duke firmosur si ish-kryeministër, këmbëngulte në vërtetësinë e memorandumeve të dërguar më parë dhe në kërkesën që “një komision hetimor neutral dhe i paanshëm” të dërgohej për të konstatuar gjendjen e vërtetë të shqiptarëve (Pirraku, 2013, 309. \*Toni më i matur i Hasan Prishtinës në dy memorandumet e fundit, të gushtit 1927 (të paraqitur me 05 prill 1929) dhe 18 mars 1930, lidhej me situatën e re ndërkombëtare të krijuar pas miratimit të Traktatit të Parisit të 27 gushtit 1928, nënshkruar nga shtetet anëtare të Lidhjes së Kombeve. Ku sipas këtij Traktati, lufta si mjet për të fituar lirinë dënohej dhe kufijtë shtetërore mund të rishqyrtohen e të ndryshonin vetëm me bisedime bilaterale të palëve në konflikt, prandaj Hasan Prishtina pas kësaj u orientua për të siguruar për çështjen e Kosovës zgjidhje politike në kuadër të veprimtarisë së Lidhjes së Kombeve).

Mirëpo, me keqësimin e situatës deri në nivele të padurueshme për popullin shqiptar në Jugosllavi pas vitit 1929, si rezultat i konjunkturave ndërkombëtare të krijuar nga kriza globale po edhe si rezultat i vendosjes së diktaturës së gjeneralit Zhivkoviç (me miratimin e mbretit Aleksandër Karagjeorgjeviç) dhe nga mungesa e veprimeve efikase të Lidhjes së Kombeve për të ndaluar dhunën mbi shqiptarët e shtuan në kulm aktivitetin e Hasan Prishtinës për të nxitur këtë organizëm ndërkombëtare të vepronte në mënyrë të efektshme. Ku ka mjaft të dhëna që provojnë se Peticioni i njohur i tre klerikëve katolik shqiptarë të arrestuar nga Jugosllavia pas vrasjes së At Shtjefën Gjeçovit, Dom Gjon Bisaku nga Prizreni (famullia e Becit), Dom Shtjefën Kurti nga Prizreni (famullia e Vovosellës) dhe nga Dom Luigj Gashi nga Shkupi (famullia e Smaçit), shtetas jugosllav, misionarë të “Propaganda Fides”, u dorëzua më 5 maj 1939 në Gjenevë Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, Erik Drymondit, i cili ishte projektuar nga Hasan Prishtina (Pirraku, 2013, 323).

Ky dokument me shumë argumente, prej rreth 30 faqesh (ASHK, Fondi: MPJ, dos. Shoqata e Kombeve në Gjenevë, viti 1927-1939), i paraqitur nga personalitete shqiptare të klerit të krishterë, që mbështeste kërkesat dhe ankesat e përsëritura të Komitetit të Kosovës

dhe Hasan Prishtinës, diskreditonte përgjigjet zyrtare të Beogradit drejtuar Lidhjes së Kombeve. Ku ndër tjera, në Peticion, thuhej se “ne, të nënshkruarit, që të tre misionarë të “Propaganda Fide” shtetas të Jugosllavisë me prejardhje shqiptare, kemi nderin në emër të banorëve shqiptarë në Jugosllavi t’ua paraqesim juve këtë peticion, për gjendjen e pakicës dhe lusim hirësinë tuaj t’i njoftoni anëtarët e Lidhjes së Kombeve”(ASHK, Fondi: MPJ, dos. Shoqata e Kombeve në Gjenevë, viti 1927-1939). Ky peticion i nënshkruar nga tre priftërinjë patriotë mbyllej me konstatimin se ata kishin përmendur vetëm një numër të vogël shembujsh e argumentesh “përkrah ekzistimit të mijëra tjerëve”. Megjithatë, Lidhja e Kombeve e injoroi edhe këtë argumentim të plotë të të dhënave të memorandumeve të Hasan Prishtinës.

Pasiviteti i përsëritur i Lidhjes së Kombeve e nxiti Hasan Prishtinën që më 10 janar 1931, nga Konstanca e Rumanisë vetëm 10 muaj pas memorandumit të 18 marsit 1930 dhe 8 muaj pas Peticionit të tre klerikëve t’i dërgonte Lidhjes së Kombeve një protestë të re që ngjan me një përmbledhje të Peticionit në fjalë (Verli, 2012, 361). Ku thelbi i kësaj proteste ishte në fakt ai i të gjitha këtyre të dërguara më parë. Përveç trajtimit të dhunës, terrorit, shpronësimeve dhe përgjithësisht goditjes ekonomike, kolonizimit sllav dhe shpërnguljes, mungesës së shkollave shqipe etj, Hasan Prishtina evidentonte edhe persekutimet që u bëheshin shqiptarëve katolike për shkak të fesë, vrasjen e klerikëve të tyre dhe konfiskimin e pronave të komuniteteve fetare.

Faktet me të cilat mbështetet thirrja ime, sipas Hasan Prishtinës, prej kohe i janë komunikuar hollësisht Lidhjes së Kombeve. Sërish kryesore janë këto që pasojnë:

1. “Pothuaj 1.000.000 shqiptarë që banojnë në Kosovë dhe Maqedoni nuk kanë asnjë të vetme shkollë në gjuhën e tyre amtare. Gjithashtu kanë qenë dhe janë të ndaluar të çelin shkolla me mjetet e veta”.
2. “Qeveria e Mbretërisë Jugosllave përdor gjithë masat e mundshme për t’i shuar shqiptarët e Kosovës e Maqedonisë. Është fakt i vërtetuar se fshatra të tëra janë masakruar. Shqiptarët janë vrarë dhe shtëpitë e tyre janë djegur me urdhrin e autoriteteve eprorë”.
3. “Duke u konfiskuar pa pagesë pronat e bujqve shqiptarë, të cilat u janë ndarë serbëve dhe malazezëve, shqiptarët muhamedanë e katolike janë të detyruar të braktisin atdheun e tyre, tokën e prindërve të tyre, të paguajnë targa shtetërore me 60 përqind më tepër dhe kjo masë përdoret që t’i shkatërrojë ekonomikisht dhe t’i shtrëngojë të emigrojnë”.
4. Qeveria jugosllave persekuton shqiptarë katolikë për shkakun e fesë. I shtrëngon këta shqiptarë të neveritin fenë e tyre dhe kombësinë e tyre. Priftërinjtë e tyre janë vrarë para krahëve gjithë për këtë shkak. Qeveria konfiskon pronat e komuniteteve fetare” (Gazeta “Shqipëria e Re”, Konstancë, më 10 janar 1931).

Duke u mbështetur në nenin 2 të Traktatit për minoritete më tutje, vinte në spikamë se “mënyra si janë trajtuar shqiptarët që jetojnë në brendi të kufijve të Mbretërisë së Jugosllavisë, jo vetëm që është në kundërshtim me çdo fjalë të këtij traktati, por na kujton mënyrën se si kanë qenë trajtuar robërit në mesjetë. Ai e përsëriste kërkesën për hetimin e çështjes në terren nga një “komision i paanshëm” i Lidhjes së Kombeve. (Dokumente, 1978, 188-189).

Për të përfunduar se Hasan Prishtina është një personalitet qendror kombëtar me integritet të pacenueshëm, pasi që me veprimtarin e begatshme politike e diplomatike u bë personaliteti i pavdekshëm, gjë që dëshmon përpjekja e tij për denoncimin e dhunës të ushtuara nga mekanizmat shtetërore Jugosllave nga popullsia civile shqiptare që jetonin në këtë mbretëri. Padyshim, që në këtë aspekt Hasan Prishtina është krenaria më e madhe

kombëtare për mbarë popullin shqiptar.

### **Burime dhe Literatura**

#### ▪ **Arkivat:**

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë - Tiranë (AQSH i RSH).

- Fondi: Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”.
- Fondi: *Hasan Prishtina*.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës – Prishtinë (ASHA të Ks)

- Fondi: *Ministria e Punëve të Jashtme, Njësia Organ: Shoqata e Kombeve në Gjenevë, viti: 1927-1937*.

#### ▪ **Literatura:**

Haxhiu, A. (1964), *Hasan Prishtina dhe lëvizja patriotike e Kosovës*, Tiranë.

Pirra, M. (2013), *Hasan Prishtina (Vlerë Sublime e Kombit)*. Prishtinë.

Shala, Xh. (2014), *Hasan Prishtina Vështrim i shkurtër Atdhetarie*, Prishtinë.

*Hasan Prishtina (Përmbledhje dokumentesh 1908-1934)*. Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, 1978.

Verli, M. & Meta, B. (2012), në: *Veprimtari Atdhetare e Hasan Prishtinës (konferencë shkencore -13-14 tetor 2012)*, vëllimi 4, Shkup.

#### ▪ **Revistat/Gazetat:**

Revista “*Shenja*”, gusht 2012, Shkup, 30.

Gazeta “*Shqipëria e Re*”, Konstancë, më 10 janar 1931.

## **Proçeset e zhvillimit të territorit dhe vlerësimi mjedisor: Rasti i qytetit të Shkodrës**

**Dr. Ervis Krymbi**

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”,  
Fakulteti i Shkencave Shoqërore,  
Departamenti i Gjeografisë

**Dr. Bujar Drishti**

Universiteti Politeknik i Tiranës,  
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit,  
Departamenti i Gjeodezisë

### **Abstrakt**

Artikulli synon të analizojë çështjet e territorit dhe ato mjedisore që qyteti i Shkodrës ka sot, ku shumëllojshmëria e këtyre problemeve lidhen me tranzicionin, mosadministrimin e tërësisë ujore, mungesën e vizionit. Gjatë procesit të tranzicionit nuk i është dhënë shumë rëndësi iniciativave të planifikimit. Në fakt, qyteti i Shkodrës dhe rrethinat e tij u ballafaquan me përvojën e tranzicionit në një mjedis ku nuk udhëhiqnin rregullat dhe udhëzimet. Një pjesë e madhe e popullatës deri në vitet 1990-të, që banonte në zonat malore dhe rurale, i lëshoi këto vendbanime duke u drejtuar drejt qendrave urbane në kërkim të jetës më të mirë, punësimit dhe mundësive për arsimim. Procesi i urbanizimit dinamik dhe pa një strategji të caktuar u shoqërua me një neglizhencë totale ndaj mjedisit. Zona e bregut të liqenit të Shkodrës dhe e bregut të Bunës ka qenë vlerësuar shumë shpesh, si një zonë me vlerë të lartë zhvillimi, por realisht i është nënshtruar zhvillimit spekulativ. Grumbullimi i pakontrolluar i mbeturinave që përbëhen kryesisht prej plastikës dhe mbetjeve të tjera të rrezikshme në sipërfaqe të hapura, por sidomos në brigjet e lumenjve dhe liqenit, gjërmimi i zonave për ndërtime ose ngritja e objekteve pa respektuar peizazhet dhe stabilitetin e tokës, çojnë në përkeqësimin e shpejtuar të aseteve peizazhistike që ka qyteti i Shkodrës dhe rajoni. Të gjitha këto veprime kanë një reaksion zinxhir në gjendjen e përgjithshme të mjedisit në qytetin e Shkodrës dhe në rajon në formën e erozionit të tokës dhe bllokimit të kapacitetit natyror të drenazhit të lumenjve dhe kanaleve, ndotjen e dherave, ujërave të lumenjve e liqenit përfshi këtu dhe akuiferet me efekte negative mbi bio-diversitetet dhe eko-sistemet që varen prej tyre.

**Fjalët kyçe:** *Zhvillimi i territorit, Problemet mjedisore, Mjedis i qëndrueshëm.*

### **Planifikimi i territorit në funksion të manaxhimit mjedisor**

Planifikimi i territorit është një pjesë e rëndësishme e manaxhimit mjedisor. Planifikimi nënkupton “identifikimin e nevojave dhe mënyrat e vlerësimit të tyre”. Ai është procesi i “zbatimit të njohurive në praktikë” ose i zgjidhjeve të problemeve thelbësore (Friedman, 1987, 12). I përshkruar në mënyrë të thjeshtë, planifikimi i territorit përfshin caktimin e objektivave, mbledhjen dhe analizimin e informacionit, si dhe përpilimin dhe vlerësimin e praktikave alternative, projekteve ose projekteve për të përmbushur këto objektiva. Manaxhimi mjedisor zbaton procesin e planifikimit të mbrojtjes mjedisore dhe zgjidhjes së problemeve. Planifikimi dhe manaxhimi mjedisor mund të jetë “reagues”, “monitorues” ose “integruues”. Masat reaguese përpiqen të korrigojnë dëmtimet paraprake mjedisore; për shembull: trajtimin e mbetjeve urbane, pastrimin e zonave ujore të ndotura. Masat monitoruese ndërmerren për të përmirësuar cilësinë mjedisore, për shembull: kontrolli i përdorimit të tokës, ruajtja e tokave nën ujë. Planifikimi mjedisor integruues përfshin

propozime paraprake dhe thelbësore të faktorëve mjedisore dhe sociale në lidhje me hartimin e planeve dhe projekteve të zhvillimit (Randolph, 2010, 38). Dikur mendohej se planifikimi ishte vetëm njohuri. Tashmë kuptohet se planifikimi është mësim. Një revolucion i qetë i planifikimit të territorit dhe manaxhimit mjedisor është në vazhdimësi të zhvillimit të tij. Si reagim ndaj kompleksitetit në rritje të problemeve, konflikteve të stërzgjatura, buxheteve qeveritare të kufizuara dhe lëvizjeve të kohëve të fundit drejt liberalizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pronës, po shfaqen qasja të reja. Ato synojnë të sigurojnë vendime më të dobishme, më efikase dhe më të pranueshme publikisht në fushën e manaxhimit mjedisor. Këto qasje janë etiketuar me emërtime të ndryshme, si p.sh: “mbrojtja e mjedisit civil”, “manaxhimi i integruar i resurseve”, “mbrojtja mjedisore e bazuar në komunitet”, “manaxhimi i ekosistemeve”, “manaxhimi i pellgjeve ujëmbajtës” dhe “marrëveshjet e negociuara” ndër të tjera. Me qëllim përmirësimit të kapacitetit të analizës dhe vlerësimit të mbështetjes mjedisore është e mundur ti referohemi modeleve të administrimit të territorit, të cilat e ndajnë territorin respektivisht me funksionet prodhuese (hapësirat bujqësore), rigjeneruese (hapësirat natyrore), dhe të konsumit (hapësirat urbane e industriale). Në këtë mënyrë është e mundur të maten lidhjet ekzistuese ndërmjet proceseve të ndryshme natyrore dhe antropike (Indovina & Fregolent & Savino, 2005, 133). Planifikimi i territorit në kontekstin e manaxhimit mjedisor nisi nga nevoja për mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi, dhe mbi të gjitha, për një organizim më të mirë të ofrimit dhe manaxhimit të shërbimeve, ku përfshihen furnizimi me ujë, trajtimi i ujërave të ndotura dhe mbetjeve të ngurta urbane në nivel vendor. Megjithatë, kalimi i përgjegjësisë drejt një autoriteti tjetër duhet të marrë parasysh përmasat, natyrën e detyrave dhe kërkesave që lidhen me efektshmërinë dhe ekonominë, si edhe kapacitetet e autoritetit marrës për ta përballuar dhënien e shërbimit. Planifikimi i territorit në thelb është planifikimi i mjedisit, si bazë e jetës së shoqërisë njerëzore dhe e të gjitha specieve në planet. “...Mjedisi është një produkt i perceptimit...ai krijohet në sytë, mendjen dhe zemrat e vështruesit, ku komponentët material të mjedisit shikohen nëpërmjet filtrit të memories, asociimit, kuptimit dhe interpretimit. Vlerësimi i mjedisit nuk është i vetëm, mjedisi është një e mirë e përbashkët dhe një resurs i ndashëm. Veprimet mbi mjedis reflektojnë situatat lokale. Kjo duhet të pasqyrohet në çdo nivel nga ai pan-Europian tek vendori, nga eksperti tek personalja, dhe në nivelin vendor e rajonal ashtu si edhe në nivelin kombëtar”(Counsil of Europe, 2002, 10).


### **Organizimi i territorit dhe kufinj të shtrirjes së qytetit të Shkodrës**

Në kohën e sotme, qyteti i Shkodrës vazhdon të jetë në një periudhë tranzicioni hapësinor ku territori po u nënshtrohet shndërrimeve drastike. Problemet e zhvillimit të territorit kanë dalë në plan të parë, ndërkohë që qyteti duhet të sigurojë një infrastrukturë të përshtatshme, dhe në të njëjtën kohë të drejtojë dhe kontrollojë zhvillimet urbane private, duke përmbytur nevojat në rritje për transport publik dhe mbrojtjen e mjedisit. Qyteti i Shkodrës vendoset në qendër të Ultësirës së Shkodrës. Në territorin e Shkodrës që përkon ndryshe me pjesën veriperëndimore të Shqipërisë, vërehet pikë takimi apo planet e ndarjes së disa nga zonave tektonike të Albanideve dhe pjesës së ultësirës ndërmatore e mbivendosur, siç mund të konsiderohet zona e ulët e Shkodrës. (Grup Autorësh, 2002, 22) Një mpleksje e tillë e shumë zonave tektonike ndarë me plane thyerjesh me shtrirje gjatësore nga verilindja ne jugperëndim dhe veriperëndim-juglindje dhe nga tërthorja Shkodër-Pejë ose ndryshe thyerja e Drinit, tregon shumë pse territori i Shkodrës ka qenë dhe mbetet me aktivitet tektonik, neotektonik dhe sizmik të konsiderueshëm. Kushtet e



mësipërme kanë pasur dinamikë interesante sidomos në zonën e thyerjeve depresionale të Shkodrës që përkon me Ultësirën e NënShkodrës, ku sizmiciteti është shfaqur më dëmtes (Grup Autorësh, 1986, 37).

Qyteti i Shkodrës kufizohet nga liqeni në perëndim, nga lumi i Kirit në juglindje, nga Drini në jug e jugperëndim. Në veri e verilindje arrin deri në Stom Golem, si dhe në ish tokat eksperimentale të Institutit të Misrit. Në fillim të viteve 1990 kishte një sipërfaqe prej 13,3 km<sup>2</sup>, prej të cilave 9,2 km<sup>2</sup> sipërfaqe urbane dhe 4,1 km<sup>2</sup> rururbane. Në vitin 2000 sipërfaqja e qytetit arriti 19,2 km<sup>2</sup> prej të cilave 13,3 km<sup>2</sup> sipërfaqe e mirëfilltë urbane dhe 5,9 km<sup>2</sup> sipërfaqe rururbane. Sipërfaqja e territorit të qytetit ka pjerrësi 0,5° dhe lartësi mbi nivelin e detit, minimale 6 metra dhe maksimale 16 metra, ndërsa lartësia mesatare është 11 metra. Në vitin 2005 sipërfaqja e përgjithshme ka arritur 27.4 km<sup>2</sup>. Në rritjen e sipërfaqes së qytetit kanë ndikuar krijimi i lagjeve të reja në breg të liqenit të Shkodrës (Shiroka dhe Zogaj), në veri të qytetit, në lindje e juglindje, kjo nga të ardhurit gjatë këtyre 20 viteve të fundit. Zona turistike Shirokë-Zogaj janë dy lagjet e reja që shtrihen në perëndim të qytetit të Shkodrës. Kjo zonë kufizohet nga veriu me liqenin e Shkodrës, nga jugu me malin e Taraboshit, nga lindja me lumin e Bunës dhe nga perëndimi me kufirin shtetëror me Malin e Zi. Në zonën turistike Shirokë-Zogaj, prej rreth 600 ha, përfshihet një vijë ujore me gjatësi rreth 14.5 km, nga e cila rreth 10 km ka breg shkëmbor dhe 4.5 km fushor (Krymbi, 2014, 64). Këtu përfshihen të tre llojet e relievit, malor (i cili është mbizotërues), kodrinor dhe pak sipërfaqe të karakterit fushor, e përqendruar pranë bregut të liqenit të Shkodrës.



Popullsia e qytetit të Shkodrës sot arrin rreth 115.625 banorë, që do të thotë një rritje e kënaqshme në krahasim me 23 vjet më parë. Kjo është një rritje artificiale, si pasojë e lëvizjes së lirë të popullsisë nga zonat malore e fushore me prirje për t'u vendosur në qytet. Duhet të evidentohet fakti që në rritje ka ndikuar edhe fakti që në vitet 1997 dhe 2005 është kryer riorganizimi administrativ, ku disa fshatra të komunës Rrethina, si Shiroka dhe Zogaj, janë bërë pjesë e bashkisë Shkodër (ZGJC, 2014). Në tre vjetët e fundit rritja e popullsisë ka qenë pothuajse e palëvizshme me një përqindje prej vetëm 0.36%. Numri i

personave për familje, ka rënë në mënyrë të vazhdueshme në periudhën 1990-2012. Kjo është evidente edhe nga rritja e mirëqënies në vite, pasi në periudhën e sistemit totalitar kishte shumë raste ku disa familje jetonin në një banesë në pamundësi për të blerë apo për të marrë me qera një të re. Nëse para viteve 1990-të, përmes një plani të centralizuar të përdorimit të tokës, shteti si politikëbërësi dhe kontrolluesi i vetëm i burimeve përcaktonte se ku dhe si do të organizohej ofrimi i shërbimeve, banimi etj., me adoptimin e ekonomisë së tregut ai humbi monopolin e ofruesit të vetëm të produkteve dhe shërbimeve. Por nëse tërheqja e shtetit si ofrues në treg, edhe pse e debatueshme për disa shërbime, ishte një zgjedhje logjike në funksion të fuqizimit të ekonomisë së tregut, tërheqja *de facto nga roli rregullator në fushën* e zhvillimit urban ishte një inerci e pamenduar që jo vetëm nuk mundësoi një zhvillim urban eficient, por mbi të gjitha, korruptoi sistemin dhe ekstremizoi pragmatizmin individualist në raport me qytetin. Aktualisht, pavarësisht kontributit që ka dhënë urbanizimi në zbutjen e varfërisë, në mungesë të një planifikimi urban efektiv, ky proces është shoqëruar dhe me mjaft probleme, si përjashtimi social, segregimi urban, dhe dëmtimet në mjedis (Gjika & Shutina, 2010, 18).

### **Proceset e zhvillimit të territorit dhe problematika e manaxhimit mjedisor në qytetin e Shkodrës**

Me hapjen e kufinjve me botën e jashtme dhe lejimin e lëvizjes së lirë të popullsisë brenda dhe jashtë kufinjve, qyteti i Shkodrës filloi të ndryshojë shpejt si qytetet e tjera të mëdha të Shqipërisë në zgjerimin hapësinor, duke mos ndjekur një formë urbane të organizuar dhe të konsoliduar. Qyteti i Shkodrës hyri në një vërshim të pakontrolluar të zhvillimit, provokuar nga: *1.mbërritja e popullsisë së re, 2.lehtësirat nga lëvizja e re, 3.mundësitë e reja për aktivitetet ekonomik informal*. Qyteti i Shkodrës u rrit virtualisht në çdo drejtim, përveç ku u ndalua nga pengesat natyrore të pakapërcyeshme. Rregullat e ndërtimit ishin reduktuar drejt një uniformiteti, pa ndonjë respektim të mjedisit, ose të vlerësimit të peizazhit. Ky zhvillim u përqendrua, në mënyrë të veçantë, në pjesën perëndimore të qytetit, në drejtim të liqenit, ku një numër i madh shtëpish banimi u ndërtuan shpejt. Procesi i konstruksionit për banim mbuloi gjithashtu, zonat brenda periferisë së qytetit, siç është rreth stacionit të trenit, ish zona industriale, ndërmjet qytetit dhe lumit Kir, rreth kodrave dhe në hyrje të qytetit, rrëzë Kështjellës Rozafa. Qyteti i Shkodrës gjithashtu, rritet vertikalisht, veçanërisht vitet e fundit, me ndërtimin e komplekseve të mëdha rezidenciale, të përqendruara përgjatë akseve urbane kryesore, duke ndryshuar në këtë mënyrë disa nga perspektivat historike dhe natyrore të qytetit.

Autoritetet lokale u gjendën të papërgatitura për t'iu përgjigjur nevojave të banorëve për strehim, shërbime dhe integrim social. Institucionet mbyllën sytë përballë përpjekjeve të banorëve për të siguruar strehimin individualisht dhe informalisht. Ndërtimi informal u përhap në territorin e qytetit të Shkodrës në mënyrë të pakontrolluar. Në vendet me traditë të hershme të planifikimit urban, është e zakonshme që t'i paraprish zhvillimit me planifikimin dhe ndërtimin e infrastrukturave, për t'i lënë më pas mundësi krijimit të zonave të banimit. Kjo mënyrë garanton drejtimin e zhvillimit në ato territore ku është më e arsyeshme nga pikëpamja e tregut dhe mjedisit dhe më eficiente në lidhje me kostot dhe përdorimin e tokës (Co-Plan & IZHH, 2013, 5). Megjithatë ky parim kaq i thjeshtë, nuk arriti të materializohej në rastin e qytetit të Shkodrës sepse shpejtësia e planifikimit dhe aftësia e autoriteteve për të planifikuar në përgjigje të nevojave të një prurjeje të lartë migratore, ishin tepër modeste. Banorët në përgjithësi dhe veçanërisht të ardhurit, përqaftuan qasje të llojit “e bëj vetë”. Në këtë mënyrë siguruan shpejt strehë


për familjet e tyre, edhe pse në mungesë të plotë të infrastrukturës. Mirëpo askush nuk e dinte asokohe se një qasje kaq pragmatiste dhe e orientuar nga nevoja urgjente, do të bëhej në të ardhmen burimi i zhvillimeve të paqëndrueshme në territor, ndarjes sociale dhe mentalitetit që ushqen sjellje korruptive në zhvillim.

Rritja urbane e qytetit të Shkodrës është shoqëruar me rritjen e ndotjes në mjediset ujore. Zhvillimi i shoqërisë ka kërkuar vazhdimisht një përdorim të gjerë të ujërave në fusha të ndryshme të saj si në industri, bujqësi, tregti dhe transport, energji elektrike, higjienë dhe më kryesorja për ujë të pijshëm. Të gjitha ujërat që përdoren kanë ndikimet e tyre në cilësinë e mjedisit ujor, pasi përdorimi i tyre për qëllime humane përfshin në vetvete aktivitetin njerëzor mbi këta trupa ujorë dhe ndryshon vetitë e tyre natyrore. Shkarkimi i mbetjeve të lëngta urbane, bujqësore dhe industriale pa asnjë lloj trajtimi paraprak janë burimi kryesor i ndotjes së ujërave sipërfaqësore në qytetin e Shkodrës. Shkarkimi i tyre në mënyrë progresive ka ndikuar në uljen e cilësisë së ujërave të lumenjve, liqenit dhe të mjedisit në përgjithësi. Veprimtaria e njeriut në brigjet e liqenit të Shkodrës, dhe gjatë brigjeve të lumit Buna, dhe në zonën e tyre ujëmbledhëse ka ndikuar në cilësinë e ujërave dhe biodiversitetin e ekosistemit ujor. Ujërat nëntokësorë si pasuri natyrore kombëtare janë objekt shfrytëzimi i vazhdueshëm me intensitet në rritje dhe me risk të përhershëm ndotjeje nga veprimtaritë natyrore e humane.



Foto nr.1: Grumbullim i pakontrolluar i mbeturinave mes ndërtime të reja dhe zonës breg liqenore (Burimi: E.Krymbi, 2014)

Aktualisht qyteti i Shkodrës si në nivelin fizik ashtu edhe në atë mendor dhe relational, i kthen kurrizin elementit më të rëndësishëm të hapësirës: liqenit. Një tokë e askujt e “njollosur”, nga abuzivizmi e ndan nga qendra e Shkodrës. Dinamizmi ekologjik i liqenit, që në periudha të ndryshme të vitit vendos kufirin midis tokës dhe ujit, është elementi që shërben për ti dhënë jetë një imazhi të ri me mjaft ndikime sociale pozitive. Regjimi hidrologjik i kompleksit hidrografik të Shkodrës është i lidhur ngushtë dhe përcaktohet nga ndikimi i kushteve klimatike. Zona dallohet për një klimë tipike subtropikale mesdhetare, që karakterizohet nga verë e thatë dhe e zgjatur dhe dimër i ngrohtë e me lagështi. Numri i ditëve me temperaturë të lartë ( $T_{max} \geq 25^{\circ}C$ ), ndryshon nga 110 në 130 ditë në vit. Për të gjithë sipërfaqen e pellgut të liqenit të Shkodrës, shtresa mesatare e reshjeve atmosferike është 2.170 mm, duke patur ndryshime të theksuara në shpërndarjen gjeografike. Lumenjtë e Bunës dhe të Drinit takohen në jugperëndim të qytetit të Shkodrës. Në lindje, qyteti kufizohet nga lumi Kir, një lum sezonal që rrjedh në pjesën jugore (Grup Autorësh, 1991, 121). Të gjithë këta lumenj janë kthyer si vend-grumbullimi për plehrat dhe janë objekt i gërmimit të pakontrolluar për lëndë të parë ndërtimi. Si rezultat ata nuk janë vetëm të ndotur dhe të çnaturuar por shkaktojnë dhe përmbajtje dhe grumbullim të ujërave të shiut në qytet. Bazuar në shumë studime të pjesëshme që janë bërë nga specialistë të ndryshëm, është arritur në konkluzionin e përgjithshëm që uji i liqenit nuk karakterizohet nga probleme shqetësuese të ndjeshme, se ai është lehtësisht i ndotur, por në liqenin e Shkodrës si një objekt hidrologjik natyror, si ekosistem dhe si mjedis, në përgjithësi vërehen një numër problemesh disa prej të cilave kanë qenë e janë shqetësuese, sidomos në brigje. Përmbajtja e oksigjenit të tretur ka vlera me luhatje jo shumë të ndjeshme (8.5 në 9.91 mg/l O<sub>2</sub>) në ujërat e lumit Drin dhe nga (8.21 në 10.4 mg/l O<sub>2</sub>) për lumin e Bunës gjë që mund të shpjegohet me ndryshimin e sasisë së ujit për shkak të reshjeve të mëdha gjatë periudhës së parë të vitit si dhe për shkak të shtimit të elementëve që konsumojnë oksigjenin në zonën ku ata rrjedhin. Ecuria e përmbajtjes së NBO<sub>5</sub> në ujërat e lumenjve Drin dhe Bunë ka të njëjtën luhatje nga stacioni në stacion gjatë periudhës me pak prurje. Kështu për stacionin e Bahçallekut kemi luhatje nga 0.57 në 0.9 mg/l O<sub>2</sub> dhe për stacionin e Bunës 0.9 në 3.8 mg/l O<sub>2</sub> (MMPAU, 2012, 54). Vlera e lartë e këtij parametri në stacionin e Bunës i përket një ndikimi ndotës si urban ashtu edhe nga rritja e sasisë së ujit që sjell shpëlarja e zonës përreth tij. Nisur nga vlerat e marra nga analizat e kampionëve në këto stacione, mund të themi se ujërat në këto stacione kanë të njëjtën cilësi të tyre me ato të cilësisë mesatare. Përmbajtja e fosforit total në ujërat e lumenjve Drin dhe Bunë ka luhatje të ndryshme. Për stacionin e Bahçallekut këto vlera kanë tendencë të qëndrueshme nga 0.01 në 0.015 mg/l P. Për stacionin e Bunës kemi variacion të vlerave nga 0.008 në 0.015 mg/l P. Vlerat e këtij treguesi për lumin e Bunës tregojnë se përzierja e ujërave me liqenin e Shkodrës ka qenë e vazhdueshme dhe me ndikim të shkarkimeve urbane në të.



Harta nr.2: Të dhënat e cilësisë së ujërave nga matjet në stacionet e lumit Buna dhe lagjen Bahçallek

(Burimi: E.Krymbi & GIS/Albania, 2010-2012)

Akuiferi ujëmbajtës zhavorror i Shkodrës: Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet është 1200-1300 l/sek për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Shkodrës dhe rrethinave, kurse sasia e ujit që shfrytëzohet në akuiferin e Shkodrës është:  $Q = 1200-1300$  l/sek. Koeficienti i shfrytëzimit është:  $K = 0.33-0.5$ . Risku i ndotjes është i lartë:

- a) për shkak të mbulesës së vogël mbrojtëse sidomos në vendburimin e Dobraçit;
- b) shfrytëzimi intensiv mund të çojë në përzierjen e ujërave të freskëta me ujërat me mineralizim të lartë. Mineralizimi i përgjithshëm varion  $M_p$  (263.42-368.16mg/l). Në shpimin e Dobraçit që shfrytëzohet për furnizimin me ujë të Shkodrës,  $M_p$  luhartet në vlerat (295.94-329mg/l) për vitin 2012, gjithashtu edhe në vite e krahasuar,  $M_p$  varion në vlerat (327-384.85mg/l) (MMPAU, 2012, 63). Një problem i madh në akuiferin ujëmbajtës zhavorror të Shkodrës, në Dobraç është edhe ndërtimet e shumta informale, të cilat nuk kanë një sistem K.U.Z. dhe K.U.B. të rregullt dhe mund të bëhen burime ndotëse.

Sistemi ekzistues i K.U.Z. në Shkodër është projektuar dhe ndërtuar si sistem K.U.Z. më vehte, me sistem K.U.B. të ndarë. Sistemi ekzistues i K.U.Z. përfshin tre kanale kryesore të ujërave të zeza, bashkë me kanalet sekondare dhe terciare. Tre kanalet bashkohen dhe shkarkohen me anë të gravitetit, në sajë të kanalit të ujërave të zeza për tek stacioni i pompave tek i cili ka 5 pompa, që nuk punojnë secila me kapacitet prej 150 l/s. Stacioni i pompave ndodhet afër urës së Bunës. Kur stacioni i pompave punon bën shkarkimin në daljen e lumit Drin. Ka një dalje të mbipurjes emergjente, ku bëhet shkarkimi në lumin Buna, në rast të mungesës së energjisë elektrike. Por se, kjo e fundit është e bllokuar. Si e tillë kur stacioni i pompave nuk punon ujërat e zeza shkarkohen në kanalën e ujërave të shiut afër Urës së Magjypit (Kanali i Fermës) dhe pastaj tek pika afër aty ku bashkohen liqeni i Shkodrës me lumin Buna.

Sistemi ekzistues i K.U.B. në qytetin e Shkodrës, është projektuar dhe ndërtuar si sistem K.U.B. me vehte, me një sistem të ndarë të K.U.Z. Qyteti i Shkodrës drenazhohet nga një sistem me kanale të mbyllura dhe të hapura, tuba drejtkëndore, shumica e tyre drenazhohen me anë të rrjedhës së lirë për në liqenin e Shkodrës. Disa zona përfshirë zonën industriale drenazhohen në lumin Kir. Gjatësia totale e drenazhuesve kryesore është rreth 37 km, prej të cileve rreth 25 km, janë tuba drejtkëndore dhe kanale me shkëputje, kanale prej betoni të cilët kanë relativisht karakteristika të mira të rrjedhës. Sistemi mbulon zonat qendrore dhe jugore të qytetit të Shkodrës, përfshirë ato që janë të shtruara dhe që nuk kanë ose kanë drenazhim shumë të kufizuar të ujërave të shiut. Sistemi kryesor drenazhues mbulon rreth 70-80% të zonave formale të qytetit, me mbulim shumë më të ulët në zonat informale (Kfw Kreditanstalt für Wiederaufbau & Ujësjiellës- Kanalizime Qytet Shkodër, 2006-2012).

Procesi i decentralizimit, në kontekstin e manaxhimit të mbetjeve filloi si një nevojë për të mbrojtur mjedisin dhe përmirësimin e shërbimit të manaxhimit të mbetjeve të ngurta, të cilat i janë deleguar niveleve më të ulëta të njësive të qeverisjes vendore, pa përcaktuar standardet e cilësisë, gjë që çoi në përkeqësimin e kushteve mjedisore edhe në qytetin e Shkodrës. Aktualisht, vendgrumbullimet e mbetjeve në pjesën më të madhe të rasteve në qytetin e Shkodrës, janë të lokalizuara në distanca shumë të vogla nga qendrat e banuara, sidomos në zonat/vendbanimet informale, shumë pranë luginës së lumit Kir, duke u bërë një burim ndotjesh për mjedisin përreth dhe shëndetin e njerëzve. Në disa hapësira periferike të qytetit në afërsi të liqenit të Shkodrës, kemi sektorë që janë kthyer në vend depozitime mbetjesh, ku rrjedha i transporton ato në zona të tjera, duke transferuar ndotjen në ujëra dhe toka të tjera. Një tjetër problem është dhe kategoria e mbetjeve të rrezikshme, të cilat në të shumtën rasteve grumbullohen së bashku me mbetjet e ngurta urbane dhe depozitohen në fushë të hapur; dhe nga ana tjetër, shtimi i sasisë të mbetjeve inerte nga ndërtimet apo shkatërrimet e shumta. Metodatat e riciklimit të mbetjeve, ndonëse kanë filluar të zbatohen në një përqindje shumë të vogël nga organizatat e ndryshme lokale mjedisore, problemet që këto të fundit hasin janë të shumta. Po ashtu po hidhen pa kriter në sektorin e tabanit të liqenit të Shkodrës në periudhën e verës, materiale inerte, të cilët me rritjen e ujërave të liqenit do të dekantohen, dhe do ta cektësojnë më shumë këtë hapësirë ujore. Të gjitha këto janë mbetje nga ndërtimi, prishja dhe mirëmbajtja e ndërtesave apo infrastrukturës civile. Për këtë rrymë specifike autoritetet lokale të qytetit të Shkodrës, nuk kanë të dhëna të sakta për sa kohë që nuk ekziston një shërbim i mirëfilltë i organizuar për grumbullimin dhe largimin e tyre. Nuk ka pika të veçanta për grumbullimin e tyre me infrastrukturën e nevojshme dhe evadimi i tyre bëhet mbi bazën e nevojave të momentit dhe jo mbi një planifikim dhe manaxhim real të territorit. Duke mos pasur vende të caktuara dhe kontenierë të përshtatshëm për evadimin e kësaj rryme specifike qytetarët dhe subjektet private i depozitojnë ato pranë kontenierëve të planifikuara për mbetjet urbane, ose në pjesët periferike të qytetit, ku shembulli klasik kohët e fundit po bëhet by-pass-i i Shkodrës.



Foto nr.2: Ndotje, depozitime urbane, ndërtime informale në tabanin e liqenit të Shkodrës (Burimi: E.Krymbi, 2013)

Gjithashtu në akset kryesore të rrugëve nacionale jo rrallë herë gjen pirgje me mbetje inerte të depozituara në mënyrë ilegale. Është duke u rritur shumë dhe duket i pakontrolluar numri i ndërtimeve përgjatë brigjeve të lumit Buna dhe liqenit të Shkodrës dhe, nëse vazhdon kështu e me ritme më të shpejta si prognozë, atëherë parashikojmë se, pas disa vjetësh, shumë pak breg i lirë ka për të mbetur, sidomos në atë perëndimor që aktualisht duket më i preferuar për infrastrukturë turistike e tregtare. Kjo dukuri do të kufizojë mundësinë për plazh, pra do të kufizojë vlerat balneare si dhe do të rrisë masën e ndotjes për shkak të derdhjeve të shumta të ektrementëve në ujë. Zona e bregut të liqenit të Shkodrës ka qenë vlerësuar shumë si një zonë me vlerë të lartë, por i është nënshtruar zhvillimit spekulativ nga ndërtimet pa kriter. Këto ndërtesa janë ndërtuar pa një vlerësim si të faciliteteve strukturore e sanitare, ashtu dhe të vlerave estetike të peizazhit ose cënueshmërinë prej rrezikut të përmbytjeve. Këto tipe të vendbanimeve përgjatë brigjeve të liqenit të Shkodrës, shpesh krijojnë degradime mjedisore të konsiderueshme të tokës dhe ujit, gjithashtu të peizazheve dhe të biodiversitetit të liqenit.

Në shumë faqe të malit të Taraboshit janë bërë ndërhyrje të pakontrolluara në terren, për marrjen e gurëve gëlqerore apo të dherave. Kjo, jo vetëm ka sjellë prishjen e peizazheve gjeografike rreth liqenit, mundësinë e provokimit të dukurive gjeomorfologjike siç janë shembjet, por ka dëmtuar e po dëmton rëndë bimësinë në këto shpate, gjë që reflektohet në dukuri negative në brigjet e liqenit e në uljen e vlerave turistike.



*Foto nr.3: Guroret dhe ndërhyrjet pa kriter në malin e Taraboshit*

*(Burimi: E.Krymbi, 2014)*

Erozioni i tokës është një problem i madh në zonat përreth brigjeve të lumenjve. Lumi Buna, Drini dhe Kiri takohen në një bashkë-rrjedhje në jug të liqenit të Shkodrës. Në dimër këtu uji arrin një nivel me të lartë (kryesisht në sezonin e shirave) dhe pengon rrjedhjen e ujit nga liqeni i Shkodrës. Kjo gjë shkakton përmytje por pengon gjithashtu edhe derdhjen e ujërave të zeza dhe të shiut, nga zona urbane duke shkaktuar grumbullime të mëdha të ujit brenda qytetit. Kjo situatë është përkeqësuar edhe nga depozitimi i materialeve në shtratin e lumenjve duke reduktuar kështu kapacitetin e tyre. Mënyrat për reduktimin e këtyre rreziqeve:

- Skarpatat e lumenjve duhet të mbrohen me diga sidomos përgjatë lumenjve të Drinit dhe Kirit kur kalojnë pranë qytetit të Shkodrës;
- Ndalimi i gjurmimeve të shtretërve të lumenjve për nxjerrjen e materialeve të ndërtimit;
- Kryerja e pastrimeve dhe prishja e ndërtimeve abuzive në shtratin e lumit Buna.



## Konkluzione

Për ta konkluduar mund të shprehemi se të gjitha këto dukuri e shqetësime mjedisore janë rrjedhojë e keqadministrimit të territorit të qytetit të Shkodrës, hapësirës ujore të liqenit dhe lumit, gjatë viteve të kaluara dhe aktualisht, rrjedhojë e një ndërgjegjësimi minimal të njerëzve për vlerat e tërësisë ujore dhe për pasojat që rrjedhin nga ndërhyrja antimjedisore, nga marrëdhëniet jo të drejta e të paekuilibruara që janë vendosur midis tërësisë ujore e veprimtarisë humane. Është e rëndësishme të merret parasysh se planifikimi i territorit dhe manaxhimi i mjedisit kërkojnë ligjitimet politik dhe shoqëror, i cili mund të fitohet vetëm nëpërmjet mishërimit të një legjislacioni të duhur. Fuqia dhe qëllimi i planifikimit varen, nga një ideologji e gjerë, e cila bazohet tek roli i shtetit dhe se sa ai duhet të ndërhyjë në proceset urbane, të cilat ndryshojnë në kohë dhe sipas konteksteve të ndryshme. Mënyra për reduktimin e ndotjes është trajtimi i ujërave urbane (ujërave të zeza) të qytetit të Shkodrës, përpara se të derdhen në liqenin e Shkodrës, në lumin Buna dhe në Drin. Rrjeti i ujërave të zeza mbulon afërsisht 65%-70% të hapësirës së populluar të qytetit. Sidoqoftë ky rrjet vuan nga probleme të ndryshme në sistemin e daljes dhe nga punimet e shumta dhe të stërzgjatura sidomos në hyrjen e qytetit të Shkodrës. Sasia totale vjetore e ujërave të përdorura nga qyteti është 9.6 milion m<sup>3</sup> dhe momentalisht nuk ka një impiant trajtimi. E rëndësishme është koordinimi më i mirë i politikave dhe i strategjive konkrete të zhvillimit hapësinor si dhe të përdorimit të tokës. Kjo duhet të ndërthuret me instrumentet ekonomike për të njohur domethënien ekologjike të zonave të mbrojtura dhe me ndjeshmëri mjedisore.

Problemet mjedisore të zonave informale kërkojnë integrimin e tyre me pjesën tjetër të qytetit sidomos nëpërmjet skeletit rrugor kyesor lidhës si edhe krijimit të një stukture urbane të mirëfilltë brenda zonave dhe pajisjen e tyre me infrastruktura e shërbime publike. Kjo nënkupton ndërhyrje në zonat të cilat paraqesin vlera nga pikëpamja peisazhistike për ringjalljen, rikthimin e funksioneve të mëparshme, ose rehabilitimin, rikthimin e vetive natyrale peisazhistike të zonave të degraduara të cilat në gjendjen aktuale e kanë humbur atë. Shkalla e ndërhyrjeve në keto zona varion që nga ndërhyrjet ndërtimore e deri tek sistemet e terrenit, krijimi i brezave të gjelbër, apo trajtimet peisazhistike për të rikthyer vlerat estetike të qytetit të Shkodrës.

## Literatura

- Co-Plan Gazette. (2013). Publikim gjashtëmujor i Co-Plan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Tiranë.
- Council of Europe. (2002). *"The European Landscape Convention"*, Bietlot-Gilly, Belgium.
- Friedmann, J. (1987). *"Planning in the Public Domain"*, Princeton University Press.
- Grup Autorësh. (1986). *"Mikrozonimi sizmik i qytetit të Shkodrës"*; Qendra Sizmologjike Tiranë.
- Grup Autorësh. (1991). *"Gjeografia Fizike e Shqipërisë"* I & II. Tiranë.
- Grup Autorësh. (2002). *"Harta Gjeologjike e Shqipërisë e shkallës 1:200.000"*, Tiranë.
- Gjika, A. & Shutina, D. (2010). Sfidat e pushtetit vendor mbi zhvillimet urbane dhe sektorin e strehimit në Shqipëri marrë nga botimi *"Politikëndjekës apo politikëbërës! Alternativa mbi zhvillimin urban, manaxhimin e territorit dhe të mjedisit"*, Editorë: Dritan Shutina dhe Rudina Toto, Instituti i Kërkimit Shkencor POLIS.
14. Indovina, F., Fregolent, L. & Savino, M. (2005). *"L'esplosione della città"* Editrice Compositori.
- Kfw Kreditanstalt für Wiederaufbau & Ujësjiellës- Kanalizime Qytet Shkodër. (2012). *"Llogaritja hidraulike e rrjetit të K.U.Z. e K.U.B. Shkodër"*, 2006-2012.
- Krymbi, E. (2014). *"Planifikimi hapësinor dhe rregullimi territorial i qytetit të Shkodrës : disert. në*

*kërkim të gradës shkencore “Doktor”*, Universiteti i Tiranës. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Gjeografisë.  
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. (2012). Raporti i Gjendjes në Mjedis për vitin 2012.  
Randolph, J. (2010). *“Planifikimi dhe manaxhimi mjedisor i përdorimit të tokës”*, Tiranë, UFO Press.  
Zyra e Gjendjes Civile. (2014). Bashkia Shkodër.

## **Përfaqje e taksonomisë zoonimike të kafshëve shtëpiake të gjuhës shqipe me atë të gjuhës gjermane**

**Sonila Disho**

*Fakulteti i Shkencave Humane Universiteti i Elbasanit*

**Brunilda Vërçani**

*Fakulteti i Shkencave Humane Universiteti i Elbasanit*

### **Abstrakt**

Aspekti taksonomik apo klasifikues i gjuhës shqipe dallon pak nga ai i gjuhës gjermane. Ndryshimet midis shqipes dhe gjermanishtes përveçse vihen re në mënyrën e organizimit të sistemit apo në strukturën e tij, vihen re dhe në numrin e elementeve që përbëjnë sistemin. Ndryshimet janë vendosur në radhë të parë nga marrëdhëniet që kanë vendosur këta dy popuj me llojet e ndryshme të gjësë së gjallë. Ky leksik ka frymëzuar studiues të ndryshëm shqiptarë (Shkurtaj, 1977, 339-348) dhe gjermanë (Kutzelnigg, 1983, 210 – 216; Koss, 2002, 24).

Në sistemin shqip të zoonimisë së kafshëve shtëpiake si hiperonim gjejmë termin gjë e gjallë . Paralel me këtë term gjejmë dhe termin kafshë shtëpiake. Ky hiperonim përfshin hiponimet kafshë prodhuese dhe kafshë joprodhuese. Tek kafshët prodhuese përfshihen bagëtia e trashë dhe e imët. Bagëtia e trashë ose ndryshe gjedhët përfshin dhe buajt. Bagëtia e imët përfshin si nënkategori delen dhe dhinë. Nje kategori me vete perbën dhe derri. Një kategori tjetër më vete përbëjnë dhe shpezët shtëpiake. Te grupi i kafshëve joprodhuese futen kali, gomari dhe mushka. Grupi i kafshëve joprodhuese quhet ndryshe dhe hajvanë ose kafshë pune.

Në sistemin gjerman të zoonimisë së kafshëve shtëpiake gjejmë si hiperonim termin *Haustier/Nutztier (kafshë shtëpiake)*. Paralel me këtë term gjermanët përdorin termin *Vieh (gjë e gjallë, bagëti )* (Carl, 1995, 172). Ky hiperonim përfshin hiponimet *Grossvieh (bagëti e trashë)* dhe *Kleinvieh (bagëti e imët )*. *Grossvieh (bagëti e trashë)* si nënkategori përfshin *Pferd (kali) dhe Rind (gjedhi)*. *Kleinvieh (bagëti e imët)* si nënkategori përfshin *Schaf (dele), Ziege (dhi), Schwein (derri), Hase (lepuri) dhe Geflügel (shpezë)*.

### **Leksiku përfaqësues i kafshëve shtëpiake**

Brenda një lloji të caktuar fjalët që emërtojnë kafshët shtëpiake formojnë sisteme interesante ku elementet organizohen në raporte të caktuara sipas disa kriterëve të ndryshëm, si gjinia (femër – mashkull ) moshë dhe funksioni. Hiperonimet dhe hiponimet të gjetura nga një analizë globale e elementeve të sistemit na bëjnë të kuptojmë se cilët nga llojet e kafshëve shtëpiake kanë qenë të rëndësishme për gjermanët dhe shqiptarët. Nëse skema paraqitet e gjerë dhe e shumëllojshme atëherë kjo kafshë shtëpiake ka një rëndësi shumë të madhe. Sistemi është i përbërë nga kategoritë, nënkategoritë, llojet, variantet e llojeve dhe individët.

### **Ndarja e kafshëve shtëpiake në klasa semantike**

Në taksonominë popullore të disa kafshëve shtëpiake dallojmë tre klasa semantike të cilat lidhen me stadet e zhvillimit fiziologjik të gjallesave dhe klasifikojnë variantet e llojit. Aftësia për të prodhuar dhe për t'u riprodhuar është tipari kryesor që ndihmon në përcaktimin e numrit të klasave të një lloji të caktuar :

I klasa e të rriturve

II klasa e të rinjve

III klasa e të vegjëlve

Shqiptarët duket se kanë një njohje goxha të mirë të kafshëve dele, dhi, lopë, pulë dhe jo fort të mirë të llojeve të tjera dhe kjo duket jo vetëm nga numri i fjalëve që shënojnë variante të llojit por dhe nga treguesit formalë të kategorisë së gjinisë për klasën e tretë. (Çelo, 1957, 32)

Në fjalët e klasës së dytë gjinia natyrore është faktori vendimtar që përcakton destinacionin e individit (prodhim, riprodhim).

Në fjalët e klasës së parë të të gjitha këtyre llojeve të kafshëve shtëpiake kemi kundërvënien gramatikore mashkullore- femërore. Kjo bën të dukshëm faktin që dobia e një kafshe është e lidhur ngushtë me gjininë natyrore. Gjinia pra tek emrat e kafshëve nuk është thjesht një kategori gramatikore, por leksiko-gramatikore sepse një element i kuptimit leksikor të fjalës (seksi i kafshës) gjen shprehje në anën gramatikore (në përfshirjen e emrit në këtë apo atë gjini). Vlen të përmendet fakti që shumica e fjalëve që shënojnë të rriturit e gjinive të ndryshme na dalin me rrënjë të ndryshme, si psh *dash-dele*; *cjap-dhi*; *lopë-dem*; *pelë-kalë*; *pulë-gjel*; *dosë-derr*; *qen-bush tër*. Ndërsa emrat e llojeve më pak të njohura e dallojnë gjininë nëpërmjet një prapashtese të caktuar e cila i shtohet temës së emrit të gjinisë mashkullore (ASHSH, 2002, 92) si psh.: *buall-buallice*; *gomar-gomare* / *gomaricë*; *lepur-lepurushe*. Emrat mashkullore që formohen nga ata të gjinisë femërore janë të paktë. Kështu kemi: *mace-maçok*; *patë-patok*; *rosë-rosak*. (ASHSH, 2002, 92) Le t'i rikthehemi përsëri gjinisë gramatikore të fjalës përfaqësuese e cila njëherësh përcakton dhe gjininë e hiperonimit. Në këtë kuptim një nga fjalët që shënojnë variantet e llojit fiton një status të ri, statusin e fjalës përfaqësuese. Fjalët që shënojnë fjalët e klasës së parë janë dy (përkatësisht një e gjinisë femërore dhe një e gjinisë mashkullore). Si përzgjidhet fjala që emërton hiperonimin? Nga një vështrim i shkurtër i leksikut përfaqësues të kafshëve shtëpiake të përzgjedhura shihet që është zgjedhur si fjalë përfaqësuese e llojit fjala e gjinisë femërore për ato kafshë, dobia e të cilave lidhet me prodhimin e qumështit, vezëve apo të të vegjëlve dhe është zgjedhur si fjalë përfaqësuese e llojit fjala e gjinisë mashkullore për kafshët që kanë funksione të ndryshme.

Kështu në rastin e kalit themi se një ndër funksionet kryesore të kësaj kafshe është aftësia për të mbartur. Tipari dallues i një lloji të caktuar është kushti kryesor që ka bërë përzgjedhjen e fjalës përfaqësuese.

Për llojet lopë, dele, dhi, pulë është gjinia femërore ajo që përcakton dobinë dhe tiparin përfaqësues. Për llojet kalë, derr, buall gjinia përfaqësuese është ajo e gjinisë mashkullore sepse dobia e këtyre kafshëve nuk është e lidhur me gjininë.

Pra mund të themi që gjinia e fjalëve përfaqësuese të llojit të kafshëve shtëpiake nuk është thjesht konvencionale.

Le t'i rikthehemi dhe njëherë statusit që fiton fjala që shënon llojin në raport me fjalët që shënojnë nënlojet apo variantet e llojeve. Duke u nisur nga pikëpamja semantike kjo fjalë bëhet e dallueshme nga fjalët e tjera dhe kjo mund të provohet lehtë po të shohim lidhjet që ajo mund të realizojë me njësi të tjera leksikore apo morfologjike. Kështu themi:

*kalë karroce dhe jo pelë karroce*

*lesh deleje dhe jo lesh dashi*

*kakardhi dhie dhe jo kakardhi cjapi*

*qumësht deleje dhe jo qumësht dashi*

Duke patur statutin e fjalës përfaqësuese kalë, dele, dhi, përcaktojnë sende sipas një tipari që i takon llojit dhe jo një varianti apo një individ të caktuar të tij.

Është interesante të vihen re disa nga formimet me temë emërtimet e llojeve të kafshëve

shtëpiake. Kështu themi :

*dhenar – bari dhensh*

*dhiar – bari dhish*

*shterpar – bari që ruan delet shterpë*

*shelegar – bari që ruan shelegët*

*lopçar – bari që ruan lopët* (njohim dhe emërtimin lopar duke kujtuar ne Elbasan mikrotoponimin Fusha e loparit)

*viçar – bari që ruan viçat*

Gjermanët duken se kanë një njohje të mirë të llojeve *Rind(gjedh)*, *Ziege(dhi)*, *Schaf(dele)*, *Schwein(derr)*, dhe *Huhn(pule)* dhe një njohje jo fort të mirë të llojeve të tjera.

Në fjalët e klasës së parë të të gjitha këtyre llojeve të kafshëve shtëpiake bëhet i dukshëm fakti që dobia e një kafshe lidhet ngushtë me gjininë natyrore të llojit. Gjinia gramatikore jo gjithmonë përkon me gjininë natyrore (DUDEN, 1998, 200). Vlen të përmendet fakti që shumica e fjalëve që shënojnë të rriturit e gjinive të ndryshme na dalin me rrënjë të ndryshme si p.sh : *Schaf- Bock*; *Ziege – Bock*; *Schwein –Sau* ; *Stute – Hengst* ; *Huhn – Hahn* ; *Hase – Bock* (Helbig-Buscha, 1996, 270).

Ndërsa për llojin Esel (gomari) për të formuar gjininë femërore na vjen në ndihmë mbaresa *-in* (Helbig – Buscha, 1996, 271) që i bashkëngjitet temës mashkullore dhe që është karakteristike për formimin e gjinisë femërore. Kështu kemi : *Esel – Eselin*. Përsa i përket llojit *Gans* dhe *Ente* për të formuar gjininë mashkullore zoologëve u vjen në ndihmë prapashtesa – *ich* që i bashkëngjitet temës femërore dhe që është karakteristike për gjininë mashkullore: *Gänserich* dhe *Enterich* (DUDEN, 1997, 191; Carl, 1995, 252)

Gjinia natyrore e fjalës përfaqësuese përcakton dhe gjininë e hiperonimit. Një nga fjalët që shënon variantet e llojit fiton një status të ri, statusin e fjalës përfaqësuese.

Gjinia gramatikore e fjalëve që shënojnë fjalët e klasës së parë thamë dhe pak më lart që nuk përkon gjithnjë me gjininë natyrore.

Duke studiuar leksikon përfaqësues të kafshëve shtëpiake shihet që është zgjedhur si fjalë përfaqësuese e llojit fjala e gjinisë femërore natyrore për ato kafshë, dobia e të cilave lidhet me prodhimin e qumështit, vezëve apo të të vegjëlve dhe është zgjedhur si fjalë përfaqësuese e llojit fjala e gjinisë mashkullore natyrore për kafshët që kanë funksione të ndryshme.

Duke iu rikthyer dhe njëherë statusit që fiton fjala që shënon llojin në raport me fjalët që shënojnë nënlojet apo variantet e llojeve por këtë radhë nga ana semantike kjo fjalë bëhet e dallueshme duke u nisur nga lidhjet që ajo realizon me njësi të tjera leksikore apo morfologjike. Kështu themi :

*Zugpferd (kalë karroce) dhe jo Zugstute(pelë karroce)*

*Pferdeapfel(bajgë kali) dhe jo Stutenapfel(bajgë pele)*

*Schafwolle(lesh deleje) dhe jo Bockwolle(lesh dashi)*

Le të vëmë re disa nga formimet e fjalëve të reja që do të shenjonin sende apo tipare që lidhen me veçoritë përfaqësuese të llojit duke pasur si temë fjalëformuese emrat e llojeve.

Kështu themi:

*Schweine-, Schaf-, Ziegen-, Kuh-, Esel-, Gänsehirt (bari derrash, delesh, dhish, lopësh, patash);*

*Ziegen-, Schaf-, Rinderherde(kope dhish, delesh, gjedhësh)*

Nuk duhen lënë pa përmendur dhe ndërtime me prapashtesat zvogëluese **-chen** dhe **-lein** që vihen re në pothuajse të gjitha llojet e kafshëve shtëpiake dhe që përdorimi i tyre po përhapet gjithnjë e më tepër në të folurën e përditshme (Carl, 1995).

Një formim interesant paraqesin dhe emrat e përbërë tema e parë e të cilave është **Jung** që do të thotë *i ri* dhe tema e dytë është emërtimi i kafshëve shtëpiake. Kështu kemi *Jungschaf*,

*Jungziege, Junghenne, Jungvieh* që emërtojnë llojet *dele, dhi, pulë, gjedh* në prag të fazës për të prodhuar dhe për t'u riprodhuar.

Interesante gjithashtu janë dhe ndërtimet me temat **Mast** dhe **Zucht** të cilat duke u bashkuar me temat e emërtimeve të kafshëve shtëpiake bëjnë dallimin e kafshëve shtëpiake që destinohen të theren dhe të kafshëve shtëpiake që destinohen të rriten. Kështu kemi :

*Zuchtkalb*(viç që destinohet të rritet) - *Mastkalb* (viç që destinohet të theret)

*Zuchtlamm*(kec që destinohet të rritet) - *Mastlamm*(kec që destinohet të theret)

*Zuchtschwein*(derr që destinohet të rritet) - *Mastschwein*(derr që destinohet të theret)

## Përqsaja

Në përfundim të këtij vështrimi të shkurtër të taksonomisë zoologjike shqipe dhe gjermane të kafshëve shtëpiake le të shohim se sa të përbashkëta dhe sa të veçanta paraqesin ato në përqsaje me njëra - tjetrën.

1. Duke nisur me llojet e kafshëve shtëpiake më të njohura për secilin grup themi se secili grup njihet më shumë llojet *dele, dhi, lopë, pulë* dhe *derr*. Kjo lidhet me dobishmërinë e madhe që paraqet secili lloj. Nëse do të vinim re klasifikimin popullor që i bëhet kafshëve shtëpiake themi që gjermanët ndryshe nga shqiptarët rendisin në bagëtinë e trashë përveç gjedhëve edhe kuajt. Shqiptarët i rendisin kafshët shtëpiake sipas një kriteri të caktuar që është prodhuese/joprodhuese, ndërsa gjermanët dobishmëritë e secilit lloj nuk ia nënshtrojnë vetëm kriterit të lartpërmendur.

2. Një element me shumë rëndësi që duhet përmendur është gjinia natyrore e secilit lloj. Nëse në shqip gjinia natyrore përkon gjithnjë me gjininë gramatikore në gjermanisht nuk ndodh gjithnjë kështu.

*kali (m) - Pferd (a)*

*mushka(f) - Maultier(a)*

*derri(m) - Schwein (a)*

*delja(f) - Schaf(a)*

3. Termi i fjalës përfaqësuese që emërton si llojin dhe një variant të llojit shfaqet si në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane. Leksiku përfaqësues i kafshëve shtëpiake të gjuhës shqipe përngjason me atë të gjuhës gjermane. Kështu kemi : *dele(Schaf)*; *dhi(Ziege)*; *qeni(Hund)*; *pata(Gans) etj*

4. Ndarja në tre klasa semantike si në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane varet nga fakti se sa e rëndësishme dhe e njohur është një kafshë shtëpiake. Për kafshët më të njohura si *dele(Schaf)*; *gjedh(Rind)* etj bëhet e mundur ndarja në tre klasa semantike. Ndërsa për kafshët më pak të njohura si *qeni(Hund)*; *macja(Katze)* kemi ndarjen në dy klasa semantike, ku klasa e dytë dhe e tretë nuk dallohet shumë nga njëra - tjetra.

5. Në gjuhën gjermane të bie në sy fakti që për shumicën e llojeve të kafshëve shtëpiake gjejmë dhe një emërtim për variantin *e tredhur*. Kështu përmendim *Hammel (dashi i tredhur)*; *Wallach(kali i tredhur)*; *Kapaun(gjeli i tredhur)*; *Gelze(dosë e tredhur)*. Ndërsa për llojin gjedh gjejmë variantin *e tredhur* si në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane: *kau(Ochse)*

6. Një interes të veçantë treguan dhe formimet e fjalëve të reja me temë llojet e ndryshme të kafshëve shtëpiake të cilat dëshmuuan si për gjuhën shqipe dhe për gjuhën gjermane dhe njëherë statusin që fiton fjalë përfaqësuese në raport me fjalët që emërtojnë nënlojet apo variantet e llojeve. Them *lopçar* dhe jo *demçar* në shqipe dhe *Kuhhirt* dhe jo *Stierhirt* në gjermanisht.

## Bibliografia

- ASHSH. (2002). *Gramatika e gjuhes shqipe 1*. Tiranë.
- Carl, H. (1995). *Die deutschen Pflanzen- und Tiernamen*. Wiesbaden.
- Çelo, A. (1957). *Rritja dhe shfrytëzimi racional për përmirësimin e racave*. Tiranë.
- DUDEN. (1997). *Deutsche Grammatik*. Mannheim.
- DUDEN. (1997). *Deutsche Grammatik*. Mannheim.
- Shkurtaç, Gj. (1977). *Emrat e kafsheve sipas ngjyres, Konferenca kombetare e studimeve etnografike*. Tirane.
- Helbig-Buscha. (1996). *Deutsche Grammatik*. Leipzig.
- Koss, G. (2002). *Namenforschung, Eine Einführung in die Onomastik*. Tübingen.
- Kutzelnigg, A. (1983). *Tiere nach Farben oder Farben nach Tieren benannt, in: Muttersprache 93*. Wiesbaden.

## **Necessity of English for tourism purposes in daily activities of tour guides**

**Luiz Seiti**

*University "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Albania*

### **Abstract**

Tour guides use passion and feelings to express a three dimensional view and provide depth of meaning to what is being shared. Language is the main tool which tour guides use to communicate with their audience. Students who have English as their second language (ESL) need not only to be taught new language skills but also educated in the principles, theories and ethos attached to interpreting a site. The paper will discuss how educators of translators and tour guides (including bilingual guides) need to be culturally sensitive and recognize ESL students and their differences.

### **Introduction**

I first started considering the issues associated with tour guides, interpreters and educators eighteen months ago and even though time has passed the topic remains valid. Having taught tour guiding for seven years to both local and international students and to both tourism and translating students, it occurred to me that site interpretation techniques should consciously be a part of my teaching methods. This led to me paying more attention to teaching students not just how to be a guide but to be aware of getting their message through and the consequences if they don't. For ESL (English as a Second Language) students the issues include not just the technique but the message as well as perhaps cultural differences.

Discussion will consider the issues involved with translators who have to not only translate a language but have to understand (whether written or oral) a message, agree with the information to some extent and be prepared to pass it on – what are the implications and issues if they don't? This paper will contemplate how we as educators can assist both the translator and interpreter in getting the message to the visitor. There are also many similarities between the role of an interpreter and that of an educator, as they both endeavor to convey a message to their respective visitors or students.

Methodology for this paper has been opportunistic and based on the hindsight gained from having worked as a tour guide and teaching in the industry. ESL students refer primarily to Asian students.

### **Issues for guides and translators**

#### **Safety**

Safety is a primary issue for guides. If translation of the message is incomplete or incorrect, not only could visitors misunderstand specifics of a site, they could easily be placed at risk. The story has been told of a group of visitors at a natural site, whose translator did not convey the full intention of the park ranger and consequently placed their visitors (customers) in danger, when the visitors and translator failed to follow the instructions as outlined by the ranger. An alternative strategy with less reliance just on the language component may have assisted the site interpreter to overcome this situation.



Japanese in particular regard obedience and respect highly and generally try to avoid risk (Reisinger & Turner, 2003), however if a translator does not convey the full message the tourists can definitely be at risk of 'losing face'.

### **Correct message**

Another problem is that if the message relies heavily on the language used then it risks either being misquoted or not having any words in the other language to which it can be translated. For many years 'Coca Cola' in Chinese translated as 'bite the wax tadpole' (Francesco & Gold, 1998). Similarly the following story shows the difficulties of dealing with complex questions and messages.

A Foreign Service linguist, while catching the evening news, discovered that a Vietnamese interpreter had simply given up when trying bridging the gap between a CBS reporter and a Vietnamese villager. The TV audience watched the reporter ask a question, heard it go back and forth between the interpreter and the villager and then heard the answer back in English. What the interpreter had done was simply ask the villager to count to ten, which he did. Then the interpreter reported what the villager might have said had he been able to understand the abstract ideas in the original questions (Fischer, 1980, 60).

Even within the English language words in one country can mean something different in another, for example the storage compartment of a car is a 'trunk' in America and a 'boot' in England and Australia. In Australia words can also have different meanings between states for example a 'port' can mean a drink, a harbor or a case, depending on your location.

Much of an interpreter's message can be lost and the experience diluted if the translator chooses to ignore the guide or significantly change the message. If as a tour guide we are talking to a group who have only conversational or phrase book English they may not be able to comprehend specialized explanations which are sometimes needed to interpret heritage or environmental sites (Aplin, 2002). The key then is to find alternative methods and to simplify technical terms without losing the context of the message. This applies equally to guides, translators and educators.

### **Language and the five senses plus one**

Traditionally language has been the main tool of tour guides as their role was seen as being more related to the social and administrative needs of the group and information rather than interpretation driven (Pond, 1993).

Research shows that 60% of communication is non-verbal, that is, how we say things, with only 7% relating directly to the content of the message (Pastorelli, 2003). From a retention perspective only 20% of what is heard is retained (James & Robertson, 2003). For a tour guide whose main tool is language it is crucial these figures are understood, especially when a translator is trying to interpret and then communicate your message.

The retention and success of communicating increases as other communication methods are introduced (James and Robertson, 2003) and less emphasis is placed on the actual coding presented by language (Van Der Wagen, 1997). Other tools or methods will introduce the other four senses of taste, sight, smell and touch alongside the sense of hearing. The visitor experience is improved when less reliance is placed on the written word and more on using all of their senses (Armstrong & Weiler, 2003), it also increases interaction and engages the visitor more. Interpretive guides who are passionate about

Teoricienët e së drejtës me frymëzim liberal kanë mbrojtur sistematikisht idealin e qartësisë të së drejtës duke u bazuar në parakushtin se, më pjesën dërrmuese të rasteve është e mundur të njihet *ex ante* ajo se, çfarë normat juridike parashkruajnë dhe parashikojnë për rastet konkrete. Neil MacCormick e përkufizon qartësinë e së drejtës si një besnikëri ndaj precedentit. “Një e drejtë është e qartë nëse përgjatë kohës, raste të ngjashme kanë gjetur zgjidhje të ngjashme. Në këtë mënyrë, qartësia është shprehje e kërkesës për besim, ruajtje dhe stabilitet të së drejtës në këndvështrim diakronik” (MacCormick, 1995). Duke integruar më tej në këndvështrimin e tij edhe funksionin e operatorit të së drejtës në raport me

qartësinë e së drejtës, MacCormick shpjegon se “arsyet që gjykatësit paraqesin publikisht për vendimet e tyre, duhet të jenë arsye që u lejojnë atyre të shfaqen për atë që supozohet se janë: shkurtimisht, arsye që tregojnë se, vendimet gjyqësore garantojnë një “drejtësi sipas të drejtës” dhe që së paku, në këtë kuptim, mund të konsiderohen arsye që ofrojnë përligjje” (MacCormick, 1978). Nuk ka dyshim se, pluralizmi i burimeve të prodhimit të së drejtës ka bërë që njohja *ex ante* e pasojave juridike të sjelljeve të individit social, pra qartësia e së drejtës, të komplikohet. Kalimi nga modeli i shtetit liberal, ku e drejta është e kufizuar në një bashkësi ligjesh formale të miratuar nga asamblëja përfaqësuese dhe e përmbledhur në formën e kodit, në shtetin kushtetues të së drejtës, ku e drejta është një sistem heterogjen, ka ndryshuar edhe qasjen ndaj qartësisë të së drejtës. Lidhur me këtë vështrim, Norberto Bobbio thotë se, në pozitivizmin juridik të ‘800 egzistonte një konsensus lidhur me idenë sipas së cilës “qartësia garantohej vetëm kur egzistonte një trup i qëndrueshëm ligjesh dhe ata që duhet të zgjidhin mosmarrëveshjet bazohen mbi normat që gjenden në atë trup dhe jo në kritere të tjerë: në rast të kundërt, vendimi bëhet arbitrar dhe qytetari nuk mund të parashikojë me siguri pasojat e akteve të tij. Pretendimi për qartësinë e së drejtës bën që juristi duhet të heqë dorë nga çdo kontribut krijues në interpretimin e ligjit për t’u kufizuar vetëm në bërjen e qartë përmes një procedimi logjik (silogjizmi) të asaj që është përcaktuar në mënyrë implicite në ligj” (Bobbio, 1961). Mirëpo, pluralizmi i burimeve të së drejtës sot e ka bërë të detyrueshëm tejkalimin e këtij kufizimi. Sot operatorët e së drejtës, për t’i bërë ballë këtij proliferimi, ndjejnë gjithmonë nevojën për t’iu drejtuar interpretimit juridik qoftë atij ekstensiv, qoftë atij analogjik, qoftë atij evolutiv, qoftë edhe parimeve të përgjithshme të sistemit juridik. Përmes kontributit të tyre krijues (pra, vendimeve) në procesin interpretues ata jo vetëm prodhojnë të drejtë, por e qartësojnë atë.

Sistemi juridik bashkëkohor, brenda kompleksitetit të tij, e bën pothuajse të detyrueshme që të njëjtat figura të disiplinohen në mënyra të ndryshme në raport me perimetrin normativ të burimeve të së drejtës të cilët, për vetë natyrën e tyre, i përkasin niveleve të shumëllojta të prodhimit. Pra, kompleksiteti i dinamikave juridike, mbi të cilat gërshetohen alternativa të ndryshme interpretimi, nuk mundëson identifikimim me qartësi të kategorive juridike që shërbejnë si referim. Sipas konceptit të teorisë së iuspozitivizmit normativist mbi qartësinë e së drejtës, që e drejta të jetë e qartë nuk është e nevojshme që ajo të bëjë të mundur parashikimin me saktësi të pasojave juridike të sjelljeve të individit por, është e mjaftueshme që ajo të mundësojë njohjen *ex ante* të mënyrave dhe kufijve të ushtrimit të pushtetit shtrëngues kur kjo bëhet në mënyrë të ligjshme. Sipas Ferrajoli-t “një e drejtë është e qartë në atë masë në të cilën ndërhyrjet e saj janë të parashikueshme dhe janë të parashikueshme vetëm ato që motivohen nga argumenta njohës tek të cilët, e vërteta formale, vendoset proceduralisht.” (Ferrajoli, 1989). Është e njohur se, për pozitivizmin normativist, qartësia nuk vlerësohet si një element tipik i fenomenit juridik sepse “e drejta duhet konsideruar, kryesisht si një objekt normativ ideal” (MacCormick & O. Weinberger, 1986). Edhe pse teoria normativiste ka një qasje relativisht skeptike rreth mundësisë të së drejtës për të mbërritur tek qartësia përmes procesit interpretues, pozicionet nuk kanë qenë statike. Hans Kelsen, për shembull, ka një evoluim mes të ashtuquajturit pozitivizëm i parë dhe i dytë. Tek versioni i parë i “Doktrina e kulluar e së drejtës” teoria e tij shfaqet si “teori e së drejtës pa interpretim” (Sanchis, 2011). Në pikpamjen e tij, interpretimi bëhet mbi një të drejtë tek e cila egzistenca është qartësuar ndërkaq, pavarësisht interpretimit. Duke iu përmbajtur tezës së tij të ndërtimit me nivele të sistemit juridik, brenda të cilit zbatimi i së drejtës egzistuese dhe krijimi i së drejtës së re janë ngushtësisht të lidhura, teoricieni austriak thotë se, interpretimi është “një operacion shpirtëror që bashkëshoqëron procesin e prodhimit të së drejtës në

orientimin e saj të ri nga një gradë më e lartë në një më të ulët të rregulluar nga ajo më e lartë” (Kelsen, 1956). Në koherencë me pikpamjen e tij mbi të drejtën si sistem piramidale, Kelsen sidoqoftë, pranon se burimi më i lartë mundet vetëm të përcaktojë një kornizë brenda së cilës ligjvënësi ose gjykatësi mund të ushtrojë diskrecionin e tij përmes procesit interpretues. Ky proces, nuk përbën gjë tjetër përveçse kompletionin vakumin normativ që mund të jetë krijuar nga autoriteti i nivelit më të ulët prej autoritetit të nivelit më të lartë. Për pasojë, procesi i aplikimit konkret të normave të përgjithshme dhe abstrakte përmes procesit interpretues ngelet një proces pashmangshmërisht krijuar, atëherë mundësia që subjekti të cilit i adresohet norma të parashikojë me saktësi çfarë do të vendosë organi ligjzbatues, që më pak fjalë nënkupton mundësinë për qartësinë e së drejtës, ngelet një iluzion. Vec kësaj, Kelsen i qëndron pozicionit të tij antiformalist përmes pikpamjes se, interpretimi i normës nuk çon domosdoshmërisht në identifikimin e një vendimi të vetëm të drejtë por, ecjen brenda një skeme që e ka paracaktuar norma e rangut më të lartë. Ai nënvizon se “fakti që një vendim bazohet mbi një normë nuk do të thotë gjë tjetër përveçse i përmbahet skemës që dizenjon ligji, nuk do të thotë ndërkaq se ajo është norma individuale por që, është një normë çfarëdo brenda normave individuale që janë të mundshme brenda skemës së normës së përgjithshme” (Kelsen, 1956). Antiformalizmi i tij i kundërvihet pikpamjes se, interpretimi i ligjit është një veprimtari e thjeshtë për qartësimin dhe kuptimin e të vetmes domethënie të saktë që rrjedh prej normës së nivelit më të lartë. Pikpamja mbi sistemin juridik si një sistem dinamik me strukturë piramidale, përputhet me konceptin e tij mbi qartësinë e së drejtës e cila është e kushtëzuar, qoftë prej identifikimit të saktë të përmbajtjes së të drejtës, qoftë prej aplikimit të kësaj përmbajtje, përmes procesit interpretues, në rastet e vecanta e qoftë prej koherencës mes niveleve të piramidës. Vecanërisht në versionin e tij të parë të iuspozitivizmit ai e vlerëson koherencën si parim i jokundërshtisë mes një norme të nivelit më të ulët dhe një norme të nivelit më të lartë. Sipas tij koherenca është kushti themelor për vlefshmërinë dhe vetë egzistencën e normës së nivelit më të ulët. Rrjedhimisht, koherenca është kusht për qartësinë.

Në këndvështrimin e Kelsen, modeli i sistemit juridik është dyformësh: i centralizuar dhe decentralizuar. Sipas modelit të parë, i gjithë prodhimi normativ i përket një organi të vetëm legjislativ. Ky lloj sistemi sipas Kelsen “vuan nga mungesa e fleksibilitetit por, ka avantazhin e qartësisë të së drejtës që konsiston në faktin se, vendimi gjyqësor, në një farë mënyre, është i parashikueshëm” (Kelsen, 1956). Kurse në sistemet e ashtuquajtura të decentralizuar, u takon gjykatave dhe organeve administrative të zgjidhin rastet sipas gjykimit të tyre” (Kelsen, 1956). Sipas këtij lloj sistemi, qartësia sakrifkohet përballë fleksibilitetit. Sigurisht, jemi në variantin ideal të kompozimit të sistemit juridik. Sistemet juridike reale e kanë të pamundur të plazmohen plotësisht sipas njërit apo tjetrit sistem por, ata ndërtohen duke respektuar pjesërisht njërin dhe tjetrin. Është mjaft domethënës transformimi, edhe pse jo radikal, i Kelsen në variantin e tij të dytë pozitivist. Ai rikonfirmon tezën e tij të “kornizës” si teza e interpretimit juridik antiformalist dhe antiskeptik njëherazi. Sipas tij, njohja e domethënies të brendshme të dënuara nga norma më e lartë, është “korniza” që kufizon diskrecionin e organit interpretues dhe vendimarrës. Por, në këtë version të dytë, Kelsen pranon edhe tezën e interpretimit autentik që praktikisht përfaqëson një lloj distancimi të pjesshëm nga teza e “kornizës”. Pozicioni i tij nxitet prej faktit se, në sisteme të ndryshëm, vendimet interpretuese të organeve ligjzbatuese mund të integrohen brenda të drejtës pozitive pavarësisht “kornizës” që imponon norma më e lartë. Sidoqoftë, për të shmangur cdo keqinterpretim, nuk mund të thuhet se Kelsen zhvendoset tek teoria skeptike e interpretimit. Zhvendosja e tij shkon maksimalisht tek diskrecionaliteti i kufizuar. Konkluzioni: për antiformalizmin e Kelsen, parimi i qartësisë

të së drejtës nuk mund të pretendohet si plotësisht i realizueshëm. Ai mund të jetë vetëm një pretendim i pjesshëm dhe një realizim po aq i pjesshëm. Ky lloj ambiguiteti në raport me qartësinë e së drejtës e modifikon pozicionin e Kelsen diku mes formalizmit absolut dhe antiformalizmit radikal.

### Shkolla anglosaksone

I të njëjtit konkluzion në raport me qartësinë e së drejtës por, për një shkak të ndryshëm nga ai i Kelsen, është edhe ai i pozitivistit të shkollës anglosaksone Herbert Hart. Pamundësia që të sigurohet qartësia e së drejtës buron, sipas Hart, jo nga këndvështrimi strukturor si në rastin e Kelsen por, për shkak të ndërvarësisë substanciale mes fenomenit juridik dhe gjuhës. Sipas tij, “në të gjitha fushat e eksperiencës dhe jo vetëm në atë të normave, ka një kufizim që gjendet tek natyra e gjuhës. Realisht egzistojnë raste të qarta që ndeshen në mënyrë konstante në kontekste të ngjashme në të cilët shprehjet e përgjithshme janë qartësisht të zbatueshme, por, do të ketë edhe raste në të cilët nuk është e qartë nëse ato zbatohen ose jo”. (Hart, 1961). Për Hart, brenda normës juridike egziston një zonë e skajshme, zona e gjysmëhijes që është më e vagullt dhe e paqartë që do të thotë se, çështja e domethënies së normës (sigurisht jo në të gjitha rastet), pra qartësia e së drejtës, është një problem. Problemi nuk mund të zgjidhet vetëm përmes instrumentave logjikë apo përcaktimit të disa kriterëve interpretues por, lipset aplikimi i diskrecionit të gjykatësit. Prej këtu buron pikpamja e tij mbi pamundësinë (sigurisht jo gjithmonë) e njohjes *ex ante* të vendimit gjyqësor. Gjuha, si strukturë e hapur që është (*open structure*), nuk mund të mos jetë e tillë edhe në rastin e së drejtës, e cila nga ana e saj operon përmes gjuhës. Kështu që, qartësia më shumë se komponente konstitutive e së drejtës ngelet një objektiv ideal i saj. Vetë konceptimi i sistemit juridik prej Hart si një sistem dyshtresor, ku njëra shtresë përbën kriteret e përgjithshme të sjelljes dhe shtresa e dytë që ka si objektiv përshtatjen dhe përforcimin e kriterëve të shtresës së parë, të krijon idenë e vështirësisë për të mbërritur tek qartësia e fenomenit juridik. Për Hart, interpretimi i së drejtës ka të bëjë pikërisht me komunikimin e kriterëve të sjelljes. Sipas tij interpretimi është mënyra me të cilën merret një komunikim dhe problematikat e interpretimit juridik qëndrojnë tek defektet organike që komunikimi gjuhësor mbart në vetvehte. Objekt i komunikimit është një kriter i përgjithshëm i sjelljes, që nënkupton se ai nuk mund të parashikojë të gjitha rastet ku mund të zbatohet. Me pak fjalë është i papërcaktueshëm. Paqartësitë për të kuptuar dhe përthithur pikat esenciale të objektit të komunikimit, pra kriteret e sjelljes, të çojnë logjikisht tek konkluzioni se qartësia e fenomenit juridik është problematik.

### Shkolla skandinave

Për realizmin skandinav (Ross, Olivercrona, Lundstedt) interpretimi është substancial brenda së drejtës, sepse është i pamundur aplikimi i normës me domethënie univoke. Diskrecionaliteti i gjykatësit merr një vlerë absolute aq sa për Ross, ndonëse në përputhje me pikpamjen e tij të rregullshmërisë objektive ose racionalitetit formal, “e drejtë reale janë vendimet e gjykatësve, kurse normat që gjenden në tekste apo kode janë një e drejtë e supozuar”. Sipas tij, përpara vendimit të gjykatësit nuk egziston e drejta, nuk egziston ligji. Para se gjykatësi të shpallë vendimin egzistojnë vetëm rregulla por, jo norma. Norma lind pasi gjykatësi identifikon rregullin dhe shpall vendimin. Ross bënë një dallim mes interpretimit juridik si veprimtari dhe interpretimit juridik si rezultat. Me konceptin e parë ai kupton gjithë veprimtarinë përmes së cilave interpretuesi synon që t'i japë një



domethënie dispozitive normative. Me konceptin e dytë ai kupton produktin që del nga kjo veprimtari e cila mund të jetë vetëm interpretim i së drejtës egzistuese ose mund të konsistojë në prodhimin e një norme të re, pra, në mbushjen e një zbrazëtie të së drejtës, si për shembull në ato raste kur interpretimi përputhet me *analogia iuris*, *analogia legis* ose argumentimi *a fortiori*. Në ndryshim nga Kelsen, në pikpamjen e të cilit prevalon vlefshmëria formale, tek Ross është vlefshmëria substanciale. Nëse për Kelsen qartësia e së drejtës gjendet tek aplikimi korrekt i ligjit, te Ross, qartësia e së drejtës transformohet në “parashikueshmëri”. Një normë juridike e formalizuar nuk mund të marrë në konsideratë të gjitha rrethanat kryesore të rastit konkret. Kjo bën që të lind një konflikt mes prirjes për drejtësi formale nga njëra anë, dhe dhe prirjes për barazvlefshmëri nga ana tjetër. Ky kontrast thellohet kur këto norma hartohen duke i lënë hapsirë diskrecionit të gjykatësit. Kjo sepse hartuesi i normës pashmangshmërisht formulon norma të mjegullta. Kjo sepse, sipas realistëve, është e pamundur të njihet domethënia leterale e një norme sepse kjo domethënie është rezultat i shumë variablave në rrethana të ndryshme. Kjo mjegull e normës bënë që detyrimisht gjykatësi të ushtrojë diskrecionin e tij, edhe pse duhet thënë që ky diskrecion vepron brenda disa standarteve juridike të paracaktuara. Duke u rrikthyer tek racionaliteti formal, për realistët skandinav, ai është jo vetëm themeli i gjithë sistemit juridik, por edhe çelësi që bënë të parashikueshëm sjelljet e individit në raport me të drejtën duke garantuar kësaj qartësinë e saj. Përplasja e tyre me shkollën iuspozitiviste buron prej konceptit të këtyre të fundit të cilët i përshkruajnë normat si duhen aplikuar dhe jo si janë. Kjo, sipas realizmit skandinav, nuk bën gjë tjetër përveçse prodhon një ngatërrim të rrezikshëm mes faktit dhe vlerësimit të tij. Në gjykimin e tyre, e drejta duhet të merret eskuzivisht me aspektet e saj reale sepse janë pikërisht këto që ndikojnë në sjelljen e individit. Duke qenë pjesë e teorisë skeptike të interpretimit, ata logjikojnë se formulat interpretuese nuk janë as të vërteta dhe as të pavërteta, sepse nuk përshkruajnë domethënien e dispozitës që kanë për objekt. Fakti që për Ross e drejta ndërtohet vetëm mbi një tip të caktuar norme, pra norma e sjelljes që i adresohet gjykatave, do të thotë se ajo ofron norma për sjelljen e gjykatave dhe jo individëve. Kjo qasje shpjegon edhe raportin e shprishur mes interpretimit dhe qartësisë të së drejtës, brenda së cilit qartësia ka një rol marginal.

### Shkolla amerikane

Në sintoni të plotë më shkollën skandinave por, në një version më radikal sa i takon raportin mes qartësisë të së drejtës dhe teorisë skeptike të interpretimit, është realizmi juridik amerikan (Frank, Holmes, Cardozo). Për këtë orientim teorik, vlefshmëria e së drejtës identifikohet me efektivitetin e saj, efektivitet që duhet zbuluar vetëm në sjelljen e gjykatësit. Me pak fjalë e drejtë është vetëm ajo që aplikohet në gjykata. Holmes, i cili për të shpjeguar se çështë e drejta, përdor logjikën e *bad man*, thotë se “...për *bad men*, nuk kanë shumë rëndësi aksiomat ose deduksionet. Ajo çfarë i intereson atij të dijë është se si do vendosin gjykatat e Massachusetts ose të Anglisë. “Unë për të drejtë nuk kuptoj asgjë më shumë pretencioze sesa parashikimi i asaj që efektivisht do bëjnë gjykatat” (Holmes, 1963). Në të njëjtën linjë qëndrimi është edhe Frank sipas së cilit, sa herë që një gjykatës merr një vendim ai prodhon të drejtë. Brenda kësaj shkolle, koncepti i qartësisë relativizohet pikërisht pse ndërtohet një identikit i gjykatësit krejt i ndryshëm nga ai i gjykatësit në sistemet e ashtuquajtura kodiciste, kryesisht ato kontinentale për të cilat qartësia e së drejtës ngelet një kriter absolut i cili më së shumti buron prej qartësisë së normës në vetvehte sesa prej diskrecionit në procesin interpretues të gjykatësit. Brenda

nënvarianeteve të tij, modeli i interpretimit skpetik, jo rrallë është kritikuar *a priori* si një formë e irracionalizmit juridik dhe si një kërcënim serioz për qartësinë e së drejtës dhe zbatimin e saj në praktikë. Mirëpo kjo nuk përputhet plotësisht me të vërtetën sepse teoria e ermeneutikës skeptike, tek e cila mbështetet shkolla e realizmit juridik, themelohet mbi argumentin gjuhësor, logjik dhe juridik, fakt ky që provon natyrën pashmangshmërisht diskrecionale të interpretimit juridik por që, nuk eliminon *a priori* arsyet e qartësisë të së drejtës. Ajo thjeshtë evidenton kufizimet e saj.

Teoricieni më përfaqësues i së drejtës moderne amerikane, Ronald Dworkin, e vështron problemin e marrëdhënies mes interpretimit juridik dhe qartësisë të së drejtës nga kategoritë “*hard cases*” dhe “*easy cases*”. Ai bën një rielaborim të teorisë iuspozitiviste të Hart duke iu referuar dy kategorive të mësipërme dhe mbërrin në disa përfundime: a) ka disa raste të vështira që lidhen me paqartësinë e formulës normative; b) në rastet e vështira nuk mund të flitet për një zgjidhje juridike unike; c) në rastet e vështira është gjykatësi përmes diskrecionit të tij në interpretim që vendos; d) për të gjitha arsyet e mësipërme, gjyqtari, brenda diskrecionit të tij, është i detyruar të marrë një vendim i cili përputhet më mirë me të mirën kolektive. Mirëpo, në koherencë të plotë edhe me pararendësit e tij Fuller, Cardozo, Sacks, Hart, teoricieni amerikan mendon se, një gjykatës mund t’i qëndrojë besnik qartësisë të së drejtës edhe në rastet e vështira. Është mjaft e rëndësishme të nënvizohet se, diskrecioni i gjykatësit në këndvështrimin e Dworkin nuk mund të jetë një diskrecion që shkon në kufijtë e arbitraritetit që do të dhunonte përfundimisht qartësinë e së drejtës. Ai ngelet një diskrecion i kontrolluar. Çdo të thotë i kontrolluar? Do të thotë që, edhe në rastet kur egziston një vakum normativ, diskrecioni i gjykatësit në momentin interpretues kufizohet nga parimet të cilët përbëjnë kritere gjykimesh të detyrueshme për gjykatësit. Ky është themeli teorik mbi të cilin Dworkin mbështet qasjen e tij se, pavarësisht gjithshkaje, egziston vetëm një përgjigje e drejtë dhe korrekte në një vendim dhe se, kjo përgjigje duhet pranuar si zgjidhja që përputhet me filozofinë politike e cila nga ana e saj, përlligj gjithë rendin juridik. Pozicioni i Dworkin mbështetet tek e ashtuquajtura “teza e të drejtave” që do të thotë se, përlligja e një vendimi gjyqësor bazohet tek respektimi i të drejtave individuale të palëve në proces. Pra, kur gjykatësi bazohet tek parimet, praktikisht ai nuk bën gjë tjetër përveçse sillet si një iusnatyralist që njuh dhe respekton prerogativat (të drejtat) e individit të cilat egzistojnë më parë se të egzistojë e drejta pozitive. Por, ai nuk sillet si ligjvënës sepse nuk krijon të drejtë të re. Sigurisht, qëndrimi i Dworkin përmban brenda tij mjaft paqartësi. Meqënëse pranohet se, norma juridike nuk mund të jetë standart që na çon pashmangshmërisht tek qartësia e së drejtës, nuk ka pse të mos lindin dyshime edhe rreth kapacitetit të parimit për t’u marrë si standart. Mundet që edhe parimet të rezultojnë joeficientë për të zgjidhur një *hard cases*. Paqartësia tjetër qendron tek dualizmi mes asaj që gjykatësit bëjnë dhe asaj që duhet të bëjnë. Përveç të tjerash, paqartësia e Dworkin është e debatueshme edhe sepse, ngelet e pashpjegueshme në mënyrë të qartë procedura sesi do të bëhet përzgjedhja e parimit mbi të cilin do të bëhet justifikimi i interpretimit dhe sesi kjo mund të garantojë qartësinë e së drejtës. Si mundet të bashkëjetojë koncepti dworkinian “interpretimi më i mirë i mundshëm” me konceptin “qartësi e së drejtës”? Madje, sipas Andrei Marmor, teoria e Dworkin nuk arrin që t’i japë përgjigje pyetjeve të tilla si p.sh. çfarë është e drejta? çfarë përcakton e drejta mbi rastin konkret? çfarë duhet që të përcaktojë e drejta mbi rastin konkret? Nga pozicioni i tij i teorisë ligjore, Marmor e kritikon jurisprudencën analitike të Dworkin dhe marrëdhëniet mes argumentimit teorik dhe praktik sepse sipas Marmor, “jurisprudenca analitike përpiket të kuptojë ajo se çfarë ligji është dhe jo përse duhet që të respektojmë ligjet” (Marmor, 1992).

## Shkolla gjenoveze

I përket orientimit teorik neoskeptik shkolla gjenoveze e interpretimit juridik (Tarello, Guastini). Një nga tezat themelore të kësaj shkolle është dallimi mes koncepteve dispozitë dhe normë. Sipas Guastinit, “dispozita është teksti i dokumentit ligjor, objekt i interpretimit kurse norma është përmbajtja e domethënies së tekstit” (Guastini, 1996). Norma është rezultati i procesit interpretues dhe mund të shprehet nga dispozita të ndryshme. Dispozita nga ana e saj mund të shprehë një pluralitet normash. Pikërisht ky dallim është në fillësë të skepticizmit interpretues të kësaj shkolle sipas së cilës, qartësia e së drejtës realizohet kur interpretimi juridik nuk konsiderohet si një akt zbulimi i përmbajtjes së tekstit normativ por, si një akt vullneti që nënkupton krijim domethëniesh. Mjafton të kujtojmë faktin se, fiziologjikisht, një tekst normativ mund të përmbajë antinomi, pra, është rrethana kur një rast konkret mund të prodhojë dy zgjidhje të ndryshme apo edhe të kundërta. Kjo, jo vetëm mund të godasë parimin e barazisë por, të kompromentojë edhe qartësinë e së drejtës. Shmangia e kësaj situatë mund të arrihet vetëm kur interpretimi i normës nuk konceptohet si një proces i ngushtë aplikativ i një norme mbi një *casus*. “Ligji kur përdoret, jo vetëm interpretohet në kuptimin e zakonshëm të fjalës por, ai gjithmonë “ integrohet”prej interpretit. Në këtë kuptim “interpretim i ligjit” do të thotë dicka më shumë se “interpretim” në kuptimin e zakonshëm ateknik”( Tarello, 1974).

Si të gjitha shkollat e tjera të skepticizmit interpretues, edhe varianti i shkollës gjenoveze është kritikuar si një formë e irracionalizmit juridik dhe si një kërcënim për qartësinë e së drejtës. Për neoskeptikët gjykatësi, por edhe juristët brenda sferës së tyre të kompetencave, kanë detyrën t’i japin konkretësi mesazheve normative të ligjvënësimit të cilat mund të kompletohen në aspektin semantik vetëm përmes procesit interpretues. Nëse pranohet kjo si tezë, duhet që detyrimisht të pranohet, thonë neoskeptikët se, norma, pra domethënia, në ndryshim nga dispozita, është akt krijues që realizohet përmes interpretimit. “Domethënia nuk i paraprin procesit interpretues sepse është një variabël i vlerësimeve dhe vendimeve të subjektit interpretues. Zgjedhja për t’i dhënë një norme një domethënie të caktuar dhe jo një tjetër, është frut i vullnetit dhe jo i njohjes”. (Guastini,1996). Mirëpo, interpretimi nuk është qëllim në vetvehte. Të zbulosh përmbajtjen e domethënies, praktikisht do të thotë të qartësosh të drejtën. Në këtë kuptim norma juridike është pikëmbërritja e procesit interpretues që e ka zanafillën tek dispozita. Për doktrinarët gjenoveze nuk egziston ndonjë dallim cilësor mes “rasteve të qarta” që nuk kanë nevojë t’i nënshtrohen interpretimit dhe “rasteve të dyshimta” të cilët kanë nevojë të interpretohen. Jo! Në pikpamjen teorike të kësaj shkolle, një dispozitë ka vetëm një mundësi për të qenë e qartë: të interpretohet!

## Jonathan Wroblewski

Së fundi, besoj së është mjaft interesante teoria e një juristi tjetër bashkëkohor, amerikanit Jonathan Wroblewski. Qartësia në këndvështrimin e tij gjendet sigurisht në një raport të qartë ndërvarësie me interpretimin juridik. Mirëpo, gjithë procesi interpretues duhet të orinetohet mbi dy “ideologji” kryesore interpretimi: ideologjia statike dhe ideologjia dinamike. Çdo të thonë njëra dhe tjetra? Ideologjia statike identifikohet me vlerat statike të qartësisë të së drejtës, të parashikueshmërisë së vendimeve gjyqësore, të qendrueshmërisë diakronike të së drejtës në raportet sociale. Shkruan Wroblewski: “Këto vlera kërkojnë që rregullat juridike të kenë një domethënie të pandryshueshme. E drejta është e qartë në atë masë sa është e qartë e drejta legislative, ose, nuk ndryshon nëse nuk ndryshon e drejta legislative. Një mungesë e tillë ndryshimi në interpretimin juridik është e lidhur me idenë se, domethënia e një rregulli

juridik nuk ndryshon nëse nuk ndryshon vetë rregulli.” (Wroblewski, 1987, 65). Thënë me fjalë të tjera, qartësia e së drejtës sipas këtij pozicioni nuk buron prej interpretimit por,prej normës së “re”. Mund të flitet për një “qartësi të re” vetëm nëse kemi një ndryshim të së drejtës legjislativë. Pozicioni relativizon thelbësisht, për të mos thënë eliminon, pozicionin e operatorit të së drejtës (gjykatësit) si një interpret i së drejtës. Ideologjia dinamike nga ana tjetër identifikohet me një supervlerë, që sipas Wroblewskit, është përshtatja diakronike e së drejtës me egzgjencat e trupit social. Ky objektivi kërkon një kooperim mes operatorëve të së drejtës për të identifikuar apo “zbuluar” zgjidhjet më cilësore brenda kontekstit hapsirë-kohë. Ky këndvështrim e rikualifikon kësaj rol in e posaçëm të gjykatësit-interpret në procesin interpretues sepse qartësia e së drejtës, sipas kësaj qasje, është një koncept i ndryshueshëm në hapsirë dhe kohë dhe se,zbulimi i domethënies së rregullit juridik është një proces dinamik brenda dinamikës së trupit social. Sipas Wroblewskit “Domethënia e rregullave juridike nuk është asesi një fakt i së shkuarës i ndërlidhur me barrierat e sforcuara të vullnetit të ligjvënësit historik. Nëse gjërat do të ishin kështu, e drejta do të ishte si një qeveri e te vdekurve mbi të gjallët. Domethënia e normave ndryshon në atë masë që ndryshojnë kontekstet” (Wroblewski, 1987, 66). Pikërisht ky vështrim të çon në konkluzionin se, interpretimi në vetvehte është një akt dinamik dhe jo thjeshtë një “përkthim” i normës që nwnkupton se,është në cdo rast një akt krijimi i së drejtës dhe se, qartësia e së drejtës i përshtatet kësaj dinamike ngaqë është, esencialisht, produkt i saj.

### Konkulzione

Marrëdhënia mes interpretimit juridik dhe qartësisë të së drejtës ngelet një nga ballafaqimet më të artikuluar në teoritë juridike moderne. Ndonëse një debat i shtrirë në kohë, ai vijon të mos ketë prodhuar një përgjigje të unifikuar lidhur me pyetjen themelore: e drejta është e qartë ashtu si është dhe procesi interpretues thjeshtë, plazmon intencionin e ligjvënësit apo qartësia e së drejtës është një koncept dinamik që reflekton mutacionet sociale dhe se, mund të arrihet vetëm përmes procesit interpretues? Ka një logjik brenda kësaj papërcaktueshmërie e cila lidhet qoftë me domethëniet e shumta që ka koncepti “qartësi e së drejtës”, qoftë me pluralitetin e korrenteve teorike mbi konceptin “interpretim juridik”. Ky shkrim, sigurisht që nuk ka për qëllim t’i përgjigjet pyetjes së mësipërme por, vetëm të rikujtojë egzistencën e këtij debati.

### Bibliografia

- Bobbio, N. (1961). *Il positivismo giuridico*. Torino: Giapichelli.  
Ferrajoli, L. (1989). *Diritto e ragione. Teoria del garantismo penale*.Bari: Laterza.  
Guastini, R. (1996).*Distinguendo:Studi di teoria e metateoria del diritto*,Torino: Giapichelli.  
Hart, H. (1961). *The Concept of Law*, Oxford: Oxford University Press.  
Holmes, O.W. (1963). *The Common Law*, Massachusetts:Mark DeWolfe Howe.  
Kelsen, H. (1956). *La dottrina pura del diritto*.Torino: Einaudi.  
MacCormick, N. & Weinberger, O. (1986). *An Institutional Theory of Law*.New York: Springer.  
MacCormick, N. (1978 ) *Legal Reasoning and Legal Theory*. Oxford: Clarendon Press.  
MacCormick, N. (1995). *Rhetoric and the Rule of Law*. Oxford. Oxford University Press.  
Marmor, A. (1992) *Interpretation and legal Theory*. Oxford. Oxford University Press.  
Sanchis L. P. (2011). *La teoria del diritto nei “principia juris di Luigi Ferrajoli*.Milano.Led Milano.  
Tarello, G. (1974). *Preliminari a una teoria dell’interpretazione giuridica*.Bologna. Mulino.  
Wroblewski, J. (1987). *Outline of a General Theory of Legal Interpretation and Constitutional Interpretation*, *Folia Juridica*,f.65, 66.

## Kapitali human, si faktor i zhvillimit ekonomik

**Albulena Mavraj**  
Univeristeti i Prishtinës  
Gazetare- Epoka e re

### Abstrakt

Investimet në Kapitalin Human, janë afatgjata, pasi njeriut mund t'i shërbejnë gjatë gjithë jetës, duke u bërë kështu bagazhi më i lehtë që njeriu mund ta bartë dhe shkëmbejë me vendet e globit. Më anë të Investimeve në Kapitalin Human, njeriu mund të jetë i dobishëm për veten e tij familjen dhe vendin, duke bërë kështu që të gjenerojë të ardhura më të mëdha, njëherësh të ndikojë dhe në ngritjen ekonomike të vendit, duke ndikuar kështu dhe në tërheqjen e Investimeve të Huaja, e me anë të kësaj duke ndikuar dhe në përmirësimin e imazhit të një vendi dhe ngritjen e kapitalit social. Adam Smithi, në vitin 1776, ishte i pari që vuri në dukje analogjinë midis rritjes së shkallëve, nivelit të arsimit dhe investimit për të blerë një makinë. Ai theksonte se një njeri, i cili shpenzon shumë kohë dhe punë dhe vullnet për të mësuar, mund të krahasohet me një investim që bëhet për të blerë një makineri të shtrenjtë. Prandaj, duke pasur parasysh që Kosova, posedon avantazhe krahasues me forcën punëtore më të re dhe më të lirë në rajon, sipas Entit të Statistikave të Kosovës, del se të rinjtë e moshës 15-24 vjeçare përbëjnë 55.9 për qind të shkallës së papunësisë. Referuar në këtë të dhënë është më së e domosdoshme shtimi i Investimeve në Kapitalin Human.

**Fjalë kyçe:** Kapitali human, Zhvillimi profesional, Zhvillimi ekonomik i Kosovës, Përparësi Krahasuese, Tërheqje e Investimeve të Huaja.

### Hyrje

Në globalizmin e sotëm, investimet në kapitalin human, janë faktorë përcaktues të zhvillimit ekonomik të ardhmes individuale, duke u gërshtuar kështu dhe me zhvillimin ekonomik të një vendi. Zhvillimi i hovshëm teknologjik, lëvizja e kapital dhe investimet e ndryshme nga ana e korporatave nacionale, kërkojnë gjeneralisim të diturive, ideve, shkathtësive dhe hulumtimeve për t'u futur në tregun e mallrave dhe shërbimeve. Mirëpo, njeriut për t'i gjeneralizuar dituritë, përpos shkathtësive të lindura, i nevojitet kohë e gjatë, mosndarje nga rruga e dijës dhe mësim gjatë gjithë jetës.

Ekonomia botërore gjatë vitit 2008 është përballur me krizë të rëndë financiare, e cila ka pasur influencë shumëdimensionale, përfshirë edhe rritjen e konkurrencës për punësim. Papunësia është bërë barrë e rëndë për shumë vende të zhvilluara, e sidomos në vendet në transicion, siç është tasi i Kosovës. Prandaj, për t'i rezistuar kohës dhe për ta pasur një mbijetesë më të mirë në të ardhmen, investimet në kapitalin human, janë faktorë të rëndësishëm, si për ekonominë e tregut, ashtu dhe për vetveten.

### Kapitali human karshi atij fizik

Nocioni i investimit përfshinë një spektër të gjerë të aktiviteteve të njeriut. Në këtë aspekt, në kuptimin e gjerë investimi nënkupton angazhimin e mjeteve financiare në: patundshmëri, letra me vlerë dhe aksione, projekte prodhuese dhe shërbyese, studime dhe kërkime shkencore, zhvillimi teknologjik, përsosje të proceseve teknologjike, krijimin e produkteve të reja, pushtimit të tregjeve të reja dhe arsimimin e personelit. Investimet

në kuptimin e plotë të fjalës janë parakusht themelor i arritjes së qëllimeve zhvillimore. (Halili & Gogiqi, 2013)

Kapitali Fizik, sipas konceptit fizik të kapitalit siç është fuqia operative, kapaciteti i prodhimit të ndërmarrjes është i bazuar në, p.sh, njësitë e dhëna për ditë Kapitali njerëzor: tërësia e njohurive dhe aftësive teknike që zotëron fuqia punëtore e një vendi e fituar përmes arsimit formal (shkollës) kualifikimit ose duke punuar. (Skenderi, 2010)

Ashtu si çdo investim tjetër, rritja në nivelin e investimit në kapitalin human kërkon me domosdoshmëri të kryesh shpenzimet sot, në kohën e tashme, për të përfituar më shumë në një kohë të ardhme. Megjithëse, Smithi pranonte që përfitimi pas kryerjes së investimit në kapitalin human duhet të ishte të paktën i barabartë me përfitimin në investimin në formën e kapitalit fizik (makinë), ekonomistët theksojnë se , në kushte të tjera të pandryshueshme, përfitimi nga një investim në kapitalin human, duhet të jetë më i lartë se sa përfitimi në investimi në kapitalin fizik më qëllim që të garantohet kryerja e këtij investimi.

Duhet të theksojmë se megjithëse ka një analogji midis investimit në kapitalin fizik (blerjes së makinës), dhe investimit në arsimit (trajnim) përsëri ekzistojnë në thelb dallime të rëndësishme midis tyre. Një firmë kur kryen një investim për të blerë një makineri pas këtij akti të shitblerjes ajo siguron edhe të drejtën e pronësisë mbi këtë makinë. Një situatë e tillë nuk ndodh me investimin të kapitalit human. Përveç shoqërisë skllavopronare, ose në raste të rralla kur një individ e detyron veten ligjërisht të punojë për një firmë në një periudhë të caktuar, firmat nuk mund të bëjnë pronë të tyre individin që ofron punë, pra nuk mund të gëzojnë të drejtën e pronësisë mbi individin.

Ideja se një investim në kapitalin human, në formën e rritjes të nivelit të arsimit dhe në formën e përgatitjes nëpërmjet punës (on the job training), është i ngjashëm me një investim që kryhet për të kryer një investim në kapitalin fizik, për shembull për të blerë një makinë, nuk është e re. (Qiriqi, 2005)

### **Gjeneza e kapitalit human ose**

Adam Smithi në vitin 1776, ishte i pari që vuri në dukje analogjinë midis rritjes së shkallëve, nivelit të arsimit dhe investimit për të blerë një makinë. Ai theksonte se, një njeri i cili shpenzon shumë kohë dhe punë dhe vullnet për të mësuar mund të krahasohet me një investim që bëhet për të blerë një makineri të shtrenjtë. Dhe ashtu si makina me punën që do të kryejë do të vërë në vend shpenzimet e investimit dhe të paktën do të sigurojë një fitim të zakonshëm, edhe njeriu i arsimuar me punën që do të kryejë pas arsimimit (trajnim) të tij, duhet të marrë një pagë më të lartë se paga e zakonshme, më qëllim që të mbulojë shpenzimet që ka bërë për arsimimin (trajnim) e tij dhe të paktën të marrë të ardhura më të larta në të ardhmen.

Adam Smith argumentonte se diferencat në pagë midis individëve që zotëronin nivele arsimimi dhe përgatitje profesionale të ndryshme, reflektonin diferencat në shpërblim pas arsimimit dhe trajnimit, të domosdoshëm këto për të shlyer kostot të domosdoshme për të realizuar përfitimin e njohurive, aftësive të reja që nuk i kishte më parë.

Si konkluzion mund të themi se çdo aktivitet që kërkon të kryesh shpenzime në periudhën korente dhe që synon të rritë produktivitetin në periudhat e ardhshme, mund të analizohet brenda kuadrit të teorisë së investimeve. Prandaj edhe në tregun e punës çdo aktivitet që rrit cilësinë e forcës punëtore ( produktivitetin e saj), duhet të konsiderohet si një investim në kapitalin human. (Qiriqi, 2005).

Arsyeja fillestare që standardet e jetesës janë më të larta sot se sa një shekull më parë është

se njohuria teknologjike ka përparuar. Telefoni, transitori, kompjuteri dhe monitori me djegës të brendshëm, janë mes mijëra novatorizmave që kanë përmirësuar aftësinë për të prodhuar mallra dhe shërbime.

Megjithëse pjesa më e madhe e përparimit teknologjik vjen nga kërkimet private të firmave dhe nga shpikësit individualë, ekziston gjithashtu një interes publik në promovimin e këtyre përpjekjeve. Në një shkallë të madhe, ditura është një mall publik: qysh kur një person zbulon një ide, ideja hynë në rezervë publike të diturisë dhe njerëzit e tjerë mund ta përdorin lirishtë atë. Po ashtu si Qeveria ka rol në sigurimin e mallrave publike, siç është mbrojtja kombëtare, ajo po ashtu ka rol në inkurajimin e kërkimit dhe të zhvillimit të teknologjive të reja. Qeveritë në vendet më të zhvilluara, e bëjnë këtë në një numër mënyrash, për shembull nëpërmjet laboratorëve të kërkimit shkencor, të zotëruar dhe të financuar nga qeveria, ose përmes një sistemi të bursave kërkimore të ofruara për studiuesit premtues. Duke i lejuar shpikësit të përfitojnë nga shpikjet e tyre, qoftë edhe vetëm përkohësisht, sistemi i patentave shton stimulimin për individët dhe për firmat që të angazhohen në kërkim. (Mankiw & Taylor, 2013).

Gjatë 30 viteve të fundit është përmirësuar aftësimi dhe kualifikimi mesatar i evropianëve. Në të njëjtën periudhë, janë zvogëluar ndjeshëm pabarazitë midis dy gjinive. Vajzat e brezave më të rinj i kanë kaluar pak djemtë për sa i përket nivelit të studimeve. Po thuaj se në të gjitha vendet anëtare ka më shumë vajza se djem që ndjekim studimet e larta. Qëllimet e strategjisë së Lisbonës, të përpunuara në vitin 2000 e vënë theksin tek domosdoshmëria e përmirësimit cilësor të sistemeve të arsimit dhe të aftësimit të vendeve anëtare dhe bashkëpunimit të përforcuar midis shteteve në këto fusha. Aktualisht, shpenzimet publike të vendeve të BE-së për shkollimin dhe arsimimin janë ndër më të lartat në të gjithë botën. Po ashtu, niveli i shkollimit dhe i arsimit është ndër më të lartit. Mesatarisht, të rinjtë e 25 vendeve të Bashkimit Evropian i mbarojnë studimet në moshë 17-19 vjeç.

Megjithatë, ekzistojnë dallime të theksuara midis vendeve që nuk shpjegohen vetëm me dallimet në nivelin e zhvillimit ekonomik. Danimarka, Suedia, Finlanda, i kushtojnë një pjesë të madhe të PBB-së, së tyre arsimit, po kështu veprojnë edhe Qipro, vendet baltike, Sllovenia, ose Portugalia që janë më pak të zhvilluara ekonomikisht. Për sa u përket shpenzimeve të përvitshme në arsim për studentë në raport me PBB-në për banorë, disa vende shkëputën ndjeshëm, sidomos Suedia dhe Danimarka, rezultatet e të cilave janë të afërta me ato të SHBA-së. (Letessies, Silvano, Soin, 2009).

### **Rëndësia e investimeve në kapitalit human**

Arsimi, investimi në kapital njerëzor, është për suksesin ekonomik afatgjatë të një vendi të paktën po aq i rëndësishëm sa edhe investimi në kapitalin fizik. Në ekonomitë e zhvilluara të Evropës Perëndimore dhe të Amerikës Veriore, çdo vit shtesë i shkollimit rrit të ardhurat e një punëtori mesatarisht me rreth 10 për qind. Në vendet me pak të zhvilluara, ku kapitali njerëzor është veçanërisht i pakët, hendeku ndërmjet pagave të punëtorëve të arsimuar dhe të paarsimuar është edhe më i madh. Pra, një mënyrë me të cilën politika qeveritare mund të rritë standardin e jetesës, është të sigurojë shkolla të mira dhe të inkurajojë popullsinë të përfitoj prej tyre.

Investimi në kapitalin njerëzor, ashtu si edhe investimi në kapitalin fizik ka një kosto oportune. Kur studentët janë në shkollë, ata heqin dorë nga pagat që ata do të mund të kishin fituar. Në vendet më pak të zhvilluara, fëmijët shpesh largohen nga shkolla në një moshë të hershme edhe pse përfitimet nga shkolla shtesë është shumë i lartë, thjeshtë sepse krahu i tyre i punës nevojitet për të ndihmuar në mbajtjen e familjes.

Disa ekonomistë kanë argumentuar se kapitali njerëzor është veçanërisht i rëndësishëm për rritjen ekonomike sepse kapitali njerëzor përçon eksternalitete pozitive. Një eksternalitet është ndikimi i veprimeve të një personi mbi mirëqenien e një sositësi. Një person i arsimuar për shembull, mund të gjenerojë ide të reja se si të prodhojë mallra dhe shërbime në mënyrën më të mirë. Në qoftë se këto ide hyjnë në rezervën e dijes së shoqërisë, në mënyrë që secili të mund të mund t'i përdor ato, atëherë idetë japin një përfitim i jashtëm nga arsimiti. Në këtë rast, fitimi nga shkollimi për shoqërinë është madje edhe më i madh sesa fitimi për individin. Ky argument do t'i justifikonte subvencionet e mëdha për investime në kapitalin njerëzor që ne e vëmë re në formën e arsimit publik. (Mankiw & Taylor, 2013). Në mars të viti 2000, Samiti i Lisbonës caktoi si objektiv për ekonominë e BE-së që të bëhet ekonomia e njohjes më efikase në botë. Në këtë perspektivë, ndjekja e përpjekjeve të bëra në kërkim dhe zhvillim, motorë të vërtetë të rritjes, të inovacionit, dhe krijimit të vendeve të punës, jep informacione të sakta mbi gjendjen e avancimit të "Strategjisë së Lisbonës".

Në përgjithësi, aktivitetet e kërkimit shkencor dhe të zhvillimit përfshijnë të gjitha punimet që kontribuojnë në zgjerimin e njohurive, qoftë kur kanë të bëjnë me fushën e eksperimentale, ashtu edhe me atë të zbatimeve. Gjithashtu, shpenzimet e brendshme bruto të kërkimit dhe zhvillimit të bëra nga aktorë të ndryshëm të ekonomisë përbëjnë treguesit kyç të përpjekjeve për modernizim të shoqërive dhe mundësojnë krahasime ndërkombëtare.

Për të përcaktuar Shpenzimet e Brendshme për Kërkime shkencore dhe Zhvillim (ShBKZh) përdoren katër tregues: ShBKZh si % e PBB, pesha respektive e ShBKZh të financuara nga ndërmarrjet kombëtare ose rajonale, nga pushteti publik, nga aktorët e huaj.

Që prej 10 vitesh, niveli i rritjes globale të ShBKZh në të gjitha vendet aktuale të BE-së, me 25 ka qenë pozitiv, por rezultatet mbetën shumë pas atyre të SHBA-së dhe Japonisë. Brenda BE-së diferencat janë të dukshme dhe vetëm Gjermania, Finlanda, Franca, Suedia, ShBA kanë një nivel kërkimi shkencor dhe zhvillimi që eskaloni 3% të PBB-së të fiksuar nga Këshilli Evropian i Lisbonës.

Mbështetja e shteteve në përpjekjet për kërkime shkencore dhe zhvillim matet me kreditë buxhetore publike, në këtë fushë të shprehura si % e PPB-së. Shtete e Bashkuara janë shumë para BE dhe Japonisë, madje e përforcojnë edhe më shumë këtë diferencë gjatë viteve 2000 nëpërmjet një ri ngritje të lehtë. Edhe në BE tendenca ka të njëjtin kah, vihet re një përforcim i mbështetjes, që prej viteve 2000, ndoshta për shkak të efektit të "Lisbonës", por intensiteti i ri ngritjes, shumë modest, ngelet poshtë pritshmërive të Samitit. Në Japoni kreditë buxhetore publike për kërkim shkencor dhe zhvillim janë në rritje të fortë që prej viteve 1990 dhe po afrohen me ato të SHBA-së. (Letessies, Silvano, Soin, 2009)

### **Sfida e vendeve të treta për të investuar në kapital human**

Një problem me të cilin përballën disa vende të varfra është eksodi i trurit, emigrimi i punonjësve më të arsimuar drejt vendeve të pasura, ku këta punonjës mund të gëzojnë një standard më të lartë të jetesës. Në qoftë se kapitali njerëzor ka eksternalitet pozitive, atëherë ky eksodi i trurit i bën ata njerëz të mbetur prapa më të varfër sesa do të ishin ndryshe. Ky problem u ofron politik bërësve një dilemë. Nga njëra anë, vendet e pasura si ato të Evropës Perëndimore dhe Afrikës Veriore kanë sisteme me të mira të arsimit të lartë dhe do të dukej e natyrshme për vendet e varfra t'i dërgojnë jashtë studentët e tyre më të mirë që të fitojnë grada më të larta. Nga ana tjetër, ata studentë që kanë kaluar kohë



jashtë vendit, mund të zgjedhin që të mos kthehen në shtëpi dhe kështu eksodi i trurit do të reduktojë më tej fondin e kapitalit njerëzor të vendit të varfër. (Mankiw & Taylor, 2013, 98-99).

Ekonomitë në tranzicion duhet të mendojmë për të ardhmen. Bota komuniste kishte fokusuar arsimimin kryesisht në ndjekje të qëllimeve ushtarake. Dhe në fillim të tranzicionit, rezervat e kapitalit njerëzor ishin të shtrembëruara shumë nga perspektiva e ekonomisë së tregut botëror. Përveç kësaj, njerëzit me një gatishmëri që të investojnë në kapitalin human duhet të kenë burime të mjaftueshme financiare dhe, për ta bërë këtë dhe sistemet arsimore duhet të ofrojnë mundësi të mira për njerëzit që të fitojnë kapital njerëzor të shitshëm, më këto elemente në vend, e ardhmja në ekonomitë në tranzicion, mund të jetë e ndritshme. (Spagat, 2001, 12).

Pa ngritjen e resurseve njerëzore dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës nuk ka rritje ekonomike. Me rëndësi është shitemi i arsimit, prandaj konsiderohet se nevojitet një reformim i vazhdueshëm i sistemit të arsimit në Kosovë. Përveç arsimit universitar me rëndësi është edhe ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve, ndërlikohet profesionale si dhe forma të tjera institucionale të veprimit të cilat do të rrisin cilësinë e arsimit dhe përgatisin kadro të afta për tregun e punës. Siç dihet shumë vende të Bashkimit Evropian përballën me sfidën e mplaqjes së popullsisë dhe kjo është një ndër problemet që reflektohet edhe në aspektin ekonomik. Në rastin e Kosovës, ekziston një shkallë e lartë e natalitetit një potencial premtues. Mirëpo një ndër kushtet që ky potencial të krijojë efekte pozitive në të ardhmen është arsimi cilësor i cili arsim do të ju mundësonte rinisë përfshirjen në rrjedhat globale por edhe mundësi zhvillimore për Kosovën. (Qorraj, 2011, 126-132.)

### **Përfundimi**

Përfundimi Vendet e zhvilluara ekonomikisht qysh herët e kanë kuptuar rëndësinë e investimeve në kapitalin human. Ky investim kontribuon në zhvillim ekonomik dhe forcim të korporatave multinacionale. Investimi në kapitalin human sfidë mbete te vendet në zhvillim dhe ato të tretat, për arsye të problemeve politike, ekonomike dhe social. Në këto vende, në mungesë buxhetit të mjaftueshëm, stimulimet dhe investimet për kapital human nuk futen në mesin e prioritetëve. Investimet në kapitalin human janë promotorë të zhvillimit ekonomik, sidomos nëse fillojnë nga mosha e re dhe vazhdojnë gjatë tërë jetës. Me anë të stimulimit dhe investimeve në kapitalin human, politikë-bërësit mund të përfitojnë në aspekte shumëdimensionale, pasi mund ta bëjnë vendin tërheqës për investitorët e jashtëm dhe ta përmirësojnë imazhin e vendi, duke krijuar përparësi krahasues për stabilitet politik dhe social. Kur një individ është i arsimuar, i trajnuar dhe i dhënë pas shkencës, gjasat janë të pakta që ai të ekspozohet ndaj dukurive negative. Këto dukur përjashtohen, pasi mirëqenia e tij është më e lartë, duke filluar nga paga dhe benefitet tjera, të cilat mund t'i gëzojë fal pozitës. Prandaj, në të ardhmen e afërt Qeveria e Kosovës, duhet të hartojë politika stimuluese për të rinj dhe forcën punëtore në mënyrë që të tërheqë sa më shumë investime të huaja si dhe t'i forcojë bashkëpunimet bilaterale.

## Referenca

- Gazmend , Q. (2011). Jean Monnet Chair . *Integrimi Evropiane dhe Kosova* , 126-132.
- Gregor, M., & Mark, T. (2013). *Ekonomiksi makroekonomia*. Tiranë, p. 98-99.
- Jean Yves, L., Jacques, S., & Robert, S. (2009). *Evropa ekonomike dhe e ardhmja e saj*. Tiranë, p. 26.
- Michae , S. (2001). Human capital and the future of transition economies. *Royal Holloway*, United Kingdom12. Cituar prej <https://www.royalholloway.ac.uk/Economics/Research/WorkingPapers/pdf/dpe0103.pdf> on 15.04.2015
- Paul, B., & Rebecca, K. (2013). Hyre në menaxhimin e burimeve njerëzore. p. 47.
- Rifat, H. & Fatlum, G. (2013). Investimet si kusht për zhvillim ekonomik. *Përmes promovimit të investimeve deri te ngritja e aftësisë konkurruese te ekonomisë*, Prishtinë, p. 11.
- Skenderi, N. (2010). *Fjalori ekonomiko-social*, Prishtinë. AKB, p. 104.
- Stefan , Q. (2005). *Ekonomiksi i punës*. Tiranë, p. 66- 67.

## Evropianizimi i Ballkanit Perendimor përmes i CSDP –së

Ardian Elezi

### Abstrakt

Evropianizimi është bërë tashmë një realitet i prekshëm në gjithë vendet e BP të dala pas konflikteve historike, ku BE përmes qasjeve të veta ,mekanizmave të shumtë ligjor, institucional e ka eksportuar këtë filozofi duke reformuar sistemin politik, ekonomik, social, juridik në këto vende.

Vendet e BP tashmë kanë kaluar fazat e hershme të tranzicionit të tyre,duke hapur prespektiva të qarta e të sigurta të integritimit në familjen e madhe evropiane.

Politika e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes evropiane ka kontribuar ndjeshëm përmes misioneve civilo ushtarake, duke u testuar me sukses në performancën dhe efektivitetin e tyre në vende si BH, Maqedoni etj.

Falë kësaj qaxsje evropianizuese ,eksportimit të noirmave dhe standarteve evropiane,rajoni është paqtuar,stabiliteti institucional, reformat demokratike në drejtim të shtetit ligjor,respektimit të drejtave dhe lirive themelore, minoriteve etj.

Evropianizimi ka shfaqur rezultatet e dimensioneve të veta duke u kthyer në sinonim i gjithë diskursit të përditshëm politik e publik në rajon,nga të gjithë aktorët e faktoret e involvuar, të cilët e kanë bërë për pjesë të platformave të tyre integrimin në BE

**Fjalë kyçe:** *Evropianizim, CSDP, bottom-up /poshtë-lart, top-down / lart-poshtë, Ballkan Perendimor, Misione civilo-ushtarake.*

### Çfarë është Europianizimi /Definim I konceptit të Evropianizimit

Europianizimi është një term modern që lidhet me ndryshimet në strukturën e Bashkimit Evropian,si dhe rritjes së rolit e të koptencave komunitare të institucioneve të tij,qoftë të Komisionit,Parlamentit,Gjykatës së Drejtësisë ,në raport me institucionet kombëtare të shteteve antare.Si term në modë është bërë shumë popullor për shkak edhe të potencialit dhe aftësisë shpjeguesereth natyrës (Chrobot, 2012, 21)e proceseve të integritimit evropian. Definimet e shumta të termit,qasjet shpjeguese që ofron kanë bërë që popullariteti në rritje i tij ,të shoqërohet edhe me polemika e paqartësi në lidhje me faktin nëse Evropianizimi është rezultat i integritimit,pasoja e tij, apo është vetë një proces i ndërtimit të një modeli të ri qeverisës evropian.

Shumë autore, Europianizimin e shohin të lidhur me zhvillimin dhe përshtatjen e strukturave të brendshme të shteteve antare,që vjen si rezultat i presionit të drejtpërdrejta apo të tërthorta nga antarsimi në BE

Shumica e definimeve tëofruara nga studiuesit,konceptin e evropianizimit,e shohin si një ndryshim a adaptim në:praktikat,normat,procedurat,rregullat e politikat e shteteve antare ,si dhe i standartizimit të tyre në nivele të ndryshme politike si rezultat i dinamikës së integritimit që vjen nga presioni i rregullave autoritar e imponues të institucioneve te BE-së Për disa syresh evropianizimi është një proces i formuar përmes ,ndërtimit,përhapjes,institucionalizimit të rregullave formale e informale, procedurave, paradigmave ,stileve,”mënyrave e të bërit të gjërave “besimeve dhe normave të përbashkëta ,të cilat janë përcaktuar e konsoliduar më parë përgjatë procesit e politikave të BE-së,si dhe janë absorbuar ,përshtatur e ngulitur në llogjikën e diskurit politik e publik kombëtar.

Ky absorbim a adaptim i politikave kombëtare qëështë në përputhje me prespektivë e

drejtimet europiane është tregues e simbol i evropianizimit të tyre në nivel kombëtar. Disa studime e kuptojnë evropianizimin në një qasje formale e minimaliste, si një proces adaptimi kombëtar përmes pajtueshmërisë ligjore (Zeff & Pirro, 2001). Ata hetojnë “rritjen e ndikimit të traktateve evropiane (Stone Sweet, 2002, 1), direktivave dhe ligjeve në praktikën gjyqësore (Smits, 2004), si dhe në sistemet e brendshme ligjore” (Smits, 2004). Studime të tjera përfshijnë një ontologji më të gjerë, dhe me to të shqyrtojnë gjitha llojet e “presionet burojnë tërthorazi nga anëtarësimi në BE” (Featherstone, 2003, 6), duke përfshirë “ndikimi i zhvillimit të shoqërisë transnacional dhe qeverisjes mbikombëtare mbi proceset dhe rezultatet (Smits, 2004, 13) kombëtar.

Ai, si një “makro-proces” (Beichelt, 2008) nënkupton krijimin e një identiteti të ri kolektiv i shkëputur nga ndjenja e përkatësisë e kulturore (Winn & Harris, 2003, 5-6) kombëtare të një shteti.

Komisioni Evropian (KE) e përdor atë në lidhje me proceset e integritimit, për shembull, në lidhje me tregut të përbashkët<sup>1</sup>

Një tjetër përkufizim i evropianizimit, e koncepton atë si një proces, ku BE-ja “eksporton strukturat dhe vlerat e saj përtej territorit të saj” (Grabbe, 2002). Kryesisht, theksi vihet tek vendet e treta që absorbajnë keto vlera, apo tek vendet që janë përfshirë në procesin e integritimit evropian përmes politikës së zgjerimit, ku këtu përmenden vendet kandidatë të BP, si dhe tek ato vende që janë pjesë e marrëdhënies së fqinjesisë Evropiane.

Evropianizimi, shihet si një “metodë e zgjidhjes së konflikteve (Noutcheva, 2004, 7), ku përmes instrumentave e mekanizmave që përdor, e lidh dhe kushtëzon zgjidhjen e konfliktit me angazhimin e saj si dhe integritimin e këtyre vendeve në strukturat evropiane. Rasti i angazhimit të BE-së në vendet e Ballkanit Perëndimor, si BH, Maqedoni, Kosovë e me misionet e tjera në vatra konfliktesh e e ilustron këtë.

### **Qasjet tipologjike e konceptuale të evropianizimit Qasja tipologjike bazike /themelore**

Ka dy qasje tipologjike konceptuale mbi evropianizimin, ajo bazike dhe sistematike. Sipas qasjes së parë konceptuale, evropianizimi shihet në mynyre maksimaliste duke përfshirë të gjitha kuptimet e mundshme enciklopedike (Bulmer & Radaelli, 2010, 38), të karakterit historik, politik, soc-ekonomik etj. Ajo paraqet shumë forma të shfaqjes së tij me kuptime sinonimike si: “modernizimit”, “transferimin e politikës”, “difuzionit”, “bashkim politik”, “integritim”, “zgjerimi” “transnacionalizimit dhe integritimin kulturor”, “ndryshimet në kufijtë e jashtëm të Evropës”, “unifikimi politik i Evropës” dhe “eksporti i institucioneve europiane përtej kufijve të Evropës”<sup>2</sup>, duke u bërë kështu edhe neologjizëm pa një kuptim të saktë dhe unik.

### **Qasja tipologjike sistematike e evropianizimit, si një proces i orientuar**

Evropianizimi, në përputhje me rrethanat, shihet e kuptohet si një proces vertikal i “institucionalizimit” (Chatzigiagkou, 2010, 38) të modeleve të ndryshme të qeverisjes së BE-së në shtetet anëtare, pra sipas modelit të orientuar “lartë poshtë”, ku sipas së cilit politikatat dhe institucionet e BE-së shihen si variabla të pavarur në politikën e

<sup>1</sup>Decision 97/761/CE, see Journal Officiel L 310 from 13.11.1997, Dimensions of Europeanisation Text for: François Bafail / Timm Beichelt (ed.): Européanisation. D'Ouest en Est L'Harmattan. Coll. Logiques Politiques (dir. Yves Surel), 2008, p1

<sup>2</sup>Po aty, si dhe shih (krh Borneman dhe Foëler, 1997; Featherstone, 2003; Schimmelfennig, 2007).

brendshme dhe, së dyti, ajo i referohet proceseve me të cilat marrëveshjet e brendshme të përshtaten (Caporaso, 2007, 23-27) me integrimin evropian

Ndërkohe, Evropianizimi si një proces interaktive i dyanshëm lidhet me zhvillimin në nivel evropian të strukturave të ndryshme qeverisëse që kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme vendore, ku si rrjedhojë e ndërveprimit me institucionet ligjore, politike, sociale ndikojnë në krjimin e rregullave autoritative evropiane” (Caporaso, 2007, 23-27).

Claudio Radaelli (2003) e definon fenomenin në mynyrë holistike si një rrethore interaktive duke e karakterizuar si (Caporaso, 2007, 44):

“Proceset (a) ndërtimin, (b) difuzionit, (c) institucionalizimi i rregullave formale dhe informale, procedurat, paradigmat e politikave, stileve,” mënyra e të bërit gjëra “; dhe besimeve dhe normave të përbashkëta të cilat janë të përcaktuara më parë dhe të konsoliduara nëbërjen e politikave publike të BE-së dhe që përfshihen pastaj në logjikën e diskursit të brendshëm, identitetet, strukturave politike dhe politikat publike “

Ndërkohe ,një autor si Olsen, jep një tipologji disi gjeopolitike të evropianizimit në 5 element të saj si:

1) ndryshimet në kufijtë e jashtëm, 2) zhvillimin e institucioneve në nivel evropian, 3) penetrimi qendror në sistemet e qeverisjes kombëtare, 4) eksportimin e formave të organizimit politik dhe 5) një projekt i bashkimi politik. Olsen e sheh llojin e pestë, evropianizimin si një projekt politik të bashkimit, më interesante, sepse në të ngërthen e përfshin katër kuptime të tjera.

### **Qasjet teorike e konceptuale te evropianizimit**

Hulumtimi i Evropianizimi është ende në fazën e hershme të zhvillimit të saj teorike. Siç është përmendur në literaturë, Evropianizimi “ nuk është në vetvete një teori por, një interes teorik (Dyson, 2002, 3) e varg qasjesh teorike që kanë prodhuar më shumë pyetje sesa përgjigje për të shpjeguar” (Bulmer, 2007, 47). Për këte ajo ofron një sërë qasjes të veta konceptuale, që janë të natyrës tipologjike vertikale dhe horizontale

### **Qasjet konceptuale**

Debati është e dominuar nga dy qasjet konceptuale, të dy prej të cilave lidhen me konceptet vertikale të evropianizimit. Nga njëra anë, qasja integracioniste të evropianizimit e koncepton evropianizimin si një proces nga poshtë-lart e ndryshimit të politikës së jashtme që çon në shfaqjen e strukturave qeverisëse të politikës së jashtme, sigurise e mbrojtjes evropiane.

Në anën tjetër, një qasje nga lart-poshtë e koncepton evropianizimin si ndikimin e CFSP mbi strukturat e brendshme qeverisëse të politikës së jashtme. Këto qasje janë të bazohet në “një dallim të qartë ndërmjet aktorëve shtetërore dhe strukturave, në të cilat integrimi evropian është trajtuar si një forcë e jashtme” (Aggestam, 1999).

### **Qasjet bottom-up /poshtë-lart**

Përkufizimet e poshtë-lart e evropianizimit në fushën e politikës së jashtme të aludojnë për rritjen e rëndësisë së procesit të EPC (deri në Traktatin e Mastroiitit), dhe për zhvillimin e mëvonshëm të CFSP. Në këtë kuptim, Evropianizimi i referohet ngritjes e bërjes e politikave të jashtme në nivel evropian. Ajo ka të bëjë me “aspektet e politikës së jashtme ,sigurisë e mbrojtjes kombëtare që kanë afektuar apo projektuar (Keukeleire &

MacNaughtan, 2008, 142) objektivat e politikave të tyre kombëtare në nivelin e BE-së” (Jorgensen, 2004, 99),ku si rrjedhojë e këtij procesi kjo politikë ajo evropianizohet,bëhet supernacionale (Ginsberg, 1999).

Qasjet konceptuale bottom-up (poshtë –lart)e identifikojnë evropianizimin si një process që lidhet me dinamikën e integritimit evropian.Sipas kësaj qasje,evropianizimi lidhet me ndërveprimet midis aktorëve,të cilët me preferencat e mekanizmat që përdorin në zgjidhjen e problemeve,ndikojnë në krijimin e rregullave autoritative (Rise, 2001, 3) mbikombëtar e në zhvillimet në nivel (Keukeleire &MacNaughtan, 2008, 142) të qeverisjes evropiane.Si rrjedhojë e kalimit të kompetencave nga shteti tek niveli evropian (Wong, 2007),kemi një bjerrje të sovranitetit kombëtar në favor të evropian.

Konceptet bottom-up e evropianizimit janë përdorur shpesh në planet kërkimore me synim studimin e ndryshimit institucional në shtetet kryesore anëtare të Evropës dhe në fusha të politikave që bien përtej kompetencave të Komuniteteve (p.sh. të politikës së jashtme dhe të sigurisë).

### **Koncepti top-down/Qasjet lart-poshtë**

Koncepti lart -poshtë e identifikon evropianizim si një variabël të varur, dhe i sheh faktorët shpjeguese, kryesisht në zhvillimet e institucioneve, politikave” (Olsen, 2007, 79) e identitetit të nivel mbikombëtar, të cilët ndikojnë në ndryshimet në strukturat e brendshme kombëtare të qeverisjes.Këtij koncepti I atribuohet shpjegimi I zhvillimeve të integritimit evropian” (Vink &Graziano, 2007).

Ky konceptim i evropianizimit e konsideron BE-në si një référéncë për aktorët vendas, dmth një model normativ e referues të cilën vendimarrësit e politikave kombëtar-e përshtasin (Hanf & Soetendrop 1998) idetë ,normat e Acquies Communautarire janë ngulitur në praktikat administrative të vendit të tyre (Bulmer & Burch, 1998, 602).

Në shtetet aplikante, Evropianizimi gjithashtu i referohet “ndikimi i procesit të pranimit në BE për modelet kombëtare të qeverisjes” (Grabbe, 2001).

Një konceptim lart-poshtë e evropianizimit në fushën e politikës së jashtme,sigurisë e mbrojtjes e sheh evropianizimin si një proces i përshtatjes së brendshme ndaj politikave të BE-së, duke nënkuptuar ndryshime e përshtatje në politikën e jashtme ,sigurisë e mbrojtjes kombëtare, mekanizmave e vendim-marrjes, vlerave dhe identitetin (Jorgensen, 2004, 48),ku si rrjedhojë e këtij adaptimi kemi një qëndrueshmëri e koherencë më të madhë me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së” (Miskimmon, 2007, 5).

### **Qasjet konceptuale horizontale**

Konceptimet horizontale e evropianizimit nuk mbështeten në një logjikë ekskluzivisht racionaliste të ndarjeve të variablave të varur dhe të pavarur “

Evropianizimi është konceptuar në përputhje me rrethanat si një proces reflektiv nëpërmjet të cilit aktorët bashkëveprojnë reciprokisht (Bulmer & Radaelli, 2004) nëpër nivelet e strukturës qeverisëse, në mënyrë që ndërveprimet e tyre karakteritike kanë një efekt konstituive në të dy strukturat,ato brendshme dhe ato evropiane.

Konceptimi horizontal i evropianizimit ka të bëjë, për shembull, për të”ndërtimin, përhapjen dhe institucionalizimin e rregullave formale dhe joformale, procedurat, paradigmata e politikës, stilet, ‘mënyra e të bërit të gjërave’ dhe besimet e dhe normat e përbashkta të cilat janë përcaktuara e konsoliduar më parë gjatë marrjes së vendimeve të BE-së dhe që më pas inkorporohen në logjikën e diskursit të brendshëm, në identitetet,

strukturave politike dhe politikat publike” (Radaelli, 2000).

Europeanizimi është e përcaktuar si një “proces i vazhueshëm e reciprokisht ndërveprues mes niveleve të politikbërjes kombëtare që ndjekin e përvetsojnë në mynyrë konseguente normat politikës evropiane” (Major, 2005, 175).

### **Dimensionet e rezultatet e Europeanizimit**

Dimensionet e shfaqjes së Europeanizimit,jepen të lidhura me koncepte themelore e sistematike (Adcock & Collier, 2001),të cilët e studiojnë atë në këndvështrime të ndryshme,si kulturore ,politike,kulturore.

Nga perspektiva historike evropianizimi pasqyron “eksportin” e institucioneve evropiane, praktikave politike dhe modelin e “rrugën e jetës” përtejkontinentit evropian përmes kolonizimit dhe detyrimit (Featherstone, 2003). Ai shihet gjithashtu një sinonim i “perëndimorizimit” në vendet e Evropës Lindore e Qendrore dhe kthimit të tyre në familjen Evropiane.

Nisur nga perspektiva e dytë,ajo kulturore,evropianizimi është rrjedhojë e standartizimit (Featherstone, 2003) të praktikave kulturore,e rritjes së kontakteve ndërkufitare,që cojnë në krijimin e një identitet evropian.

Qajsa politike e vë theksin në ndikimin që ka koncepti në bërjen e politikave të shteteve antare,si rrjedhojë kjo e procesit integrues a presionit institucional e sistematik të BE-se. Ajo përfshin politikën e zgjerimit ,adaptimit politik,institucional nën influencen evropiane. Tanja Börzel (Börzel, 2003, 55-78) (2005) ka dhënë një përmbledhje orientuese të fushëveprimit dhe drejtimit të efekteve të evropianizimit. Në veçanti, rezultatet e ndryshimit mund të variojnë nga një gjendje inercie,në absorbim ,akomodim dhe transformim.Një gjendje inercie,nënkupton një situatë të pandryshueshme që bllokton ,reziston ndryshimeve apo shkakton vonesa në ndërtimin e institucioneve.Absorbimi e akomodimi nënkuptojnë përshtatjen me kërkesat e BE-së që reflektohen në politikat ,strukturat e insitucionve ,si dhe në llogjikën e sjelljes politike e publike.Këto më pas krijojnë premisat e terrenin për zëvendësimin me modele te reja paradigmatiche e institucionale,duke prekur kësisoj thelbin e strukturave politike,ekonomike në vencanti e sistemit shoqëror në tërësi.

### **Europeanizimi BP përmes i CSDP -së**

Europeanizimi I BP nuk nënkupton vetëm një përafrim dhe përshtatje te standarteve evropiane,por edhe braktisje të mërive e shernajave arkaike të kaluarës .

Ai,shihet si korniza konceptuale e referuese për demokratizimin, reformimin e modernizimin e sistemeve politike,sociale ,ekonomike e vendeve candidate që synojnë integrimin evropian

Për këtë qëllim,rëndësi të madhe marrin edhe kontributi i instrumentave,politikave dhe mekanizmave që ndërmerr BE për integrimin e këtyre vendeve në familjen evropiane.

BE me qajsen e vet multidimensionale është një aktor i pasfidueshëm ndërkombatër.Ai ka një rol të dorës së parë në rajonin e trazuar.Roli i CSDP ,instrumentava të saj civilo – ushtarak ,që mbulojnë një gamë të gjërë detyrash e objektivash për ty përmbushur,ka qenë evident gjate prezences e mandatevetë misioneve të saj në vendet e BP,qoftë në drejtim të paqimit të situatës,stabilizimit të saj,po ashtu edhe krijimit të premisave të integrimin të shpejtë të këtyre vendeve.

Rezultatet në drejtim të forcimit të shtetit ligjor,kontrollit kufitar,bashkëpunimit rajonal,luftës kundër krimit të organizuar,terrorizmit,reformave në sektorin e sigurisë,demokracisë funksionale janë disa nga outputet e siguruara nga performanca

efektive e mekanizmave te CSDP në evropianizimin e vendet e BP.

CSDP, si një faktor kohezioni social,demokratizimi, zhvillimi e integrimi rajonal shihet si një vlerë e shtuar për krijimin e kushtevë lehtësuese drejt integrimin e evropianizimit të shpejtë të vendave te BP.Nga a tjetër testimi i performacës sëmisioneve të BE-së në kuadër të CSDP-së,sukseseve të arritura,sfidave apo pengesave të hasura ka kontribuar në dimensionin poshtë –lart për përmisimin e aspekteve të ndryshme vendimarrëse që kanë të bëjnë me politikën r sigurisë e mbrojtjes evropiane në qasjet e saj në vende e raste të tjera ku BE angazhohet.

### **Konkluzione**

Bashkimi Evropian në qasjen e vet ndaj vendeve te Ballkaint Perendimor,përmes instrumentave te CSDP-së ka konntriuar ne përsheptimin e ritmeve te integrimin si dhe në evropianizimin të vendeve të rajonit.Nga ana e te këto vende kanë ofruar mjaft eksperiencë për të mësuar dhe përmirsuar n drejtim të koezionnit të strukturave vendimarrëse të BE,bashhkepunimit mes rye, e aktorëve e ffaktorëqve të tjerë multiataral pjesmrrës në menzhmin e konflikteve, stabilizimin e situatës si dhe ndërtimi ne paqes në rajon.CSDP,pavarsisht sfidave dhe vështriisive të hasura, me rezultatet e arrituara ka testua veten si dhe kapacitetet reale të BE-sësi aktor sfidues ndaj cdo përpjekje tjetër për të kthyer kohën e ngjarjeve arkaike e të shernajave të hërshme ballkanik,të provokuara këto edhe nga influencat Ruse.

### **Referencat**

- Adrian Łukasz Chrobot ,Europeanization and its impact on the new democracies that joined the European Union. A comparative study of Portugal and Poland, PhD in Social Sciences Specialty: Political Sociology 2012.
- Zeff, E. E. and Pirro, E. B. eds. 2001. The European Union and the Member States: Cooperation, Coordination, and Compromise.
- Stone Sweet, A. 2002. 'Integration and the Europeanisation of the Law.' Queen's Papers on Europeanisation (2).p. 1, 13.emphasis added.
- Smits, J. M. 2004. 'The Europeanisation of National Legal Systems: Some Consequences for Legal Thinking in Civil Law Countries.' In Epistemology and Methodology of Comparative Law, ed. Van. Smits, J. M. 2004. 'The Europeanisation of National Legal Systems: Some Consequences for Legal Thinking in Civil Law Countries.' In Epistemology and Methodology of Comparative Law, ed. van Hoecke, M.
- Featherstone 2003 cit. in Wouters, J., et al. eds. 2008a.The Europeanisation of International Law.
- Winn, N. and Harris, E. 2003. 'Introduction: 'Europeanisation': Conceptual and Empirical Considerations.' Perspectives on European Politics and Society vol.4 (1).
- Decision 97/761/CE, see Journal Officiel L 310 from 13.11.1997, Dimensions of Europeanisation Text for: François Bafoil / Timm Beichelt (ed.): Européanisation. D'Ouest en Est L'Harmattan. Coll. Logiques Politiques (dir. Yves Surel), 2008.
- Grabbe, H. 2002. 'Europeanisation Goes East: Power and Uncertainty in the EU Accession Process.' Conference paper; Sjursen, H. 1998. 'Enlargement and the Common Foreign and Security Policy: Transforming the EU'S External Policy.' ARENA Working Papers vol.18; Gawrich, A., et al. 2009. 'Neighbourhood Europeanization Trough Enp -the Case of Ukraine.' KFG Working Paper Series(3).
- Noutcheva, G., et al. 2004. 'Europeanization and Secessionist Conflicts: Concepts and Theories.'



In *Europeanization and Conflict Resolution: Case Studies from the European Periphery*, eds. Coppeters, B., et al. p. 7; see also Tocci, N. 2007. *The EU and Conflict Resolution: Promoting Peace in the Backyard*.

Bulmer, S. and Radaelli, C.M. (2005) „The Europeanization of National Policy, in Simon Bulmer and Lequesne, Ch. (eds.), *Georgios Chatzigiagkou, The Member States of the European Union*, Oxford: Oxford University Press Enlargement Goes Western Balkans Croatian Institutions in Time, September 2010.

Georgios Chatzigiagkou *Enlargement Goes Western Balkans*: p 38, University of York, September 2010.

Bulmer, S. 2007. 'Theorizing Europeanization.' In *Europeanization: New Research Agendas*, eds. Graziano, P. and Vink, M. P.

Aggestam, L. 1999. 'Role Conceptions and the Politics of Identity in Britain, France and Germany?' *ARENA Working Papers* vol.8.

Jørgensen, K. E. 2004. 'European Foreign Policy: Conceptualising the Domain.' In *Contemporary* Ginsberg, R. H. 1999. 'Conceptualizing the European Union as an International Actor: Narrowing the Theoretical Capability-Expectations Gap.' *Journal of Common Market Studies* vol.37 (3).

Risse, T., et al. 2001. 'Europeanization and Domestic Change: Introduction.' In *Transforming Europe: Europeanization and Domestic Change*, eds. Green Cowles, M., et al.

Keukeleire, S. and MacNaughtan, J. 2008. *The Foreign Policy of the European Union*. p. 142.

130 Stone Sweet, A. and Sandholtz, W. 1998. 'Integration, Supranational Governance and the Institutionalization of the European Polity.' In *European Integration and Supranational Governance*, eds. Sandholtz, W. and Stone Sweet, A; Lawton, T. C. 1999. 'Governing the Skies: Conditions for the Europeanisation of Airline Policy.' *Journal of Public Policy* vol.19.

Wong, R. 2007. 'Foreign Policy.' In *Europeanization: New Research Agendas*, eds. Graziano, P. and Vink, M. P.

Olsen, J. P. 2007. *Europe in Search of Political Order: An Institutional Perspective*. p. 79; Wouters, J., et al. eds. 2008a. *The Europeanisation of International Law: The Status of International Law in the EU and Its Member States*.

Vink, M. P. and Graziano, P. 2007. 'Challenges of a New Research Agenda.' In *Europeanization: New Research Agendas*, eds. Graziano, P. and Vink, M. P; see also Radaelli, C. M. and Pasquier, R. 2007. 'Conceptual Issues.' In *Europeanization: New Research Agendas*, eds. Graziano, P. and Vink, M.P; and in the field of European legal studies, see Smits, J. M. 2001. 'Attitudes and Approaches to Europeanisation.' *Public Policy and Administration* vol.16 (2); Wouters, J., et al. 2008b. 'Introduction: The 'Europeanisation' of International Law.' In *The Europeanisation of International Law: The Status of International Law in the EU and Its Member States*, eds. Wouters, J., et al.

Hanf, K. and Soetendorp, B. eds. 1998. *Adapting to European Integration: Small States and the European Union*.

Miskimmon, A. 2007. *Germany and the Common Foreign and Security Policy of the European Union: Between Europeanization and National Adaptation*.

Radaelli, C. M. 2000. 'Whither Europeanization? Concept Stretching and Substantive Change.'

*European Integration online Papers* vol.4 (8).p. 4; Checkel, J. T. 2001. 'The Europeanization of Citizenship?' In *Transforming Europe: Europeanization and Domestic Change*, eds. Green Cowles, M., et al; Bulmer, S. and Radaelli, C. M. 2004. 'The Europeanisation of National Policy?' *Queen's Paper on Europeanisation* vol.2004 (1).

Major, C. 2005. 'Europeanisation and Foreign and Security Policy – Undermining or Rescuing the Nation State?' *Politics* vol.25 (3).p. 175.

Börzel, Tanja A./Risse, Thomas 2003: *Conceptualising the Domestic Impact of Europe*, in: Featherstone, Kevin /Radaelli, Claudio (eds): *The Politics of Europeanisation*, Oxford: Oxford University Press, 55-78.

## Mësonjëtorja e shekullit XXI në trojet shqiptare

**Dokt. Ramadan Beqiri**  
SHMU "Xhavit Ahmeti" Prishtinë

### Abstrakt

Të mësuarit asnjëherë nuk mund të themi se ka arrit pikën më të lartë të zhvillimit. Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme që cilësia e tij të rritet gjithnjë e më shumë, në vitet e fundit, pikërisht në fillim vitet e shekullit XXI, kemi një kthesë të madhe në metodat e reja të të nxënimit që po pushtojnë botën. Në trojet tona, të mësuarit, gjithnjë ka qenë një nga sfidat më të mëdha me të cilën është përballë trangu ynë kombëtar. Nën okupim dhe nën represione të panumërta, shtylla e arsimit, asnjëherë nuk është dorëzuar por ka mbijetuar. Falë gjithë atyre sakrificave sot, mburremi me 7 Marsin – Ditën e Mësuesit, që festohet anembanë trojeve shqiptare. Mësonjëtorët e para me hapa gjigantë po fillonin punën e tyre, për të hapur dritare të vockla, e të cilat sollën dritë edhe deri në ditët e sotme. Edhe bota po përballlet me sfida të reja të të mësuarit. Teknologjia informative po zhvillohet me hapa gjigantë, ajo po sjell gjithnjë e më shumë pajisje të reja të cilat po hapin shtigje të reja të të nxënimit. Ekspertët e arsimit nuk po rrinë duarkryq, por vështirësitë për të gërmuar aq sa është e nevojshme nuk po ia dalin. Mësonjëtorët e shekullit XXI, janë sfidat të cilat do të na bëjnë të pa epur përballë zhvillimeve të hovshme të shoqërisë.

Në këtë punim jam përpjekur që në mënyrë konkrete të shtjellojë kërkesat themelore të krijimit të mësonjëtorëve të shekullit XXI. Ato janë imperativ i kohës dhe sfidë e ekspertëve që të punojnë me inercion të shtuar ngase zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit po bën ndryshime rrënjësore në metodologjitë e reja të të nxënimit.

**Fjalë kyçe:** *Shkollat tradicionale, mësonjëtorët bashkëkohore, të mësuarit online, teknologjia 3D, mësimi joformal.*

### Hyrje

Shkollat tona janë të vjetra sa edhe vetë njerëzimi. Ato gjatë historisë kanë qenë të formateve të ndryshme. Fëmijët janë mësuar të flasin e të punojnë nga prindërit, rrethi familjar, e tek më vonë është arrit të kemi organizime të të mësuarit në formë mësonjëtorësh. Dihet se tokat tona stërgjyshore ishin nën kthetra të pushtuesve të ndryshëm. Armiqtë nga më të ndryshmit, pikësynim të parin kishin mos shkollimin tonë. Arma më e fuqishme kundër tyre ishte hapja e shkollave. Ndaj me forcë gjithnjë tentuan të mbajnë këtë popull të robëruar vetëm e vetëm të mos shkollohet.

Sot me krenari festojmë Ditën e Mësuesit – 7 Marsin. Kjo ditë, së paku njihet, si më zyrtare deri më tani, për fillimin e organizuar të mësimimit me komplet tiparet e shkollës së kompletuar. Ndërsa vitet po kalojnë dhe gjithnjë po përballemi me kërkesa e nevoja të reja që shkollat tona të të gjitha niveleve të jenë në një shkallë me ato të botës së civilizuar. Por zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative, ka bërë që brenda vitit të paraqiten nevoja të ndërhyrjeve në metodologjitë e të mësuarit, ndryshime dhe plotësime në kurrikula të arsimit, si dhe botime e ribotime të teksteve shkollore me standarde të reja.

Të mësuarit me metoda të reja, nëpërmjet akademive virtuale në shikim të parë duket se janë klishe, por vërtetë ato po sjellin ndryshime rrënjësore. Të mësuarit në shekullin XXI, gjithnjë e më shumë po i kushtohet rëndësi e nivelit më të lartë. Zhvillimi permanent i TIK, po bën që shoqëria të ndihet gjithnjë e më afër, jo vetëm brenda një shteti por anembanë rruzullit tokësor. Jeta gjithnjë po bëhet më dinamike ndërsa kërkesat për reforma në arsim

janë të padiskutueshme. Ndërhyrja në kurrikula ekzistuese duhet të jetë përditshmëri. Kurrikulat e reja, duhet të harmonizohen me ato të vendeve të BE-së, ndërsa shkollat të standardizohen dhe të jenë bashkëkohore.

### **Të mësuarit tradicional në shkollat tona**

Mësimi që është organizuar nëpër shkollat tona në Kosovë, ka hasur në pengesa të ndryshme. Sistemet të cilat mbretëruan në këto troje, të ndara padrejtësisht nga trangu kombëtar, ka lënë pasojë të mëdha që për kohë të gjatë është vështirë të sanohen. Shkollat tona, në nivel fillor, ishin në kohëzgjatje prej 8 vitesh, niveli tjetër i shkollimit të mesëm ishte me kohëzgjatje prej 4 vitesh. Një numër i madh i të rinjve këtu përfundonin shkollimin e tyre. Ata për shkak kushteve të rënda ekonomike, duhej doemos të kërkonin një vend pune, me çka talenti i tyre dhe ëndrra për të gërmuar në fusha të ndryshme, sidomos shkencore, përfundimisht këtu shuhej. Për këtë angazhoheshin qarqe të ndryshme të sistemit jugosllav. Pak nga ata të rinj, si nëpër breshër plumbash arritën të depërtojnë në fakultete të Universiteteve jugosllave, në gjuhë të huaja studimi. Dolën gjenerata të diplomuarve, që edhe pse studimin e patën bërë në gjuhë të huaja, tani po mendonin dhe vepronin shqip. Me të shpejtë nisin punën fakultete në Prishtinë, ku pastaj themelohet edhe Universiteti i Kosovës. Në nivele fillore dhe të mesme tani gjithçka po ndryshonte. Të mësuarit po bëhej traditë, obligim dhe shpresë për një të ardhme më të mirë dhe më kualitative.



Foto 1. Klasë tradicionale (24.4.2015)

Ato vite qenë historike, sakrificë për mbijetesë të arsimit shqip në Kosovë, që po ashtu duhej të reflektohet edhe në ish republikat tjera jugosllave që jetonin shqiptarët të kufizuar me Kosovën, si shqiptarët në Maqedoni, Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, pastaj shqiptarët në Mal të Zi. Për mbarëvajtjen e arsimit dhe shkollimin e kuadrove në nivel universitar kujdesej Kosova, edhe pse me një status të nëpërkëmbur nga serbosllavët të cilët nuk patën ndryshuar strategji të sundimit mbi shqiptarët, me të vetmin qëllim, mos shkollimin universitar dhe pasuniversitar. Tentohet të mbahej një qëndrim për gjysmë arsimim. Gjithçka që pretendohet të arrihet në nivel akademik, ishte cak i sulmeve dhe shpifjeve se po tentohet për një Shqipëri të Madhe. Kongresi i gjuhës së unifikuar dha një dritë tjetër

e cila do na shpie deri te një e sotme e bashkuar për të themeluar shkolla online, akademi virtuale dhe përgatitje për themelimin e klasave virtuale. Ndërsa ne duhet sa më parë të kemi strategji të mirëfillta që mësorjtë tona të jenë bashkëkohore. Edhe fëmijët tanë të ndjekin mësimet në kushte dhe ambiente komode, ashtu siç parashihen me pedagogjinë e shekullit të ri.



Foto 2. Mësorjtë bashkëkohore

### Mësorjtë bashkëkohore të shekullit XXI

Sfidë jona është se si do të duken mësorjtë e shekullit XXI (Foto 2. <http://rgvisionmagazine.com/2013/08/evolving-classrooms-for-21st-century-learning/>, 23.4.2015). Ato do të jenë bashkëkohore, me standarde të larta dhe shumë më ndryshe se tradicionalet. Libri nuk do të jetë burimi i vetëm, e as kryesor për nxënësin. Në qendër të vëmendjes do të jetë nxënësi, ndërsa mësimdhënësi ndryshon rolin e tij nga ligjëruesi, tani do të merr rolin e një analisti dhe trajneri për bartje të dijes. Burime të reja të të nxënimit do të jenë interneti i cili ofrohet në formate të ndryshme. Të shkruarit me laps në fletore, do t'i përket të kaluarës me një kujtim dhe material për historinë e zhvillimit të të mësuarit.

Marc Prensky përshkruan se si nxënësit më nuk e duan amfiteatrin e madh për ligjërata dhe në vend të kësaj duan hapësira të cilat “lejojnë ata të takohen, të angazhohen në dialog, duke punuar vetëm ose në grupe në projekte. Ata po ashtu janë të interesuar për të marrë ose siguruar feedback personal për të mësuarit. Gjithashtu kërkojnë mjedis bashkëpunues që mbështet të mësuarit dhe të kuptuarit “ (Company, 2011, 5-6).



Foto 3. Klasa sipas HermanMiller

**DETEL 21<sup>ST</sup> CENTURY CLASSROOM EXAMPLE**




Foto 4. Dizajni i një klase moderne (<http://www.detel.com/Pages/21stCenturyClassroom.aspx>, 23.4.2015)

“Kohë të gjatë po shpenzojmë për të ndryshuar njerëzit. Në vend të saj do të duhej të ndryshojmë mjedisin dhe pastaj njerëzit vetë do të ndryshojnë” (Watson Les, Pro Vice-

Chancellor, Glasgow Caledonian University).



Foto 5, ...(<http://sefnj.org/Page/132>, 23.04.2015)

Klasat tradicionale janë të dizajnuara në atë mënyrë që mësimit është në qendër të vëmendjes, i cili tërë kohën ligjëron para nxënësve. Mësonjëtorët moderne në fokus kanë nxënësin, mënyrën e komunikimit të tij, bashkëpunimin në grup dhe të shprehurit individual. Në vijim do të paraqesim disa karakteristika themelore të mësonjëtorëve bashkëkohore për një cilësi më të mirë në mësim nxënie.

**Fleksibiliteti i hapësirës** së mësonjëtorëve është një karakteristikë themelore që e bën ambientin e rehatshëm, ku nxënësi ndihet i relaksuar si në punë individuale, punë në grupe të vogla apo të mëdha, debate, diskutime etj. Mësonjëtorët bashkëkohore kanë mure lëvizëse, tabela elektronike dhe mjete tjera të cilat e krijojnë një ambient komodë për nxënësin.



Foto 6. <http://smithsystem.com/21centuryclassroom/> 22 prill 2015

**Teknologjia interaktive**, ndihmon që nxënësi të jetë më i sigurt në vetvete ngase ai mund të përdor teknologji 3D, nëpërmjet të cilave në mënyrë simultante do t'i 'përjetojë' dukuritë e ndryshme nga shkencat ekzakte si fizika, kimia, astronomia etj.

Kreativiteti është një mundësi e pazëvendësueshme, e një mësonjëtorje bashkëkohore, ku nxënësi arrin që të jetë fleksibil në punimet veta, bashkëpunon me nxënësit tjerë brenda dhe jashtë grupit, shkëmben mendime dhe shprehë intuitën e tij para mësimdhënësi, bënë ndryshime dhe plotësime në detyrat e parashtruara nga mësimdhënësi. Mësonjëtorja moderne e pajisur me mjete dhe teknologji 3D, promovon dhe inkurajon nxënësin për të arrit objektivat e ndërveprimit dhe të mësuarit social.

Këndet rekreative në ambiente të hapur, ndikojnë që nxënësit të shijojnë realitetin e hapësirës së natyrës. Ambientet e tilla janë të domosdoshme dhe përfshijnë sipërfaqe të mëdha. Nxënësit në ato ambiente shfaqin shkathtësitë e tyre fizike. Shprehin talentin e tyre, shpenzojnë energjinë e akumuluar gjatë qëndrimit në kabinete virtuale, zgjerojnë njohuritë e tyre për natyrën dhe dukuritë natyrore, ndjehen më komod dhe më social, rrisin komunikimin etj. Në këtë mënyrë shfaqin ndjenjat e tyre mes shokëve dhe mësimdhënësve duke rrit nivelin e të mësuarit joformal.

Komunikimin mes veti nxënësit dhe mësimdhënësit e bëjnë në forma dhe mënyra të ndryshme, si nëpërmjet gmail, Google Hongout, Google Drive, Google Calendar etj.

**Learning Café** është një vendtakim i të rinjve, ku disa universitete botërore kanë filluar si pilot projekte ku studentët aty kanë hapësirë komode e cila plotëson kushtet e një kafeneje moderne dhe njëkohësisht të një laboratorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Studentët janë të ndarë në grupe dhe aty përfundojnë detyrat e ndryshme të cilat i kanë për studim të mirëfilltë.

Relaksimi me një kafe dhe të mësuarit bashkëkohor po sjell rezultatet e para që janë evidente.



Foto 7. Learning café

**Motivimi** për punë dhe rezultate të mira të nxënësve ndikojnë shumë faktorë. Hapësira e shkollës duhet të jetë e pajisur me dritë të mjaftueshme natyrore, që krijojnë ambient të pranueshëm dhe komod për nxënësin. Qasje në çdo cep të shkollës me WiFi, learning café, pajisje të kompletuara të teknologjisë së fundit, qasje e mjaftueshme në ambiente të hapura përreth shkollës, komunikim social ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve do të motivojnë nxënësit për arritje të suksesit edhe të atyre detyrave që shpesh shihen si të

pamundura për t'u zgjidhur. Një plan model i shkollës moderne mund të shihen në foton vijuese.




Foto 8. Klasë standarde moderne MPS

### Konkluzione

Shkollat tona tradicionale sa më parë duhet të shndërrohen në mësonjëtoresh bashkëkohore. Nxënësit duhet të ndiejnë veten të lirë, të relaksuar, që mund të shprehin lirshëm. Aktivitetet e tyre të lira të ndikojnë që të arrijnë edhe më shumë rezultate. Ndryshimi natyral, dizajnimet e objektit dhe renditja e të gjitha pajisjeve sipas kriterëve të përcaktuar do të relaksojnë nxënësit edhe atëherë kur para vetes kanë detyra të vështira dhe eksperimente të cilat edhe mund të jenë të koklavitura.

Në bazë të kësaj mund të konkludohet se mësonjëtoresh moderne të shekullit XXI, duhet të jenë të dizajnuara dhe të pajisura me teknologjinë më moderne, të harmonizuara në mënyrë pedagogjike sipas planit programor të reformuar, ku nxënësve dhe mësuesve ju ofrojnë:

- Fleksibilitet,
- Kreativitet
- Interaktivitet,
- Motivim në mësim
- Komunikim dhe bashkëpunim në mes nxënësve dhe mësuesve.

### Burimet:

DreamBox learning: Essential characteristics of 21st century classrooms

Educational Origami

<http://www.educatorstechnology.com/>

Promethean: 21st Century Classroom

SmithSystem



## Roli i marketingut në menaxhimin strategjik

**Rrezarta Gashi, PhD Cadidate**

*Universiteti European i Tiranës,  
Tiranë, Shqipëri*

**Arjanit Avdiu**

*Universiteti i Prizrenit  
Prizren, Kosove*

### Abstrakt

Zhvillimet e vazhdueshme të tregut ndikojnë në bizneset që të ju përshtaten tregut dhe kërkesave të cilat vijnë si pjesë e zhvillimeve. Të qenit në qendër të zhvillimeve është dëshirë e çdo biznesi sepse kjo ju mundëson që të gjinden më afër ndryshimeve dhe pjesë e trendeve duke u përshtatur me kërkesat që rrjedhin nga tregu. Zhvillimet aktuale të tregut, pjesë e ndryshimeve globale në tregjet e lira, mbërthejnë në vete një gamë të gjërave të cilat detyrojnë bizneset të përdorin me qëllim të përshtatjes me ndryshimet e shpeshta në treg si rrjedhojë e ndryshimeve në shije, kërkesa dhe dëshira të konsumatorëve dhe klientëve. Menaxhimi strategjik si koncept ka për qëllim të identifikimit dhe aplikimit të strategjive të përshtatshme për të krijuar përparsi mbi konkurrencën me qëllim të arritjes së qëllimeve dhe objektivave biznesore. Pjesë e menaxhimit strategjik është përdorimi i marketingut si pjesë e vlefshme në biznes. Duke parë rëndësinë që ka marketingu në arritjet biznesore, roli i tij sa vjen dhe shton vlerat në përdorimin e tij adekuat si pjesë e pakos së menaxhimit strategjik biznesor. Përdersia bizneset me anë të menaxhimit strategjik ka për qëllim aplikimin e tij duke ju mundësuar të kenë përparsi mbi konkurrencën përdorimi me marketingun njëkohësisht mundëson bizneset në krijimin e diferencimit në nga të tejerët, zhvillimin e brendeve, promocionet, dhe zhvillimet apo inovacionet në treg. Andaj kombinimi i menaxhimit strategjik dhe marketingut strategjik në një biznes të vetëm mund të shihet si strategji e përkryer në arritjen e qëllimeve në përmirsim të performancës së përgjithsme të bizneseve duke u përshtatur me zhvillimet, trendet dhe ndryshimet e vazhdueshme në treg.

**Fjalët kyce:** *Menaxhimi strategjik, marketingu, tregu, zhvillimet, objektivat*

### Hyrje

Ndryshimet janë duke ndodhur në shpejtësi të madhe; e sotmja nuk është sikur e djeshmja, si dhe e nesërmja do të jetë ndryshe nga e sotmja. Strategjia e vazhdueshme e të sotmes është e rrezikshme; ajo është duke u shëndërruar në strategji të re. Andaj kompanitë e suksesshme të së nesërme (të së ardhmen) duhet të jetë të kujdesshme në tri gjëra të sigurta:

1. Forcat Globale do të vazhdojnë të ndikojnë në binzeset dhe jetët personale të çdo personi,
2. Teknologjia do të vazhdojë të na mahnis me zhvillimet e saja,
3. Do të ketë në vazhdimësi tendenca të për shtyrje të gjërave drejt çrregullimit të sektorit ekonomik (Kotler, 2002,1).

Në të sotmen të gjitha tregjet janë dinamike. Ndryshimet vërehen gjithkund, ndërsa ndryshimet ndikojnë në strategji. Strategjia e sukseshme e të sotmes mund të mos jetë të triumfoj nesër. Për më shumë ajo mund të mos jetë e përshtatshme për të nesërmen (Aaker, McLoughlin, 2010, 1).

Ngjashëm sikur në tregun global edhe në tregun Kosovar dinamika si dhe ndryshimet e shpeshta shtyjnë bizneset të bëjnë lëvizje në përshtatje të trendeve bashkohore. Lëvisjet e tregut nxisin sipërmarrjet apo bizneset që të kombinojnë shumë elementë që t'i ndërthurin ato mirë mes vete për të mbijetuar dhe për të korrur suksese në tregun e ndryshimeve të shpeshta. Në këtë pikë kompanitë fillimisht duhet që të orjentoohen në krijimin e një plani strategjik duke kombinuar të gjitha elementet për t'u konsoliduar fillimisht në ambient të mbrendshëm apo intern të kompanisë. Me këtë mendoj se në strukturën e biznesit duhet të punohet që të kordinohet mirë mes departamenteve apo sektorëve në hartimin e planeve dhe kombinimin e tyre prë të sajuar një strategji të mirëfillt konkurruese dhe sfiduese në përballje me ambientin e jashtëm biznesor. Arritja e një përputhshmërie mes planit strategjik operativ dhe atij të marketingut shihet si kombimin i nevojshëm në përballje të sukseshme me konkurrencën pikësëpari, pasandej me shijet, nevojat dhe kërkesat e konsumtorëve të cilët poashtu ndikohen nga ndryshimet e vazhdueshme. Krijimi i një strategjie hibride mes marketingut dhe menaxhimit strategjik mund të llogaritet si strategji vizionare në përmbushjen dhe arritjen e qëllimeve të çdo biznesi duke ju mundësuar që kenë përparsi konkurruese pavarësisht veprimtarisë së tyre dhe përqindjes së pjesmarrjes në treg.

Strategjia menaxheriale dhe strategjia e marketingut janë një kombinim përkryer i çmuar dhe i mirëmenduar duke ju mundësuar bizneseve të arrijnë më shpejtë drejt qëllime të tyre afariste. Strategjia e marketingut në veçanti është qasje cila integron veprimet e marketingut brenda një biznesi, kompanije apo organizate duke ju mundësuar të jenë të sukseshmën në treg. Me anë të adoptimit efikas të marketingut strategjik, bizneset arrijnë që shumë më lehtë të promovojë vlerat e tyre organizative në të njejtën kohë të përmirsojnë edhe profitabilitetin si synim afarist. Marketingu strategjik është koncept i ri i cili është zhvilluar vitet e fundit duke synuar që biznesi të jetë sa më afër konsumatorëve dhe klientëve duke arritur të përmbush kërkesat dhe nevojat e tyre duke krijuar njëkohsisht përparsisë mbi konkurrencën (Chetty, 2012).

Qëllimi i këtij punimi është të paraqes rolin dhe ndikimin e marketingut në menaxhimin strategjik. Mbi të gjitha, punimi përmes shembujve dhe fakteve të siguruara ofron jep poashtu sqarime rreth krijimit të një strategjie të re mes marketingut dhe menaxhimit strategjik duke i mundësuar bizneseve që me anë të këtij kombinimi të synojnë të bëjnë më të mirën në tregun që ata/ato operojnë. Për më tepër, punimi përmes metodës kualitative ka për qëllim të mbështes të gjitha faktet e siguruara me literaturë të përzgjedhur nga autorët të shumtë për të dëshmuar dhe ofruar një pasqyrim rreth shtjellimit sa më të kuartë dhe kuptimplotë të temës së punimit mbi rolin crucial që ka marketingut në menaxhimin strategjik.

### **Roli i Marketingut në Zhvillimin Strategjive Biznesore**

Sipas AMA the American Marketing Association marketingu definohet si: *proces i planifikimit dhe të zbatuarit e koncepteve, çmimeve, promocionit, shpërndarjes të ideve, të mirave (produkteve) dhe shërbimeve që të krijojnë shkëmbime që të kënaqin individë-konsumatorët dhe klientët, njëkohsisht të përmbushin qëllimet e organizatës apo biznesit* (Kotler, 2002).

Marketingu ka të bëjë me identifikimin dhe përmbushjen e nevojave njerzore dhe shoqërore. Duke ju referuar definicionit më të shkurtër rreth marketingut që është: *“përmbushja e nevojave për profit - fitime.”* Të gjitha kompanitë si Procter & Gamble, Olestra, CarMax, IKEA të gjitha ofrojnë produkte dhe shërbime për konsumatorët

dhe klientët e tyre. Qëllimi i bizneseve shihet se është të të kthejnë nevojat private apo shoqërore në biznes fitimprurës duke shfrytëzuar mundësinë e dhënë që kjo të arrihet përmes marketingut (Kotler, 2002,1).

Përgjatë shumë viteve menaxherët, studjuesit dhe dijetarët janë munduar që të indentifikojnë se çfarë i bën dhe çfarë i diferencon bizneset që të jenë më të suksesshëm në raport me bizneset tjera. Përgjigja mund të gjindet në aftësitë e bartjes së vlerave të veçanta të konsumatorëve duke bërë që biznesi përformojë më mirë kundrejt konkurrencës dhe të dëshmojë këtë edhe para syve të konsumatorit. Në këtë qështje të definuarit dhe indentifikimit të vlerave të konsumatorit në një treg të veçantë mund të shihet apo paraqitet si problem i cili kërkon zgjidhje nga bizneset duke pasur për qëllim të bërit biznesin të orjentuar më shumë nga konsumatori. Për këtë përgjigja mund të gjindet në aplikimin e marketingut strategjik. Brenda kufinjve të bizneseve dhe strategjisë menaxhuese të përzgjedhur marketingu strategjik shihet si mjet që mundëson gjetjen e zgjedhjes sa i përket vlerave të konsumatorit dhe shënjestrimin e tij. Përdorimi i segmentimit të tregut dhe pozicionimi ndihmon bizneset që me anë të këtyre instrumenteve të marketingut strategjik të arrijë tregun si dhe objektivat e parashtuara (Nijssen & Frambach, 2001,9).

Viteve të fundit marketingu në tërësi është duke luajtur rol të rëndësishëm. Pyetja më e shpeshtë që ngrihet mbi rëndësinë e marketingut qoftë nga zyrtarët e marketingut apo divizioni i marketingut brenda një firme apo kompanije është nëse implementimi dhe përdorimi taktik i menaxhimit të programit i duhuri i përdoruri nga biznesi. Vizioni mbi marketingun është duke ndryshuar. Tanimë ai është duke u konsideruar dhe pranuar më shumë si pjesë e strategjisë së marketingut të një biznesi, firme apo kompanije pamvarësisht madhësisë. Pikëpamja se çfarë është marketingu dhe si është duke u ndërruar roli i tij në proceset e përgjithshme të biznesit, në ditët e sotme ai është i pranuar dhe përceptuar si pjesë kyqe dhe e pandashme e manaxhimit strategjik të kompanisë. Duke e parë ndërthurjen e strategjisë së biznesit dhe strategjinë e marketingut, shihet se roli i marketingut mund të qartësojë dhe luaj rol të rëndësishëm edhe në strategjinë e përgjithshme të biznesit duke krijuar mundësitë që me anë të analizave strategjike të përdorura të kuptohet më mirë pozita e konsumatorëve, konkurrencës, si dhe forcave të tjera të tregut të cilit i takon përfshirë edhe trendet. Rolet e marketingut në përmirsim të performacës së kompanisë janë të shumta. Praktikën më të mira të aplikuarit e marketingut si pjesë e vlefshme e strategjisë së menaxhimit të përgjithshëm të biznesit mund të veçojmë më të dalluarat siq janë:

**1. Marketingu drejtues primar në analizat strategjike.** Departmenti i marketingut është në pozitë dhe ka për qëllim që të kuptojë konsumatorët, konkurrencën, tregun, forcat e ambientit si dhe trendet. Me anë të menaxhimit efikas të hulumtimit të tregut si dhe të dhënat e nxjerra nga tregu, shumë nga informatat të cilat nxirren janë shumë të duhura për të analizuar në detaje ambientin e jashtëm apo tregun. Me anë të kompletimit të analizave, departmenti i marketingut udhëheq dhe merr iniciative për të krijuar një portfolio të brendit, për të zgjedhur dhe modifikuar kanalet e shitjes si dhe ato të distribuimit. Për më tepër departmetni mund të marr kompetencat e idejimit dhe prezentimit të produkteve të reja duke u bazuar në analizat strategjike të dala nga hulumtimet.

**2. Marketingu zhvillues i strategjisë së kompanisë.** Strategjitë e biznesit më së miri mund të definohen nga marketingu duke u bazuar në vlerat e sygjeruara nga konsumatorët: çfarë janë vlerat të cilat firma apo kompanija do të ofroj tani dhe në të ardhmen? Marketingu në fakt duhet të jetë zëri i konsumatorëve dhe klientëve në diskutimet strategjike duke u siguruar se sygjerimet dhe propozimet janë të bazuara në substancë dhe kanë kuptim për konsumatorin si pjesa e rëndësishme e tregut. Zgjidhja e sferës së tregut duhet të jetë

i bazuar në strategjinë e segmentimit. Shumë vlera dhe kompetenca siq është perceptimi mbi brendin nga ana e konsumatorëve krijohet nga lidhja e produktit me konsumatorin me anë të përdorimit dhe ndikimit të marketingut në perceptim dhe pranim pozitiv të produktit. Ndikimi i perceptimit pozitiv dhe lidhjes së konsumatorit në produktin ndikon në zhvillim e strategjisë së kompanisë.

3. **Marketingu udhëheqës në ngritje të strategjisë së kompanisë.** Alternativa për përritje të kompanisë bazohet dhe poashtu mvaret në konsumatorin dhe në strategjinë së përdorur për depërtim në treg. Roli i marketingut në këtë drejtim është dhe duhet të jetë kyq. Bazuar në studimet nga Booz Allen dhe Hamilton nga 2000 biznese pjesë e hulumtimit rezultatet kanë dhënë të kuptojmë se kompanitë përshkruajnë si ndikues në ngritje të kompanisë është pikërisht strategjia e të aplikuarit të marketingut të duhur si pjesë e të operuarit në biznes. (Aaker, McLoughlin, 2010, 15-16).




Figura 1. Kombinimi mes marketingut dhe menaxhimit strategjik në përballje me tregun.

Burimi: Përpunuar nga autorja

### Arritja e Objektivave Biznesore Përmes Aplikimit të Marketingut

Për të krijuar një strategji sa më të sofistikuar dhe sa më mirë të zbatueshme, përdorimi i marketingut si pjesë operacionale drejt arritjes së objektivave të kompaninë duket se është i pashmangshëm. Thënë edhe më lartë se se tregjet në ditët e sotme janë dinamike dhe në ndryshim të shpejtë, arritja e objektivave dhe planeve të parashtruara nga bizneset duhet të përshtatet së bashku me ndryshimet dhe trendet e tregut pjesë e së cilës është kompanija. Në këtë kontekst objektivat e marketingut gjithsesi se duhet inkorporohen me strategjinë operative të zgjedhur nga biznesi. Objektivat e kompanive nëpër botë ndryshojnë në masë të madhe, por ato rrënjësoret apo fundamentalet shumë të diskutura mes studjuesve si Ansoff (1968), McKay (1972), dhe Gultinan & Paul ( 1988), identifikohen të jenë tri kyqe:  
A. Të rritet tregu,

B. Të zgjerohemi në pjesmarrje të tregut,  
C. T'i rrisim fitimet. (Gilligan, Wilson, 2003, 325).

Për të arritur objektivat qofshin ato edhe më shumë në numër se tri të sipërpërmendurat, marketingut luan rol vendimtar në këtë pikë. Shprehur edhe më lartë, roli i marketingut në të zbatuarit e menaxhimit strategjik është kyq kur kemi parasysh se përveç se ka të bëjë me identifikimin dhe përmbushjen e nevojave njerëzore, marketingu mundëson dhe lehtëson punën e bizneseve në identifikimin dhe shtjellimin e faktorëve të tregut - të mbrendshëm dhe të jashtëm. Andaj impakti i tij në biznes pikërisht në gjetjen e dobësive, përparësive, kërcënimeve, apo mundësive drejt arritjeve të objektivave ka gjetur zbatim tek të gjitha bizneset duke ju mundësuar që përmes marketingut strategjia e kompanisë të formësohet të nxjerrë në pah të gjitha detajet e tregut që e rrethojnë kompaninë.

### Konkluzionet

E Drejta e autorit si e drejtë subjektive e karakterit absolut është me rëndësi të veçantë për titullarët, sipas të drejtës pozitive por edhe sipas të drejtës evropiane dhe ndërkombëtare. Duke marrë parasyshë rëndësinë e kësaj të drejte, ligjvënësi ka bërë, bën si dhe duhet të bëjë vazhdimisht përpjekje për rregullimin më të mirë të mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të përafërta. Këtë para së gjithash e bënë rregullativa nacionale nën ndikimin e rregullave të konventave ndërkombëtare sepse rregullativa e unifikuar obligon nënshkruesit dhe ratifikuesit që legjislacionin e tyre nacional ta harmonizojnë më rregullativën e unifikuar andaj me këtë edhe të drejtat e tyre bëhen pjesë përbërëse e rendit juridik nacional. Me këtë i kontibohet shumë mbrojtjes bashkëkohore të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të përafërta. Kuptohet, me këto rrjedha nuk duhet të egzistojë kurrëfar iluzioni se është lehtë të krijohet e drejta nacionale e unifikuar me të drejtën e Unionit European dhe më gjerë sepse në këtë rrugëtim ka pengesa të natyrave të ndryshme. E drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta parimisht gëzojnë të drejtën për mbrojtje gjyqësore dhe mënyrën se si duhet të realizohet kjo mbrojtje, si dhe autorizimin për këtë mbrojtje nga bartësit ose titullarët e këtyre të drejtave dhe fituesit e të drejtave ekskluzive të kësaj fushe. Kjo mbrojtje mund të realizohet përmes mbrojtjes juridiko-civile, juridiko-penale, juridiko-administrative, ndërkombëtare dhe nëpërmjet arbitrazhit. Këtë mbrojtje mund të realizojë individi i caktuar ose mund të organizohet mbrojtje kolektive e së drejtës së autorit dhe e të drejtave të tjera të përafërta, kështu që duhet thënë që këto subjekte i realizojnë këto të drejta në procedurë gjyqësore. Në këtë punim do të trajtohen mbrojtja juridiko-penale dhe juridiko-administrative si dhe vështirësitë, perspektiva dhe sukcesi i realizimit të mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të përafërta.

## **Kuptimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit**

Mbrojtja e të drejtave të caktuara është mision me rëndësi i së drejtës. Kjo mbrojtje bëhet duke marrë parasyshë interesin e caktuar shoqëror të mbrojtjes së saj, ngase ajo është çenuar ( Aliu, 2013, 287, Kadriu, 2008,437, Kondili, 2008,103). Me këtë dëshmohet elementi kryesor i së drejtës, që është sanksioni i saj. Nga ana tjetër, me aplikimin e këtij elementi realizohet gjëja kryesore e mbrojtjes të së drejtës, pra realizohet një e drejtë e caktuar. Kur kjo mbrojtje kryhet me sukses, atëherë sistemi juridik tregon funksionalitetin e vet dhe sigurinë e caktuar në rrjedhat e veta të rëndomta. Kjo rrjedhë është esenca e gjërave tek mbrojtja e së drejtës së caktuar apo e të drejtave të caktuara. Në këtë mënyrë mbrojtja duhet të realizohet, mirëpo gjatë realizimit të mbrojtjes së të drejtave nuk veprohet kështu, sepse për arsye të ndryshme mbrojtja mund të realizohet më shumë vështirësi apo më me pak vështirësi. Duke marrë parasyshë këtë rrjedhë me rëndësi, mendojmë se për mbrojtje efikase kërkohet rregullativë e mirë dhe zbatim efikas i saj dhe ambient i mirë për funksionimin evident të mbrojtjes ( Enciklopedija, 1979, 69 ). Së këndejmi edhe në mbrojtjen e së drejtës kërkohet organizim i mirë dhe tentim i përhershëm për një zbatim normal të mbrojtjes juridike të çështjes juridike në segmente të ndryshme të fushave të ndryshme të së drejtës ose në pjesë të ndryshme të ndonjë dege të së drejtës. Mbrojtja e të drejtës së autorit dhe e të drejtave të tjera të përafërta vjen në shprehje kur ato çenohen në raste dhe situata të ndryshme ( LDADA, 5, 6, 130 ). Në këtë mënyrë ndihmohet dhe sigurohet që këto të drejta të funksionojnë sipas destinimit. Ky funksionim nuk është krejtësisht i plotë sepse nuk e lejojnë cënimet e shumta që ndodhin në jetën e përditshme të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të përafërta. Mirëpo prania e mbrojtjes së këtyre të drejtave është dëshmi se këto të drejta kanë mbrojtje normale, sepse ia mundësojnë qdo bartësi të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të përafërta ti mbrojë të drejtat e veta ekskluzive. Në këtë mënyrë pakësohen rastet e cënimit të këtyre të drejtave, sepse titullarët ose fituesit ekskluziv të këtyre të drejtave kanë një siguri të dukshme në shfrytëzimin e të drejtave të kësaj fushe (Vukoviq, 2005, 11). Me fjalë të tjera, me mbrojtjen juridike të së drejtës së autorit dhe e të drejtave të tjera të përafërta, as subjektet e kësaj fushe, nuk janë në stih, por gëzojnë mbrojtje kur të drejtat e tyre rrezikohen nga subjektët e paautorizuara ( Aliu, 2004, 55). Ky funksionim i mbrojtjes bënë të mundshme që gjërat të kenë rrjedhë që i siguron këto të drejta të popujve të civilizuar. Kuptohet, edhe për këto të drejta, vështirësitë janë evidente, por me rregullativë të duhur dhe me profesionalist të mirë të kësaj fushe, synimet e mbrojtjes do të jenë në suaza të normales, dhe në rrjedhat e njëmëndësisë së jetës edhe në këtë segment të së drejtës. Rregullat e së drejtës së autorit dhe e të drejtave të tjera të përafërta e kanë të paraparë mënyrën e mbrojtjes së këtyre të drejtave të çenuara dhe në këtë mënyrë kanë ndihmuar efektivitetin e kësaj mbrojtje që nga ana tjetër shton sigurinë juridike të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të përafërta. Këtë mbrojtje e realizojnë individët e autorizuar dhe institucionet me rëndësi në qarqet e ndryshme të së drejtës dhe shoqërisë (Gams, 1972, 44).

### **Mbrojtja juridiko-penale dhe juridike-administrative e të drejtës së autorit në vështrim të ligjit të zbatueshem në Kosovë**

Mundësitë e cënimit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta janë të shumta. Si në të kaluarën ashtu edhe sot, janë krijuar norma juridike në të cilat parashihet mbrojtja e të drejtave të autorit dhe e të drejtave të përafërta ( Aliu, 2004, 61 ). Duke marrë parasysh mënyrat e reja të shfrytëzimit të së drejtës së autorit siç është shumëzimi i veprave duke

përfshirë incizimin e tonit dhe të fotografisë, vënja në qarkullim e veprave të shumëzuara, shfaqja e veprave para publikut, emitimet radiodifuzive dhe format e tjera të prezantimit të këtyre veprave para publikut, kanë mundësuar dhe lehtësuar edhe më shumë cënimin e së drejtës së autorit ( Krstiq, 2005, 11, Hennenberg, 2001, 212). Me qëllim të mbrojtjes juridike të së drejtës së autorit, ligjet e reja për të drejtat e autorit, e ndër ta edhe Ligji i Kosovës për të drejtat e autorit dhe për të drejtat e përafërta dhe disa ligje të tjera përmbajnë rregulla në të cilat parashikohen sanksione për rastet në të cilat shkellet e drejta e autorit dhe rregulla që pengojnë shkeljen e së drejtës së autorit që ende nuk është shkelur. Përveç kësaj edhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e autorit i detyrojnë shtetet që të nxjerrin rregulla me qëllim të mbrojtjes të së drejtës së autorit dhe të bartësve të tjerë të këtyre të drejtave (Konventa e Bernës, 1886). Konventat ndërkombëtare të kohës më të re përmbajnë një sërë rregullash për mbrojtjen e së drejtës së autorit. Sipas llojit të cënimit të të drejtave të autorit dhe në mbështetje të sanksioneve e të masave të pengimit të cënimit, ligjet për të drejtat e autorit, ndër ta edhe Ligji i Kosovës për të Drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta përmban rregulla për mbrojtjen e së drejtës së autorit. Të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta mbrohen me gjyq në të gjitha sistemet juridike kombëtare. Kjo mbrojtje është e karakterit juridik civil, juridik penal dhe juridik administrative (Besareviq, 2002, 354, Drakuliq, 2002, 365). Në këtë punim do të vështrohen çështjet e mbrojtjes juridiko-penale dhe juridiko-administrative e të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta në vështrim të rregullave juridiko-penale dhe juridiko-administrative në sistemin juridik të Kosovës. Kuptohet se për këtë nuk kemi iluzion se do t'i themi të gjitha që janë të nevojshme për mbrojtjen e së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në këtë fushë, por do të përpiqemi ta themi esencën e mbrojtjes së këtyre të drejtave. Në realizimin e kësaj mbrojtjeje, në sistemin tonë juridik, krahas rregullave të Ligjit për të drejtat e autorit, si rregulla speciale, zbatohen edhe dispozitat e përgjithshme materiale dhe procedurale, të së drejtës penale dhe të procedurës penale, të së drejtës administrative dhe të procedurës administrative po ashtu edhe dispozitat e së drejtës për kundërvajtje, me rastin e shqiptimit të dënimit për kundërvajtje për shkeljen e rregullave të LDADA .

### **Mbrojtja juridiko-penale**

Mbrojtja juridiko-penale për t'u dalluar nga mbrojtja juridiko-civile e së drejtës së autorit që mund të kërkohet në cilindo rast të shkeljes të së drejtës pasurore ose të së drejtës morale të autorit, ka të bëjë vetëm me shkelje që sipas ligjit konsiderohen vepra penale. Disa shtete të Evropës në ligjet e veta penale kanë përcaktuar cilat janë veprat penale kundër së drejtës së autorit, siç janë Franca, Zvicra etj. Mirëpo këto shtete, për ta shtuar efektshmërinë e mbrojtjes juridike të autorëve, dispozitat penale me të cilat mbrohët e drejta e autorëve, nga kodet penale, i kanë bartur në dispozitat e së drejtës së autorit dhe kanë krijuar legjislacion penal të veçantë p.sh. Franca më përpara në vitin 1992, kurse Zvicra më 1999. Edhe Kosova, me LDADA kishte formuar legjislacion penal të veçantë që mbronte të drejtat e autorit. Normimi i këtyre të drejtës së autorit i ka përparësitë e veta, sepse mundëson lidhshmëri më të ngushtë të përshkrimit ligjor të veprës penale kundër së drejtës së autorit, të nevojshme për ta qartësuar dallimin a veçimin e shkaqeve kryesore të veprës penale kundër së drejtës së autorit siç janë: cilat vepra konsiderohen vepra të autorit, kush konsiderohet bartës i së drejtës së autorit, cilat janë llojet dhe përmbajtjet e së drejtës së autorit, sa kohë zgjasin të drejtat e autorit etj. Kosova në kodin e vet penal nuk përcaktonte veçanërisht veprat penale kundër së drejtës së autorit, mirëpo e drejta

jonë, sikur edhe e drejta e shteteve të tjera, me rregulla të veqanta, përcaktonte mbrojtjen juridiko-penale të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të ngjashme në rast të shfrytëzimit të pa autorizuar të tyre. Ligji i të drejtave të autorit, ( LDADA, 209) qe ishte në zbatim deri në vitin 2011 i përcaktonte disa vepra që mund të cilësohen si vepra penale në raste të shkeljës së këtyre të drejtave. Mirëpo me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, në fushën e mbrojtjes juridiko-penale të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta krijohet situatë tjerër normative juridike, sepse dispozitat penale me të cilat mbrohët e drejta e autorëve, nga LDADA, janë bartur në Kodin penal, dhe aktualisht sistemi jone juridik, autorëve u ofron mbrojtje penalo-juridike me dispozitat e përgjithshme te Kodit Penal. Eshtë për tu vënë në dukje se disa shtete, për ta shtuar efektshmërinë e mbrojtjes juridike të autorëve, dispozitat penale me të cilat mbrohët e drejta e autorëve, nga kodet penale, i kanë bartur në dispozitat e së drejtës së autorit dhe kanë krijuar legjislacion penal të veçantë. Mirëpo sistemi juridik i Kosovës nuk ka vepruar ngjajshëm, dhe mund të thuhet se praktika ka treguar se me bartjen e rregullave të përgjegjësive penale nga LDADA në KP nuk i kontribuohet efektshmërisë së mbrojtjes juridiko-penale të autorëve.

Ligjdhënësi, me legjislacionin penal u ofron mbrojtje juridiko-penale autorëve, për mbrojtjen e të drejtave qe u takojnë, në bazë të pronës intelektuale, përkritazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës, dhe të artit. Kodi penal i ka parapa disa vepra penale dhe format e shfaqjes së tyre, si dhe sanksionet penale për cenimin e të drejtave qe sipas Ligjit konsiderohen punë e mbrojtur me të drejtën e autorit ( KP,296 ). Duke pasur parasyshë specifikat e mbrojtjes penalo-juridike të autorëve, në rastet kur u cënohen të drejtat mbi pronën intelektuale dhe nderlikueshmërinë e identifikimit të formave te shfaqjes se veprave penale të përcaktuara me KP, në trajtimet e mëtuqeshme të kësaj mbrojtjeje, imponohet nevoja për ti analizuar dhe për ti zbërthyer vec e vec të gjitha format e veprave penale të përcaktuara me KP. Pra, duke pasur parasysh faktin se cka konsiderohet punë e mbrojtur me të drejtën e autorit, cilat janë subjektet që ndërmarrin veprimet me të cilat cënohen të drejtat e autorit, e që sipas KP konsiderohen vepra penale, dhe cila janë motivet e ndërmarrjes se veprimeve të tilla, mund të thuhet se është e nevojshme për tu vënë në dukje se veprat penale të përcaktuara me legjislacionin penal, mund të ndahen në tri grupe.

1. Në grupin e parë përfshihen veprat penale qe kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave morale të autorit dhe të interpretuesit të veprës (KP, 296 paragrafët , 2, 3 ). Këto vepra paraqiten në disa forma:

**a.** Forma e parë e paraqitjes kësaj vepre penale ka të bëjë me ndërmarrjen e veprimeve nga personat e caktuar lidhur me publikimin e veprës së huaj në emër të vet ose në emër të tjetrit ose po që se në ndonjë mënyrë ose tjetër ia kumton publikut veprën e huaj ose interpretimin e huaj. Baza juridike e përgjegjësive per këtë veper penale është fajësia, sepse kjo vepër penale kryhet me dashje direkte. Dashja në këtë rast duhet të përfshijë vetëdijen se në emrin e vet apo të tjetrit ( pa autorizim) e shfaq, apo në ndonjë mënyrë tjetër ia kumton publikut punen e mbrojtur me të drejtën e autorit Për këtë formë të veprimit ( KP, 296.1) për vepër penale, parasheh dënim me gjobë dhe me burgim prej tre muaj deri tre vjet .

**b.** Forma e dytë ka të bëjë me rastin kur shfrytëzuesi i veprës së autorit, shfrytëzuesi i interpretimit të interpretuesit, me qellim nuk i tregon emrin, pseudonimin apo shenjën e autorit ose të interpretuesit edhe pse për këtë është i obliguar me ligj. Kryes i kësaj forme të veprës penale mund të jetë cdo person, i cili merret me përdorimin e punës së mbrojtur me të drejtën e autorit. Edhe për këtë vepër baza e përgjegjësive penale përcaktohet në



bazë të fajsisë, sepse kjo veprë kryhet me dashje por mund të kryhet edhe nga pakujdesia. Për këtë veprë penale ligdhënesi ka paraparë dënimin me gjobë dhe me burgim deri në një vit ( KP, 296.2 ).

**c.** Forma tjetër e paraqitjes së veprës penale ka të bëjë me rastin e dëmtimit të veprës së autorit ose me interpretimin e huaj dhe me publikimin e saj si të tillë dhe me rastin kur vepra e autorit ose interpretimi publikohet ose interpretohet para publikut si e dëmtuar. Punë e mbrojtur me të drejtën e autorit sipas KP konsiderohet e dëmtuar në rastet kur prishet forma, kuptimi ose vlera e saj. Pra vlen të theksohet se qëllimi i ligdhënesit është mbrojtja e autorit nga pasojat që mund të shfaqen nga kumtimi i punës së autorit nga paraqitja e tjetrit publikut si të ndryshuar, shtrëmbuar ose të dëmtuar. Të gjitha veprimet që ndërmerrën në drejtim të shkakimit të pasojave të përmendura konsiderohen vepra penale të kryera me dashje direkte. Për këtë veprë penale KP, parasheh dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në një vit, ( KP, 296.3)

**d.** Forma tjetër e paraqitjes së veprës penale ka të bëjë me shfrytëzimin e palejueshëm të veprës së autorit, ose me shfrytëzimin e lëndës nga të drejtat e përafërta. Kjo veprë kryhet me paraqitjen e punës së mbrojtur nga e drejta e autorit, para publikut, ose me paraqitjen e interpretimit të tjetrit në mënyrën e pa përshtatshme e cila krijon paragjykimin për nderin dhe autoritetin e autorit dhe interpretuesit. Me këtë dispozitë legjislacioni penal mbron veprat e autorit dhe interpretimin e interpretuesit, por edhe nderin dhe autoritetin e tyre. Pra veprimet me të cilat kryhet kjo veprë ndërmerrën me vetëdije, sepse kryerësi i kësaj veprë është i vetëdijshëm se është duke e dëmtuar punën e mbrojtur nga e drejta e autorit, po ashtu edhe nderin e autorit dhe të interpretuesit. Prandaj mund të themi se kjo veprë penale kryhet me dashje, sepse kryerësi i veprës me vetëdije ndërmerr veprimet e ndaluara me qëllim për ti shkakuar pasojat e dëmshme për nderin dhe autoritetin e autorit dhe të interpretuesit. Prandaj, në këtë rast, për dëmtimin e nderit dhe te autoritetit, që janë objekt i mbrojtjes juridiko-penale, ligjdhënësi ka përcaktuar dënimin me gjobë ose me burgim deri në një vit,(KP,296.4).

2. Në grupin e dytë bëjnë pjesë veprat penale që kanë të bëjnë me përdorimin e punës së mbrojtur me të drejtat e autorit ose të lëndëve nga të drejtat e përafërta, pa autorizim dhe format e paraqitjes se tyre.

**a.** Forma e parë e paraqitjes ka të bëjë me shfrytëzimin e palejueshëm të veprës së autorit ose me shfrytëzimin e lëndës nga të drejtat e afërta. Legjislacioni penal e ka inkriminuar përdorimin e punës së mbrojtur me të drejtën e autorit ose të lëndëve nga të drejtat e përafërta, pa autorizimin e autorit, sepse vepra e autorit është e drejtë ekskluzive e tij për mbrojtjen e së drejtes mbi veprën e vet. Ajo e drejtë mund të shfrytëzohet nga personat e tjerë vetëm me autorizimin e autorit. Prandaj, duhet theksuar se cdo person i cili publikisht e përdor punën e mbrojtur me të drejtën e autorit, pa autorizim, bënë veprë penale, sepse me vetëdije i ndërmerr veprimet e kundersligjshme me të cilat shkaktohet pasoja e dëmshme për autorin Prandaj, me të drejtë mund të themi se ligjdhënësi për ti ofruar mbrojtje juridiko-penale autorit, për këtë formë të veprës penale ka përcaktuar sanksionin penal me burgim deri në tre vjet, (KP,296.6).

**b.** Formë tjetër e veprës penale paraqitet me shfrytëzim, pa leje të veprës së autorit ose të drejtave të përafërta duke i sjellë vetës ose të tjerëve përfitime materiale. Kjo formë e veprës penale sipas legjislacioni penal konsiderohet formë e kualifikuar e veprës penale dhe kryhet atëherë kur kryerësi ndërmerr veprime të kundersligjshme me qëllim përfitimi për vete ose për tjetrin së paku 10.000 euro, por më pak se 50.000 euro. Për këtë veprë penale KP parasheh dënim me burgim prej tre muajve deri pesë vjet.

**c.** Edhe për formën tjetër të kësaj veprë penale të sanksionuar me KP parashihet dënimi

me burgim me kohëzgjatje prej gjashtë muaj deri tetë vjet. Ky dënim, për këtë veër parashihet për restet kur shfrytëzuesi i pautorizuar arrin përfitime ekonomike për vete ose për të tjerët në shumë më së 50.000 euro, (KP, 296.7) Edhe kjo formë e veprës penale konsiderohet e kualifikuar, sepse të gjitha veprimet e kryerit për ti sjellë vetes ose të tjerëve përfitime materiale, për kryerjen e kësaj vepre ndërmerrën me dashje.

3. Vepra e tretë penale, sipas legjislacionit penal, ka të bëjë me shmangien e masave teknologjike efektive (KP, 297). Konsiderohet se një person i ka cënuar të drejtat ekskluzive që mbrohen nga e drejta e autorit, nëse është bërë çfarëdo veprimi për t'i shmangur masat teknologjike efektive ose ndonjë veprim për heqjen ose ndryshimin e informacionit elektronik të administrimit të të drejtave. Përcaktimi i sanksionit penal për këtë veper ka për qëllim shtrirjen e mbrojtjes juridiko-penale masave teknologjike. Duhet të përmendet se me rastin e ndërmarrjes e veprimeve për shmangjen e këtyre masave kryersi ka qenë i vetëdijëshëm se po ndërmerr veprime të kundërligjshme, prandaj konsiderohet se veprimet e tilla janë ndërmarrë me dashje direkte. Për këtë veper penale Legjislacioni penal parashih dënim me burgim deri tre vjet, (KP, 297).

### **Mbrojtja juridiko-administrative**

Krahas mbrojtjes juridiko-civile dhe mbrojtjes juridiko-penale kanë edhe mbrojtje juridiko-administrative ( Aliu, 2004 ). Kjo mbrojtje e së drejtës, i ofrohet autorit, sepse mbrojtja penale nuk mund t'u sigurojë mbrojtje të plotë për të gjitha shkeljet që mund t'i bëhen këtyre të drejtave, sepse të gjitha ato nuk mund të cilësohen e të ndëshkohen si vepra penale, por ndëshkohen si kundërvajtje edhe pse përshkrimi i kundërvajtjes dhe i veprës penale janë të ngjajshme. Rregullat e së drejtës administrative u sigurojnë mbrojtje juridike autorëve, përveç rasteve, kur shkelës të këtyre të drejtave janë personat fizikë, edhe në rastet kur këto të drejta shkelën nga personat juridik si psh Shoqatat për administrimin kolektiv të të drejtave (SHAK) institucionet radiodifuzive etj (Hennenberg, 2001, 20, Josipoviq, 2002, 55 ). Për të gjitha shkeljet LDADA, në kuadër të dispozitave ndëshkimore për shkelësit e të drejtave të autorit, parashih dënime për kundërvajtje ( LDADA,190). Rregullativa juridike administrative, me qëllim të ofrimit të mbrojtjes juridike autorëve, në dispozitat ndëshkimore ka përcaktuar sanksionin për kundërvajtje për personin juridik dhe përfaqësuesin ligjor të tij që shfrytëzon pa leje veprën e autorit ose të drejtat e përafërta me to (LDADA, 190.1 dhe 190.2.). Me këto dispozita është përcaktuar dënimi për kundërvajtjen e personit juridik, përfaqësuesit ligjor të tij dhe personit fizik, për shmangie të masave efektive teknologjike të mbrojtjes, (LDADA nenet 191.1.1, 191.1.2, dhe191.2). Ligjdhënësi në dispozitat ndëshkimore ka përcaktuar sanksione për kundërvajtje edhe për personat juridik, përfaqësuesit ligjor të tyre dhe personat fizik që brenda afatit të caktuar nuk i dërgon SHAK. të dhëna për llojin dhe për numrin e mjeteve të shitura ose të importuara për fiksimin e zërit ose të pamjeve, për fotokopjimin të bartësve të zbrazët të zërit ose të pamjeve si dhe të dhënat për numrin e fotokopjeve të bëra që nevojiten për llogaritjen e kompensimit të veçant. Ligji për të drejtat e autorit ka përcaktuar ndëshkime për kundërvajtje edhe ndaj subjekteve që e pamundësojnë kontrollin e dokumentacionit, që ka të bëjë me detyrimin e dhënies së informacionit që ndërlihet me mbrojtjen e interesit të autorëve, (LDADA, 192.1.1., 192.1.2 dhe 192.2). SHAK dhe përfaqësuesi i saj ligjor dënohen për kundërvajtje nëse nuk mbajnë ose mbajnë pa kujdes evidencën dhe kontabilitetin. Këto subjekte ndëshkohen edhe në rastet kur nuk ia përcjell titullarit të së drejtës të ardhurat e tërësishme nga kompensimet e mbledhura prej shfrytëzuesve të lëndëve të mbrojtura. Rregullativa juridike administrative përcakton sanksionin edhe për

mospërfilljen e kërkesës për revizionin e veprimtarisë financiare nga ana e revizorëve të pavarur, po ashtu edhe për moseliminimin e parregullësive sipas urdhërit të organit mbikëqyrës (LDADA, 193.1, 193.2). Ky ligj në dispozitat ndëshkimore parasheh mundësinë e konfiskimit të sendeve të përfituara me kryerjen e kundërvajtjes, (LDADA, 194). Me këtë ligj, përveq konfiskimit, përcaktohet edhe çështja e sekuestrimit të përkohëshëm të mallrave, të mjeteve ose të materialeve të përdorura, ose që janë dedikuar për kryerjen e kundërvajtjes dhe atyre që janë përfituar me kryerjen e kundërvajtjes. Kjo bëhet në rastet kur personi i autorizuar për inspektim ose organi policor gjatë veprimeve të mbikëqyrjes dyshon se është bërë kundërvajtje e përcaktuar në kreun -II- të Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta. Gjërat e sekuestruara përkohësisht, në fillim të procedurës për kundërvajtje i dorëzohen gjykatës kompetente të kundërvajtjeve, (LDADA, 184 ). Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje sipas këtij ligji e bënë subjekti që i janë shkelur të drejtat, organi i administratës kompetente për inspektim, organi kompetent policor. Po ashtu, kërkesën për fillimin e procedurës mund ta bëjë edhe organi i administratës kompetente për pronësinë intelektuale ose SHAK ( LDADA, 195).

### **Perspektiva, suksesi dhe veshtërsitë rreth mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta**

Pa dyshim duhet të theksohet se të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta kanë perspektivë në mbrojtjen e tyre. Kështu është dhe duhet të jetë, sepse në të drejtën bashkëkohore ekzistojnë edhe kushtet e volitshme në këtë drejtim, sepse ekziston rregullativa nacionale dhe e unifikuar për një besim të qëndrueshëm në të. Andaj vetëm duhet një zbatim efektiv i kësaj rregullative dhe të ndihmoj që të krijoj një situatë të volitshme në këtë përcaktim. Kuptohet se këtë zbatim duhet ta bëjnë njerëzit me njohuri të konsiderueshme profesionale në këtë fushë të së drejtës. Për këtë perspektivë dhe sukses në mbrojtjen e këtyre të drejtave kontribut evident japin si gjykatat e kompetencës së përgjithshme ashtu edhe gjykatat e veçanta në ato shtete ku janë të formuara edhe më herët, nga se, nëse kjo gjyqësi funksionon si duhet dhe sa duhet në mbrojtjen e këtyre të drejtave, atëherë nuk ka dyshim se ky orientim do të jetë i realizueshëm dhe i qëndrueshëm (Samargjiq, 2002, 1038 ). Nga ana tjetër kjo perspektivë dhe suksesi në mbrojtje gjithsesi do t'i kontribuoi ardhmërisë së njeriut, zhvillimit kulturor, civilizimit juridik si dhe civilizimit në përgjithësi në vend dhe më gjërë. Realizimi i suksesit dhe krijimit të perspektivës në mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, ka pengesa dhe vështërsi të ndryshme, që si duket gjithnjë duhet pasur parasysh. Pengesa kryesore është moszbatimi i kësaj rregullative si duhet dhe sa duhet. Kjo mund të jetë rrjedhojë e zbatimit të dobët të së drejtës materiale e procedurale, dhe moskordinimit të infrastrukturës që ekziston në vend dhe që mund të ndihmoj në këtë drejtim. Mungesa e këtij ambienti në këtë lëmi është pengesë e evidente në këto tentime. Krijimi i perspektivës dhe i suksesit në këtë lëmi kaq të ndjeshme nuk është i lehtë, por duhet pasur parasysh dobinë që sjell, duhet angazhim si përventivë, poashtu duhet të jetë edhe preokupim permanent. Në këtë mënyrë krijohen parametrat reale që të bëhet mbrojtja adekuate e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.

Perspektiva dhe suksesi i mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe i të drejtave të përafërta në Kosovë pa dyshim duhet të ekzistoj, sepse rregullativa juridike vendore, e aplikueshme, dhe rregullativa e unifikuar që formojnë të drejtën bashkëkohore krijojnë besimin e qëndrueshëm për perspektivën dhe suksesin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në Kosovë. Por për këtë perspektivë dhe sukses nevojitet zbatimi efektiv i kësaj rregullative nga ekspertët e kësaj fushe dhe nga kontributi që do ta japin

gjykatat kompetente për këtë çështje. Mirëpo realizimi i kësaj perspektive gjithnjë do të hasë në pengesa dhe që gjithmon duhet pasur parasysh. Shkaktari kryesor i paraqitjes së pengesave për këtë çështje është moszbatimi i kësaj rregullative si duhet dhe sa duhet. Mirëpo krijimi i perspektivës dhe suksesit në këtë fushë shumë të ndjeshme në Kosovë nuk është i lehtë, por duke marrë parasysh dobinë që sjell ai nevoitet angazhim preventiv dhe preokupim i përhershëm për ta realizuar atë duke angazhuar tërë infrastrukturën e nevojshme në funksion të këtij qëllimi (Alishani, 2006, 332).

### **Përfundimi**

Në përfundim të këtij punimi, në të cilin u trajtuan aspektet e mbrojtjes juridiko-penale dhe juridiko-administrative të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të përafërta, në vështrim të ligjit të zbatueshëm në Kosovë dolën disa konkluzione. Nga analizat e bëra në punim mund të thuhet se e drejta e autorit konsiderohet e drejta më e rëndësishme e titullarëve sipas të drejtës nacionale dhe asaj të unifikuar. Mirëpo kjo rëndësi nuk shprehet vetëm ndaj bartësve të së drejtës së autorit, por edhe ndaj bartësve të sistemit juridik të kësaj fushe. Duke marrë parasysh këtë, vlen të theksohet se rregullativa juridike e kësaj fushe ka bërë vazhdimisht përpjekje për ta organizuar sa më mirë mbrojtjen e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të përafërta. Mbrojtja juridiko-penale dhe juridiko-administrative e së drejtës së autorit në vështrim të ligjeve të zbatueshme në Kosovë dhe mënyra se si realizohet ajo mbrojtje, janë gjëra që e preokupojnë shoqërinë tonë. Vlen të theksohet se kjo mbrojtje është e evidente në rregullativën juridike të kësaj fushe të së drejtës, mirëpo preokupim mbetet vetëm zbatimi funksional i saj. Duhet theksuar se për këtë fushë të së drejtës rregullativa është e vecantë, mirëpo kjo nuk e përjashton as zbatimin e rregullave të përgjithshme. Këto të drejta parimisht gëzojnë mbrojtje gjyqësore dhe mënyrën se si duhet të realizohet ajo mbrojtje nga bartësit ose titullarët e këtyre të drejtave dhe fituesit e të drejtave ekskluzive. Këtë mbrojtje, sipas rregullativës së aplikueshme mund ta realizojë individi i caktuar ose mund të organizohet mbrojtje kolektive që aktualisht në praktikë në vendin tonë nuk është në nivel të kënaqshëm. Hulumtimet në fushën e së drejtës së autorit rreth mbrojtjes juridiko-penale dhe juridiko-administrative na sjellin në konkluzionin se të drejtat e autorit si dhe mënyra e mbrojtjes së tyre janë në shkallë jo të lakmueshme. Këtë e dëshmon fakti se në këtë fushë ka shkelje të shumta, ka pasiguri juridike për shkak të cënimeve të shumta të cilat paraqesin shkelje të rregullativës të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të përafërta. Nga ana tjetër, vërehet nevoja për zbatimin funksional të kësaj rregullative, kuptohet se në këtë drejtim vështirësitë janë të dukshme por me rregullativë të duhur dhe me profesionistë të shquar synimet e mbrojtjes do të sillen në suaza të normales që do tu përshtateshin në masë rrjedhëve të njëmëndësisë së jetës shoqërore në vend. Pengesë tjetër e zbatimit të mbrojtjes të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të përafërta paraqesin edhe mungesa e funksionimit të institucioneve përkatëse, që nga ato vendimmarrëse e deri tek ato implementuese, që do ta bënin më efektiv sistemin e mbrojtjes juridike në këtë fushë të së drejtës. Në mungesë të këtyre institucioneve shkaktohen pengesa të vazhdueshme për të ndërmarre masa të nevojshme për ti arritur trendet bashkëkohore, për ti evituar pengesat e paraqitura në fushën e mbrojtjes të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të përafërta.

## Shkurtesat

LDADA – Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta i Republikës së Kosovës,

KP – Kodi penal i Republikës së Kosovës,

SHAK- Shoqata për administrimin kolektiv të të drejtave

## Literatura

Aliu, A. (2004). E Drejta e Autorit, Prishtinë.

Aliu, A. (2013). E Drejta Civile, Prishtinë.

Kadriu, O. (2008). Hyrje në të Drejtën Civile, Shkup.

Kondili, V. (2008). E Drejta Civile I - Pjesa e përgjithshme, Tiranë.

Alishani, A. (2006). Studime nga e drejta e detyrimeve, pjesa II, Prishtinë.

Gams, A. (1972). Hyrje në të drejtën civile, Prishtinë.

Hennenberg, I. (2001). Pravna zastita autorskog prava, Zagreb.

Hennenberg, I. (2002). Autorsko pravo, Zagreb.

Besareviq, V. (2002). Intelektualna svojina i autorsko pravo, Beograd.

Drakulij, M. (2002). Intelektualna svojina i poslovanje, Beograd.

Josipoviq, I. (2002). Prekersaji protiv autorskog prava, Zagreb.

Vukoviq, P. S. (2005). Komentar zakona o autorskom pravu i srodnim pravima, Beograd.

Krstiq, J. (2005). Kriviqnopravna zastita prava intelektualne zvojine, Beograd.

Samargjiq, M. (2002). Neke karakteristike nasih propisa iz oblasti autorskog prava, PZH/11, Beograd.

Samargjiq, M. (2002). Kolektivna zastita autorskog prava- dosadasnja iskustva i moguqa resenja, PZH.br 11 (1979) Pravna enciklopedija savremena administracija, Beograd.

Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta i Republikës së Kosovës, nr 04/L-065.  
Kodi penal i Republikës së Kosovës, nr 04 / L – 082.

Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare, shkencore dhe artistike, 9. 2. 1886, e plotësuar në Paris me 4. 5. 1896, e rishikuar në Berlin me 13. 11. 1908, e plotësuar në Bern me 20. 3. 1914, e rishikuar në Romë me 29. 6. 1928, e rishikuar në Bruksel me 26. 6. 1948, në Stokholm me 14. 1. 1967 dhe në Paris me 24. 7. 1971.

## Roli dhe zhvillimi I NVM-ve në Kosovë dhe rajon

**Ma.Sc. Pllashniku Mehdi, PhD.Cand**

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - ARBK Prishtinë*

### Abstrakt

Përmes këtij abstrakti do mundohem që të paraqes punimin, që ka nevojë për një trajtim shkencor. Meqenëse u krijuan rrethana të reja pas luftës është nevojë imediate për ndërtimin dhe krijimin e një mentaliteti të ri për rolin dhe zhvillimin e NVM-ve në Kosovë dhe Rajon.

Punimi do të konsistojë në mbledhjen e materialeve mbi pjesën teorike, doktrines dhe legjislacionit kosovar dhe të huaj në këtë rast mbi rolin dhe zhvillimin e NVM-ve.

Në mbledhjen e materialit dhe elaborimi i legjislacionit përkatës të Kosovës në lidhje me rolin dhe zhvillimin e NVM-ve dhe legjislacionit të Shteteve në Rajon.

Studimi i NVM-ve dhe i risive më të fundit në këtë fushë në nivel kombëtar dhe europian, paraqet një rëndësi të veçantë lidhur me rolin dhe zhvillimin e NVM-ve. Në dekadën e fundit gjendja duket se ka ndryshuar, respektivisht është në fillim të një ndryshimi, sepse është shtuar interesi për tematikat për rolin dhe zhvillimin e NVM-ve në nivelin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Punimi do të strukturohet në dy pjesë:

Në pjesën e parë do të bëhet elaborimi i legjislacionit përkatës të Kosovës dhe shteteve në rajon në lidhje me rolin dhe zhvillimin e NVM-ve.

Në pjesën e dytë do të bëhet fjalë për Statistikat e Ndërmarrjeve sipas Statusit Ligjor, Sektorve, Numrit të Punësuarve etj.

Punimi do të analizojë rolin dhe zhvillimin e NVM-ve në përgjithësi si dhe në fund do të ketë një përmbledhje nga çfarë kemi cekur më lartë, në formë analitike, rekomandimet dhe konkluzionet.

**Fjalë kyçe:** *Zhvillimi i NVM-ve, Ndërmarrjet në Shqipëri, mikro ndërmarrjet, zhvillimi i ndërmarrjeve, Agjencioni ARBK, ndërmarrjet publike dhe private.*

### Hyrje

Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik mundëson krijimin e vendeve të reja të punës, kjo varet nga zhvillimi i sektorit privat. Në Kosovë që nga viti 2000 e deri me sot janë të regjistruara 134545 biznese, shumica prej tyre rreth 98% janë të regjistruara si ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM).

Për zhvillimin me sukses të këtyre bizneseve duhet të kenë një mbështetje si nga niveli lokal ashtu edhe nga niveli qendrorë me qëllim të krijimit të kushteve më të përshtatshme për zhvillimin e NVM-ve. Po ashtu rreth 10% e këtyre bizneseve janë biznese që e shuajnë aktivitetin e tyre dhe kjo na shtynë të mendojmë dhe të angazhohemi se cilët janë ata faktorë që qojnë deri te shuarja apo pasivizimi i këtyre bizneseve. Sipas një hulumtimi të aplikacioneve të dorëzuara në Agjencionin e Regjistrimeve të Bizneseve në Kosovë, shumica prej tyre janë deklaruar se deri te mbyllja ka ardhur përshkak të: konkurrencës jolohale, mungesa e kapitalit, tatimet e shumta, evazioni fiskal si dhe arsye të tjera.

Për zhvillimin me sukses të NVM-ve nevojitet edhe një përkrahje nga institucionet si në nivelin lokal ashtu edhe qendrorë që të krijohen Zona Ekonomike që do të ndikojnë në rritjen, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e bizneseve.

## Qëllimi

Qëllimi i punimit është identifikimi i faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Kjo do të ndikonte në marrjen e masave preventive për:

- Krijimin e zonave ekonomike,
- Lehtësimin në marrjen e Kredive me kamata të buta,
- Ndikimin e zonave ekonomike në krijimin e vendeve të reja të punës, në krijimin e të ardhurave, marrjen e teknologjive të reja, rritjen e bashkëpunimit mes bizneseve, rritjen e konkurrencës, etj.

## Nocioni dhe përkufizimi i NVM-ve

Për të identifikuar biznesin se në cilën kategori të ndërmarrjeve bënë pjesë sipas BE-së duhet të vendosë të dhënat e biznesit në bazë të kriterëve:

- Numri i punëtorëve,
- Qarkullimi vjetorë,
- Bilanci vjetorë.

Në bazë të 3 (tri) kriterëve të lartpërmendura do të vijmë deri te përcaktimi i madhësisë së ndërmarrjes.

Sipas BE-së përcaktimi (definimi) i NVM-ve bëhet përmes numrit të punësuarve, qarkullimit vjetorë si dhe bilancit vjetorë, mirëpo tejkalimi i njërit nga kriteret matës nuk do të thotë se humbin statusin. ( SME definition, user guide and model declaration

[http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sme/files/sme\\_definition/sme\\_user\\_guide\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enterprise/policies/sme/files/sme_definition/sme_user_guide_en.pdf)) Për të argumentuar atë që u cek më lartë marrim p.sh. bizneset sipas aktiviteteve, aktiviteti i tregtisë na paraqitet më shumë se ato të qarkullimit në aktivitete prodhuese, çka mund të vijmë në përfundim se faktori kryesorë për definimin e NVM-ve është numri i të punësuarve.

Pra, numri i të punësuarve është kriteri kryesorë për përcaktimin e madhësisë së ndërmarrjeve e sidomos në bizneset e reja.

Qarkullimi vjetorë përcaktohet duke i mbledhur të ardhurat që ndërmarrja kishte gjatë vitit nga prodhimi, shitja, shërbimet, etj.

Bilanci total vjetorë është vlera e asetëve kryesore të ndërmarrjes.

## Definimi i NVM-ve sipas Komisionit Evropian

Kategorizimi i Ndërmarrjeve	Numri i Puntorëve	Qarkullimi Vjetorë	Bilanci Vjetorë
Mikro Ndërmarrje	<10	≤ 2 milion €	≤ 2 milion €
Ndërmarrje e Vogël	< 50	≤ 10 milion €	≤ 10 milion €
Ndërmarrje e Mesme	<250	≤ 50 milion €	≤ 43 milion €

## Definimi i NVM-ve në Kosovë

Ekzistojnë kriterë të përgjithshme që përcaktojnë biznesin mikro, të vogël, të mesëm në krahasim me bizneset e mëdha. Kriteri më i përgjithshëm për përkufizimin e bizneseve

është definimi i Ndërmarrjeve Mikro të Vogla dhe të Mesme (NMVM). Në Kosovë biznesi është i definuar me Ligjin Nr.02/L5 si dhe me Ligjin Nr.03/L-031 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. (Ligji Nr.02/L5 për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë)

<b>Klasifikimi i Ndërmarrjeve</b>	<b>Numri i Punëtorëve</b>
Mikro Ndërmarrje	1 deri 9 punëtorë
Ndërmarrje e Vogël	10 deri 49 punëtorë
Ndërmarrje e Mesme	50 deri 249 punëtorë
Ndërmarrje e Madhe	Mbi 250 punëtorë

### **Definimi i NVM-ve në Shqipëri**

Politikat shtetërore në Shqipëri për klasifikimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, rregullohen me Ligjin Nr.8957 për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe me Ligjin Nr.10042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.8957 të datës 17.10.2002 për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. (Ligji Nr.8957, datë 17.10.2002 për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme dhe Ligji Nr.10042, datë 22.12.2008, me ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.8957 datë 17.10.2002 për Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme në Shqipëri.)

<b>Klasifikimi i Ndërmarrjeve</b>	<b>Numri i Punëtorëve</b>
Mikro Ndërmarrje	1 deri 9 punëtorë
Ndërmarrje e Vogël	10 deri 49 punëtorë
Ndërmarrje e Mesme	50 deri 249 punëtorë
Ndërmarrje e Madhe	Mbi 250 punëtorë

### **Definimi në Maqedoni**

Në Maqedoni ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, janë të parapara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Përkufizimi i NVM-ve është gjerësisht, por jo tërësisht në përputhje me atë të BE-së. (Comparative analysis of factors from marketing and legal perspective and policies that affect SNEs in Macedonia and EU <http://eprints.uged.mk/1923/1/Final%20Paper.pdf>.)

<b>Klasifikimi i Ndërmarrjeve</b>	<b>Numri mesatar i të Punësuarve</b>	<b>Qarkullimi Vjetor</b>	<b>Vlera Mesatare e Totalit të Aseteve</b>
Mikro Ndërmarrje	<10	<50.000€	-
Ndërmarrjet e Vogla	<50	<2.000.000€	<2.000.000€
Ndërmarrje e Mesme	<250	<10.000.000€	<11.000.000€
Ndërmarrje e Madhe	-	-	-

### **Zhvillimi i NVM-ve**

Zhvillimi ekonomik dhe rritja e qëndrueshme ekonomike janë prioritetet kryesore strategjike të Kosovës. Zhvillimi ekonomik i Kosovës ka kaluar në periudha të ndryshme të zhvillimit, në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore kishim një sistem Socialist Centralist që u aplikua në ish Republikën Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ). Në atë kohë Kosova ishte një vend tipik agrarë pa industri të zhvilluar. Në vitet e 80-ta, vendi kishte një strukturë më të favorshme në krahasim me periudhën e kaluar, e cila



përbëhej nga NVM-të, si dhe nga ndërmarrjet e mëdha prodhuese, produktet e të cilave eksportoheshin jo vetëm në ish- RSFJ-në por edhe në vendet tjera duke përfshirë edhe tregjet e Evropës perëndimore. Përbërja e ekonomisë ishte nga sektorë të ndryshëm, si: industria dhe mineralet me 47.5% të produkteve vendore në Kosovë, bujqësia me 20.80%, tregtia me 12%, ndërtimtaria me 6.80% dhe infrastruktura e transportit dhe komunikimit me 4.5%. Rritjet e theksuara në themelimin e NVM-ve shënohen në vitet 1990 – 1994. Themelimi i këtyre ndërmarrjeve nuk ishte rezultat i kushteve por ishte si rezultat kur njerëzit për të mbijetuar pasi ishin larguar nga puna, hapen bizneset e tyre si alternativë për punësim të vetin dhe familjes. Kjo periudhë zgjati deri në vitin 1999, kur shumica e këtyre bizneseve u shkatërruan nga lufta.

Korniza e parë e pasluftës lidhur me Shoqëritë Tregtare është themeluar për të parën herë përmes Rregullores së UNMIK-ut 2000/8 për regjistrimin e përkohshëm të bizneseve, e cila detyroi të gjithë operatorët ekonomik në Kosovë të regjistronë bizneset e tyre në Departamentin për Tregti dhe Industri pranë UNMIK-ut.

Me datën 8 Shkurt 2001, hynë në fuqi Rregullorja 2001/6 për Shoqëritë Tregtare e cila paraqet kornizën e parë gjithëpërfshirëse të themelimit dhe organizimit të Shoqërive Tregtare në Kosovë, e cila buron dhe mbështetet në parimet e ekonomisë së lirë. (Rregullorja Nr.2001/6 për Shoqëritë Tregtare.) Përmes kësaj rregullore themelohet edhe Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare (ARBK), si agjenci ekzekutive e organizuar në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Kjo kornizë ligjore hap rrugë për themelimin e formave të shoqërive që njohin të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

Me nxjerrjen e kësaj rregullore filloj edhe regjistrimi i përkohshëm i bizneseve dhe deri me 17.03.2003 u regjistruan 43378 biznese të reja. Ky numër i regjistrimit të bizneseve vazhdoi të rritet çdo vit e më shumë, deri tani me datë 30.11.2014 figurojnë 134545 biznese të regjistruara. Pavarësisht kësaj, Kosova është ende në fazën e tranzicionit ku ndërmarrësia dhe krijimi i NVM-ve pritet të luaj rol të rëndësishëm në rrugën drejt një ekonomie moderne të tregut të lirë edhe drejt zhvillimit dhe rritjes ekonomike. Në përgjithësi shërbejnë si motor kryesor i hapjes së vendeve të punës në ekonominë në zhvillim dhe në tranzicion, duke përfaqësuar mbi 70% të vendeve të punës. Po ashtu zhvillimi i NVM-ve ofron shumë mundësi punësimi, që ndihmojnë në zvogëlimin e nivelit të papunësisë dhe në përbalimin e sfidave demografike të këtyre popullatave, të cilat janë në rritje të shpejtë. Zhvillimi i sektorit të NVM-ve mund të kontribuojë në përforcimin e konkurrueshmërisë dhe të prodhueshmërisë, duke nxitur njëkohësisht rritjen e të ardhurave të vendit.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë shumë fleksibile ndaj ndryshimeve inovative dhe përshtatshmërisë se tregut. Pra, duke ditur rëndësinë e NVM-ve në krijimin e vendeve të punës, zbutjen e papunësisë, rritjes ekonomike dhe novacionit, qeveritë duhet të marrin masa për stimulimin e zhvillimit të NVM-ve.

Stabiliteti legjislativ është një nga elementet kyçe për një mjedis politik që mbështet klimën e fuqishme të biznesit dhe investimeve. Ndërmarrjet ndërnacionale parapëlqejnë të investojnë në vende me klimë të shëndetshme biznesi ku kostot, vonesat dhe risku janë të minimizuara. NVM-të janë më të pritura të lulëzojnë në një klimë ku nuk rëndohen së tepërmi me taksa dhe rregullime, procedura, burokraci dhe ku nuk ka korrupsion.

### **Statistikat e ndërmarrjeve sipas statusit ligjor**

Avancimi i sistemit ka ndikuar që të ndryshojë numri dhe struktura e bizneseve në ekonominë kosovare. Të dhënat nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare të

regjistruara sipas tipit të organizimit që nga viti 2000 deri me 30 Gusht 2014. ( Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë – MTI)

Tabela: Ndërmarrjet sipas madhësisë dhe statusit ligjor

Llojet e Bizneseve	M i k r o ndërmarrjet	Ndërmarrje e Vogla	Ndërmarrjet e Mesme	
Biznesi individual	112484	795	43	3
Ortakëri e përgjithshme	3321	98	13	1
Shoqëria komandite (ortakëri e kufizuar)	33	2	8	1
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK)	10975	754	136	16
Shoqëri Aksionar (SHA)	307	34	49	21
Kompani e Huaj	571	52	20	4
Ndërmarrje Shoqërore	5	6	12	2
Ndërmarrje Publike	0	1	7	2
K o o p e r a t i v a t Bujqësore	46	37	0	0
Ndërmarrje tjera nën juridiksion të AKM	0	0	0	1

**127742 1779 288 51**

### Statistika e ndërmarrjeve sipas sektorve

Nëse shikojmë regjistrin e regjistrimit të ARBK-së, shihet se ndërmarrjet që aktivitet kryesor e kanë tregtinë dominojnë në krahasim me ndërmarrjet me aktivitetet tjera, ndërsa vërehet se ndërmarrjet që aktivitet kryesorë e kanë peshkatarinë janë në numrin më të vogël, si dhe veprimtaritë tjera ekonomike konkretisht ekonomit shtëpiake, ndërsa nëse shikojmë organizatat dhe trupat ndërkombëtarë shihet se nuk kemi asnjë regjistrim. Tabela, regjistrimi i NMVM-ve sipas sektorëve nga viti 2000 deri më 31 gusht 2014. (Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë – MTI)

Spektori	Përshkrimi	NVM-të, sipas Sektorve (%)
	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria	4081
B	Peshkimi	52
C	Industria përpunuese	695
D	Industria përpunuese	12731
E	Furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë	204
F	Ndërtimtaria	9617
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve motorike, motoçikletave, mallrat personale dhe të amvisërisë	54198
H	Hotelet dhe Restorantet	13262
I	Transporti, depot dhe telekomunikacioni	15696
J	Aktivitetet financiare	405

K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira dhe aktivitetet e biznesit	7747
L	Administrimi dhe mbrojtja publike, mbrojtja e obligueshme sociale	289
M	Arsimi	1117
N	Shëndetësia	2100
O	Aktivitetet tjera shoqërore (soc) dhe personale	7653
P	Ekonomitë shtëpiake private, me p.të punësuar	13
Q	Organizatat dhe trupat ndërkombëtare	0
	TOTAL	100.00

### Numri i ndërmarrjeve të klasifikuara nëpër komuna

Nëse i japim një vështrim të përgjithshëm ndërmarrjeve të regjistruara nëpër komuna që nga viti 2000 deri me 30.11.2014 ai duket si në tabelën më poshtë. (Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë – MTI)

ID	B.I.	O.P	O.K	SH.P.K.	SH.A	K.H.	N.SH	N.P.	K.B.	AKM	TOTAL
<b>Komuna</b>											
1.Deçan	1832	24	0	78	4	1	0	0	1	1	1941
2.Gjakovë	6207	126	24	534	33	8	0	1	6	31	6970
3.Drenas	3015	36	1	137	3	8	0	0	5	0	3205
4.Gjilan	7760	154	2	548	16	17	0	1	4	0	8502
5.Dragash	1095	11	0	21	1	0	0	0	6	0	1134
6.Istog	2174	28	0	133	4	3	0	0	5	0	2347
7.Kaçanik	2398	59	3	125	1	4	2	0	0	0	2593
8.Klinë	2203	38	2	84	9	2	1	0	4	0	2344
9.F.Kosovë	2946	79	3	412	13	24	0	0	0	0	3477
10.Kamenicë	2155	51	0	70	1	1	0	0	1	0	2279
11.Mitrovicë	5669	138	1	267	58	10	2	0	1	0	6146
12.Leposaviq	890	61	4	54	5	0	0	1	2	1	1018
13.Lipjan	3345	102	2	220	3	24	1	0	2	0	3699
14.Nov. Bërdë	213	4	0	10	0	0	0	0	0	0	227
15.Obiliq	1164	15	0	104	8	7	0	0	1	0	1299
16.Rahovec	2512	49	2	190	3	5	0	0	5	0	2766
17.Pejë	7208	207	5	439	10	14	0	1	2	0	7886
18.Podujevë	3873	56	2	160	4	2	1	0	2	0	4100
19.Prishtinë	24663	1411	26	6712	184	481	13	3	7	0	33500
20.Prizren	10626	278	4	667	9	26	5	1	7	0	11642
21.Skenderaj	2092	48	0	64	2	1	1	0	5	0	2213
22.Shtime	1440	30	0	86	1	0	0	0	5	0	1562
23.Shtërpçë	667	4	1	35	1	0	0	0	1	0	709
24.Suharekë	2226	36	0	191	6	3	0	0	1	0	2463
25.Ferizaj	9144	291	2	699	23	15	1	1	2	0	10178
26.Viti	3025	90	0	134	7	5	0	0	2	0	3263
27.Vushtrri	3276	45	0	142	1	2	0	0	2	0	3468
28.Zubin Potok	416	18	0	13	2	1	0	0	0	0	450
29.Zveçan	547	15	2	17	8	1	0	1	0	0	591
30.Malishevë	1850	29	0	91	1	4	0	0	3	0	1983

31.Graçanicë	283	6	0	119	4	3	0	0	1	0	416
32.Mitrovicë. Ver	162	1	0	29	0	0	0	0	0	0	192
33.Hani i Elezit	6	0	0	2	0	0	0	0	0	0	8
<b>Total</b>	<b>117082</b>	<b>3540</b>	<b>86</b>	<b>12587</b>	<b>425</b>	<b>672</b>	<b>27</b>	<b>10</b>	<b>83</b>	<b>33</b>	<b>134545</b>

Statistikat e ndërmarrjeve sipas numrit të punësuarve, duke konsideruar të rëndësishme strukturën e të punësuarve në Kosovë, veçanërisht punësimin sipas llojeve të ndërmarrjeve (mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha), sipas të dhënave të ARBK-së duket kështu. (Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë – MTI)

Ndërmarrjet sipas madhësisë	Nr.i punëtorve	%
Mikro Ndërmarrjet	212821	65.44
Ndërmarrjet e Vogla	30133	9.27
Ndërmarrjet e Mesme	28767	8.85
Ndërmarrjet e Mëdha	53476	16.44
<b>Totali</b>	<b>325197</b>	<b>100.00</b>

Bazuar në raportin e fundit Aktit evropian për biznes të vogël “Small Business Act” të Komisionit Evropian, në mesin e 8 vendeve anëtare të këtij akti, edhe Kosova ka raportuar për progresin e NVM-ve.

Kosova sipas vlerësimit të raportit të politikave të indekseve të NVM-ve për Ballkanin Perëndimor, vlerësohet të jetë ende mbrapa pjesës tjetër të rajonit, e cila regjistrohet nën mesataren e performancës rajonale.

Megjithatë, krahasuar me raportin e vitit 2009 në ekonominë e Kosovës ka pasur progres në dimensionet e politikës e të mësuarit dhe aftësitë ndërmarrëse të ndërmarrjeve. Kosova ka bërë progres në plotësimin e strategjisë së zhvillimit të NVM-ve. Megjithatë, niveli i zhvillimit të politikave në shumicën e zonave të tjera është ende i ulët dhe shumë i varur nga ndihma e donatorëve.

## Bibliografia

ARLEM “Raport mbi rolin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Mesdhe - Bari – Itali 2012. <http://cor.europa.eu/en/activities/arlem/Dokuments/report-on-SMEs-2011/SQ.pdf>

Banka Botërore “Doibg Business 2013” Washington DC,2013.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve “Raporti Vjetor” Prishtinë, 2012, [www.mti-ks.org](http://www.mti-ks.org)

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, Prishtinë,2013, [www.arbk.org](http://www.arbk.org)

Enti i Statistikave të Kosovës, historiku i ekonomisë së Kosovës, Prishtinë.

Komisioni Evropian për Tregti dhe Industri “The new SME definition, User guide and model declaration” Bruksel, 2005.

Ligji Nr.8957,datë 17.10.2002 për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme dhe Ligji Nr.10042, datë 22.12.2008, me ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.8957 datë 17.10.2002 për Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme në Shqipëri.

## Zhvillimi historik i normave për ndalimin e përdorimit të forcës nga ana e shteteve në të drejtën ndërkombëtare deri te Karta e OKB-së

**Shefki Shtërbani, Ass**  
*University of Prizren "Ukshin Hoti"*

**Halim Bajraktari, PhD**  
*Prof. Ass. Dr. University of Prizren "Ukshin Hoti"*  
*Law Faculty.*

### Abstrakt

Ndalimi i përdorimit të forcës në horizontin e sotem nga ana e shteteve në të drejtën ndërkombëtare përbën një ndërë debatet më të diskutueshme në vijën juridike, politike, dhe atë ushtarake të shteteve me ndikim në botë. Shtetet në të kaluarën kanë përdorur forcën ndaj shteteve tjera, në rast kur kanë konsideruar se "kishin të drejtë" të sulmonin ndonjë shtet tjetër, për qfarëdo arsye. Indicjet para për ta sanksionuar përdorimin e forcës në të drejtën ndërkombëtare filluan në fund të shek. XIX, ku ishin nxjerrë akte juridike ndërkombëtare, që kufizonin përdorimin e forcës. Madje, edhe këto akte nuk kanë pasur formulime të sakta lidhur me ndalimin e përdorimit të forcës. Megjithatë, me themelimin e OKB-së, në bazë të kartës, bëhet ndalimi i përdorimit të forcës, që sot paraqet bazën në të drejtën ndërkombëtare lidhur me kufizimin e përdorimit të saj. Meqë, Karta e OKB-së paraqet bazën lidhur me këtë temë, ky punim gjeneralisht trajton çështjet që kanë të bëjnë me përdorimin e forcës, me qëllim që të kem një pikpamje më të qartë lidhur me kufizimin dhe ndalimin e përdorimit të forcës, gjithashtu edhe akte, dhe raste të organeve të OKB-së që e mbështesin ndalimin e përdorimit të forcës me bazë në kartë. Ky, ndalim i përdorimit të forcës nga ana e shteteve të cilin e bënë karta dhe se shtetet nuk duhet që ta interpretojnë në atë mënyrë e cila mund të sjellë deri te keqpërdorimi për të vepruar lirshëm. Sigurisht, se edhe ndalimi i përdorimit të forcës ka përjashtim se kur shteteve u lejohet përdorimi i forcës, gjithashtu me bazë në kartën e OKB-së, por ky punim do të trajtojë historikun e ndalimit të përdorimit të forcës deri në ditët e sotme. Çështja adresuese esenciale ka të bëjë me normat e ius ad bellum, që rregullojnë drejtimin e luftës, se kur shtetet kanë të drejtë të përdorin forcë sot dhe në të ardhme.

**Key words:** *Ndalimi i forcës, normat, Karta e OKB-së, dilemat, përjashtimet dhe mundësit.*

### **Ndalimi i përdorimit të forcës në të drejtën ndërkombëtare Zhvillimi historik i normave që ndërlidhen me përdorimin e forcës para vitit 1945**

Rregullat e së drejtës ndërkombëtare historikisht e praaktikisht para vitit 1945, përbënin një tërësi të së drejtës zakonore të kodifikuara me traktate ndërkombëtare, të cilat parashikonin përdorimin e njëanshëm të forcës nga ana e shteteve. Çështja më diskutive është të përcaktuarit se deri në ç'masë normat lidhur me përdorimin e forcës në të drejtën ndërkombëtare përpara vitit 1945, a e ruajnë ende ndikimin mbi të drejtat dhe detyrimet e shteteve sipas të drejtës ndërkombëtare bashkëkohore?, Në etapën e parë të së drejtës ndërkombëtare, përdorimi i forcës nga shtetet udhëhiqej nga doktrina e luftës së drejtë (Dixon, 2007, 405).

Përpjekjet e para teorike e praktike, për të bërë dallimin ndërmjetë luftërave të drejta dhe të padrejta, janë paraqitur qysh në periudhën antike. Shprehjen "luftë e drejtë" e ka përdorur filozofi Aristoteli me qëllim që të siguronte paqe midis qytet-shteteve greke, për t'i rindërtuar ato nga shkatërrimet e luftës. Por, me kaq mbyllej cikli rrethor, sepse ndaj

popujve të tjerë vlenin rregulla të tjera. (Gruda, 2009, 532).

Nga paraqitja e Krishterimit, deri në ditët e sotme është bërë dallimi midis luftërave të drejta (të lejuara) dhe luftërave të padrejta (të ndaluara). Teorinë mbi luftërat e drejtë e kanë zhvilluar teologët e kishës katolike si: Shën-Augustini, Tomas Akuini, Vitoria, Suares, etj. Shën Augustini: "(354-430), konsideronte se lufta është e lejueshme nëse është e drejtë". Të këtilla janë: luftërat për mbrojtjen e shtetit nga armiqtë e jashtëm ose për dënimin e padrejtë, kur një popull apo një qytet kundër të cilit janë drejtuar aktet armiqësore, nuk i ka dënuar padrejtësitë që kanë bërë qytetarët e tij, ose nuk i kanë kthyer ato që janë marrë pa të drejtë (Gruda, 2009, 532). Sipas Thomas Akunit (1225-1274): "lufta ishte e drejtë, vetëm në qoftë se janë plotësuar tre kushte: 1) të jetë bërë nga organet udhëheqëse kompetente të shtetit, për ta bërë atë (auc-toritas principis); 2) arsyeja të jetë e drejtë (Justa causa) dhe, 3) se qëllimi të jetë korrekt (recta intentio)". Edhe pse kushti i dytë është thelbësore, kushti i parë ka fituar rëndësi me kalimin e kohës, pasi që lufta ishte e lidhur, gjithmonë me sovranitetin (Milojevic, 2001, 583).

Autori i njohur i së drejtës, Vitoria e lejon luftën, nëse ajo ishte luftë mbrojtëse; luftë për t'u hakmarrë për cenimin e së drejtës; luftë për kthimin e asaj që është marrë pa të drejtë (dëmshtëpërblimi) dhe lufta që e urdhëron perëndia (luftërat, kundër të paafteve dhe heretikëve, janë të dashura për Perëndinë). (Gruda, 2009, 531).

Doktrina islame e bënte dallimin midis luftës së drejtë dhe luftës së padrejtë. Sipas saj: "...lufta vetvetiu s'është e keqe as e pamoralshme, por gjithçka varet nga qëllimi i saj". "Nëse lufta bëhet për pushtimin e tokave të huaja ose me qëllim plaçkitjeje ajo është për t'u dënuar, por nëse ajo zhvillohet për t'u mbrojtur, për liri të qytetarëve, ose në interes të përgjithshëm të njerëzimit, ajo është e arsyeshme dhe e moralshme". (Gruda, 2009, 531).

Në fund të shekullit. XVI, dallimi në mes luftës së drejtë dhe luftës së padrejtë filloi të zbehet. Teologët ishin veçanërisht të shqetësuar me gjendjen e ndërgjegjies së njëriut dhe pranuan se të dyja palët do të jenë të paqortuara në qoftëse me të vërtet besonin se kjo ishte e drejtë, edhe pse njëra nga palët mund të ketë qenë objektivisht e gabuar (kjo ishte e njohur si doktrina e mundësisë). Për më tepër, kategoria e tyre që ishin përkrahës vetëm për luftëra (bellum justum), filloi të zgjerohet në mënyrë të rrezikshme. Megjithëse autorët në shek. XVII, si Hugo Gracius, kanë bërë disa përpjekje për të rivendosur doktrinën tradicionale (Malanczuk, 1997, 306-307). Autori i parë që bëri dallimin ndërmjet jus ad bellum dhe ius in bellum, ishte Hugo Gracius (1583-1645), dallim i cili rivendos bilancin mes tyre, pra ndërmjet luftës dhe paqes, duke zëvendësuar dhe duke përjashtuar në mënyrë reciproke njëra-tjetrën (Milojevic, 2001, 583).

Në shekull. XVII në Europë lindja e shteteve- kombeve, solli një ndryshim të drejtimit të përgjithshëm. Periudhë në të cilën filloi dhe u rishikua doktrina e luftës së drejtë, një shtet mund të thirrej tanimë se vepronte ligjërisht, në rast se besonte se kishte të drejtë, pavarësisht faktit se a kishte apo jo, një gjë të tillë. Mirëpo nuk kishte, një kriter juridik-objektiv lidhur me të drejtën e shtetit për të përdorur forcën. Pasi praktika e shtetit filloi të shikohej si burim përfundimtar i së drejtës ndërkombëtare. Aktualisht mund të themi se ky lloj i teorisë së luftës më nuk ekziston. Në shek. XVIII, doktrina mbizotëruese u bë e drejta sovraane e shteteve për të filluar luftën. Shtetet tani më kishin të drejtën, të fillonin luftën për arsye të ndryshme. E drejta ndërkombëtare rregullonte veprimet konkrete të zhvillimit të luftës, por nuk ndërhynte në të drejtën e shtetit për të vazhduar atë. Ky zhvillim pati një rëndësi të qenësishme në historinë e ius ad bellum (Dixon, 2007, 406). Në fund të shek. XIX, ishte dukuri e theksuar përpjekja për të ndërmarrë hapat e para për të ndryshuar qëndrimin drejtë mos-kufizimit të drejtimit të luftës. (Heselhaus, 2008, 3).

## Konventa e Lidhjes se Kombeve

Iniscativa multidimensionale nga shtetet ndikuese në ditet e sotme për nxjerrjen e konventës, të Lidhjes së Kombeve ishte përpjekja e parë për të krijuar sistemin e sigurisë kolektive. (Heselhaus, 2008, 4). Detyra kryesore e së cilës ishte për të siguruar paqen. (Karta e Lidhjes së Kombeve, 1919-1920, neni 11).

Konventa, rregullon kufizimin për fillimin e luftës. (Heselhaus, 2008, 4). Kjo konventë përcaktoi një kufizim të vogël të së drejtës sovrane për fillimin e luftës. Sipas kësaj konvente, "lufta ishte e ligjshme vetëm nëse zbatoheshin masat procedural të sigurisë të përcaktuara në nenet 10-16", ndërsa nëse kjo përmbushej atëherë një shtet kishte plotësisht të drejtë të arrinte synimet e veta nëpërmjet luftës zyrtare. Përveç kësaj që përmendëm më lartë, konventa nuk përcaktonte asnjë kusht tjetër për përdorimin e "forcës pa qenë në gjendje lufte" dhe meqenëse klasifikohet si "luftë" dhe jo qfarëdo akt i dhunshëm, varej vetëm nga shteti që ndërmerre atë. Konventa nuk përcaktonte decidivisht ndalimin e fillimit të dhunë së çfarëdo përmase. (Dixon, 2007, 406). Më 1928, konventa u plotësua nga traktati i përgjithshëm për heqjen dorë nga lufta, i njohur ndryshe si pakti Briant Kellog (Dixon, 2007, 408).

## Pakti Briant-Kellog

Për gjatë viteve të 1920-ta ishin bërë përpjekje të shumta, për të përmbushur "zbrastirat e konventës së Lidhjes së Kombeve", me qëllim për të transformuar ndalimin e kufizimit të pjesshëm të luftës, në një ndalim të përgjithshëm të saj. Këto përpjekje arritën pikën më të lartë të zhvillimit në Traktatin e Përgjithshëm për Mospranimin e Luftës, ndryshe të njohur si pakti Briant-Kellog (Malanczuk, 1997, 308). Shtetet nënshkruese të këtij pakti, solemnisht deklarojnë në emër të popujve se ato dënojnë mbështetjen e luftës, si rrugë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare dhe heqin dorë nga ajo, si një instrument i politikës kombëtare, në raportet e tyre me njëri-tjetrin (Pakti Briant Kellog, 1928-1929, neni I). Pakti Briant-Kellog, është ratifikuar nga gjithsej 63 shteteve. Ky pakt parashihte mundësinë për pranim me rezerva apo edhe heqjen dorë nga ai. Pakti, kishte detyrim pothuajse universale, ku vetëm katër shtete në bashkësinë ndërkombëtare para luftës së dytë botërore nuk detyroheshin nga dispozitat e tij (Brownlie, 2008, 730).

Por kjo nuk e përjashton atë nga prodhimi i pasojave juridike të luftës të ndjekura për shkelje të paktit (Lesaffer, 2011, 6). Traktati i përgjithshëm i njohur ndryshe edhe si Pakti Briant-Kellog, përbënte sfondin e krijimit të së drejtës zakonore në periudhën para krijimit të kartës së OKB-së dhe është në kontekst me praktikën në periudhën prej 1928 deri në vitin 1945 duke përfshirë edhe ndjekjet penale të Tribunalit ndërkombëtar të Njrembergut dhe Tokios (Brownlie, 2008, 730).

Në periudhën e mëvonshme, përkatësisht disa vite para krijimit të OKB-së ky pakt ka luajtur një rol të rëndësishëm në praktikën e shteteve. Kështu, Shtetet e Bashkuara bëjnë apel për krijimin e një pakti në lidhje me armiqësinë ndërmjet Kinës dhe Japonisë, si dhe në kontekstin e marrëveshjes Letika ndërmjet Perus dhe Ekuadorit në vitin 1933. Kuvendi i Lidhjes së Kombeve, citoi: Paktin me rastin e dënimit të sulmit Sovjetik kundër Finlandës. Praktika e shteteve nuk ka qenë e qëndrueshme, megjithatë dhe pushtimi i Etiopisë nga Italian ishte njohur nga një numër i shteteve, kjo njohje u tërhoq në vitin 1941. Ky ishte regjimi ligjor, i cili ishte pararendës aktual i kartës së Kombeve të Bashkuara (Brownlie, 2008, 730). Fatkeqësisht, pakti Briant-Kellog paraqet mungesë të sanksioneve të tjera. Për më tepër, formulimi i saj ishte i kufizuar për luftërat. Shtetet si Japonia në vitet 1930-ta u përpoqën ta anashkalojnë paktin duke mos deklaruar konfliktin e armatosur si një luftë (Heselhaue, 2008, 4).

## Ndalimi i përdorimit të forcës me kartën e OKB-së

Kronologjikisht e praktikisht krijimi i OKB-së, rezultoi si modifikimi më i rëndësishëm dhe më ambicioz i së drejtës ndërkombëtare në shekullin XX, ku e bënë të paligjshëm përdorimin e forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare. (Värk, 2003, 28). Preambula e kartës së OKB-së fillon me fjalët: “Të vendosur të mbrojmë brezat e ardhshme nga tmerri i luftës, i cili në ditët tona ka sjellë dy herë vuajtje të pathëna mbi njerëzimin dhe të forcojmë sërish besimin tonë në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerat e personalitetit njerëzor, në barazinë mes burrit dhe gruas si dhe në mes gjithë kombeve, qofshin këto të mëdha a të vogla...” (Karta e OKB-së, neni I). Neni 2(4) paraqet ndalimin bazë të përdorimit të forcës nga ana e shteteve. Ky nen, konsiderohet si një ndër parimet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare bashkëkohore dhe bën një ripohim për ekzistimin e së drejtës zakonore. (Kittrich, 2008, 9).

Mirëpo në diskutimet lidhur me nenin 2(4), ekziston një mospajtim sa i përket ndalimit dhe përdorimit të forcës me kartën e OKB-së lidhur me atë se ky nen a ishte një dispozitë revolucionare apo e drejtë zakonore, edhe pse tashmë kjo dispozitë është zhvilluara në nenin 2(4) të kartës së OKB-së. Karta nuk synon vetëm ndalimin e njëanshëm të forcës nga shtetet në nenin 2(4), por gjithashtu ka synim për ta centralizuar kontrollin për përdorimin e forcës në Këshillin e Sigurimit, konkretisht duke u mbështetur në kapitullin VII (Gray, 2003, 590).

Pas krijimit të kartës së OKB-së parimi i mospërdorimit të forcës është përkrahur dhe mbështetur nga institucionet kryesore të OKB-së. Lidhur me ndalimin e njëanshëm të forcës nga ana e shteteve Asambleja e Përgjithshme e ka bërë këtë të ditur në disa rezoluta, siq janë: Definimi i agresionit (AP Rez., 3314, 1974); Deklarata për papranueshmërinë e ndërhyrjes në punët e brendshme të shtetit (AP, Rez., 2131, 1965); Deklarata për mospërdorimin e forcës (AP, Rez., 42/22, 1987), etj.

Edhe pse, në doktrinën juridike dhe në bazë të kartës së OKB-së, rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme, nuk janë obligative për dallim nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit, mirëpo praktika tregon, se rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme janë më të përfillura se deklaratat e thjeshta politike. Në mendimin këshilldhënës për kërcënimin dhe përdorimin e armëve kimike të vitit 1996, të GJND-së, gjithashtu në përputhje me mbizotërimin e mendimit në shkrimet e autorëve të së drejtës ndërkombëtare vënë në dukje se rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme, nganjëherë mund të kenë karakter obligativ për shtetet (Haselhaus, 2008, fq. 5).

### Neni 2(4) i Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Neni 2(4) i kartës si njëri ndër parimet kryesore parasheh ndalimin e përdorimit të forcë. Neni 2(4) parasheh si më poshtë:

“Të gjithë anëtarët duhet të përmbahen në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare nga kërcënim apo përdorimi i forcës kundër integritetit territorial apo pavarësisë politike të ndonjë shteti, ose ndonjë mënyrë tjetër e cila bie ndesh me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.”(Karta e OKB-së, 1945, neni 2 (4) ).

Neni 2(4) kërkon nga shtetet të përmbahen nga kërcënim apo përdorimi i forcës. Ky nen, paraqet dispozitën më të saktë të kartës kundër intervenimit me përdorim të forcës. Neni 2(4), përcakton një ndalim të përgjithshëm të përdorimit të forcës. Më saktësisht, zgjeron ndalimin e përdorimit të forcës përveç luftës, duke përfshirë lloje të tjera të njëanshme të kërcënimit me forcë. (Kinancıoğlu, 2005, 19).



Shumica e autorëve të së drejtës ndërkombëtare nenin 2(4) e konsiderojn si normë zakonore të së drejtës ndërkombëtare, apo si (jus cogens). Kjo është pohuar nga GjND-ja, në rastin Nikaragua. (Nikaragua Kundër Shteteve të Bashkuara, (RAP. GjND, 392, 1986). GjND-ja vendosi në favor të Nikaraguas dhe kundër shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe caktoi dëmshpërblim për Nikaraguan. GjND-ja konstatoi se citoj: SHBA-ja kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare, duke mbështetur forcat guerile në rebelimin e tyre kundër qeverisë së Nikaraguas. Gjykata refuzoi justifikimin e SHBA-së për vetëmbrojtje kolektive, ku ka shkelur obligimet e përcaktuara nga normat zakonore për të mos ndërhyrë në punët e brendshme të shtetit tjetër. (Nikaragua kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, (RAP. GjND, 392, 1986).

Neni 2(4) flet për “kërcënimin apo përdorimin e forcës”, jo për “luftën”. Termi luftë, i referohet një situatë teknike dhe të ngushtë ligjore e cila fillon me një deklaratë për luftë dhe përfundon me një traktat për paqe. Lufta, ishte përgjithësisht e ndaluar para luftës së dytë botërore, mirëpo shtetet gjetën mënyra për t’iu shmangur një ndalimi të tillë. Për shembull, Japonia refuzoi t’i shpallë luftë Kinës dhe e quajti operacionin e vetë ushtarak në Mençuri (1932-1941) një incident, me qëllim për të mos ta shkelur ndalimin për mos fillimin e luftës. Në të kaluarën termi “përdorim i forcës” ishte i preferuar sepse shtetet gjenin mënyrën për të mbular të gjitha llojet e armiqësive, pra si luftërat teknike ashtu edhe incidentet dështonin për një luftë zyrtare shtetërore e cila shkonte nga përlëshjet në zonat kufitare deri tek operacionet e gjëra ushtarake. Prandaj, përdorimi i forcës nuk varej nga ajo se sa shtetet e përfshira preferojn ta definojnë operacionin e vetë, si operacion ushtarak (Värk, 2003, 29-30).

Anët negative, të cilat i ngerthen në vete neni 2(4), janë:

Së pari, ndalimi i përdorimit të forcës në nenin 2(4), përfshin si kërcënimin ashtu edhe përdorimin e forcës, megjithatë, gjuha e nenit 2(4), nuk përcakton, as nuk kualifikon termin “forcë”. Mendimi mbizotërues është se nocioni “forcë”, në këtë nen nuk vlen për të gjitha llojet e forcës, sikurse është forca politike dhe ekonomike, por nënkupton vetëm forcat e armatosura (Kinancioğlu, 2005, 17-18).

Së dyti, neni 2(4) shprehimisht, ndalon përdorimin e forcës “kundër tërësisë territoriale ose pavarësisë politike” të çdo shteti ose në çdo mënyrë tjetër e cila është e papërputhshme me qëllimet” e OKB-së (Dixon, 2007, 409). Ky formulim mjaft i rrumbullaksuar ka sjellë daljen e pikëpamjes, sipas së cilës neni 2(4) ndalon vetëm atë përdorim të forcës, që në fakt drejtohet kundër “tërësisë territoriale” ose “pavarësisë politike” ose, në fakt, është në kundërshtim me qëllimet e OKB-së. Kjo terminologji hap mundësinë, të argumentuarit se forca e përdorur për një shumëllojshmëri të gjerë të qëllimeve (Shembull: për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose për të imponuar çfarëdo lloje të drejte ligjore që i përkasin shtetit) është e ligjshme, sepse nuk ka për qëllim të bëhet “kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të çdo shteti”, por referenca për “integritetin territorial” ose “pavarësinë politike” nuk duhet ta shkëpus fokusin tonë nga fjalët “ose në ndonjë mënyrë tjetër” si e papajtueshme me qëllimet OKB-së. Ky interpretim i nenit 2(4) është i përforcuar, nga një shqyrtim i dispozitave të tjera të kartës. Preambula thotë: “Se popujt e Kombeve të Bashkuara janë të vendosur për të shpëtuar brezat e ardhshëm nga tmerret e luftës i cili dy herë në jetën tonë ka sjellë dhembje të papërshkrueshme për njerëzimin”. Dhe neni 2(3) detyron anëtarët t’i zgjedhin, mosmarrëveshjet e tyre në mënyrë paqësore në mënyrë që paqja siguria dhe drejtësia ndërkombëtare nuk janë të rrezikuara (Malanczuk, 1997, 310). Nganjëherë është thënë se fjalët “Kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të një shteti”, mund të kenë efekt kualifikues të ndalimit të përdorimit të forcës. Sido që të jetë, kjo nuk mbështetet nga travaux préparatoires (dokumentet zyrtare, të raporteve,

negociatave, diskutimeve gjatë procesit të krijimit të traktatit) të OKB- së. Debatet e ndryshme, gjatë hartimit të kësaj dispozite tregojnë se fraza nuk kishte për qëllim të jetë e kufizuar. Por, në të kundërtën kjo frazë është përfshirë vetëm për të dhënë siguri më të madhe shteteve të vogla (Hovell, 2005, 399-400). Kjo pikëpamje është e mbështetur dhe interpretuar në rastin e Kanalit të Korfuzit. (Britania e Madhe kundër Shqipërisë, (Rap. GjND. 1949, 4 ).

Gjithashtu, është e konfirmuar për ndalim të përdorimit të forcave të armatosura në Deklaratën për Marrëdhënie Miqësore (AP. Rez. 2625, 1970), të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1970. Analiza e, travaux préparatoires e Konventës së San Franciskos, e cila shënoi fillimin e statutit të OKB-së dëshmon që fraza e diskutuar e nenit 2(4) ishte përfshirë në marrëveshjet paraprake, me qëllim që të rriste detyrimin e shteteve për mospërdorimin e forcës. Për më tepër, megjithëse ka pasur shumë shembuj në praktikën e përgjithëshme se përdorimi i forcës në 50 vitet e fundi, fillimisht Izraeli pas sulmit ndaj Entebesë u mbështet në interpretimin e gjerë, të nenit 2(4). Gjithashtu edhe në rastet e tjera, si p.sh. pushtimi Republikës Dominikane nga SHBA-ja më 1965 dhe Granadës 1983, bombardimi i reaktorit bërthamor të Irakut në vitin 1981, pushtim i Pakistanit lindor nga India më 1971, pushtimi i Ugandës nga Tanzania më 1979, veprimet e NATO-s në vitet 1998-99 ndaj ish-Jugosllavisë dhe pushtimet e Irakut dhe Afganistanit. Shtetet që kanë përdorur forcën janë arsyetuara duke i cilësuar se këto raste bëjnë përjashtim nga parimi i mospërdorimit të forcës. (Dixon, 2007, 411).

Megjithatë, neni 2(4) i kartës duhet të konsiderohet si ndalim i përgjithshëm i përdorimit të forcës, në të drejtën ndërkombëtare dhe se shtetet nuk duhet ta interpretojnë në mënyrën e cila u jep hapësirë të veprojnë lirshëm. Kjo për arsye se shtetet mund ta keqpërdorin një të drejtë të tillë.

### **Përjashtimet nga Neni 2(4) i kartës së OKB-së**

Si çdo rregull ashtu edhe ndalimi për përdorimin e forcës ka përjashtime. Edhe pse disa shtete dhe autorë të së drejtës, kanë disa pyetje të diskutueshme për ligjshmërinë e përdorimit të forcës, vetëm dy përjashtime janë të pranuar shprehimisht për ndalimin e përgjithshëm të përdorimit të forcës (Värk, 2003, 31). Karta e OKB-së parasheh në mënyrë shprehimore dy përjashtime; 1). Vetëmbrojtja Individuale dhe Kolektive (neni 51); 2). Autorizimet nga ana e Këshillit të Sigurimit (kapitulli VII).

Të vetmet këto dy raste, karta parasheh si përjashtime nga ndalimi i përdorimit të forcës, se kur shtetet osa Këshilli i Sigurimit, mund të përdorin forcën kundër një shteti tjetër.

### **Përfundime**

Dimenzionaliteti i ndalimit të përdorimit të forcës në të drejtën ndërkombëtare, është zhvilluar gjatë historikë, duke filluar nga luftërat e drejta dhe të padrejta, ka pasur ndryshme lidhur me kushtet për fillimin e luftës pasi që nuk kishte rregulla që ndalonin në mënyrë shprehimore luftën deri te ndalimi i përdorimit të forcës me karën e OKB-së. Meqë, aktet pararendësi siç janë: Konventa e Lidhjes së Kombeve dhe pakti Briant-Kellog, nuk kanë ndaluar në mënyrë shprehimore përdorimin e forcës, si dhe ka pasur mangësi në formulimin e përdorimit të forcës, luftës, si dhe mungesën e ndonjë mekanizmi për mbrojtjen e këtyre akteve, shumë herë kjo është keqpërdorur nga ana e shteteve.

Karta e OKB-së, me ndalimin e përdorimit të forcës në kartën e saj, nën nenin 2(4), ndalon përdorimit të forcës kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike ndaj shteteve. Ky formulim ligjorë i të drejtave paraqet një pike kthese lidhur me

ketë kufizim, ku e sanksionon përdorimin e forcës në të drejtës ndërkombëtare. Pasi që, zgjeron ndalimin e përdorimit të forës përveq, përfshin edhe lloje të tjera të kërcënimit me force, pasi që shtetet në të kaluarën e kanë keqpërdorur, duke mos e emërtuar përdorimin e tyre të forës si luftë. Gjithashtu, ky ndalim, është i mbështetur edhe nga rezoluta të OKB-së dhe vendime të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Pamvarsisht rasteve, ku shtetet e kanë interpretuar këtë ndalesë në mënyrë ekstensive, për t'i arsyetuar ndërhyrjet e tyre, një interpretim i tillë nga ana e shteteve, për të vepruar në bazë të vlerësimit të tyre, do të adresonte në keqpërdorimin e një të drejte të tillë, duke i dhënë "të drejtë" padrejësisht rasteve të tilla duke u mbështetur në parime që njëherit janë shumë prektekst se sa konteste. Sot, dimenzioni ndërkombëtar gjindet në një udhkryq dilemash sa të ndalushme aq edhe të lejushme, duke ditur se fuqia e së drejtës ndërkombëtare lindë nga superfuqit e shteteve të cilat njëherit janë gjeneruesit dhe balancuesit në të drejtën ndërkombëtare.

### Literatura

1. Dixon, M. (2007). E drejta Ndërkombëtare, Shqipëri, Instuti për studime Ndërkombëtare.
2. Malanczuk, P. (1997). Akehurst's Modern Introduction to International law, New York.
3. Gruda, Z. (2009). Prishtinë. E Drejta Ndërkombëtare Publike, Furkan ISM-Shkup.
4. Milojević, M. (2001). Sërbi, Prohibition of Use of Force and Threats in International, Relations. Facta Universitatis.
5. Heselhaus, S. (2008). Gjermani, International Law and the Use of Force, International Law and Institutions.
6. Brownlie, I. (2008). New York, Principles of Public INTERNATIONAL LAW, Seventh Edition, Oxford University Press Inc.
7. Lesaffer, R. (2011). Holandë Kellog-Briand Pact (1929), Max Planck Encyclopedie of Public Internatioanl Law.
8. Värk, R. (2003). Estoni, The use of force in the modern world: Recent Development and the Legal Regulations of he Use of Force, Baltic Defence Review No. 10 Vol.
9. Gray, C. (2003). The use of force and international legal order, third edition, Oxford University Press, Inc., New York.
10. Hovell, D. (2005). Australi, Chinks in the Amour: International Law, Terrorism and the Use of Force, UNSW Law Jurnal, Vol. 27(2).
11. Kittrich, J. (2008). Gjermani, The Right of Individual self-defense in International Law, Logos Verlag Berlin GmbH.
12. Kinancioğlu, M. (2005). Angli, The Principes of the non-intervention at the United Nations. The Charter Framework and the legal debate, European Institute and Visting Fellow, Centre for International Studies.
13. Konventa e Lidhjes së Kombeve (Nënshkuar më 28 Qershor 1919, ka hyr në fuqi më 10 janar 1920).
14. Paktin Kellog-Briand, (U nënshkrua më 27 Gusht, 1928, hyri në fuqi më 24 korrik 1929, Paris.
15. Karta e OKB-së, (U nënshkrua më 25 Qershor 1945, dhe ka hyrë në fuqi më 24 tetor 1945, San Francisko, SHBA).
16. Asambleja e Përgjithshme (AP), Rez. 3314 (XXIX), 1974.
17. AP, Rez. 2131, 1965. (XX).
18. AP Rez., 3314, 1974.
18. AP, Rez. 42/22, 1987.
19. Aktivitetet paramilitare dhe ushtarake kundër Nikaraguas, RAP. GJND, 1986. (Nikaragua kundër Shteteve të Bashkuara).
20. Rap. GJND. 1949, 4. (Britania e Madhe kundër Shqipërisë).

## Transaksionet bankare permes internetit te perdorshme apo jo?

Jehona Gjermizi, Phd Candidate  
Dr. Blerim Kola

### Abstrakt

Shume banka ne Shqiperi kane implementuar sherbimin "internet banking". Por a eshte i perdorshem dhe efektiv ky sherbim? Kjo eshte pyetja qe shtrohet per diskutim ne kete artikull.

Ky punim mori shkas nga kompeticioni "World's Best Internet Banks" qe u zhvillua nga Global Finance per rajonin qendror dhe lindor e Evropes dhe ku nje banke shqiptare mori vleresimin "Best Consumer Internet Bank in Albania".

Kriteret qe u aplikuan dhe ne kete kompeticion dhe qe u jemi referuar per te kryer kete studim mbi kete ceshtje jane: forca e strategjise per t'rrheqjen dhe sh'rbimin e klienteve online, suksemi ne t'rrheqjen e klienteve per t' p'rdorur sherbimin e "internet banking", shtimin e numrit te perdoruesve te ketij sherbimi, gjeresia e sherbimeve online qe ofron banka, evidenca ne lidhje me p'f'itimet e prekshme te ketij sherbimi si dhe dizanji dhe funksionaliteti i faqeve te internetit.

Ne studim kemi p'rfshire vetem perdoruesit "institucione" pasi nga informacionet qe morem nga bankat, kishte p'rdorim te kufizuar nga individet.

Nga hulumtimet tona rezultoi qe vertet bankat tona kane investuar shume ne implementimin e kesaj teknologjie, por ende mbetet nje kanal i pashfrytezueshem kryesisht p' arsye sigurie.

Bankat qe ofrojn' sh'rbim n'p'rmjet ketij kanali pretendojn' se ajo redukton kostot dhe i b'n ata me shume konkures. Megjithate, shume perdorues nuk jan' shume entuziast' p' kete sherbim bankar n'p'rmjet internetit. Mb'shtetja ligjore eshte gjithashtu nje pengese e madhe ne perdorimin e ketij sherbimi.

**Fjal'et kyce:** "Internet banking"(IB), perdorues "institucione", Shqiperi.

### Hyrje

N' vitet e fundit, sektori bankar ka qen' nje sektor me zhvillime interesante p' sa i perket risive ne sherbimet qe ato ofrojne, duke u referuar kryesisht ne perdorimin e internetit per te zhvilluar kanale te reja te ofrimit te sherbimeve bankare. "Internet banking" eshte nje prej ketyre risive qe u lejon konsumator've te kene qasje t' drejtp'rdrejt' ne informacionin e tyre financiar dhe t' nd'rmarrin transaksione financiare pa patur nevoj' p' t' shkuar ne bank'. Nga pik'pamja e bankave, aplikimi i "internet banking" synon n' reduktimin e kostos dhe konkureshmeri me te larte ndaj bankave te tjera. Ky kanal i ofrimit t' sh'rbimit eshte par' si i rendesishem per faktin se klientet aktuale te nje banke mund te marrin sherbimet bankare kudo qe ato jane. P' m' tep'r, "Internet banking" ofron mundesi p' bank'n qe t' zhvilloje tregun e saj duke t'rrhequr nje baze t' re t' klienteve nga ato ekzistues. Por g'jerat nuk kan' l'vizur me shpejtesine e parashikuar per t' shnd'rruar ne realitet kete risi n' sektorin bankar. Disa hulumtime tregojn' se shumica e klienteve bankare e kane renditur "Internet banking" si nje prej kanaleve me pak t' r'nd'esishme ne krahasim me kanale t' tjera sherbimi te bazuar ne teknologji, t' tilla si ATM dhe bankingu permes telefonit. Edhe per sa i perket klienteve "korporate", situata duket t' jet' e ngjash'm, ndon'ese disi m' pak e hulumtuar. Klientet "korporate" te bankave realizojne transaksione m' intensive dhe komplekse sepse ato p'rfshijn' marr'rdh'net nd'rmjet firmave dhe bankave. Por pavaresisht nivelit te madh te transaksioneve ende prej klienteve "korporate" te bankave nuk ka perdorime masive te "internet banking". Sigurimi

i ketyre klienteve potencial varet shume nga tejkalimi i disa barrierave të rëndësishme qe pengojne apo frenojne perdorimin e kesaj teknologjie.

Relativisht pak hulumtime ka ne lidhje me çështjen e barrierave në miratimin dhe aplikimin e “internet banking”. Studimet e meparshme shpesh fokusoheshin në aspektet pozitive të bankngut nëpërmjet internetit. Përveç kësaj, hulumtimet ne lidhje me “Internet banking” kane tentuar të përqëndrohen në perspektivën e llogarive personale te klienteve. Ka pak punë të botuar mbi perceptimet e klientëve “korporate” te bankave rreth pengesave te ketij kanali te sherbimit bankar sidomos në kontekstin e vendeve në zhvillim. Per kete arsye ky studim ka per qellim te identifikojë se si korporatat, kliente te bankave perceptojne apo hasin barriera ne perdorimin e bankngut permes internetit të ofruar nga bankat shqiptare.

### **“Internet banking” dhe konteksti kulturor në Shqipëri**

Sistemi yne bankar eshte karakterizuar nga ndryshime te rendesishme strukture, ku theksohet ne menyre te dukshme rritja e numrit te bankave, ristrukturimi dhe privatizimi i bankave shtetere, hyrja e bankave te huaja ne vend, zgjerimi i aktivitetit te mbikëqyrjes bankare , te cilat kane ndikuar mjedisin dinamik ku operojne bankat sot.

Aktualisht ne shqipëri operojne 3 banka lokale dhe 14 banka të huaja te cilat ofrojne shërbime bankare tregtare , ndonëse kategorizimi i saktë është disi i veshtire për shkak se disa banka lokale kanë kapital të huaj dhe pjesëmarrje ne menaxhimin e tyre. Ne përpjekje për të qene më efikas dhe konkurrues, veçanërisht pas krizës ekonomike, shumica e bankave shqiptare kanë investuar shumë në teknologjinë e informacionit për të ofruar shërbime më të mira për klientët e tyre. Ato kerkojne vazhdimisht menyra për të zvogëluar kostot operative dhe per të gjeneruar fitime më të larta afatgjata, ashtu sic ndodh ne shumë vende të tjera. Aktualisht, pesë bankat lokale janë liderët në sigurimin e “Internet banking”. Këto banka ofrojnë shërbime mjaft të ngjashme, shërbime standarde nëpërmjet internetit, të tilla si kontrollimi i balanceve te llogarive, nxjerrja e raporteve mbi gjendjen e llogarive , transfertat e parave, berjen e pagesave, këmbim valutor, dhe letrat e kreditit. Sipas menaxherëve të bankave të intervistuar për përgatitjen e ketij hulumtimi, bankat besojne se ky sistem ofron nje mundesi ekstra per klientet, e cila ul kostot e transaksionit dhe përmirëson efikasitetin e pagesave.

### **Shqyrtimi i literatures:**

Benifitet e kesaj forme te re te kryrjes se transaksioneve te cituara shpesh duket se nuk materializohen ne cdo rast pasi duket se barrierat per perdorimin e kesaj forme jane shume te larta. Pengesat ne aplikimin e tregtisë elektronike në përgjithësi gjenden te klasifikuara ne mënyra të ndryshme. Shumë elemente në këte diskutim janë të lidhura me aftësinë e organizatës për të përdorur teknologjinë e internetit ne menyre efikase. Çështja e dytë ka të bëjë me besimin në sistemin “internet banking” dhe ne bankat që e zbatojnë atë. Ne fakt ka shume pak studime persa i perket njohjes dhe vleresimit te barrierave te siperpermendura ne perdorimin e ketij aplikacioni te tilla si *siguria, ruajtja e te dhenave private dhe besimi i sistemeve web*. Një faktor i tretë është *mbështetja ligjore* e cila duket se mungon ose nuk eshte e implementuar sic duhet per te ngjallur besimin e klienteve qe do perdorin sherbimet bankare permes internetit.

## **Barrierat organizative**

Aftësia e organizatave për të shfrytëzuar mundësitë e internetit për të kryer transaksione apo për tregti është një barriera e pare që frenon dhe e bën këtë shëmbim me pak të përdorshëm. Kjo nënkupton fenomene të tilla si qëndrimi i menaxhereve ndaj këtyre zhvillimeve të teknologjise se komunikimit, kufizimet e burimeve, dhe paisja me njohuritë në përdorimin e këtyre teknologjive. Disa studime kanë cituar qëndrimet negative në mesin e disa menaxherëve si një pengesë e madhe. Qëndrimet negative të menaxhereve shpesh citohen nëpër studime si një pengesë e madhe që shkaktojnë rezistenca në ndryshim, duke zvogëluar mundësitë për shpërndarjen e burimeve të kompanisë dhe motivimin për të përdorur teknologjinë e re. Gjithashtu implementimi i teknologjive të reja si një kanal i biznesit kërkon disa investime dhe burime, të tilla si hardware dhe software shtesë.

### **Besimi në sistemin e “internet banking”**

Mundësitë nga zbatimi i teknologjisë së internetit mund të jenë të kufizuara në qoftë se ekziston një mungesë e besimit të klienteve në këtë sistem. Besimi nënkupton gadishmerinë për të përdorur këtë mundësi të kryerjes së një transaksioni pa patur frikë për humbje apo rrjedhje informacioni.

Klientet zakonisht nuk besojnë në këtë teknologji për shkak të dyshimeve që kanë në besueshmërinë e sistemit dhe të atyre që kujdesen për mbarevajtjen e sistemit. Shumica e klientëve nuk janë të kënaqur me infrastrukturën e sistemeve web të sigurisë. Në shërbimet bankare nëpërmjet internetit, siguria është një nga sfidat e ardhshme më të rëndësishme, sepse klientët perceptojnë risk me të lartë për transaksionet financiare. Reputacioni i një banke ka ndikim të madh në perceptimin e sistemeve të saj si të besueshme apo jo pasi një bankë me reputacion të mirë shihet si një institucion i besueshëm dhe që i ndërshej që “kujdeset” për klientet e saj. Këto institucione që të fitojnë reputacion të mirë duhet të kenë përvojë në fushën e biznesit, politikës, dhe personelit mbështetës për të ndërtuar besueshmërinë tek klientet e tyre që menyrat apo sistemet që përdor banka për të ofruar shërbime të jenë të shkurtra. Për bankat, reputacioni është një nga faktorët kryesorë që ndikon në përdorimin nga ana e klienteve të shërbimeve bankare përmes teknologjive të tilla si “Internet banking”. Reputacioni varet nga politikat premtuese të bankave për klientët, duke përfshirë “privacy policy”, përderisa të gjithë klienteve nuk u pëlqen që të dhënat e tyre personale të përdoren në mënyrë të papërshtatshme ose keqpërdoren nga të tjerët. Klientet të cilët adoptojnë shërbimet financiare elektronike kanë më shumë të ngjarë të hasin probleme në lidhje me humbjen e privatësisë, përderisa ky kanal është lehtësisht i aksesueshëm nga të tjerët. Për këtë klientet jo gjithmonë i besojnë politikave të ruajtjes së privatesisë së të dhënave.

Ky rrezik i perceptuar gjithashtu mund të shkaktojë të konsumatorët prirjen për të refuzuar këtë menyrë të re të marrjes së shërbimeve bankare. Klientet janë gjithashtu të shqetësuar për faktin se ofrimi i shërbimeve bankare bazuar në teknologji nuk do të realizohet siç pritet, dhe mungon besimi se problemet mund të zgjidhen shpejt. Shpeshherë reagimi i ngadalshëm i sistemit pas dhenies së komandave të çon në një vonesë të ofrimit të shërbimeve dhe ndonjëherë klientët janë në pikepyetje nëse transaksioni është përfunduar apo jo.

### **Metodologjia e kerkimit**

Edhe pse hulumtimet mbi barrierat në përdorimin e tregtisë elektronike (në këtë rast

trëgëtime elektronike bankare) nuk janë shumë të gjera në krahasim me diskutimet për përfitimet, shumica e koncepteve në këtë studim janë të testuara herë pas here më parë, por kryesisht në kontekstin përëndimor. Përdorimi i një qasje cilësore na dha mundësi për të grumbulluar me shume të dhëna dhe informacione për të eksploruar këndvështrimet e ndryshme mbi këto çështje në fazat e para të hulumtimit, për të fituar një kuptim më të mirë fillestar të problemit dhe për të identifikuar fenomenet, qëndrimet dhe ndikimet.

Të anketuarit janë menaxherëve të firmave- kliente të bankave , të cilët janë përgjegjës për transaksionet financiare të kompanive të tyre. Të anketuarit kategorizohen në dy grupe :menaxhere financiare /ose të kontabilitetit dhe menaxherë drejtues.Grupi i parë përbëhet nga pesë korporatava që aktualisht kryejnë shumë nga transaksionet e tyre financiare nëpërmjet internetit .Grupi i dytë përbëhet nga dhjetë perfaqesues korporatash që nuk përdorin shërbimet bankare përmes internetit. Ata të gjithë janë përzgjedhur në mënyrë të tillë që monstra të jetë sa më përfaqësuese dhe të mbulojë një gamë të gjërë të industrive, p.sh. financave, leasing, të sigurimit, prodhim, dhe kompanitë të tjera (Tabela I).

Kërkimi është bazuar në intervista balle për balle me klientët “korporata” të bankave. Intervistat u kryen në një format gjysmë të strukturuar për tu lejuar të anketuarve të shprehnin pikëpamjet e tyre .Një set me çështje dhe pyetje u përdorën gjatë intervistës për të mbledhur opinionet e të intervistuarve. U diskutuan gjithashtu dhe tema që shpesh i sillnin të anketuarit gjatë diskutimit. Intervista përfshinte pyetje edhe për perceptimet pozitive dhe negative mbi shërbimet bankare përmes internetit , edhe pse ky punim fokusohet vetëm tek pengesat. Të gjitha intervistat u zhvilluan në gjuhën shqipe. Gjatë intervistave u mbledhën informacione të shumta nga ku nënvizua çështjet kryesore të përmendura nga çdo intervistë dhe vecuam çështjet e diskutuara me shpesh nga të intervistuarit. Për të identifikuar barrierat kryesore në përdorimin e shërbimeve bankare përmes internetit , ne kemi përdorur analizën cilësore ku janë marrë në konsideratë një varg çështjesh të rëndësishme. Të gjitha komentet dhe mendimet e njëjta janë të përmbledhura dhe të kategorizuara sipas barrierave të shpjeguara në skemën e diskutuar më lart, por këto kategori nuk ju bene me dije të anketuarve. Me pas u bë krahasimi mes përdoruesve dhe jopërdoruesve për të përcaktuar dallimet e mundshme.**Tabela 1:**

**Kategoritë e të intervistuarve**

Industria	Nr i të intervistuarve	Pozicioni
<b>Perdorues të IB</b>		
Kompanitë të mëdha prodhuese	2	Menaxher finance/ kontabiliteti
Shoqëri financiare dhe sigurimesh	2	Menaxher Zv/drejtor finance
Shoqëri Hoteliere	1	Menaxher drejtues
<b>Jopërdorues të IB</b>		
Sigurimet	4	Menaxhere financiare
Lizingu	2	Pergegjes finance
Spitale private	3	Drejtuës financiar
Kompani ajrore	1	Menaxher finance/ kontabiliteti

Analiza e të dhënave të grumbulluara nxorri në pah kryesisht nëntë lloje barrierash në aplikimin e bankëngut përmes internetit të cilat i kemi grupuar në tre kategori kryesore . Tri kategoritë lidhen kryesisht me çështjet e besimit dhe janë si më poshtë:

-siguria e sistemit

-besueshmeria ne kryejen e transakcioneve

-dhe besueshmeria tek ofruesit e sherbimeve ,kryesisht persa i perket ruajtjes se te dhenave personale.

Siguria është një nga pengesat më të mëdha.Gjate intervistave me perfaqesues te korporatave te cilat e kane adaptuar kete kanal sherbimi, u vu re qe ky kanal ishte adaptuar vetem per te ju vene ne dispozicion klienteve te tyre si menyre alternative per te shlyer detyrimet karshi kompanise sepse nuk perdorej per transkacione te vete kompanise ndaj te tjereve.Kjo per shkak te shqetesimeve ne lidhje me sigurine e ketyre sistemeve. Fjalite e meposhtme jane shkeputur nga intervista me menaxhere dhe tregojne shume mire kete te fundit:

...Ne jemi te shqetesuar per sa i perket sigurise sepse ka plot hakera te cilet mund te depertojne keto kanale dhe te na shkaktojne humbje te medha.Ideja eshte qe bankat duhet te shqetesohen per kete dhe te marrin masa per te investuar me teper ne infrastukturen e sigurise se ketyre kanaleve si dhe ne miratimin e potilikave te demshperblimit ne raste te humbjeve ne rrjet.(Perdoruesi 1)

....Ne e perdorim “Internet banking” si një kanal shtesë për klientet tone për të bërë ndonjë pagesë për ne. Për transaksione të brendshme financiare, të tilla si paga e punonjësve, pagesat për furnizuesit, ne përdorim kanale të tjera të ofrimit të shërbimit, p.sh. transferta tradicionale e të hollave ose permes cekut.(Perdoruesi 3).

Kompanite qe nuk e kishin adaptuar kete sherbim te ri preferonin ti merrnin sherbimet ne menyre tradicionale nepermejt sporteleve te bankave dhe madje as nuk e kane vene ne funksionim kete sherbim per klientet e tyre si menyre per kryejen e shpejte dhe pa kosto te transakcioneve ne lidhje me kompanine.Keta kliente nuk jane domosdoshmerisht kundra novacioneve teknologjike, por preferojne te qendrojnë me shërbimet të cilat ose janë më pak të avancuar teknologjikisht ose më të mbyllura, sepse ata besojnë se interneti është një teknologji e hapur me qasje të lehtë, dhe në këtë mënyrë, nuk është i sigurtë. Konkretisht ato u shprehen si me poshte:

...Kjo menyre e kryerjes se transakcioneve kerkon qe une te memorizoj emer perdoruesi dhe fjalekalim. Gjithashtu i druhem faktit qe persona te paautorizuar te kompanise qe mund te mesojne rastesisht apo qellimisht fjalekalimet te sjellin rrezik financiar per kompanine. (jo perdoruesi 2)

...Unë preferoj që të përdorin sistemet tradicionale, pasi shërbimet bankare nëpërmjet internetit nuk janë mjaftueshme të sigurt për transaksione financiare të cilat nga ana e tyre kanë nevojë për procedura të shumta. (jo perdoruesi 3).

Të dy kategorite e marra ne shqyrtim , pra perdoruesit dhe jo perdoruesit e perceptojne besueshmërinë e sistemit në nivele të ndryshme.Perdoruesit besojne qe ky kanal eshte i besueshem por jo ne nivele asolute. Ndersa jo perdoruesit nuk janë aspak të sigurt për të gjitha transaksionet financiare nëpërmjet internetit, dhe e perceptojnë “Internet banking” si shumë te pasigurt. Konkretisht jane shprehur si me poshte:

...Transaksionet financiare te biznesit zakonisht shoqerohen me levizje të madhe parash dhe me një klikim te gabuar mund të shkaktohet ndonjë demtim në sistemin financiar të firmës. Unë nuk dua të marr persiper risk financiar dhe përgjegjësi. Transaksionet tona financiare kërkojnë shume dokumenta te nenshkruara dhe ne shume kopje duke garantuar kontroll me te mire te brendshem.(Jo perdoruesi 4)

Një tjetër çështje e rëndësishme që përdoruesit e “internet banking” sollen ne fokus kishte te bente me faktin qe nese nje problem do te shfaqej ne sistem gjate kryerjes se nje transakcioni , ai nuk mund te zgjidhej menjehere. Përdoruesit duhet të shkonin në bankë



për të zgjidhur probleme të tilla, gje e cila konsumonte kohë.

Përveç kësaj, disa përdorues të “Internet banking” janë të pakënaqur me shpejtësinë e ulët të përgjigjes se ketij shërbimi, gje e cila rezulton nga mangësitë në infrastrukturën e komunikimit në internet. Reagimet janë të ngadaltë gjatë transaksionit. Kështu që ky kanal i kryerjes së transaksioneve perceptohet si papershtatshem. Për shembull, një prej menaxhereve financiare të një kompanie u shpreh kështu në lidhje me kohën e reagimit: ...Koha që merr sistemi gjatë transaksionit është shumë e gjatë dhe une qendroj në tension për më shumë se 10 minuta deri sa të marr konfirmimin. (Përdoruesi 5).

Duke u nisur nga këto faktore përdoruesit e “Internet banking” duket se janë me të prirur për të zgjedhur bankat të cilat ata mendojnë dhe besojnë se kanë më shumë eksperiencë në ofrimin e shërbimeve të bazuara në teknologji, gje e cila duket të jetë një faktor i madh që kontribuon në besimin e konsumatorit dhe i ndihmon ata të vendosin nëse do ta adoptojnë shërbimin e ri apo jo.

Gjithashtu përdoruesit janë të shqetësuar për ruajtjen e të dhënave personale, po jo në masën që shqetësohen për sigurinë në transaksione. Shumica e të anketuarve besonin se ata e kishin humbur tashmë kontrollin e informacionit të tyre personal sepse sistemet e informacionit të bazuara në internet e bëjnë shumë më të lehtë aksesimin e ketij informacioni. Një i anketuar tha se ai beson se bankat i përdorin informacionet rreth klienteve, pa pëlqimin e tyre pavarësisht se çfarë kanali të ofrimit të shërbimit përdor. Interneti e bën më të lehtë aksesimin e të dhënave, por pavarësisht kësaj të dhënat janë gjithkund të rrezikuara për tu përdorur duke cenuar kështu të drejtën e privatesisë së të dhënave personale. **Tabela**

## 2: Përmbledhje e barrierave me nivelet e preokupimit të perceptuara

Pengesat	Përdoruesit e IB	JO përdoruesit
Besueshmëria në sistem	Nivele të ulëta shqetësimi	Nivele të larta shqetësimi
<b>Siguria e sistemit si i tere</b>	Nivele të ulëta shqetësimi	Nivele të larta shqetësimi
<b>Siguria gjatë transaksioneve</b>	Nivele të ulëta shqetësimi	Nuk i besojnë shërbimeve IB
<b>Besueshmëria të banka</b>	Nivele të ulëta shqetësimi	Nivele të larta shqetësimi
Suporti ligjor dhe teknik	Nivele të ulëta shqetësimi	Nivele të larta shqetësimi
<b>Aftësia e grupeve të punës për të zgjidhur me efikasitet problemet që hasen</b>	Nivele mesatare të shqetësimit	Nivele të larta shqetësimi
<b>Mbrojtja e privatesisë</b>	Qendrimet pozitive për adaptimin	Qendrimet negative për adaptimin
<b>Shlyerja e detyrimeve që mund të lindin nga humbjet</b>	Kane burime të mjaftueshme IT	Kane mungesa në burime IT
Pengesat organizative	Kane me shumë njohuri teknike	Kane me pak njohuri teknike
<b>Sjellja e menaxhereve</b>		
<b>Mungesa e burimeve</b>		
<b>Mungesa e dijeve</b>		

## Konkluzione dhe implikime

Këto intervista të detajuara tregojnë që ka ende disa pengesa serioze në adaptimin e ketij kanali të marrjes së shërbimeve bankare (IB) nga ana e klienteve korporata të bankave. Pengesat janë të fortë për jo-përdoruesit, por edhe përdoruesit nuk janë plotësisht të kënaqur me shërbimin bankar nëpërmjet internetit, dhe ende nuk përdorin shumicën e opsioneve që ofron ky shërbim edhe nëse e kanë adaptuar. Tabela II përmbledh tri lloje

kryesore të barrierave të adaptimit të shërbimit bankar përmes internetit. Besimi është një nga çështjet më kritike, duke përfshirë shqetësimet në lidhje me sigurinë e sistemit, besueshmërisë së ulët të transaksioneve, dhe mosbesimi të ofruesit të shërbimit. Siguria është një pengesë e cituar shpesh. Në hulumtimin tonë, të gjithë klientet e kanë këtë shqetësim, por jo-përdoruesit kanë nivele më të larta të shqetësimit, nuk kanë besim për të bërë ndonjë transaksion financiarë nëpërmjet internetit, dhe nuk kanë ndërmend ta përdorin këtë shërbim bankar.

Besueshmëria e transaksioneve bankare nëpërmjet internet është një tjetër shqetësim i madh midis të gjithë klienteve, por përsëri me e fortë në mesin e jo-përdoruesive. Përdoruesit kishin shqetësime mbi besueshmërinë e këtij shërbimi të ri, por ishin më të sigurt dhe besonin se banka është në gjendje të zgjidhë problemet që mund të lindin gjatë aplikimit të IB. Megjithatë, ata preferonin të ishin kliente të bankave me më shumë degë, në mënyrë që të ishte me e lehtë për të shkuar në bankë kur të shfaqej ndonjë problem. Kjo implikon një punë të madhe që duhet të bëjnë bankat për trajnimin e stafit në degët e saj. Edhe pse degët nuk janë përgjegjëse për implementimin e IB të klientet, duhet të jetë dikush i trajnuar në çdo degë për të trajtuar problemet që mund të hasin klientet përdorues të IB.

Së fundi, besimi është një çështje që lidhet shumë me eksperiencën e bankave dhe politikën e tyre, gjë e cila kontribuon në besimin e klienteve. Reputacioni i përgjithshëm i bankës së bashku me reputacionin në ofrimin e shërbimeve bankare të bazuar në teknologjinë e internetit, i bën bankat më shumë ose më pak atraktive. Nëse bankat nuk kanë patur marrëdhënie të mëparshme me klientët, nuk kanë reputacion të mirë, dhe nuk kanë përvojë në lidhje me teknologjinë, konsumatorët nuk kanë gjasa të kenë besim në përdorimin e shërbimeve bankare përmes Internetit.

Shqipëria është aktualisht në fazat e hershme të zhvillimit të ligjit mbi tregtinë elektronike dhe shqiptaret besojnë se vendit ende i mungon aftësia për të mbrojtur klientët e bankës në mënyrë të gjithanshme në rastet e humbjeve financiare kur përdorin shërbimet bankare nëpërmjet internetit, dhe për të gjetur prova në internet si dhe për të zgjidhur rastet në mënyrë të drejtë. Më tej, përdoruesit nuk janë të kënaqur me mbështetjen ligjore në mbrojtjen e privatësisë gjatë aplikimit të IB. Por duke patur parasysh që në Shqipëri në asnjë lloj kanali tjetër të ofrimit të shërbimit nuk ke mbrojtje të dhenave personale, kjo duket se është një çështje me pak shqetësuese për përdoruesit aktualë dhe potenciale. Nga ana tjetër edhe prirja e menaxhereve për të perqafuar apo jo këtë shërbim të ri ndikon shumë në qasjen e këtij shërbimi të ri.

Për sa i përket jo-përdoruesve u vu re që ata nuk donin as të investonin e as të humbisnin kohë në adaptimin e shërbimit bankar nëpërmjet internetit.

Por edhe përdoruesit nuk e përdorin këtë shërbim në të gjitha opsionet që ofrohen. Ende klientet korporata të bankave preferojnë shërbimet balle për balle të bankave.

Nisur nga këto barrierë në perceptime duket se ka shumë vështirësi për të rritur bazën e përdoruesve. Kështu do të sugjerohet që bankat të tregojnë dukshëm shqetësim për sigurinë, besueshmërinë, dhe detyrimet që mund të lindin me zgjidhjet konkrete për të zvogëluar ose eliminuar kostot ndaj klienteve në rastet që ka perpunime të gabuara të transaksioneve apo në rastet e humbjeve në sistem. Shpesh, këto nuk janë thjesht çështje teknike, por më tepër, janë të lidhura me procesin e projektimit, ose, ndonjëherë, pjesërisht me psikologjinë dhe besimet e klienteve. Të gjithë klientet, edhe përdoruesit, besojnë dhe mendojnë se do të shfaqen probleme gjatë përdorimit të teknologjisë. Ideja është që të ndryshohet perceptimi i tyre në lidhje me reagimet e bankave për rregullimin dhe marrjen e masave korigjuese. Për këtë bankat duhet të ngrejnë struktura të koordinuara, të tilla që

klientet te mund te nderveprojne me njerez te specializuar per zgjidhjen e problemeve qe mund te hasen gjate punes me sistemin IB.

Pavaresisht barrierave te perdorimit gjate ketij studimi u vune re dhe shume ane pozitive te ketij kanali te ri te marrjes se sherbimeve bankare.

Nese ky sherbim arrihet te integrohet mire ne strukturen organizative te nje biznesi, klienti i nje banke, mund te perfitojen sherbime shume me te pershtatshme dhe te personalizuar. Kështu, klientet nuk do ta shohin kete sherbim si nje kanal për të zëvendësuar transaksionet tradicionale me banken, por më tepër si një mënyrë për të plotësuar dhe përmirësuar marrëdhëniet.

Bankat nga ana e tyre e shohin kete mekanizem si nje forme e reduktimit te kostove operative te tyre, por edhe te klienteve. Por klientet i druhen rreziqeve qe mund te hasen te cilat i perceptojne si shume te kushtueshme.

Perfundimisht mund te thuhet se duhet ende pune per te permiresuar perceptimet ne lidhje me kete kanal te ri qe nga ana e tij duket te jete shume premtues dhe me benefite.

### Referencat

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

[www.bkt.com.al](http://www.bkt.com.al)

<http://www.raiffeisen.al/>

<http://www.venetobanka.al/Default.aspx>

<http://www.tiranabank.al/>

<http://www.nbg.gr/>

<http://www.alphabank-albania.al/>

<http://www.intesasanpaolobank.al/>

<http://www.procreditbank.com.al/>

[http://www.bankofalbania.org/goto.php?url\\_link=http://www.emporiki.com.al/&url=http://www.emporiki.com.al&uniqueid=201301251512581206&thisMode=&ses\\_userid=2](http://www.bankofalbania.org/goto.php?url_link=http://www.emporiki.com.al/&url=http://www.emporiki.com.al&uniqueid=201301251512581206&thisMode=&ses_userid=2)

<http://www.bankacredins.com/>

<http://societegenerale.al/>

<http://www.fibank.al/>

Aladwani, A. (2001), *"@Online banking: a field study of drivers, development challenges and expectations"*, International Journal of Information Management, Vol. 21 No. 3, pp. 213-25.

Gerrard, P. & Cunningham, J.B. (2003), *"@The diffusion of Internet banking among consumers"*, International Journal of Bank Marketing, Vol. 21 No. 1, pp. 16-28.

## Aspekti Ligjor i Mbrojtjes së Konsumatorit ne Fushën e Bujqësisë dhe Ushqimit në Shqipëri

Iva Balza

Universiteti "Aleksander Xhuvani"; Elbasan

### Abstrakt

Artikulli "Mbrojtja e Konsumatorit në Fushën e Bujqësisë dhe Ushqimit në Shqipëri" është një analizë e përmbledhur mbi situatën administrativo-juridike në Shqipëri për një çështje me sensitivitet të lartë, sic është ajo e mbrojtjes së konsumatorëve.

Në të do të analizohen organet që mbrojnë të drejtat e konsumatorit, por gjithashtu do të vërehet sa dhe si janë implementuar direktivat e BE ne legjislacionin vendas.

**Fjalë Kyce:** Mbrojtje; konsumator; institucione; direktiva; legjislacion.

### Qëllimi

Qëllimi i këtij artikulli është të bëjë një vështrim analitik të situatës së institucioneve shqiptare që kanë kompetencë mbrojtjen e konsumatorit, të gjykojë sa këto struktura administrativo-organizative jane eficente duke i krahasuar me ato europiane. Me anë të krahasimit synohet të evidentohen elementët që duhen ndryshuar ose përmirësuar.

### Metodologjia

Metoda e përdorur është ajo analitike dhe krahasimore. Artikulli bazohet në tre çështje kryesore:

- Instucionet përgjegjëse në Shqipëri për mbrojtjen e konsumatorëve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit
- Institucionet përgjegjëse të BE për mbrojtjen e konsumatorëve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit
- Baza ligjore europiane për mbrojtjen e konsumatorit dhe nevoja për implementimin e saj ne legjislacionin e brendshëm shqiptar.

Mbrojtja e konsumatorit ne fushën e bujqesise dhe ushqimit, në ditët e sotme janë nga çështjet më të rëndësishme dhe sensitive, qoftë në aspektin juridik, qoftë në atë praktik. Investime të konsiderueshme janë realizuar vitet e fundit në Shqipëri për fuqizimin e rrjetit të laboratorëve të kontrollit ushqimor, në nivel rajonal e qëndror dhe janë kryer mjaft trajnime për personelin teknik që merret me kontrollin veterinar e fitosanitar, por ka ende për të bërë.<sup>1</sup>

Fuqizimi i konsumatorëve nuk është vetëm një e drejtë, por ka të bëjë me krijimin e një mjedisi të përgjithshëm që i mundëson atyre të shfrytëzojnë këto të drejta dhe të përfitojnë prej tyre, që do të thotë krijimin e një sistemi në të cilin ata mund të mbështeten dhe që u garanton sigurinë e

mallrave dhe shërbimeve si dhe mbrojtjen efektive të interesave të tyre ekonomike kur

<sup>1</sup>Monitorimi i ecjes së Shqipërisë drejt Integritimit European, Fondacioni Friedrich-Ebert, Zyra Tiranë.

këto vihen në rrezik.<sup>2</sup>

Në punimin e mëposhtëm do të trajtohet mbrojtja e konsumatorit në aspektin e organeve shtetërore, institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e saj në Shqipëri, sikundër do të ketë edhe një krahasim me strukturat e BE përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit. Fokusi do të jetë organizimi, funksionimi dhe administrimi në fushën e bujqësisë, ushqimit. Trajtimi i bërë do të jetë i fokusuar në një analizë juridiko-administrative të strukturave, në efikasitetin konkret të tyre. Në këtë trajtim nuk janë të përfshira OJF apo OJQ si dhe struktura ndërkombëtare të instaluar në vendin tonë.

Institucionet kyçe që garantojnë mbrojtjen e konsumatorit në Shqipëri, japin një kontribut të përditshëm e konkret janë:

### **Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit**

Misioni i MBUMK është zbatimi i programit të qeverisë në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit. Në zbatim të programit politik të qeverisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ka si objekt kryesor rritjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor, rritjen e aftësinë konkurruese të produkteve bujqësore, blegtorale dhe të përpunuara brenda dhe jashtë vendit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore e financiare.

Misioni i MBUMK është zbatimi i programit të qeverisë në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit. Elementët bazë të këtij misioni janë :

- Hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe blegtoral.
- Hartimi dhe përafrimi i legjislacionit në fushat e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit konform me kërkesat e BE.
- Mbrojtja e shëndetit të kafshëve, bimëve dhe garantimi i shëndetit të njerezve nga sëmundjet që rrjedhin prej kafshëve dhe cilesia e ushqimeve.
- Sigurimi i informacionit bujqësor.
- Menaxhimi dhe administrimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore.
- Asistencë dhe informacion për fermerët.

### **Autoriteti Kombëtar i Ushqimit**

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është krijuar si pjesë përbërëse e një programi për të krijuar dhe garantuar sistemin e sigurisë ushqimore në Shqipëri. AKU është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1081 datë 21.10.2009 . Ky institucion është krijuar dhe mbështetur nga ekspertë të huaj me fondet e BE, duke filluar që nga viti 2007, periudhë në të cilën kanë filluar hapat e parë të konceptimit të AKU. Sot ky institucion shtrihet në të 12 qarqet e vendit me drejtoritë e saj, në të gjithë Shqipërinë.

Është me interes për t'u përmendur fakti që AKU ka një faqe zyrtare interneti (website), tejet të azhurnuar. Në këtë faqe gjendet informacion i detajuar mbi strukturën, funksionet e saj dhe institucionet brenda dhe jashtë vendit me të cilat bashkëpunon. Aksesi i cdo qytetari në këtë faqe dhe përfshirja e tyre duke bërë ankesa, ose dhënë indicie tregon

<sup>2</sup>Strategjia Ndersektorale për Mbrojtjen e Konsumatoreve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2014-2020; faqe 8; paragrafi 3.

për një institucion të nivele bashkëkohore. Krijimi i këtij institucioni përgjegjës për mbikqyrjen e sigurisë ushqimore në Shqipëri është i domosdoshëm për të përmbushur kërkesat ligjore, ekonomike por edhe ato sociale.

AKU, si një institucion në varësi të Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit siguron një nivel të lartë të mbrojtjes së qytetarëve, si dhe synon të krijojë besimin, por dhe ta garantojë atë për produktet ushqimore në vendin tonë. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është autoriteti kompetent me funksione inspektuese për menaxhimin në nivel kombëtar të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe shëndetit të kafshëve.

Me krijimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, nga viti në vit kemi jo vetëm një trend rritës të numrit të inspektimeve por edhe rritjen e cilësisë së tyre, si rezultat i unifikimit të procedurave, përmirësimit të legjislacionit, rritjes së kapaciteteve tekniko-profesionale nëpërmjet trajnimeve etj. Përmirësimi i cilësisë së inspektimit ka sjellë një zbatim më rigoroz të kërkesave të

legjislacionit në fuqi, gjë e cila ka ndërgjegjësuar dhe OBU në përmirësimin e kushteve të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit.<sup>3</sup>

### **Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit**

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka në themel të punës mbrojtjen e disa të drejtave të konsumatorit dhe synon të rrisë bashkëveprimin dhe efektivitetin e punës për përmbushjen e objektivave të planifikuara përmes monitorimit dhe vlerësimit

Agjencia është person juridik publik, e cila vepron në bazë të Kushtetutës, të legjislacionit shqiptar në fuqi, në veçanti në mbështetje të nenit 8 pika 1, shkronja “ç”, nenit 32 shkronja “ç” e ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; nenit 128 e ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave administrative” (i ndryshuar); ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 për “Mbrojtjen e konsumatorëve”, (i ndryshuar); ligjit nr.9803, datë 04.11.2004 për “Shërbimin dhe inspektoratin veterinar”, ligjin nr.9010, datë 13.02.2003 për “Administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.798, datë 29.09. 2010 për “Miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”; si edhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve të miratuara nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë.

Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit, në themel të punës së saj do të ketë mbrojtjen e disa të drejtave të konsumatorit dhe është konsideruar si simbol i sinkronisë dhe bashkëpunimit mes pushtetit vendor dhe atij qendror. AMK synon të rrisë bashkëveprimin, efektivitetin e punës për përmbushjen e objektivave të planifikuara nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe kontrollit të vazhdueshëm.

Vizioni i Agjencisë dhe njëkohësisht vizioni i Bashkisë së Tiranës për mbrojtjen e konsumatorit është jo vetëm monitorimi por edhe mbrojtja e së drejtës së konsumatorit të komunitetit të Tiranës. Ajo që synohet është që konsumatorët të jenë individë më të mirëinformuar dhe vetëpërcaktues në mënyrë që të zotërojnë njohuritë përkatëse mbi të drejtat e tyre në raport me tregun, ofrimin e shërbimeve publike etj. Ata do të kenë një pozicion të mirë në vlerësimin e situatës së tregut që rrjedh nga mbikëqyrja bashkëkohore dhe transparenca e tregut. Duke qënë më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre tashmë konsumatorët do të luajnë një rol më aktiv duke denoncuar shkeljet përkatëse si edhe

<sup>3</sup>Strategjia Ndersektorale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2014-2020; faqe 11; paragrafi 6.

mund të mbrohen në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet serioze të cilat ata s'mund t'i trajtojnë si individë.

Nëpërmjet veprimtarisë së saj Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit do të sigurojë:

- Zbatimin e legjislacionit dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij në drejtim të sigurisë dhe cilësisë së mallrave dhe shërbimeve të ofruara.
- Trajtimin në mënyrë integrale dhe të njëhsuar i problematikave të mbrojtjes së konsumatorit.
- Komunikimin e përhershëm me konsumatorin e kryeqytetit, verifikimin në kohë të ankesave të tyre edhe marrja e masave përkatëse. Qytetarët e Tiranës do të kenë mundësi të shprehin shqetësimet e tyre drejtpërdrejt në Agjenci, nëpërmjet telefonit ose internetit. Informimin e vazhdueshëm të konsumatorit mbi tregjet, produktet, tregtimet e mallrave jashtë normave e standardeve higjienike, mungesën e dokumentacionit të origjinës së mallit dhe të çertifikateve shëndetësore.
- Bashkëpunimin me agjenci të tjera qeveritare, Institucione Qëndrore në nivel vendor që merren me aspekte të mbrojtjes së konsumatorit, por edhe me organizata jo-qeveritare në funksion të ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta për mbrojtjen e konsumatorit.

### **Organizmat e BE që mbrojnë konsumatorin**

Cështja e mbrojtjes së konsumatorit është në themel të të gjithë veprimtarisë së BE. Megjithatë në organigramën institucionale të kësaj strukture (BE), ekziston edhe një organizëm tejet i specializuar që operon në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, më specifikisht në një nga fushat më sensitive sic është ajo e ushqimit.

### **Autoriteti Europian i Sigurisë Ushqimore**

Autoriteti Europian i Sigurisë Ushqimore është një agjenci e pavarur europiane themeluar nga buxheti i BE-së që operon veçmas nga Komisioni Europian, Parlamenti Europian dhe shtetet anëtare.

Funksioni i EFSA është vlerësimi dhe bërja publike e të gjitha risqeve që lidhen me zinxhirin ushqimor. Këshillimi i bërë nga EFSA do të orientojë politikat dhe vendimet në këtë fushë. Nga ana tjetër veprimtaria e kësaj agjencie lidhet ngushtë me këshillimin shkencor për çështje specifike. Kërkesat për studime shkencor merren nga Komisioni Europian, Parlamenti Europian dhe shtetet anëtare, por studimet shkencore mund të nisin edhe me iniciativë të vetë EFSA.

EFSA në vazhdimësi suporton çështjet që lidhen me menaxhimin e riskut dhe politikbërjen mbi këtë çështje. Në terma konkretë kjo mund të ketë lidhje me rishikimin ose përshtatjen me legjislacionin europian mbi ushqimin dhe sigurinë ushqimore, duke zgjedhur kështu ose pranimin e rregullimeve të bëra mbi substanca si pesticidet ose aditivët ushqimorë, ose ngritjen e politikave të reja mbi ushqimin. EFSA nuk përfshihet në procese të tilla menaxhuese, por këshilla e saj e pavarur u jep këtyre të fundit një bazë të fortë shkencore. Nëpërmjet aktiviteteve të komunikimit të riskut EFSA synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të bëjë një shpjegim të detajuar të veprimtarisë së saj shkencore. Ajo synon të realizojë komunikime të herëpashershme, koncize, të sakta me palët e interesuara, si edhe publikun e gjerë, për çështjet që lidhen me sigurinë ushqimore, bazuar në vlerësimin e riskut dhe ekspertizën shkencore.

Për të hartuar qëndrimin e saj shkencor, EFSA ndjek një rrjedhë pune të mirëpërcaktuar. Gjithëkërkimi gjë nis me një kërkesë të bërë për këshillim shkencor ose me iniciativë të saj. EFSA ka hartuar një grup të detajuar praktikash mbi vlerësimin e riskut që do të orientojnë Komitetin e Ekspertëve dhe Panelin shkencor, duke bërë kështu që opinioni i saj të reflektojë standartet më të larta shkencore. Ajo vazhdimisht implementon një sistem sigurimi që kontrollon dhe forcon cilësinë e veprimtarisë shkencore.

Vlerësimi i riskut dhe komunikimi i riskut u nënshtrohen kritereve strikte ligjore. EFSA ka personalitetin e saj juridik dhe vepron në mënyrë të pavarur nga institucionet e BE. Ajo menaxhohet nga një Drejtor Ekzekutiv.

Që nga krijimi i saj agjencia ka vendosur rregullat dhe principet kryesore të veprimtarisë së saj të cilat janë përshtatur nga Bordi i Menaxhimit. EFSA bazohet tek legjislacioni i BE për çështje që lidhen me aksesimin publik të dokumentave. Në përputhje me Fondin Rregullator, ajo është ligjërish e detyruar të publikojë çdo arritje të veprimtarisë së saj shkencore, dokumentat menaxhuese si buxheti, kontratat. Parime të bazike që udhëheqin veprimtarinë e saj janë: pavarësia, transparencja, niveli i lartë shkencor, përgjegjshmëria. EFSA si një strukturë e mireorganizuar baze ligjore themelore për funksionimin e saj ka Rregulloren nr 178/2002

Në vazhdim të akteve që kategorizohen në të detyrueshme dhe jo të detyrueshme, një ndër më të rëndësishmit është Rregullorja nr 178/2002 (shtuar dhe ndryshuar disa herë) e Parlamentit Europian dhe Këshillit Europian e cila vendos parimet dhe kërkesat themelore që duhet të përmbajnë ligjet për ushqimin, procedurat që duhen ndjekur për sigurinë e ushqimit si dhe trajton funksionet e parimet e funksionimit të EFSA.

### **Trajtesa teorike mbi Rregulloren**

Më poshtë do të paraqiten disa përfundime të një natyre teorike që vetë BE ka nxjerrë në trajtën e sqarimeve që i bëhen paraprakisht rregullores:

- Lëvizja e lirë e ushqimeve është një aspekt esencial i tregut të brendshëm dhe kontribuon konsiderueshëm në shëndetin e qytetarëve, sikundër edhe në mirëqenien e tyre sociale dhe ekonomike.
- Mbrojtje e lartë e jetës dhe shëndetit të njeriut duhet të sigurohet nga politikat komunitare.
- Lëvizja e lirë e ushqimeve dhe ushqimeve të kafshëve mund të arrihet vetëm nëse nuk bëhet diferencim midis shteteve anëtare mbi kërkesat/kushtet e sigurisë ushqimore.
- Ekzistojnë diferenca në aspektin parimor dhe procedural të ligjeve mbi ushqimin midis shteteve anëtare. Këto diferenca mund të ndikojnë direkt ose indirekt në funksionimin e tregut të brendshëm europian.
- Duhet bërë një përafrim sa më i madh i mundshëm midis shteteve anëtare për konceptet, parimet dhe procedurat .
- Është me rëndësi të sigurohen konsumatorët, palët tregtare dhe palët e tjera të interesuara që vendimarrja në fushën e mbrojtjes së konsumatorit duhet të ketë mbi të gjitha baza shkencore.
- Është e nevojshme që të merren masa konkrete që ushqimi i pasigurtë (në aspektin cilësor) të mos hidhet në treg.
- Në mënyrë që përqsasja të jetë gjithpërfshirëse dhe e mirëintegruar duhet që ligji të ketë një fushë të gjerë mbulimi, një sërë parashikimesh me efekt direkt ose indirekt.



- Për të garantuar sigurinë ushqimore është e nevojshme që të merret në shqyrtim gjithë zinxhiri ushqimor, duke nisur nga produktet primare deri tek ato sekondare, duke marrë parasysh edhe ushqimete kafshëve etj.
  - Për të garantuar sigurinë e ushqimit duhet të merret në konsideratë edhe paketimi, transporti, shpërndarja.
  - Për parandalimin e rreziqeve potenciale mbi shëndetin duhet ngritur një rrjet ekselent laboratorik i netëorkut që të sigurojë monitorim të vazhdueshëm.
  - Masat e aplikuara nga shtetet anëtare duhet të bazohen në analizën e riskut, me përjashtim të rasteve kur ajo nuk është e përshtatshme me natyrën e masave të marra dhe situatën.
  - Në raste specifike ku risku për jetën ose shëndetin ekziston, por ka paqartësi nga ana shkencore, parimi i parandalimit prodhon një mekanizëm determinant për menaxhimin e riskut që të mbrohet shëndeti i konsumatorit.
  - Duke parë sensitivitetin e ëështjes, autoritetet publike duhet të informojnë vazhdimisht publikun kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme që një ushqim të përbëjë rrezik për shëndetin.
  - Siguria e konsumatorit brenda dhe jashtë BE është e një rëndësie esenciale, gjë që kontribuon në ngritjen e standarteve.
  - Është e nevojshme të përcaktohen parimet kryesore të tregtisë së ushqimeve duke ngritur kështu standarte ndërkombëtare.
  - Një operator biznesi në fushën e ushqimit duhet me patjetër të ketë përgjegjësi ligjore për sigurinë e ushqimit.
  - Kriteret shkencore dhe teknike të BE që lidhen me sigurinë e ushqimit duhet të kontribuojnë në arritjen e një niveli të lartë mbrojtjeje të konsumatorit brenda BE.
  - Struktura e posacme (EFSA), duhet të forcojë mbështetjen teknike dhe shkencore duke u shndërruar kështu në një burim këshillimi shkencor.
- Vetë përkufizimi i konceptit të EFSA dhe strukturimi i funksioneve të saj bazë tregon që fokusi kryesor është siguria e ushqimit, kështuqë veprimtaria që lidhet me shëndetin dhe sigurinë e kafshëve, bimëve duhet të jetë e një karakteri më të limituar duke u fokusuar vetëm në opinionet shkencore. Misioni i EFSA duhet të mbulojë këshillimin teknik dhe shkencor mbi ushqimin e njerëzve duke dhënë mbështetje dhe asistencë jo vetëm mbi programet mbi shëndetin, por edhe mbi legjislacionin e BE dhe të shteteve anëtare.
- Është e nevojshme të sigurohet një balancë midis strukturave kombëtare dhe EFSA, sikundër të lejohet përfshirja e shteteve joanëtare të BE të cilët kanë lidhur marrëveshje, duke u detyruar të implementojnë ligjet komunitare që mbulojnë fushën e mbrojtjes së konsumatorit.
- Rregullorja vendos bazat për sigurimin e një niveli të lartë mbrojtjeje të shëndetit të njeriut dhe interesave të konsumatorit në raport me ushqimin, duke marrë në konsideratë funksionimin normal të tregut të brendshëm. Ajo ngre parimet dhe përgjegjësitë me qëllim përfitimin e një baze të fortë shkencore, veprimtarie efçente dhe procedurave vendimmarrëse në çështje që lidhen me sigurinë e ushqimit.
- EFSA duhet të jetë e hapur edhe me shtetet të cilat pavarësisht se nuk janë pjesë e BE, kanë bërë një marrëveshje me BE ose kanë adaptuar legjislacionin komunitar në fushën e ushqimit.<sup>4</sup>

<sup>4</sup>Article 49, Regulation (EC) NO 178/2002.

Parimet e EFSA janë të implementuara në një masë të konsiderueshme në legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e konsumatorit, por ky fakt nuk shmang problematikat dhe mangesitë që evidentohen.

### Konkluzione

- Institucionet që mbrojnë konsumatorin në Shqipëri janë tejet të ngjashme me ato që parashikon BE, qoftë në aspektin organizativo-administrativ, qoftë në atë funksional.
- Mbrojtja e konsumatorit, çështjet që lidhen me ushqimin, realizohen sot kryesisht nga agjencitë, si një formë specifike dhe mjaft eficiente e organizimit.
- Legjiislacioni aktual shqiptar në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, ushqimit dhe bujqësisë është mjaft i gjerë dhe me ndikim të madh nga legjislacioni i BE, gjë që dëshmon për një gradë të lartë implementimi.
- Më i vakët është organizimi në struktura specifike për bujqësinë. Më tepër se ngritja e strukturave direkte, dallohet fakti që organizmat që mbrojnë konsumatorin, indirekt prekin dhe çështjet e bujqësisë.
- Për sa i përket legjislacionit bujqësor, ai është i zhvilluar, dhe reflekton përveç parimeve komunitare edhe cilësitë natyrore e gjeografike të vendit tonë, duke u përshtatur kështu edhe me kontekstualitetin shqiptar.
- Fakti që është bërë një implementim i mirë i legjislacionit, që janë ngritur struktura të ngjashme me ato të BE, nuk do të thotë që është zgjidhur definitivisht çështja e ushqimit, bujqësisë dhe mbrojtjes së konsumatorit, pasi këto kanë një karakter dinamik e kanë nevojë për përshtatje të vazhdueshme dhe për një veprimtari sa më efikase nga ana e institucioneve përkatëse.
- Ndërtimi i infrastrukturës për rrjetin e bashkëpunimit të strukturave shtetërore me përgjegjësi institucionale për mbrojtjen e konsumatorëve, për te qenë pjesë e CPCN është një fazë që duhet të paraprijë hyrjen e Shqipërisë në BE
- Përmirësimi i nivelit të këshillimit të konsumatorëve nëpërmjet funksionimit të qendrave të këshillimit, që drejtohen nga shoqatat e konsumatorëve është një nevojë emergjente për realitetin shqiptar
- Duke u nisur nga eksperiencia e deritanishme e aktivitetit të AKU-së, evidentohet se sfidat për të ardhmen do të jenë zhvillimi i kapaciteteve për të inspektuar stabilimentet e biznesit ushqimor dhe për të kontrolluar përputhshmërinë me standardet e BE-së në kuadër të rritjes së sigurisë ushqimore për konsumatorin.
- Në lidhje me sistemin e kontrollit të sigurisë ushqimore, është nevojshme rritja e koordinimit të përgjithshëm të kontrollit të sigurisë së ushqimit uniformiteti i inspektimeve, disponueshmëria dhe përdorimi i udhëzimeve për kontrollet zyrtare, si dhe kontrollet zyrtare të vendosen sipas prioriteteve bazuar në rrezikun në të gjitha nivelet.

## Bibliografi

- Stephen, W. (2005). *EU Consumer Law and Policy*, Elgar European Law, Cheltenham-UK.
- Malek, R. "Fair Trading in EC Law, European Law Publishing".
- Sinai, K.J. (2003). "The action plan on european contract law", 26 *Journal of Consumer Policy*.
- Rregullore 178/ 2002 e BE.
- Ligji nr 9902, d 17.04.2008 " Per mbrojtjen e konsumatorit".
- Relacion per kriimin e AMK.
- VKM Nr. 145, datë 8.3.2006. "Për përberjen, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e komisionit shtetëror të prodhimit organik".
- Ligji nr.7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik".
- Ligji Nr. 10465, datë 29.09.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr.10 028, datë 11.12.2008 Për aredimin e Republikës së Shqipërië në "Marrëveshjen Ndërkombëtare për ullirin dhe vajin e ullirit".
- VKM Nr. 234, datë 11.05.2000 ."Mbi kriteret dhe procedurat e marrjes së mostrave dhe vlerësimit të plehrave kimike".
- Ligji Nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural".
- Ligji nr.10416, datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor".
- Ligji nr. 9199, dt. 26.02.2004 "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve BIO".
- Ligji Nr. 8944, datë 19.09.2002,"Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit".
- Ligji Nr. 8880, datë 15.04.2002, "Për mbrojtjen e të drejtave të seleksionerit të bimëve".
- Ligji. Nr. 8691, datë 16.11.2000, "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe cigareve".
- Ligji Nr. 10390, datë 03.03.2011, "Për plehrat e përdorimit për bimësinë".
- Ligji Nr. 8443, datë 21.01.1999, "Për vreshtarinë, verën dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rrushi".
- Rregullore e brendshme e AKU.
- Monitorimi i ecjes së Shqipërisë drejt integritimit europian, studim i Fondacionit Friedrich Ebert, zyra Tirane.
- VKM Nr. 145, datë 8.3.2006. "Për përberjen, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e komisionit shtetëror të prodhimit organik".
- Ligji Nr.10 028, datë 11.12.2008 Për aredimin e Republikës së Shqipërië në "Marrëveshjen Ndërkombëtare për ullirin dhe vajin e ullirit".
- VKM Nr. 234, datë 11.05.2000 ."Mbi kriteret dhe procedurat e marrjes së mostrave dhe vlerësimit të plehrave kimike".
- Ligji Nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural".
- Ligji nr.10416, datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor".
- Ligji nr. 9199, dt. 26.02.2004 "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve BIO".
- Ligji nr . 9902, dt 17.04.2008, " Për mbrojtjen e konsumatorëve".
- Strategjia Ndwrsëktoriale Pwr Mbrojtjen e Konsumatorwve dhe Mbikwyrjen e Tregut 2014-20020.

## **Rëndësia e bazës së të dhënave në marketingun e marrëdhënieve të ndërtuar online kundrejt atij offline. Rasti i sektorit bankar shqiptar**

**Dr. Ervin Myftaraj**

*Departamenti i Marketingut,  
Fakulteti i Biznesit,  
Universiteti "Aleksandër Moisiu"*

### **Abstrakt**

Baza e të dhënave marketing është procesi i ndërtimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të bazës së të dhënave konsumatore dhe bazave të tjera të të dhënave (produktesh, shitësish, etj), për arsyen e kontraktimit, transaksioneve dhe ndërtimit të marrëdhënieve me konsumatorin. Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë rëndësinë e bazës së të dhënave në procesin e ndërtimit të marketingut të marrëdhënieve në tregun offline dhe në tregun online.

Për realizimin e këtij punimi, është përdorur literatura e marketingut dhe është marrë një zgjedhje prej 316 konsumatorësh, të cilët u janë përgjigjur pyetjeve për rëndësinë e bazës së të dhënave dhe ndikimit të saj në marketingun e marrëdhënieve. Zgjedhja është bërë rastësore, e grupuar sipas një shpërndarje demografike në bazë të rajonit ku jetojnë, moshës, gjinisë, nivelit arsimor dhe sektorit ku punojnë. Pyetësorët janë plotësuar në dy qytetet kryesore shqiptare, Tiranë dhe Durrës. Punimi është bazuar në të dhëna parësore dhe dytësore për rastin e sektorit financiar në Shqipëri.

Përfundimet e këtij kërkimi theksojnë se baza e të dhënave është e rëndësishme për marketingun e marrëdhënieve, si atë të ndërtuar offline dhe në atë të ndërtuar online.

**Fjalët kyçe:** *Baza e të dhënave, Marketingu i marrëdhënieve, Tregu offline dhe online.*

### **Hyrje**

Sot kompanitë përballen me një konkurrencë mjaft të fortë. Për të krijuar një konkurrencë sa më të mirë, duhet lëvizur nga filozofia e produktit dhe shitjes tek filozofia e marketingut. Pika kryesore e një orientimi të qartë marketing është një marrëdhënie e fortë me klientin. Marketerët duhet të lidhen me konsumatorët, t'i informojnë, t'i tërheqin dhe t'i përfshijnë vullshëm në këtë proces. Ata duhet t'i njohin konsumatorët e tyre dhe në mënyrë që ato ta bëjnë këtë, duhet të mbledhë informacione dhe t'i ruajë ato në bazën e të dhënave të saj. Një bazë e të dhënave konsumatore është një mbledhje e organizuar e informacioneve të nevojshme për një konsumator të përhershëm apo potencial. Këto informacione janë të vazhdueshme, të aksesueshme dhe të përdorshme për ato vendime marketing që të drejtojnë drejt drejtimit të tregut, kualifikimit, cilësisë, shitjes së produktit, shërbimit si dhe mirëmbajtjes së marrëdhënies me konsumatorin.

Firmat sapo kanë filluar të përdorin internetin për të përfutur informacionin e klientëve dhe proceset e tyre të marketingut të databaseve, për të përmirësuar menaxhimin e lidhjeve me klientin. Ky punim paraqet një plan ose sistem në lidhje me këtë. Në mënyrë esenciale, ajo paraqet se zbatimi i marketingut të database sjell zgjidhje për shumë vështirësi në menaxhimin e lidhjeve me klientin, duke mundësuar një interaktivitet një me një. Për

shembull, interneti ofron përfitime, si: saktësi, shpejtësi të madhe në mbledhjen e të dhënave të konsumatorëve, kursim shpenzimi në mbledhjen e të dhënave, influencë të madhe dhe lidhje me të mira me konsumatorët.

Rritja në marketingun e database-it dhe emergjenca e tregtisë nëpërmjet internetit, si pasojë e zhvillimit shumë të madh të internetit, bën të nevojshme që ata që merren me marketing, që të jenë konkurrues, të kapitalizojnë mbi avantazhet e mundësuar nga teknologjia e informacionit. Komponenti kyç i marketingut të database është aftësia e tij për të përmirësuar programin e marketingut të një organizate, duke identifikuar klientët të cilët tërhiqen më shumë nga një ofertë specifike. Në fakt, praktika kompetente e marketingut të database-it ka nevojë të jetë e integruar me praktika dhe strategji të tjera të marketingut. Ambienti interaktiv i web-it dhe hyrja e marketingut të internetit, paraqesin një oportunitet të faktuar dhe të qartë për firmat, në mënyrë që të depozitojnë përfitime maksimale në marketingun e marrëdhënieve. Megjithëse principet bazë të marketingut të database-it janë të njëjta, integrimi i internetit në procesin e marketingut të database-it lejon komunikim dhe bashkëveprim të personalizuar. Pra, web-i mundëson regjistrimin dhe përdorimin e informacioneve personale, si: emri, interesat, makina që disponon, programet televizive të ndjekura, e kështu me radhë. Informacioni cilësor i konsumatorëve u mundëson marketerëve të shënojnë në mënyrë të efektshme pritjet e tyre më me vlerë, t'i "presin" ofertat e tyre sipas nevojave individuale, të përmirësojnë kënaqjen e klientëve dhe të identifikojnë mundësitë për produkte dhe shërbime të reja.

### Metodologjia

Hulumtimi është përshkrues dhe shpjegues në lidhje me variablin dhe ndërton një tablo të gjerë të marketingut të marrëdhënieve dhe marketingut në internet. Të dhënat janë analizuar duke përdorur metoda të ndryshme statistikore, si: regresioni i shumëfishtë, analiza e regresionit me variabla dummy dhe regresioni logjistik, për të testuar variablin dhe hipotezat e ngritura. Studimi hulumton këta faktorë duke përdorur si shembull industrinë bankare shqiptare. Për të arritur objektivin e kërkimit, për të provuar ose hedhur poshtë pyetjen kryesore të kërkimit, kjo arrihet përmes testimit të hipotezave të ngritura.

- $H_1$ : Baza e të dhënave është e rëndësishme për marketingun e marrëdhënieve.
- $H_2$ : Baza e të dhënave është e rëndësishme për marketingun në internet.
- $H_3$ : Baza e të dhënave që arrihet nga marketingu në internet është e rëndësishme për marketingun e marrëdhënieve.

Punimi përbëhet nga dy pjesë, të cilat janë të harmonizuara së bashku. Pjesa e parë është e përbërë prej teorisë, për të cilën kemi përdorur literaturën përkatëse për të argumentuar bazën e të dhënave, fenomenin e marketingut të marrëdhënieve dhe rëndësinë e faktorit të kënaqësisë konsumatore në strategjinë marketing. Gjatë kësaj pjese kemi hulumtuar nëpër botime dhe studime të ndryshme. Të gjitha botimet e marra në konsideratë janë analizuar dhe janë marrë konkluzionet përkatëse për secilën, të cilat të ndërthurura së bashku, japin një fokus lehtësisht të kuptueshëm të rëndësisë së elementëve demografikë, në mbledhjen e të dhënave konsumatorët për të identifikuar rëndësinë e kënaqësisë konsumatore dhe zbatimin e marketingut të marrëdhënieve në tregun online / offline në Shqipëri.

Pjesa e dytë është ndërtuar duke u mbështetur në një anketim me një zgjedhje prej 316 të anketuarish, të cilët u janë përgjigjur 14 pyetjeve. Përzgjedhja e kampionit (mostrës) të studimit është bërë më parë, duke përzgjedhur një mostër me grupomoshë të ndryshme (e cila përkon edhe me hapat e zhvillimit teknologjik në Shqipëri) si dhe me nivel arsimor të ndryshëm, e cila përsëri shkon në përpjesëtim të drejtë me zhvillimin teknologjik dhe përdorimin e internetit, kompjuterit apo celularit. Gjithashtu, jemi munduar të kemi një harmonizim të kampionit midis të dy gjinive. Zgjedhja është bërë rastësore dhe e grupuar sipas moshës, gjinisë dhe arsimit. Pyetësorët janë plotësuar në dy qytete kryesore shqiptare, Tiranë dhe Durrës.

Metodologjia e studimit të përdorur për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve është një vlerësim i impaktit “rangu mesatar”. Ndryshe nga metodologjitë “akademike” më rigorozë, metodologjitë e rangut mesatar, janë të prirura të pranojnë në mënyrë të qartë një nivel më të zvogëluar të vlefshmërisë statistikore, në mënyrë që të akomodohen të dhënat e mbledhura në terren, kufizimet e burimeve dhe të kënaqen kërkesat e programit për eficiencën dhe dobishmërinë.

Me të dhënat e grupuara kemi ndërtuar një model ekonometrik dhe kemi realizuar testime statistikore, për të evidentuar se si kryqëzohen faktorët demografikë me faktorët që ndikojnë kënaqësinë konsumatore, në ndërtimin dhe zbatimin e marketingut të marrëdhënieve në Shqipëri dhe rëndësitë statistikore të tyre.

### **Rezultate dhe diskutime Literatura e përdorur**

Baza e të dhënave marketing është procesi i ndërtimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të bazës së të dhënave konsumatore dhe bazave të tjera të të dhënave (produktesh, shitësish, etj), për arsyen e kontraktimit, transaksioneve dhe ndërtimit të marrëdhënieve me konsumatorin. Kompanitë e fokusuar tek konsumatori janë të afta, jo vetëm të prodhojnë një produkt, por edhe të ndërtojnë një marrëdhënie me të. Ato janë të afta, jo vetëm në inxhinierinë e produktit, por edhe në atë të marketingut. Shpërndarjet demografike të konsumatorëve bëjnë që kompanitë të segmentojnë dhe t'iu shërbejnë atyre sipas demografisë së tyre, jo vetëm për segmentimin e tregut, por edhe për mënyrën e sjelljes dhe marrëdhënieve që krijohen me ta.

Për zbatimin e bazës së të dhënave për aplikimin e marketingut të marrëdhënieve, kërkohet një investim i madh për pjesë harduerësh, bazë softuerësh, programe analitike, lidhje komunikacioni dhe personel të aftë. Është e vështirë të mblidhen të dhënat e duhura, sidomos për të kapur të gjitha mundësitë e ndërveprimit të kompanisë me konsumatorët individualë. Krijimi i një baze të dhënash konsumatore nuk mund të jetë e dobishme në disa raste, si: 1 - kur një produkt është blerë vetëm një herë në jetë (p.sh. një piano e madhe), 2 - kur konsumatorët tregojnë vetëm pak besnikëri për markën, 3 - kur njësitë e shitjes është shumë e vogël, dhe 4 - kur kostoja e mbledhjes së informacionit është shumë e lartë. Problemi i dytë është vështirësia që çdo person i kompanisë të fokusohet tek konsumatori dhe të përdorë informacionin e nevojshëm. Punonjësit e kanë më të lehtë të përdorin marketingun tradicional të transaksioneve, sesa të praktikojnë marketingun e marrëdhënieve me konsumatorin. Marketingu efektiv i bazës së të dhënave kërkon drejtimin dhe trajnimin e punonjësve, si dhe të shitësve dhe furnitorëve. Problemi i tretë është se jo të gjithë konsumatorët duan të kenë një marrëdhënie me kompaninë dhe ata mund të ndjehen keq nëse dinë që kompania mund të ketë mbledhur shumë të dhëna personale për ta. Përsa i përket sigurisë, marketerët mund të jenë të shqetësuar për

zakonet e konsumatorëve. Shumë kompani ngatërrojnë listën e konsumatorëve me bazën e të dhënave të konsumatorëve. Një listë konsumatorësh të kompanisë është thjesht një listë me emra, adresa dhe numra telefoni. Një bazë të dhënash konsumatore përmban shumë më tepër informacione. Idealisht, një bazë e të dhënave duhet të përmbajë blerjet e mëparshme të konsumatorëve, vëllimet e mëparshme, çmimet dhe fitimet, emrat e pjesëtarëve blerës (moshat, ditëlindjet, hobet dhe ushqimet më të preferuara), statusin e kontratës së tanishme, një përcaktim të pjesës së shitësit në biznesin e konsumatorit, shitësit konkurrentë, përzgjedhja e fuqive dhe dobësive konkurruese për t'i shitur dhe shërbyer konsumatorëve dhe praktika të blerjes, modele e politika.

Një program marketingu që mbështetet në bazën e të dhënave është mënyra më efektive për të ndërtuar besnikërinë e klientëve, për të rritur frekuencën e blerjeve të klientëve, për të përmirësuar mbajtjen e klientëve dhe për të rritur shitjet. Ky program jep një avantazh konkurrues dhe u ofron klientëve një arsye të fortë për të zgjedhur një firmë kundrejt një tjetre.

Çdo kompani që tregton duhet të kapë informacione çdo herë që një konsumator vihet në kontakt me ndonjë nga departamentet. Pikat e takimit përfshijnë një blerje të konsumatorit, kur një konsumator kërkon një shërbim me telefon, ose e-mail. Bankat dhe kompanitë e kartave të kreditit, kompanitë telefonike, marketerët e katalogëve dhe shumë kompani të tjera, kanë informacion shumë të gjerë rreth konsumatorëve të tyre, që përfshijnë jo vetëm adresat dhe numrat e telefonit, por dhe të dhënat e tyre nga transaksionet, të dhëna mbi moshën, madhësinë e familjes, të ardhurat dhe të dhëna të tjera demografike. Këto të dhëna janë mbledhur nga qendra e kontaktit të kompanisë dhe organizuar në magazinën e të dhënave.

Pësoneli i kompanisë mund t'i marrë, t'i qartësojë dhe analizojë këto të dhëna. Mund të ketë ndërhyrje nga nevojat individuale të konsumatorit dhe përgjigjet që ai merr. Telemarketerët mund t'i përgjigjen paqartësive të konsumatorit bazuar në një pamje të qartë të marrëdhënies me këtë konsumator. Njëpërmjet përpunimit të të dhënave, statisticienët e marketingut mund të nxjerrin ekstrakte me informacione të dobishme rreth individëve, sjelljeve dhe segmenteve të të dhënave masive. Përpunimi i të dhënave përfshin përdorimin e teknikave të sofistikuar statistikore dhe matematikore, si: analiza përmbledhëse, dedaktimi i ndërveprimit automatik, modelet parashikuese dhe rrjeti neutral. Disa vëzhgues thonë se baza e të dhënave mund t'i japë një kompanie një avantazh të rëndësishëm konkurrues.

Interneti ofron një mundësi të vlefshme për të mbledhur informacion në lidhje me një konsumator. Njëpërmjet internetit, çdo kontakt i konsumatorëve mund të përdoret si një mundësi për të mbledhur të dhëna për konsumatorët, të cilat përfshihen në bazën e të dhënave të marketingut, për të zhvilluar profilet e përfunduar të konsumatorëve. Një informacion i tillë mund të krahasohet me bazat e të dhënave të brendshme apo të jashtme të organizatës, kështu, japin informacione të pasura të profileve të konsumit me një kosto minimale. Këto të dhëna të kombinuara mund të përdoren për ndërtimin e njohurive të konsumatorit, të cilat drejtojnë strategjinë e marketingut për të zhvilluar marrëdhëniet afatgjata praktike me klientët. Nëse këto marrëdhënie do të jenë të suksesshme, ato do të çojnë në marrjen e informacioneve më të hollësishme të konsumatorëve dhe/ose të shitjeve që japin më shumë të dhëna dhe prandaj do të fillojë rrethi nga e para. Dy

mënyrat interaktive në natyrën e mekanizmave të internetit, paraqesin një mundësi për firmat që të rrisin shpejtësinë dhe vëllimin e këtij rrethi të mbledhjes së të dhënave të konsumatorëve. Shkurtimeisht, teknologjia e internetit e ka bërë relativisht të lehtë mbledhjen në sasi të mëdha të informacionit individual të konsumatorëve dhe të të dhënave. Njohja e njësisë ekonomike, sinkronizimi dhe baza e të dhënave të integruara, u mundësojnë firmave shënjestrimin në mënyrë të përpiktë të përmbajtjeve demografike, që ata të mund të arrijnë tregjet si një klient të vetëm. Kjo rezulton në nivele të mëdha të kënaqjes së konsumatorëve. Megjithatë, bashkimi i bazave të të dhënave jashtë internetit dhe në internet, ngre çështje të tilla si: kompatibiliteti i teknologjisë, cilësia e të dhënave, variancat e formateve, se si të përdorim volumin e madh të të dhënave të grumbulluara dhe shqetësimeve të privatësisë së konsumatorit.

Për zbatimin e bazës së të dhënave për aplikimin e marketingut të marrëdhënieve kërkohet një investim i madh për pjesë harduerësh, bazë softuerësh, programe analitike, lidhje komunikacioni dhe personel të aftë. Është e vështirë të mblidhen të dhënat e duhura, sidomos për të kapur të gjitha mundësitë e ndërveprimit të kompanisë me konsumatorët individualë. Krijimi i një baze të dhënash konsumatore nuk mund të jetë e dobishme në disa raste: 1 - kur një produkt është blerë vetëm një herë në jetë (p.sh. një piano e madhe), 2 - kur konsumatorët tregojnë vetëm pak besnikëri për markën, 3 - kur njësia e shitjes është shumë e vogël, dhe 4 - kur kostoja e mbledhjes së informacionit është shumë e lartë. Problemi i dytë është vështirësia që çdo person i kompanisë të fokusohet tek konsumatori dhe të përdorë informacionin e nevojshëm. Punonjësit e kanë më të lehtë të përdorin marketingun tradicional të transaksioneve, sesa të praktikojnë marketingun e marrëdhënieve me konsumatorin. Marketingu efektiv i bazës së të dhënave kërkon drejtimin dhe trajnimin e punonjësve, si dhe të shitësve dhe furnitorëve.

Baza e të dhënave marketing është përdorur më shpesh nga marketerët e biznesit dhe ofruesit e shërbimeve (hotelet, bankat, agjencitë e udhëtimit dhe sigurimit, kartat e kreditit dhe kompanitë e telefonave), të cilët normalisht dhe në mënyrë të thjeshtë, mbledhin të dhëna për konsumatorët. Të tjera lloje kompanish që janë në pozicion të investojnë në marketingun e marrëdhënieve, janë kompani që bëjnë shumë shitje ndërvepruese dhe rritje shitjesh (p.sh., GE dhe Amazon) apo kompani, konsumatorët e të cilave kanë nevoja në rritje të diferencuara dhe kanë vlera të ndryshme të diferencuara për kompaninë. Kurse kompani të tjera mund të shohin pak përmirësim në implementimin e marketingut të marrëdhënieve. Deloitte Consulting ishte një nga këto kompani, ku arsyet ishin: sistem i projektuar jo mirë, çmime të larta, përdoruesit nuk e përdorën shumë ose nuk raportuan shumë përfitime dhe bashkëpunëtorët e injoruan sistemin, etj.

## Gjetjet

### Hipoteza e parë e ngritur:

$H_1$ : Baza e të dhënave është e rëndësishme për marketingun e marrëdhënieve.

Për të realizuar këtë testim kemi përdorur analizën e regresionit të shumëfishtë. Në rastin e kësaj hipoteze  $P_{\text{value } H_1} = (0.00) < (\alpha) 0.05$ . Kjo tregon se  $H_1$  mbështetet nga rezultatet e testimit, pra baza e të dhënave konsumatore është e rëndësishme në marketingun e marrëdhënieve. Nëpërmjet përpunimit të të dhënave, statisticienët e marketingut mund të nxjerrin ekstrakte me informacione të dobishme rreth individëve, sjelljeve dhe segmenteve të të dhënave masive. Përpunimi i të dhënave përfshin përdorimin e teknikave



të sofistikuara statistikore dhe matematikore, si: analiza përmbledhëse, dedaktimi i ndërveprimit automatik, modelet parashikuese dhe rrjeti neutral. Rezultati tregon se baza e të dhënave mund t'i japë një kompanie një avantazh të rëndësishëm konkurrues. Pra, nga tabela 1, shohim se variabli i bazës së të dhënave është i rëndësishëm dhe ndikon te marketingu i marrëdhënieve. Kjo sepse  $P_{\text{value}} = 0.00 < 0.05$ , që do të thotë se ndërthurja e tyre është brenda intervalit me besueshmëri 95%.

Por, nuk gjendet ky konkluzion nga përpunimi i të dhënave të pyetësorëve të mbledhur nëpërmjet intervistave dhe anketimeve te punonjësit e bankave të nivelit të dytë, në të cilën shohim se baza e të dhënave nuk është statistikisht e rëndësishme për marketingun e marrëdhënieve, pasi për këtë variabël, nga ky anketim rezultojnë se  $P_{\text{value}} = 0.461 > 0.05$ .

**Tabela 1 Koefficientët për hipotezën H1.**

Modeli	Koefficientët e pastandardizuar		Koefficientët e standardizuar	t	Sig.
	B	Gab. Stand.	Beta		
1 (Konstantja)	1.554	.250		6.226	.000
Database	.631	.066	.589	9.532	.000

Pra, hipoteza  $H_{1,2}$ , sipas anketimit të punonjësve, nuk mbështetet statistikisht. Ky rezultat vjen për faktin se zgjedhja e mostrës tek punonjësit e bankave dominohet nga punonjës financiarë dhe jo të shërbimit konsumator apo drejtues. Dalim në këtë përfundim duke u bazuar te analiza, ku rëndësia e bazës së të dhënave, edhe në rastin kur kemi intervistuar punonjës financiarë është e madhe dhe sidomos duke u mbështetur në teorinë e marketingut të marrëdhënieve, ku database është një nga elementët më të rëndësishëm të ndërtimit dhe zbatimit të marketingut të marrëdhënieve.

Ndërkohë, nga treguesi statistikor i  $R^2$  kuptojmë se variabli i bazës së të dhënave i vetëm, shpjegon 34.7% të marketingut të marrëdhënieve. Ndërsa, nga përpunimi i të dhënave të anketimit të punonjësve, shohim se  $R^2 = 1.1$ , që do të thotë se në bazë të anketimit të këtyre të fundit, database shpjegon 1.1% të marketingut të marrëdhënieve. Si konkluzion mund të themi se database vlerësohet nga konsumatorët si një instrument i rëndësishëm në aplikimin e marketingut të marrëdhënieve, duke shpjeguar gati 35% të tij. Ky rezultat bie në kundërshtim me anketimin e kryer te punonjësit, për arsyt e trajtuara më sipër, por edhe për faktin se kur database testohet i vetëm, nuk ka ndonjë domethënie të rëndësishme për marketingun e marrëdhënieve, sipas të dhënave të shqyrtuara të punonjësve.

### Hipoteza e dytë e trajtuar

$H_1$ : Baza e të dhënave është e rëndësishme për marketingun në internet.

Në tabelën e mëposhtme shohim vlerën  $P_{\text{value H2}}$  dhe e krahasojmë atë me koefficientin  $\alpha$  (0.05). Në rastin tonë, kur testojmë bazën e të dhënave të izoluar nga variablat e tjera,  $P_{\text{value H2}} = (0.00) < (\alpha) 0.05$ . Kjo tregon se  $H_1$  mbështetet nga rezultatet e testimit. Pra, baza e të dhënave është e rëndësishme në marketingun në internet. Rritja në marketingun e database-it dhe emergjenca e tregtisë nëpërmjet internetit, si pasojë e zhvillimit shumë të madh të internetit, bën të nevojshme që ata që merren me marketing, që të jenë konkurrues, të kapitalizojnë mbi avantazhet e mundësuar nga teknologjia e informacionit. Nëpërmjet

internetit, çdo kontakt i konsumatorëve mund të përdoret si një mundësi për të mbledhur të dhëna për konsumatorët, të cilat përfshihen në bazën e të dhënave të marketingut për të zhvilluar profilet e përfunduar të konsumatorëve.

Nga tabela 2 shohim se variabli database ndikon fuqishëm tek marketingu në internet, kjo sepse  $P_{\text{value}} = 0.00 < 0.05$ , që do të thotë se ndërveprimi i tyre është brenda intervalit me besueshmëri 95%. Edhe nga përpunimi i të dhënave të pyetësorëve të mbledhur nëpërmjet intervistave dhe anketimeve tek punonjësit e bankave të nivelit të dytë, marrim të njëjtat përfundime.

**Tabela 2 Koeficientët për hipotezën H2**

Modeli	Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientët e standardizuar	t	Sig.
	B	Gab. Stand.	Beta		
(Konstantja)	2.471	.271		9.104	.000
Database	.345	.079	.316	4.354	.000

Nga tabela e koeficientëve shohim se baza e të dhënave konsumatore është e rëndësishme për marketingun në internet, pasi për këtë variabël,  $P_{\text{value}} = 0.00 < 0.05$ .

### Hipoteza e tretë e ngritur

$H_1$ : Baza e të dhënave që arrihet nga marketingu në internet është e rëndësishme për marketingun e marrëdhënieve.

Nga analiza e regresionit të shumëfishtë, në tabelën e mëposhtme (tabela 3) shohim vlerën  $P_{\text{value H3}}$  dhe e krahasojmë atë me koeficientin  $\alpha$  (0.05). Në rastin tonë,  $P_{\text{value H3}} = (0.00) < (\alpha) 0.05$ . Kjo tregon se  $H_1$  mbështetet nga rezultatet e testimit. Pra, baza e të dhënave që krijohet nga marketingu në internet është e rëndësishme në marketingun e marrëdhënieve. Si një mjet për mbledhjen e të dhënave, interneti është i pakrahasueshëm, kur vjen rasti për të shërbyer informacionin mbi aktivitetin e konsumatorit. Çdo herë që një vizitor hyn në një faqe ëeb, ai lë një gjurmë informacioni që përfshin: si ka arritur në këtë site, si ka lundruar në këtë site, mbi çfarë artikulli ka klikuar, çfarë ka blerë dhe plot informacione të tjera. Duke njohur sjelljen dhe preferencat e konsumatorit, marketerit i jepen mundësi të jashtëzakonshme për t'i shërbyer nevojave të tij. Nëse kjo punë është bërë në mënyrë të drejtë, atëherë konsumatori do t'i përgjigjet kompanisë me një besnikëri të përhershme. Nga tabela shohim se variabli i database ndikon fuqishëm tek marketingu në internet, kjo sepse  $P_{\text{value}} = 0.00 < 0.05$ , që do të thotë se ndërveprimi i tyre është brenda intervalit me besueshmëri 95%.

**Tabela 3 Koeficientët për hipotezën H3.**

Modeli	Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientët e standardizuar	t	Sig.
	B	Gab. Stand.	Beta		
(Konstantja)	2.471	.271		9.104	.000
datasainternet	.345	.079	.316	4.354	.000

Nga tabela e koeficientëve shohim se baza e të dhënave që krijohet nga marketingu në

internet është i rëndësishme në marketingun e marrëdhënieve, kjo në bazë të teorive të marketingut në internet dhe të perceptimit konsumator, të dhënë nëpërmjet anketimit të zhvilluar. Edhe nga përpunimi i të dhënave të pyetësorëve të mbledhur nëpërmjet intervistave dhe anketimeve të punonjësit të bankave të nivelit të dytë, shohim se variabli i database nëpërmjet internetit është i rëndësishëm për marketingun e marrëdhënieve.

### **Konkluzione dhe Rekomandime**

Baza e të dhënave konsumatore është e rëndësishme në marketingun e marrëdhënieve. Nëpërmjet përpunimit të të dhënave, statisticienët e marketingut mund të nxjerrin ekstrakte me informacione të dobishme rreth individëve, sjelljeve dhe segmenteve të të dhënave masive. Përpunimi i të dhënave përfshin përdorimin e teknikave të sofistikuara statistikore dhe matematikore, si: analiza përmbledhëse, dedaktimi i ndërveprimit automatik, modelet parashikuese dhe rrjeti neutral. Rezultati tregon se baza e të dhënave mund t'i japë një kompanie një avantazh të rëndësishëm konkurrues.

Pra, baza e të dhënave është e rëndësishme në marketingun në internet. Rritja në marketingun e database-it dhe emergjenca e tregtisë nëpërmjet internetit, si pasojë e zhvillimit shumë të madh të internetit, bën të nevojshme që ata që merren me marketing, që të jenë konkurrues, të kapitalizojnë mbi avantazhet e mundësuar nga teknologjia e informacionit. Nëpërmjet internetit, çdo kontakt i konsumatorëve mund të përdoret si një mundësi për të mbledhur të dhëna për konsumatorët, të cilat përfshihen në bazën e të dhënave të marketingut për të zhvilluar profilet e përfunduar të konsumatorëve.

Baza e të dhënave që krijohet nga marketingu në internet është e rëndësishme në marketingun e marrëdhënieve. Si një mjet për mbledhjen e të dhënave, interneti është i pakrahasueshëm, kur vjen rasti për të shërbyer informacionin mbi aktivitetin e konsumatorit. Çdo herë që një vizitor hyn në një faqe ëeb, ai lë një gjurmë informacioni që përfshin: si ka arritur në këtë site, si ka lundruar në këtë site, mbi çfarë artikulli ka klikuar, çfarë ka blerë dhe plot informacione të tjera. Duke njohur sjelljen dhe preferencat e konsumatorit, marketerit i jepen mundësi të jashtëzakonshme për t'i shërbyer nevojave të tij. Nëse kjo punë është bërë në mënyrë të drejtë, atëherë konsumatori do t'i përgjigjet kompanisë me një besnikëri të përhershme.

### **Referenca**

- Balakrishnan, A., Kumura, T. and Sundaresan, S. (1999), "Manufacturing in the Digital Age: Exploiting Information Technologies for Product Realization", Information Systems frontiers.
- Barkham, P. (2000), "New Media: Why Tunbridge Wells matters. Net talk is all about building global communities..." The Guardian, February 14th.
- Brown, S. (1995), Postmodern Marketing, London, Routledge.
- David, P.A. (1991), "Computer and dynamo: the modern productivity paradox in a not-to-distant mirror" in Technology and Productivity – The Challenge for Economic Policy, OECD, Paris.
- Dutta, S. and Segev, A. (1999), "Business Transformation on the Internet", European Management Journal, pp. 466-476.
- Economides, N. (1996), "The Economics of Networks", International Journal of Industrial Organisation, pp. 673-699.
- Franke, R.H. (1987), "Technological Revolution and Productivity Decline: The Case of US Banks" Technological Forecasting and Social Change, Vol 31.

- Fraser (1880), quoted in “Special Report on the New Economy”, (2000) [www.economist.com](http://www.economist.com)
- Fullerton, R.A., (1988), “Modern Western Marketing as a Historical Phenomenon: Theory and Illustration”, in Newett, T. and Fullerton, R.A. (eds), *Historical Perspectives in Marketing*, Lexington Books, pp. 73 - 89.
- Gilfillan, S.C. (1935), *The Sociology of Invention*, London, Follett.
- Gulati, R., N. Nohria, N. and Zaheer, A. (2000), “Strategic Networks”, *Strategic Management Journal*, pp. 203-215.
- Hagel, J. III and Armstrong, A.G. (1997), *Net Gain: Expanding Markets through Virtual Communities*, Boston, Harvard Business School Press.
- Hoffman, D.L. and Novak, T.P. (1997) A new marketing paradigm for electronic commerce.
- Hamel, G. (2000), *Leading the Revolution*, Boston, Harvard Business School Press.
- Hamel, G., Doz, Y. and Prahalad, C.K. (1989), “Collaborate with your Competitors – and Win”, *Harvard Business Review* 67(1) pp. 133 - 9.
- Hanson, W. (2000), *Principles of Internet Marketing*, New York, Thomson Learning.
- Hoffman, D. and Novak, T. (1997), “A new Paradigm for Electronic Commerce”, *The Information Society, Special Edition on Electronic Commerce*, 13, January – March, pp. 45-59.
- Kalakota, R. and Robinson, M. (1999), *e-Business: Roadmap for Success*, New York, Addison Wesley.
- Keith, R. J., (1960), “The Marketing Revolution”, *Journal of Marketing*, 24 (January), pp. 35-38.
- Luengo-Jones, S. (2001), *All to One: The Winning Model for Marketing in the Post Internet Economy*, London, McGraw Hill.
- Myftaraj E.: (2014) “Sinergjia që krijohet nga ndërveprimi i marketingut të marrëdhënies me marketingun në internet. Rasti i industrisë bankare shqiptare”. Tezë Disertation. “Aleksander Moisiu” University, Durres, Albania.
- Newell, F. (2000), *Loyalty.Com: Customer Relationship Management in the New Era of Internet Marketing*, McGraw-Hill, New York.
- Parker, R. (2000), *Relationship Marketing on the Internet*, Holbrook, MA, Adams Media Corporation.

## Ndikimet mjedisore në ndërtimin e aksit Tiranë-Elbasan

Phd. Mirela (Alushi) Islami

### Abstrakt

Tema në fjalë do të prek një problematikë e cila do të lidhet në të ardhmen me ndërtimin e aksit Tiranë-Elbasan. Ndikimet që do të sjellin punimet e rrugës duke iu referuar projektit, ecurisë së punimeve dhe faktorëve natyrorë dhe humane. Duke lokalizuar vendndodhjen por dhe kushtet e shtrirjes së aksit do të pasqyrohen disa pasoja mjedisore të cilat do të kenë ndikime mjedisore por dhe humane, dhe ekonomike.

Ndër problematikat që ndjekin gjeografët janë dhe ato që lidhen me ndikimet e ndryshimeve të mjedisit si pasojë e ndërtimeve dhe ndërhyrjeve në të. Për ndërtimin e aksit rrugor Tiranë-Elbasan është një rast i cili lidhet pikërisht me ndikimet mbi mjedis dhe peizazh si një element i ndryshimeve të bëra për ndërtimin e saj.

**Fjalët kyç:** *Mjedis, risk natyror, G.I.S, aks rrugor, aksi Tiranë-Elbasan.*

### Hyrje

Aksi po ndërtohet mbi një territor pothuajse fushor sepse do të kalojë mbi luginat e lumejve dhe përrejtje që janë: lumi Erzen dhe përroi i Kushës. Traseja e re do të kalojë në këtë peizazh të ri dhe do të jetë pjesë e ndryshimeve mjedisore si pasojë dhe e faktorëve natyrorë dhe humanë. Një pjesë e faktorëve natyrorë ka të bëjë dhe me risqet natyrore si: rrëshqitjet, erozioni, ndryshimi i ekuilibrave të botës bimore dhe shtazore, ndryshim i shtretërve të lumejve dhe pellgjeve ujëmbledhës së tyre etj.

Ndërtimi i aksit ka të bëjë dhe me nevojat kombëtare dhe lokale të ndërlidhjes midis dy rrethëve Tiranës dhe Elbasanit por kanë dhe një rëndësi të madhe për akset rrugore. Ato do të lehtësojnë lëvizjet midis perëndimit dhe lindjes, por edhe një ndihmë tjetër që do të ndihmojë ndërlidhjen mes kryeqendrës dhe pjesës juglindore të vëndit. Ndërtime të tilla që kanë rëndësi të madhe për lidhjen midis dy rrethëve ka një rëndësi të vecantë por duhet të bëhet një studim i thelluar gjeologjik i cili do të parashikojë dhe veprimtaritë pas vepruesë të ndërtimit të tyre. Logaritët një ndikimi mbi mjedis dhe sidomos ndryshimi i tij i cili do të shkaktojë jo vetëm dëmtime të dukshme dhe serioze të mjedisit por do të kërkojë dhe ndërhyrje të reja. Risqet natyrore do të jenë një problematikë e cila do të kërkojë dhe mendimin e një specialist apo një studimi të mirëfilltë për ndikimet mjedisore. Metodatat do të jenë: punimi i hartave me G.I.S, studimi gjeomorfologjik, dhe paraqitja fotografike e territorit.

### Pozicioni gjeografik dhe shtirja e aksit

Rruga në fjalë është një ndërtim që ka filluar në vitin 2008 dhe vazhdon të ndërtohet. Qeveria shqiptare e ka ndërmarrë ndërtimin e saj duke u bazuar tek ligji për transportet dhe kodi rrugor. Rruga e vjetër kalonte midis antiklinalit të kodrave të Kërrabës dhe distanca ishte 54 km, ajo përshkohej për një kohëzgjatje prej një orë e pesëmbëdhjetë minutash.

Rruga e re do të kalojë kalojë do të kalojë në një territor pothuajse fushor dhe do të përshkruajë një distancë prej 31.17 km për një kohë rreth 50 minutash. Ai do të shtrihet pjesërisht në trasenë e vjetër të aksit por një pjesë e konsiderueshme do të jetë në shtretërit e lumit Erzen dhe përroit të Kushës. Arsyet e ndërtimit të aksit të ri ishin

disa. Më të rëndësishmet janë pjesë e akteve kombëtare dhe lokale, lidhje midis dy rretheve, nevoja ekonomike, arsimore, punësimi dhe turistike. Aksi i vjetër kalonte në disa komuna pjesë e dy qarqeve, ndërsa aksi i ri do të kalojë në të njëjtat komuna, por do të anashkalojë disa. Aksi kalon në komunat: Lundër, Petrelë, Mullet, Bradashesh.



### 1. Harta ku kalon aksi Tiranë-Elbasan

Aksi Tiranë-Elbasan është pjesë e një ndërtimi si ndërmarrje e aksit të madh Perëndim-Lindje. Aksi ka dy pjesë, ku pjesa e parë është aksi Durrës-Tiranë dhe pjesa e dytë është aksi Tiranë-Elbasan. Aksi Tiranë-Elbasan është aksi i cili lidh dy nga qarqet më të mëdha të vendit tonë, dhe përkatësisht dy rrethet më të mëdha të tyre.

Tirana shtrihet në qendër të vendit dhe është rrethi më i madh i qarkut me të njëjtin emër. Në kongresin e Lushnjës ai u shpall kryeqytet më 21 shkurt 1920 (Akademia e shkencave, 104). Ndodhet rreth 35 km larg qytetit të Durrësit dhe 40 km larg Elbasanit. Tirana sot si qytet ka një sipërfaqe prej 31 km<sup>2</sup>, përshkohet nga lumi Lana dhe rrethohet nga kodrat e Saukut, Kasharit, Vorës, Prezë (Frashëri, 2012, 129), lartësi të vogël, e rrethojnë nga juglindja, jugu dhe perëndimi. Tirana, jozyrtarisht numëron më shumë se 1.000.000 banorë, kurse të dhënat numërojnë rreth 800.000 banorë. (Instat, 2013-2014). Qyteti shtrihet midis koordinatave gjeografike 41.33° në veri dhe 19.2° në lindje.

Elbasani, është një qytet që shtrihet në (JG) të rrethit të Tiranës Elbasani lidhet me atë, me gjeoparkun e Krrabës, dhe ndahet nëpërmjet komunës Gracen. Përgjatë luginës së mesme të lumit Shkumbin. Qyteti shtrihet në krahun e djathtë të luginës së Shkumbinit, pranë zgjerimit të fushës së Paprit dhe rrëzë gjeoparkut të Krrabës në një lartësi mesatare 125m mbi nivelin e detit dhe ka një sipërfaqe prej 1.481 km<sup>2</sup>. Ka një popullsi mbi 128.000 banorë. Qyteti është i vendosur në gjerësisë gjeografike (V) 41° e 10' dhe Jugore 40° e 10', si dhe gjatësisë (L) 20° e 34' dhe (P) 19° e 03'.

Elementët e përgjithshëm fiziko-gjeografik

Zona në fjalë ka një peizazh të vecantë gjeografik dhe gjeomorfologjik. Në këtë territor dominojnë shkëmbinj gëlqerorë të periudhës së miocenit, argjilat, zona e dushkut në lartësitë 500-600m lartësi, tokat e kafejta malore dhe kullotat të lartësive 600-1200

m(Paheshti, 2007, 39).

Karakteristike për rajonin është karakteri i theksuar hipsometrik i llojit kodrinoro-malor. Territoret e kodrave të Krrabës dhe rajonet përreth dallohen për një zonim të lartë me copëtim horizontal të madh (3-5km\km<sup>2</sup>). Ato përfshijnë rajone shumë të pjerrta, të përbëra nga terrigenë e sidomos nga flishi i zonës së Krastës dhe Jonike. (Paheshti, 2007, 41).

Hidrografia: përbëhet nga dy elemente bazë si lumi Erzen dhe përroi i Kushës, si dhe nga disa degë të tjera ujëmbledhëse ( përroi i Zaranikës) këto të fundit derdhen në lumin Shkumbin.

Lumi Erzen (me gjatësi 108 km) është lugina e dytë më e rëndësishme, pas përroit të Kushës, sipas rëndësisë së trasesë së rrugës. Ka një lartësi mesatare nga 357- 435m mbi nivelin e detit dhe mbledh ujë nga përrejtë kodrinor të rajonit. Prurjen mesatare vjetore e ka 18m<sup>3</sup>/sek.dhe prurja është 101kg/sek. (Qiriazi, 2001, 103) etj.

Përroi i Kushës ka një gjatësi rreth 20 km, buron në malësinë e Krrabës në lartësinë 780-1000m dhe mbushet me ujë gjatë dimrit nga shirat, gjatë verës, thahet.Veprimtaritë përpunuese të shtratit kanë care e copëtuar nënndësinë dhe ka formuar luginën (Paheshti, 2007, 25). Pjesë e pellgut ujëmbledhës të lumit Shkumbin.

Klima: Zona përfshihet në zonën e klimës së zonës mesdhetare paramalore, sepse përfshihet në luginën e sipërme të lumit Shkumbin.Tipike është klima e nënzonës mesdhetare paramalore veriore, dhe është nën ndikimin e e erërave lindore.Temperaturat mesatare vjetore është 9-11°C.Reshjet e dëborës zgjasin deri në 40 ditë me shtrashësi maksimale deri në 2m. (Qiriazi, 2001, 88).

Bota bimore dhe shtazore: Peizazhi përreth është i veshur me bimësi endogjene. Atje ku mbizotërojnë gëlqerorët ka edhe zona të zhveshura. Bimësi endogjene dhe e kultivuar, mund të vecohet gjineshtra, mareshka, dushku, pishat, kullotat malore si dhe bimësi e kultivuar që fillon me ullinjt, fiq, rrush, qersh, ftonj, hurma dhe shegë etj. Në lartësitë mbi 800m ka pyje dushku dhe ahu, dhe kullota malore (Paheshti, 2007, 27). *Bota shtazore*: e cila është e pasur me kafshë të zonave mesatare, me shpendë dhe zvarranikë, një kafshë e cila takohet më shpesh në gjëndje të egër është derri i egër.

Ndikimet mjedisore të aksit

Ndërtimi i aksit të ri rrugor, sikurse është përmendur dhe më lart po bëhet plotësisht në një territor të ri. Po ndiqet trajektorja fushore e shtretërve të lumejve duke i dhënë një karakter fushor.Ky ndërtim kërkon që për arsye të punimeve të ketë dhe hapje të trasheve, ndërtime të urave, ndërtimet e mbi dhe nënkalimeve, dhe ndikime tek shtretërit e hapësirave ujore, tek bota bimore, toka e kultivuar dhe tek risqet natyrore.

Ndikimet mjedisore do të kenë ndikime dhe tek peizazhi por dhe tek popullsia e cila do të ketë ndikime ekonomike, natyrore dhe mjedisore të cilat do të duan ndërhyrje të reja. Veprimtaritë prapavepruese të ndërtimit do të kenë një karakter të theksuar nëse do të kishim të qartë situatën nëpërmjet studimit gjeologjik dhe lidhjes me studimet litologjike, klimaterike, hidrografike, mjedisore dhe humane.


Nëse do të merrnim në shqyrtim të drejtëpërdrejtë disa faktorë do të shihnim dhe ndikimet e tyre në mjedis. Faktorët e mbledhur sëbashku do të pasqyronin më mirë se cilat do të jenë pasojat në mjedis.

Territori përbëhet në pjesën më të madhe nga molasat të cilat në disa vënde janë bashkë me gëlqerorët dhe argjilat.Kjo përbërje litologjike është në vetvete e paqëndrueshme dhe në disa seksione të vecanta të rrugës ka shkaktuar rrëshqitje të mëdha (fakt: në janar të 2015 në afërsi të fshatit Ibë ndodhi një rrëshqitje masive e cila bllokoi lëvizjen e njerëzve dhe mallrave për disa ditë). Masat e argjilave duke patur dhe faktorë të tjerë si mbingopja me reshjet e shiut, me pakësimin e bimësisë ka prirje për të shkaktuar në sektor të vecantë

dukuri të tilla.

Erozioni i shtretërve të lumejve do të sjell dhe ai ndryshime të rëndësishme të mjedisit. Veprimtaria gërryese e lumit Erzen dhe e përroit të Kushës sëbashku me degët e tyre do të kenë një aktivitet më të madh. Kjo veprimtaria do të vij si pasojë e ndryshimit të ekuilibrave të shtratis të lumejve si pasojë e punimeve për ndërtimin e urave dhe kalimeve të tjera. Një faktor tjetër i cili kishte filluar më parë është dhe veprimtaria humane pranë brigjeve të tyre për të marrë materiale ndërtimi. Ndërtimet që do të zhvillohen dhe për efekte të vetë rrugës, të cilat mund të jenë dhe për arsye shërbimi, turizmi, pikash furnizimi me karburant, rezorte etj.

Faktor tjetër i cili do të veprojë është dhe faktori klimë i cili me elementin reshje (shiu por dhe dëbore), dhe sidomos regjimin e tyre do të fuqizojë veprimtarinë përpunuese të shtretërve të lumejve dhe do të fuqizojë veprimtarinë erozive.



## 2. Pamje të rrugës Tiranë-Elbasan.

Të dy faktorët, litologjik dhe klimatik do të sjellin dhe një risk tjetër natyror i cili është rrëshqitja e cila si pasojë e punimeve do të aktivizohet dhe do të jetë e pranishme në sektor të vecantë. Do të ishte më e volitshme që edhe masat e dherave të larguar nga trasetë e punës të ishin llogaritur në përshtatje me elementet e relievit, klimës dhe hidrografisë.

Në segmente të vecanta të rrugës dalin në pasqyrim të drejtëpërdrejtë masat e argjilave të cilat janë të ekspozuara si pasojë e skarpateve të rrugës dhe që janë aktivizuar ndaj faktorëve të jashtëm dhe sidomos reshjeve të shiut. Më e mira ndoshta do të ishte që skarpatet e trasesë së re në disa sektor të mos ishin prekur dhe të mos dëmtohej dhe bimësia e cila popullon atë territor. Në pjesën më të madhe do të jetë e nevojshme që pothuajse përnjëherë me punimet të bëhet dhe një rimbjedhje e zonave ku ka ndërhyrje, me bimësi të re e cila do të zëvendësojë atë të mëparshmen. Duhet të bëhet një përzgjedhje e kujdeshme për llojin e bimësisë e cila do të ruajë dhe raportet me zonat pyjeve përreth. Prerja e zonave pyjore është një problematik tjetër e cila lidhet me dy faktorë të tjerë: lartësia mesatare mbi nivelin e detit dhe lloji i bimësisë pyjore që popullon zonën, në fjalë.

Bimësia e zonës dominon me llojin e shkurreve dhe më pak me bimësinë e pyjeve, është një faktor i rëndësishëm sepse mban me anë të sistemit rrënjor të fuqishëm masat e argjilës të mbështetura fort pas masive të kodrave. Prishja e ekuilibrave nga popullsia vëndase fillimisht e cila e përdor për nevojat e saj dhe zbatuesit e projektit të rrugës e lënë këtë problem të zbuluar. Kjo të sjell shumë shpejt territore toke të cilat do të jenë të pa shfrytëzueshme për arsye të elementeve fizik dhe kimik të tyre. Veprimtarinë bujqësore apo dhe të aktiviteteve të tjera do të ndikohen nga kjo veprimtaria që po zhvillohet nga projekti i rrugës.

Faktori litologjik do të shërbente si një drejtues i cili do të tregonte raportet jo vetëm litologjike por dhe raportet e përdorimit të tokës bujqësore, e cila nuk është në një sipërfaqe të konsiderueshme duke u nisur dhe nga pozita gjeografike e zonës. Një studim rreth përdorimit dhe shfrytëzimit të saj do të sillte dhe minimizimin e risqeve natyrore



të mjedisit përreth. Toka bujqësore do të ketë dhe një kufizim të kulturave bujqësore të cilat kultivohen në zonë. Kulturat bujqësore do të mundohen ti përshtaten sidomos pranë trasesë së rrugës, dhe faktorëve të cilat sipas agronomëve do tu përshtaten, hapësirave të reja.

Nga studimi fillestar (profesor Faruk Kabës) është bërë një përlllogaritje e vëndit që zë toka e punueshme në aksin e rrugës por nuk është llogaritur ndikimi prapaveprues që do të sjell ajo. Tek toka e cila përdoret për bujqësinë do të vërehen dhe ndikime të tilla si: erosion i sipërfaqshëm i tyre, shpëlarje, tjetërsime fizike dhe mekanike etj. Do të duhet një sistem drenazhimi (hidrografik) i cili të shërbej si një sistem i cili do të parandaloj dukuritë e mësipërme.

Bimësia e territorit kryesisht përbëhet nga shkurre të cilat mbizotërojnë dhe janë një element i cili shfrytëzon të përthithë një pjesë të konsiderushme të ujrave të cilat vijnë nga reshjet e shiut dhe të dëborës. Bimësia e zonës ka pësuar një dëmtim jo vetëm si pasoj e punimeve të ndërtimit të rrugës por edhe si pasoj e shfrytëzimit nga popullsia vëndase. Banorët e përdorin bimësinë dhe për aktivitete të tjera si: bazë për lëndët djegëse, ushqim për bagëtinë që mbajnë, kullotje etj

Ndikimi i botës bimore do të ketë një ndikim dhe tek një faktor tjetër, bota shtazore e cila jeton në mënyrë të lirë në zonën përreth. Prishja e ekuilibrave ushqyes të faunës së zonës do të bëjë që një pjesë e saj e cila jeton në gjëndje të egër të prish ekuilibrat e saj. Jo vetëm fauna e egër por dhe ajo e cila është nën kujdesin e popullsisë vëndase do të përballlet me një problematik të tillë.

Një faktor i fundit, i cili do të ndikoj në mjedis do të jetë dhe cilësia e ajrit. Ndërtimi i aksit do të sjell një fluks më të madh të veprimtarive transportuese të cilat do të jenë prioritet i lehtësimit të aksit Elbasan-Durrës-Tiranë. Transporti më i madh do të bëjë që dhe klima të ndryshoj, duke sjellë një mikroklimë të re.

### **Konkluzion**

Dherat, ujërat dhe ajri janë komponentët më të rëndësishëm, për peizazhin dhe mjedisin. Është një ndikim komponentësh bazë të botës bimore, shtazore dhe për aktivitetet humane duke përfshirë dhe aktivitetet bujqësore. Është e rëndësishme të ruhen ekuilibrat e mbrojtjes së territorit si pasoj e zhvillimit të ndërtimit të rrugës Tiranë-Elbasan.

### **Bibliografia**

- Akademia e Shkencave. (2002). Historia e popullit shqiptar, vëll. i II, Tiranë.  
Frashëri, A. (2012). Gjeomonumentet, që tregojnë historinë e tokës shqipëtare, Guidë, Tiranë.  
Të dhënat e Instat, 2013-2014.  
Qiriazi, P. (2001). Gjeografia e përgjithshme Fizike, Tiranë.  
Paheshti, B. (2007). Gjeografia e Elbasanit, Elbasan.  
Profesor Faruk Kaba 2007-2008, Studimi inxhinerik i rrugës Durrës-Tiranë-Elbasan.

## Një këndvështrim mbi Përgjegjësisë Sociale të Korporatave në mjedisin Shqiptar

**Veronika Kallanxhi**

*PhD. Candidate Pedagogue at Tirana University Faculty of Economic  
Department of Management Saranda Branch*

### Abstract

Përgjegjësia Sociale e Korporatave ka të bëjë me veprime që një organizatë ndërmerr për të përmbushur qëllimet ekonomike të saj dhe për të sjellë përfitime për shoqërinë. Përgjegjësia sociale ka të bëjë me mënyrën se si një kompani menaxhon procesin e saj ekonomik dhe prodhon një impakt pozitiv në shoqëri. Të jesh një korporatë e përgjegjshme, do të thotë, të ndërmarrësh dhe të kryesh veprimet e biznesit në një mënyre etike, duke pasur parasysh interesat e komuniteti ku operon dhe më gjerë. Shumë nga bizneset i përmbahen vetëm legjislacionit, duke mos konsideruar mundësinë e ndërmarrjes së veprimeve të tilla jashtë asaj çfarë ju kërkohet me ligj.

**Keywords:** *Përgjegjësia Sociale e Korporatave, Përgjegjshmëria.*

### Rishikimi i literaturës Trajtimi i CSR-së ndër vite

Përgjegjësia Sociale e Korporatave (PSK), është një praktikë menaxheriale, përgjegjëse në menaxhimin e organizatës. Ndikimi i kësaj filozofie menaxheriale vërehet në impaktin që kanë vendimet e kompanisë mbi ambientin, shoqërinë dhe zhvillimin e vetë organizatës (Eccles, Ioannou, & Serafeim, 2011). Përgjegjësia sociale në kompani ka të bëjë me një detyrim, përtej kërkesave të ligjit. Është një angazhim që ndërmarrin kompanitë për tu sjellë në mënyrë etike, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe njëkohësisht duke përmirësuar cilësinë e jetës të punonjësve, të familjeve të tyre si dhe të komunitetit ku ata operojnë (Ioannou & Serafeim, August, 2010). Përgjegjësia sociale ka të bëjë me mënyrën se si një kompani menaxhon procesin e saj ekonomik dhe prodhon një impakt pozitiv në shoqëri. Interesat e aksionerëve duhet të balancohen gjithnjë me interesat e stakeholder-ave të tjerë (Eccles & Serafeim). Nëse korporata do të krahasohej me një individ, përgjegjësia sociale e bën atë një qytetar të mirë. Ideja e një korporate me përgjegjësi sociale (CSR), lindi në fund të viteve 1960 dhe në fillim të viteve 1970. Në këtë periudhë kompanitë dhe qeveritë gjithashtu filluan të shikojnë përtej performances financiare të korporatave. Këto vendime erdhën dhe si pasojë e një numri katastrofash si ajo e 1984, ku u shkaktua një rrjedhje gazi në Indi nga Union Carbide, dhe në 1990 Exxon Valdez ishte përgjegjëse për derdhjen e vajit në Alaske (Maguire to Vogel). CSR lidhet me idenë kryesore që bizneset duhet të plotësojnë pritshmëritë e shoqërisë. Përgjegjësia sociale në korporata ka ndryshuar në vite. Ajo nuk ka pasur këtë status që ka sot. Koncepti i CSR ka ekzistuar që në vitet 1800, po realisht ajo ka filluar të shkruhet në literaturë pas viteve 1950. Fokusi i saj ka evoluar nga një periudhë në tjetrën, prandaj dhe përkufizimi i saj ka ndryshuar. Megjithatë CSR deri në ditët e sotme ka kaluar në katër periudha sipas Patrick Murphy (University of Michigan Business Review, 1978) kemi katër periudha. Periudha e parë në dhe pas viteve 1950. Në një skemë të thjeshtuar, Murphy argumentoi se periudha deri në 1950 ishte epokë 'filantropike' në të cilat kompanitë dhuronin bamirësi më shumë se çdo

gjë tjetër. Periudha 1953-1967 ishte klasifikuar si epoka e 'vetëdijes' në të cilin u bë njohja e përgjegjësishë së përgjithshme të biznesit dhe përfshirjen e saj në punët e komunitetit. Periudha 1968-1973 ishte quajtur si epoka e 'çështjes' në të cilën kompanitë filluan duke u përqëndruar në çështje të veçanta të tilla si shkatërrimi urban, diskriminimi racial dhe problemet e ndotjes. Së fundi, në epokën e 'përgjegjshmërisë' (1974-1980) dhe duke vazhduar më tej, kompanitë filluan duke marrë seriozisht menaxhimin dhe veprimet organizative për të trajtuar çështjet e CSR. Deri në ditët e sotme nuk ka një përkufizim të përcaktuar të qartë të CSR. Përkufizimi i saj ka evoluar gjatë viteve nga vitet 50 e deri në ditët e sotme. Që në fillimet e saj u pa se përgjegjësia sociale nuk është zgjidhja për të gjitha problemet sociale të biznesit, por është ajo që përmban një të vërtetë të rëndësishme që duhet të udhëheq biznesin në të ardhmen. Ai përkufizoi se: CSR i referohet detyrimeve të biznesmenëve për të ndjekur ato politika, për të marrë ato vendime, apo të ndjekë atë linjë veprimesh të cilat janë të dëshirueshme në aspektin e objektivave dhe vlerave të shoqërisë sonë (Howard R. Bowen, Social Responsibilities of the Businessman, 1953). Një nga shkrimtarët e parë të viteve 1960, dhe më të shquar, në këtë periudhë për të përcaktuar CSR ishte Keith Davis. Davis argumentoi se përgjegjësia shoqërore ishte një ide e mjegullt, por duhet të shihet në një kontekst menaxheriale. Më tej, ai pohoi se disa vendime mbi përgjegjësi sociale të biznesit mund të justifikohet në një proces të gjatë dhe të ndërlikuar, si të paturit e një shansi të mirë që sjellë fitim ekonomik afatgjatë për firmën. Ai e cilësoi CSR si: Vendimet e biznesmenëve dhe veprimet e marra pjesërisht përtej interesave të drejtpërdrejta ekonomike ose teknike të firmës (Keith Davis, 1960). Një tjetër kontribues në përkufizimin e përgjegjësishë sociale ishte William C. Frederick. Ai thoshte që përgjegjësia sociale në fund të fundit nënkupton një qëndrim publik ndaj burimeve ekonomike dhe njerëzore të shoqërisë dhe gadishmëria për të parë se këto burime janë përdorur për qëllime të gjera sociale dhe jo thjesht për interesa të ngushta të personave privatë të firmës (William C. Frederick, 1960). Clarence C. Walton, një mendimtar i rëndësishëm për biznesin dhe shoqërinë, në një libër me titull Përgjegjësitë e Sociale të Korporatave (1967) përkufizimi i tij ishte: Përgjegjësia sociale njeh intimitetin e marrëdhënieve midis korporatës dhe shoqërisë dhe kupton se marrëdhëniet e tilla duhet të mbahen në mendje nga drejtuesit më të lartë të korporatës dhe grupet e lidhura që ndjekin qëllimet e tyre përkatëse (Clarence C. Walton, Corporate Social Responsibilities 1967). Walton vazhdon të theksojë se përbërësit themelore të përgjegjësishë sociale të korporatës përfshijnë një shkallë të vullnetarizmit, një lidhje të tërthortë të organizmave të caktuara të tjera vullnetare në korporatë, dhe pranimi se shpenzimet që janë të përfshirë nuk mund të vlerësohen si kthim të drejtpërdrejtë i matshëm ekonomike. Harold Johnson është një tjetër mendimtar që ka dhënë kontributin e tij në studimin e CSR. Sipas tij një firmë me përgjegjësi sociale është një udhëheqëse e cilia balancon një shumëllojshmëri të interesave. Në vend që të përpiqet vetëm për fitimet e mëdha të aksionerëve të saj, një ndërmarrje përgjegjëse gjithashtu merr në konsideratë punonjësit, furnitorët, tregtarët, komunitetin lokal dhe kombin (Harold Johnson, Business in Contemporary Society: Framework and Issues, 1971). George Steiner ishte një tjetër shkrimtar i rëndësishëm në përgjegjësinë sociale të korporatës në vitet 1970. Në librin e tij, Biznesi dhe Shoqëria (1971), ai e tha mendimin e tij mbi këtë temë si vijon: Biznesi është dhe duhet të mbetet në thelb një institucion ekonomik, por ai ka përgjegjësinë të ndihmojë shoqërinë në arritjen qëllimeve themelore të saj (George Steiner, Business and Society, 1971). Sa më e madhe një kompani bëhet, aq më shumë rriten përgjegjësitë, por të gjitha kompanitë nuk duhet të pranpajnë atë si pjesë e kostos në një periudhë afatshkurtër, por ta shikojnë atë si një fitim afatgjatë. Thomas M. Jones i hyri diskutimit të CSR në vitin 1980 me një perspektivë interesante.

Ai e përcaktuar CSR si më poshtë: Përgjegjësia e përbashkët sociale është nocioni se korporatat kanë një detyrim ndaj grupeve të ndryshme në shoqëri nga aksionerët dhe më gjerë që parashikohen me ligj. Dy aspekte të këtij përkufizimi janë kritike. Së pari, detyrimi duhet të miratohet në mënyrë vullnetare, sjellja e ndikuar nga forcat shtrënguese të ligjit apo kontratat sindikale nuk është vullnetare. Së dyti, detyrimi është i gjerë, që shtrihet përtej detyrës tradicionale të aksionerëve ndaj grupeve të tjera shoqërore si konsumatorët, punonjësit, furnizuesit dhe komunitetet fqinje. Carroll është një tjetër kontribues në studimin e CSR. Ai e përcaktoi CSR duke ndërthurur katër komponentë kryesore: përgjegjësi ekonomik për investitorët dhe konsumatorët, përgjegjësi ligjore, përgjegjësi etike të shoqërisë dhe përgjegjësi ndaj komunitetit që shoqëria pret nga organizatat në një kohë të caktuar (Carroll, 1979).

### CSR në Shqipëri

Mund të themi që në Shqipëri koncepti i CSR-së nuk është shumë i përhapur. Biznesi shqipëtar dominohet nga SME-të. Në 2010 mikrondërmarrjet me 1 deri në 9 të punësuar përbënin 95.7% të numrit total të ndërmarrjeve aktive. Të vetëpunësuar 62% (Ministria e Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës, 2013). Në këtë studim synohet që të analizohet se sa bizneset shqipëtare operojnë në mënyrë të përgjegjshme. Do të realizohet një studim i websiteve të kompanive për të analizuar se sa ato realisht e komunikojnë këtë. Nga një studim është vënë re që CSR në SME është më shumë një mundësi. Kjo mënyrë e të bërit biznes mund të sjellë profesionalizëm kryesisht në fazat ku operacionet nuk kryhen në mënyrë formale. CSR mund të aplikohet edhe kur kompanitë nuk kanë një strategji të përcaktuar qartë (Gregor & Fontrodona, 2011). Komunikimi i CSR është një mënyrë për të qënë të suksesshëm. E një rëndësie të madhe është edhe fakti që cdo iniciativë e ndërmarrë nga korporatat duhet gjithashtu të komunikohet (Moreno & Capriotti, 2005). Mënyra e analizimit të informacionit që paraqesin kompanitë në websitet e tyre, po merr një zhvillim të shpejtë. Nga kjo formë analizimi synohet të nxirren konkluzione të cilat vërtetojnë atë çfarë pretendojnë realisht kompanitë. Pra është një mënyrë e cila synon që të tregojë se sa përgjegjëse janë realisht kompanitë dhe se sa realisht e komunikojnë CSR-në. Nga analiza të tilla duke përdorur metodën Content Analysis (analiza e përmbajtjes), është parë që kompanitë të cilat përdorin paraqitjen e CSR-së në website janë më të suksesshme dhe kanë përfitime financiare, imazh më të lartë, reputacion më të mirë në krahasim me kompanitë të cilat nuk i përdorin (Sweeney & Coughlan, 2011). Nga analiza të tilla është parë që vendet e zhvilluara bëjnë një raportim të CSR, ndërsa vendet në zhvillim nuk i japin rëndësinë e duhur. Por gjithashtu kina verehet se ka një nivel minimal të raportimit të CSR-së në website (Alon, Lattemann, Fetscherin, Li, & Schneider, 2010).

### Metodologjia Mostra

Punimi im kosiston në studimin se sa kompanitë që operojnë në tregun shqiptar sillen me përgjegjësi sociale. Për ndërtimin e mostrës kam marrë të dhëna nga QKR. Kjo mostër përmban 680 kompani VIP që operojnë në të gjithë territorin shqiptar. Këto kompani i përkasin sektorëve të ndryshëm. Për cdo kompani janë mbledhur të dhëna në internet. Është studiuar nëse të gjithë kompanitë kanë faqe interneti, dhe çfarë hapësire zë CSR. Hapësira e CSR do të thotë që vetëm është përmendur, ka raporte të detajuar vjetore mbi

CSR, ndodhet ne faqen e parë të web. Sa e dukshme është ajo dhe sa e komunikueshme.

### Metoda

Për analizimin e të dhënave të mbledhura është përdorur analiza e përmbajtjes (Content Analysis). CA është një teknikë e përdorur për të interpretuar dhe koduar materiale tekstuale. Duke vlerësuar në mënyrë sistematike tekste, të dhënat cilësore mund të konvertohet në të dhëna sasiore. CA është një teknikë e cila nxjerr konkluzione duke organizuar në mënyrë sistematike dhe objektive karakteristika të caktuara në tekst. Me anë të kësaj teknike mund të merren në analizë fjalë kyce, fjali apo paragrafe. Pastaj të dhënat analizohen me metoda statistikore dhe nxirren konkluzione. Për të lehtësuar punën është përdorur programi QDA Miner. QDA Miner është lehtë për ta përdorur në analizën e të dhënave cilësore për kodimin dhe analizimin e teksteve dhe dokumenteve. QDA Miner mund të përdoret për të analizuar intervistat apo transkriptimin, dokumente ligjore, artikuj ditar, fjalime, madje edhe libra të tërë. Ajo jep fleksibilitet të paparë për të analizuar tekstin dhe përmbajtjen e informacionit të strukturuar përfshirë të dhënat numerike dhe kategorike. Në fillim përcaktojmë kategoritë ku duhet të përqendrohemi dhe më pas nën kategoritë. Kategoritë që kam përcaktuar janë parimet, proceset menaxheriale, stakeholderat. Tek parime bëjnë pjesë vlerat (mision, vizion), performanca, stakeholderat. Te proceset menaxheriale bëjnë pjesë filantropi, sponsorizim, dhurime, kodi i etikës, cilësi, siguri. Te stakeholderat bëjnë pjesë komuniteti, klientët, punonjësit, aksionerët, partnerët, furnitorët. Komunikimi i CSR-së sjell përfitime për kompanitë si financiare dhe jo financiare. Synimi i studimit është të analizohet nëse kompanitë shqiptare e komunikojnë CSR-në në websitet e tyre. Njëkohësisht synohet të analizohet nëse ky komunikim është efektiv. Pyetja që mund të ngrihet mund të jetë: A e komunikojnë CSR-në kompanitë shqiptare? Sipas të dhënave të mbledhura nga 680 kompani, vetëm 217 kompani kanë faqe interneti. Për cdo kompani të tillë është parë nëse ka seksion dedikuar CSR, dokumenta mbi CSR, sa klikime duhet për të arritur te CSR, sa faqe i dedikohen CSR, lajme sporadike në lidhje me CSR, dokumensta mbi CSR me pagesë ose jo. Përveç studimit të nivelit të komunikimit mbi CSR-në, synohet të analizohet se ku fokusohen më shumë kompanitë. Ajo çfarë kërkohet, është përcaktimi nëse të gjithë elementët e CSR-së trajtohen njësoj, apo nëse grupe të caktuara kanë prioritet. Pyetja që mund të shtrohet në këtë rast është: A kanë të njëjtën rëndësi faktorët e CSR-së? Nëse jo, cilët janë faktorët që marrin më shumë rëndësi? Faktorët e CSR që janë marrë në studim janë aksionerët, klientët, punonjësit, komuniteti lokal, etika, mbrojtja mjedisit, vlerat. Sot në vendet e zhvilluara gjithnjë e më shumë po i jepet rëndësi mbrojtjes së mjedisit. Ajo që unë synoj të nxjerr në pah nga ky punim është se sa merret parasysh mbrojtja e mjedisit nga kompanitë që operojnë në Shqipëri. Pyetja që mund të ngrihet në këtë rast: A është mjedisi një faktor i rëndësishëm që përfshihet në komunikim e CSR-së? Këto do vërtetohen në bazë të informacionit të mbledhur ne faqet e interneti dhe përpunuar në mënyrë statistikore. Informacioni me i detajuar i cili ka të bëjë me dokumanta dhe tekste që u përkasin kompanive përkatëse janë përpunuar me analizën e përmbajtjes.

### Rezultatet

Pas mbledhjes dhe përpunimit të informacionit për secilën kompani rezulton që nga 680 kompani vetëm 217 kompani kanë një faqe interneti, nga këto vetëm 52 kanë një seksion dedikuar CSR dhe vetëm 35 kishin dokumenta të plota në lidhje me CSR. Sipas sektorit

mund të themi që nga 217 vetëm 28% i përkasin tregti me shumicë nga ku 5 prej tyre kanë dokumenta dedikuar CSR. Sektori i ndërtimit zë një peshë prej 20% nga ku vetëm 4 prej tyre kanë dokumenta dedikuar CSR. Sektori i institucioneve financiare zë një peshë prej 10% dhe 5 prej tyre kanë dokumenta dedikuar CSR. Sektori telekomunikacionit zë një peshë prej 7% dhe vetëm 5 prej tyre kanë dokumenta dedikuar CSR. Sektori energjitik zë një peshë prej 4%(8kompani) ku 4 prej tyre kanë dokumenta dedikuar CSR. Sektori prodhimit zë një peshë prej 4.2% nga ku 3 prej kompanive kanë dokumenta dedikuar CSR. Sektori i shërbimeve një peshë prej 6% nga ku 6 prejkompanive kanë dokumenta dedikuar CSR. Sektorë të tjerë që zënë 12% nga ku vetëm 3 kompani kanë dokumenta dedikuara CSR. Pra sic shihet nga rezultatet sektorët të cilët sillen me përgjegjësi sociale janë telekomunikacioni, energjitika dhe bankat. Nëse gjykojmë nga numri i faqeve të informacionit që komunikohet mund të themi që në sektorin e telekomunikacionit numri mesatar i faqeve të web është 30 faqe dhe numri i klikime për CSR është 2. Në sektorin e energjitikës numri mesatar i faqeve web është 28 dhe numri i klikimeve për të arritur CSR është 2. Në sektorin institucion financiar numri faqeve web është 27 faqe dhe numri i klikimeve për të arritur te CSR-ja është 2. Kurse në përgjithësi mund të themise rreth 22% e firmave kanë nr e klikimeve për të arritur në CSR 1 pra CSR ndodhet në faqe të parë. Sekioni dedikuar CSR, telekomunikimi nga 14 kompani, 8 kompani kanë seksion dedikuar CSR, dhe vetëm 4 prej tyre kanë dhe raporte të detajara në lidhje me CSR. Përsa i përket instituciaoneve financiare janë 14 dhe 9 prej tyre ka në seksion dedikuar CSR dhe 3 prej tyre kanë raporte të detajura në lidhje me CSR. Mund të themi se këto janë sektorët që i japin më shumë rëndësi CSR dhe e komunikojnë në mënyrë më efektive se sektorët e tjerë. Telekomunikimi në lidhje me numri i dokumentave është 4 ndërsa në sektorin institucion financiar numri i dokumentave është 11. Nga këto rezultate mund të arrijmë në përfundimin që komunikimi i CSR në kompanitë shqiptare është në nivele mjaft të ulëta. Shpesh edhe kur kryhet ky komunikim nuk realizohet në raporte të strukturuar, por më tepër jepet thjesht si informacion. Nëse do të krahasojmë sektorët, janë sektori i telekomunikacionit dhe ai bankar të cilët qëndrojnë në krye. Megjithatë duhet të theksojmë që kompanitë e sektorit të telekomunikacionit bëjnë një raportim më të detajuar. Nga 14 kompani 8 kanë sesion të dedikuar CSR-së dhe kanë raporte mbi CSR-në. Pas këtij sektori vjen ai bankar. Theksojmë që kompanitë e këtij sektori janë më të orientuara në raportimin e CSR-së brenda raporteve vjetore se sa në krijimin e raporteve të dedikuara CSR-së. Fakt që bie në sy është edhe sektori i ndërtimit. Kompanitë e këtij sektori kanë ëeb, por vetëm publikojnë dhe reklamojnë shërbimet e tyre, kanë seksion dedikuar CSR por nuk raportojnë mbi CSR-në. Pyetja - A është mjedisi, një faktor i rëndësishëm në komunikimin e CSR-së? Për të realizuar këtë u analizua se cila fjalë është më e përdorur në informacionet e mbledhura. Ndër këto fjalë ishin mjedisi, ambjenti. Më pas vinin stakeholder të ndryshëm. Kur u studiuuan raportet mbi CSR-në u pa se rëndësi të madhe i jepej mjedisit, por duke qenë se numri i kompanive që kishin raporte mbi CSR-në është i vogël atëherë në tërësi mund të themi se mjedisit si faktorë i CSR-së i jepet rëndësi relativisht e ulët. Këto rezultate na cojnë në arsyetimin që theksi vendoset tek mbrojtja e mjedisit. Por kjo bie poshtë kur analizohen kategoritë në pyetjen e radhës. Pyetja - A kanë të njëjtën rëndësi të gjithë faktorët? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje është mledhur informacion për cdo kompani që kishte websitë në lidhje me misionin, vizionin, objektivat, proceset menaxheriale, raportet mbi CSR. Këtu synohet të analizohet nëse të gjithë faktorët e CSR-së janë njësoj të rëndësishëm. Pra nëse kanë të njëjtën peshë komunikimi. Së pari është parë se cila është fjala më e përdorur dhe me anë të kësaj mund të konkludojmë se ku kompanitë shqiptare e vendosin theksin më shumë. Me anë të

analizës së përmbajtjes si dhe me programin QDAMiner kam arritur në përfundimin që fjala më e përdorur është mjedisi. Ky përfundim është arritur përsa i përket kategorisë së CSR. Këto rezultate na cojnë në përfundimin që theksi vendoset tek mbrojtja e mjedisit më shumë se cdo gje tjetër që mund të jenë filantropia, sponsorizime, etj. Por nëse do të përqendrohemi në bazë të kategorive si parimeve, stakeholderave dhe proceseve menaxherile frekuenca e fjalës mjedis është shumë e ulët. Ajo në këtë rast zë një peshë prej 9.7% të kompanive duke qenë më poshtë se performanca financiare. Në tre vendet e para janë vlerat me 14.7%, punonjësit me 14.2%, dhe klientët me 12.3%. Pra në tërësi kompanitë nuk janë të fokusuar te mjedisi. Gjithashtu mund të themi se stakeholderat zënë pesha të ndryshme. Pra faktorët nuk janë njësoj të rëndësishëm. Pyetja - A kanë lidhje faktorët me njëri tjetrin? Nga tabela kemi 103 korrelacione nga të cilat nuk ka asnjë negative, 17 skanë lidhje fare, dhe vetëm 6 kanë lidhje statistikisht të rëndësishme. Aksionerët nuk kanë lidhje me dhurimet, filantropinë, komunitetin dhe sponsorizimin ndërsa kanë një lidhje statistikisht të rëndësishme me furnitorët, ndërsa me variablat e tjerë ka lidhje pozitive por jo statistikisht të rëndësishme. Cilësia nuk ka lidhje fare me dhurimet, filantropinë, furnitorët dhe sponsorizimet. Me variablat ka lidhje pozitive por jo statistikisht të rëndësishme. Dhurimet kanë lidhje asnjësoje me furnitorët, kodin e etikës dhe mjedisin dhe ka lidhje mjaft të fortë me filantropinë dhe sponsorizimet. Filantropia ka një lidhje asnjësoje me furnitorët dhe mjedisin dhe një lidhje të fortë me sponsorizimin. Furnitorët nuk kanë lidhje asnjësoje por nuk ka një lidhje të fortë me variablat përkatës. Klientët nuk kanë lidhje asnjësoje por kanë vetëm një lidhje të fortë me punonjësit, kjo varet ndoshta nga që pjesa më e madhe e kompanive janë kompani shërbimi. Kështu që ndërveprimi mes punëtorit dhe klientit luan një rol të rëndësishëm në komunikimin e reputacionit të kompanisë në publik. Kodi etikës ka lidhje mjaft të dobëta me të gjithë variablat. Mjedisin ka një lidhje të fortë me stakeholderat dhe lidhjet e tjera i ka të dobëta. Performanca ka një lidhje të fortë me punonjësit dhe stakeholderave por ka një lidhje mjaft dobët me sponsorizimet. Punonjësit kanë lidhje të fortë me stakeholderat dhe vlerat. Sponsorizimet kanë lidhje të dobëta me vlerat dhe stakeholderat.

### **Pse Shqipëria në këtë gjendje?**

Niveli i korrupsionit në Shqipëri gjatë vitit 2013 në Shqipëri ka shënuar rritje. Ky ka qenë konstatimi i bërë nga organizata "Transparency International Albania", e cila e rendit Shqipërinë në vendin e 116-të, nga 177 shtete gjithsej. Në një listë prej 177 shtetesh, Shqipëria renditet në vendin e 116-të, nga vendi i 113-të që ishte një vit më parë. Në raportin e saj, Transparency International thotë se treguesit e këtij viti janë një paralajmërim se shpërdorimi i pushtetit dhe ryshfetet vazhdojnë t'u sjellin shkatërrime shoqërive kudo në botë. Zakonisht vende që karakterizohen nga nivele të larta të korrupsionit shënojnë nivele më të ulëta të përgjegjësisë sociale (George Serafeim, 2011). Sistemi financiar kryesisht në Shqipëri është i mbështetur në borxh. Sipas Bankës Botërore Shqipëria ka një nivel borxhi 60% e PBB-së. Nisur nga ky fakt, në Shqipëri, kompanitë operojnë apo jo me përgjegjshmëri sociale? Përsa i përket sistemit ligjor mund të themi se Shqipëria që nga vitet 1990 ka miratuar ligje për hapjen e konkurrencën dhe nxitjen e saj. Por ajo që lë për të dëshiruar është zbatimi i ligjit. Në këto 20 vjet tranzicion mund të themi që Shqipëria ka një paketë ligjesh shumë të mire po nuk mund të ndodhë ndryshe kur niveli i korrupsionit është kaq i lartë. Kështu një mangësi në njërin anë dikton mangësi në anën tjetër prandaj dhe zbatimi i ligjit është kaq i dobët. Shqipëria karakterizohet nga

një kulturë kolektivistike. Kjo ka bërë që të rritet numri i të arsimuarve, ka rritur numrin e profesioneve, por ajo që lë për të dëshiruar është cilësia. Vërtet sasia është rritur por për cilësinë nuk mund të gjykohej në të njëjtën trend. Të gjitha këto të meta mund të ndikojnë negativisht në mosfunksionimin e ligjit, *konkurenca, mjedisi politik dhe social*. Në bazë të kërkimeve të bërë nga studiesve të huaj vende të cilat karakterizohen nga këto të meta kanë pasur sjellje të ulët të përgjegjshmërisë sociale.

### Konkluzionet

Duke kombinuar literaturën, teorinë, artikuj të ndryshëm, analizën e përmbajtjes dhe metodologjinë e përdorur qëllimi i këtij kërkimi është të hetojë se sa efektive është CSR në Shqipëri. Kjo u arrit duke hetuar: A komunikohet CSR në Shqipëri? A janë të gjithë faktorët e CSR njësoj të rëndësishëm? A është mjedisi një faktor i rëndësishëm i CSR-së që ndihmon në komunikim e saj? Si janë të lidhur faktorët me njëri-tjetrin? Nga hetimi i këtyre pyetjeve u arrit në përfundimin se komunikimi i CSR-së në Shqipëri është në nivele të ulëta. Për të studiuar këtë janë marrë në konsideratë vetëm kompanitë që kanë faqe interneti. Kështu që numri i kompanive VIP është reduktuar në 30% të cialt janë marrë në studim. Nga këto vetëm 24% prej tyre kanë sesion dedikuar CSR-së dhe akoma më tej reduktohet numri i dokumenteve mbi CSR-në në 10%. Duke qenë se ky studim është i fokusuar mbi të dhënat që janë të publikuara në internet dhe në pamundësi për të përdorur mënyra të tjera për të studiuar CSR-në në Shqipëri mund të them se ka kufizime në këtë studim prandaj dhe rezultatet janë qaq të dobëta. Përsa i përket rëndësisë së faktorëve të CSR-së, ata nuk janë njësoj të rëndësishëm dhe faktorët më të rëndësishëm janë vlerat, punonjësit dhe klientët. Kjo do të thotë se kompanitë shqiptare janë më të fokusuar te kushtet e punë, trajnimet, dhe te shërbimi ndaj klientit. Ajo që vlen të theksohet këtu është që mjedisi është renditur si faktorë i fundit për nga rëndësia që do të thotë që kompanitë nuk i kushtojnë aq rëndësi mbrojtjes së mjedisit apo politikave të ndërmarra për mjedisin. Por kur u studiuat raportet mbi CSR-në u pa se rëndësi të madhe i jepej mjedisit, por duke qenë se numri i kompanive që kishin raporte mbi CSR-në është i vogël atëherë në tërësi mund të themi se mjedisit si faktorë i CSR-së i jepet rëndësi relativisht e ulët. Gjithashtu në këtë kërkim u pa se çfarë lidhje egziston ndërmjet faktorëve të ndryshëm. Këtu u vu re se filantropia dhe dhurimet kishin një lidhje të fortë (54%) dhe me sponsorizimet (40%). Kjo ndoshta se kompanitë i orientojnë praktikat e tyre drejt këtyre koncepteve në mënyrë të ndërthurur. Një lidhje tjetër rezultoi në rëndësinë që i japin kompanitë punonjësve së bashku me klientët. Pra, edhe pse vemendje më e madhe u vihej burimeve njerëzore, punonjësve (me trainim, zhvillim, motivim etj), rezultoi që egziston një lidhje e punonjësve me klientët. Niveli i lartë e korrupsionit, system financiar i mbështetur në shifra të larta të borxhit, niveli arsimor është e vështirë të gjykohej nëse është rritur cilësia, mos zbatimi i ligjit besoj se janë disa faktorë që ndikojnë negativisht në CSR. Të gjitha këto të meta mund të ndikojnë negativisht në mosfunksionimin e ligjit, *konkurenca, mjedisi politik dhe social*. Në bazë të kërkimeve të bërë nga studiesve të huaj vende të cilat karakterizohen nga këto të meta kanë pasur sjellje të ulët të përgjegjshmërisë sociale.



## Rreferencat

- Carrol to Ioannou, I., & Serafeim, G. (2010). The Impact of Corporate Social Responsibility on Investment Recommendations. Best Paper Proceedings, Academy of Management 2010 Social Issues in Management (SIM) Division): Harvard Business School.
- Eccles, R. G., & Serafeim, G. (23 May 2011). Leading and Lagging Countries in Contributing to a Sustainable Society. Harvard Business School.
- Eccles, R. G., Ioannou, I., & Serafeim, G. (2011). The Impact of a Corporate Culture of Sustainability on Corporate Behavior and Performance. Harvard Business School.
- Eccles, R. G., Serafeim, G., & Andrews, P. (2011). Mandatory Environmental, Social and Governance Disclosure in the European Union. Harvard Business School.
- Gössling, M. t. (2011). Corporate Social Responsibility and Business Performance. Northampton Massachusetts 01060 USA: Edward Elgar Publishing Limited The Lypiatts 15 Lansdown Road Cheltenham Glos GL50 2JA UK.
- Gregor, S. P., & Fontrodona, J. (2011). Statagic CSR for SMEs: paradox or possibility? Univerisia Business Review.
- Hill, R. P., & Becker-Olsen, K. L. (2005). The Impact of Perceived Corporate Social Responsibility On Consumer Behavior. UC Berkeley: Working Paper Series, Center for Responsible Business, .
- Ioannou, I., & Serafeim, G. (2010). The Impact of Corporate Social Responsibility on Investment Recommendations. Harvard Business School: Best Paper Proceedings, Academy of Management 2010 Social Issues in Management (SIM) Division).
- Jasch, C. (2002). The Use of Environmental Management Accounting (EMA) for Identifying Environmental Cost. Vienna, Austria: Institute for Environmental Management and Economics, IO" W, Rechte Wienzeile 1915, A-1040 .
- Mele, G. t. (2011). Corporate Social Responsibility and Business Performance. Northampton Massachusetts 01060 USA: Edward Elgar Publishing Limited The Lypiatts 15 Lansdown Road Cheltenham Glos GL50 2JA UK.
- Moreno, L. t., & Capriotti, P. (2005). Communicating CSRm citizenship and sustainability on the web.
- Satish, K., & Tiwari, R. (2012 йил 17-March). Corporate Social Responsibility: Insights into Contemporary Research. IUP Journal Of Corporate Governance 10 , pp. 22-44.
- Stone, D. S. (2002). The Content Analysis Guidebook. London, New Delphy: International Educational and Professional Publisher.
- Sweeney, L., & Coughlan, J. (2011). Do Different Industries Report Corporate Social Responsibility Differently? An investigation throught the lens of stakeholder theory. Journal of Marketing Communications , pp 113-124.
- Vogel, D. J. (2005). Is there a Market for Virtue? The business case for corporate social responsibility. pp. 3,4.

## **Biznesi i orientuar nga gratë – Rasti i Kosovës**

**Fellanza Pula, PHD Candidate**

### **Abstrakti**

Ndërtimi i historisë së gruas, veçmas i historisë ekonomike dhe fuqisë së saj ekonomike, politike e sociale, ka kaluar jo edhe pa shumë pasoja, vështirësi dhe sakrificë për të si në botë e ashtu edhe në Kosovë. Ndryshimet rapide kanë ndodhur dhe këto më së shumti kanë prekur dhe influencuar ekonominë femërore ku vërehet se në dekadat e para është folur mbi fillimin e punësimit, edukimit dhe zvogëlimin të diferencës së pagave për punën e njëjtë mes mashkullit-gruas, e dekadave të fundit çdo ditë e më tepër gruaja po bëhet fuqi ekonomiko-politike dhe sociale. Se ndikimi i gruasë në ekonominë bashkëkohore është mëse i dukshëm dhe kuptimplotë ma nuk vihet as në dyshim. Këto mendime mbështeten në shumë fakte të cilat do të prezentohen në këtë artikull shkencor të cilat do ti marrë për bazë e që paraqesin gruan si faktorë fuqiptotë dhe vendimarrës në shpenzime e të cilat kryekëput lidhen me ekonominë-ndikimin në zhvillim dhe në trendet e saja. Fuqia e saj në blerje dhe shpenzime ndërron korsinë e trendeve prodhuese bazuar në preferencat dhe kërkesat e gruas, andaj mund të themi se bizneset janë të vetëdisjshëm për gruan si faktorë dominus në ekonomi. Vështrimet teorike të shumë studjuesve të ekonomisë së tregut përbëjnë një variaitet të ndryshëm të ofrimit të njohurive të dala nga studime të thella mbi konsumatorin, nga disa të quajtur “mbret” e që mund të them se kjo shprehje i takon një kohe shumë më të hershme studimore. Përderisa në ditët e sotme - gjithmonë bazuar në studime e kohëve të tanishme moderne në tregjet mbarëbotrore, hulumtimet dhe studimet të bartura në vështrime teorike na japin një konkluzion të qartë të kuptuarit se konsumatori lirisht mund të quhet “mbretëreshë”. Ky ndryshim i titullit, duke mos qenë i ndikuar as me dashjen më të vogël të animimit gjinor, shihet se është real, aktual dhe faktik. Termi “Gruaja konsumatore” në përgjithsi është term i cili nënkupton konsumin e bërë nga shtëpitë apo të njohur si ekonomia shtëpiake pasi që ajo përfaqëson konsumin e tërësishëm familjar. Përgjegjësina e grave në aktivitet e saja si blerjet e gjërave të tjera të domosdshme për familjen, krijonë interes dhe qëllim kryesor të bizneseve, se si ta përfitoi besimin e saj duke shëndruar atë si konsumatore primare, e cila behet pjesë vitale, dhe kyqe e bizneseve të tyre.

### **Zhvillimi**

Zhvillimi i teorisë gjinore së fundmi ka shënuar rritje të madhe veçmas si pjesë e përgjithshme post-moderne dhe veçanërisht në sferën avokuese; dekonstruktimi i shprehjeve gjuhësore “fakt” dhe “njohuri” duke i kushtuar rëndësi të veçantë rolit ideologjik dhe agjendës politike në formimin e fjalorit dhe shprehjeve në të folur dhe të shkruar: fuqia e normave të diskutueshme dhe përfundimeve të pathëna (Bettio & Verashchagina, 2008, 23). Mënyra se si termi “gjinor” është përdorur në konceptet ekonomike dhe sociale zakonisht reflekton në dykuptimësi. Ndonjëherë termi “ekonomia gjinore” i referohet tërësisë, gjithë-përfshirëse i përdorur për çdo analizë ekonomike që në mënyrë eksplicite e dallon burrin dhe gruan. Në qarqet politike sociale dhe ekonomike shpesh termi ‘qasje gjinore’ është i referuar si inovacion i ri për “mundësi të barabarta për gratë”. Në qarqet akademike termi ‘ekonomi gjinore’ mund t’i referohet një zone që në masë të madhe përputhet me konceptet e ekonomisë së punës së femrave, ose mund edhe të kuptohet si hulumtim feminist i një fryme të ‘butë’ (Bettio & Verashchagina, 2008, xiii). Mirëpo ne nuk nisemi nga teoria feministë mbi gjininë!

Sipas mendimit tim, bota duhet të çlirohet nga këto diskriminime, gjykoj se nuk duhet pasur një dorë dominuese, përkundrazi duhet shikuar gjërat në mundësitë bashkëpunuese

dhe në respektimin e natyrës së ndërsjellë gjinorë.

Ne sot jetojmë në epokën e ndryshimeve të shpejta - ndryshim në kushtet ekonomike, në institucionet ekonomike dhe sociale, në zakonet dhe besimet. Ndryshimet në rolet në mes grave dhe meshkujve, marrëdhëniet me njëra-tjetrën, dhe në natyrën e familjeve në të cilat shumica e tyre vazhdojnë të jetojnë e të zhvillohen me një shpejtësi të paparë (Blau, 2010, 12).

Tanimë roli i gruas është fuqizuar dhe ajo ka ndikim jo vetëm në familje, shoqëri por me punën e saj ,krijonë dhe shpenzonë të ardhura duke implikuar ndikime edhe në ekonomitë e vendeve të ndryshme duke përfshirë edhe Kosovën.

Autor dhe ekspert të fushave të ndryshme studimi, Gruan e vendosin në qendër të vëmendjes dhe e konsiderojnë atë si një prej kategorive më të rëndësishme të biznesit në botë “Gruan si fuqi blerëse”. Dhe kjo fuqi e saj shendohet si mundësi potenciale për shume biznese te reja e po ashtu edhe atyre ekzistuese që t’i orientojnë bizneset e tyre nga GRATË.

Në krizën e tanishme ekonomike, kompanitë e shumta në botë kanë filluar rishqyrtimin e strategjive të tyre për të gjetur metoda të reja për të targetuar konsumatorë potencial. Kompanitë që nuk marrin parasysh ndikim e gruas si fuqi blerëse, ( duke ditur që gratë janë përgjegjëse për 64% të shpenzimeve familjare dhe duke llogaritur fitimet e tyre mahnitëse që janë afro 12 Bilion \$ në vit), krijojnë rrezik për rishqyrtim të suksesshëm të këtyre strategjive biznese (Silverstein, 2009,9). Se fuqia blerëse e gruas ka rol të rëndësishëm në strategjitë biznese të kompanive prodhuese dhe shërbyese, e dokumentojnë edhe shumë autor të fushave menaxheriale dhe ato të marketingut .

Tani, këto janë ditët e marketingut me gra- ti trajtoni ato si partnere të biznesit dhe ti dëgjoni ato , gjatë çdo hapi në procesin e marketingut. Pra, nëse ju me të vërtetë doni të keni sukses me grupin më të fuqishëm të konsumit në botë, e gjitha që ju duhet të bëni është të pyesni atë (Quinlan, 2003, 3).

Gratë janë konsumatorët më të fuqishme në planet, duke pas influence apo duke bërë blerjen e 85% ,të çdo gjëje që ju keni për të bërë(prodhuar), për të shitur, apo për të ofruar (shërbime). Ato janë zëri në linjën tuaj të shërbimit për konsumator, para te gatshme në banakun (llogarinë) tuaj dhe majat e gishtërinjve në faqen tuaj të internetit. Nëse ju jeni pjese e mallrave të konsumit të paketuar, të shitjes me pakicë, shërbimeve, teknologjisë, financave, kujdesit shëndetësor, ose çdo kategorie tjetër që ju i takoni, ju mund ti emëroni si “Ajo vajza” e rëndësishme për planet strategjike të marketingut e po ashtu “gjak-jetese” e shitjes dhe profitit tuaj. Duke ditur atë se çfarë gratë duan është bileta juaj për ide të mëdha biznesi dhe para të mëdha.

### **Pse biznesi duhet të jetë i orientuar nga grate**

Rritja mbarëbotërore e ekonomisë femërore po ndryshon perceptimin e asaj se si kompanitë bëjnë hulumtime zhvillojnë produkte, shesin dhe pozicionojnë, dhe se në çfarë forme shtojnë shërbime në propozimet valutore (Silverstain, 2009, 9). Pra tashmë gruaja është shndërruar në fuqinë numër një ekonomike, ato janë konsumatorët më të mëdha, rreth 20 **bilionë** dollarë shpenzohen çdo vit prej grave për mallra dhe shërbime të të gjitha natyrave dhe shumë shpejt kjo shifër do të shkojë në 28 bilionë dollar. Gratë sigurojnë të ardhura në një vlerë rreth 12 bilionë dollarë dhe për disa vite mund të shkojnë në 18 bilionë dollarë . (Silverstain, 2009, 31). Gratë do të zënë një pozitë edhe më të rëndësishme në ekonominë dhe rendin botëror sesa që kanë tani dhe do të përfaqësojnë një pjesë gjithnjë e më të madhe të fuqisë punëtore. Numri i grave që punojnë është rritur

me rreth 2.2% në vit, Gjatë vitit 2013 sipas parashikimeve numri i grave që kanë hyrë në fuqinë punëtore është shtuar me afërsisht 90 milionë. Në gati çdo kompani të mëdha të konsumit, shumica e menaxhereve të mesëm janë gra (Harvard Business Review). Gruaja tani ma i ka fitimet e veta dhe pavarësinë e saj ekonomike e nga ky segment mundë të përfitojnë shumë kompani prodhuese dhe shërbyese nëse do ta kuptojnë me kohë se ku është fitimi i kompanisë së tyre.

Gruaja në gjithë globin ka shumë mjete financiare për ti shpenzuar, në mbarë botën fitimet dhe pagat e grave për 1 vitë arrijnë shumën 12 Bilion \$, në këtë shumë gratë amerikane marine pjesë me 4.3 Bilion \$. Nga 3 në 10 gra të punësuar (29%), e përbëjnë afër ose komplet të ardhurat familjare, dhe 6 në 10 (62%) gra të punësuar fitojnë gjysmën e të hyrave familjare. Në vendet me ekonomi të zhvilluar 40% të grave kontrollojnë 91-100% të shpenzimeve familjare. Gratë amerikane kanë influencën më të madhe në shpenzime për konsum familjar, 72% të shpenzimeve kontrollohen dhe bëhen nga vet ato (Silverstain, 2009, 31). E tërë kjo shumë e parave në kontot dhe portofolit e grave janë mundësi në rritje për shumë biznesmen dhe financier të aftë që njohin burimin e pasurimit real të tyre, dhe këto mjete të gruas të suksesshme presin për tu investuar dhe për tu shpenzuar diku.

Tanimë me të nisemi nga fakti më i thjeshtë dhe ekzistues, gratë tani janë të integruara thellë si fuqi punëtore dhe mbajnë vende të rëndësishme të punës, mesatarisht janë më të arsimuar në raport me meshkujt, dhe shpesh fiton të ardhura të njëjta ose edhe më shumë se meshkujt (burrat). Fuqia e portofolit (kuletës) që vjen nga të fituarit e të ardhurave financiare (Barletta, 2007, 31). Potenciali në rritje i gruas si fuqi blerëse ka ndikim në shoqëri dhe në ekonomi me mënyrën se si ajo harxhon mjetet e fituara, këto mjete bëjnë ndryshime edhe në strukturën e shumë bizneseve. Numri i madh i grave të punësuar, pasuria, martesat e më vonshme, numri shume më i lartë i divorceve në raporte me të kaluarën, më shumë kohë të kaluar si e "vetme", dhe një popullatë në plakje, janë mundësi të mëdha për biznese nëse ato me kohë i kuptojnë këto implikime demografike si segmente të rëndësishme në strategjitë e bizneseve të tyre (Brennan, 2011, 14-15).

### **Fuqizimi i gruas kosovare**

Shoqëria kosovare, pas luftës ka bërë përpjekje për arritjen e barazisë gjinore, e psaqërishtë avancimin e pozitës së gruas në shoqëri si dhe fuqiziminë e saj. Duke u nisur nga fakti se si shoqëri patriakale që jemi nga hulumtimi i kryer del se gratë kosovare jnaë përgjegjëse mbi blerjet dhe fuqia e saj vendimmarrëse është në rritje. Artikulli ka si, fokus biznesinë e orientuar nga gratë dhe sa ka evoluar gruaja kosovare ndikojnë ato me nevojat e tyre në treg, të dhënat dhe informacionet që paraqiten dhe që janë përpunuar, i referohen gruas në këndvështrime të ndryshme, të domosdoshme për të kuptuar rolin dhe pozicionin e saj në ekonominë dhe shoqërinë kosovare në raport me vendet tjera, vlerësimin e rolit të shumëfishtë të saj, përfshirë atë si konsumatore dhe si influencuese në shumicën e vendimeve të blerjes. Ndryshimi i pozitës së gruas kosovare dhe hyrja e saj në treg si fuqi punëtore, i mundëson asaj pavarësinë financiare e nga kjo edhe kërkesat e saj rriten për shumë shumë produkte dhe shërbime.

Nga statistikat zyrtare të MSHP/DASHC del se shkalla e punësimit në nivel komunal apo qendror dhe në pozita drejtuese dhe menaxheriale, në mes meshkujve dhe grave, dallon nëse krahasohen vitet 2008 dhe 2009. Në nivele drejtuese janë 50 gra në vitin 2008, ndërsa në vitin 2009 janë 67. Këtu shihet një rritje prej më pak se 15% të grave në pozita drejtuese. Ndërsa, në nivelin menaxherial, të raportuar për nivelin komunal dhe qendror, në vitin 2008 janë 528 gra ndërsa në vitin 2009 janë total 560, ku i bie të jenë afërsisht 7%

rritje edhe në këtë nivel. Në institucione publike si KEK-u nga 7804 punëtor, prej të cilëve 573 ose 7% janë gra dhe 7231 ose 93% janë meshkuj. Nga 36 pozita vendimmarrëse 4 ose 11% janë gra dhe 32 ose 89% meshkuj. Në PTK gjatë vitit 2011 kanë qenë të punësuar gjithsej 3354 punëtorë, prej tyre 794 ose 24% janë gra dhe 2560 ose 76% meshkuj. Numri i menaxhimit të lartë në zyrën qendrore të PTK-së është 73, nga të cilët 8 ose 11% janë gra dhe 65 ose 89% meshkuj. Në QKUK, nga 2828 të punësuar 68% janë gra dhe 32% meshkuj. Në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nga gjithsej 64 punonjës të punësuar në këtë institucion 29 ose 39% janë femra dhe 35 ose 61% meshkuj. Nga 10 fakultete të dhënat e marra rezultojnë se raporti gjinor për sa i përket numrit të studentëve kryesisht është i barabart, duke veqar Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, ku femrat janë 23% dhe meshkujt 77%. Ndërkaq në Fakultetin Filologjik kemi një situatë anasjellt, përkatësisht nga numri i përgjithshëm i studentëve, 71% janë femra dhe 29% meshkuj.

Në Kuvendin e Kosovës, siq dihet për shkak të kuotës 30% të përcaktuar paraprakisht, femrat e përbëjnë një të tretën e parlamentarëve. Kjo përqindje është edhe në asamblatë komunale. Organet udhëheqëse, në Presidencë, pozitën e Presidentës së vendit aktualisht e mbanë një grua dhe për këtë vendi ynë është në avantazhe me vendet në rajon dhe më gjerë. Sfidat më të madhe për shoqërinë Kosovare mbetet ende për tu dëshiruar dhe për të arritur barazi në vendet e punës dhe në instancat vendimmarrëse. Numri i të punësuarve gra në institucionet publike dhe ato private në Kosovë ende nuk është proporcional me përqindjen gjinore të popullsisë. E kur flasim për pozitën vendimmarrëse, kjo përqindje është edhe më e vogël.<sup>1</sup>

Nga kjo shihet se edhe në shoqërinë Kosovare gratë kanë filluar ngadal por me hapa të sigurt të ndikojnë në çdo sferë të jetës. Rritja e fuqisë së tyre ekonomike çdo ditë e më tepër i bënë ato atraktive si fuqi blerëse për kompanitë e ndryshme që ofrojnë produkte dhe shërbime. Nga këto shënime statistikore dhe fakte të pamohueshme cilat dokumentohen dhe mbrohen nga autor dhe studiues të fushave të ndryshme ekonomike, mbi potencialin e të bërit biznes me gruan është mundësi biznesi i pa eksportuar e po ashtu një shtytje e madhe për shumë biznese ekzistuese dhe ato të reja që ta kuptojnë fuqinë e ekonomike të gruasë e po ashtu vendimi se si se si do të funksionoi biznesi i tyre e ka Gruaja konsumatore. Dhe sa më shpejtë do të kuptohet nga kompanitë e ndryshme se si ta ndryshojnë realisht strategjinë e të bërit biznes me atë aq ma të sukseshëm do jenë. Çdo kompani prodhuese dhe shërbuese dhe marketeret e tyre duhet t'ia parashtrajnë vetës pyetjet gjatë përpilimit të strategjive të bizneseve të tyre. Për ta kuptuar gruan si fuqi blerëse nuk është edhe aq proces i lehtë dhe nevojitet shumë me shumë punë nga kompanitë dhe markierët e tyre, që ti kuptojnë nevojat dhe kërkesat e saj reale.

Bizneset kosovare që ofrojnë produkte dhe shërbime duhet të fillojnë të kuptojnë se si ta përfitoi konsumatorën grua e cila çdo ditë e më shumë ka pavarësinë financiare, bizneset duhet të fokusohen më shumë tek gratë dhe ta shohin atë si mundësi primare ekonomike; Duke e njohur konsumatorën e tyre primare, kompanitë ato duhet të kuptojnë që gratë janë shumë sociale, dhe komunikative për t'u treguar të tjerëve përparësitë dhe mangësitë e produkteve/shërbimeve

Bizneset kosovare duhet të fokusohen në ato produkte dhe shërbime që janë praktike dhe i'a lehtësojnë punën gruas në jetën e përditshme pasi që gruaja është e ngarkuar me punë të dyfishtë atë në shtëpi dhe asaj profesionale

Bizneset kosovare duhet të mendojnë që të bëjnë promovimin e produkteve dhe shërbimeve të reja;

<sup>1</sup>Raport - Grate ne procesin e punes dhe vendimarrjes ne Kosove, Qeveria e Kosoves

## Bibliography

- Bridget, B. (2011). *Why She Buys*.
- Bettio, F. & Verashchagina, A. (2008). *Gender segregation in the labour market*. Euopean Comission.
- Blau, F. (2010). *Economic of Women, Men and Work*.
- Barletta, M. (2007). *Marketing to Women*.
- Quinlan, M. L. (2003). *Just Ask a Women*.
- Silverstain, M. J. (2009). *Women Want More*.
- Qeveria e Kosoves. (2011). *Grate ne procesin e punes dhe vendimarrjes ne Kosove*. Prishtine.

## **Bashkimi Evropian i shekullit XXI, sfidat dhe perspektivat për vendet e Ballkanit**

**Msc Ermira Pervizi**

### **Abstrakti**

Bashkimi Evropian është familja e vendeve demokratike me një të kaluar të përbashkët kulturore dhe historike. Ai bazohet në vlerat universale si liria, respektimi i të drejtave të njeriut, barazia, shteti i së drejtës, demokracia, siguria, drejtësia.

Në Europën e Bashkuar kombet nuk do të humbasin identitetin e tyre, përkundrazi vetë ata do të përbëjnë bazën e nevojshme të ndërtesës së përbashkët . Bashkimi Evropian po përballet me sfidën e globalizimit.

Procesi i globalizimit po e shëndron botën në një fshat te madh global dhe problematikat që hasen janë ato:

- 1- Mjedisore (ndotja, efekti sere, çarja e shtreses së ozonit)
- 2- Social - ekonomike (unifikimet e kulturave, kriza e ekonomike)
- 3- Politike (konflikte etnike etj)

Globalizimi dhe konkurrenca lokale kufizojnë hapësirën e veprimit për politikën kombëtare dhe shumë probleme mund të trajtohen në mënyrë të përshtatshme vetëm në nivel ndërkombëtar apo rrafsh global.

Kështu integrimi Evropian përcaktohet si një përgjigje premtuese për suksesin ndaj sfidave të globalizimit. Politika e organizuar sikurse edhe më parë kryesisht në nivel territorial dhe në kuadrin e shteteve kombëtare ka mbetur prapa në krahasim me ekonominë e organizuar gjithnjë e më shumë në mënyrë ndërkombëtare apo globale e çliruar nga kufijtë dhe materia.

Një sfide tjetër e BE-së është çballkanizmi i Ballkanit nëpërmjet frymëzimit dhe mbështetjes së integritetit rajonal. Është e pa diskutueshme që të gjitha arritjet e rajonit në mënyrë direkte ose indirekte janë ndikuar fuqishëm nga aftësia gjeografike e BE-së në promovimin e stabilitetit politik dhe rritjes ekonomike me anë të shumë instrumentave .

Përpjekjet e BE-së për rritjen e shkallës së bashkëpunimit në nivel rajonal në sektorin e ekonomisë kërkojnë:

1-Që të ecet përpara duhet aftësia e rajonit për të konkurruar me pjesët e tjera të globit në aspektin ekonomik-shoqëror.

2-Nevojitet një rikonceptim rajonal për shtetet institucionalisht të uniformizuar.

\* Ky proces duhet të synojë zhvillimin ekonomik dhe shoqëror si projekt i përbashkët i vendeve të rajonit.

Përmes sistemit të rajonizimit (NUTS), nxjerrjes së statistikave të përbashkëta të vendeve të rajonit dhe të nënrajoneve sjell përfitimin e mjeteve financiare nga KE-ja për politikën e zhvillimit rajonal. Restaurimi i dinjitetit dhe krenaria e të qenit banor i Ballkanit duhet të përbëjë bazën e procesit të çballkanizimit të Ballkanit.

**Fjalë kyç:** *Globalizim, sfide e përbashkët, çballkanizim, rajonizim, stabilitet politik.*

### **Hyrja**

Procesi i formësimit të BE është larg përfundimit.Realizimi i tij do të duhet të kapërcejë shumë kriza.Ai do të kërkojë shumë kohë durim dhe diplomaci.

Deri tani ky bashkim përbëhet nga 28 shtete anëtare ku anëtarja më e re është Kroacia pas së cilës shpresojmë që edhe vendet e tjera të ballkanit të bëhen shumë shpejt pjesë e BE. Këta shtete si Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Kosova, M.Zi, Bosnje-Hercagovina përbëjnë

plotësimin e hartës së BE në Ballkan i cili është një nyje lidhëse e rëndësishme. Padyshim që për të arritur këtë lipset kohë dhe refoma rigoroze.

Në BE vendet e Ballkanit kërkojnë të aderojnë për shumë arsye :

Se pari BE është familja e vendeve demokratike me një të kaluar të përbashkët kulturore dhe historike .

Se dyti BE bazohet në vlerat universale si liria, respektimi i të drejtave të njeriut, barazia, shteti i së drejtës, demokracia ,siguria dhe drejtësia.

Se treti ne Europën e bashkuar shtetet nuk do të humbasin identitetin e tyre ,perkundrazi vetë ato do të përbëjnë bazën e nevojshme të ndërtesës së përbashkët.

Zgjerimi i BE me anëtar të rinj ishte dhe mbetet një proces i pakthyeshem.

### **Globalizimi dhe Ballkani**

Globalizimi nuk është vetëm një sfidë zhvillim por edhe një sfidë sigurie. Bota është dhe do të jetë e kërcënuar nga rreziqet globale të cilave gjithnjë e më shumë u duhet kushtuar vëmendje dhe strategji të përbashkët për mbrojtje.

Globalizimi i cituar nga Dirk Messer dhe Franz Nuscheler është kthesa më e madhe ekonomike dhe shoqërore qe prej revolucionit industrial.

Procesi i globalizimit po e shndërron botën në një fshat të madh global dhe problematikat që hasen janë :

\* Mjedisore (ndotja e mjedisit, efekti serë ,carja e shtresës së ozonit)

\* Social – ekonomike (unifikimin e kulturave, kriza e ekonomike (Greqia dhe pasojat e saj).

\* Politike (konflikte etnike) si shembull konflikti Kosove –Serbi sulme sporadike të të rinjve Maqedonas ndaj atyre shqiptarë. Apo diskriminimi që shfaqin përfaqësuesit e Agimit te arte ndaj emigrantëve Shqiptarë në Greqi.

Parimet nga të cilat udhëhiqet BE-ja janë:

➤ Respektimi i identitetit kombëtar të shteteve anëtare, sistemi qeverisës i të cilave bazohet në parimet demokratike;

➤ Respektimi i të drejtave dhe i parimeve themelore siç janë parashikuar nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe siç del edhe nga traditat e përbashkëta kushtetuese dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare.

-Globalizimi dhe konkurenca lokale kufizojnë hapësirën e veprimit për politikën kombëtare dhe shumë probleme mund të trajtohen në mënyrë të përshtatshme vetëm në nivel ndërkombëtar apo rrafsh global (Yzeiri, 2005).

Keshtu integrimi i vendeve të Ballkanit në BE përcaktohet si një përgjigje premtuese për suksesin ndaj sfidave të globalizimit.

Si faze e parë e procesit të globalizimit në Ballkan ishte shpërbërja e ish rep Jugosllave si një shtet shumëkombësh dhe rikthimin në realitetin e etnive.

U krijuan hapësira te reja si : Në Maqedoni midis Shqiptarëve dhe Maqedonasve, në Bsnjë-Hercegovinë midis Kroateve Serbëve dhe Boshnjakeve, në Kosovë kryesisht midis Shqiptarëve dhe Serbeve. Ne Malin e zi midis Malazezëve dhe shqiptarëve.

Kjo prirje e fragmentarizimit të hapësirave lokale ,zbehet jashtëzakonisht shumë nga hyrja e flukseve materiale dhe financiare globale në ekonominë nacionale të vendeve ballkanike.

Duke e parë problemin në këndvështrimin gjeopolitik dhe sociologjik besoj se kjo shpjegon lëkundjen e brendshme të shteteve me ekuilibra të brishtë në Ballkan.

Kjo paqëndrueshmëri që vjen pikërisht nga konfiguracioni i brendshëm i hapësirave gjeopolitike ,ekonomike e demografike Ballkanike, shpreh sfidën e forcave të ndryshme.



Forcë e cila shfaqet përpara vendeve të Ballkanit nëpërmjet procesit të globalizimit dhe të hapjes drejt BE.

-Politika e organizuar sikurse edhe më parë kryesisht në nivel territorial dhe në kuadrin e shteteve kombëtare ka mbetur prapa, në krahasim me ekonominë e organizuar gjithnjë e më shumë në mënyrë ndërkombëtare apo globale e çliruar nga kufijt dhe barrierat.

Prandaj që shteti të ecë përpara në kuptimin ekonomik duhet të integrohet në BE .  
Ekonomia botërore në fund do të bëhet një e vetme kjo e thënë nga ai që konsiderohet si “Babai i Globalizimit”(Naisbitt, 1980).

Ky specialist i ekonomisë theksoi që në 1982 në të ashtuquajturën “Megatrends”per rritjen e shpejtë të Azisë në epokën e informacionit dhe kjo sot është vërtetuar sepse Tigrat e Azisë dhe sidomos, Kina ka rritje dyshifrore në kushtet e krizës së madhe botërore dhe renditet e dyta si ekonomi e fuqishme e botës pas SHBA (Milo, 2002).

Pra Globalizmi nuk është vetëm një sfidë zhvillimi por edhe një sfidë sigurie.

Çlokalizimi industrial ka sjellë këtë zhvillim të vendeve të lindjes së largët dhe e ka shndërruar Paqesorin në një zonë kryesore të ekonomisë botërore.

Fenomeni i globalizimit e ka kthyer ekonominë botërore në hallka që varen nga njëra-tjetra dhe që formojnë zinxhirin e kësaj ekonomie. Globalizimi e ka shndërruar botën në një mekanizëm gjigand ku çdo vend përbën një pjesë të këtij mekanizmi.

Një sfidë tjetër e BE-së është zbehja e konjunkturave ballkanike nëpërmjet frymëzimit dhe mbështetjes së integritimit rajonal. Ballkani në periudhen para viteve 2000 ishte një burim krize dhe gjeneronte një situatë konfliktuozë.

-Marrëveshja e Dejtonit kishte mbyllur përkohësisht një vatër krize por nuk kishte eliminuar faktorët që i nxisin ato, nacionalizmat e egër, primitivë, shovinizmin, urrejtjen etnike dhe nacionale.

-Një sfidë jo e vogël është edhe zbatueshmëria e rezolutës 1244 per Kosovën si dhe të marrëveshjes së fundit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të cilat ose do ti japin zgjidhje përfundimtare konflikteve në ballkan ose do ti mbajnë edhe për shumë kohe larg nga qëllimet e dëshiruara popujt e këtyre vendeve. <sup>1</sup>

2- E ardhmja e BE-së dhe problematikat

Në një të ardhme pak a shumë të afërt pa dyshim numri i antarëve të BE-së do të dyfishohet dhe kjo rritje do të shoqërohet me:

#### ❖Veshtiresite e shumta.

E ardhmja e vendeve te ballkanit ne BE ku bëhet fjalë për më shumë se 170 mln banorë përfshirë këtu edhe Turqinë, vetëm sa do të shtojë peshën dhe ndikimin e BE-së në botë dhe do të zhvillojë shkëmbimet brenda bashkësisë. Por probleme te shumta do te dalin për shkak të një gjendje ekonomike shumë të prapambetur si në: bujqësi tradicionale, industri pak e zhvilluar, struktura të vjetëruara.

#### A.Rritja e karakterit heterogjen.

Analiza e PNB-së për frymë ose PBB është më e ulët tek vendet e Europës Juglindore(Shqipëria ,Bosnja) etj me perjashtim të Maltës e Qipros.

#### B.Probleme bujqësore.

Çmimet e produkteve bujqësore të VEQL janë më të ulta se të BE-së.

Konkurenca e produkteve Mesdhetare për shkak të hyrjes se Turqisë.

#### C. Problemet financiare.

<sup>1</sup>“ Rreziqet, ndryshimet dhe perspektivat e Ballkanit” Strasburg 2001

Një ekonomi e tregut funksionale që është e aftë të ballafaqohet me presione konkurruese në kuadër të tregut unik duke përfshirë arritjen e objektivave politik, ekonomik dhe monetar duhet të përballojë shtimin e barrës financiare (si për vendet perëndimore të BE-së si për Francën Gjermaninë dhe si rasti i Greqisë etj.) (Shala, 2012).

#### D. Probleme njerezore.

Kërkimi i një vendi pune dhe joshja nga një mbrojtje sociale më e mirë mund ti bëjë shumë punonjës të emigrojnë drejt vendeve të Evropës Perëndimore duke përfituar nga qarkullimi i lirë.

#### E. Probleme politike.

Siç janë përplasjet: Greqi ,Turqi lidhur me Qipron e ndarë që nga pushtimi veriut nga Turqia.

Por faktori politik ka një rol mjaft të rëndësishëm edhe në zhvillimet që e pasojne-atë në rastin e ushtrimit të një funksioni mjaft potent social, siç është ai i pushtetit. Në mjaft raste janë evidentuar role pozitive dhe negative në ushtrimin e një funksioni të tillë në hapësirën sociogjeografike. Zhvillime negative të pranishme në hapësirën gjeografike kanë konsistuar në shfaqjen e largimeve të popullsisë nga një territor caktuar, duke bërë të mundur edhe humbjen e rëndësisë së vendeve të ndryshme sociale të pranishme në këtë territor. Po kështu ndikime negative në hapësirën sociale janë edhe diskriminimet e ndryshme politike, të cilat janë shfaqur kryesisht në hapësirat sociogjeografike ku funksioni i pushtetit është prezent në zhvillimet e një demokracie të brishtë (Akhemi, 2008).

Lind pyetja: Në këto kushte para kaq shumë problemesh për të ardhmen e BE-së ,përse duhet të shkohet drejt zgjerimit?

-Në lidhje me lëvizjen e lirë pa viza vihet re një keqmenaxhim i lejeve për azil politik sidomos nga shtetas (serb, maqedonas, shqiptar).

Anët pozitive të gjendjes që vihen re tek vendet e Ballkanit janë:

Se pari : Në historinë e rajonit nuk ka patur rrezik real për konflikte masive në këto 10 vitet e fundit.

Së dyti: Të gjitha vendet e Ballkanit kanë bërë përparime të dukshme dhe në instalimin e shtetit të së drejtës,të demokracisë dhe të konsolidimit të institucioneve .

Se treti: Të gjitha vendet e rajonit kanë patur zhvillime të shpejta ekonomike jo vetëm rritje e prodhimit por edhe inpakt direkt në sektorin e ekonomisë.

Është e padiskutueshme që të gjitha vendet e rajonit në mënyrë direkte ose indirekte janë ndikuar fuqishëm nga aftësia gjeografike e BE-së në promovimin e stabilitetit politik dhe të rritjes ekonomike me anë të shumë instrumentave. *Çdo popull ka nevojë për hapësirë. Pikërisht nga kjo rrjedhin konfliktet midis popujve të ndryshëm dhe prirjet për ekspansion territorial, i cili paraprihet gjithmonë paraprakisht nga ekspansioni tregtar*”(Revista Gjeopolitika, 43).

Perpjekjet e BE-së për rritjen e shkallës së bashkëpunimit rajonal në sektorin e ekonomisë përfaqësohen nga qasje të reja në shekullin e XXI ndaj sfidave me të cilat rajoni përballet. Mendoj që grupimi i vendeve sipas sistemit të rajonizimit NUTS , nxjerrjes së përbashkët të statistikave dhe ,hartimit të përbashkët të projekteve rajonale do të sillte përfitime dhe mjete financiare nga KE për politikën e zhvillimit rajonal.

Studimi i konceptit “sektor terciar i ekonomisë” kërkon para së gjithash përcaktimin e hapërisës gjeografike ku ai do të realizohet. Ndryshimet e shpejta ekonomike, politike, sociale, etnokulturore e mjedisore janë duke u përjetuar me intensitet në mënyrë globale.

“Globalizimi i shpejtë i ekonomisë botërore nëpërmjet shtrirjes së kapitaleve, teknologjive dhe informacioneve ka sjellë dhe po sjell ristrukturimin e përgjithshëm të shumë hapësirave gjeografike” (Qirjazi, 1999).

### **Misioni i BE-së në shek XXI**

“Banka Evropiane për investim ka si mision të ndihmojë në zhvillimin e ekuilibruar dhe pa përplasje të tregut të përbashkët. Në interes të bashkësisë (neni 130i Traktatit të BEE-se), ku të privilegjuar janë projektet për zhvillim rajonal dhe zvogëlimi i çekuilibrave rajonal është një nga qëllimet themelore të traktatit të BEE-së (Yzeiri, 2008).

Ajo financon modernizimin e infrastrukturave të ndryshme si: rrugë, rrjete telekomunikacioni, ujësjellësa, centrale elektrik. Sipas të dhënave të EUROSTAT vjetari 2000 ndihma më të mëdha financiare merr fusha e bashkëpunimit.

### **Perspektiva Europiane e Ballkanit**

Ballkani tashmë ka hyrë në një faze kreu tjetër nga ajo që jemi mësuar të shohim; popujt tanë po bashkëtojnë me njeri tjetrin dhe kultura, arti, muzika, veshjet, gjuha, kanë ndersjellë vlera të përbashkta dhe ngjashmëri të padiskutueshme.

Vetëm këta 20 vite ballkanasit kanë emigruar në të gjithë botën dhe kryesisht në Europë dhe tashmë ata bashkëtojnë si europianë. Një nga problematikat sociale sot janë dyndjet e ndërsjellta në të gjithë botën, falë lirive të individit dhe thyerjen e kufinjve, apo lëvizjes së lirë. Edhe Ballkani si më i vonuar në këtë aspekt për shkak të lufrave dhe të nacionalizmave ekstremist, tashmë po shpëtohet nga primitizimi i kufinjve dhe izolimit dhe po lëviz i lirë. Kufinj të tashmë rrinë vetëm në kuptimin institucional. të sovranitetit teritorial ti garantuar nga konventat ndërkombtare, por në kuptimin e lëvizjes, tregut dhe shkëmbimeve nuk ka më kufinj.<sup>2</sup>

Rëndësi e vecantë i kushtohet krijimit të zonave të shkëmbimit të lirë, hartimit të projekteve për të siguruar energji të pastër dhe mbrojtje të përbashkët të mjedisit.

### **Pritshmëritë e BE-së në shekullin XXI janë:**

- 1- Vazhdimi i zbatimit të manovrës së tregëtisë së lirë (CEFTA)
- 2- Ngritja e shteteve të ballkanit mbi ndasitë etnike ku këtu perfshihet (mbyllja e konflikteve, promovimi i frymës së tolerancës dhe mirëkuptimit).
- 3- Nxitje e progresit ekonomik dhe shpëputje nga e kaluara
- 4- Realizimi i integritetit Europian të shteteve të ballkanit para se ti rrezikojë globalizimi arritjet e tyre.
- 5- Restaurimi i dinjitetit dhe krenaria e të qenit banor i Ballkanit duhet të përbëjë bazën e procesit të integritetit të Ballkanit në BE.
- 6- Hartimi i projekteve të përbashkëta dhe vlerësim e zgjidhje të problematikave në kuadër rajonal është rruga e vetme që vendet e Ballkanit të ecin përpara.

---

<sup>2</sup>Enis Sulstarova <http://www.e-zani.com/2013/04/01/mbi-nacionalizmin-shqiptar-sot-kombi-si-projekt-100-vjet-pas-shpalljes-se-pavaresise/>

## Summary

The European Union is a family of democratic countries with a common cultural and historical past. It is based on universal values such as freedom, respect for human rights, equality, rule of law, democracy, security, justice.

In the European Union nations will not lose their identity, contrary separately they will form the basis necessary to building the joint. The European Union is facing the challenge of globalization.

The process of globalization is shendron world into a large global village and the problems encountered are those:

- 1 - Environment (pollution, greenhouse effect, ozone layer rift)
- 2 - Social and economic (unification of cultures and economic crisis)
- 3 - Political (ethnic conflicts, etc.)

Globalization and local competition limit the action space for national policy and many problems can be treated adequately only at the international level or global scale. Thus, European integration is defined as a promising answer to the challenges of globalization success. Organized policy as previously mainly territorial level and in the framework of national states is lagging behind compared to the organized economy increasingly global international order or free from boundaries and matter.

Another challenge the EU is changing the concept of balkanization through inspiration and support to regional integration. It is not disputed that all the achievements of the region, directly or indirectly, are strongly influenced by geographic ability of the EU in promoting political stability and economic growth through more indstumentave.

EU efforts to increase the level of cooperation at the regional level in the sector of the economy search:

1-To move forward should the region's ability to compete with other parts of the globe in terms of economic and social development.

2-Regional need for a new concept for unified institutionally states.

This process should aim at economic and social development as a joint project of the country in the region.

Through the system of regionalization (NUTS), issuing the joint statistics of the countries of the region and subregions brings the experience of the EC Financial means for rajoral development policies. Restoration of dignity and pride of being a resident of the Balkans should form the basis of the process of eradicating the Balkan old ideas.

## Bibliografi

- Yzeiri, E. (2005). "Gjeografia Politike", Tiranë.
- Naisbitt, J. (1980). "Megatrends".
- Milo, P. (2002). "Bashkimi European", Tirana.
- " Rreziqet, ndryshimet dhe perspektivat e Ballkanit" Strasburg 2001
- Shala, A. (2012). "Shëndrrimi i rritjes ekonomike në zhvillim", Prishtinë.
- Axhemi, S. (2008). "Gjeografia Sociale", Tiranë.
- Revista "Gjeopolitika" fq.43
- Qiriazhi, P. (1999) "Probleme të zhvillimit aktual në botë e në Shqipëri dhe ndihmesa e studimeve gjeografike regjionale për zgjidhjen e tyre, Studime Albanologjike" Tiranë.
- Yzeiri, E. (2005). "Gjeografia Rajonale", Tirane.
- Enis Sulstarova <http://www.e-zani.com/2013/04/01/mbi-nacionalizmin-shqiptar-sot-kombi-si-projekt-100-vjet-pas-shpalljes-se-pavaresise/>

## Sistemi evropian i mbrojtjes së të drejtave të njeriut

**Skerdilajd Bajramaj**  
Specialist Kabineti, KESH SH.A

### Abstrakt

Studimi ka si objekt trajtimin që i behet çështjes së të drejtave të njeriut nga një këndvështrim juridiko-institucional dhe filozofik. Mbrojtja e të drejtave të njeriut ka qenë temë kulmore në arenën ndërkombëtare menjëherë pas Luftës së II Botërore, e cila përfaqësoi edhe shkeljen më flagrante dhe çnjerëzorë të këtyre të drejtave. Hapat e parë të mbrojtjes institucionale dhe juridike të këtyre të drejtave i gjejmë në sferën globale.

Akti i pare dhe më i rëndësishmi është “Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut” e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB, e cila i hapi rrugën edhe sistemeve, më të vogla rajonale dhe më të detajuara, që kishin në fokus mbrojtjen e këtyre të drejtave. Ajo që na intereson në veçanti në këtë punim është studimi i sistemit evropian, pjesë e të cilit është edhe vendi ynë.

Analiza do të fokusohet në veçoritë që karakterizojnë mbrojtjen e këtyre të drejtave në kuadrin rajonal evropian. Do të shohim se si funksionon sistemi evropian i mbrojtjes së këtyre të drejtave. Më pas do të kalojmë në analizimin juridik dhe filozofik të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Një vend të rëndësishëm në këtë studim zë edhe roli që ka luajtur dhe luan Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut për mbrojtjen faktike të këtyre të drejtave si dhe interpretimi korrekt i këtyre vendimeve nga ana e shteteve anëtare. Këtu do të shohim dhe ndikimin e vendimeve të saj në Republikën e Shqipërisë dhe natyrën e këtyre vendimeve. E gjithë analiza do të shoqërohet edhe me disa konkluzione që shpresoj të pasurojnë sado pak vlerat e doktrinës së të drejtave të njeriut në vendin tonë.

### Hyrje

Një ndër aktet e para në Evropë që rilindi nga gërmadhat e Luftës së II Botërore, dhe kishte në përmbajtjen e tij një referim solemn tek principi i dinjitetit njerëzor, ishte Ligji themelor i Republikës Federale Gjermane. Ky princip u adoptua edhe nga hyrja e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ku theksohet se: “Bashkimi ngrihet mbi vlera të pamohueshme dhe universale të dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë dhe solidaritetit” dhe nga neni I-2 i të sapo lindurës “Kushtetutë Evropiane”, sipas së cilës: “Bashkimi ngrihet mbi vlera që respektojnë të drejtat e njeriut, liritë, demokracinë, barazinë, shtetin e së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që ju përkasin pakicave”. Një mënyrë solemne për tu kujtuar popujve të Evropës, që vlerat tek të cilat ngrihet procesi i bashkimit të kontinentit plak, rrjedhin nga kujtesa e të këqijave absolute të kampeve të përqendrimit dhe jo vetëm, si dhe të kapërcimit të mitit të mos kushtëzimit të sovranitetit të shtetit, nga kufizime me karakter etik.

Sot ndarja bipolare e skenës ndërkombëtare, që ekzistonte në kohën e miratimit të Deklaratës Universale, është shuar pothuajse fare. Rënia e komunizmit dhe përhapja e gjerë e “vlerave demokratike”, dukeshin si të dhënat e nevojshme për të përhapur në shkallë globale fjalorin e të drejtave të njeriut. Fundi i “luftës së ftohtë”, kishte nxjerrë në plan të parë, probleme politike, natyra etnike e të cilave ishte evidente. Çështje si të drejtat

e njeriut, ndërhyrjet humanitare, trajtimi i refugjatëve, mbrojtja e ambientit në proceset e zhvillimit ekonomik, po dilnin me forcë në planë të parë si tema qendrore të axhendës politike ndërkombëtare, pasi për pesëdhjetë vjet me radhë kishin qenë sakrifikuar në emër të interesave gjeopolitike të dy superfuqive. Dukej sikur për herë të parë në historinë e njerëzimit nuk ekzistonin më ndarje ideologjike të rëndësishme, me pak fjalë asnjë gjë që nuk mund të ndreqej ndërmjet popujve të globit.

Sistemi<sup>1</sup> i OKB për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, është një sistem universal parë edhe nga numri shumë i madh i vendeve anëtare që janë pjesë e saj. Rrjedhimisht, zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i këtij sistemi, ka qenë shumë i vështirë, pasi numri i madh i vendeve anëtare, bënë që vendimmarrja për këto probleme të jetë shumë e vështirë. Nga ana tjetër, edhe qëndrimet e ndryshme ideologjike midis shteteve apo grupeve të shteteve e vështirësojnë më tej këtë proces.

Një arsye tjetër që vështirëson procesin e arritjes së një konsensusi ndërmjet vendeve në nivel global është dhe ndryshueshmëria ndërmjet sistemeve juridike që konsiston kryesisht në një trashëgimi të ndryshme juridike. Për këto arsye mbrojtja e të drejtave të njeriut është zhvilluar me tej në kontekstet rajonale, duke përfshirë një numër më të vogël shtetesh, të cilat i bashkon e njëjta trashëgimi ligjore dhe kulturore. Të drejtat e njeriut në nivel global, përfaqësojnë shkallën më të vogël të konsensusit të arritur ndërmjet shteteve, ndërsa në nivel rajonal është disa herë më e lartë. Krijimi i sistemeve rajonale ka bërë të mundur që shtetet të mund të zhvillojnë standarde më të larta për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në raport me sistemin universal, duke ju përshtatur më mirë karakteristikave rajonale. Zhvillimi i këtyre sistemeve sot ka një rëndësi të veçantë, pasi gjatë dekadave të fundit, të drejtat e njeriut janë element thelbësor i marrëdhënieve ndërkombëtare, ndërmjet shteteve, duke përbërë kështu bazën e këtyre marrëdhënieve.

Nga një këndvështrim tjetër, në këtë situatë paralele të krijuar nga ekzistenca e sistemeve rajonale dhe atij universal, lind edhe problemi i dualizmit të kompetencës lidhur me sistemet e ankimimit dhe shqyrtimit të tyre në raport me shtetet që janë palë njëkohësisht në sistemet rajonale dhe ato globale. Lidhur me këtë çështje është e rëndësishme të sjellim ndërmend që organet e sistemeve rajonale dhe ato të OKB përjashtojnë kompetencat e njëra tjetrës dhe këshillohet që një subjekt që ka vendosur të bëjë një ankim, të fillojë me nivelin rajonal dhe më pas me atë universal. Megjithatë mund të ketë raste kur mund të drejtohem një organi të OKB sesa një sistemi rajonal.

### Sistemi Evropian

Sistemi Evropian në fakt përbëhet nga tre sisteme të ndryshme të përbëra nga një numër i madh instrumentesh dhe organesh në kuadër të: Këshillit të Evropës (KE), Bashkimit Evropian (BE) dhe Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE). Sigurisht, këto tre organizma janë të lidhura me njëra tjetrën dhe deri më tani është konfirmuar se sistemi i krijuar në këtë kuadër të Këshillit të Evropës ka krijuar një pozitë epërsie në raport me dy sistemet e tjera, sidomos me sistemin në kuadër të Bashkimit Evropian. Megjithatë duke u trajtuar në një kontekst rajonal dhe duke pasur parasysh edhe ndërlidhjen dhe ndërvarësinë jo vetëm teorike, por edhe praktike që ekziston midis këtyre tre sistemeve, ndër të tjera edhe për lehtësi studimi do të identifikohen me emrin Sistemi Rajonal Evropian. Ky sistem i sotëm rajonal, është rezultat i një procesi të gjatë historik gjatë të cilit të drejtat e njeriut ishin fillimisht si të drejta të qytetarit dhe të drejta të pakicave në nivel kombëtar.

<sup>1</sup>Shih Tekstin e Deklatates Universale

Natyrisht, Këshilli Evropës është organizata më e rëndësishme që u krijua pas Luftës së Dytë Botërore dhe që synonte parandalimin e konflikteve dhe mizorive të përjetuara gjatë luftërave botërore, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit të bazuar në sundimin e së drejtës, të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe të demokracive pluraliste të përcaktuara në nenin 3 të Traktatit Themelues të KE. Nga ana tjetër, parimi i demokracisë konsiderohet pjesë e trashëgimisë evropiane. Ky qëndrim gjen pasqyrim edhe në tekstin e KEDNJ<sup>2</sup>, sipas të cilëve të drejtat e garantuara si p.sh. e drejta e jetës private dhe e familjes, liria e mendimit, besimit fetar, liria e shprehjes dhe organizimit mund të kufizohen vetëm kur *inter alia* janë të parashikuara në ligj dhe këto kufizime janë të nevojshme për një shoqëri demokratike. Megjithëse mandati i Këshillit të Evropës është shumë i gjerë, ai nuk përfshin mbrojtjen ushtarake. Ndërkohe mandati i KE për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është përcaktuar në Traktatin e Themelimit të KE<sup>3</sup> dhe gjen pasqyrim si prioritet në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, së bashku me 14 protokollat shtesë si dhe në disa instrumente të tjerë ligjor, ku vlen të veçohet Karta Sociale Evropiane e ndryshuar dhe protokollat shtesë, Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor dhe Degradues, Konventën Kuadër Evropiane për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare etj. Përveç këtyre instrumenteve ligjore, si bazë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë dhe shumë rekomandime dhe rezoluta të miratuara nga KE, duke përfshirë dhe instrumente të tjerë ligjore që në mënyrë indirekte kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, sidomos traktatet e bashkëpunimit në fushën e drejtësisë penale, të cilat jo vetëm lidhen me këto të drejta, por përmbajnë edhe klauzola që synojnë mbrojtjen e tyre.

### Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

KEDNJ ka hyrë në fuqi në vitin 1953. Sistemi aktual që parashikon Konventa, daton vitin 1998, kohë kur hyri në fuqi Protokollin nr. 11, i cili ndryshoi sistemin e kontrollit duke unifikuar funksionet e Komisionit Evropian me atë të Gjykatës Evropiane. Kjo e fundit është organi i vetëm kontrollues që ka mandat të shqyrtojë dhe të shprehet lidhur me ankesat e individëve përfshi personat juridik, sipas Konventës<sup>4</sup> si dhe shteteve palë. Protokollat shtesë konsiderohen pjesë e Konventës për të gjitha shtetet anëtare të KE që i kanë ratifikuar ato. Konventa përbëhet nga 59 nene, dhe tashme janë hartuar 14 protokolle shtesë.

- Protokollat 1,4,6,7,12 dhe 13 kanë zgjeruar listën e të drejtave,
- Ndërsa protokollat 2,3,5 dhe 8 kanë modifikuar mekanizmin mbikëqyrës,
- Protokollin 9 u njohu individëve të drejtën e paraqitjes së ankesave individuale,
- Ndërsa Protokollin 10 u zëvendësua nga Protokollin 11, i cili hyri në fuqi në Nëntor 1998 dhe ndryshoi tërësisht mekanizmin e kontrollit.
- Protokollin 12 bënë ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit,
- Protokollin 13 bënë heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat.

Konventa ligjërisht përfaqëson një kartë të vërtetë kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore politike dhe civile. Si rrjedhojë të gjitha shtetet palë që kanë ratifikuar Konventën dhe protokollat shtesë, janë të detyruara të zbatojnë dhe garantojnë të drejtat dhe liritë themelore si vijon: të drejtën e jetës, lirinë nga tortura dhe ndonjë trajtim çnjerëzor, lirinë

<sup>2</sup> Shih Nenet 8-11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

<sup>3</sup> Shih Neni 3 i Traktatit të Themelimit të KE

<sup>4</sup> Shih neni 34 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

nga skllavëria dhe robëria si dhe nga puna e detyrueshme, apo e imponuar me dhunë, të drejtën për liri dhe siguri, të drejtën për një proces të rregullt ligjor të zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm për çështje civile dhe penale, lirinë nga dëbimi i pabazuar në ligj, të drejtën e respektimit të jetës private, familjare, të paprekshmërisë së banesës dhe të korrespondencës, lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit, lirinë e shprehjes, duke përfshirë lirinë e shtypit, lirinë e tubimeve paqësore dhe të organizimit së bashku me të drejtën e krijimit dhe pjesëmarrjes në sindikata, të drejtën për martesë dhe për krijim të familjes; të drejtën për mjete të efektshme ankimi, lirinë nga diskriminimi, të drejtën për arsim, të drejtën e pronës, të drejtën për zgjedhje të lira, lirinë e lëvizjes, të drejtën për të mos u ndaluar për borxhe, të drejtën për tu zhdëmtuar në rast gabimi gjyqësor, të drejtën për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale, të drejtën e barazisë ndërmjet bashkëshortëve dhe të drejtën e apelit në çështjet penale. Megjithatë mund të kemi rastin kur shtete të caktuara vetëm kanë nënshkruar një ose disa protokolle, por nuk i kanë ratifikuar ato dhe lind pyetja nëse këto shtete janë të detyruara për të respektuar këto protokolle apo jo? Në këtë rast, vlen të theksohet që të gjitha shtetet anëtare në bazë të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve, janë të detyruar të mos ndërmarrin masa që çenojnë thelbin e këtyre protokolleve deri në momentin e shprehjes përfundimtare të vullnetit për ti ratifikuar ose jo.

KEDNJ i është nënshtruar ndryshimeve të vazhdueshme të realizuara nëpërmjet miratimit të protokolleve shtesë, por një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Gjykata ndonëse etiketohet si shumë konservatore, falë angazhimit të saj maksimal për një mbrojtje sa më efektive të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Konventë dhe në protokollin shtesë, ka bërë të mundur që nëpërmjet një interpretimi të zgjeruar të dispozitave në një mënyrë të vazhdueshme ka siguruar një mbrojtje efektive të të drejtave dhe lirive dhe ka siguruar njëkohësisht zbatimin e të gjitha vendimeve të saj.

Konventa përmban kryesisht të drejta civile dhe politike. Megjithatë për disa studiuës, Konventa përmban edhe disa të drejta me karakter ekonomik e social si: e drejta e pronës, e drejta për arsim dhe e drejta e organizimit që duke bërë një paralelizëm me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturorë. Këto të drejta klasifikohen si të drejta me karakter jo vetëm politik por dhe civil, por edhe ekonomik social dhe kulturor. Ndërsa disa studiuës të tjerë e kufizojnë katalogun e të drejtave dhe lirive të Konventës si të drejta civile dhe politike plus të drejtën për arsimim duke lënë jashtë të drejtën e organizimit dhe të drejtën e pronës. Kjo e fundit është thellësisht sa politike aq dhe ekonomike, etj. Për më shumë informacion lidhur me të drejtat dhe liritë që parashikon KEDNJ, do shohim më nga afër se si ajo funksionon.

### **Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)**

Deri në vitin 1998, në kuadër të GJEDNJ mekanizmi kontrollues përbëhej nga komisioni për të Drejtat e Njeriut i krijuar në 1954 dhe që pushoi së ekzistuari në 1999 dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me hyrjen në fuqi të Protokollit 11, këto dy organe u shkrinë në një të vetëm, në GJEDNJ. Gjykata është mjete kryesor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Evropë, e cila ka një juridiksion të detyrueshëm për të gjitha shtetet anëtare të KE. Numri i gjyqtarëve është i barabartë me numrin e vendeve që janë palë kontraktuese të Konventës dhe i ashtuquajturit Gjyqtari Kombëtar në shqyrtimin e një çështjeje kundra shtetit nga i cili ai është, përfshihet në proces vetëm për të lehtësuar të kuptuarit e legjislacionit kombëtar. Sidoqoftë, gjyqtarët pasi të emërohen veprojnë vetëm



në cilësi personale dhe jo si përfaqësues të shtetit. GJEDNJ, pranon ankime nga shtetet palë kontraktuese dhe nga çdo person, OJQ, ose grup që pretendon që është viktimë Neni 34.

Numri aktual i gjyqtarëve të GJEDNJ është i barabartë me numrin e vendeve anëtare të KE që janë palë e Konventës. Gjyqtarët zgjidhen nga Asambleja Parlamentare. Gjyqtarët zgjidhen për një mandat prej 6 vjetësh me të drejtë rizgjedhje, por ky mandat mbaron qoftë edhe përpara me mbushjen e moshës 70 vjeç, ose kur japin dorëheqje dhe brenda 3 vjetësh për gjyqtarët e zgjedhur në zgjedhjen e parë<sup>5</sup> ose me anë të revokimit kur 2/3 e gjyqtarëve të tjerë vendosin që një gjyqtar nuk i përgjigjet kushteve të kërkuara (Neni 24 i Konventës). Gjyqtarët duhet të kenë moral të lartë dhe të jenë juristë me kontribut të shquar dhe mandati i gjyqtarit është i papajtueshëm me çdo lloj veprimtarie që cënon paanësinë, pavarësinë, dhe mundësinë për një veprimtari me kohë të plotë. Çdo çështje që lidhet me këto kritere zgjidhet nga gjykata<sup>6</sup>.

Gjykata gjykon me një komitet prej tre gjyqtarësh, Dhoma prej 7 anëtarësh, Komiteti prej 5 gjyqtarësh të Dhomës së Madhe dhe Dhoma e Madhe prej 17 gjyqtarësh. Krahas gjyqtarëve, Gjykata ka dhe administratën e cila në 30 Qershor 2002 numëronte afërsisht 348 punonjës nga të cilët 187 ishin të punësuar me kohë të plotë (përfshi 76 avokatë) dhe 161 punonjës të punësuar me kontrata të përkohshme (përfshi 78 avokatë). Gjykata ka buxhetin e saj, i cili zë 17,6% të buxhetit të KE dhe përllogaritet afërsisht në 29,8 milion Euro.

### Interpretimi i vendimeve të GJEDNJ

Vendimet përfundimtare janë të detyrueshme dhe zbatimi i tyre mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave të KE-së. Në çdo rast, Gjykata kundrejt kërkesës së Komitetit, ka të drejtë ti paraqesë këtij të fundit këshilla juridike ose mendime këshilluese që lidhen me interpretimin e Konventës dhe protokolleve të saj. Deri me sot, nuk ka asnjë vendim të gjykatës i cili nuk është zbatuar sepse sanksionet që mund të zbatohen ndaj vendeve që nuk zbatojnë vendimin janë shumë të ashpra dhe përmbajnë një kosto shumë të lartë për to.

Për vendimet që përmbajnë dëmshpërblim të drejtë për palën e dëmtuar, qeveria i ngarkon Ministrisë së Financave ose ministrisë kompetente që i korrespondon asaj për lëvrimin e fondeve dhe ekzekutimin e vendimit. Nga ana tjetër, në kushte normale kur vendimi deklaron shkelje të konventës si pasojë e mospërputhjes së dispozitave ligjore të brendshme të Konventës, shteti në fjalë duhet të ndërmarrë hapat e duhur për eliminimin e shkaqeve që kanë çuar në shkeljen e Konventës dhe të protokolleve të saj.

Vendimet ndonëse nuk kanë vlerë *erga omnes* sigurisht që shërbejnë për të gjykuar lidhur me interpretimin e dispozitave të Konventës dhe/ose protokolleve shtesë dhe papajtueshmërinë e tyre me legjislacionin e brendshëm të një shteti kontraktues. Nga kjo pikëpamje vendimet e Gjykatës duke qenë se kanë karakter detyrues, duhet të merren parasysh nga gjykatat kombëtare në rastet kur shtrohen probleme pajtueshmërie apo interpretimi të ligjeve të brendshme në raport me Konventën. Ky qëndrim është i drejtë, pasi gjykata është organi i vetëm kompetent për interpretimin dhe zbatimin përfundimtar të Konventës dhe epërsia e vendimeve të saj lidhur me vendimet e gjykatave kombëtare, legjitimon përdorimin e praktikës së kësaj gjykate gjatë procedimeve kombëtare. Kuptohet

<sup>5</sup>Shih Neni 23 i Konventes Evropiane per te Drejtat e Njeriut.

<sup>6</sup>Shih Neni 21 i Konventes Evropiane per te Drejtat e Njeriut.

që vendimet që caktojnë dëmshpërblime të drejta nuk mund të merren parasysh për sa i përket masës së shpërblimit, e cila është objekt i gjykimit rast pas rasti nga Gjykata, e cila shqyrton për këtë qëllim një tërësi faktorësh.

Ndryshe qëndron çështja kur një vendim i GJEDNJ konstaton shkelje të KEDNJ, të shkaktuar nga një vendim përfundimtar i gjykatave kompetente kombëtare. Në këtë rast, shtrohet për diskutim çështja e efekteve që ky vendim do të ketë mbi vendimin e formës së prerë të gjykatës kombëtare, pasi shteti duhet të ndërmarrë patjetër hapat e duhur për eliminimin e gjendjes që ka shkaktuar dhunimin e Konventës, pavarësisht se kush është shkaktari i dhunimit. Në shumë vende kjo situatë e komplikuar ligjore, nuk gjen rregullimin e duhur ligjor. Në disa vende legjislacioni i brendshëm është ndryshuar për t'ju përshtatur kësaj situatë dhe qëndrimet mbështesin një qëndrim pothuajse të njëjtë, që një vendim i GJEDNJ mund të shërbejë si shkak për një gjykim *de novo* të çështjes (rishikimin e çështjes). Në disa vende të tjera si Spanja, vendimi i gjykatës kompetente kombëtare në kundërshtim me KEDNJ konsiderohet si shkelje e rendit kushtetues dhe për rigjykimin e çështjes vendos Gjykata Kushtetuese me kërkesë të palës. Ndërsa në Zvicër, konstatimi i shkeljes së GJEDNJ është shkak për rishikimin e vendimit, i cili është marrë në kundërshtim me KEDNJ, me qëllim që të kurohet (eliminohet) shkelja e konstatuar nga GJEDNJ.

### Shqipëria si palë e GJEDNJ

Në lidhje me këtë problem, legjislacioni i Republikës së Shqipërisë duhet të rishikohet me qëllim përshtatjen e tij me rastin kur vendimi i GJEDNJ konstaton shkelje të KEDNJ të shkaktuar nga një vendim i formës së prerë të dhënë nga një gjykatë kompetente kombëtare, pasi ndonëse RSH ka pranuar juridiksionin e Gjykatës dhe karakterin detyrues të vendimit të saj (legal binding) nuk parashikohet mënyra se si duhet të reflektojë sistemi i brendshëm lidhur me vendimin e formës së prerë, i cili është marrë në kundërshtim me KEDNJ. Konkretisht, legjislacioni ynë penale<sup>7</sup> duhet të parashikojë si rast rishikimi edhe rastin kur GJEDNJ ka konstatuar shkelje të Konventës të shkaktuara nga një vendim i formës së prerë, i cili është marrë nga një gjykatë kompetente kombëtare. Në të njëjtën formë edhe Kodi i Procedurës Civile<sup>8</sup>, duhet të parashikojë si rast për rishikim një vendim të formës së prerë, vendimin e GJEDNJ i cili i referohet një vendimi të formës së prerë të gjykatave shqiptare. Në të dy rastet, Gjykata e lartë duhet të vendosë rishikimin e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rishikim gjykatës ku është konstatuar shkelja, por në rastin e RSH ose në raste të ngjashme kur hallka e fundit e ankimit është vetë Gjykata Kushtetuese si shkallë e katërt, ankimi për çështjet që lidhen me shkeljen e të drejtave të parashikuara në Konventë dhe në protokollat shtesë, për rishikimin e vendimit duhet të vendosë kjo e fundit dhe më pas Gjykata e Lartë do të vendosë kalimin e çështjes për rishikim, gjykatës ku është konstatuar shkelja.

Kjo është një logjikë e drejtë dhe duke pasur parasysh faktin që Kushtetuta<sup>9</sup> jone e thërret në mënyrë të drejtpërdrejtë KEDNJ duke e bërë atë pjesë të saj. Rrjedhimisht, çdo shkelje e KEDNJ duhet të konsiderohet si shkelje e rendit kushtetues njëlloj siç bënë dhe Spanja. Duke ndjekur këtë logjikë, për një kohë të gjatë në mungesë të rregullimit të duhur ligjor, kur KEDNJ konsiderohet pjesë e Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese, duhet të shkarkojë

<sup>7</sup>Shih Neni 450 i K.Pr.P

<sup>8</sup>Shih Neni 494 i K.Pr. C

<sup>9</sup>Shih Paragrafi 2, Neni 17 i Kushtetutës R.Sh.

si antikushtetues një vendim (të saj si shkalla e fundit e ankimit) që ka shkaktuar një dhunim të Konventës ose të protokolleve të saj dhe t'ia dërgojë çështjen Gjykatës së Lartë e cila të vendosë për kalimin e çështjes gjykatës ku është konstatuar shkelja për kurimin e saj. Në këtë mënyrë, teorikisht vihet në pikëpyetje parimi i *res judicata*, aq më pakë kur Gjykata Kushtetuese duhet të hedhë poshtë një vendim të saj.

Megjithatë, ky fakt nuk duhet të shërbejë si shkas për mos rishikimin e vendimit, pasi interesi madhor i drejtësisë dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, e justifikon një qëndrim të tillë. Sidoqoftë, në kushtet e mungesës së rregullimit të duhur ligjor, zgjidhja më e mirë do të ishte ndërmarrja e iniciativës legjislative dhe ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale dhe të Procedurës Civile në mënyrë që të parashikohet si shkak për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, rastin kur vendimi i GJEDNJ konstaton shkelje të KEDNJ dhe protokolleve shtesë të saj, të shkaktuar nga një vendim i formës së prerë i dhënë nga një gjykatë kompetente. Ndryshimi i këtyre neneve është pjesë e detyrimeve të marra nga RSH-së me bërjen palë e KEDNJ dhe protokollet shtesë të saj si dhe anëtarësimin në BE dhe është një hap i domosdoshëm për përafrimin e legjislacionit vendas me KEDNJ dhe aktet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në të gjitha rastet e tjera çështja duhet të zgjidhet në favor të të dëmtuarit.

Ndaj Republikës së Shqipërisë nga viti 1998 deri në 2007 janë paraqitur në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut 204 ankesa nga të cilat 94 janë deklaruar të papranueshme ose janë çregjistruar, 40 i janë komunikuar qeverisë, 9 janë pranuar për shqyrtim, dhe për 10 ankime është dhënë vendim. Nga ky numër, në 8 vendime Gjykata ka konstatuar të paktën një dhunim të të drejtave dhe lirive themelore të mbrojtura nga Konventa dhe protokollet shtesë, për një rast<sup>10</sup> Gjykata ka dhënë edhe vendim për kompensim të drejtë, në 7 raste është konstatuar shkelja e të drejtës për proces të rregullt, në 4 raste është konstatuar zgjatje tej afateve të arsyeshme të procedimit, në 1 rast është konstatuar shkelje e të drejtës për jetë private dhe familjare (Bajrami vs. Shqipërisë), në 1 rast është konstatuar shkelje e së drejtës për tubim dhe për organizim, në 4 raste është konstatuar shkelje e së drejtës për ankim efektiv, në një rast është konstatuar shkelje e ndalimit të diskriminimit, në një rast është konstatuar shkelje e së drejtës për të mos ju nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe degradues (Dybeku vs. Shqipërisë), në katër raste të tjera është konstatuar shkelje e të drejtës së pronës.

### Konkluzione

Nga një studim i detajuar i praktikës tradicionale të funksionimit të tyre, këto mekanizma i bëjnë proceset vendimmarrëse të jenë të tej zgjatura dhe të pazbatueshme. Për këtë qëllim duhet të merret parasysh realiteti i ri i një bote gjithnjë e më të integruar. Kushdo qoftë objektivi, paqja, rritja ekonomike, mbrojtja e ambientit, përpjekjet ndërkombëtare për të arritur këto ndryshime nuk do të kishin efikasitet nëse faktorët kombëtarë do të mbaheshin larg apo nuk do të përfshiheshin aq sa duhet.

Një mësim i mirë që është marrë në dhjetëvjeçarën e fundit është se institucionet politike kombëtare nuk janë të afta të ecin në një hap me sfidat që ju paraqiten nga një botë gjithnjë e më e ndërvarur. Ndërkohë që demokracitë e reja po bëjnë të gjitha përpjekjet për të hedhur bazat e një sistemi qeverish demokratike, ka disa forca dhe institucione të reja që ushtrojnë një trysni të madhe mbi jetën e personave. Ekzistojnë gjithashtu vatra të reja konfliktesh si ndërmjet shteteve ashtu edhe brenda vetë shteteve. Ekonomia globale,

<sup>10</sup>Çështjen Qufaj Co Shpk kundër Shqipërisë, nr. 54268/00, § 38, 18 nëntor 2004.

me mekanizmat dhe rregullat e saj ecën përpara me ritmin e shpikjeve teknologjike pa pyetur që ata që nuk kanë mjetet e nevojshme mund të ngelen mbrapa. Në lidhje me këtë të fundit ekziston një debat i madh mbi të mirat dhe të këqijat që sjell një fenomen i tillë. Ka edhe nga ata që mendojnë se globalizimi nuk mund të kufizohet vetëm me ekonominë, duke injoruar tërësinë dhe kompleksitetin e përmasave që përfshihen në të, siç janë ato kulturore, politike, shoqërore dhe ushtarake. Gjithsesi, duket qartë se duhet vepruar. E nevojshme është gjithashtu dëshira për të vepruar sipas mënyrave që instalojnë dhe forcojnë demokracinë, përmirësojnë zhvillimin dhe përhapjen e lirive të individit në botë.

### Bibliografia

- Apostoli, A. (2000). La Carta dei Diritti dell'Unione Europea, Roma, Promodis.
- Puto, A. (2002). Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut në përfaqje me Kushtetutën e Shqipërisë" (Vështrim krahasues), Tiranë, Albin.
- Puto, A. (2007). E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, Albin.
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Dhjetor 1948, OKB.
- Canaj, E. & Banaj, S. (2010). E Drejta e Bashkimit Evropian, Azhurnuar me Traktatin e Lisbonës, Tiranë.
- Dobjani, E. (2007). "E Drejta Administrative 1", Tiranë.
- Daci, J. (2008). Të drejtat e Njeriut, Tiranë, Erik.
- Casavola, F.P. (1997). I Diritti Umani, Milano, CEDAM.
- Kushtetuta e R.SH. (1998). Tiranë.
- K.Pr.C. (2007). Tiranë, Qendra e publikimeve Zyrtare.
- K.Pr. P. (2007). Tiranë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare.
- K. Traja, "Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe procesi i rregullt ligjor sipas Kushtetutës shqiptare", referat i mbajtur ne konferencën e zhvilluar me rastin e 10 vjetorit të Gjykatës Kushtetuese të R. SH.
- Këshilli i Evropës. (1998). Udhëzues për Përdoruesin e KEDNJ, Tiranë.
- Këshilli i Evropës, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Strazburg.

## Probleme të natyrës së zhvillimit historik; Pretendimi historicist parë nën spektrin e lentes Popperiane

MSc. Fjorentina Klllogjeri (Kodrallari)  
Universiteti « A. Xhuvani »

### Abstrakt

Idea e “progresit” është e ngulitur fortë tek të gjithë ne. Bota, mendojmë ne, duhet të bëhet më e mirë, jo më e keqe, dhe kështu ne e shohim historinë si një « vijë » nëpër të cilën udhëtojmë.

Në të shkuarën, historia shihej si një rreth ose edhe si diçka e pandryshueshme. Përfytyrimi i historisë si një “vijë e vazhdueshme” është e vetmja mënyrë për ta përfytyruar atë. Por ç’farë e vë në lëvizje historinë përgjatë kësaj vije dhe a ka kjo vijë ndonjë fund? A egziston një shoqëri e “fundit”, e përkryer, që përbën qëllimin e progresit? Nëse po, kjo do të shënonte realizimin e një ëndrrë apo përjetimin e një makthi?

Në të vërtetë historia përbën një proces të hapur, i cili varet nga të gjithë individët të përfshirë në veprim apo në kushtet e veprimit. Ajo është një tërësi historish, që janë të bashkëvendosura nga veprimi i njerëzve dhe interpretohet në retrospektivë nga vetë njerëzit. Në këtë mënyrë, duke u nisur nga përvoja njerëzore mund të pohojmë se idetë dhe përfytyrimet e gabuara, historikisht kanë qënë motive për veprime të gabuara. Një proverb latin thotë: “Kush mendon madhërishtëm, gabon dhe po aq shumë”. Çelësi i gjithë kësaj duket se është fakti se, nëqoftë se ne e kuptojmë që njohja njerëzore mund të gabojë, atëherë, ne do të kuptojmë gjithashtu se nuk mund të jemi kurrë tërësisht të sigurtë që s’ kemi bërë ndonjë gabim, siç edhe argumenton doktrina popperiane.

Duke pranuar logjikisht që historia përbën një proces të hapur, i cili varet nga të gjithë individët të përfshirë në veprim, atëherë mund të pohojmë se për nga natyra që gëzon, ajo mund të cilësohet si një ndodhi që ndodh lirisht, pa urdhërin e askujt. Ajo ngrihet mbi bazën e lirisë njerëzore dhe jo mbi bazën e një procesi a-priori që çon në liri. Për këtë arsye ajo mund dhe duhet aktualizuar si depozitë e tërësisë së zhvillimit njerëzor.

Historikisht kanë egzistura doktrina të ndryshme në lidhje me interpretimin e natyrës së zhvillimit historik. Përplasja mes këtyre doktrinave përbën një hapsirë të gjërë diskutimesh, si për mbrojtjen ashtu dhe për kundërshtimin e tyre.

**Termat kyç:** *Histori, zhvillim historik, proces a-priori, doktrina popperiane, histoicizëm.*

### Hyrje

Koha e përjetuar e historisë kolektive dhe individuale duhet të gjejë kuptimin dhe thellësinë se kjo kohë e përjetuar, kjo e tashme mes të kaluarës dhe të ardhmes, të lejon interpretimin egzistencial të së vërtetës dhe të lirisë. Ajo ka të bëjë me diçka që “përshkon kohën” (Jaspers: *Quer zur Zeit*), pa të cilën nuk do të ishte më kohë.

Për historinë është folur dhe flitet shumë. Zakonisht kur flitet për të insistohet tek kuptimi që përpiqemi të lexojmë tek ajo, apo tek kuptimi që duam ti japim asaj. Pasi në të kundërt nuk do ishte një histori, por vetëm një zinxhir epokash dhe çastesh. Pikërisht interpretimet që i janë bërë historikisht natyrës së zhvillimit historik, kanë përbërë një hapsirë të gjërë diskutimesh dhe një arenë përplasjesh mes përkrahësve të doktrinave të ndryshme.

Kanë qënë dhe janë të shumtë ata që duke kërkuar absolutin tek historia, pretendojnë të njohin konturet e saj. Por një absolutizim i tillë i relatives tregon se raporti me absolutin transhental ka qënë gjithmonë i ndërprerë. Mund të themi me bindje se një nga këto doktrina, siç ishte historicizmi, përbën një lëvizje shumë të lashtë. Doktrinat e cikleve jetësore, të qyteteve apo të recave, që përbëjnë format më të hershme të tij, i paraprijnë

pikëpamjes primitive teleologjike, se pas vendimeve në dukje të verbëra të fatit, ka qëllime të fshehura. Mënyrat shkencore të të menduarit, kanë bërë që hyjnizimi i qëllimeve të fshehura të flaket tej, por gjithsesi ai ka lënë gjurmë të qarta tek teoritë historiciste. Madje vetë historicistët modern nuk janë të vetëdijshëm për lashtësinë e doktrinës së tyre, dhe për faktin se mbulohen prej një konservatorizmi të pavetëdijshëm. Pretendimi i tyre shkon deri aty, sa ata besojnë se historicizmi i markës së tyre është arritja më e fundit dhe më e guximshme e mendjes njerëzore, aq sa vetëm pak njerëz janë të aftë të njësohen me të. Ata mendojnë se përparimi u bë i mundur prej faktit se ne tani jetojmë në një revolucion, i cili e ka përshpejtuar kaq shumë zhvillimin tonë sa që ndryshimi shoqëror mund të përjetohet drejtpërdrejt brenda kohëzgjatjes së një jete. Natyrisht që kjo përrallë përbën një mitologji të kulluar, e cila duke kërkuar absolutin tek historia, pretendon me një bindje të dëshpëruar të njohi konturet e saj.

### **Pretendimi historicist dhe kritika Popperiane**

Në pjesën e parë të veprës së tij *“Shoqëria e hapur dhe armiqët e saj”* Karl Popper e merr Platonin si një shembull të pakrahasueshëm të një filozofi gjenial, teoria politike e të cilit përfshin dëshirën për tu kthyer në të kaluarën, qëndrim të cilin ai e komenton me anë të një kritike të detajuar. Ndërsa në vëllimin e dytë, Popper parashton një kritikë po të së njëjtës natyrë por këtë herë ndaj Marksit, si një filozof madhor, teoria e së cilit është e bazuar në një parashikim për të ardhmen e cila sipas tij do të jetë e përkryer (Megi, 1999,139). Mënyra e trajtimit që autori i bën të dyja tezave, dhe mënyra e parashtrimit të kritikës përbën një nga mësimet më të rëndësishme metodologjike që mund të nxirren nga shkrimet e tij. Për të bërë evidente këtë të vërtetë, duhet të pohojmë fillimisht se kyçi qëndron në mënyrën se si Popper kupton dhe shpjegon zhvillimin që mund të vijë nga kritika e ngritur ndaj një teze të caktuar. Në këtë mënyrë, ai përkrah idenë se sa më i gjatë të jetë diskutimi mes dy njerëzve inteligjentë, aq më të mira bëhen teoritë e tyre, për arsye se çdonjëra prej tyre përmirësohet vazhdimisht nga kritikata e tjetrit. Ajo që ka synuar Popperi të bëjë, dhe që realisht ka pasur sukses, është sulmi në anën më të fuqishme të teorisë së kundërshtarit. Si fillim para se të sulmojë, ai e forcon edhe më tepër teorinë apo tezën e marrë në shqyrtim duke kaluar përkohësisht në krahun e saj. Dhe, pasi e ka sjellë në formën më të përshtatshme, ai e sulmon në pjesën më të fuqishme.

Gjithësesi, nëse do bënim një pasqyrë të realitetit se si u prit *“Shoqëria e hapur dhe armiqët e saj”* mund të vemë re se gjërësisht në botën akademike, kritikata ndaj Platonit janë kuptuar dhe cilësuar si sulm dhe neglizhim nga Popperi ndaj personalitetit të Platonit si filozof. Por e vërteta është komplet ndryshe, pasi Popper, Platonin e cilëson në çdo moment si *“filozofin më të madh të kohërave”* (Popper, 1966, 98). Gjithsesi, platonizmi si teori, nuk konsiderohet si problem në jetën politike apo shoqërore të botës moderne, ashtu sikurse filozofia parasokratike, në të kundërt marksizmi po. Qëndrore për marksizmin është pohimi i tij se është teori shkencore, pasi Marks veten e tij e konsideronte si Njuton apo Darwin të shkencave historike, politike, ekonomike apo të të gjitha atyre që konsiderohen shkencë shoqërore. Sipas tij zhvillimi i shoqërive njerëzore përcaktohet dhe drejtohet nga ligjet specifike shkencore, të cilat sipas tij mund të zbulohen apo të njihen. Ashtu si Njutoni kishte zbuluar ligjet natyrore sipas të cilave lëvizte materia në hapësirë, ashtu sikurse ne mund të parashikojmë kohën e lindjes dhe perëndimit të diellit, errësimin, lëvizjet e baticave etj, ashtu Marks pretendonte se mund të zbulohen ligjet natyrore të prodhimit kapitalist. Në këtë mënyrë ai i vishte teorisë së tij një natyrë shkencore. Por, Popper pranon dallimin që ekziston midis mendimit marksist se ne jemi të pafuqishëm

për të ndikuar në kursin e historisë, nga njëra anë, dhe atij utopist, besimit se njerëzit kanë mundësi që të krijojnë një shoqëri të përkryer, nga ana tjetër. Edhe pse marksizmi është keqkuptuar si përfaqësues i qëndrimit të dytë, Popper thekson se sipas tij, komunizmi është utopist, ndërsa marksizmi jo. Ky është një dallim që duhet vlerësuar dhe duhet pasur parasysh.

Për pasojë, thelbësore e pretendimit të marksizmit për të qënë shkencë, është detyrimi i tij që të mbrojë në mënyrë të vendosur vetveten në nivel shkencor të argumentimit pasi në të kundërt do të jetë jokohorent. Rrjedhimisht, ai duhet ti nënshtrohet testimit dhe ti pranojë pasojat. Ajo që Popper ka bërë, është hedhja poshtë e pretendimeve të marksizmit ndaj së vërtetës shkencore duke mos lënë asnjë mundësi për justifikimin e pretendimeve të tij. Vetë teoria e Karl Marksit ka dëshmuar një numër të konsiderueshëm parashikimesh të falsifikueshme, të cilat janë konsideruar si të pavërteta. Për shembull, sipas kësaj teorie vetëm vendet plotësisht të zhvilluara kapitaliste do të kishin mundësi të kalonin në komunizëm, por në reletet të gjitha vendet që kaluan në komunizëm ishin vende paraindustriale dhe asnjëri nuk ka qënë vend, shoqëri plotësisht e zhvilluar kapitaliste. Sipas kësaj teorie, është vetë masa e gjërë e popullsisë ajo që do të sjellë komunizmin, por në të vërtetë në asnjë vend kjo teori nuk ka fituar shumicën përkrahëse. Sipas saj, pronësia e mjeteve kapitaliste të prodhimit detyrimisht do të përqëndrohej në duart e sa më pak njerëzve, ndërkohë ajo që ndodhi ishte që pronësia u bë përgjithësisht shumë e shpërndarë. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me pikëpamjen e teorisë së Marksit dhe Engelsit mbi zhvillimin e institucioneve politike në të ardhmen, zhvillim i cili nuk i përgjigjet aspak asaj ç'ka ndodhi në të vërtetë.

Gjithë sa thamë më lart dëshmon një mohim të teorisë që pretendon të jetë shkencore përmes metodikës themelore që parashikimet e saj ia nënshtrojnë testit të përvojës duke i verifikuar ato si të pavërteta. Vetë pikëpamja e Marksit se, gjithçka që ka të bëjë me ndryshimet historike zhvillohet në përputhshmëri me ligjet shkencore, përbën atë që Popper e quan "historicizëm", kritikën ndaj të cilit e ka paraqitur të plotë dhe të qartë në veprën e tij "Mjerimi i historicizmit" e cila është një vepër që sipas vlerësimeve të kritikës së kualifikuar, qëndron me dinjitet përkrah veprave më të mira të Popperit "të cilat janë kthyer në pika referimi të mendimit filozofik bashkëkohor. Kjo vepër mbetet një përfaqësuese e mendimit Popperian dhe e stilit të papërsëritshëm të arsytimeve të tij" (Minga, 2003, 10)

### **Mohimi i ligjeve të përgjithshme parashikuese**

Karl Popper mbron ekzistencën e ligjeve të përgjithshme e të domosdoshme të historisë, në bazë të të cilave mund të parashikohen ngjarjet, proceset, fenomenet etj. Historicistët pohojnë se, ligjet e shoqërisë ndryshojnë në vende të ndryshme, kohë të ndryshme dhe rrjedhimisht varen prej situatave historike të veçanta. Pra, relativiteti historik i ligjeve shoqërore i bën të pazbatueshëm metodat e shkencave natyrore në shoqëri.

Argumentimi i kësaj ideje ka të bëjë me përgjithësimin, në bazë të të cilit mund të pohojmë se njëtrajtësia e përgjithshme e natyrës si parim, është i papërdorshëm në shoqëri, pasi ajo ndryshon sipas periudhave historike, ndryshim ky që kushtëzohet nga veprimtaria njerëzore. Gjithashtu, eksperimenti si metodë, nuk është i zbatueshëm në shoqëri. Pasi eksperimentet në shoqëri nuk janë si ato që realizohen në fizikë: tek shkencat shoqërore këto eksperimente nuk mund të ndihmojnë në zbulimin e të ardhmes politike. Kryerja e eksperimenteve shoqërore i ndryshon kushtet e shoqërisë, pasi jo vetëm do të përshpejtonte zhvillimin e një ngjarje, por mund të bëhet shkak për ngjarjen që parashikon, e cila mund

të mos kishte ndodhur fare në qoftë se nuk do ishte parashikuar.

Në vijim, argumentimi i Popperit ka të bëjë me vështirësinë e parashikimit, i cili nënkupton faktin se parashikimet e përpikta dhe të hollësishme në shoqëri janë të pamundura. “Historicistët pretendojnë të tregojnë rëndësinë e parashikimit si një prej detyrave të shkencave shoqërore, në këtë këndvështrim jam krejt i një mendjeje me ta, por nuk besoj se profecia historike është një prej detyrave të shkencave shoqërore.” (Popper, 2003,29). Sipas interpretimit Popperian, parashikimi sipas pretendimit historicist është i pamundur dhe mbetet veçse një program. Pasi, në një shoqëri, duke përfshirë këtu në tërësi natyrën e zhvillimeve të saj, është krejt e pamundur të kontrollohen të gjitha ose “thujtë” të gjitha këto zhvillime duke pretenduar në arritjen e ligjeve të përgjithshme me natyrë parashikuese. Rrjedhimisht është një pamundësi logjike, pasi është gabim të besosh se mund të ketë ligje të kësaj natyre, që të paraqesin “të tërën e organizmit shoqëror” ose “të gjitha ngjarjet shoqërore, historike e politike të një epoke”.

### **Kundër një linje të paracaktuar zhvillimi**

Karl Popper pranon se ne asnjëherë nuk do të kemi një bazë reale për të thënë se shoqëria do zhvillohet patjetër në një linjë të caktuar, pasi në këtë mënyrë deshën apo nuk deshën antarët e saj. Në shkencat shoqërore kemi veprim të ndërsjelltë midis subjektit, pra vrojtuesit, dhe objektit, pra të vrojtuarës, në këtë mënyrë shkencëtari dhe objekti i tij i përkasin të njëjtës botë. Si pasojë e kësaj, në shkencat shoqërore ka pak gjëra që mund të ngjajnë me kërkimin objektiv dhe ideal të së vërtetës (ashtu siç e hasim në fizikë për shembull), pasi tek këto shkencë ka po aq shumë prirje sa ç’mund të gjejmë në jetën shoqërore. Rrjedhimisht shkencëtari (apo subjekti) që përpiket të gjejë të vërtetën në shoqëri, në të njëjtën kohë do të ushtrojë një ndikim të caktuar mbi shoqërinë, dhe është pikërisht kjo gjë që e prish objektivitetin e fakteve në shoqëri.

Një moment i rëndësishëm në kritikën e Karl Popper përbën dhe trajtimi i idesë së J.S.Mill-it dhe O.Comte-it, të cilët pretendonin për ligje historike të cilat përcaktonin ngjarjet politike. Për Popperin, këto mund të quhen veçse “kuazi-ligje të vazhdimësisë”, sipas tij megjithëse mund të supozojmë se çdo rradhitje e dukurive, ndodh sipas ligjeve të natyrës, “është e rëndësishme të kuptohet se praktikisht asnjë varg me tri apo më shumë ngjarjesh konkrete të lidhura shkakësisht, nuk ndodh në pajtim me ndonjë ligj të vetëm të natyrës” (Popper, 2003, 119)

Por, Comte dhe Milli, i përfytyrojnë ligjet historike të vazhdimësisë si ligje që përcaktojnë vargun e ngjarjeve historike sipas ndodhjes së tyre të vërtetë. Kjo del më e qartë tek mënyra me të cilën Milli flet për metodën që “qëndron në përpjekjen që nëpërmjet studimit dhe analizës së fakteve të përgjithshme të zbulohet... ligji i progresit: ligj që me tu vërtetuar do... të na lejonte të parashikonim ngjarje në të ardhmen, tamam ashtu si pas pak kufizash të pafundme në algjebër, si rezultat jemi në gjendje të diktojmë parimin e rregullsisë së formimit të saj dhe të parashikojmë pjesën tjetër të serisë deri në çdo kufizë që të na pëlqejë”. Milli vetë e kritikon këtë metodë, por kjo kritikë e tij pranon plotësisht mundësinë e gjetjes së ligjeve të vazhdimësisë analoge me ligjet e vargut matematik, megjithëse ai shfaq dyshime nëse “renditja e vazhdimësisë” që na paraqit historia “mund të jetë aq rreptësisht e njëtrajtshme sa të krahasohet me atë të një vargu matematik” (Popper, 2003, 119).

Popper mbështet mundësinë e kuptimit intuitive të shoqërisë apo të historisë, sipas të cilit duhet të vlerësojmë domethënien e disa ngjarjeve duke i krahasuar me ngjarje analoge në periudha më të hershme në mënyrë të tillë që të na ndihmojë për parashikime të reja,



pa harruar këtu ndryshimet ndërmjet periudhave. Paralelisht me këtë ai kundërshton karakterin utopik të qëndrimeve të historicistëve, duke theksuar fort se realiteti duhet kuptuar nga këndvështrime reale dhe jo mbi veprimtaritë jorealiste nga pikëpamja shkencore. Ide të cilën e shpreh në mënyrë më të përgjithshme në pohimin e tij: "...besimi i verbër në të vërtetën tënde nuk bën gjë tjetër veçse inkurajon intolerancën dhe izolimin intelektual" karakteristika që i gëzonte padyshim pretendimi historicist.

Është me vend të citojmë përsëri Popperin me një thënie që mbart një kuptim të fuqishëm: "...pasioni për të provuar superioritetin tënd shpjegohet me përpjekjen për të kompesuar inferioritetin tënd". Thënie që konsiston në ndërgjegjësimin se progresi intelektual vjen vetëm kur njerëzit diskutojnë me njëri-tjetrin: dhe kjo është gjithmonë e mundur, e vështirë dhe e dobishme për të zgjeruar horizontet intelektuale, në mënyrë të tillë që të mos mbetemi të identifikuar me teza të "lashta".

Si një jodeterminist, ai beson se ndryshimi vjen si rezultat i përpjekjeve tona për zgjidhjen e problemeve dhe se në këto përpjekjet tona për zgjidhjen e problemeve, në mes të tjerave, bëjnë pjesë edhe të papriturat, imagjinata, zgjedhja dhe fati. Në mes gjithë këtyre, ne jemi përgjegjës vetëm për zgjidhjet tona. Në qoftë se është duke u zhvilluar ndonjë proces, jemi ne ata që, me komunikimet dhe interaksionet tona me njëri-tjetrin, me mbjentin tonë fizik (të cilin nuk e kemi krijuar ne si qënie) dhe me Botën (të cilën e kemi krijuar ne por të cilën çdo individ e trashëgon dhe mund të ndikojë shumë pak për ta ndryshuar) e çojmë historinë përpara. Rrjedhimisht cilado qofshin qëllimet e historisë ato janë qëllimet tona, çfarëdo kuptimi të kenë ato, është kuptim që i japim ne dhe askush tjetër.

Qëndrimi që mban Popper në raport me teori të tilla të tipit marksist, është sulmues pasi ai nuk e përkrah pretendimin e tyre që zhvillimi i linjës historike ndodh sipas ligjeve shkencore dhe se duke i njohur këto ligje, ne mund të parashikojmë të ardhmen, autori argumenton fuqishëm dhe bindshëm se asnjë parashikim shkencor, qoftë i shkencëtarit apo i makinës llogaritëse, nuk ka asnjë mundësi që me anë të metodave shkencore të parashikojë rezultatet e tij në të ardhmen. Është mëse e pranueshme se logjikisht është e pamundur të parashikohet dija e së ardhmes, pasi nëse do të ishim në gjëndje ta bënim këtë, atëherë këtë dije ne do ta zotëronim tashmë në moment, rrjedhimisht sikur ta kishim të mundur ti parashikonim zbulimet e së ardhmes, ato automatikisht do të ishin zbulime të së tashmes. Në të njëjtën mënyrë, nëse vetë e ardhmja përmban ndonjë zbulim të rëndësishëm, është e pamundur që atë ta parashikojmë në mënyrë shkencore (Megi, 1998, 149).

Duke u rrëzuar ideja se e ardhmja nuk shpaloset në një mënyrë të paracaktuar, bie dhe ideja e shoqërisë plotësisht të planifikuar, duke forcuar bindjen se është e pakuptimtë ideja e projektimit politik të një shoqërie duke qënë se ndryshimet kurrë nuk përfundojnë.

## Përfundime

Duke pasur parasysh risinë e ideve që K.Popper hodhi në qarkullim me qëndrimin e shfaqur në veprat e tij "*Mjerimi i Historicizmit*" dhe "*Shoqëria e hapur dhe armiqët e saj*", mund të themi pa asnjë dyshim se ai e freskoi mendimin filozofik. "Pasi idetë e tij prekën çështje kardinale, prishën qetësinë e doktrinave hijerënda, që ushtronin një ndikim jo të vogël dhe me pasoja të dëmshme. Ai përpunoi dhe përsosi një sistem argumentash të mprehta dhe të goditura, dhe me anë të konsequencës së vet i mbërthen teoritë false në darën e hekurt të logjikës" (Minga, Poper, 2003, 9).

Mjaft origjinale dhe për tu vlerësuar është mënyra se si ai i trajton doktrinën të cilat kritikon. Jo vetëm i trajton me seriozitet të madh, por nuk nguron "të kalojë" përkohësisht

në terrenin e tyre, duke sajuar në përputhje me logjikën e kundërshtarëve, por sigurisht me argumenta të reja dhe me mendjemprehtësin, që ata nuk i kanë menduar ndonjëherë. Në çdo formulim të Popperit ndjehet të pulsoj një arsytim i hollë dhe në të njejtën kohë shumë i zhdërvjellët, arsytim i cili në tezën e marrë në shqyrtim, dëshmon mësëmiri se për arsye rreptësisht logjike është e pamundur të parashikojmë rrjedhën e ardhshme të historisë.

Autori mban qëndrimin e tij kritik në lidhje me doktrinën sipas së cilës, është detyra e shkencave sociale të propozojë profetësitë historike dhe zhvillimet që do pasojnë, ky qëllim është i arritshëm nëpërmjet zbulimit të “ritmeve”, “prirjeve”, “rrugëve”, apo ligjeve” që fshihen nën evolucionin e historisë. Këtë Popper e quan *historicizëm*, dhe e cilëson si një relike të supersticionit të lashtë, megjithëse ka njerëz të cilët e konsiderojnë atë si një teori të re, progresive, revolucionare dhe shkencore. Ai dëshmon me një bindje të mirëargumentuar se historicizmi përbën një metodë të varfër e cila nuk jep asnjë fryt. Pretendimit historicist Popper i përgjigjet me pohimin se, besimi në fatin historik është një bestytini e kulluar dhe se nuk mund të parashikohet rrjedha e historisë njerëzore me metoda shkencore apo metoda të tjera racionale.

### Referenca

- Allhoff, F. (2010). *Philosophies of the sciences*. United Kingdom.  
Bloch, M. (2003). *Apologji për Historinë*. Tiranë.  
Carvi, R. (2005). *An introduction to the thought of Karl Popper*. New York.  
Kosłowski, P. (2005). *The Discovery of Historicity in German Idealism and Historicism*. New York.  
Megi, B. (1998). *POPPERI*. Pejë.  
Miller, D. *Karl Popper- Punime të zgjedhura*. SOROS & Afërdita.  
Popper, K. (1975). *Conoscenza Oggettiva*. Roma.  
Popper, K. (1974). *La società aperta e i suoi nemici*. Roma.  
Popper, K. (1998). *Logica della Scoperta Scientifica*. Torino.  
Popper, K. *Che cos'è la dialettica*. Milano.  
Popper, K. (2003). *Mjërimit i Historicizmit*. Tiranë.  
Popper, K. (2009). *Për Filozofinë dhe Shkencën*. Tiranë.  
Popper, K. (1988). *The Open Universe – An Argument for Indeterminism*. New York.  
Sinani, Gj. (1999). *Filozofia e Historisë*. Tiranë.  
Stumpf, S. E. *Filozofia – Historia dhe Problemet*. Tiranë.

## Transition reforms in transition economies - Case study for SEE countries

*Malësor Kelmendi,  
Jeton Zogjani, MSc*

### Abstract

In this research paper is analyzed transition reforms in transition economies with case study SEE countries and the main theoretical arguments for discussions are as following: the effect of transition reforms during transition processes in SEE countries, the impact of these reforms in institution and policy aspects, then their effect to economy, education and overall aspects in these countries. In methodology, the secondary data that is used is collected from international institutions and they are calculated through STATA program. The main analysis include: descriptive statistic, multiple regression analysis and correlation matrix. Based on empirical results, in the OLS regressions analysis is found that economic growth and financial market development have negative impact on transition reforms (enterprises reforms and market & trade reforms). Innovation reform has negative impact on enterprises reforms but it has shown positive impact on market and trade reforms. Other variables have shown positive impact on transition reforms in the SEE countries. In T-statistic analysis all independent variables have shown negative significance ( $T < 2$ ) on two transition reforms. In correlation methods, all variables that are including on research paper have shown positive correlation on transition reforms (except economic growth). In conclusion, all of SEE countries must attempt the processes of reforms because the reforms are very necessary for economic sustainable, political stability and institutional consolidation, process of integration and in other important challenges in the future.

**Keyword:** *Enterprises reform, growth, regression analyses, STATA program, trade reform*

### Introduction

Different discussion for few decades have existed about reforms in the transition economies and still exist discussion over pacing and sequencing reforms and dynamic of transition reforms (Stiglitz, J.E., 1999). When the transition countries changed their orientation in economy and politic aspects from the totalitarian system to the liberalization markets, institutional stability has played a crucial role in these countries. Also macroeconomic stabilization and structural reforms have the important impacts in transition economies, (Ubierno et al, 2006). Processes of transition reforms have strong impact in economic and state activity and it is realized through in two main aspects: a) privatization of enterprises and the liberalization and b) changes in government expenditures, transfers and taxes (Peev, E. & Muelle, D.C., 2012). Then privatization and price liberalization are considered as internal reform with greater effects in transition economies, (Barlow et al, 2009). However, as a key detail to orient the market reforms in future is to focus on improving innovation and knowledge in all transition economies, particularly being focused on creating innovation culture, supporting innovative companies and rising the government and local support for this field in the future, (Baković, 2010).

During the initial phrase of transition, as main elements in most transition countries (in context of economic development and growth) were sustainable institutions (Beck, Th. & Laeven, L., 2006). In fact, transition processes in many transition countries have brought negative


consequence and the process of construction in markets, economic system and institutional was very hard and with many challenges. These challenges have led to large regional fluctuations particularly on poverty in many aspects, such as poor condition for food and housing, low system of healthcare and education, limited access to local and government services, migration, etc; (Bezemer, 2006). It has consequences in many countries (particularly in Balkans countries) and their effects always have failed to create sustainability comprehensive reforms during transition processes, (Muço, 2001). Also, the experience in many transition countries shows that economic “speed” reforms have affected negatively economic development, (Merlevedea, B. & Schoors, K., 2007). In banking system, transition process has their two effects: a) banks with low performance (weak banks), so these banks are affected mostly by limited entry and poor troubled-bank intervention; b) as best opportunities for improving banking system is to attract foreign banks in the most of transition economies; (Claessens, 1998).

### **A Review of Selected Literature:**

The economic growth is presented by GDP while the government debt is the external debt (public and private debt) guaranteed by government. The government debt is the factor and the economic growth, GDP, is the effect in our model. First we thought to determine the inverse correlation, were the economic growth is the factor and the government debt is the effect, too but we thought this is not relevant for the main model and we will be investigating in later research. Also a differentiation between the public and private debt guaranteed by government should be a topic for future research. The relationship between the government debt and economic growth is scare. Many studies on the subject through out the region are absent.

### The model

Correlation analysis made using the SPSS (Statistical Package for Social Science) program. According to the regression analysis will reject the hypothesis of independence of these variables if the  $R^2$  is less than 0.05. We will accept the hypothesis of no dependence between variables. The theoretical literature, especially from a neoclassical point of view, the relationship between public debt and economic growth tends to point a negative relationship (Ch, Cristina & Ph. Rother, 2010, 1237). As Modigliani and Buchanan, respectively in 1961 and 1958, would say that public debt is sad to be a burden for next generation. The sign plus or minus determined for the independent variable, is determined by the theory. In our case from the above mentioned theory the sign of government debt on economic growth is minus.

**Table 1.** Budget is 1.000.000 lek



**Source:** Data used for this scatter plot are from World Bank

The scatter plot is used to represent relationship between variables in our case, the link between the economic growth, GDP, and government debt of Albania in the period under consideration.

The government debt is 1.000.000 lek and is fixed in 500 segments. As it can be seen the values of both variables which are far from the trend line are the ones in 1991, 1992 and 1997. From 2001 the values tend to reach the trend line and have a normal spread over time.

The coefficient of regression statistic is  $0.052 > 0.005$ . This means that the H1 hypothesis is rejected and the H0 hypothesis  $b=0$  should be accept. H1 represent the hypothesis were there exist a relationship between the two variables and the HO represent that there is no effect of government debt on economic growth. Referring to our model we can say that for the case of Albania the government debt does not have a strong effect over the economic growth, as  $R = 0.052$ .

**Table 2.** Model Summary

Mode	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.229	<b>.052</b>	.003	9.93937522

**A.** We do not analyze the R square as the model has only two variables

**Source:** By Author

The table presents coefficient standardized and standardized coefficient of regression model estimated standard errors of it and t test values.

**Table 3.** Coefficients

	Intercept	Variable	t-test	Nr of Observations
	.976	-0.003	0.97	19

**A.** The sign of variable comes from theory

**Source:** By Author

According to this table, the equation / model relationship between the variables studied in the scheme  $Y = a + bx$  is the following:

$$Y = 0.976234393 + 0.003X$$

This means that on average, effect variable, Y (economic growth, GDP) increase by 0.003 to increase by a unit of independent variable X (government debt). Coming to the t-test is seems that the test is statistically insignificant.

### Conclusion

The main conclusion for the paper is that there is not a direct correlation between the government debt – and the economic growth, GDP, for the case of Albania. Although the model could be valid for other national economies as well, we cannot be sure for it was

not tested.

Also there could be some non-economic variables that can affect the model validity as the political decision taken without taking account of strictly economic and fiscal needs. Also there should be considered and the number of observation taken in consideration, 19, which is a limited number.

The model is the first step in a more large approach for determining the way government debt can be a preventive factor for the economic growth and it can help the policy makers to access the volume of government expenditure for infrastructure that we are willing to sacrifice for the economic growth and GDP increase.

On future research is focus on determining the level of economic growth from where the sustainable economic development is possible. At the enterprise level this issue is the marginal benefit that permits the firm to be responsible and to invest by debt.

As a main conclusion the relationship between government debt and GDP growth for the case of the Albania is insignificant or very weak. Considering that the government debt for the Euro zone has a limit of 60 percent of GDP, there can be concluded that at this level the volume of government debt does not prevent the economic growth.

### Acknowledgement

This work is part of a deeper research studies.

### 6. References

1. Scelarak & F. Balester. 2005. *External Debt and Economic Growth in Latin America*". Working paper.
2. Ch, Cristina & Ph. Rother. 2010. *The impact of growing government debt on economic growth*. European Central bank.
3. F.Emma. 2007. *Pakistan Public Debt*. Pakistan Resident Mission.
4. G. Alfred & F. Bettina. 2009. *Public Debt, Productive Public Spending and Economic Growth with Full Employment*". Springer.
5. J.Irons & J.Sivens. 2010. *Government Debt and Economic Growth*, Economic Policy Institute.
6. L.Taylor. 2009. *Government Debt, Deficit and Economic Growth*". Schwartz Center for Economic Policy.
7. M.Cholifiani. 2009. *The Role of Public Debt in Economic Development*. Working Paper.
8. M.S.Kumar & J.Voo. 2010. *Public Debt and Growth*. IMF Working Paper.
9. National Tax Journal, 1999. Vol 52.
10. United Nations Conference on Trade and Development. 2008. *Domestic and External Public debt in Development Countries*.

## **Rregullimi ndërkombëtar ligjor për të parandaluar abuzimin e drogave dhe substancave psikotrope**

**Ahmet Maloku**  
University College "Gjilani"  
Lecturer

### **Abstrakt**

Me zhvillimin e shoqërisë njerëzore, janë zhvilluar edhe forma nga më të ndryshmet të kriminalitetit e në veçanti të krimit të organizuar dhe kjo ka bërë që organet e ndjekjes të vendeve të ndryshme të botës të vënë ura bashkëpunimi mes vete në mënyrë që ta kenë më të lehtë ta luftojnë këtë dukuri negative në mbarë botën. Në punim paraqitet historia e rregullimit ndërkombëtar ligjor në fushën e parandalimit të prodhimit të drogave dhe substancave psikotrope. Konventat ndërkombëtare për rregullimin ndërkombëtar ligjor mbi kontrollin e opiumin në fillim, e më vonë kokainës, heroinës, marihuanës, drogave sintetike dhe prekursorve. Për luftimin e kriminalitetit në nivel transnacional, rëndësi të veçantë kanë konventat, protokollet, deklaratat, rekomandimet dhe planet e veprimit që do të shtjellohen në këtë punim. Për të luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar është më se e domosdoshme që institucionet kompetente të shteteve ti harmonizojnë legjislacionin me standardet botërore të bashkëpunojnë ndër vete, veçanërisht në fushën e shkëmbimit të informacioneve që paraqesin rëndësi për parandalimin dhe për luftimin e krimit të organizuar.

**Fjalët kyçe:** Konventat ndërkombëtare, krimi i organizuar, drogat, substancat psikotrope, bashkëpunimi ndërkombëtar.

### ***International legal regulation to prevent drugs abuse and psychotropic substances***

### **Abstract**

With the development of the human society, developed also different types of criminality especially of organized crime and this has made that the investigative bodies of different countries of the world to build cooperation bridges between themselves in order to have much more easier to combat this negative phenomena in the whole world. In the paper it is presented the history of international legal regulation in the field of preventing the manufacturing of drugs and psychotropic substances. International conventions for the international legal regulation on controlling the opium, at the beginning, and later the cocaine, heroin, marijuana, synthetic drugs and precursors. To combat the criminality in the international level, a very big importance have the conventions, protocols, declarations, recommendations and action plans, which will be dicussed in this paper. To fight the international organized crimes it is more than necessary that the competent institutions of the countries to harmonize the legislation with international standards in order to cooperate among themselves, especially in the field of information's exchanges that are important for the prevention and fighting of organized crime.

**Key words:** International conventions, organized crime ,drugs, psychotropic substances, international cooperation.

## Hyrje

Origjina e Opiumit dhe përdorimit të tij e hasim qysh në vitin 3.400 p.e.r, ku bima e opiumit ishte kultivuar në Mesopotaminë e ulët (*Azia Jugperëndimore*). Sumerët<sup>1</sup> i referoheshin si Huli Gil, “Bimë gëzimi.” Sumerianët shpejt e pasojnë atë tek Asirët, nga ata kalohet tek Egjiptasit<sup>2</sup>. Ndërsa njerëzit mësuan për fuqinë e opiumit, kërkesa për të ishte rritur. Në shumë vende filloi të rritet procesi i kultivimit të opiumit. Kultivimi i saj u përhap përgjatë Rrugës së Mëndafshit ku tregtarët e opiumit shfrytëzuan rrugët tokësore dhe ujore për të përhapur opiumin nga Mesdheu nëpër Azi dhe më në fund në Kinë.

Si akt i parë dhe dispozitë ligjore që rregullonte çështje e konsumimit të pijeve narkotike konsiderohet akti i veçantë i Perandorit Kinez, Yung Cheng i vitit 1729, që lëshon një “Edictum” që e ndalon tymosjen opiumit dhe shitjen e tij të brendshme, përveç në bazë të licencës për përdorim si ilaç.<sup>3</sup>

Me 1799 Perandori i Kinës, Kia King, ndalon plotësisht opiumin, duke e bërë kultivimin dhe tregtinë lulëkuqes së paligjshme.<sup>4</sup>

Në mënyrë për të financuar dëshirën e tyre gjithnjë në rritje për çajin kinez të prodhuar, Britania, nëpërmjet kontrollit të tyre të “The British East India Company’s”, filloi kontrabandën e opiumit indian në Kinë. Kjo rezultoi në një normë fluturues varësisë mes kineze dhe çoi në Luftërat e Opiumit.<sup>5</sup>

Duke e kuptuar shtrirjen shumë të shpejtë të kriminalitetit gjegjësisht tregtisë me narkotik jo vetëm brenda kufijve nacional por edhe në ata ndërkombëtare, u kuptua se edhe një shtet i fort ku ka sistem të mirëfilltë juridik për luftimin e kriminalitetit të organizuar nuk do të jetë në gjendje ta luftoj kriminalitetin pa bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar. Trafikimi i Drogave dhe substancave psikotrope si një delikt tipik me karakter internacional ika shty shtetet në fillim të shekullit XX të sjellin marrëveshje ndërkombëtare për kontrollin e drogave dhe substancave psikotrope, që nga Konferenca e Shangajit e vitit 1909 e deri te Konventa kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope e vitit 1988 e cila është aktualisht në fuqi.

---

<sup>1</sup>Shkrimet Mesopotamie janë ndër më të lashtat të njohura deri më sot në botë, duke e bërë Mesopotaminë “djepin e qytetërimit”. Sipas një teze sumerët ishin të parët, që krijuan një nga sistemet e para të shkrimit në historinë e njerëzimit. Qytetërimet më të rëndësishme të Mesopotamisë ishin sumerët (3500 p.e.r - 2000 p.e.r.), babilonët (1800 p.e.r - 539 p.e.r.), dhe asirët (1350 p.e.r - 612 p.e.r.).

<sup>2</sup>Egjiptianët fillojnë kultivimin e opiumit ku kultivimi dhe tregtia e tij lulëzon gjatë sundimit të Thutmose IV, Akhenaton dhe Mbretit Tutankhamen. Rruga tregtisë përfshinin Fenikasit (*Phoenicians*, ku janë sot Siria, Libani dhe Izraeli) dhe Minoanët (Minoans-Kreta e sotme) që lëvizin nëpër pikat fitimprurëse nëpër Detin Mesdhe në Greqi, Carthage (tani-Tunis), dhe Evropë.

<sup>3</sup>Qasur me 11, nëntor, 2014 nga: <http://cbn.nic.in/html/opiumhistory1.htm>,

<sup>4</sup>Po aty.

<sup>5</sup>Më 19 mars 1839- 1842, Lin Tse-Hsu, komisioneri i Perandorisë Kineze në krye ka shtypur trafikun e opiumit, duke urdhëruar të gjithë tregtarëve të huaj për të dorëzuar opium tyre. Në përgjigje të këtij veprimi, britanik dërguan luftanije në bregdetin e Kinës, duke filluar Luftën e Parë të Opium. Kurse lufta e dytë në mes të Anglisë dhe Francës në njërin anë kundër Kinës në anën tjetër ka zgjatur prej vitit 1856 deri në vitin 1860.

## Marrëveshjet ndërkombëtare

Sipas Konventës së Vjenës për të Drejtat Kontraktuale të vitit 1969, e cila është burimi më autoritativ për çështjet e marrëveshjeve ndërkombëtare, shprehja marrëveshje ndërkombëtare, nënkupton marrëveshjen e lidhur në formë të shkruar midis shteteve, ndaj të cilave zbatohet e drejta ndërkombëtare, qoftë ajo e shprehur përmes një apo më shumë dokumenteve reciprokisht të ndërlidhura, pa marrë parasysh titullin e tyre. Kjo konventë, Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, flet për konventat ndërkombëtare, qofshin ato të përgjithshme apo të posaçme të cilat i përcaktojnë rregullat e pranuar në mënyrë eksplicite nga shtetet në kontest. Fjala është për konventat, gjegjësisht marrëveshjet dhe ky është kuptimi i vetëm në të drejtën ndërkombëtare dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare në përgjithësi. Sinonimet tjera për marrëveshjet ose për llojet e kontratave siç janë paktet, aktet, protokollet, deklaratat, kartat, marrëveshjet, aranzhimet, etj.

Konventat ndërkombëtare janë marrëveshje të lidhura midis dy apo më shumë subjekteve ndërkombëtare që përfaqësojnë marrëveshjet me të cilat përcaktohen raportet mes shteteve në ndonjë lëmi të caktuar.

Konventat përmbajnë dispozitat mbi definimin e juridiksionit universal për vepra penale të cilat janë objekt i marrëveshjes me imponimin e njëkohshëm të detyrimeve për shtetet anëtare që të ndërmarrin masa për zbatimin apo hartimin e legjislacionit të brendshëm, aty ku ka nevojë. Në të vërtetë çdo shtet ndërmerr masat të cilat mund të jenë të domosdoshme me qëllim të përcaktimit të juridiksionit mbi veprat të cilat janë objekt i konventës gjegjëse, nëse ato vepra janë të kryera në territorin e tij, gjegjësisht në vendin apo objektin që gjendet në territorin e juridiksionit të tij, ose veprën e ka kryer shtetasi i tij. (Softić., 2007, fq. 131)

Gjithashtu shteti anëtarë mund ta vendos juridiksionin e vet nëse vepra penale është kryer kundër shtetasit të atij shteti, kundër objektit të atij shteti ose qeverie në botën e jashtme, përfshirë ambasadën apo objektin tjetër diplomatik – konsullor të atij shteti, ose veprën penale e ka kryer personi pa shtetësi, i cili e ka vendqëndrimin në territorin e atij shteti, ose vepra penale është kryer me qëllim që shteti të detyrohet ta kryej ose të mos e kryej ndonjë veprim..

### Konferenca e Shangajit, 1909 (*The Shanghai Opium Commission, 1909*)

Prej pesë shkurt deri me njëzetegjashtë shkurt të vitit 1909 në Shangai të Kinës u mbledhën trembëdhjetë shtete (*Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Austro-Hungaria, Kina, Franca, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Japonia, Hollanda, Persia (Iran), Portugalia, Rusia dhe Siam<sup>6</sup>*) në konferencën e parë ndërkombëtare për të diskutuar për problemet e narkotikëve në botë dhe për vendosjen rregullit për kontrollin ndërkombëtar të narkotikëve. Iniciativa për organizimin e kësaj Konference erdhi nga qeveria e presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Theodore Roosevelt dhe fuqitë e interesuara evropiane. Kjo konferencë hodhi themelet për traktatin e parë ndërkombëtar të kontrollit

<sup>6</sup>Siam është përdorur si emër i Tajlandës së sotme para 24 qershor të vitit 1939, dhe përsëri ky emër është përdorur prej datës 8 shtator të vitit 1945 deri më 20 korrik të vitit 1949.



të drogës që quhet Konventën Ndërkombëtare për Opium (*Hagës, 1912*).

Për prodhimin e opiumit Konferenca kërkoi fuqimisht qeveritë pjesëmarrëse që të marrin masa drastike për të kontrolluar prodhimin dhe shpërndarjen e morfinë dhe i derivateve të tjera të opiumit që iu nënshtrohet abuzimeve të ngjashme.

Takimi i ashtuquajtur “Komisioni për opium” nuk kishte për qëllim për të vendosur detyrime të detyrueshme, ajo megjithatë i përshpejtoi përpjekjet të cilat vetëm tre vjet më vonë çuan në përfundimin e Konventës Ndërkombëtare për Opium në Hagë në vitin 1912, duke vendosur kështu kontrollin e narkotikëve, si një institucion i të drejtës ndërkombëtare në baza multilaterale.

Në konferencë u miratuan nëntë rekomandime të cilat kishin të bënin me kontrollin dhe mbikëqyrjen, si dhe zvogëlimin e tregtisë me opium.

### **Konventa ndërkombëtare për opium, 1912** (*The International Opium Convention, 1912*)

Me njëzetetë janar të vitit 1912 në Hagë të Holandës u nënshkrua Konventa Ndërkombëtare e Opiumit nga përfaqësuesit nga Kina, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Holanda, Persia (*Iran*), Portugalia, Rusia, Siam (*Tajlandë*), Britania e Madhe dhe territoret britanike të mbikëqyra (*përfshirë British India*) Kjo konferencë kishte të bënte me problemin ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe kishte për qëllim të jetë një vazhdim i konferencës së parë ndërkombëtare për të adresuar çështjen e drogës, Konferenca e Shangait e vitit 1909. Ajo ishte menduar edhe për të krijuar disa kompetenca të zbatimit për rezolutat e miratuara në Konferencën e Shangait të vitit 1909. Haga ishte zgjedhur si vend të konferencës për të rritur aspektin ndërkombëtar të konferencës. Ajo u bë instrumenti i parë i detyrueshëm i të drejtës ndërkombëtare që rregullon implemtimin dhe monitorimin e transportit të paligjshme të opiumit (*veçanërisht atë detar*)

Tre vjet më vonë, kjo konventë hyri në fuqi në pesë vende. Konventa u implementua më 1915 nga Shtetet e Bashkuara, Holanda, Kina, Hondurasi, dhe Norvegjia. Ajo hyri në fuqi globalisht më 1919. Kështu në vitin 1920 afër gjashtëdhjetë shtete kishin nënshkruar - de jure - dhe ratifikuar traktatin e Hagës dhe ky numër në vitin 1949 ka arritur në gjashtëdhjeteshtatë shtete .

Qëllimi i Konventës ishte që “të ndalej gradualisht abuzimi me opium, morfinë, kokainë dhe substanca të tjera të përpunuara dhe derivate, përdorimi i të cilit lehtësisht të çojë në abuzim” Konventa përmban një numër të madh të propozimeve dhe përfaqëson fillimin simbolik të luftës ndërkombëtare kundër drogave dhe substancave psikotropike.

Konventa ndërkombëtare për opium thotë “Vendet kontraktuese të përdorin të gjitha fuqitë për të kontrolluar të gjithë individët që prodhojnë, importojnë, shesin, shpërndajnë dhe eksportojnë morfinë, kokainë, dhe kripërat e tyre përkatëse , si dhe ndërtesat në të cilat këta individë mbajnë një industri të tillë apo tregti.”<sup>7</sup>

<sup>7</sup>UNDOC, qasur me 18 dhjetor, 2014. nga: <http://www.unodc.org/unodc/en/frontpage/the-1912-hague-international-opium-convention.html>,

## Konventa e I- rë e Gjenevës mbi opiumin dhe drogat tjera, 1925 (*Geneva Convention on Opium and Other Drugs, 1925*)

Midis nëntorit të vitit 1924 dhe shkurt të vitit 1925 u mbajtën dy back-to-back konferenca, dhe dy traktate të veçanta u nënshkruan. Kjo konventë u nënshkrua me nëntëmbëdhjetë shkurt të vitit 1925 në Gjenevë dhe ratifikua nga shtatë fuqitë e mëdha të asaj kohe si: Britania, India, Franca, Japonia, Holanda, Portugalia dhe Tajlanda. Konventa e parë e Gjenevës është përqendruar në vende të prodhimit të opiumit. Nënshkruesit u lejohe për të shitur opium vetëm nëpërmjet monopoleve qeveritare, të cilat qeveri ishin ti gatshme për t'i dhënë fund tregtisë me opium tërësisht brenda pesëmbëdhjetë vjetësh. Kjo konferencë është iniciuar nga Lidhja e Kombeve. Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore u krijua Lidhja e Kombeve<sup>8</sup>. Ndonëse Shtetet e Bashkuara refuzuan të marrin pjesë në Lidhjen e Kombeve, komunikimet informale vazhduan ndërmjet Lidhjes së Kombeve dhe Shteteve të Bashkuara përmes qeverive dhe diplomatëve tjerë. Pavarësisht përparimeve të Konferencës të Shangait (1909) dhe të Hagës (1912), opiumi dhe trafikimin ndërkombëtar i opiumit ka vazhduar të jetë një problem i madh.

Në vitin 1928 Konventa hyri në fuqi dhe është nënshkruar dhe ratifikuar nga pesëdhjetegjastë shtete, ku përfshinte shumë nga akterët kyç të tregtisë me drogë, si nga anëtarët dhe jo anëtarët e Lidhjes të Kombeve si: Perandorinë Britanike, Indinë, Holandën, Francën, Japoninë, Bashkimin Sovjetik, Gjermaninë, Zvicrën, Turqinë, Portugalinë, Egjiptin, dhe Bolivinë. Megjithatë, Konventa nuk është nënshkruar dhe ratifikuar ndër aktorët tjerë kyç si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina, Persia (*nënshkruar por jo ratifikuar*) dhe Perusë.<sup>9</sup>

Kjo konventë u fokusua në vendet e prodhimit të opiumit ku kombet nënshkruese ishin deklaruar “plotësisht të vendosur për të sjellë ndalimin gradual dhe efektiv të prodhimit të tregtisë së brendshme dhe përdorimit të opiumit të përgatitur”.<sup>10</sup>

Qëllimi i Konventës ishte parandalimi i trafikimit të paligjshëm dhe vendosjen e kontrolleve të rrepta. Bile Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë kërkuar ndalimin plotë të prodhimit dhe përdorimit të heroinës, mirëpo ky propozim nuk u miratua për shkak të kundërshtimit nga mjekët britanik dhe francez të cilët besonin se heroina është një analgetik i pazëvendësueshëm. Me këtë Konventë për herë të parë u vendos kanabisi nën mbikëqyrje.

Me Nenin e parë të Konventës kërkohet përjashtimi i shitjes me pakicë. Importimi, shitja

<sup>8</sup>Lidhja e Kombeve u krijua pas Luftës së Parë Botërore nga fuqitë fitimtare të mbledhura në Konferencën e Paqes në Paris. Për krijimin e Lidhjes së Kombeve, përkrahësi më i fortë ishte presidenti i SHBA-ve Woodrow Wilson. Por, për ironi Senati i vendit të tij nuk pranoi të ratifikonte anëtarësinë e Shteteve të Bashkuara dhe si pasojë, shteti më i fortë i botës u tërhoq në njëfarë ‘izolimi’. Nga fuqitë e tjera të mëdha, vetëm Britania dhe Franca mbetën anëtare gjatë gjithë ekzistencës së Lidhjes. Gjermania, Bashkimi Sovjetik, Japonia dhe Italia hynë vonë, ose u tërhoqën ose i bënë të dyjat.

<sup>9</sup>“International Opium Convention”, Geneva 19 February 1925, qasur me 20 dhjetor, 2014. nga: <http://untreaty.un.org/ENGLISH/bible/englishinternetbible/partI/chapterVI/treaty6.asp>

<sup>10</sup>Schaffer Library of Drug Policy, “The 1925 Geneva Opium Conventions”, qasur me 10 janar, 2015. nga: [http://druglibrary.org/schaffer/library/studies/canadasenate/vol3/chapter19\\_1925\\_Geneva.htm#\\_ftn2](http://druglibrary.org/schaffer/library/studies/canadasenate/vol3/chapter19_1925_Geneva.htm#_ftn2), qasur me 15, dhjetor, 2014.

dhe shpërndarja e opiumit të jetë një monopoli i qeverisë, e cila do të ketë ekskluzivisht të drejta për të importuar, shitur, ose shpërndarjen e opiumi. Lizingu, delegimit i kësaj të drejtë ishte e ndaluar në mënyrë specifike. Me nenin e dytë kërkohet ndalimi i shitjes së opiumit për të miturit, kurse me nenin e tretë të bëhet ndalesa i të miturve për të hyrë në divanet e tymosjes së opiumit (smoking divans). Neni i katërt ju kërkohet qeverive për të kufizuar numrin e dyqaneve të shitjes me pakicë të opiumit dhe tymosjen e opiumit në divane (smoking divans) sa më shumë të jetë e mundur. Nenet pestë dhe gjashtë kanë rregulluara eksportin dhe transportin e opiumit dhe fundërrinës së saj. Dhe, me nenin shtatë kërkohet nga qeveritë për të dekurajuar përdorimin e opiumit përmes mësimit nëpër shkolla, literaturës, dhe metodave të tjera.<sup>11</sup>

Nga kjo që u pa më lart nga neni i parë shohim hapin e parë të futjes nën kontroll të importimit dhe shitjes dhe shpërndarjen e opiumit nga ana e shteteve nënshkruese si një preventivë për luftimin e kriminalitetit me narkotikë. Po ashtu neni i dytë dhe i tretë ju ndihmon shumë shteteve për të marrë masa adekuate për të parandaluar përdorimin e opiumit tek të miturit kur dihet se në atë periudhë të përdorimi varshmëria e opiumit tek të miturit ishte me shifra marramendëse. Përveç shitjes sipas nenit të dytë po ashtu sipas nenit të tretë ju ndalohej edhe hyrje në vendet ku tymosej opiumi në divane (smoking divans) si masë preventive. Nëse analizohet neni shtatë shihet se me këtë konventë shtete pjesëmarrëse dakordohen për masat preventive përmes fushatave parandaluese nëpër shkolla, përmes broshurave apo literaturave të ndryshme dhe metodave tjera që nuk specifikohet detalisht por që mbetet që vendet nënshkruese të zgjedhin metoda adekuate në vendet e tyre për të parandaluar në masë sa më të madhe përdorimin e opiumit në vendet e tyre.

### **Konventa e II- të e Gjenevës për kufizimin e prodhimit dhe rregullimin e shpërndarjes së drogave narkotike, 1931** (*Convention for Limiting the Manufacture and Regulating the Distribution of Narcotic Drugs, 1931*)

Pesëdhjeteshtatë shtete morën pjesë në Konferencën për kufizimin e prodhimit dhe rregullimin e shpërndarjes së Drogave Narkotike, të cilat u takuan në Gjenevë prej njëzeteshtatë maj deri më trembëdhjetë korrik të vitit 1931. Konventa për kufizimin e prodhimit dhe rregullimin e shpërndarjes së drogave narkotike, përveç për përdorim të mjekësisë dhe shkencës, hyri në fuqi në korrik të vitit 1933 dhe u ratifikua nga dyzet shtete. Po atë vit në Bangkok të Tailandës me njëzeteshtatë nëntor, u nënshkrua marrëveshja për kontrollin e konsumit të opiumit për tymosje në Lindjen e Largët.

Përfundimisht gjashtëdhjeteshtatë shtete nënshkruan dhe ratifikuan këtë konventë, duke përfshirë të gjithë prodhuesit kryesorë të drogës: Shtetet e Bashkuara, Gjermaninë, Zvicrën, Holandën, Britania e Madhe dhe Irlandën e Veriut, Francën, Kanada, Australinë dhe Bashkimin Sovjetik<sup>12</sup>. Konventat Ndërkombëtare për Opium e vitit 1912, Konventa

<sup>11</sup>League of Nations, Agreement concerning the Suppression of the Manufacture of, Internal Trade in, and Use of, Prepared Opium, Geneva, 11 February 1925.

<sup>12</sup>“Convention for limiting the Manufacture and regulating the Distribution of Narcotic Drugs”, Geneva, 13 July 1931, qasur me 22 janar 2015. nga: <http://untreaty.un.org/ENGLISH/bible/englishinternetbible/partI/chapterVI/treaty10.asp>

Ndërkombëtare mbi Opium dhe drogat tjera e vitit 1925, dhe Konventa për kufizimin e prodhimit dhe rregullimin e shpërndarjes së drogave narkotike, e vitit 1931, siguruan një bazë për kontrollin tregtisë së ligjshme me substancat psikoaktive.

Konventa e vitit 1931 paraqiti një sistem të preventivave të detyruara që kishin për qëllim kufizimin e prodhimit botëror të drogës për sasi të nevojshme për qëllime mjekësore dhe shkencore dhe për të krijuar një trup mbikëqyrës të drogës për të monitoruar funksionimin e sistemit<sup>13</sup>

Konventa të vitit 1931 gjithashtu prezantoi siç njihet sot si 'klasifikimi i drogave', duke aplikuar masa të ndryshme të kontrollit për droga të ndryshme. Sipas Konventës të vitit 1931, shkalla e kufizimit dhe rregullimit varionte sipas dy kritereve: e para ishte shkalla e rrezikut e prezantuar nga një drogë e caktuar, dhe e dyta ishte shkalla në të cilën një i drogave përdorej nga profesioni mjekësor.

Nga këto këndvështrime, drogat e mbuluara nga kjo Konventa hynë në tre grupe.<sup>14</sup> Droga siç janë codeine dhe dionine, i ishin nënshtruar masave më pak të rrepta për shkak të shërbimeve të tyre mjekësore dhe potencialit të ulët të abuzimit. Në të kundërt në grupin e tretë heroina, u ndalua për eksport, përveç në kushte të veçanta. Sipas Konventës, çdo heroinë e konfiskuar ose duhet të shkatërrohet ose të konvertohet, në vend se të ridrejtohet kah përdorimi mjekësor ose shkencor, siç u lejohet për konfiskimet e disa drogave të tjera.

### **Konventa e III- të e Gjenevës për ndalimin e trafikut të paligjshëm të drogave të rrezikshme, 1936** (*Convention for the Suppression of the Illicit Traffic in Dangerous Drugs, 1936*)

Me iniciativën e Komisionit Policor Ndërkombëtar, paraardhëse e Policisë Ndërkombëtare Kriminale (*Organizata INTERPOL*), negociatat kishin filluar në 1930 për të zhvilluar një traktat për të ndaluar trafikimin e paligjshëm të drogës dhe për të ndëshkuar rëndë trafikantët përmes sanksioneve penale. Në vitin 1936 me njëzetegjashtë qershor, Konventa për ndalimin e trafikut të paligjshëm të drogave të rrezikshme u aprovua në Gjenevë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të udhëhequr nga Anslinger, kishte tentuar të përfshijë dispozita për të penalizuar të gjitha aktivitetet e kultivimit, përpunimit, prodhimit dhe shpërndarjes që lidhet me përdorimin e opiumit, kokainës (*dhe derivateve të saj*) dhe i kanabisit për qëllime jo-mjekësore dhe jo-shkencore. Shumë vende e kundërshtuan këtë propozim, dhe fokusi mbeti mbi trafikun e paligjshëm. Neni i dytë i Konventës<sup>15</sup> bëri thirrje shteteve nënshkruese të përdorin sistemet e tyre të drejtësisë në fushën penale për të dënuar "ashpër", "veçanërisht me burg ose dënime të tjera të privimit të lirisë", aktet e lidhura direkt me trafikun e drogës.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës refuzuan të nënshkruanin versionin përfundimtar, sepse ai version konsiderohej si shumë i dobët, veçanërisht në lidhje me ekstradimin, ekstraterritorialitetin dhe konfiskimin e të ardhurave të trafikut me drogë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin gjithashtu të shqetësuar se me nënshkrimin e saj mund të

<sup>13</sup>United Nations, (1998) "The beginnings of international drug control", *UN Chronicle*,

<sup>14</sup>United Nations, (1953) "Article 10 of the 1931 Convention". *Bulletin on Narcotics*, Issue 2-013.

<sup>15</sup>Qasur me 20 shkurt 2015. [http://www.druglibrary.org/schaffer/library/studies/canadasenate/vol3/chapter19\\_1936\\_geneva.htm#\\_ftnref1/](http://www.druglibrary.org/schaffer/library/studies/canadasenate/vol3/chapter19_1936_geneva.htm#_ftnref1/)

dobësohej sistemi i brendshëm penal i tyre për kontrollin dhe për zbatimin e Konventës. Në fakt, Konventa kurrë nuk gjeti pranim të gjerë, sepse shumica e vendeve të interesuara për luftimin trafikut me narkotik nënshkruanin traktate e tyre bilaterale.

### **Protokolli i vitit 1946, Lake Success** (*The Lake Success Protocol of 1946*)

Në Lake Success të të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me njëmbëdhjetë dhjetor të vitit 1946 u nënshkrua protokollin me të cilin ndryshohen dhe plotësohen Konventa ndërkombëtare për opium të Hagës të vitit 1912, Konventa e I- rë e Gjenevës e viti 1925, Konventa e II- të e Gjenevës të vitit 1931 dhe Konventa e III e Gjenevës e vitit 1936.

### **Protokolli i vitit 1948, Paris** (*The Paris Protokoll of 1948*)

Parimi se të gjitha substancat që krijojnë varësi duhet të jetë nën kontroll u pranua përgjithësisht gati dyzet e pesë vjet më parë dhe rrallë herë ka qenë i sfiduar. Në këto përpjekje, Protokollin Parisi i nëntëmbëdhjetë nëntorit i vitit 1948 zë një vend meritues, sepse me nënshkrimin e këtij protokollin u vendosën nën mbikëqyrje ndërkombëtare drogat sintetike të cilat me konventën e vitit 1931 dhe protokollin i vitit 1946 nuk i ishin përfshirë dhe përmendur fare. Ky protokoll filloi të vlej prej vitit 1949

### **Protokolli dhe akti final i njëzetetë qershorit 1953** - (*Protocol and Final Act of 23 June 1953*)

Në New York, SHBA, më njëzetetë qershor të vitit 1953 u nënshkrua protokollin qëllimi i secilës ishte ndalimi i prodhimit dhe tregtisë së opiumit në vendet e prodhimit. Protokollin lejoi prodhimin e opiumit për qëllime mjekësore dhe shkencore në Bullgari, Greqi, Indi, Turqi dhe BRSS e Jugosllavinë e atëherëshme. Ky protokoll ka qenë i vlefshëm deri në vitin 1963.

### **Konventa e vetme mbi drogat narkotike, 1961** (*Single Convention on Narcotic Drugs, 1961*)

Miratimi i kësaj Konvente konsiderohet si një moment historik në historinë e kontrollit ndërkombëtar të drogës. Konferenca e Kombeve të Bashkuara për miratimin e një Konvente të vetme mbi drogat narkotike u mbledh në Selinë e Kombeve të Bashkuara në New York nga njëzetekatër janari deri më njëzetepesë mars të vitit 1961 ku shtatëdhjetë e tre shtetet morën pjesë në këtë konferencë

Qëllimi ishte për të zëvendësuar traktatet e shumta ekzistuese shumëpalëshe në fushën drogës me një instrument të vetëm, si dhe për të zvogëluar numrin e organeve të traktateve që merren me kontrollin e drogave narkotike, dhe për të bërë dispozita për kontrollin e prodhimit të lëndëve të para të drogave narkotike. Konventa vetme hyri në fuqi më trembëdhjetë dhjetor 1964. Me miratimin e kësaj konvente pushuan së ekzistuari të gjitha konventat e mëherëshme ndërkombëtare, marrëveshjet dhe protokollin. Nënshkruesit e Konventës janë obliguar që të harmonizojnë legjislacionet e tyre me Konventën dhe që të

formojnë organe që do ti mbikëqyrë zbatimin e tyre.

### **Konventa mbi substancat psikotrope, 1971** (*Convention on Psychotropic Substances of 1971*)

Konventa mbi Substancat Psikotrope e vitit 1971 është një traktat i Kombeve të Bashkuara i projektuar për të kontrolluar drogat psikoaktive (*amphetamines, barbiturates, benzodiazepines, dhe psychedelics*) e nënshkruar në Vjenë të Austrisë më njëzetën shkurt të vitit 1971. Konventa e vetme mbi drogat narkotike e vitit 1961 kishte mangësi sepse nuk mund të ndalonte risitë e zbuluara të substancave psikotrope (*p.sh, LSD, meskallin, stimulansë të ndryshëm kanabis etje.*). Arsyeja ishte se fushëveprimi i saj ishte i kufizuar tek drogat si kanabis, kokainë, dhe efektet e opiumit. Konventa e vitit 1971 substancat psikotrope i ka trajtuar njëjtë sikur drogat. Konventa përmbante edhe disa obligime konkrete të shteteve nënshkruese si p.sh, aftësimi i ekspertëve për parandalimin e keqpërdorimit të këtyre substancave, mundësimin e shërimit dhe rehabilitimit në vend të dënimit.

### **Protokolli i vitit 1972 për ndryshimin e Konventës së vetme mbi drogat narkotike, 1961** (*Protocol amending the Single Convention on Narcotic Drugs, 1961*)

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për të shqyrtuar ndryshimet e Konventës së vetme mbi drogat narkotike e vitit 1961, u mbajt në Gjenevë nga gjashtë deri me njëzetepesë mars të vitit 1972 ku miratua Protokolli për ndryshimin Konventës së vetme mbi drogat narkotike e vitit 1961. Protokolli ishte një mbikëqyrje e zgjeruar e kultivimit të opiumit dhe prodhimit të drogave sintetike. Me protokoll me kufizimin e prodhimit të opiumit u mundësua shkatërrimi ilegal i prodhimit të opiumit dhe kanabisit, si dhe forcimi i disa ndalesave të konventës së lartpërmendur.

Konferenca, e cila ishte thirrur nga Këshilli Ekonomik dhe Social (Rezoluta 1577 (L) e 21 Majit 1971), u ndoq nga përfaqësuesit e nëntëdhjeteshtatë shtete; pesë shtete kishin dërguar vëzhgues, Konferenca u ndoq edhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, Bordi i Kontrollit Ndërkombëtar të Narkotikëve dhe Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale (INTERPOL).<sup>16</sup>

Protokolli rrit përgjegjësinë e Bordit të Kontrollit Ndërkombëtar të Narkotikëve për sigurimin e bashkëpunimit me qeveritë shtetërore, ndërsa në të njëjtën kohë bënë parandalimin e kultivimit të paligjshëm, përpunimit, prodhimit dhe trafikimit të drogave.

### **Deklarata mbi kontrollin e trafikut të drogës dhe abuzimit me drogë, 1984** (Declaration on the Control of Drug Trafficking and Drug Abuse, 1984)

Në New-York në vitin 1984 asambleja e përgjithshme e OKB-së miratoi deklaratën mbi kontrollin e trafikut të drogës dhe abuzimit me drogë. Me këtë deklaratë Organizata e Kombeve të Bashkuara shënjoji tregtinë dhe abuzimin si “Veprimtari kriminale

<sup>16</sup>UNDOC, qasur me 25.02.2015 nga: [https://www.unodc.org/unodc/en/data-and-analysis/bulletin/bulletin\\_1972-01-01\\_3\\_page002.html](https://www.unodc.org/unodc/en/data-and-analysis/bulletin/bulletin_1972-01-01_3_page002.html).

ndërkombëtare e cila kërkon një vëmendje të veçantë dhe sjellje preventive”. Tregtia ilegale dhe abuzimi i drogave paraqesin kërcënimin serioz të sigurisë dhe zhvillimin e shumë shteteve të cilat duhet ti kundërvihen me të gjitha mjetet juridike në planin nacional, regjional dhe ndërkombëtarë. Luftimi i tregtisë dhe abuzimi me drogë është caktuar në deklaratën si përgjegjësi e përbashkët e të gjitha shteteve.

### **Konventa kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, 1988** (Convention against illicit traffic in narcotic drugs and psychotropic substances, 1988)

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope e vitit 1988<sup>17</sup> është një nga tre traktateve e mëdha të kontrollit të drogës aktualisht në fuqi. Ajo siguron mekanizma shtesë ligjor për zbatimin e Konventës së vetme mbi drogat narkotike të vitit 1961 dhe Konventës të vitit 1971 mbi Substancat Psikotrope.

Konventa u miratua në Vjenë me nëntëmbëdhjetë nëntor të vitit 1988 me të cilën përcaktohen mbikëqyrje më e rreptë mbi tregtinë ilegale dhe substancat psikotrope si dhe financimin e tyre. Konventa mundëson zbulimin, ngrirjen dhe konfiskimin e pasurisë të arritur me tregtinë ilegale me drogë dhe substanca psikotrope.

Konventa hyri në fuqi më njëmbëdhjetë dhjetor 1990. Në qershor të vitit 2014 Konventa ka pasur 189 Palët nënshkruese.<sup>18</sup>

### **Përfundimi**

Përdorimi, përpunimi, prodhimi dhe tregtia me opium është shfaqur dhe shfaqet në forma të ndryshme gjatë gjithë historisë, që nga viti 3.400 p.e.r, e deri më ditët tonë, në fillim kjo dukuri është shfaqur me opium e më vonë me kokainë, heroinë, marihuanë, droga sintetike dhe prekursor. Shpërndarja dhe përdorimi i opiumit filloi të zgjerohej edhe më shumë kur kinezët shfrytëzuan rrugët tokësore dhe ujore të mëndafshit për transportin e opiumit. Në fillim u neglizhuan nga vendet prodhuese efektet negative të përdorimit të tij, por me kalimin e kohës gjegjësisht në vitin 1729 Perandori Kinez Yung Cheng u detyrua që të lëshoj një akt të veçantë “Edictum” për ndalimin e parë për tymosjen e opiumit, ky akt e kishte karakterin nacional brenda Perandorisë kineze, dhe ende mungonte një interesim ndërkombëtarë për bashkëpunim kundër përdorimit, përpunimit, prodhimit dhe tregtisë me opium.

Për luftimin e kriminalitetit në nivel transnacional, rëndësi të veçantë kanë konventat, protokollet, deklaratat që janë miratuar që nga Konferenca e Shangait e vitit 1909, ku mblodhën trembëdhjetë shtete për të diskutuar për problemet e narkotikëve si problem transnacional, dhe për vendosjen rregullit për kontrollin ndërkombëtar të narkotikëve. Pra kjo konferencë siç u pa më lart e ka rëndësinë e vetë të veçantë sepse është dokumenti i parë ku fuqitë botërore të asaj kohe u mblodhën për diskutuar problemin e opiumit si

<sup>17</sup>UNDOC, qasur me 20.03.2015 nga [https://www.unodc.org/pdf/convention\\_1988\\_en.pdf](https://www.unodc.org/pdf/convention_1988_en.pdf).

<sup>18</sup>“Monthly Status of Treaty Adherence”. United Nations Office on Drugs and Crime. Archived from the original on 2007-11-07. Retrieved 2011-12-19.

një problem transnacional. Pasandaj me zgjerimin përdorimit të opiumit dhe mungesën e një instrumenti obligativ ligjor ndërkombëtare në vitin 1912 në Hagë u miratua Konventa e parë si instrument obligativ i të drejtës ndërkombëtare për mbikëqyrjen e transportit tokësor dhe ujqor të opiumit. Me Konventën e parë të Gjenevës për herë të parë u vendos nën mbikëqyrje edhe kanabisi, kurse me Konventën e dytë siç u pa më lartë u vendos një kufizim i prodhimit, e me Konventën e tretë të Gjenevës u ndalua tregtia ilegale me drogë ku edhe u vendosën dënimet si dhe masat preventive për luftimin dhe keqpërdorimit të drogës. Protokollet e viteve 1946,1948 si dhe 1953 kanë plotësuar dhe ndryshuar konventat e më hershme ku edhe u vendosën nën mbikëqyrje edhe drogat sintetike. Bashkëpunimi ndërkombëtar filloi të formësohej me Konventa e vetme mbi drogat narkotike të vitit 1961 ku të gjitha dokumentet e më hershme u unifikuan dhe shtetet nënshkruese morën obligim për ndjekjen e kryerësve të veprave penale me narkotik, dhe për inkorporimin e legjislacionit të tyre nacional me Konventën. Përsëri me kalimin e viteve bashkëpunimi ndërkombëtar ishte më i mangët për arsye se në treg filluan të përhapen drogat sintetike kurse këto droga me konventat e më hershme nuk ishin përfshi gjë që ishte mangësi e tyre, andaj kjo zbrazëtirë e bashkëpunimit ndërkombëtarë u plotësua me Konventën e substancave psikotrope. Luftimi i tregtisë transnacionale dhe abuzimi me drogë të ndryshme është caktuar në Deklaratën mbi kontrollin e trafikut të drogës dhe abuzimit me drogë, si përgjegjësi e përbashkët e të gjitha shteteve për ta luftuar kriminalitetin transnacional të tregtisë me substanca narkotike. Konventa e cila është në fuqi edhe sot e kësaj dite që siguron zbatimin për zbulimin, ngrirjen dhe konfiskimit e parave të fituara me tregtinë ilegale me narkotikë është Konventa kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope.

Nga kjo që u shtjellua në këtë punim u pa se pa një rregullim ndërkombëtar ligjor për parandalimin abuzimit të drogave dhe substancave psikotrope nuk do të ishte e mundur të luftohet krimi i organizuar, gjegjësit kriminalitetit me narkotik. Për të luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar është më se e domosdoshme që institucionet kompetente të shteteve nacionale ti harmonizojnë legjislacionin konform konventave ndërkombëtare për bashkëpunimin transnacional.

## Bibliografia

### Burimet Primare

- Allan, T. (2001). « Drug Laws: the debate nobody wants ». The Guardian. May 14.
- Carruthers, SG (1980). "Duration of drug action". Am Fam Physician **21** (2): 119-26. Retrieved 3 November 2012
- Convention against Illicit Traffic in Narcotic Drugs and Psychotropic Substances, 1988 (CTS 1990/42).
- Convention for limiting the Manufacture and regulating the Distribution of Narcotic Drugs", 1931. Geneva.
- Convention on Psychotropic Substances, 1971 (CTS 1988/35).
- International Opium Convention", 1925. Geneva.
- Malanczuk, P. (1997). Akehurst's Modern Introduction to International Law, seventh revised edition Routledge.
- McAllister, W.B. (1999). Drug Diplomacy in the Twentieth Century : An international history.



London : Routledge.

- Monthly Status of Treaty Adherence. United Nations Office on Drugs and Crime. Archived from the original on 2007-11-07. Retrieved 2011-12-19
- Softić, S. (2007) “Međunarodno pravo”, Sarajevo: FKKSS.
- United Nations, (1953). “Article 10 of the 1931 Convention’. Bulletin on Narcotics,
- United Nations, (1998) “The beginnings of international drug control”, UN Chronicle.

## Burime sekundare

- <http://cbn.nic.in/html/opiumhistory1.htm>, qasur me 11, nëntor, 2014.
- <http://www.unodc.org/unodc/en/frontpage/the-1912-hague-international-opium-convention.html>, qasur me 18 dhjetor, 2014.
- <http://untreaty.un.org/ENGLISH/bible/englishinternetbible/partI/ chapterVI/treaty6.asp>, , qasur me 20 dhjetor, 2014.
- [http://druglibrary.org/schaffer/library/studies/canadasenate/vol3/chapter19\\_1925\\_Geneva.htm#\\_ftn2](http://druglibrary.org/schaffer/library/studies/canadasenate/vol3/chapter19_1925_Geneva.htm#_ftn2), qasur me 15, dhjetor, 2014.
- <http://untreaty.un.org/ENGLISH/bible/englishinternetbible/partI/chapterVI/ treaty10.asp>, qasur me 22 janar 2015.
- [http://www.druglibrary.org/schaffer/library/studies/canadasenate/vol3/chapter19\\_1936\\_geneva.htm#\\_ftnref1/](http://www.druglibrary.org/schaffer/library/studies/canadasenate/vol3/chapter19_1936_geneva.htm#_ftnref1/), qasur me 20 shkurt 2015.
- <http://www.un.org/documents/ga/res/39/a39r142.htm>, qasur me 18.03.2015.
- [https://www.unodc.org/pdf/convention\\_1988\\_en.pdf](https://www.unodc.org/pdf/convention_1988_en.pdf). qasur me 20.03.2015.